

ENVER HOXHA

VEPRA

29

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
- PRANË KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

V E L L I M I

2 9

SHKURT 1965 - MAJ 1965

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1979

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 29-TË

Vëllimi i 29-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës shkurt-maj 1965, shumica e të cilave botohen për herë të parë.

Në të gjitha dokumentet e këtij vëllimi, në fjali-
met, artikujt, diskutimet në Byronë Politike e në Se-
kretariatit e Komitetit Qendror dhe në bisedat me të
huajt pasqyrohet vija e kristaltë marksiste-leniniste e
Partisë sonë në trajtimin e problemeve të brendshme
e të jashtme.

Problemet e politikës së brendshme të Partisë
zënë një vend të veçantë në materialet e këtij vëllimi.
Nëpërmjet tyre komunistët dhe masat punonjëse arma-
tosen më tej politikisht e ideologjikisht, për të reali-
zuar me sukses detyrat në të gjitha fushat e ndërtimit
dhe të mbrojtjes së socializmit. Gati në të gjitha shkri-
met theksohet fort nevoja e zbatimit të parimit revo-
lucionar të ndërtimit dhe të mbrojtjes së socializmit,
duke u mbështetur fuqimisht në forcat e veta. Në këto
materiale gjejmë një përpunim të mëtejshëm të poli-
tikës së Partisë për industrializimin socialist të vendit
dhe për intensifikimin me ritme të shpejta të bujqë-
sisë, duke u mbështetur në parimet themelore të mar-

ksizëm-leninizmit dhe në përputhje me kushtet konkrete të vendit tonë.

Për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë i jepet një rëndësi e veçantë zhvillimit të industrisë minerare, ngritjes së uzinave për prodhimin e plehrave kimike, ndërtimit të hidrocentraleve, siç ishte ai i Vaut të Dejës, ndërtimit të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Ndërtimi i këtyre veprave thekxson shoku Enver «është një detyrë shumë e madhe, urgjente dhe shpëtimtare për vendin tonë. Asnjë nuk duhet të mbetet prapa në punë, edhe ai më i thjeshti të mobilizojë në shkallën maksimale të gjitha energjitë që këto vepra të mbarojnë sa më parë për të mirën e atdheut, të popullit dhe të secilit».

Realizimi me sukses i detyrave shihet jo si një problem thjesht ekonomik për rritjen e mirëqenies së masave e për fuqizimin ekonomik të vendit, por edhe si problem i rëndësishëm politik e ideologjik që ka të bëjë me çuarjen përpara të revolucionit.

Në dokumentet e këtij vëllimi trajtohen probleme që kanë të bëjnë me edukimin e komunistëve e të masave të gjera punonjëse, me përgatitjen e tyre politiko-ideologjike dhe ushtarake. Këto kushtëzoheshin dhe nga situatat në të cilat kalonte vendi. Borgjezia, imperialistët dhe revizionistët e kishin dëndësuar në mënyrë të ndjeshme diversionin ideologjik ndaj vendit tonë dhe kërkonin të gjenin ndonjë të çarë për të realizuar qëllimet e tyre.

Shoku Enver Hoxha porositte të gjithë Partinë, komunistët, klasën punëtore, masat punonjëse, që të

jetonin me këto situata, të mobilizoheshin me frymë të lartë luftarake për të realizuar të gjitha detyrat e planit të vitit 1965, që ishte edhe viti i fundit i pesë-vjeçarit të tretë, dhe të mbanin lart vigjilencën revolucionare, për të mos u zënë kurrë në befasi nga armiku. Një rëndësi e veçantë i jepej punës politike dhe ideologjike me të gjithë punonjësit, me qëllim që të krijoheshin tek ata bindje të thella dhe të qarta për domosdoshmërinë e realizimit të këtyre detyrave.

Në materialet e këtij vëllimi jepen porosi shumë të vlefshme edhe për rrugët se si të realizohen detyrat e shumta. Të një rëndësie të veçantë janë fjala në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës «Metoda dhe programi i punës së organizatave-bazë të Partisë të jenë model për të gjithë punonjësit», fjala në Plenumin e 14-të të KQ të PPSH «Realizimi i planit kërkon dituri, organizim, punë sistematike», fjala në konferencën e BRPSH të rrethit të Elbasanit «Rinia — forcë e madhe për ndërtimin e socializmit», si dhe materialet «Të ngrihemi në këmbë për ndërtimin e veprës së madhe të metalurgjisë së zezë në Elbasan», «Forcimi i Partisë është hallka kryesore» etj.

Në diskutimet në Sekretariat dhe në Byronë Politike të Komitetit Qendror të Partisë si dhe në fjalime dhe artikuj të ndryshëm porositen komunistët që t'i mbajnë gjithnjë të pastra dhe të forta themelet e Partisë, organizatat-bazë, t'i bëjnë ato çerdhe revolucionare ku të kaliten e të edukohen në tej komunistët e me shëmbullin, me fjalën dhe me punën e tyre të udhë-

heqin me zotësi masat në punën e madhe për realizimin e detyrave.

Kryerja me sukses e detyrave të shumta e të vështira që parashikonte plani, kërkonte të thellohej më tej puna në fushën e arsimit e të shkencës, të bëheshin këto çdo ditë e më tepër pronë e masave të gjera punonjëse, të përshkoheshin nga politika e Partisë, nga ideologjia marksiste-leniniste e saj, të lidheshin sa më ngushtë me problemet më akute që kishte ekonomia jonë.

Në materiale të tilla si «Puna shkencore kërkon pasion, disiplinë, metodë», «Problemet e shkollës studiohen e zgjidhen sipas kushteve të reja», «Shkolla jonë është politike dhe ideologjike», shohim se ç'rëndësi e kujdes të posaçëm i kushtohet zhvillimit të mëtejshëm të arsimit e të shkençës sonë socialiste.

Të shumta janë shkrimet e këtij vëllimi që trajtojnë në mënyrë shkencore probleme të politikës së jashtme marksiste-leniniste të Partisë sonë. Këto materiale i përshkon si një fill i kuq vendosmëria për të vazhduar me konsekuencë luftën në dy fronte: kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, duke mbrojtur deri në fund marksizëm-leninizmin, revolucionin dhe duke mbështetur e duke përkrahur me të gjitha forcat luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Në saje të luftës së guximshme të Partisë sonë dhe të partive të vërteta marksiste-leniniste iu çor maska revizionizmit hrushovian.

Në shkrimet e këtij vëllimi u bëhet një analizë e thellë shkencore marksiste-leniniste kontradiktave që

brejnë revizionizmin dhe vihet në dukje se midis revizionistëve nuk ka e s'mund të ketë unitet, se ata janë të destinuar të shkatërrohen ashtu si të gjitha forcat e imperializmit e të reaksionit. Siç theksohet në bisedën me Çu En Lain «Revizionizmi mban në vetvete disfatën. Ai sjell disfatën për ata që janë infektuar prej tij, sepse revizionizmi është tradhti, është disfatizëm, kapitullim, shkatërrim».

Rruga në të cilën ishin futur prej kohësh revizionistët hrushovianë e pasqardhësit e tyre, i kishte bashkuar ata përfundimisht me imperializmin e reaksionin, prandaj PPSH dhe shoku Enver Hoxha, me argumente bindëse, theksonin domosdoshmërinë e luftës gjer në fund kundër revizionistëve modernë. Në materiale të tilla si «Shqipëria socialiste i ka kryer dhe do t'i kryejë deri në fund detyrat e saj për triumfin e marksizëm-leninizmit», «Trojka hrushoviane — Brezhnjev-Kosigin-Mikojan, në rrugën e mohimit dhe të sabotimit të luftërave çlirimtare të popujve», apo «Të mbrosh me gjak lirinë e pavarësinë e vendit tënd është patriotizëm i madh, virtutet e madh» spikatin qartë rruga konsekuente e PPSH në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, vendosmëria e saj për të zhvilluar kurdoherë drejt e pa u lëkundur këtë luftë, papajtueshmëria e saj me pikëpamjet e revizionistëve kinezë që në atë periudhë kërkonin të mbështeteshin edhe te revizionistët modernë gjoja për të luftuar kundër imperializmit. PPSH e shoku Enver theksonin me forcë se asnjë iluzion e shpresë s'mund e s'duhet mbajtur te natyra e revizionistëve modernë. Ata ishin dhe mbeten armiq të betuar të proletariatit, të popujve, të

revolucionit. Revizionistët modernë, e në radhë të parë ata sovjetikë, ashtu si dhe imperialistët, me në krye ata amerikanë, përbëjnë një front të madh e të përbashkët për të shtypur revolucionin dhe luftërat nacionalçlirimtare. Ndaj dhe lufta kundër tyre është e pandarë.

Dokumentet e vëllimit të 29-të janë me vlerë të madhe për të gjithë komunistët dhe mbarë masat tona punonjëse, për ngritjen e tyre politiko-ideologjike në luftën për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit, si edhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga revizionistët e ndryshëm duke përfshirë edhe ata kinezë.

NATYRA KAPITALISTE E «VETADMINISTRIMIT PUNËTOR» JUGOSLLAV NË DRITËN E KONGRESIT TË 8-TË TË LKJ

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

7 shkurt 1965

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar u mbajt në Beograd Kongresi i 8-të i Lidhjes së «Komunistëve» të Jugosllavisë. Në rendin e ditës ishin jo më pak se 9 çështje dhe u mbajtën 5 raporte: nga Titoja, Kardeli, Rankoviçi, Vllahoviçi dhe Kolishevski. Për një vit të tërë titistët bënë zhurmë të madhe mbi «rëndësinë historike» të Kongresit të 8-të të LKJ jo vetëm për Jugosllavinë, po «për mbarë zhvillimin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për zhvillimin e shoqërisë botërore», sikurse theksohej, ndër të tjera, në direktivat e plenumit të 6-të të KQ të LKJ. Propagandës së tyre për ta paraqitur Kongresin e 8-të si një ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, si një pasurim krijues të marksizmit, i mbajti iso grupi revizionist i Hrushovit dhe pasuesit e tij, të cilët i premtuan udhëheqjes jugosllave pjesëmarrjen e tyre në kongres. Imperializmi amerikan, nga ana e tij, nuk i kurseu dolla-

rët dhe elozhet. Mjafton të përmendim deklaratën që bëri në prag të Kongresit të 8-të kryetari i komitetit për çështjet e politikës së jashtme të Senatit Amerikan, Fullbrajt, i cili, duke premtuar ndihmat e reja, theksoi se «Jugosllavia ndërton një shoqëri të re dhe ky është një eksperiment social, tek i cili vetë amerikanët mund të mësojnë shumë gjëra». Por me gjithë këtë përgatitje, jehona e Kongresit të 8-të të LKJ u shua përpara se të ndizej. «Opinionit botëror», tek i cili Titoja kishte shpresë se do t'i bënte jehonë kongresit, ideve të tij, nuk u preokupua fare për këtë kongres «me rëndësi historike ndërkombëtare».

Kongresi i 8-të i LKJ, duke u mbështetur në tezat themelore të referateve të Titos e të shokëve të tij, ishte një vazhdim i natyrshëm, një shtojcë e Kongresit të 7-të, një thellim i mëtejshëm në rrugën e tradhtisë, një thirrje e re për të zbatuar me besnikëri e konsekuencë programin e LKJ, të cilin, në kohën e vet, lëvizja komuniste e punëtore, gjithë opinionit publik revolucionar e përparimtar e dënoi njëzëri si kodin e revizionizmit modern. Kongresi i 8-të i LKJ ishte një orvatje tjetër për të futur në rrugën jugosllave parti e vende të tjera, sidomos partitë ku sundojnë revizionistët hrushovianë, ishte një nga ato «ura» për të cilat flet Xhonsoni dhe që do t'i shërbejnë atij për të futur kthetrat në vendet e demokracisë popullore.

Vendosja e programit të LKJ në bazën e gjithë veprimtarisë së Kongresit të 8-të do të mjaftonte për të vërtetuar se në interes të kujt u zhvillua Kongresi i 8-të i LKJ dhe se në ç'drejtim ai «hapi rrugë të

reja» për të ardhmen. Këtë realitet nuk mund ta shikojnë, se nuk duan ta shikojnë, vetëm revizionistët hrushovianë, për shkak të kauzës së përbashkët që kanë bërë me Titon. Këta, besnikë të kursit të predikuar nga N. Hrushovi, vazhdojnë të thërresin për socializmin titist, për marksizëm-leninizmin titist, për bashkekzistencën paqësore titiste, për origjinalitetin e rrugës jugosllave, për nevojën e analizës së gjendjes së re të krijuar nga «kthesa» që paskeshin bërë udhëheqësit jugosllavë. Por ndërsa hrushovianët i thurën himne nga tribuna e Kongresit të 8-të socializmit specifik jugosllav dhe disa prej tyre rregullojnë hapin pas ushtarit të veçuar nga toga, sikurse e quanin revizionizmin jugosllav dje, kur e «kritikonin», titistët, nga ana e tyre, ecin përpara dhe mundohen të marrin pas qerres të gjithë togën e revizionistëve hrushovianë.

Titistët theksuan edhe një herë me vendosmëri se i përmbahen pa rezerva programit të aprovuar në Kongresin e 7-të të LKJ. Vetë Titoja deklaroi me mburrje se «do të kishim më pak gabime sikur t'u ishim përmbajtur më shumë parimeve themelore të programit», i cili, sikurse theksoi ai, mbetet «udhërrëfyes i qartë për punën tonë». Revizionistët hrushovianë, pjesëmarrës në kongres, nuk bënë gjë tjetër veçse duartrokitën atë program që partitë e tyre me dokumente zyrtare, me vendime kolektive të marra në plenumë, konferenca apo kongrese të partisë, e kanë dënuar njëzëri. Qëndrimi i tyre ndaj Kongresit të 8-të të LKJ, solidarizimi me vendimet e tij, ishte një dëshmi tjetër e tradhtisë së tyre ndaj idealeve të marksizëm-leninizmit, ndaj çështjes së revolucionit socialist, ndaj çështjes së punë-

torëve, të fshatarëve dhe të popullit jugosllav, ishte një shkelje e hapët e Deklaratës së Moskës të vitit 1960, e detyrës së domosdoshme që kanë partitë marksiste-leniniste për të demaskuar udhëheqësit revizionistë jugosllavë dhe për të luftuar idetë e tyre revizioniste. Ai ishte gjithashtu në kundërshtim të hapët me vetë realitetin e sotëm të zhvillimit ekonomik e shoqëror të Jugosllavisë, i cili vërteton edhe një herë, në mënyrë të pakundërshtueshme, drejtësinë e mendimit kolektiv të partive komuniste e punëtorë motra, për vlerësimin e revizionizmit jugosllav dhe të pasojave të rrugës që ai ndjek duke filluar qysh nga Rezoluta e Byrosë Informative e vitit 1948.

Solidarizimi me udhëheqësit jugosllavë tregon she-shit se rivendosja e kapitalizmit nëpërmjet «vetadministrimit punëtor» u shkon plotësisht pas midesë edhe revizionistëve hrushovianë, se këta shfaqin një simpati të veçantë për eksperiencën jugosllave në këtë drejtim dhe dëshirojnë që «mësimet» e nxjerra prej saj t'i vënë në jetë në vendet e tyre. Përveç kësaj, asnjë kuptim tjetër nuk mund të ketë afrimi dhe bashkimi me titistët.

Përkrahja që revizionistët hrushovianë i dhanë Titos në këtë kongres e qetësoi këtë pas tronditjes që pësoi në ditët e para pas likuidimit nga udhëheqja e N. Hrushovit, frymëzuesit të politikës antimarksiste të rehabilitimit të Titos. Duke përshëndetur Titon dhe kongresin e tij, revizionistët hrushovianë përshëndetën politikën titiste, politikë që justifikon e mbrojnë veprimet agresive të imperializmit amerikan kundër lirisë e

pavarësisë së popujve dhe çështjes së paqes e të sigurimit ndërkombëtar. Për opinionin publik botëror janë tanimë të njohura qëndrimet proimperialiste amerikane të revizionistëve jugosllavë në ngjarjet e ndryshme ndërkombëtare, sikurse kanë qenë komplotet dhe aktet agresive kundër Kubës dhe Vietnamit të Jugut, kundër Laosit dhe Kamboxhias, kundër Kongos dhe Panamasë, kundër Qipros dhe Indonezisë etj.

1. Klika titiste — detashment diversioni në shërbim të imperializmit amerikan

E gjithë politika e jashtme e udhëheqjes revizioniste jugosllave, politikë fund e krye kundërrevolucionare e reaksionare, u ka shërbyer dhe u shërben me besnikëri të verbër interesave themelore të politikës së agresionit e të luftës së imperializmit amerikan. Ky tipar karakteristik i politikës së jashtme jugosllave, si shtojcë dhe mbështetje e politikës së imperializmit amerikan, u duk qartë edhe një herë në të gjitha raportet dhe diskutimet që u mbajtën në kongres. Ku haptazi e ku tërthorazi, titistët mbrojtën pozitën e politikës agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gati në të gjitha çështjet themelore të kohës. Ata nuk gjetën të thonë asnjë fjalë për demaskimin e politikës së imperialistëve amerikanë, por, përkundrazi, u përpoqën ta zbukurojnë dhe ta arnojnë atë në sytë e popujve, përsëritën falënderimet për dollarët e marrë dhe shtrinë duart për dollarë të tjerë. Titoja theksoi me bujë «ar-

syen dhe mendjen e shëndoshë të Kenedit», të cilat bëjnë që «të shpëtojë bota» nga zjarri i luftës gjatë shpërthimit të konfliktit të Karaibeve. Ai jo vetëm që nuk dënoi agresorët imperialistë, por përkundrazi, vendet si Laosi, Vietnami i Jugut, Kamboxhia, Kongo, Qipro etj., popujt e të cilave luftojnë kundër imperialistëve e neokolonialistëve për t'u çliruar e për të mbrojtur pavarësinë, i paraqiti si «vatra të rrezikshme jo vetëm për lirinë e pavarësinë e tyre, por edhe si rrezik për një luftë të re botërore».

Në raportin e Titos u bëhen elozhe rolit dhe veprimtarisë së OKB-së, e cila, në kundërshtim me realitetin historik, mburret si një «instrument i aftë që ka penguar konfliktet e luftës», që ka «siguruar paqen», që «lufton kolonializmin dhe gjithë format e pabarazisë në marrëdhëniet ndërkombëtare» etj., duke u bërë tërthorazi thirrje popujve të ndalojnë luftën për çlirim, sepse për çlirimin e tyre nga zgjedha imperialiste mendoka OKB-ja. Kjo është një mbrojtje e hapët e politikës dhe e akteve agresive që ka kryer kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër çështjes së socializmit e të paqes, imperializmi amerikan, vullneti i të cilit bën akoma ligje në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Me demagogjinë që e karakterizon, Titoja u orvat edhe kësaj here ta paraqesë Jugosllavinë si «vend i paangazhuar» dhe të bëjë predikime mbi politikën e mosangazhimit, të dalë bile në radhët e para të mbrojtësve të interesave të «vendeve të paangazhuara». Për të fituar pika, ai nuk u ndal as përpara formulimit të frazave bombastike e lajkatare të tilla si «politika e mosangazhimit është

një prej faktorëve më të mëdhenj që shpejton proceset progresive shoqërore, që ndryshon gjendjen në botë» etj. Por në fakt revizionistët jugosllavë janë përçarësit dhe sabotuesit e njohur të lëvizjes antiimperialiste nacionalçlirimtare. Jugosllavia, e udhëhequr prej tyre, është një vend plotësisht i angazhuar, i lidhur pas politikës së agresionit e të luftës të imperializmit amerikan, pas qerres së tij. Maskën e «vendit të paangazhuar» udhëheqja jugosllave e përdor për t'u shërbyer planeve të imperialistëve e të neokolonialistëve amerikanë, që përpiqen të depërtojnë kudo ku imperializmi e kolonializmi po pëson disfata, e sidomos në Afrikë, me qëllim që të zbukurojë imperializmin amerikan e të zbutë karakterin antiimperialist të luftës së popujve. Por ashtu si edhe në drejtimet e tjera, edhe në këtë drejtim, ajo ka pësuar disfatë, është demaskuar si shërbëtore e imperializmit amerikan (sikurse ndodhi edhe në konferencën e Kajros) dhe, pavarësisht nga demagogjia që bën rreth rrolit të saj në politikën e mosangazhimit, në të vërtetë, ajo nuk gëzon influencë në shtetet «e paangazhuara».

Në të gjitha raportet dhe dokumentet e Kongresit të 8-të, dhe në mënyrë të veçantë në raportin e Titos, u shpreh qartë antikomunizmi i revizionistëve jugosllavë, u shpreh qëndrimi i tyre armiqësor ndaj revolucionit socialist e në përgjithësi kundër çdo lëvizjeje revolucionare antiimperialiste. Me fraza të errëta, korfuze e demagogjike, që janë karakteristike për revizionistët, titistët, me qëllim që të frenojnë lëvizjen revolucionare të proletariatit, të shuajnë luftën e tij kla-

sore revolucionare, të vënë në gjumë vigjilencën e klasës punëtore përballë shtypjes e shfrytëzimit të egër kapitalist, predikuan kotësinë dhe bile dëmin që mund të pësojë proletariati nga revolucioni; bënë zhurmë për mundësitë e mëdha që janë krijuar sot për triumfin e socializmit pa revolucion, për vendosjen e socializmit kudo e vetvetiu, sepse, sipas tyre, «socializmi po bëhet gjithnjë e më shumë formë e zhvillimit të shoqërisë së sotme dhe e përparimit shoqëror përgjithësisht». Pra, si pasojë, proletariati nuk i duhet të luftojë, por të presë, ashtu siç është dëshira e imperialistëve dhe e borgjezisë ndërkombëtare, derisa «socializmi të bëhet gjithnjë e më shumë formë e zhvillimit të gjithë shoqërisë».

Udhëheqësit jugosllavë, nga tribuna e kongresit të tyre, u bënë thirrje revizionistëve hrushovianë që të gjithë së bashku të intensifikojnë luftën kundër «dogmatizmit» në kampin socialist e në lëvizjen komuniste. Në raportin e tij Titoja bëri kërcënime të hapëta dhe i paralajmëroi hrushovianët të mos ushqejnë iluzione e «të pajtohen me kompromise formale» me «dogmatikët». Pasi mbrojti N. Hrushovin nga «fyerjet» që iu bënë pas «fatkeqësisë» që pësoi, ai i thuri atij lëvdata për «rolin e madh në pikëpamje të destalinizimit dhe shprehjes më të lirë të qytetarëve», «për meritat e mëdha në ruajtjen e paqes në botë», «për përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë» (lexo për rehabilitimin e Titos me shokë), rol dhe merita që, sipas Titos, «nuk ia mohon as udhëheqja e PK të BS».

Titoja, i frymëzuar nga prania e revizionistëve hru-

shovianë në kongres, hodhi parullën «për të qëruar hespet me qëndrimet sektariste e dogmatike, për të përcaktuar në praktikë platformën antidogmatike të politikës së jashtme, sepse ka ende elementë stalinistë», që do të thotë për të vazhduar me konsekuencë e pa lëkundje afrimin dhe bashkëpunimin me imperializmin amerikan dhe luftën kundër forcave të shëndosha të marksizëm-leninizmit, të cilat, sipas titistëve, ndjekin politikë «staliniste» e «luftënxitëse». Duartrokitjet e revizionistëve hrushovianë për këtë kurs dhe diktat të udhëheqësve jugosllavë dëshmojnë qartë se sa mashtruese janë «dëshirat» dhe «vullneti» i hrushovianëve për gjoja kapërcimin e divergjencave, për gjoja rivendosjen dhe forcimin e unitetit. Pëlhurën që hrushovianët endin natën për të mbuluar demagogjinë e tyre për gjoja unitetin e kampit të të lëvizjes komuniste, Titoja ua gris në mes të ditës.

Duke u përpjekur që t'i shërbejë sa më mirë imperializmit dhe që të kryejë misionin e saj antikomunist, udhëheqja jugosllave arriti që në Kongresin e saj të 8-të të bashkojë revizionistët e ndryshëm me socialdemokratët në luftë kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit. Në të vërtetë, në Kongresin e 8-të morën pjesë jo vetëm shumë përfaqësues të udhëheqjeve revizioniste, por edhe përfaqësues të disa partive socialdemokrate. Sigurisht, Titoja ka pasur plane akoma më megalomane. Ai do të dëshironte që në kongresin e LKJ të përfaqësoheshin të gjitha udhëheqjet e atyre partive në krye të të cilave janë revizionistët. Kjo do të ngrinte më shumë peshën ndërkombëtare të titizmit

dhe do t'i krijonte mundësitë atij të paraqitej si «koka udhëheqëse» apo «strumbullari» i gjithë revizionistëve modernë.

Por, siç duket, disa udhëheqje revizioniste preferuan të mos shkonin në këtë kongres, ndoshta për të mos u komprometuar akoma më keq në sytë e komunistëve dhe të opinionit publik. Por kjo nuk i pengoi titistët që të arrinin qëllimin e dytë, të vendosnin «urat» e një bashkëpunimi më të ngushtë midis revizionistëve e socialdemokratëve mbi bazën e platformës antimarksisiste që Titoja shtroi në Kongresin e 8-të, platformë që u përshëndet nga të gjithë pjesëmarrësit e huaj dhe që, siç e theksuam edhe më sipër, u shërben interesave të imperializmit dhe drejtohet kundër marksizëm-leninizmit, socializmit e lirisë së popujve.

Kongresi i 8-të i LKJ ishte një vërtetim i gjallë i degjenerimit të plotë të së ashtuquajturës Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë në një rrjetë agjenturore të rëndomtë. Një fakt shumë kuptimplotë është vetë mbajtja e raportit «Mbi problemet aktuale të ndërtimit të mëtejshëm të LKJ» nga frymëzuesi dhe organizatori i policisë së fshehtë, Rankoviç. Dhe kjo, si për të treguar se e vetmja hallkë që lidh organizatat dhe organet e LKJ nga poshtë lart e anasjelltas, është UDB-ja, e cila ka plotësisht nën kontroll edhe vetë LKJ. Nga raporti i Rankoviçit, me gjithë manipulimet e tij për të fshehur e për të zbutur realitetin, del qartë se parimet themelore të ndërtimit të partisë janë zhdukur plotësisht në LKJ. Në të nuk gjen as gjurmën më të vogël të një partie marksiste të klasës punëtore. Vetë Rankoviçi u detyrua të pohojë karakterin antipu-

nëtor të LKJ dhe qëndrimet antipunëtore që karakterizojnë organizatat e saj, të pohojë se nga LKJ po dëbohen në masë punëtorët dhe në vend të tyre ka një dyndje të theksuar të elementëve borgjezë e mikroborgjezë, të cilët gjejnë në LKJ përfaqësuesen dhe realizuesen e idealeve të tyre klasore. Në kapitullin «mbi pranimet» Rankoviçi theksoi, natyrisht në mënyrë demagogjike, se «është problem fare i dukshëm pranimi i pamjaftueshëm i punëtorëve nga prodhimi i drejtpërdrejtë», se «akoma kemi në LKJ një strukturë shoqërore të pafavorshme», se ka pikëpamje se «nuk duhet t'u kushtojmë ndonjë kujdes të veçantë prodhuesve të drejtpërdrejtë», se «punëtori pranohet me vështirësi në LKJ». Dhe më poshtë Rankoviçi nxiton që këto qëndrime antipunëtore t'i justifikojë me «kushtet specifike» të Jugosllavisë. Ai thotë haptazi se «orientimi kuadrovik i LKJ me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore nuk mund të jetë në kuptimin klasik edhe me karakter të ngushtë klasor», se «ne nuk i idealizojmë punëtorët, në mes të të cilëve ka shumë të pakualifikuar, gjysmëkatundarë, por ata na interesojnë si flamurtarë interesash klasore». (Demagogjia e titistëve që çirren për vendosjen e punëtorit në qendër të vëmendjes së «vetadministrimit» s'ka kufi!). Dhe, më në fund, theksoi Rankoviçi, «në lidhje me pranimin e punëtorëve ka edhe vështirësi objektive, të cilat vijnë nga pozita e tyre materiale dhe nga nevojat e një pjese të punëtorëve për fitime plotësuese». Pra, punëtorët, për «vështirësi objektive», nuk kanë vend në LKJ. Jo vetëm kaq, por edhe ata që sot gjenden në radhët e saj duhen përjashtuar. Sikurse e deklaroi Rankoviçi, «prej

1958-s deri më 1963 janë përjashtuar nga LKJ 96 610 anëtarë. Në mënyrë të veçantë përqindja e punëtorëve të përjashtuar është shumë e madhe dhe në shtim e sipër. Nga 37 për qind që ishte në vitin 1958, ajo është ngritur në 48,3 për qind në vitin 1963. Ka shumë shembuj që tregojnë se organizatat kanë marrë vendime shumë lehtë për përjashtimin e punëtorëve për shkak të ardhjes me vonesë në mbledhje, mospagimit të kuotizacionit, kurse nëpunësit janë dënuar vetëm me vërojtje po për këso gabimesh». Pra, duke mos pranuar në LKJ punëtorë, duke dëbuar ata punëtorë që janë dhe duke hapur të gjitha portat për elementët borgjezë e mikroborgjezë, revizionistët jugosllavë po e degjenerojnë çdo ditë e më tepër LKJ në një parti borgjeze, në një parti socialdemokrate, në një front, gjë që ka qenë synimi i vjetër i udhëheqësve revizionistë jugosllavë. Në këtë drejtim Rankoviçi bëri edhe një thirrje të re. «Në kushtet e vetadministrimit, tha ai, LKJ duhet të jetë sa më e hapur ndaj shoqërisë». Ai vetë, në raportin e tij, dha një tablo të gjallë të degjenerimit të LKJ kur foli për ekzistencën në LKJ të «qarqeve të ndryshme të mbyllura» e të «shoqërive intime», për kërkesa «për legalizimin e së drejtës së pakicës» etj. Pra, as më pak e as më shumë, kërkohet likuidimi i plotë e përfundimtar edhe i asaj fare të centralizmit demokratik që mund të jetë trashëguar nga e kaluara. Për degjenerimin e LKJ flasin edhe «kritikat» e Rankoviçit për «vatrat e konflikteve midis forcave të socializmit dhe botëkuptimeve të disa komunistëve», për arbitrarizmat dhe raprezaljet që vihen re kudo, për «ndërrimin e gjeneratave» etj.

Në një kaos të tillë, në këtë front amorf, nuk është vështirë që në Jugosllavi të lindin parti të ndryshme si në shtetet kapitaliste, sepse baza shoqërore e ekonomike për një gjë të tillë tanimë është krijuar nga vetë titistët. Por, pa dyshim, klika e Titos, që ka likuiduar diktaturën e proletariatit dhe ka vendosur një diktaturë të egër revizioniste, që mban nën kontrollin e UDB-së popullin dhe vetë LKJ, nuk lejon krijimin e partive të tjera. Bile ajo, nën parullën e «rotacionit të kuadrove», po bën pastrimin rrënjësor edhe të LKJ nga elementët që, për një arsye ose për një tjetër, manifestojnë kundërshtime ndaj vijës së titistëve. Për këtë pastrim flet edhe fakti që në Kongresin e 8-të 85 për qind e delegatëve merrnin pjesë për herë të parë.

Dhe me gjithë këto revizionistët hrushovianë vazhdojnë ta quajnë titizmin socializëm të vërtetë, bile bien edhe në gjunjë e i heqin kapelen për «krijimet» e tij. Por me këtë politikë ata nuk do të vazhdojnë gjatë të mashtrojnë njerëzit.

Çdo komunist e proletar revolucionar mendon se qëndrimi i një partie marksiste-leniniste ndaj udhëheqësve revizionistë jugosllavë ka qenë dhe mbetet një kriter për të gjykuar drejt mbi vijën e kësaj partie, mbi qëndrimin e saj klasor revolucionar, mbi faktin nëse kjo parti është për revolucionin apo me kundërrevolucionin; nëse kjo parti është për unitetin marksist-leninist të kampit socialist e të lëvizjes komuniste apo për përçarjen e tyre, për integrimin e socializmit në kapitalizëm; nëse kjo parti është për socializmin apo për rivendosjen e kapitalizmit e mbrojtjen e tij; nëse kjo parti është për çlirimin e popujve apo për trashjen e vargo-

njve të skllavërisë së tyre; nëse kjo parti është për demaskimin e imperializmit me SHBA-në në krye si agresor, shfrytëzues e xhandar ndërkombëtar, apo për bekimin e politikës së agresionit e të luftës, për mbjelljen e iluzioneve pacifiste.

Revizionistët hrushovianë bëjnë çmos të maskojnë realitetin e hidhur jugosllav, ta paraqesin demagogjinë e titistëve, mashtrimet dhe dështimet e tyre, si në ekonomi dhe në fushat e tjera, si autokritikë prej komunistësh të vërtetë, nga të cilët bile duhet marrë shembull. Ç'është e vërteta, të gjitha raportet dhe diskutimet në Kongresin e 8-të të LKJ u përshkuan fund e krye nga një frymë e përgjithshme që konstaton kudo «vështirësi» e «pengesa», «dobësi» e «burokraci», «prapambetje» e «pakënaqësi», «revoltime» e «gabime», «arbitrarizma» e «kaos ekonomik», «pabarazi» e «spontaneitet», «nivel të ulët jetese» e «deformime», «liberalizma» e «kasta burokratike», «vagabondazh» e «nacionalizëm», «shovinizëm» e «antagonizma nacionalë», «asimilim të kombeve» e «hegjemonizëm» etj., etj. Këto fakte e shumë të tjera që titistët i përmendën në kongres, janë të vërteta. Por nuk janë aspak të vërteta betimet dhe përgjërimit e revizionistëve jugosllavë dhe hrushovianë që bërtasin se, së pari, këto fenomene negative në Jugosllavi ndodhin për shkak të moskuptimit nga masat të sistemit të ri, të të ashtuquajturit vetadministrim të punëtorëve, dhe së dyti, se titistët po bëjnë me të vërtetë autokritikë, se po bëjnë kthesë. «Autokritika» e tyre, sikurse e theksuam më sipër, është demagogji e mashtrim dhe, çka është e rëndësishme, ata janë të detyruar ta bëjnë këtë nga gjendja reale e sendeve dhe e feno-

meneve negative që karakterizojnë gjithë jetën e sotme në Jugosllavi. Vetë shtypi borgjez, dashmirës i grupit të Titos, duke karakterizuar Kongresin e 8-të të LKJ, vuri në dukje në komentet e tij të pakta e të zbehta se «Kongresi i 8-të i LKJ pati sukses jo në zgjidhjen, por në theksimin e dilemave të shumta që kanë krijuar udhëheqësit jugosllavë vetë», se «vetëqeverisja e tyre, demokracia e tyre direkte, është një shesh shumë pjellor për rritjen e shumë dëshirave dhe të pikëpamjeve liberale».

2. «Vetadministrimi i punëtorëve» — formë e veçantë për rivendosjen e kapitalizmit

Në Kongresin e saj të 8-të udhëheqja jugosllave, me qëllime të paracaktuara, vuri në qendër të vëmendjes detyrën për të përligjur procesin e zhvillimit kapitalist të vendit, për të pastruar nga çdo pengesë rrugën e filluar për rivendosjen e plotë të kapitalizmit në Jugosllavi. Si mjet justifikimi «teorik» për arritjen e këtij qëllimi dhe pikë kyç e kongresit, u paraqit i ashtuquajturit sistem i vetadministrimit punëtor. Pikërisht në këtë çështje do të ndalemi edhe ne.

Në raportet e Titos e të Kardelit dhe në fjalimet e figurave të tjera kryesore titiste u lavdërua me të gjitha mënyrat, u ngrit në qiell sistemi i «vetadministrimit» dhe u kërkua me çdo kusht zhvillimi i mëtejshëm i tij. Tani, ndryshe nga sa thuhej e propagandohej më parë, «vetadministrimi» nuk u paraqit më si një «rrugë e veçantë e socializmit specifik jugosllav», por u

cilësua si e vetmja metodë për ndërtimin e socializmit, si një model me karakter e vlerë universale për të gjitha vendet e botës që duan të hyjnë në rrugën e zhvillimit «të vërtetë» socialist. Me një fjalë, «vetadministrimi» u paraqit si fjala e fundit në «zhvillimin krijues» të teorisë marksiste mbi socializmin e thënë nga revizionistët jugosllavë.

Në këtë kuadër udhëheqësit jugosllavë shpallën në kongres se LKJ do të luftojë për të shpartalluar çdo kundërshtim që i bëhet «vetadministrimit», çdo ide ose pikëpamje që nuk pajtohet me këtë sistem.

Duke paralajmëruar të gjithë ata që kundërshtojnë sistemin e «vetadministrimit» në Jugosllavi, Titoja bërtiti: «Duhet t'i qërojmë hesapet vendosmërisht, pa kompromise të kalbura dhe pa kurrfarë lëkundjesh deri në fund, me të gjithë bartësit e tendencave prapanike, që me vetëdije ose pa vetëdije na vënë këmbëzën. Ky kongres duhet të jetë kongresi i pastrimit të guximshëm e konsekuent i rrugës sonë prej çdo gjëje që ende na tërheq prapa».

Shqetësimi i udhëheqjes jugosllave është i kuptueshëm. I ashtuquajtur i sistem i vetadministrimit nuk është tjetër veçse sistemi nëpërmjet të cilit po rivendosi kapitalizmi në Jugosllavi. Siç dihet, revizionistët jugosllavë, pasi e nxorën vendin nga kampi socialist, filluan të predikojnë me të gjitha mënyrat pikëpamjen se për ndërtimin e socializmit gjoja nuk ekzistojnë ligje të përgjithshme të domosdoshme për çdo vend, se çdo vend mund ta ndërtojë «socializmin» sipas dëshirës së tij. Ky ishte hapi i tyre i parë në përgatitjen e kushteve ideologjike për largimin nga socializmi. Më vonë

ky hap u mishërua me vënien në zbatim të të ashtu-
quajturit sistem të vetadministrimit punëtor, i cili hapi
gjerësisht e në mënyrë paqësore portat për zhvillimin
e vendit në rrugën kapitaliste.

Qëkurse u vu në zbatim ky sistem, propaganda e
titistëve asnjë shfaqjeje tjetër nuk i ka kushtuar një
vëmendje kaq të madhe sa i ka kushtuar «vetadminis-
trimit të punëtorëve» në ndërmarrjet. Në këtë rast të
gjithë revizionistët jugosllavë janë të mendimit se me
«vetadministrimin punëtor» ata kanë gjetur rrugën dhe
mjetin me ndihmën e të cilëve mund të mashtrojnë
masat se gjoja kështu vendoset «prona shoqërore» mbi
mjetet e prodhimit, «njeriu vihet në qendër të vëmen-
djes së shoqërisë», «çlirohet personi», «krijohet demo-
kracia direkte e prodhimit» dhe «marrëdhëniet midis
njerëzve e puna e tyre marrin një karakter humanitar»
etj., etj. Këtu ne nuk do të numërojmë të gjitha epitetet
që i ngjiten «vetadministrimit» nga revizionistët jugo-
sllavë, por do të ndalemi në shqyrtimin e bazave të kë-
tij sistemi, pasojave të tij në zhvillimin ekonomik të Ju-
gosllavisë, në qëllimet e zhurmës dhe të demagogjisë që
titistët thurën për këtë sistem në kongresin e tyre të
fundit.

Në Kongresin e 8-të të LKJ sistemi i «vetadminis-
trimit punëtor» u paraqit si forma e vetme që shpreh
marrëdhëniet «e vërteta» socialiste, si baza e vetme e
rendit shoqëror e politik socialist, si i vetmi socializëm
autentik, ndërsa rendi i vërtetë socialist, jashtë «vetad-
ministrimit», u shpall «revizionizëm dogmatik stali-
nian», «socializëm etatik, burokratik» etj. Paraqitja e
«vetadministrimit punëtor», si formë që shpreh marrë-

dhëniet socialiste, është në kundërshtim të hapët me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe bëhet me qëllim që të mbulohet rivendosja e kapitalizmit.

Dihet se idenë e tij kryesore mbi përcaktimin e karakterit të rendit shoqëror Marksi e përpunoi në një mënyrë të tillë që, nga marrëdhëniet e ndryshme të jetës shoqërore, ai veçoi marrëdhëniet në prodhim dhe, mbi këtë bazë, tregoi se përmbajtja e këtyre marrëdhënieve përcakton edhe përmbajtjen e karakterin e rendit shoqëror. Nga ana tjetër, çdo sistem i marrëdhënieve në prodhim, sipas teorisë së Marksit, është një organizëm i veçantë shoqëror, që ka ligjet e veta ekonomike të funksionimit dhe që dallohet nga proceset e kategoritë e veta ekonomike.

Po të mbajmë parasysh marrëdhëniet socialiste në prodhim në tërësinë e tyre, si elementë kryesorë marksizëm-leninizmi nënkupton: pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit në dy format e saj (shtetërore e kooperativiste); bashkëpunimin shoqëror dhe ndihmën reciproke midis punonjësve në procesin e prodhimit, midis klasës punëtore e fshatarësisë kooperativiste; shpërndarjen e produktit në bazë të sasisë dhe të cilësisë së punës që jep çdo anëtar i shoqërisë. Dhe ndër këta elementë, vendimtare është prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit, e cila përbën edhe themelin ekonomik të rendit socialist. Mbi bazën e këtyre marrëdhënieve, rendi socialist karakterizohet nga ligjet e kategoritë e veta ekonomike të zhvillimit, të cilat janë antipodi i atyre të rendit kapitalist.

Po të ballafaqojmë tani marrëdhëniet që përfaqë-

son i ashtuquajtur i sistemit i vetadministrimit me këto mësimet të marksizëm-leninizmit mbi marrëdhëniet socialiste në prodhim dhe rendin socialist, do të bindemi patjetër se ato s'kanë asgjë të përbashkët me marrëdhëniet socialiste në prodhim, por përkundrazi, karakterizohen nga të gjitha ato tipare që janë specifike për marrëdhëniet kapitaliste dhe rendin kapitalist.

Dhe me të vërtetë, si rezultat i zbatimit të «vetadministrimit», ekonomia jugosllave sot përfaqëson një grumbull ndërmarrjesh të veçuara njëra nga tjetra dhe që kanë liri të plotë veprimi. Secila prej tyre ka të drejtë të caktojë vetë vëllimin dhe strukturën e prodhimit e të investimeve kapitale, të blejë dhe të shesë mjete të prodhimit; të paraqitet në mënyrë të pavarur në tregun e brendshëm dhe të jashtëm; të caktojë lirisht çmimin e prodhimit në përputhje me koniunkturën e tregut, me kërkesën dhe ofertën. Secila ndërmarrje prodhon atë që dëshiron, pavarësisht nga prodhimi i të tjerave. Asnjëri nuk e di se sa dhe çfarë prodhimi duhet për shoqërinë. Puna nuk është më punë drejtpërdrejt shoqërore. Tregu me forcat e tij spontane sundon mbi prodhuesit. Qëllimi kryesor i veprimtarisë ekonomike dhe i prodhimit të ndërmarrjes është fitimi. Shpërblimi i punës në ndërmarrjet bëhet në bazë të të ardhurave dhe të fitimit; për të vlerësuar shpërblimin e punës nuk ekziston një masë e njëllojtë për të gjithë punonjësit.

Nga ky kuadër, qoftë edhe shumë i ngushtë, i «vetadministrimit» del se

Në vend të pronës shoqërore të mjeteve të prodhimit, në ekonominë jugosllave është vendosur prona e

grupeve të veçanta, e cila, nga pikëpamja e jashtme, ruan akoma formën e pronës shtetërore;

Në vend të shpërndarjes së produktit shoqëror sipas punës, bëhet shpërndarja sipas fitimit dhe aftësive komerciale të ndërmarrjes;

Në vend të prodhimit për të plotësuar nevojat e punonjësve, kemi prodhimin për hir të fitimit dhe të pasurimit të personave të veçantë, duke shfrytëzuar punonjësit e qytetit e të fshatit;

Në vend të planifikimit e të centralizimit të punës e të prodhimit në shkallën e gjithë shoqërisë, kemi decentralizimin, zhvillimin pa plan të ekonomisë, spontanitetin, anarkinë, konkurrencën, lojën e lirë të çmimeve dhe veprimin e lirë të ligjit të vlerës, si forca e vetme rregulluese e zhvillimit ekonomik.

Nga të gjitha këto rrjedh se «vetadministrimi» është një mjet i veçantë për rivendosjen e kapitalizmit. Krahas zhvillimit të sektorit kapitalist privat në industri, tregti, bujqësi e transport, kapitalizmi i rivendosur në Jugosllavi u vesh me petkun e «vetadministrimit», i cili është një variant i kapitalizmit shtetëror. Në kushtet e sotme do të ishte një iluzion i zbrazët dhe një gjë absurde të pritet që rivendosja e kapitalizmit në Jugosllavi e kudo gjetkë të realizohej nëpërmjet kalimit të plotë apo të pjesshëm të mjeteve të prodhimit në duart e kapitalistëve privatë, të ish-pronarëve të vjetër. Bile sot edhe në vendet kryesore kapitaliste kapitalizmi po shfaq tendencën e theksuar për të marrë gjithnjë e më shumë pamjen dhe karakterin e kapitalizmit monopolist shtetëror.

Revizionistët jugosllavë ngulin këmbë me të madhe

dhe përhapin pikëpamjen sipas së cilës marrëdhëniet ekonomike e shoqërore në Jugosllavi janë gjoja marrëdhënie socialiste, pasi mbështeten në pronën «shoqërore». Ky është një pohim që bëhet vetëm për qëllime demagogjike, që është në kundërshtim të hapët me marksizëm-leninizmin dhe karakterin real të pronës të marrëdhënieve në Jugosllavi.

Është e vërtetë se nga pamja e jashtme, formalisht, pjesa më e madhe e mjeteve kryesore të prodhimit në Jugosllavi ruan formën e pronës shtetërore. Por kjo nuk do të thotë aspak se ajo është një pronë shoqërore, sepse jo çdo pronë shtetërore mund të quhet ose të shpallet pa përjashtim si pronë shoqërore socialiste.

Marksizëm-leninizmi ka vërtetuar dhe eksperiencia historike ka treguar se karakteri shoqëror i pronës shtetërore varet e përcaktohet nga natyra klasore e shtetit, nga fakti se në interes të kujt përdoret kjo pronë dhe çfarë marrëdhëniesh ekonomike e shoqërore ndërtohen mbi bazën e saj. Duke e shtruar çështjen në këtë mënyrë të vetme të drejtë, si në teori ashtu edhe në praktikë, është provuar se vetëm kur ekziston diktatura e proletariatit, kur në pushtet është klasa punëtore e udhëhequr nga partia e saj e vërtetë marksiste-leniniste, vetëm atëherë prona shtetërore përdoret në interesin e gjithë shoqërisë, në interesin e socializmit, merr karakterin e pronës shoqërore socialiste dhe bëhet bazë e marrëdhënieve socialiste. Në çdo rast tjetër kur në krye të shtetit nuk ndodhet në mënyrë reale klasa punëtore, prona shtetërore nuk mund të quhet pronë shoqërore socialiste dhe mbi bazën e saj nuk mund të lindin kurrsesi marrëdhëniet socialiste.

Dhe me të vërtetë, në qoftë se sot në Jugosllavi, ku pushteti ndodhet në duart e revizionistëve, pronën shtetërore do ta quanim pronë shoqërore dhe marrëdhëniet që ekzistojnë mbi bazën e kësaj prone do t'i quanim marrëdhënie socialiste, atëherë në mënyrë të detyrueshme duhet të quanim pronë shoqërore socialiste edhe pronën shtetërore në vende të tilla kapitaliste si në Norvegji, Suedi apo në Angli, ku, siç dihet, në degë të ndryshme shkalla e «nacionalizimeve» nuk është e vogël e ku pushteti ndodhet në duart e socialdemokratëve, duhet të pranohet se edhe në këto vende kemi të bëjmë me marrëdhënie «socialiste», megjithëse askush nuk dyshon për karakterin kapitalist të ekonomisë dhe të marrëdhënieve të këtyre vendeve.

Në të gjitha rastet kur në pushtet nuk është klasa punëtore e udhëhequr nga partia e saj e vërtetë marksiste-leniniste, në ndërmarrjet e mëdha të shtetëzuara e vetmja alternativë e socializmit është kapitalizmi, e vetmja alternativë e pronës shtetërore socialiste është prona shtetërore kapitaliste. Rrugë të tretë nuk ka dhe nuk mund të ketë, pasi ajo përjashtohet nga vetë karakteri i prodhimit të sotëm të madh.

Një rast të tillë paraqet pikërisht edhe prona shtetërore që ekziston sot në Jugosllavi, e cila, nga pikëpamja e përmbajtjes së saj reale — e marrëdhënieve të prodhimit, të shpërndarjes e të shkëmbimit, e qëllimit të prodhimit, e organizimit, e drejtimit të tij dhe e shpërndarjes së punës — përfaqëson një formë të një tipi të veçantë të pronës shtetërore kapitaliste dhe përbën bazën e rivendosjes së kapitalizmit, bazën e të gji-

tha fenomeneve ekonomike që janë karakteristike për marrëdhëniet kapitaliste.

Revizionistët jugosllavë përpigën që «vetadministrimin e prodhuesve» ta përshkruajnë si kulmin e «demokracisë ekonomike direkte», si sistemin që e vë «njeriun në qendër të vëmendjes, që shkon drejt afirmimit të formave më të larta të lirisë njerëzore, drejt zhvillimit deri në fund të humanizmit dhe pasurimit të personalitetit të njeriut» etj., etj.

E gjithë kjo frazeologji «demokratike» lidhur me «vetadministrimin e prodhuesve» është një ribotim i ideve të renegatëve të marksizëm-leninizmit, si Kautski, Trocki, Buharini etj. Kautski, për shembull, thoshte se «socializmi është organizatë demokratike e jetës ekonomike». Trocki dhe Buharini shpallën «teorinë» e tyre të «demokracisë punëtore», të «demokracisë në prodhim». Pikëpamjet mbi socializmin si «demokraci ekonomike» përmbahen sot edhe në programet e të gjitha partive socialdemokrate. Të gjitha këto pikëpamje antimarksiste mbi socializmin dhe demokracinë u luftuan, u demaskuan dhe u hodhën poshtë në kohën e vet nga V. I. Lenini.

Lenini, duke luftuar kundër anarkosindikalistëve dhe trockistëve, theksonte se kalimi i ndërmarrjes në duart e të ashtuquajturit vetadministrim të punëtorëve do të thotë largim i plotë nga socializmi.

«një shtrembërim shumë i madh i parimeve themelore të pushtetit sovjetik dhe heqje dorë plotësisht nga socializmi është çdo për-

ligjje, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, e pronës së punëtorëve të një fabrike të veçantë ose të një profesioni të veçantë mbi prodhimin e tyre të veçantë, ose çdo përlligjje e së drejtës së tyre për të dobësuar ose penguar urdhrat e pushtetit të përgjithshëm shtetëror»¹.

Le të shohim tani nga afër se në ç'shkallë «vetadministrimi i prodhuesve» është një institucion demokratik dhe në ç'shkallë «prodhuesit direktë» janë bërë edhe drejtues të ekonomisë në kuadrin e këtij institucioni, sikurse pohojnë me të madhe titistët.

Lidhur me këtë, duke u mbështetur në nenet 9 dhe 17 të kushtetutës jugosllave, po përmendim këtu thelbin e mekanizmit të funksionimit të të ashtuquajturit sistem të vetadministrimit. Në bazë të këtij mekanizmi veprimtaria e ndërmarrjes drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga drejtori i saj, i cili, plotësisht i lirë dhe i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, është personi i parë që merr drejtpërdrejt masa disiplinore dhe çdo masë tjetër administrative. Drejtori ka të drejtë të anulojë vendimet e «këshillit të punëtorëve». Punëtorët e ndërmarrjes nuk kanë të drejtë ligjore as të zgjedhin drejtorin e ndërmarrjes, as edhe të kërkojnë zëvendësimin e tij. Akoma më të vogla janë të drejtat e punëtorëve në ndarjen e të ardhurave bruto të ndërmarrjes dhe të të ashtuquajturave të «ardhura të thjeshta» ose neto, nga të cilat krijohet fondi i pagës. Këshilli i punëtorëve dëgjon raportin vjetor të drejtorit mbi punën

1 V. I. Lenin. «Mbi demokratizmin dhe karakterin socialist të pushtetit sovjetik».

e ndërmarrjes, formalisht aprovon bilancin, përcakton planin, ushtron kontroll mbi punën e drejtorisë. Themi formalisht sepse, në fund të fundit dhe në mënyrë përfundimtare, për çdo gjë ka të drejtë të vendosë drejtori.

Duke bërë një krahasim midis të drejtave e detyrave të punëtorëve e këshillave të tyre nga njëra anë, dhe të drejtorit nga ana tjetër, në mënyrë të pashmangshme duhet pranuar se këtu nuk bëhet fjalë për «vetadministrimin e punëtorëve», po për veprimtarinë e paravarur e të lirë të ndërmarrjeve ekonomike, si rezultat i futjes së tyre në rrugën e zhvillimit kapitalist. «Këshillat e punëtorëve» dhe «vetadministrimi» në të vërtetë përfaqësojnë një lloj klubi për diskutime dhe parada të «lirisë», të «demokracisë» etj., të cilat sanksionojnë formalisht vullnetin dhe çdo gjë që urdhëron drejtori dhe mbulojnë veprimtarinë e ndërmarrjeve me karakter kapitalist. Përndryshe si mund të ndodhë që në kushtet e «demokracisë punëtore» drejtorët dhe personeli drejtues i ndërmarrjeve marrin «të ardhura» 20-40 herë më të mëdha se punëtorët, ose marrin shpërblime shuma e të cilave është e barabartë me fondin e pagës së të gjithë kolektivit të ndërmarrjes? Si mund të flitet për «vetadministrim të punëtorëve» kur ndërmarrjet mbyllen dhe punëtorët mbeten pa punë? A mos vallë punëtorët vendosin vetë që të mbeten pa punë? Ose si mund të shpjegohet që punëtorët e një ndërmarrjeje konkurrojnë shokët e tyre të një ndërmarrjeje tjetër dhe përpiqen të sigurojnë fitime sa më të mëdha, duke mos u ndalur as para spekulimit, në kurriz të shokëve të tyre punonjës?

Me vënien në zbatim të «vetadministrimit», punëtorët jugosllavë kanë humbur fitoren e tyre më të madhe revolucionare, e cila nuk mund të kompensohet me asnjë lumë fjalësh të ëmbla dhe llomotitjesh boshe mbi «demokracinë direkte» etj. Ata kanë humbur të drejtën për punë të garantuar, të drejtën që për punë të barabartë të kenë shpërblim të barabartë. Ja, ky është i gjithë kuptimi i vërtetë i «demokracisë direkte» të zbatuar nga revizionistët, me anën e të ashtuquajturit sistem të vetadministrimit.

Demokracia e vërtetë socialiste dhe karakteri i vërtetë socialist i pjesëmarrjes së masave punonjëse në drejtimin e prodhimit shoqëror, si dhe bashkërendimi i interesave individuale e shoqërore, mund të sigurohen vetëm mbi bazën e pronës shoqërore të mjeteve të prodhimit, vetëm atëherë kur punonjësit të jenë me të vërtetë pronarë të këtyre mjeteve. Por duhet thënë se demokracia socialiste është demokraci e shtetit, e diktaturës së proletariatit, dhe pjesëmarrja e masave punonjëse në drejtimin e vërtetë të prodhimit është pjesëmarrje që sigurohet e garantohet nga shteti socialist. Lenini na mëson se nga kapitalizmi

«zhvillimi... «në demokraci gjithnjë më të madhe» nuk është i thjeshtë, nuk bëhet drejtpërdrejt dhe pa pengesa, siç e paraqesin profesorët liberalë dhe oportunistët mikroborgjezë. Jo; zhvillimi që shkon përpara, domethënë drejt komunizmit, kalon nga diktatura e proletariatit...»¹.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 548.

Ndërsa revizionistët jugosllavë e hedhin poshtë diktaturën e proletariatit, duke shpallur si mjet të «demokracisë» të ashtuquajturin vetadministrim.

Si pronarë të mjeteve të prodhimit, të drejtën e pronës në rendin socialist, punonjësit e realizojnë duke e drejtuar prodhimin e vet në interes të tyre, mbi bazën e centralizmit demokratik dhe me anën e shtetit, i cili është përfaqësues i tyre, shprehës besnik i vullnetit të tyre. Format organizative të këtij drejtimi, si dhe të zbatimit të centralizmit demokratik në ekonomi, nuk mund të jenë universale për çdo vend dhe për çdo kohë. Por thelbi i tyre duhet të jetë një dhe i vetëm, për çdo rast e çdo vend: tërheqja e gjerë dhe pjesëmarrja aktive e masave punonjëse në drejtimin e shtetit dhe të ekonomisë, për rritjen e shpejtë të forcave prodhuese, për zgjerimin dhe për forcimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim, për ngritjen e ndërgjegjes socialiste, për luftën kundër burokratizmit dhe çdo gjëje që pengon lulëzimin e forcës krijuese të popullit.

Praktika e derisotme e ndërtimit të socializmit në vendin tonë ka përpunuar shumë forma organizative që lejojnë pjesëmarrjen e punonjësve në drejtimin e centralizuar e të planifikuar të prodhimit e të ekonomisë, siç janë: mbledhjet e prodhimit të punëtorëve, këshillat teknike në ndërmarrjet, konferencat ekonomike, mbledhjet e novatorëve dhe të racionalizatorëve të prodhimit, e drejta e kontrollit të organizatave-bazë të Partisë mbi veprimtarinë e ndërmarrjes, veprimtaria dhe të drejtat e bashkimeve profesionale. Këto forma dhe metoda sigurojnë një pjesëmarrje reale dhe efektive të punonjësve në drejtimin e prodhimit dhe të ekonomisë,

në hartimin dhe në realizimin e planeve të prodhimit të ndërmarrjes, në çështjet e organizimit dhe të drejtimit të punës, e caktimit të normave të punës dhe të pagës, e përmirësimit të kushteve materiale të jetesës e të punës së punonjësve etj.

Meqenëse i ashtuquajturit sistem i vetadministrimit ka dhënë pasoja shumë të rënda për ekonominë jugosllave dhe ka ngjallur pakënaqësinë e masave punonjëse, revizionistët e Beogradit, në kongresin e fundit të LKJ, u përpoqën me të gjitha forcat «të vërtetojnë» se për këtë fajin nuk e paska gjoja vetë sistemi, por disa të meta të tij, që rrjedhkan nga moskuptimi dhe moszbatimi si duhet i këtij sistemi, nga tendencat burokratike, liberale, anarkike etj. që shfaqin disa njerëz. Sistemi i «vetadministrimit», sipas titistëve, do të mund të zhvillohej shumë më lehtë «sikur të kishte më shumë mirëkuptim, më pak rezistencë e tendenca antagjoniste».

Këto dhe arsytetime të tjera të tilla rreth pasoja-ve e «të metave» të të ashtuquajturit sistem të vetadministrimit bëhen me qëllim që të fshihen dhe të mbulohen shkaqet e vërteta. Ato tregojnë se grupi revizionist i Titos po e çon në mënyrë të ndërgjegjshme ekonominë jugosllave në rrugën kapitaliste të zhvillimit, e cila përbën edhe burimin kryesor dhe shkakun e vërtetë të të gjitha të këqijave që jep ky zhvillim dhe që masat punonjëse të Jugosllavisë janë të shtrënguara t'i mbajnë mbi kurrizin e tyre.

Prandaj edhe gjithë «kritika» dhe «autokritika» që u orvatën të bëjnë titistët në kongres për «fenomenet e ndryshme jonormale e kapitaliste» që kanë lindur

në sistemin e «vetadministrimit të punëtorëve», ishte thjesht një demagogji e tyre e zakonshme, një manovrim për të zbutur ndjenjat e pakënaqësisë midis punonjësve.

Cilatdo qofshin premtimet për perfeksionimin e sistemit të «vetadministrimit», «kritikat» dhe «autokritikat» e titistëve për të ndrequr anët negative të tij, ligjet ekonomike të kapitalizmit, mbi të cilat mbështetet ky sistem, bëjnë punën e tyre. Ato e kanë çuar dhe po e çojnë gjithnjë më thellë ekonominë jugosllave drejt kaosit, spontaneitetit, konkurrencës së shfrenuar, rritjes së papunësisë dhe shfrytëzimit të masave punonjëse, mosshfrytëzimit kronik të aftësive prodhuese, disproporcioneve etj.

3. Pasojat ekonomiko-shoqërore të «vetadministrimit» jugosllav

Rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe në Jugosllavi në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit pasqyrojnë më së miri «drejtësinë» e parimeve dhe të formave të drejtimit të ekonomisë dhe të gjithë sistemit jugosllav «të vetadministrimit të ndërmarrjeve nga kolektivat e punës» që me aq bujë është reklamuar nga revizionistët. Prapa këtyre «novacioneve» fshihet revizionimi dhe mohimi i plotë i teorisë marksiste dhe i eksperiencës së deritanishme mbi ndërtimin e socializmit. Si rezultat i kësaj politike të dëmshme në jetën e vendit, ka shfaqje dhe pasoja identike me ato të ekonomisë kapitaliste, si lindja e anarkisë dhe e spon-

taneitetit, rritja e elementëve kapitalistë dhe spekulantë në ekonomi, ngritja e çmimeve dhe e papunësisë, zhvillimi disproporcional i degëve dhe i rajoneve të ndryshme të vendit, goditja e nivelit jetësor të masave punonjëse e të tjera shfaqje që flasin mbi degjenerimin e ekonomisë dhe të marrëdhënieve socialiste, si dhe mbi zhvillimin kapitalist të vendit si tipare dalluese të rendit jugosllav.

Në të vërtetë, ndërmarrjet që ndodhen nën vartësinë e «vetadministrimit të punëtorëve» janë në kthetrat e një shtrese të caktuar të përfaqësuar nga udhëheqja revizioniste që shfrytëzon prodhuesit. Në maskën e parullave e teorive «socialiste» dhe duke pasur përkrahjen e gjithanshme të imperializmit, kjo shtresë pronën e përbashkët të popullit e ka kthyer në një mjet për të shfrytëzuar masat punonjëse, për të mbajtur aparatit shtetëror që ka degjeneruar në aparat të diktaturës së grupit udhëheqës të Titos.

Konkurrenca e ashpër kapitaliste karakterizon këto ndërmarrje të «vetadministrimit të punëtorëve» që revizionistët përpiqen t'i reklamojnë si ndërmarrje të formës më të lartë të pronësisë socialiste e të demokracisë së prodhimit. Kjo konkurrencë dhe luftë për fitime sa më të mëdha që bëhet në mes të ndërmarrjeve të bazuara mbi «vetadministrimin e punëtorëve», shtrihet edhe në lëmin e tregtisë së jashtme, duke sjellë si pasojë vërshimin e mallrave të importit dhe mbylljen ose shfrytëzimin jo të plotë të ndërmarrjeve kombëtare, kthimin e shumë ndërmarrjeve industriale në shtojcë të shoqërive të huaja dhe në ofiçina të montimit dhe të përpunimit të thjeshtë.

Ekonomia dhe tregu i brendshëm karakterizohen nga zhvillimi spontan dhe kaotik. Çmimet ndryshojnë brenda të njëjtit qytet, për të njëjtat lloje mallrash të prodhuara nga i njëjti prodhues. Ashtu si në ekonominë kapitaliste, edhe në të ashtuquajturin sistem të «vet-administrimit të prodhuesve», me qëllim që të ruhen çmimet e larta dhe të sigurohen fitime maksimale, zbatohet metoda e zhdukjes së prodhimeve, fakte që gjejnë pasqyrimin e vet edhe në shtypin e përditshëm jugosllav. Vetë Titoja, në fjalimin e tij të mbajtur në Split në maj të vitit 1962, u detyrua të pranonte se «mallrat mbahen nëpër magazina që të ketë pak në treg e kështu të mund të ruhen çmimet e larta. Dhe këto mallra jo vetëm që rrinë atje, por edhe prishen». Rezervat e mallrave të pashitura rriten nga viti në vit. Rezervat e përgjithshme të mallrave gjysmëfabrikate dhe të mallrave të gatshme në fund të vitit 1961 arritën vlefën e përgjithshme 1,8 miliard dinarë, ndërsa në fund të vitit 1962 arritën shumën e përgjithshme 2,2 miliardë dinarë.

Sikurse edhe në ekonominë kapitaliste, marrëdhëniet midis ndërmarrjeve jugosllave, të mbështetura në parimet e «vet-administrimit», bazohen mbi shkëmbimin e mallrave dhe të parave, mbi konkurrencën e lirë dhe spontaneitetin e tregut. Ligji i vlerës, i mbështetur mbi pronën kapitaliste private dhe kapitalisto-shtetërore, në ekonominë jugosllave vepron pa pengesa dhe në mënyrë shkatërruese. Ashtu siç e pranojnë edhe revizionistët jugosllavë, siç del nga vetë shtypi i tyre, «ndërmarrjet janë të lira të orientojnë prodhimin në çdo drejtim qoftë, por në qoftë se një orientim i tillë

nuk u përgjigjet nevojave të shoqërisë (të shprehura në treg), ato i mbajnë mbi vete edhe pasojat. Kur punëtorët nuk kanë parasysh kriteret në treg, pagat e tyre bien nën minimumin e parashikuar nga ligji. Likuidimi i një ndërmarrjeje nuk përjashtohet në qoftë se prodhimi i saj nuk u përgjigjet nevojave të tregut».

Rezultat i «vetadministrimit» është jo vetëm «teprica» dhe zhdukja e mallrave, por edhe mbyllja e vazhdueshme e ndërmarrjeve dhe «teprica» e fuqisë punëtore. Nga të dhënat jugosllave del që rreth 500 ndërmarrje mbyllen çdo vit dhe se papunësia rritet në përpjesëtime gjithnjë e më të mëdha, gjë që pasqyron qartë degjenerimin e ekonomisë dhe falsitetin e «demokracisë së prodhuesve» që gjoja qenka vendosur në Jugosllavi mbi bazën e «vetadministrimit të punëtorëve». Në shkurtin e vitit 1963 numri i të papunëve arriti në 339 000, duke e tejkaluar rreth 5 herë nivelin e vitit 1955. Papunësia, si një nga problemet e ashpra shoqërore, është e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me «shpikjet» dhe «rrugët» e reja drejt «socializmit» që mbështeten mbi «vetadministrimin punëtor». Në vitin 1962, në krahasim me vitin 1955, ndërsa prodhimi industrial është rritur një herë, numri i të papunëve është rritur afro tri herë. Dinamika e papunësisë në Jugosllavi flet qartë se zhvillimi ekonomik i saj mund të kuptohet në lidhjen e tij të ngushtë dhe në kuadrin e ligjeve dhe të fenomeneve të zhvillimit ekonomik të botës kapitaliste, gjë që nuk mund të fshihet as edhe nga propaganda revizioniste. Vetë shtypi ekonomik jugosllav thekson se «gjatë kohës së krizës së superprodhimit në vitin 1961 dhe 1962, papunësia u rrit në 9,4 për qind dhe kjo qe pasojë e drejt-

përdrejtë e vetë krizës». Papunësia, si një plagë dhe sëmundje kronike, godit rëndë nivelin jetësor të masave punonjëse. Nga të dhënat zyrtare jugosllave del se në vitin 1962 rreth 80 për qind e të papunëve ishin në moshën deri 39 vjeç, ndërsa nga pikëpamja e kualifikimit nga punëtorët e papunë rreth 17 për qind ishin punëtorë të kualifikuar.

Papunësia është shoqëruese e mënyrës kapitaliste të prodhimit dhe problem i pazgjidhshëm për të. Revizionistët kanë qenë të detyruar që edhe në kushtetutën e re të vendit ta pranojnë ekzistencën e papunësisë si një fenomen të zakonshëm, bile kanë parashikuar, formalisht, garantimin e «ndihmës» për të papunët sipas sistemit amerikan. Dhe ç'përfaqëson në të vërtetë kjo ndihmë që revizionistët u «garantojnë» të papunëve? Nga të dhënat e vetë shtypit jugosllav del qartë se, së pari, nga kjo «ndihmë» përfitojnë një numër shumë i vogël punëtorësh dhe, së dyti, me anë të kësaj «ndihme» punëtorët nuk mund të sigurojnë as minimumin e minimumit të mjeteve të jetesës. Le të përmendim vetëm një shembull. Gazeta «Borba» e 30 tetorit 1963 është e detyruar të pohojë, ndër të tjera, se «në Kosovë dhe në Metohi ka sot 43 643 veta pa asnjë mjet jetese. Vetëm 8 567 nga ata marrin «ndihmë» nga komuna (mesatarisht rreth 40 dinarë në ditë).. Ndihma që jepet është më tepër një ndihmë simbolike». Se çfarë kriteri ndiqet për dhënien e ndihmës, kjo thuhet, ndër të tjera, në gazetën «Borba» të datës 5 prill 1963: «Tani në Zagreb ka 15 461 persona pa punë, kurse ndihmë marrin vetëm 1 368. Një konditë kryesore për marrjen e ndihmës është që të ardhurat e përgjithshme të njeriut pa

punë ose të ndonjë anëtarë të familjes së tij të mos i kalojnë 5 000 dinarët». Po të shikojmë se çfarë mund të blejë njeriu në tregun jugosllav me 40 dinarë që merr si «ndihmë» në ditë, me të cilat duhet të ushqejë veten dhe familjen, del se me ta ai mund të blejë 50 gram spinaq, ose gjysmën e pakos së cigareve të cilësisë më të dobët. Për të blerë një kile mish është e nevojshme të grumbullojë «ndihmën» e 20 ditëve. Me «ndihmën» ditore mund të udhëtojë një herë me transport urban, por vetëm në një linjë. Me «ndihmën» 8-ditore mund të blejë një kile sallatë jeshile. Për të blerë një kile qepë i duhet «ndihma» e tri ditëve. Me «ndihmën» ditore mund të blihet një kokërr vezë, në qoftë se shtohen edhe disa dinarë të tjerë. Për të paguar kopshtin ose çerdhen për një fëmijë, vetëm për një muaj i duhet «ndihma» e më tepër se një viti.

Të ashtuquajturat ndihma dhe lëmosha për të papunët janë të njohura në propagandën e vendeve kapitaliste. Revizionistët mund të marrin guximin që, për qëllime propagandistike, të premtojnë «ndihma», por ata nuk mund të guxojnë të premtojnë zhdukjen e papunësisë. Mbledhja e pestë e ekonomistëve jugosllavë që zhvilloi punimet e saj nga 13-14 dhjetor 1963 në Novisad, vërejti se Jugosllavia, edhe gjatë shtatë vjetëve të ardhshëm, do të përfshihet në radhët e vendeve që karakterizohen nga një shfrytëzim i pamjaftueshëm i forcës punëtore. Shtypi ekonomik jugosllav i vitit 1963 shkruan: «Papunësia e një numri të rëndësishëm të popullsisë është edhe shkaku i nivelit të ulët të jetesës dhe i varfërisë së një numri të konsiderueshëm të popullsisë së shoqërisë sonë socialiste. Koncepti kryesor ka-

rakteristik i futjes në punë qëndron në zvogëlimin e konsiderueshëm të përqindjes së futjes në punë të njerëzve gjatë shtatë vjetëve të ardhshëm».

Mënyra kapitaliste e prodhimit karakterizohet nga shfrytëzimi jo i plotë jo vetëm i forcës punëtore, por edhe i kapaciteteve prodhuese. Shfrytëzimi jo i plotë kronik dhe irracional i kapaciteteve prodhuese është fenomen që karakterizon ekonominë jugosllave. Vetë udhëheqësit jugosllavë janë të detyruar të pranojnë se kapacitetet prodhuese shfrytëzohen deri në 50 për qind. «Kapacitetet ekzistuese, tha Titoja në plenumin e 6-të të KQ të LKJ, ne duhet t'i shfrytëzojmë jo në masën 50 për qind dhe 60 për qind, siç ndodh tani». Veprimi çrregullues i ligjeve spontane të ekonomisë kapitaliste, zhvillimi disproporcional i degëve të ndryshme, dhe në radhë të parë në mes degëve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, decentralizimi dhe mohimi i drejtimit të ekonomisë në mënyrë të planifikuar, etja për fitime e ndër marrjeve që mbështeten mbi «vetadministrimin», lindin në ekonominë jugosllave këtë fenomen tipik të kapitalizmit siç është shfrytëzimi jo i plotë, kronik i aftësive prodhuese. Në këtë mënyrë marrëdhëniet ekonomike në mes ndër marrjeve që mbështeten mbi parimet e «vetadministrimit» nuk kanë karakter socialist. Këto marrëdhënie të tipit kapitalist karakterizohen nga lufta e etshme spekulative për nxjerrjen e fitimeve sa më të mëdha.

Degjenerimi i marrëdhënieve socialiste në marrëdhënie të tipit kapitalist pasqyrohet edhe në shkeljen e parimit socialist të shpërndarjes së produktit shoqëror sipas sasisë dhe cilësisë së punës së kryer nga çdo

prodhues. Në kushtet e «vetadministrimit të punëtorëve», parimi socialist i shpërndarjes sipas sasisë dhe cilësisë së punës nuk gjen zbatim, sepse, nga njëra anë, në treg ekziston loja e lirë e çmimeve të produkteve dhe, nga ana tjetër, nuk ka tarifa unike për shpërbimin e punës.

Në ndërmarrjet e mbështetura mbi parimet e «vetadministrimit të punëtorëve» shpërndarja bëhet jo në vartësi të ligjit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, por në vartësi të koniunkturës së tregut dhe aftësive komerciale dhe spekuluese të drejtuesve të veçantë. Veprimi pa pengesa i ligjit të vlerës krijon të gjitha kushtet objektive për shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, shfrytëzimin e një grupi punonjësish nga një grup tjetër. Vetë presidenti i sindikatave jugosllave, V. Tempo, në shkurtin e vitit të kaluar, u detyrua të pranonte që «edhe një analizë e përciptë do të na zbulojë neve se marrëdhëniet e tanishme të çmimeve jo vetëm që deformatojnë parimet e ndarjes sipas punës, por ndikojnë keq edhe në zhvillimin ekonomik, në ndërgjegjen e njerëzve dhe në veprimtarinë e tyre politike».

Në mes pagave të punëtorëve të kolektivave të ndryshëm ekziston një disnivel i theksuar, i cili rrjedh jo nga ndryshimet në nivelin e rendimentit të punës dhe në rezultatit më të mirë të punës së një kolektivi nga një kolektiv tjetër, por nga fitimet e siguruar nëpërmjet rrugëve spekulative-komerciale, nga shfrytëzimi i koniunkturës së tregut, nga mekanizmi i ndërtimit të çmimeve dhe veprimi pa pengesa i ligjit të vlerës. Sipas të dhënave zyrtare të anuarit statistikor jugosllav, del që të ardhurat personale mujore (shtator 1962) për

një punonjës në ndërmarrjet e industrisë së duhanit të Sllovenisë ishin afro 3 herë më të larta se të Maqedonisë dhe rreth 4 herë më të larta se të Malit të Zi. Në ndërmarrjet e industrisë së drurit të Sllovenisë të ardhurat për një punonjës ishin afro 60 për qind më të larta se në ato të Maqedonisë e të Kroacisë. Po në këtë muaj del se pesha specifike e punonjësve me të ardhura mujore shumë të vogla në industrinë e Sllovenisë ka qenë rreth 4 për qind, ndërsa në Maqedoni — afro 38 për qind dhe në Kroaci — 14 për qind. (Statisticke Godisnjak SFRJ, 1963, f. 463-464).

Në këtë mënyrë, mbi bazën e «vetadministrimit të punëtorëve» lindi dhe zhvillohet shfrytëzimi, një grup punëtorësh i kundërvihet një grupi tjetër dhe zhduket kështu çdo gjurmë e parimit socialist të shpërndarjes sipas punës.

Shkelja e parimit socialist të shpërndarjes sipas punës vihet re në mënyrë të theksuar edhe brenda të njëjtit kolektiv për kategori dhe grupe të caktuara njerëzish. Në ndërmarrjet e «vetadministrimit punëtor» marrëdhëniet në mes drejtorëve dhe një grupi të caktuar burokratësh, nga njëra anë, dhe punëtorëve që krijojnë të mirat materiale, nga ana tjetër, janë në të vërtetë marrëdhënie midis shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve.

Megjithëse formalisht pagat vendosen nga të ashtuquajturat këshilla punëtorë, drejtorët dhe personeli i privilegjuar administrativ kanë në këta këshilla fjalën e fundit në çështjen e caktimit të pagave. Në përcaktimin e rregullave mbi pagat dhe normat e shpërndarjes nuk ka një politikë unike të centralizuar dhe kontroll të rreptë. Praktika dhe rregullat e vendosura nga

disa udhëheqës të ndërmarrjeve synojnë në shtimin e të ardhurave të tyre në kurriz të punëtorëve, gjë që shkakton lindjen e disproporcioneve të mëdha në nivelin e pagave të tyre. Vetë Titoja, në maj të vitit 1962, u detyrua të pranojë se «rroga më e lartë është deri 20 herë më e madhe se rroga më e ulët në të njëjtin kolektiv». Për sa i përket ndarjes së brendshme të fitimeve dhe nivelit të shpërblimeve, ka arritur që personeli drejtues të marrë 40 herë më shumë se punëtorët. Kështu, për shembull, në kombinatin «Sljeme» të Zagrebit, siç njofton gazeta jugosllave «Borba» e datës 8 shkurt 1964, shpërblimi i caktuar vjetor prej 850 000 dinarësh u shpërnda vetëm në 8 veta (asnjë punëtor ose nëpunës i thjeshtë), nga të cilët vetëm drejtori mori 200 000 dinarë. Në këtë mënyrë vetëm në formën e shpërblimit drejtori mori aq sa një punonjësi të thjeshtë i duhet të punojë për afro një vit e gjysmë. Përvetësimi i një pjese të madhe të të ardhurave të ndërmarrjes nga drejtorët dhe personeli tjetër drejtues dhe pasurimi i tyre i shpejtë, duke shfrytëzuar haptazi frytet e punës së punëtorëve, paraqet një nga format kryesore të krijimit të elementit të ri borgjez kapitalist në kushtet e të ashtuquajturit vetadministrim.

Si pasojë e vendosjes së sistemit të «vetadministrimit të punëtorëve» dhe «demokracisë së prodhimit», zhduken marrëdhëniet socialiste, lind e zhvillohet shfrytëzimi i njeriut nga njeriu dhe elementet e tjera të ekonomisë kapitaliste, goditet niveli jetësor i masave punonjëse. Ndërsa masat punonjëse të Jugosllavisë rrojnë në varfëri, një grup i ri shoqëror përvetëson dhe shfrytëzon punën e tyre mbi bazën e privilegjeve të

përligjura në sistemin e «vetadministrimit». Vetë revizionistët nuk mund të fshehin se rritja e privilegjeve për një grup të caktuar njerëzish, ashtu siç vë në dukje edhe V. Bakariçi, «po forcohet deri në shkallën e fillimit të krijimit të një klase të re». (V. Bakariç, Diskutim në mbledhjen e komitetit të LK, të qytetit të Zagrebit, shtator 1964).

Pra, vendosja e «vetadministrimit punëtor», e «demokracisë së prodhimit» dhe «shpërndarja e pavarur e produktit» kanë shpënë në futjen e ekonomisë jugosllave në rrugën e zhvillimit kapitalist, në rritjen e shfrytëzimit të masave punonjëse, në zëvendësimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim me marrëdhënie kapitaliste. Rivendosja e kapitalizmit në Jugosllavi ka përfshirë të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore. Të njëjtat fenomene kapitaliste që përmendëm për industrinë vihen re, në forma të ndryshme, me tërë forcën dhe ashpërsinë e tyre, edhe në bujqësi, në tregti, në transport, në kulturë, art e kudo. Procesi i rivendosjes së kapitalizmit ka çuar në mënyrë të pashmangshme në vartësinë e Jugosllavisë nga «ndihma» e imperializmit amerikan. Nga vendet kapitaliste Jugosllavia ka marrë «ndihma» në një masë prej rreth 5,5 miliardë dollarësh, nga të cilat rreth 3,5 miliardë dollarë i përkasin imperializmit amerikan.

Me anën e së ashtuquajturës ndihmë, monopolet amerikane, në radhë të parë, dhe kapitali i vendeve të tjera imperialiste po depërtojnë gjithnjë më thellë në ekonominë jugosllave dhe nga shfrytëzimi i saj po nxjerrin fitime të mëdha. Udhëheqësit jugosllavë jo vetëm që nuk e pengojnë dhe nuk e kundërshtojnë një gjë të

tillë, por përkundrazi, e përkrahin me gjithfarë masash (siç është heqja e monopolit të tregtisë së jashtme, e kufizimeve mbi valutën e huaj etj.), të cilat i hapin lirisht dyert e ekonomisë jugosllave për kapitalin e huaj dhe lehtësojnë shtrirjen e tij. Bile ata shkojnë edhe më tej. Me pretekstin e «ndarjes ndërkombëtare të punës» dhe të luftës kundër «mbylljes së ekonomisë në vet-vete», titistët jo vetëm që përpiqen të justifikojnë nga pikëpamja teorike hapjen e dyerve të ekonomisë së vendit të vet për kapitalin e huaj, por edhe ta paraqesin këtë si një proces të natyrshëm e të pashmangshëm për ekonominë e çdo vendi. Pasojat e këtij kursi lidhur me ndihmën e imperializmit amerikan dhe me hapjen e dyerve për kapitalin e huaj janë jashtëzakonisht të rënda për ekonominë jugosllave dhe kryekëput në dobi të kapitalit monopolist amerikan.

Nëpërmjet «ndihmave», tregu jugosllav po push-tohet vazhdimisht nga dumpingu imperialist, me anën e të cilit monopolet e huaja, sidomos ato amerikane, sigurojnë fitime duke shfrytëzuar masat punonjëse të Jugosllavisë. Ekonomia jugosllave është shndërruar në një treg investimesh fitimprurëse të kapitalit amerikan. Shumë ndërmarrje industriale të Jugosllavisë në fakt përfaqësojnë ofiçina montimi të monopoleve të huaja kapitaliste, pasi ato prodhojnë në bazë të patenteve të këtyre monopoleve dhe varen nga materialet gjysmë të fabrikuarat e pjesët e këmbimit që u japin këto monopole. Si rezultat i dumpingut të monopoleve dhe i investimeve të huaja, dezekuilibrimi i ekonomisë jugosllave është thelluar edhe më shumë, ndërsa industria ka pësuar goditje të ashpra nga konkurrenca

shumë e fuqishme dhe pa pengesë e industrisë së vendëve imperialiste. Nga kjo konkurrencë e kanë pësuar, në radhë të parë, ndërmarrjet e vogla, të cilat, duke u ndodhur nën peshën e rëndë e të dyanshme të presionit të monopoleve të huaja dhe të ndërmarrjeve të mëdha të brendshme, janë shtrënguar të pushojnë veprimtarinë, të mbyllin dyert dhe të nxjerrin punëtorët në rrugë të madhe. Si rrjedhim, zgjerohet tregu i fuqisë punëtore, nga ku pastaj monopolet e huaja blejnë fuqi punëtore të lirë dhe e eksportojnë në vendet e tyre, për ta shfrytëzuar në mënyrë të pamëshirshme. Më në fund, ekonomia jugosllave është kthyer në një bazë nga e cila monopolet kapitaliste dhe imperializmi furnizohen me lëndë të para strategjike.

Depërtimi i kapitalit të huaj dhe lidhjet që ai vendos me ndërmarrjet më të mëdha të industrisë jugosllave në luftën e konkurrencës kundër ndërmarrjeve të vogla kanë nxitur së tepërmi lindjen dhe krijimin e monopoleve. Sot krijimi i monopoleve në ekonominë jugosllave është bërë fakt. Në disa degë të industrisë jugosllave 4-5 ndërmarrje më të mëdha kanë monopolizuar 80-100 për qind të prodhimit të degës dhe ushtrojnë një ndikim të madh mbi gjithë ekonominë e vendit. Duke shfrytëzuar gjendjen e tyre monopol, këto ndërmarrje sundojnë në treg, diktojnë çmime të larta shitjeje, ushtrojnë presion kundër ndërmarrjeve të tjera me qëllim rrënimi dhe realizojnë fitime shumë të mëdha, duke shfrytëzuar klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e vendit. Këto ndërmarrje shfaqin gjithnjë më shumë tendencën për t'u afruar e për t'u lidhur me kapitalin e huaj, gjë që përkrahet edhe nga udhëheqja

revizioniste edhe nga imperializmi, pasi që të dyja janë të interesuara njëllor që të nxjerrin fitime sa më shumë e sa më të mëdha në kurriz të masave punonjëse.

Meqenëse qëllimi i ndërmarrjeve monopoliste është realizimi i fitimeve dhe nuk mund të jenë kurrë interesat e përgjithshme të ekonomisë kombëtare, ose të krahinave të veçanta të vendit, në Jugosllavi është thelluar edhe më shumë disproporcioni midis degëve dhe pabarazia në zhvillimin ekonomik të republikave e krahinave të ndryshme. Mbi këtë bazë janë shtuar edhe më shumë ndjenjat e shovinizmit dhe vala e nacionalizmit borgjez ka pushtuar kombësitë e ndryshme të Jugosllavisë.

Ky është kuptimi dhe qëllimi i vërtetë i «ndihmës» që imperializmi ndërkombëtar, dhe sidomos ai amerikan, i jep Jugosllavisë. Ja përse imperializmi jo vetëm që e lavdëron socializmin specifik jugosllav por edhe e financon dhe e ndihmon atë pa kursim dhe me të gjitha mjetet.

Faktet tregojnë se restaurimi kapitalist në Jugosllavi është një fenomen i qartë dhe i pamohueshëm. Duke ecur në rrugën e zhvillimit kapitalist, udhëheqja titiste orvatet të fshihet në mënyrë demagogjike pas perdes së «vetadministrimit punëtor», në mënyrë që të luajë më mirë rolin e agjenturës së imperializmit.

4. Qëllimet e propagandës revizioniste dhe imperialiste për përhapjen e «vetadministrimit»

Vënia e të ashtuquajturit sistem i vetadministrimit punëtor në qendër të vëmendjes së Kongresit të 8-të të LKJ, si dhe zhurma e madhe që u bë rreth tij, nuk ishin një gjë e rastit. Përkundrazi, ato kishin qëllime të caktuara: të mbroheshin, të justifikoheshin nga pikëpamja «teorike» dhe të përhapeshin edhe jashtë kufijve të Jugosllavisë pikëpamjet e revizionistëve titistë mbi socializmin reaksionar borgjez, të përhapej vija e tyre e rivendosjes së kapitalizmit, të mësohej e gjithë bota se si, me anën e evolucionit paqësor, duhet «transformuar» shoqëria.

Titistët u përpoqën në kongres ta paraqitnin të ashtuquajturin sistem të vetadministrimit si metodën e vetme të drejtë, si rrugën e vetme të dhënë për ndërtimin e socializmit, duke e rekomanduar këtë si për vendet që ndërtojnë socializmin ashtu edhe për të gjitha vendet e tjera që do të dëshirojnë të ndërtojnë rendin socialist.

Kur lëvizja komuniste e punëtore ndërkombëtare ishte e bashkuar në luftën kundër revizionizmit jugosllav, ky i fundit shprehej haptazi kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Po kur në lëvizjen komuniste filloi të përhapej revizionizmi i përkrahur nga N. Hrushovi dhe pasuesit e tij, udhëheqja jugosllave ndërroi taktikën. Tani, duke pasur përkrahjen e imperializmit amerikan dhe të grupit të Hru-

shovit, ajo përpiqet me çdo mënyrë të zgjerojë ndërhyrjen e saj në vendet socialiste.

Ndërtimi i «socializmit» me ndihmën e imperializmit amerikan dhe me anën e të ashtuquajturit vetadministrim punëtor e demokraci të prodhimit janë sot drejtimi kryesor i influencës që përpiqet të ushtrojë grupi revizionist i Titos në vendet socialiste, për t'i futur edhe këto në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit dhe të evolucionit paqësor nga socializmi në kapitalizëm.

Dhe duhet pranuar se veprimtaria e revizionistëve jugosllavë në këto vende nuk ka mbetur pa jehonë. Në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera, ku janë në fuqi revizionistët, gjithnjë më shpesh po dëgjohen zëra dhe po kërkohet të merren masa për decentralizimin e ekonomisë, për liberalizimin e sistemit ekonomik, për shpalljen e fitimit si kriter kryesor në planifikimin dhe si rregullues kryesor të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve, për liberalizimin e sistemit të çmimeve e të tregut etj. Disa nga këto masa kanë filluar bile të vihen në zbatim, megjithëse njihen mirë pasojat që ato kanë dhënë për ekonominë e Jugosllavisë. Sipas këtyre «reformave» apo këtyre «sistemeve të reja të përmirësuarra të planifikimit dhe të administrimit ekonomik», ndërmarrjet tani e tutje kanë të drejtë të caktojnë vetë vëllimin e prodhimit, çmimin e shitjes së produkteve të gatshme, të sigurojnë vetë lëndët e para, bile të jenë autonome edhe për importin. Rezultatet ekonomike të ndërmarrjeve do të gjykohen vetëm në bazë të fitimit, pagat e punëtorëve dhe çmimet e shitjes do t'i caktojnë vetë ndërmarrjet. Këto do t'u nënshtrohen influencës së konkurrencës dhe presio-

nit të tregjeve dhe të çmimeve botërore, pra konkurrenca do të jetë e lirë dhe do të inkurajohet me të gjitha mjetet. Këto «reforma» dhe «sisteme të reja» po gjejnë përhapje në industri, në ndërtim, në tregtinë e jashtme e të brendshme dhe gradualisht në bujqësi, në transport, në shërbimet publike etj. Por duhet thënë se, si në Bashkimin Sovjetik ashtu edhe gjetkë ku sot bëhen përpjekje për të përdorur eksperiencën jugosllave lidhur me «vetadministrimin», zbatimi i saj po has në kontradikta e vështirësi të mëdha. Dhe kjo është e natyrshme dhe e kuptueshme, pasi në këtë rast sa më shumë që revizionistët ngulin këmbë në zbatimin dhe në zgjerimin e eksperiencës së «vetadministrimit», aq më shumë ata i largojnë popujt e këtyre vendeve nga rruga e drejtë e socializmit, lehtësojnë përgatitjen sistematike për gjallërimin e elementit kapitalist, hapin rrugën për evolucionin në kapitalizëm, aq më shumë ata do të ndeshin në kundërshtimin e vendosur të popujve dhe të revolucionarëve të vërtetë.

Udhëheqja jugosllave sistemin e «vetadministrimit të punëtorëve» përpiqet ta përdorë si mjet diversioni edhe në vendet që janë në zhvillim e sipër, për të mos u futur këto në rrugën e socializmit, por në rrugën «e veçantë» të zhvillimit kapitalist. Dihet se zhvillimi i sistemit botëror të socializmit dhe sukseset që janë arritur, kanë shtuar në popujt e botës, e sidomos në popujt që hoqën qafe zgjedhën koloniale dhe fituan pavarësinë, simpatinë për socializmin dhe rrugën socialiste në zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Kundër kësaj tendence luftojnë me të madhe imperialistët dhe neokolonialistët. Titoja, nën maskën e mosangazhimit apo të

socializmit specifik, bën përpjekje të veçanta për të depërtuar në vendet e reja, me qëllim që t'u shërbejë interesave të imperializmit dhe të neokolonializmit. Propagandimi i «vetadministrimit» dhe rekomandimi i kësaj eksperience si mjet magjik për ndërtimin e socializmit kanë për qëllim mashtrimin e vendeve të reja, futjen e tyre nën kthetrat e neokolonializmit nëpërmjet rrugës specifike, dënimin e tyre me skllavërinë e përjetshme. Por popujt e këtyre vendeve e njohin mirë natyrën e kapitalizmit dhe të rrugës kapitaliste të zhvillimit, pasi ata kanë qenë të shtrënguar të provonin në lëkurën e tyre të gjitha pasojat e këtij zhvillimi — shtypjen, shfrytëzimin e pamëshirshëm, mohimin e të drejtave dhe të lirive më elementare të njeriut punonjës, marrjen nëpër këmbë të çdo dinjiteti të tij. Prandaj ata, ashtu siç nuk u besojnë titistëve në politikë, nuk i besojnë as «vetadministrimit» të tyre, apo çdo sistemi tjetër mashtrues.

Dihet se pas Luftës së Dytë Botërore, si kundërpeshë të ideve të socializmit, ideologët e borgjezisë janë përpjekur të ngulitin në mendjen e masave punonjëse idenë se kapitalizmi i sotëm ka ndryshuar, është bërë «popullor» etj. Bile në disa vende kapitaliste, si në Angli, Francë, Gjermani Perëndimore, Itali, në Vendet Skandinave e Finlandë janë krijuar edhe disa forma të ndryshme, të cilat gjoja lejojnë që punëtorët të marrin pjesë në drejtimin e ndërmarrjeve dhe që dëshmojnë gjoja për «natyrën e re» të kapitalizmit e karakterin e tij «demokratik». Sot borgjezia monopoliste e vendeve kapitaliste i kushton një vëmendje gjithnjë më të madhe «pjesëmarrjes së punëtorëve në drejtimin

e ndërmarrjeve», meqenëse ajo u tregua si një mjet i efektshëm e me leverdi reale për monoilet, si mjet që mund të ndihmojë në rritjen e fitimeve të kapitalistëve me anën e rritjes së intensivitetit të punës, në pajtimin e interesave të klasës në kuadrin e ndërmarrjes, në shuarjen e frymës revolucionare e të luftës së klasës dhe në mashtrimin e masave punonjëse.

Dhe ja, në këto kushte borgjezisë monopoliste i vjen në ndihmë edhe grupi titist me «teorinë» e tij të «vetadministrimit punëtor». Sipas revizionistëve jugosllavë, i ashtuquajtimi vetadministrim punëtor mund të përdoret me sukses edhe nga vendet kapitaliste, si mjet për «transformimin» e shoqërisë mbi baza socialiste, pa qenë nevoja të bëhet revolucioni socialist, të vendoset diktatura e proletariatit dhe të zhduket prona private kapitaliste e mjeteve të prodhimit. Ky është zaten edhe thelbi i rrugës paqësore të revolucionit socialist që revizionistët jugosllavë predikojnë për vendet e zhvilluara kapitaliste. Nuk ka dyshim se një rrugë të tillë për transformimin socialist të shoqërisë e pranon me gjithë qejf edhe borgjezia monopoliste, pasi në të ajo nuk sheh asnjë rrezik ose kërcënim për interesat e saj jetike. Pikërisht për këtë arsye shumë përfaqësues të borgjezisë monopoliste e konsiderojnë «vetadministrimin punëtor» si model për të gjitha vendet e zhvilluara kapitaliste, me qëllim që klasa punëtore të mashtrohet, të largohet nga revolucioni socialist dhe lufta e saj revolucionare e klasës. Përndryshe, në qoftë se «këshillat e punëtorëve» dhe format e tjera të «vetadministrimit» do të përfaqësonin me të vërtetë transformimin socialist të shoqërisë, siç predikojnë revizionistët jugosllavë,

atëherë kapitalistët nuk do të lejonin kurrë ekzistencën e tyre dhe nuk do të pranonin në asnjë rast krijimin e tyre. Kapitalistët pranojnë dhe ndihmojnë të përhapet çdo iluzion mbi «transformimin» socialist të shoqërisë përderisa nuk prek interesat e tyre jetike, mbajtjen e pushtetit politik dhe të mjeteve kryesore të prodhimit në dorë të tyre.

Sikurse e theksuam më sipër, megjithëse revizionistët jugosllavë bënë një zhurmë të madhe rreth «vet-administrimit» dhe i bënë këtij një reklamë të paparë, si mjet diversioni ideologjik në interes të borgjezisë dhe imperializmit, kongresi i tyre i fundit nuk pati jehonën që ata dëshironin. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe. Tani jo vetëm marksistë-leninistët e vërtetë, por edhe shumë punonjës e njerëz të tjerë përparimtarë në botë e njohin mirë fytyrën e vërtetë të udhëheqjes revizioniste jugosllave si minuese e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare, e kampit socialist dhe e lëvizjes nacionalçlirimtare.

Kongresi nuk pati jehonën e kërkuar nga titistët as brenda në Jugosllavi. Ai nuk zgjidhi asnjë nga problemet jetike që preokupojnë sot popullin jugosllav. Përkundrazi, ai dha direktiva të tilla që do ta çojnë akoma më thellë Jugosllavinë në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit. Kongresi i 8-të, duke u mbështetur në programin e LKJ, përligji edhe një herë restaurimin e kapitalizmit, aprovoi vijën e përkrahjes së elementëve kapitalistë në qytet e në fshat, aprovoi nënshkrimin ekonomik të vendit monopoleve të SHBA-së, u bëri lëshime të reja elementëve shovinistë etj., etj. Ndihma e re në dollarë që i dha Jugosllavisë imperializmi ameri-

kan është një tregues tjetër bindës se në dobi të kujt, në interes të kujt i zhvilloi punimet Kongresi i 8-të i LKJ.

Fakte të shumta pas kongresit vërtetojnë se ky nuk shënon ndonjë kthesë, për të cilën çirren revizionistët hrushovianë, por përkundrazi, ai vetëm e hapi më tepër rrugën drejt kapitalizmit në të cilin janë zhytur prej vitesh udhëheqësit jugosllavë, ai theksoi orientimin që çon drejt keqësimit të jetës së masave punonjëse...

Shembuj të kaosit ekonomik e të keqësimit të gjendjes, të goditjes së nivelit të jetesës së masave punonjëse edhe pas Kongresit të 8-të janë të panumërt. Për realitetin e hidhur të Jugosllavisë tanimë janë të detyruar të flasim vetë titistët. Raportet e tyre nxinin nga dobësitë, prapambetja e të metat në të gjitha fushat e jetës. Por me konstatime demagogjike nuk nxirret nga qorrrokaku ku është futur Jugosllavia e sotme për shkak të ndjekjes së kursit revizionist. Dhe është një akt tradhtie ndaj popullit jugosllav ta nanurisësh atë me iluzione, siç bëjnë hrushovianët, sikur gjoja udhëheqja jugosllave po vihet në rrugën e socializmit.

Bile edhe pas Kongresit të 8-të, në një koment të vonuar prej afro dy muajsh, gazeta «Pravda» predikon përsëri se gjoja në kongres titistët na paskan theksuar: «Gatishmëria që me një këmbëngulje më të madhe të vihet në jetë roli udhëheqës i LKJ»; dhe ky fakt, nënvizon «Pravda», «u reflektua edhe në plotësimet, si dhe në ndryshimet në statutin e LKJ». Siç shihet, hrushovianët digjen nga dëshira për të parë ndryshime e kthesa, për të parë autokritika të Titoja, por më kot. Vetë «Pravda», po në atë artikull ku i thur himne sistemit

jugosllav të «vetadministrimit», është e detyruar të vërejë se «thelbin e politikës ekonomike të Jugosllavisë e përbën dhënia e fushës së veprimit mekanizmit të tregut»; dhe përsëri, për ta zbutur këtë, shton: «Por në të njëjtën kohë në kongres u nënvizua që marrëdhëniet e tregut nuk duhet të zhvillohen spontanisht». Çdo orvatje e trojkës hrushoviane, Brezhnjev-Mikojan-Kosigin dhe pasuesve të tyre, për ta paraqitur si socialiste veprën kundërrevolucionare të titistëve, ka qenë dhe mbetet pa rezultat. Zogjtë e korbit nuk mund të zbardhen. Realiteti jugosllav nuk mund të maskohet.

Marksistë-leninistët kanë tanimë 16 vjet që i njohin mirë ideologjinë dhe veprimtarinë armiqësore të titistëve kundër socializmit e paqes, kundër lirisë e pavarësisë së popujve. Për ta është e qartë se Kongresi i 8-të i revizionistëve jugosllavë, që u zhvillua mbi bazën e programit të LKJ, ishte një komplot i ri i forcave kundërrevolucionare, se ai do t'u shërbejë po atyre qëllimeve e planeve antimarksiste, antisocialiste, proimperialiste që u shërbeu edhe Kongresi i 7-të dhe kongreset e mëparshme. Çdo përkrahje këtij kongresi, sikurse vepruan revizionistët hrushovianë edhe pasuesit e tyre, është përkrahje për agjenturën e imperializmit në lëvizjen komuniste. Çdo luftë parimore për demaskimin e klikës së Titos, për demaskimin e ideologjisë së revizionizmit modern, mbron marksizëm-leninizmin, forcon kampin socialist, forcon unitetin e lëvizjes komuniste e punëtore. Prandaj, si dje dhe sot, po me atë vendosmëri e principialitet, marksistë-leninistët do të luftojnë kundër ideologjisë e veprimtarisë minuese të klikës së Titos, duke kryer me nder detyrën internacio-

naliste të Deklaratës së Moskës të vitit 1960 të nënshkruar nga 81 partitë dhe që përsërit: «Demaskimi i mëtejshëm i udhëheqësve revizionistë jugosllavë dhe lufta aktive për ta ruajtur lëvizjen komuniste, si dhe lëvizjen punëtore, nga idetë antileniniste të revizionistëve jugosllavë, vazhdojnë të mbeten një detyrë e domosdoshme e partive marksiste-leniniste».

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 32 (5128), 7 shkurt 1965

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin» vëll. IV, f. 159. Tiranë, 1965

**METODA DHE PROGRAMI I PUNËS SË
ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË
TË JENË MODEL PËR TË GJITHË
PUNONJËSIT**

*Fjala në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë
të Qytetit të Tiranës*

8 shkurt 1965

Më lejoni t'ju uroj, shokë, për punën e mirë që ka bërë organizata e Partisë e qytetit të Tiranës dhe për sukseset që ajo ka korrur, si në realizimin e planeve ekonomike, ashtu edhe në qëndrimet politike dhe ideologjike të komunistëve dhe të punonjësve pa parti të qytetit tuaj. Ky është një sukses i madh për gjithë Partinë, sepse organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës, si organizatë e kryeqytetit, i takojnë nderi dhe detyra të jetë shembull në çdo drejtim për të gjitha organizatat e tjera të Partisë në të gjithë vendin tonë.

Ne dëgjuam në këtë plenum si raportin që mbajti shoku Rrapo Dervishi¹ mbi rolin e organizatës-bazë në

1 Në atë kohë ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Tiranës.

administratë, ashtu edhe diskutimet e shumë shokëve. Plenumi juaj u tregua në nivelin e duhur dhe dha një ndihmë të madhe për të gjithë ne, për ta çuar edhe më përpara punën e Partisë, për t'i rritur më tej sukseset tona.

Por, me gjithë sukseset e arritura, në punë kemi edhe të meta e gabime. Në raportin që u mbajt këtu, në emër të byrosë së komitetit të Partisë, janë trajtuar në mënyrë koncize si sukseset, ashtu edhe të metat e gabimet në punën e organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës. Në të përcaktohen gjithashtu edhe shumë detyra që i vihen përpara organizatës suaj për përmirësimin e mëtejshëm të punës.

Edhe diskutimet e shokëve më pëlqyen. Ato tregojnë preokupacionin e kuadrove tanë, kujdesin e tyre për mbarëvajtjen e punës dhe për ngritjen e problemeve në nivelin e duhur. Çështjet që u diskutuan, u argumentuan me shembuj. Të gjithë ju keni shembuj të shumtë për t'i ilustruar si duhet problemet. Edhe kritikën mbi të metat në punë, që vënë në dukje shokët, të cilat ne i shohim vetë me sy dhe që me kurajë u prekën gjatë diskutimeve, qoftë në përgjithësi, qoftë drejtpërsëdrejti, janë të drejta dhe na shërbejnë të gjithëve të forcojmë më shumë punën tonë.

Ju vutë shumë mirë në dukje rëndësinë që ka forcimi i gjithanshëm i organizatës së Partisë në Tiranë. Dëshiroj të theksoj edhe unë me këtë rast rëndësinë e madhe që ka kryeqyteti për arsye të rrezatimit të eksperiencës së punës që bëhet këtu. Ju, komunistët e Tiranës, punën si anëtarë partie dhe si nëpunës të shtetit tonë popullor duhet ta shikoni jo në kuadrin e ngushtë

të organizatës suaj bazë këtu në Tiranë, po në kuadrin e rëndësisë që ka puna e organizatës së Partisë të Tiranës për gjithë vendin.

Në raport bëhet fjalë për organizatat-bazë të administratës. Duke i quajtur këto «organizata-bazë të administratës», nuk do të thotë se ato janë organizata të kartërave. Jo. Puna e organizatës së Partisë në Tiranë ka shumë rëndësi, se ajo mendon, punon dhe ndihmon për zberthimin e direktivave të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë nga të gjitha organet shtetërore dhe organizatat-bazë të Partisë që ndodhen në ministritë, në ndërmarrjet apo në institucionet qendrore. Njerëzit që militojnë në organizatën tuaj në ministritë, në ndërmarrjet apo në institucionet qendrore, shkojnë në të katër anët e Shqipërisë, janë të lidhur në mënyrë organike me gjithë aktivitetin ekonomik e kulturor të vendit, kontrollojnë e ndihmojnë për zbatimin në jetë të direktivave të Partisë dhe të vendimeve të Qeverisë në ndërmarrjet dhe në institucionet vartëse në bazë.

Prandaj, kur ju trajtoni probleme në organizatat-bazë, shqyrtoni medoemos edhe qëndrimet, veprimet, sjelljet dhe kapacitetin e shokëve tuaj që organikisht janë të lidhur me kryeqytetin, por që më të shumtën e kohës shkojnë në bazë për qëllimin që thamë. Këtu ka një rëndësi të veçantë çështja se si organizata-bazë e administratës, e institucionit ose e ndërmarrjes duhet të dijë të hartojë planet e saj të punës, me qëllim që aktivitetet e mëdha të Partisë, të organizatës, të byrosë ose të komitetit të Partisë që drejton këtë organizatë, t'i harmonizojë me punën e saj të gjerë jo vetëm këtu në

Tiranë, në ministri, në ndërmarrje apo në institucion, po edhe në lidhje me organet e saj vartëse në rrethë.

Duke e kuptuar kështu rolin e organizatës suaj të Partisë, dua të ngre dy çështje me rëndësi. Këto që do të theksoj para jush nuk janë tërësisht karakteristika vetëm të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës, ku organizatat-bazë në përgjithësi janë të ngritura, luftarake, revolucionare, për arsye të kuadrove të Partisë që militojnë në to, dhe që kanë një eksperiencë të madhe. Shumë nga ato që do të them, pra, nuk i takojnë vetëm organizatës suaj, po unë dua t'i vë në dukje se eksperiencia e përditshme e Partisë na tregon se ka akoma dobësi të theksuara në punën e organizatave-bazë të Partisë në tërë Shqipërinë. Prandaj, meqenëse ju jeni pjesëtarë të organizatës së Partisë të kryeqytetit dhe keni kontakte me komunistë e drejtues partie dhe pushteti në bazë, jeni të detyruar të futeni thellë goftë në realizimin e planeve, goftë edhe në qëndrimin e komunistëve dhe në metodën e tyre të punës. Dashur pa dashur, ju, si funksionarë, si specialistë edhe si komunistë, e keni për detyrë të përhapni eksperiencën e gjithë Partisë, për forcimin e punës kudo në të gjithë vendin tonë.

Shumë herë e kemi marrë në shqyrtim çështjen që na preokupon të gjithëve, që organizatat-bazë të Partisë të forcohen, të shkunden, të bëhen revolucionare, luftarake. Prandaj për këtë qëllim unë doja të flisja pak mbi rendin e ditës në organizatat-bazë, si edhe mbi edukimin ideopolitik dhe teknik të komunistëve nën drejtimin e organizatës-bazë, se si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim këto çështje.

1. — Rendi i ditës në organizatat-bazë

Për rendin e ditës së organizatës-bazë s'ka asnjë dyshim se të gjithë ju e kuptoni rëndësinë e madhe të tij dhe tregoni kujdes për të. Por megjithatë më lejoni të bëj disa vërejtje dhe sugjerime, të cilat mund të shërbejnë për ta kuptuar më mirë dhe për ta forcuar punën në këtë drejtim.

Pa metodë dhe plan pune askush, dhe në radhë të parë Partia, nuk mund të ecë si duhet. Partia jo vetëm nuk mund të bëjë pa to, por e ka detyrë edukative dhe veprimi që metoda dhe programi i punës së saj të jenë model për të gjithë punonjësit, një model natyrisht jo statik, i pandryshueshëm, por i përmirësuar, i perfeksionuar në dinamizmin e jetës, në eksperiencën e fituar, në edukimin nga të metat e gabimet që sjellin punët tok me sukseset. Prandaj metoda e punës nuk mund të jetë e vdekur, ajo duhet të përmirësohet vazhdimisht.

Disa shokë mendojnë se përcaktimi i tematikave për mbledhjet e organizatave, që me fjalë të tjera është hartimi i planit të punës, është një gjë e lehtë. Ndodh që sekretari i organizatës, në fillim të vitit ose në çdo tremujor, merr kalemin dhe me një copë letër, brenda një çerek ose gjysmë ore, shënon tri tema për tri mbledhje, «tema tingëlluese», ia paraqet byrosë ose komitetit dhe ato pranohen.

Më lejoni të them se këta shokë gabohen, nuk vepronë drejt dhe nuk e kuptojnë rëndësinë e madhe të fillimit të punës, rëndësinë e themelit mbi të cilin do të

ngrihet ndërtesa, dua të them mbi të cilin do të hartohet plani i raportit, do të grumbullohet materiali, do të përpunohet ai dhe do të pasqyrojë në të gjitha aspektet problemin që preokupon Partinë.

Nuk është e lejueshme që me një të lëvizur të kalendarit të hidhen në letër tri tema për rendin e ditës dhe plani i punës për tre muaj rresht. Kjo do të thotë të mos e kuptosh rëndësinë e madhe të problemit që preokupon me të vërtetë Partinë sot, këtë muaj, ose këtë tremujor. Temat që cakton pa u thelluar sekretari i organizatës-bazë, mund të tingëllojnë mirë kur i lexon, por mund t'i vënë në gjumë shokët, prandaj në mbledhje në vend që ato të edukojnë, në vend që t'i vënë në lëvizje njerëzit, ndjellin gogësima dhe mërzi.

Nuk e bëjnë të gjithë sekretarët kështu, po ata që e bëjnë duhet ta braktisin menjëherë këtë metodë të gabuar dhe të pafrytshme. Këta shokë duhet të kuptojnë se një punë e tillë e fillimit është pa perspektivë, është një përsëritje e disa tematikave pune që kanë qenë të nevojshme dhe urgjente vjet, por e vjetshmja na ka mësuar me të mirat dhe me gabimet e veta dhe e sivjetshmja u ka nxjerrë Partisë, kuadrove, probleme, halle dhe preokupime të reja, të cilat duhen shkallëzuar sipas rëndësisë, sipas urgjencës. Kapaciteti i kuadrove sivjet s'është ai i dy vjetëve përpara ose edhe i vitit që kaloi. Ky është një kompleks i tërë që nuk duhet nënvleftësuar. Neve nuk na lejohet të shfletojmë defterin e vjetshëm të tematikave e të radhitim edhe për sivjet të njëjtat probleme në mënyrë shabllore, duke ndërruar disa terma, duke u kënaqur me vetveten e duke thënë se «këto probleme qëndrojnë aktuale tërë jetën».

Po si ta bëjmë më mirë këtë punë? Konkretisht, dhe në radhë të parë, i takon udhëheqjes së organizatës-bazë ta mendojë seriozisht këtë. Unë do të këshilloja që për t'u bërë mirë përcaktimi i drejtë i planit të punës, ky duhet të bëhet i lidhur ngushtë me planin vjetor të çdo institucioni ose ndërmarrjeje, të asaj apo të kësaj organizate-bazë. Ky është orientimi kryesor. Pastaj komunistët, si udhëheqës të masave, kanë nevojë të udhëzohen dhe të mbahen në korent edhe për shumë probleme, jashtë kuadrit të punës së tyre, probleme që interesojnë gjithë vendin, gjithë sektorët, politikën e Partisë si brenda vendit dhe atë ndërkombëtare, si edhe në veçanti e posaçërisht edukimin ideologjik.

Shkurt unë i thashë, por po të mendojmë pak, ky është një kuadër i gjerë pune, që po s'u organizua mirë nga udhëheqja e organizatës dhe nga vetë komunistët individualisht, ata nuk do të kenë kohë as të hanë, as të pushojnë, pa le të bëjnë edhe ndonjë punë shoqërore. Çështjen e kam që për disa probleme që janë të dorës së dytë e të tretë, organizata-bazë duhet të japë herë pas here një orientim të përgjithshëm, të ndihmojë, por i përket komunistit të interesohet vetë individualisht, të organizojë punën jashtë zyrës, të lërë kohë për ngritjen e nivelit të tij politik, ideologjik, për punë shoqërore, argëtim etj.

Por, për problemet e dorës së parë që kanë lidhje me punën kryesore dhe vendimtare të organizatës-bazë, udhëheqjes nuk i lejohet që çdo problem ta marrë të shkëputur nga detyrat e planit, qofshin këto edhe probleme politike, ideologjike e morale.

Për planin e përgjithshëm të ministrisë, të institu-

cionit ose të ndërmarrjes duhet të jenë në dijeni pa-tjetër të gjithë komunistët, po kështu edhe për planin e veçantë të sektorit të tyre. Ministria harton zbërthimin e këtij plani, kolegji ose drejtoritë bëjnë detajimin e tyre, caktojnë masa dhe detyra. Në rast se plani i organizatës-bazë nuk lidhet, nuk puqet, nuk parashikon dhe nuk koordinohet me sa thashë pak më parë, ai nuk është plan, ai nuk qëndron në këmbë dhe nuk mund të përfaqësojë as në parim, as në esencë, atë që Partia drejton, ndihmon, kontrollon. Po të veprohet kështu, Partia, si unitet udhëheqës, qëndron në bisht të situatës, mbledhjet s'bëhen interesante, ato janë monotone, ose krijohet një situatë rutine. Kjo është e rrezikshme.

Është e domosdoshme të kuptohet mirë çështja kur themi që Partia nuk duhet të monopolizojë punët e shtetit. Për këtë çështje kemi folur shumë herë, përmirësimet janë të dukshme në këtë drejtim, por ka disa organizata-bazë që i kalojnë caqet e udhëzimeve të drejta që janë dhënë; në këto organizata flitet fare pak dhe lidhen jo organikisht çështjet ekonomike, politika ekonomike, zbatimi dhe kryerja e detyrave të planit. Për të fshehur këtë të metë zgjidhen tema me karakter gjoja edukimi. Organizata të tilla çdo herë që mblidhen flasin kryesisht për shembullin personal, bëjnë autokritikë e kritikojnë njëra-tjetrën.

Organizata-bazë mblidhet rregullisht 12 herë në vit. Është e kuptueshme, pra, sa të rëndësishme, sa substanciale dhe të përgatitura mirë duhet të jenë këto mbledhje, sa të balancuara duhet të jenë temat dhe karakteri i tyre.

Temat duhet të jenë kyçi i punës. Çdo temë që nuk është përsëritur ndonjëherë gjatë vitit, duhet të jetë një orientim i qartë për gjithë vitin. U diskutua një temë, u mor një vendim, ai duhet të udhëheqë, të pasurohet, të korrigojohet gjatë gjithë veprimit, gjatë të gjitha formave të tjera të punës.

Vjen puna, kush do t'i bëjë këto tema? Ndodh në disa raste që sekretari ose udhëheqja e organizatës gjejnë belanë derisa ngarkojnë njërin ose tjetrin për përgatitjen e temës, pse ka dhe komunistë që duan t'i shmangen kësaj pune, u vjen rëndë dhe kur e pranojnë, se s'kanë ç'bëjnë, shkruajnë diçka me mërzi, kufizohen në disa fraza të përgjithshme, të thëna e të dëgjuara qindra herë, japin disa shifra dhe disa shembuj që i kanë marrë kalimthi në ndonjë zyrë, pa munguar të fusin edhe anët e tyre subjektive.

Kjo nuk është përgatitje serioze. Ne kemi shumë njerëz të zotë në dikastere, në institucione ose në qendra pune, që udhëheqin me sukses në sektorët ku punojnë e drejtojnë, po kur vjen puna për të bërë një raport të organizatës-bazë, ngurrojnë. Këta shokë kanë iniciativë të madhe në detyrë, kryejnë punë të rënda, krijojnë, bëjnë përgjithësime shumë të mira në raportet që u kërkohen nga ministrat, nga drejtorët, ndërsa, kur vjen puna për të bërë raportin e organizatës së Partisë, s'dinë nga ta kapin. Përse? Sepse u kërkohet diçka eks katedra, u jepet vetëm titulli i problemit dhe u thuhet: «hë bëje, se ti mund ta bësh». Kjo mënyrë është e pafrytshme.

Dua të theksoj se në disa raste nuk i vihet rëndësi e duhur personit që zgjidhet si sekretar organizate.

Kuptimi i kësaj çështjeje të madhe shikohet disa herë cekët, si një detyrë burokratike. Disa përpiqen t'i shmangen, me pretekste se janë të zënë me punë etj. dhe nuk mendohet se sekretari i organizatës ose i komitetit duhet të jetë dhe është dora e djathtë e ministrit ose e drejtorit të institucionit apo të ndërmarrjes. Ai duhet të jetë nga njerëzit më të zotë, si në çështje thjesht organizative të Partisë, ashtu edhe në problemet ekonomike, njeri me moral të lartë e me virtyte të mira. Ai duhet të jetë nga këshilltarët dhe bashkëpunëtorët më të afërt të përgjegjësit të dikasterit, ai duhet të jetë në dijeni të problemeve shtetërore, të halleve materiale, të vështirësive, mungesave objektive dhe subjektive. Tek ai do të përplasen shokët e Partisë dhe ata pa parti, do t'i shfaqin mendime për punën e tyre, për punën e të tjerëve, për punën e përgjithshme dhe personale. Ai duhet t'i dëgjojë, t'i këshillojë, të marrë masa, të ngarkojë të tjerë të sqarojnë në rrugë partie disa çështje, të krijojë komisione etj., etj. Kjo, përveç punës shtetërore që ka, është një punë e madhe dhe e lodhshme për të. Por ai s'është vetëm, ai ka shokë komunistë, si dhe specialistë të çdo lloji, ai ka teknikë të metalit, të penës, të fjalës, të jurisprudencës, ka nga ata që kanë prirje dhe aftësi për çështje ideologjike etj. Ai dhe shokët e tij të byrosë e të komitetit duhet të dinë të njohin mirë problemet dhe njerëzit që të caktojnë mirë tematikën e rendit të ditës të organizatës-bazë.

Atëherë, më duket mua, në rast se ecim si duhet në këtë rrugë, a ka ndonjë vështirësi për ne që rendi i punës i organizatës-bazë të jetë i përsosur? Jo, s'ka asnjë vështirësi. A ka ndonjë vështirësi për të mobilizuar

shokë që të hartojnë, të shtrojnë problemet në organizatën-bazë në një nivel të tillë të lartë? Jo, s'ka asnjë vështirësi. A ka vështirësi kur në organizatën-bazë shtrohen qartë e drejt të tilla probleme të kohës? A ka vështirësi që organizata të mos bëhet luftarake, revolucionare? Jo, s'ka asnjë vështirësi.

Pra të gjitha mundësitë i kemi për këto. Suksese kemi arritur, Partinë e kemi luftarake dhe revolucionare. Le të vëmë edhe më shumë kujdes në këtë drejtim dhe sukseset e Partisë do të jenë akoma më të mëdha, njerëzit do të edukohen dhe do të mësohen më mirë, punët e Partisë dhe punët shtetërore do të shkojnë më mirë.

Dëshiroj të shtoj edhe diçka tjetër. 12 mbledhje në vit për një organizatë-bazë nuk janë pak, po të marrim parasysh sa të tjera ka jashtë këtyre, si mbledhje prodhimi, të bashkimeve profesionale, të gruas, të rinisë etj. Në rast se organizata-bazë nuk i koordinon, nuk i organizon, nuk i ushqen këto mbledhje, atëherë krijohet një ndjenjë lodhjeje dhe monotonie, që bëhet e mërzitshme, prandaj disa herë dhe me të drejtë këto nuk frekuentohen rregullisht.

Partia nuk duhet as të kënaqet, as të lejojë që në këtë gamë mbledhjesh të ketë paralelizma, përsëritje të kota, përgatitje të dobët sa për të kaluar radhën e për të bërë mbledhje për mbledhje. Dhe në këto mbledhje kërkohet që të marrin pjesë të gjithë kuadrot. Në rast se Partia jep shembullin e mirë me tematikat e veta, ajo do të dijë të frymëzojë tematikën e mbledhjeve të tjera, do të dijë të ndihmojë për këto tematika, të cilat jo vetëm plotësojnë nevojën për sektorët speciale, për të

cilët bëhen këto mbledhje, por kështu do të dijë të përdorë levat e saj të rëndësishme në drejtime të caktuara që pa qenë një punë përsëritëse, është një punë e madhe plotësuese e programit të saj të gjerë e të shumanshëm. Sekretarët mjaft herë as që interesohen për planet e punës të organizatave të ndryshme, për përgatitjen, përpunimin e zbatimin e tyre nga udhëheqjet e këtyre organizatave. Ata shkojnë me mendimin se këto organizata kanë forumet dhe udhëheqjet e tyre, që janë specialistë për këtë punë dhe le të bëjnë ç'të duan dhe kur të duan.

Me këtë nuk dua të them se ata nuk kanë kontakte, se nuk këmbëjnë mendime dhe nuk i koordinojnë fare punët. Por me atë seriozitet, zell dhe kujdes ashtu si duhet të bëhen punët, them përsëri që nuk bëhen. Prandaj ne duhet ta përmirësojmë punën edhe në këtë drejtim.

2. — Edukimi ideopolitik dhe teknik i komunistëve nën drejtimin e organizatës-bazë

Le të shikojmë tani çështjen e dytë, për të cilën doja të flisja, për edukimin ideopolitik dhe teknik të komunistëve nën drejtimin e organizatës-bazë të Partisë. Ky është një problem shumë i gjerë. Partia ka një plan dhe një program për këto probleme kapitale. Këto janë probleme të vazhdueshme për Partinë dhe për shtetin tonë. Sukseset janë shumë të mëdha në këta sektorë, prandaj në mbledhjen e sotshme nuk kam ndër mend ta zhvilloj këtë çështje në tërësinë e saj, po dua të theksoj disa aspekte praktike të çështjes dhe veça-

nërisht lidhur me interesimin më të mirë të organizatës-bazë dhe të komunistëve individualisht.

Pikësëpari, dua të theksoj se Partia dhe shteti ynë kanë krijuar për punonjësit e çdo kategorie të gjitha mundësitë ekonomike e materiale për të mësuar, si teknikën e punës e të zanatit, ashtu edhe për zhvillimin e intelektit, ngritjen ideologjike dhe politike të tyre. Pra, çështja vihet jo më se s'kemi mundësitë, por si ta organizojmë më mirë përfitimin kolektiv e individual me këto mundësi të mëdha që na janë krijuar. Këtu luajnë rol shumë faktorë që duhen vënë në lëvizje në mënyrë kolektive dhe individuale nga cilido prej nesh, faktorë objektivë dhe subjektivë.

E para, duhet vullnet i hekurt për të zhvilluar intelektin, për të mësuar nga puna, nga jeta, nga librat, nga sukseset, nga gabimet. E kanë të gjithë këtë vullnet? Atë nuk e kanë të gjithë njëlloj të zhvilluar. Disa e kanë vazhdimisht, e zhvillojnë dhe e ruajnë atë gjatë gjithë jetës; disa e kanë të zhvilluar për një periudhë, kur janë të rinj, me kujtesë më të freskët e fizik më të fortë; disa u dobësohet vullneti gjatë rrugës për shumë arsye, disa herë jo të shëndosha; disa nuk e kanë këtë vullnet fare, kanë mentalitet prapanik, kënaqen me pak ose pretendojnë shumë me një bagazh të vogël në kokë, ose me një fije zanati të prapambetur në dorë.

Vullneti nuk është si një paketë me energji që ta fal dikush një herë e përgjithmonë, ai lind, forcohet, shtohet, kalitet tok me jetën e njeriut, në jetë, në punë, në vështirësi, në gëzime dhe në hidhërime. Vullneti i hekurt është karakteristikë dalluese e revolucionare e ko-

munistëve, e luftëtarëve përparimtarë, e pionierëve që çajnë rrugë të panjohura e të vështira. Vullneti nuk ekziston ose thuhet të të plogëtit, të dembelët, tek ata që i tremben jetës, tek ata që e mendojnë jetën shesh me lule, pa përpjekje e pa mundime, tek ata që duan të rrojnë dhe të përfitojnë pa mundime me punën e shfrytëzimin e të tjerëve.

Njerëzit pa vullnet ose me vullnet të dobët në jetë, e që u thuhet vullneti, kanë nevojë për kalitje ideologjike dhe politike të madhe dhe të vazhdueshme, që ta kuptojnë si duhet drejtësinë e vijës së Partisë sonë në ndërtimin e socializmit, në rrugën e zhvillimit përparimtar të vendit, në luftë me ideologjinë borgjeze, me mbeturinat e saj në ndërgjegjen e njerëzve, të kuptojnë politikën e Partisë dhe të shtetit tonë në përgjithësi dhe në veçanti në arenën ndërkombëtare, në ndërlikimet e ngjarjeve botërore, në zhvillimin e tyre kompleks në luftën e përditshme me imperializmin, revizionizmin etj., etj.

Kjo nuk do të thotë se njerëzit me vullnet të fortë nuk kanë nevojë për kalitje të mëtejshme. Jo, edhe ata kanë nevojë, sepse nuk janë të imunizuar nga vështirësitë e jetës. Pra, që të ecë puna përpara, që njerëzit, komunistë e pa parti, të jenë në ballë të punës, në ballë të luftës, Partia duhet t'i kalitë të gjithë me një vullnet të hekurt për punë, për luftë kundër çdo vështirësie që hasin në rrugë. Që kjo të bëhet si duhet, Partia t'i mësojë njerëzit ta duan punën fizike e mendore dhe të zhvillojë e të organizojë kontrollin e të mësuarit të teknikës dhe ngritjen ideologjike e politike të tyre. Kur themi që Partia duhet të interesohet

intensivisht për këtë problem, ne kuptojmë në radhë të parë organizatën-bazë të Partisë.

Me kënaqësi mund të themi se organizatat-bazë të Partisë çështjen e edukimit të gjithanshëm të komunistëve e kanë kapur mirë, ka interesim të veçantë nga ana e tyre, prandaj ka edhe shumë rezultate të mira. Çështja vihet të ecim përpara, ta përmirësojmë punën.

Pikësëpari, Partia duhet t'ua bëjë vazhdimisht të qartë të gjithëve, dhe veçanërisht anëtarëve të saj, nevojën e domosdoshme të të mësuarit dhe vazhdimisht të të mësuarit. Shokët duhet të kuptojnë se të mbarosh një shkollë, nuk do të thotë të kesh mësuar çdo gjë që ke nevojë për luftën e jetës dhe, ca më pak, kur të mësuarit ose të mbaruarit e një shkolle e bën si një punë angari, me qëllim që të marrësh një diplomë, pa mësuar si duhet me baza, me rrënjë. Kualifikimi i kuadrit është një nevojë jetike për çështjen e socializmit, është një armë e domosdoshme e jetës materiale dhe shpirtërore për njeriun. Këto janë probleme të lidhura ngushtë, që Partia duhet t'ua sqarojë mirë anëtarëve të saj, si nga ana e zhvillimit ekonomik të vendit, ashtu edhe nga ana ideologjike e politike.

Sa tema diskutimesh mund të zhvillohen në një organizatë-bazë ku ka dobësi në këtë drejtim? Sa të duash. Disa herë në organizatën-bazë, për shembull, në temën si vete ndjekja e arsimit, e shkollës, mjaftohet me një raport të thatë dhe pastaj zihen në gojë për të mirë një ose pesë veta, nja dhjetë të tjerë zihen në gojë për të keq dhe raporti mbyllet me një rekomandim standard.

Kur flasim për edukimin ideologjik dhe politik të kuadrove, këtë nuk duhet ta bëjmë në mënyrë simplis-

te, duke mësuar disa formula teorike, ose duke parashtruar me pak fjalë, për shembull, politikën reaksionare amerikane. Ideologjia dhe politika, në kuptimin e vërtetë e të plotë të fjalës, duhet të jenë në zbrëthimin e të gjitha problemeve që na preokupojnë. Në çdo çështje, qoftë edhe në atë për të cilën në dukje mund të thuash: «Ç'hyn këtu politika ose ideologjia?», me një reflektim më të thellë do të shikosh se pamja në sipërfaqe të gabon.

Prandaj çështja e shkollës dhe e kualifikimit për kuadrot, për komunistët, duhet ta preokupojë Partinë. Partia të ndihmojë, të ketë lidhje me të gjitha institucionet ku mësojnë kuadrot e organizatës-bazë, të këshillojë e të marrë edhe masa për ata që neglizhojnë. Këto masa t'i shpjegojë politikisht që anëtari i Partisë, i cili është i pakujdesshëm për mësim e kualifikim, të kuptojë mirë se të mësuarit nuk është vetëm një përfitim individual, po edhe një detyrë shoqërore e dorës së parë. Shoqëria harxhon dhe ka nevojë për punë të kualifikuar. Në qoftë se ti nuk kualifikohesh, atëherë detyrimisht mbetesh prapa dhe do të humbasësh edhe politikisht, edhe moralisht, edhe ekonomikisht. Pastaj nuk ke të drejtë të thuash se ma ka fajin ai ose ky. Fajin e ke vetë.

Pra duhet t'i dënojmë qëndrimet formale ndaj punës edukative nga ana e organizatës-bazë. Po çështja s'mbaron vetëm këtu. Komunisti personalisht ka detyrën më të madhe, varet çdo gjë nga ndërgjegjja, nga vullneti, nga këmbëngulja, nga metoda e tij e punës dhe nga zbatimi i saj me rreptësi për të mësuar, për të ngritur nivelin e vet.

Tesera e Partisë të detyron moralisht, ideologjikisht dhe politikisht të jesh njeri i pararojës në punë, në luftë dhe veçanërisht për çështjen që na preokupon, për përvetësimin e diturisë. Ne kemi me mijëra kuadro pa parti ndaj të cilëve politika e Partisë ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht e drejtë. Ata janë të lidhur me Partinë dhe me popullin. Midis tyre ka sigurisht shumë që nuk tregojnë kujdes për kualifikimin e tyre. Por, në qoftë se merren edhe masa për këtë mungesë të tyre të madhe, duke i ulur në përgjegjësi, duhet të merren masa dy herë më të rënda për atë që mban taserën e Partisë dhe nuk e plotëson këtë detyrë.

Ka komunistë që nganjëherë qahen dhe thonë: «Pse ai që s'është anëtar partie më qëndron në atë vend, kurse unë mbaj një vend më të ulët se ai?». Është lehtë të fshihesh prapa taserës së Partisë dhe të reklamosh atë që akoma s'e meriton. Është mirë që njerëzit pa parti, kur e do puna, t'i ndreqim, t'ua korrigojmë të metat, siç bëjmë me komunistët, por t'i marrim edhe shumë herë si shembull kur kanë vullnet të fortë në punë, në mësim, në kualifikim dhe sjellje morale dhe politike shumë të mira. Mbi këto çështje ne duhet të reflektojmë thellë në organizatën-bazë dhe jashtë saj.

Të gjithë komunistët nuk do të bëhen filozofë dhe profesorë të marksizëm-leninizmit. Kjo do të ishte e mirë, po është e pamundur. Mirëpo çdo komunist, jo vetëm duhet ta dojë komunizmin, jo vetëm duhet ta dojë teorinë marksiste-leniniste, por edhe të luftojë për komunizmin, nën drejtimin e teorisë marksiste-leniniste. Për këtë ai quhet komunist dhe është anëtar partie. Por pa e mësuar këtë teori udhëheqëse, si mundet.

të luftojë ai si duhet? Prandaj studimi i teorisë marksiste është i domosdoshëm për të gjithë e, në radhë të parë, për komunistët.

Për këtë ka vështirësi, prandaj duhen vullnet, metodë dhe këmbëngulje. Zor ishte për ne në të kaluarën që filluam ta mësonim marksizmin «vjedhurazi», nëpër libra, pa pasqyrën e eksperiencës së jetës. Po tani kohët kanë ndryshuar. Sot po ndërtojmë me sukses socializmin, kemi një eksperiencë kolosale më se 20-vjeçare, çdo gjë sot flet qartë për vërtetësinë dhe drejtësinë e marksizëm-leninizmit. Sot ne kemi gjithashtu shkolla e kurse të marksizëm-leninizmit, libra e profesorë, nga çdo gjë e kudo nxirren vazhdimisht konkluzione teorike që pasurojnë dijenitë tona. Prandaj, vështirësitë në përvetësimin e shkencës së marksizëm-leninizmit sot i lehtësojnë realiteti socialist i vendit tonë dhe mjetet e panumërta që Partia dhe shteti u kanë vënë të gjithëve në dispozicion. Marksizëm-leninizmi dhe realiteti ynë socialist janë një thesar i madh: përfitoni prej tyre me të dyja duart, mësoni me zell të madh, mos u lodhni kurrë, mos u ngopni kurrë së mësuari!

Por të tërë nuk dinë të përfitojnë sa duhet dhe si duhet nga ky thesar. Prandaj organizata-bazë duhet t'i ndihmojë anëtarët e saj në këtë çështje të madhe, në mënyrë të organizuar. Të shtrosh thjesht detyrën e të mësuarit të teorisë marksiste-leniniste në organizatën-bazë, të kënaqesh me një kritikë apo autokritikë, të bësh një referat të çalë teorik, kuptohet se nuk është e mjaftueshme. Por edhe sikur këto që numërova të bëhen shumë seriozisht, kjo nuk është gjithçka dhe në kompleksin e gjerë të të mësuarit të marksizëm-leninizmit.

Kujdesi i organizatës-bazë duhet të konsistojë në atë që komunisti të mësojë nga librat e nga referatet bazat e teorisë, gradualisht, ashtu sikundër i kanë përcaktuar programet e Partisë, sepse të tëra përnjëherësh nuk mësohen, por puna e përditshme i mëson njerëzit me teorinë e marksizëm-leninizmit. Kush punon mirë në jetë, kush kryen detyrën e tij me më pak gabime, ai njih më mirë ligjet, rregullat, normat e punës që kryen. Këto ligje, rregulla e norma që ai i njih e i zbaton, janë me përmbajtje socialiste, janë ndërtuar me ideologjinë marksiste-leniniste. Në të shumtën e herës shokët tanë, nga studimi dhe njohja e ligjeve ekonomike, politike dhe nga zbatimi i tyre në jetë, janë një-rëz shumë të ngritur ideologjikisht, pavarësisht se janë në stadin e fillimit ose në stadin mesatar të studimit të teorisë, si teori që mësojnë në shkollë. Me këtë nuk dua të them aspak atë që, meqenëse zbatimi i detyrave në jetë na pajis njëkohësisht me teori, atëherë nuk duhet të bëjmë përpjekje për të mësuar teorinë marksiste-leniniste. Jo, këtë e them se puna, jeta socialiste, na mësojnë dhe na zhvillojnë njohjen me ligjet socialiste, na pajisin me një eksperiencë të tillë që lehtëson shumë studimin e teorisë.

Prandaj organizata e Partisë që udhëheq, organizon, frymëzon dhe edukon punonjësit, duhet të udhëheqë veçanërisht përgjithësimin e eksperiencës së ministrisë, të ndërmarrjes ose të institucionit, të jetë ky një përgjithësim teorik i problemit dhe këtë përgjithësim të eksperiencës dhe të luftës ta ballafaqojë me teorinë marksiste-leniniste, për mësim për kuadrot. Kështu, teoria dhe praktika koordinohen, teoria drejton prakti-

kën dhe praktika pasuron teorinë. Kjo është një punë që bëhet, po jo në thellësinë dhe në gjerësinë që duhet. Këtu ka akoma shumë të meta. Kjo duket një punë e rëndë, por shokët po të reflektojnë, do të dalin në konkluzionin që nuk është një punë e pamundshme të nxirret eksperiencia teorike nga puna për ndërtimin e socializmit. Natyrisht ne nuk duhet të kemi pretendime që çdo gjë do të dalë e përsosur. Asgjëkundi s'ka ndodhur dhe s'do të ndodhë kështu. Çdo gjë lind, rritet, përmirësohet me kohë, me pjekuri, me eksperiencë. Por kjo është një metodë dhe një mjet i rëndësishëm për të mësuar teorinë, për të forcuar njohuritë teorike. Prandaj organizata-bazë duhet të reflektojë thellë mbi këtë dhe të veprojë.

Veçanërisht ju, shokët e kryeqytetit, që jeni kuarto nga kryesorët, me ngritje kulturore dhe ideologjike, me luftë, me stazh dhe me eksperiencë të madhe në punë, duhet të jeni shembull pune në këtë drejtim. Partia dhe shteti ju kërkojnë ta kryeni medoemos këtë detyrë të madhe, pse ju udhëzoni, drejtoni, mësoni shokët e bazës.

Përveç kontakteve të gjalla dhe luftarake që ju mbani, zhvilloni e duhet të zhvilloni edhe më tej me bazën, juve ju bie barrë kryesore ndihma, kontrolli e përgjithësimi i eksperiencës. Ato letra që janë të lidhura me punën tuaj, duhet të jenë të atilla që t'u nxirrni, si të thuash, vaj të kulluar, për të cilin motorët kanë nevojë të vajisen që të punojnë mirë. Prandaj të mendojmë, shokë, dhe të veprojmë më mirë në këtë drejtim.

Por, përveç këtyre që thashë, edukimi ideologjik dhe politik i komunistëve nuk plotësohet me kaq, duhet

të ngjallim te shokët etjen për të lexuar jashtë këtyre formave të caktuara, jashtë punës, të lexojnë me kujdes literaturë teknike speciale, thjesht literaturë që ka lidhje me specialitetin dhe jashtë specialitetit. Komunisti duhet ta dijë mirë zanatin dhe profesionin, por duhet të jetë, si të thuash, deri diku edhe enciklopedik, brenda mundësisë të mos lërë asgjë t'u shpëtojë syrit dhe mendjes së tij, ai të mos lexojë vetëm me sy, por edhe me mendje, të mos pranojë kurdoherë konkluzionet e autorit, por të nxjerrë edhe vetë konkluzionet e tij dhe këto konkluzione, bashkë me ato të autorit, t'i peshojë me matësen e pagabueshme të marksizëm-leninizmit. Do të shihni atëherë sa të mëdha do të jenë përfitimet, sa e lehtë dhe e këndshme do të na duket puna, sa lehtë do të largohemi nga thashethemet, nga koha e humbur pa përmbajtje morale dhe intelektuale që, për fat të mirë, nuk është karakteristikë e kuadrove tanë, por që ka tek-tuk të tillë.

Por a mund t'i bëjë organizata-bazë të gjitha këto e të tjera si këto? Sigurisht, sigurisht, shokë. Këtu qëndron ajo që ne themi se organizata duhet të jetë një çerdhe revolucionarësh, ku jeta të gumëzhijë, të rrezatohet gjallëria e saj në punë, në shtëpi, në klub. Organizata-bazë s'punon vetëm ditën e mbledhjes. Dita e mbledhjes është orientimi kryesor, jeta e organizatës është jashtë mbledhjes. Jashtë luftojnë komunistët e ndërgegjegjshëm, parimorë, të ndershëm, në mënyrë revolucionare, të grupuar dhe individualisht.

Në këtë kuadër hyjnë detyrat shoqërore të komunistit. Këto detyra të mos i kodifikojmë dhe t'i fusim në korniza. T'i zhvillojmë ato, të gjejmë format e për-

shtatshme dhe t'i braktisim mbledhjet formale e të mër-zitshme.

Populli ynë i mrekullueshëm ka kurdoherë nevojë të mbahet në korent të situatave, të sqarohet për problemet e detyrat. Kush më mirë se komunistët do ta bëjnë këtë gjë për probleme të veçanta të sektorëve? Kush më mirë se shokët komunistë të atyre sektorëve do ta bëjnë këtë në mbledhje të popullit, në bisedimet në rrugë, në klub e kudo që ta bjerë rasti, ose në mbrëmjet familjare në shtëpitë e tyre? Të gjitha format janë të mira, ato janë të nevojshme, prandaj të tëra t'i përdorim.

Gazetat e përditshme ose periodike janë një ushqim i madh ideologjik, politik, ekonomik, informacioni për kuadrot. Shumë dinë të përfitojnë nga ky thesar, shumë nuk dinë dhe sa fatkeqë janë këta që nuk dinë. A duhet të ketë komunistë të tillë? S'duhet të ketë, s'duhet ta tolerojmë një gjë të tillë. Duhet filluar me qëllim të shëndoshë, me objektiv të qartë, me metodë pune për të krijuar te të gjithë njerëzit, te komunistët në radhë të parë, interesimin, zakonin e shfrytëzimit, të leximit e të komentimit të shtypit tonë. Sa përfitime, sa diskutime, sa shkëmbim mendimesh do të sjellë me vete leximi i shtypit. Sa pikëpamje të shëndosha do të kaliten, sa pikëpamje të paqarta në kokën e njerëzve do të sqarohen, sa pikëpamje të gabuara të disave do të ndreqen, sepse nuk mendojnë të tërë njëlloj për shtruarjen e ndonjë problemi. Sa kritika konstruktive mund t'i bëhen autorit të artikullit, sa sugjerime mund t'u bëhen Partisë dhe shtetit nga komunistët, nga masat, po të ndiqet e të lexohet si duhet shtypi.

Por ç'zhvillim merr intelekti i atij që e ndjek shtypin? Atij i mprehen mendimi, gjykimi, merr kurajë të flasë e të shfaqë mendimet e tij, të bëjë propozime, të aprovojë dhe të kundërshtojë. Duke lexuar shtypin, ai është në dijeni ç'bëhet në të gjithë vendin, ç'bëhet në botë, si zhvillohen e si zgjidhen problemet e brendshme dhe ndërkombëtare, si qëndrojnë e si luftojnë në ballë Partia dhe populli i tij heroik. Prandaj, organizata-bazë të bëjë propagandë të madhe në këtë drejtim. Njerëzit jo vetëm të abonohen në gazetë, por të udhëzohen e të mësohen sidomos si ta këndojnë gazetën dhe si të përfitojnë sa më shumë prej saj.

Nga një edukatë e tillë ideopolitike, nga një organizim i tillë i punës dhe i drejtimit nga ana e organizatës-bazë, ne do të shohim sa përparime do të kemi në forcimin e ndërgjegjes në punë, do të shohim se kuadrrot jo vetëm nuk do ta lënë kohën t'u kalojë kot, por kjo nuk do t'u mjaftojë.

Komunistët të jenë gjithmonë në këmbë, revolucionarë dhe pikërisht se komunistët janë të tillë, Partia jonë e lavdishme është revolucionare, luftarake, e pamposhtur në të gjithë punën dhe qëndrimet e saj. Këtë e tregon çdo gjë në të gjitha fushat, po edhe në luftën ndërkombëtare kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit hrushovian dhe titist. Partia çdo ditë ju mban në korent mbi situatën e brendshme dhe të jashtme.

Si mund ta karakterizojmë gjendjen aktuale ndërkombëtare? Ne shikojmë, nga njëra anë, kontradikta të thella midis imperialistëve, nga ana tjetër edhe thellimin e kontradiktave dhe të luftës së marksistëve.

zëm-leninizmit kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Ne vëmë re gjithashtu se revizionistët modernë kanë kontradikta të mëdha në mes tyre dhe s'ka si të jetë ndryshe, midis tyre s'mund të ketë harmoni. Revizionistët modernë të vendeve ish-socialiste po bëjnë përpjekje si e si t'i shpëtojnë drejtimit të revizionistëve sovjetikë, të bëhen sa më të pavarur, të mbajnë me këta vetëm disa lidhje ekonomike e politike dhe, nga ana tjetër, të krijojnë mundësi të shumta lidhjesh me imperialistët amerikanë dhe imperialistët e tjerë, lidhje ekonomike në fillim, por që kanë karakter politik. Më vonë, këto lidhje do të zhvillohen më tej në aleanca të ndryshme.

Aktualisht në dukje ngjan sikur imperializmi amerikan është në pararojë dhe drejton në vija të përgjithshme politikën botërore. Po në fakt nuk është kështu. Ai është sot përpara vështirësish të mëdha politike, ushtarake dhe ekonomike.

Pavarësisht se imperializmi amerikan është i armatosur gjer në dhëmbë, të gjitha synimet e tij po pësojnë disfatë nga lufta e popujve në radhë të parë. Ai ka krijuar fusha zjarri, të cilat e kanë vënë në vështirësi të mëdha ushtarake. Ato kanë diskredituar forcën ushtarake amerikane, i kanë dhënë një goditje të rëndë politike prestigjit të fuqisë së saj të madhe në fushën ndërkombëtare. Disfatat që po pëson imperializmi amerikan në çdo fushë janë një shprehje edhe e forcës së madhe gjithnjë në rritje të marksizëm-leninizmit dhe të popujve që luftojnë kundër imperializmit, ato janë njëkohësisht një fitore e madhe për ne.

Imperializmi amerikan po dështon me turp jo ve-

tëm në vatrat e zjarrit që ka hapur për shtypjen e popujve, por edhe në vetë aleancën e Atlantikut të Veriut, në të cilën dominon me vijën e tij politike, ekonomike dhe ushtarake. Në Evropë ai ka pësuar një tronditje të konsiderueshme, që ia ka shkaktuar borgjezia imperialiste franceze me Dë Golin në krye. Borgjezia franceze aktualisht ka krijuar një potencial ekonomik dhe ushtarak relativisht të konsiderueshëm, prandaj Dë Goli në udhëheqje të saj ka ngritur krye kundër diktaturës amerikane. Në këto kushte qenia e Francës në NATO është bërë një çështje formale, që mbahet vetëm në kartën e traktatit të NATO-s. Në fakt Franca ka tërhequr nga NATO-ja ushtrinë e saj, armatimet, marinën, aviacionin. Politika e Dë Golit është politikë e hapët antiamerikane, ajo nuk mund të mos jetë për ruajtjen e traktatit të Atlantikut të Veriut, megjithëse thotë se ai nuk është më aktual dhe kërkon që ai të ndryshohet. Ndryshimi në thelb qëndron në çështjen që borgjezia franceze nuk dëshiron që SHBA të jenë në krye dhe të sundojnë në këtë organizatë. Prandaj borgjezia imperialiste franceze është bërë tani minuese e autoritetit politiko-ushtarak të SHBA-së në përpjekjet e saj për të dominuar në Evropë.

Politika e Dë Golit synon për një Evropë gjoja për evropianët, po ku të dominojë Franca, politika franceze, ekonomia franceze, kultura dhe kapitali francez etj. Për t'ia arritur kësaj vetë Dë Goli bën përpjekje të mëdha. Ai bën një politikë që është e dëshirueshme edhe për revizionistët modernë. Nga një anë Dë Goli po vë barazhe kundër Amerikës, duke i krijuar kësaj vështirësi të mëdha në Evropë, nga ana tjetër ai ka hapur

krahët të lyer me njaltë për të kapur mizat revizioniste.

Ju jeni në dijëni se kohët e fundit Franca, përveç sabotimit që po i bën në fushën ushtarake NATO-s, ka filluar një sulm kundër SHBA-së edhe në drejtimin e politikës monetare amerikane. Dë Goli deklaroi haptazi për kthimin e monedhës në bazën e arit. Ai nuk pranon më bazën e dollarit për Francën dhe për këtë përpjet të gjejë përkrahës në botën financiare kapitaliste. Dë Goli, për të forcuar pozitën e monedhës franceze, deklaroi se dollari nuk është më një monedhë ndërkombëtare me forcën e arit; ai po lufton dhe propagandon që çdo monedhë të ketë bazën e vet te floriri dhe rekomandon të arrihet në gjendjen e vitit 1932. Një hap i tillë, natyrisht, nuk u pëlqen aspak amerikanëve. Pikërisht për këtë po zhvillohet tani një luftë e ashpër banditeske në mes imperialistëve, kush t'i vërrë këmbën njëri-tjetrit.

Çështje me rëndësi në Evropë për të dyja këto fuqi të mëdha kapitaliste është ajo e Gjermanisë Perëndimore. Si Franca, ashtu edhe SHBA kanë vënë shanset e fitoreve të tyre «të ardhshme» te ky kalë, kush do ta ketë me vete. Mirëpo Boni është një ujkongjë e vjetër. Qëllimi i tij është revanshi dhe ky qëllim po bëhet gjithnjë e më i qartë çdo ditë që kalon. Gjermania Perëndimore tani është forcuar, ajo ka sot forcën më të madhe ushtarake në NATO, paguan shumë para në këtë organizatë, prandaj edhe kërkon të ketë dorë në sistemin e armëve atomike amerikane. Natyrisht, SHBA-së nuk u leverdis që Gjermaninë Perëndimore ta bëjnë plotësisht ortakun e vet, ta armato-

sin me armë atomike. Dë Goli, nga ana tjetër, është kundër kësaj gjëje, po jo që Gjermaninë të mos e ketë aleate. Franca bën përpjekje ta ketë aleate Gjermaninë e Bonit edhe në qoftë se kjo do të ketë armët atomike, po këto ajo t'i ketë në kuadrin e një aleance me Francën. Duke e mbuluar këtë aleancë me parullën e «Evropës për evropianët», Franca dëshiron që Gjermania t'i japë dudat Amerikës. Tani Gjermania e Bonit nuk shkon pas kësaj politike, por edhe nuk shkëputet fare nga Franca. Gjermania Perëndimore bën një politikë të lëkundshme, ruan marrëdhëniet me Francën, por edhe me SHBA-në nuk e prish, megjithëse Dë Goli e nxit ta prishë. Me një fjalë lufta zhvillohet kush ta bëjë për vete Gjermaninë.

Vetë Gjermania Perëndimore ka për qëllim jo vetëm të armatoset, por edhe të dominojë. Për këtë qëllim ajo përpiqet të krijojë një fuqi të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake. Për t'ia arritur këtij objektivit në radhë të parë ajo lufton që «të bashkohet», domethënë të gllabërojë Republikën Demokratike Gjermane, sepse kështu Gjermania do të bëhej gradualisht ajo që ka qenë në kohën e hitlerianëve, e armatosur gjer në dhëmbë dhe me një potencial ekonomik të fuqishëm.

Pra për problemin gjerman dhe zgjidhjen e tij sot ka tri synime, tri politika.

Politika amerikane, në lidhje miqësore e të fshehtë me hrushovianët, nisët nga parimi që aktualisht të mos prishet statukuojë për sa i përket Berlinit, që sovjetikët dhe Republika Demokratike Gjermane t'u bëjnë lëshime

imperialistëve amerikanë, të prishet muri i ndarjes në Berlin dhe, po të duan gjermanët e Lindjes, të bashkohen. Imperializmi gjerman shpreson në këtë drejtim. Kjo shpresë ishte e madhe sidomos kur N. Hrushovi ishte në fuqi. Me sa dimë ne, Hrushovi kishte hyrë në marrëveshje të fshehta me Bonin në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane, pa dijeninë e vendeve të tjera anëtare të Traktatit të Varshavës. Ai u përpoq të krijonte një situatë kompromisi për zgjidhjen jo menjëherë të çështjes gjermane, por duke iu adaptuar gradualisht politikës dhe kërkesave të amerikanëve dhe të Bonit. Mirëpo edhe pas rënies së Hrushovit tratativat midis amerikanëve dhe sovjetikëve në fakt vazhdojnë. Çështja gjermane i ka zënë në fyt ata.

Dë Goli ndjek edhe ai një politikë, natyrisht reacionare, por me qëllime të tjera dhe të mbuluara me njëfarë demagogjie. Ai është i bindur se populli gjerman duhet të bashkohet dhe këtu ai është në një vijë me Adenaurin. Por një gjë e tillë, sipas Dë Golit, nuk mund të bëhet përderisa amerikanët të mos jenë qeruar nga Evropa. Francezët thonë në qoftë se «aleatët» tanë amerikanë nuk largohen nga Evropa, mosbesimi ndaj tyre nuk ka si evitohet, prandaj ata duhet të largohen nga Evropa, gjë që do të bëjë të mundshme të krijohet një situatë e favorshme që me bisedime, me kontakte dhe me kompromise të zgjidhet problemi gjerman, sigurisht në drejtimin që duan ata, francezët dhe gjermanët. Kjo është një tufë me lule që i jep Dë Goli Adenaurit.

Anglezët, natyrisht, qëndrojnë dhe do të qëndrojnë edhe në të ardhmen të lidhur me amerikanët, por nuk janë plotësisht të bindur që revanshistëve të Bonit t'u

lihet në dorë një potencial i madh atomik. Anglezët kanë disa plane që nuk ndryshojnë nga ato të amerikanëve për sa i përket armatimit të Bonit, por me nuanca, të cilat amerikanët dhe gjermanët pranojnë t'i diskutojnë, kurse Franca nuk pranon. Në këto kushte kryeministri anglez u orvat të shkonte në OKB me disa propozime të reja për sa i përket armatimit të Gjermanisë Perëndimore. OKB-ja është një tjetër qendër kontradiktash të mëdha midis imperialistëve dhe një vatër intrigash amerikano-sovjetike në dëm të popujve. Kohët e fundit kriza e OKB-së është bërë shumë e thellë. Prandaj kryeministri anglez nuk mundi të shkonte në SHBA dhe të shtronte në OKB problemet e mëdha ndërkombëtare që mendonte.

Konflikti, në dukje, në OKB është për çështje financiare, por në fakt ai është një konflikt i ashpër ideologjik financiar. Dy superfuqitë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, OKB-në e kanë kthyer në një vegël me anën e së cilës ndërhyjnë në punët e brendshme të popujve për t'u diktuar vullnetin e tyre.

Shqipëria e ka shfrytëzuar tribunën e OKB-së për të demaskuar politikën mashtruese të të dy superfuqive, duke u treguar popujve rrugën e vërtetë. Për Shqipërinë në OKB është krijuar një situatë shumë e favorshme. Ka përfaqësues të shumë popujve, sidomos të atyre të Afrikës dhe të Azisë, që na simpatizojnë, sepse politika e Partisë sonë ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë e drejtë duke përkrahur popujt e shtypur.

Revizionistët aktualë sovjetikë janë po aq tradhtarë dhe të poshtë, armiq të socializmit, sa ishte edhe N. Hrushovi. Ai ishte një armik i tillë që ndiqte një po-

litikë të jashtme dhe të brendshme aventureske dhe pa baza. Veprimet e tij ishin të pamatura, të papeshuara. Çdo mëngjes ai hidhte nga një «bombë». Propaganda jonë e bëri leckë atë para opinionit publik botëror. Udhëheqësit e rinj sovjetikë ndjekin vijën e Hrushovit, pasi nxorën mësim nga disfatat, përpiqen që pa i ndryshuar asnjë presje vijës së përgjithshme hrushoviane të politikës së jashtme, të jenë sa më të kamufluar. Brendapërbrenda ata po bëjnë disa ndryshime.

Por megjithatë udhëheqja e sotme sovjetike është shumë e tronditur, sepse me rrëzimin e Hrushovit ajo pësoi një disfatë të madhe ideologjike dhe politike dhe tani po përpiqet të marrë veten. Preokupacioni i saj kryesor është të pushojë polemika nga ana jonë. Ajo po përpiqet me çdo kusht t'i mbajë sa të jetë e mundur nën vete vasalët e vet revizionistë, të mbajë miqësi dhe të kurdisë aleanca të reja me imperialistët amerikanë, «të korrigojë» gabimet e Hrushovit, siç janë, për shembull, gabimet në fushën ekonomike. Në drejtim të partisë Hrushovi krijoi dy parti, atë të industrisë dhe partinë e bujqësisë. Këtë, qysh sa e morëm vesh, ne e kemi kritikuar dhe e kemi goditur si një hap antimarksist, shkatërrues, që ndihmon në restaurimin me shpejtësi dhe me bujë të kapitalizmit.

Marrëdhëniet e revizionistëve sovjetikë me imperialistët amerikanë po shkojnë duke u forcuar. Ata kanë nënshkruar gjer tani 4-5 marrëveshje të rëndësishme me amerikanët që Hrushovi i kishte përgatitur, por që ndoshta nuk pati kohë ose nuk mund t'i nënshkruante. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë kanë arritur gjithash-

tu në ujdi me amerikanët që Xhonsoni të vizitojë Bashkimin Sovjetik dhe ata të vizitojnë SHBA-në. Pra kua-dri është i plotë, udhëheqësit e tanishëm sovjetikë ndjekin rrugën tradhtare të Hrushovit të aleancave me imperializmin amerikan.

Për sa i përket çështjes brenda radhëve të revizionistëve, në mes tyre ka kontradikta që shtohen çdo ditë. Revizionistët evropianë e pranojnë me zor hegjemoninë e revizionistëve sovjetikë. Të gjithë janë bërë kokoshë, ndjekin një politikë më vete speciale dhe një politikë të përgjithshme ekonomike dhe ideologjike me imperialistët e ndryshëm. Edhe për mbledhjet që ata orvaten të bëjnë kanë divergjenca.

Sikurse e dini, në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës nuk u arrit asnjë unitet midis tyre, përkundrazi, disa u ngritën për t'u larguar, meqenëse nuk ishin dakord me ato që u shtruan. Me një fjalë, sikurse e patë edhe nga komunikata, kjo mbledhje e revizionistëve ishte diçka as mish as peshk, një gjë e vdekur. Shtypi botëror kapitalist kritikoi çështjen që nga kjo mbledhje nuk doli asgjë, ndërsa vetë amerikanëve u erdhi rëndë, sa që një gazetë e Uashingtonit, për t'i dhënë pak popullaritet mbledhjes, u detyrua të thoshte sikur gjoja një frazë e komunikatës së mbledhjes së Traktatit të Varshavës përbëka rrezik.

Pra midis revizionistëve ka pasur dhe ka kontradikta. Letra që iu dërgua mbledhjes së fundit të Varshavës nga ana e Qeverisë Shqiptare i bëri pjesëmarrësit të diskutonin, që ta lexonin apo të mos e lexonin atë në mbledhje. Vendosën të mos e lexojnë në mbledhje, po çdo delegacion ta lexonte më vete. Qeverisë sonë

sekretariati i mbledhjes nuk pranoi t'i përgjigjej, po vendosi të na jepej përgjigje nga komiteti, sikurse e morët vesh. Kjo gjë u duk qartë edhe në mbledhjen e KNER-it, që u zhvillua kohët e fundit, e cila kishte si qëllim kryesor futjen e Jugosllavisë në këtë organizatë. Në komunikatën që lëshuan u tha se bisedimet u zhvilluan në unitet. Kjo sa për konsum të jashtëm, sepse në të vërtetë mbledhja ka pasur kundërshtime të mëdha midis vendeve revizioniste dhe revizionistëve sovjetikë që kërkonin me çdo kusht t'i bindeshin diktatit të tij. Këtu ata shtruan vetëm disa çështje pa rëndësi, kurse ato më të rëndësishmet i diskutuan prapa skenës, sepse midis tyre ka pasur kundërshtime të mëdha. Është e pamundur që revizionistët të bien dakord midis tyre. Kjo vjen edhe nga fakti se marrëdhëniet ekonomike të vendeve ish-socialiste ku sundojnë revizionistët janë në vështirësi të mëdha, pasi këto vende planet e tyre i kanë pasë ndërtuar në ujdi me planet e sovjetikëve, që ishin të fryra dhe boshe. Mirëpo ndryshimet që u bënë në Bashkimin Sovjetik pas tradhtisë së hapët të Hrushovit, shkaktuan katastrofa të mëdha ekonomike që u reflektovan edhe në planet e këtyre vendeve. Kështu sot këto vende nga Bashkimi Sovjetik nuk marrin dot as bukë as mish as lëndë të para për të cilat ka nevojë ekonomia e tyre. Kështu, për shembull, Polonia dhe Hungaria aktualisht kanë nevojë për drithë, kurse Bashkimi Sovjetik nuk është në gjendje t'ua plotësojë këto nevoja.

Prandaj në këto situata të vështira po krijohen pakënaqësi të mëdha në popujt e këtyre vendeve, për shkak të disfatave në ekonomi si pasojë e pikëpamjeve antimarksiste dhe e politikës tradhtare, properëndimit,

të revizionistëve. Popujt e këtyre vendeve po shohin se si udhëheqjet e tyre po vërsulen të marrin, dhe në fakt po marrin, kredi nga Amerika, Franca, Anglia etj. Dihet se askush nga imperialistët nuk jep kredi pa pasur interes. Kreditë që janë duke marrë, nuk janë veçse investime të kapitaleve të imperialistëve në vendet e ish-demokracive popullore në interes të kapitalizmit amerikan, anglez, francez etj. Këto vende do të nxjerrin nga kreditë përfitime gjoja në formën e ndihmës, kurse në fakt, me transformimin e ndërmarrjeve, gjoja me sistem socialist, në truste të mëdha, po hidhen themelet e ekonomisë kapitaliste, në të cilën me kohë kapitalet e huaja do të kenë paketat më të mëdha të aksioneve. Nga ana tjetër, marrja nga vendet ish-socialiste e kredive nga imperialistët do të sjellë me vete edhe pasoja të tjera të rrezikshme. Vendet që marrin kredi do të detyrohen t'u japin privilegje kredidhënësve, do t'u hapin këtyre portën për futjen e kulturës dekadente, të propagandës dhe të ideologjisë borgjeze. E tillë është perspektiva e këtij orientimi.

Në këto situata revizionistët sovjetikë përpiqen të mos u shpëtojnë nga duart revizionistët në vendet e tjera. Por dominimin e dikurshëm mbi të tjerët ata nuk do ta kenë, kjo ka vdekur. Përpjekja për bashkimin e revizionistëve në një drejtim është njëlloj sikur të duash të bësh një stan me lepuj.

Revizionistët sovjetikë po përpiqen të bëjnë mbledhjen e 1 marsit. Por vallë a do të arrijnë ta bëjnë këtë mbledhje? Shanse ka ta bëjnë, por mundet edhe të mos e bëjnë, sepse edhe në radhët e tyre ka shumë që nuk e duan mbledhjen. Por mundet edhe ta bëjnë për arsye

se sovjetikët duan të krijojnë së paku njëfarë nyje lidhëse dhe ta zhvillojnë atë me një veprimtari të mëtejshme të të gjithë krerëve revizionistë nga janë dhe nga s'janë. Kështu mendojmë ne. Mund edhe të gabohemi, por gjer tani Partia jonë nuk ka gabuar. Duket se revizionistët modernë po përpiqen të krijojnë grupe. Toliati, për shembull, ka synuar krijimin e grupeve të tilla, të cilat në politikën e përgjithshme të jenë së bashku, po të veprojnë cilido veç e veç. Kurse sovjetikët po orvaten të krijojnë grupe në favor të tyre. Kështu ata kanë punuar kohët e fundit me disa parti të vendeve të Amerikës Latine dhe kanë arritur të influencojnë për të bërë një mbledhje të tyre, që është mbledhje e partive revizioniste të këtij kontinenti. Kjo mbledhje u bë në Havanë nën influencën e sovjetikëve. Qëllimi i revizionistëve sovjetikë është të grumbullojnë rreth vetes krerët revizionistë të Amerikës Latine për të dhënë përshtypjen që të gjithë komunistët e këtij kontinenti janë me sovjetikët dhe jo me «dogmatikët». Mirëpo kjo nuk qëndron në këmbë. Edhe në vendet e Afrikës dhe të Lindjes së Afërt revizionistët sovjetikë ndjekin një politikë me dy brirë. Politika e hrushovianëve në këto vende ka synuar dhe synon në likuidimin e partive marksiste-leniniste dhe tani për t'i nxjerrë ato nga ilegaliteti në legalitet, për t'i bërë komunistët e këtyre vendeve që t'u nënshtrohen regjimeve në fuqi.

Në Lindjen e Largme revizionistët sovjetikë mbështeten tani në partinë tradhtarë të Danges në Indi, e cila ka mbetur në pakicë. Gjithashtu mbështeten te Sharki në Australi etj.

Partia Komuniste Franceze me rrugën revizio-

niste që ndjek po shkon drejt kësaj situatë. Rryma e revizionistëve italianë po depërton në këtë parti, revizionistët titistë jugosllavë kanë depërtuar gjer në udhëheqjen e Partisë Komuniste Franceze, e cila, megjithëse ka mosbesim te sovjetikët, përsëri po degjenerohet.

Revizionistët modernë kanë pësuar disfata të mëdha për shkak të luftës që po u bën Partia jonë dhe lëvizja marksiste revolucionare, prandaj janë në kaos. Lëvizja e partive dhe e grupeve marksiste revolucionare ka gjetur dhe vazhdimisht do të gjejë kudo rrugën e vërtetë që duhet ndjekur. Në vendet kapitaliste kjo lëvizje natyrisht nuk është akoma në atë nivel që kërkohet, por po ecën përditë në rritje të shpejtë. Ne shikojmë se grupet e mëparshme marksiste revolucionare nuk janë më të vogla si para dy vjetësh, ato tashmë janë transformuar në grupe më të mëdha, me një rreth të mirë anëtarësh e aktiv simpatizantësh.

Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) u formua gjithashtu kohët e fundit. Edhe kjo do të nxjerrë së shpejti organin e vet. Kurse në vendet e Amerikës Latine ka disa parti që qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste.

Pra kudo lëvizja revolucionare marksiste është në ngritje. Po a mund të na bëjnë ne revizionistët të pushojmë polemikën? Partia e Punës e Shqipërisë nuk e ka pushuar dhe nuk do ta pushojë polemikën, përkundrazi, ashtu si gjer më sot, ajo do të luftojë deri në fund për shkatërrimin e plotë të revizionizmit modern. Ky është një qëndrim plotësisht i drejtë që gjen edhe aprovimin e gjithë partive të vërteta marksiste-leniniste.

niste. Të gjithë kanë respekt, dashuri dhe aprovojnë plotësisht vijën e drejtë të Partisë sonë. Edhe Partia Komuniste e Kinës në shtypin e saj boton artikujt tanë. Disa pyesin: përse shokët kinezë nuk dalin me artikuj sikurse edhe ne kundër udhëheqësve të rinj sovjetikë? Ata thonë se do të dalin, por deri tani këtë nuk e kanë bërë. Të shohim më vonë.

Revizionistët sovjetikë po zhvillojnë një veprimtari të madhe për të lidhur nyjet atje ku e shikojnë të mundshme. Për këtë qëllim shkoi në Vietnam Kosigini. Gjatë udhëtimit për në Vietnam ai u ndal edhe në Pekin. Çfarë bisedoi gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Pekin, ne nuk dimë gjë, po jemi të bindur se Kosigini me shokë po bëjnë çdo përpjekje që u vjen për dore për shuarjen e polemikës dhe për të bindur të tjerët të shkojnë në mbledhjen e tyre.

Përse shkoi Kosigini në Vietnam? Për të ngritur prestigjin e Bashkimit Sovjetik në Vietnam, për t'i gënjyer vietnamezët se gjoja Bashkimi Sovjetik do ta ndihmojë popullin «vëlla» vietnamez, bile në mënyrë «të sinqertë», mund t'u thotë edhe në vesh që Hrushovi nuk u ka dhënë ndihmë, se u ka dhënë topa të vjetër etj., po pasardhësit e tij do t'i ndihmojnë me tanke dhe me avionë. Këtë ata mund ta bëjnë për të lëkundur besimin dhe vendosmërinë e vietnamezëve në luftën kundër imperialistëve amerikanë. Këtë demagogji sovjetikët do ta bëjnë sikurse e kanë zakon, me qëllim që të krijojnë përshtypjen në botë se janë vetëm ata që e ndihmojnë Vietnamin. Bile Kosigini mund të ketë në xhep edhe ndonjë plan për koordinimin e veprimeve në drejtim të neutralizimit të Vietnamit të Veriut ose për ndonjë

kompromis në mes Republikës Demokratike të Vietnamit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por a do të guxojë ta shtrojë këtë Kosigini dhe të arrijë ndonjë rezultat? Ne nuk e besojmë, sepse ndaj imperialistëve amerikanë nuk do të lëshojnë as vietnamezët e Veriut, as ata të Jugut. Udhëheqësit sovjetikë ka mundësi të parashtrajnë variante të ndryshme në Vietnam, por ne kemi bindjen se do të dështojnë.

Amerikanët bënë mbrëmë një provokacion tjetër të madh në Vietnamin e Veriut, ku bombarduan dy qendra banimi, duke përdorur si pretekst se në një largësi të madhe nga Sajgoni partizanët e Vietnamit sulmuan përsëri një aerodrom, ku vranë 7 amerikanë, plagosën mbi 100 të tjerë, dogjën edhe shumë aeroplanë. Kjo tregon për luftën e madhe që bëhet në Vietnamin e Jugut. Reaksionarët vietnamezojugorë dhe amerikanët mbajnë vetëm qytetet, aerodromet dhe rrugët, kurse gati i tërë territori është në duart e partizanëve vietnamezë. Në Vietnamin e Jugut komunistët janë në udhëheqje të luftës, ata nuk e kanë legale partinë, po ajo udhëheq Frontin Kombëtar të Çlirimit. Në saje të luftës së ashpër pozitat e imperialistëve amerikanë në Vietnamin e Jugut janë dobësuar jashtëzakonisht shumë. Tani preokupacioni i madh i tyre është si të shpëtojnë nderin. Kosigini me vajtjen e tij në Vietnam po përpiqet t'i ndihmojë në këtë drejtim imperialistët amerikanë, duke u orvatur të nxjerrë disa koncesione në favor të tyre.

Por do t'ia arrijë këtij qëllimi? Nuk e besojmë. Me provokacionin e rëndë që bënë mbrëmë amerikanët u dhanë një shuplakë të fortë sovjetikëve, në një kohë

kur Kosigini po bën bisedime me vietnamezët e Veriut. Sot TASS-i lëshoi një komunikatë, në të cilën shpresohet se amerikanët nuk do ta zgjerojnë luftën në Vietnam. Ky është një tjetër gjest kapitullimi si ai i Karaibeve përpara imperialistëve amerikanë. Me bombardimet amerikanët i paralajmërojnë sovjetikët se, në qoftë se nuk lëshojnë në favor të Vietnamit të Jugut, ata kështu do të veprojnë dhe, me të ikur Kosigini nga Vietnam, do ta zgjerojnë luftën. Ky është një shantazh që u bëhet Kosiginit dhe shokëve të tij, për t'i futur në rrjetë, për të fituar koncesione si me Hrushovin në ngjarjet e Karaibeve.

Kështu është situata në përgjithësi. Edhe brenda në Bashkimin Sovjetik gjendja nuk është e mirë. Udhëheqësit revizionistë kanë shumë vështirësi.

Partia jonë ecën me vendosmëri në rrugën e saj të drejtë. Këtë rrugë ajo do ta ndjekë gjer në fund, se është e bazuar në marksizëm-leninizmin dhe vija e saj aprovohet nga i gjithë populli ynë. Me vijën e Partisë sonë janë solidarë edhe të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë në botë. Detyrat tona në këtë situatë politike dhe ekonomike janë të mëdha.

Në pikëpamje ekonomike ka rëndësi të madhe çështja që situata në vendin tonë të jetë vazhdimisht e mirë, populli të gjejë çdo gjë dhe në çdo kohë. Prandaj duhet të punojmë që popullit t'i plotësohen kërkesat. Në pikëpamje politike ka rëndësi të madhe çështja që me sukseset tona në çdo fushë të vërtetojmë drejtësinë e sistemit socialist që ka mbetur në të vetmin vend në Evropë, sepse që nga Bashkimi Sovjetik dhe në vendet e tjera socialiste, ka filluar në shkallë të

gjerë degjenerimi i sistemit socialist dhe transformimi i tij gradual në sistem kapitalist. Prandaj Shqipëria është kështjella e ndërtimit të vërtetë të socializmit në Evropë. Ajo po ndërton socializmin në kushte shumë të vështira, e rrethuar nga të katër anët nga armiq imperialisto-revizionistë, që harxhojnë forca të mëdha ekonomike dhe propagandistike kundër nesh për të na mposhtur. Por Shqipëria socialiste nuk tronditet, përkundrazi ajo ecën përpara me sukses, përballon vështirësitë, fiton dhe jep shembull në çdo drejtim.

Ne nuk mburremi me qëndrimet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë, por është fakt se qëndrimi i Shqipërisë, qëndrimi i palëkundur dhe i drejtë i një vendi dhe i një populli kaq të vogël si ne, i frymëzon popujt. Ndihma që na jep Shqipëria, vënë në dukje ata, nuk mund të çmohet.

Për këtë arsye, çdo vit në vendin tonë vijnë dhe do të vijnë shumë njerëz si miq, jo vetëm marksistë-leninistë, por edhe të rrymave të tjera demokratike, për t'u njohur me sukseset e arritura në ndërtimin socialist të vendit. Prandaj të jemi kurdoherë në lartësinë e detyrave, të japim shembullin e mirë të një vendi të përparuar dhe të pastër socialist, të një populli heroik e përparimtar dhe të një partie marksiste-leniniste që do t'u qëndrojë kurdoherë besnike idealeve të mëdha të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

*Botuar për herë të parë, me shkurtime, në «Raporte e fjalime 1965-1966», f. 5.
Tiranë, 1971*

Botohet sipas origjinalit që gjendet në AQP, duke përfshirë edhe pjesë të papublikuara më parë

FORCIMI I PARTISË ËSHTË HALLKA KRYESORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

13 shkurt 1965

Duke marrë shkas nga disa çështje që na raporton Komiteti i Kontrollit të Partisë, dua të them pak fjalë për forcimin e Partisë. Në radhë të parë, jam i mendimit që, kur të na vijnë raporte të tilla për shqyrtim në Sekretariatit e Komitetit Qendror, nuk mjafton të përmbajnë vetëm tematikën e punës, ose të radhiten në mënyrë të thjeshtë disa ngjarje. Do të ishte më frytdhënëse të pasqyrohej këtu jo vetëm natyra e këtyre ndodhive, po edhe si i zgjidh Komiteti i Kontrollit të Partisë problemet, si është zhvilluar procesi i tyre. Nuk duhet që Komiteti i Kontrollit të Partisë ta mbësh-tetë punën vetëm në lutjet, kërkesat dhe ankesat e atyre komunistëve që bëjnë faje ose që kërkojnë të shfajësohen. Sikurse u tha edhe këtu, në Parti ka edhe shumë probleme të tjera, për të cilat nuk bëhen shë-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Komitetit të Kontrollit të Partisë gjatë vitit 1964.

nime, jepen dënime, por ata që janë dënuar nuk drejtohen më lart.

Disa fenomene që u ngritën këtu për Vlorën, nga informacionet që kemi, ku më shumë e ku më pak, dalin edhe në rrethet e tjera, ndoshta edhe më shumë se në Vlorë. Kjo është një çështje që duhet të na preokupojë seriozisht. Këtë ne e kemi thënë edhe herë të tjera dhe përmirësime janë bërë, por duhet t'i mobilizojmë edhe më mirë aparatet, komitetet e Partisë, sekretarët e tyre dhe instruktorët që të bëjnë një kthesë rrënjësore në çështjen e mobilizimit të komunistëve, të forcimit të organizatave-bazë, të forcimit të Partisë në të gjitha drejtimet. Nuk është fjala se në Partinë tonë ka shfaqje të huaja të theksuara. Përkundrazi, Partia jonë në radhë të parë po rritet dhe po forcohet, po kalitet vazhdimisht bashkë me zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Po kjo nuk do të thotë që në pikëpamjet e njerëzve, në jetën e në qëndrimet e tyre të mos ketë edhe shfaqje negative, të mos ketë dobësi në karakterin dhe në botëkuptimin e tyre. Këto i shikojnë organet dhe komitetet e Partisë, por mbase duhet t'i shikojnë më thellë nga pikëpamja e rëndësisë dhe e rrezikshmërisë, në mënyrë që të vepronhet menjëherë, me energji dhe në mënyrë revolucionare kundër këtyre shfaqjeve të huaja, jo duke dhënë dënime e duke marrë masa, por duke bërë një punë të dendur e të thellë edukative me njerëzit.

Është theksuar kurdoherë se realizimi i planeve ekonomike në vendin tonë është konkluzion logjik dhe në raport të drejtpërdrejtë me forcën mobilizuese, drejtuese, organizuese dhe edukuese që zhvillohet nga

Partia. Në këtë drejtim kemi përparime. Duhet të kuptojmë se rezultate në ekonomi ne do të kemi vazhdimisht dhe kurdoherë do të jemi në progres. Por nuk duhet të vetëkënaqemi me rezultatet që arrijmë dhe të harrojmë se në këtë punë të madhe që bëhet në fushën ekonomike nuk ka vështirësi, shpërdorime, dëmtime dhe përvetësime të pasurisë socialiste etj. dhe këto t'i mbulojmë me sukseset që realizojmë ose me opinionin që ekziston nganjëherë se «punët po na shkojnë mirë». Kështu ne mund të gjendemi në situata të vështira.

Si pasojë e një pune të dobët politike ka pasur raste që ne të jemi gjendur në situata të vështira. Kështu ndodhi, për shembull, në disa rrethe të Veriut lidhur me kooperativat bujqësore¹. Po të thellohemi në këtë çështje, do të konstatojmë se në këto rrethe nuk është bërë si duhet një punë e organizuar politike, një vlerësim i punës armiqësore, një kujdes për forcimin e organizatave-bazë në luftën kundër grindjeve e tarafeve dhe për edukimin politik e ideologjik të vazhdueshëm të njerëzve. Përkundrazi, ka pasur një nënvleftësim të kësaj pune, ka pasur vetëkënaqësi, që shprehet me fjalët, për shembull, «në Shkodër punët shkojnë mirë», se «po realizohen planet ekonomike» etj. Mirëpo arrin një moment që del hapur puna armiqësore. Elementi armik vepron kundër vijës së Partisë dhe lëkund te disa fshatarë çështjen e drejtë të kolektivizimit.

Po ta shohim si është ndërtuar shteti ynë dhe si

1 Shih në këtë vëllim, f. 119.

udhëhiqet ndërtimi i socializmit në Shqipëri, duhet të nxjerrim menjëherë konkluzionin që çdo fenomen negativ, kudo që shfaqet, tregon se në atë sektor Partia punon dobët, ka njerëz liberalë, oportunistë, që nuk luftojnë në mënyrë revolucionare. Është për këtë arsye që njeriu i keq, me parti ose pa parti, gjen shesh dhe na dëmton ekonominë ose na pengon në punën që bën Partia për ngritjen ideologjike të njerëzve.

Kështu duhet të shikohen këto çështje dhe jo të na thuhet se kemi dëmtime ose përvetësime, po këto nuk bëhen nga anëtarët e Partisë. Ç'do të thotë kemi të tilla, po jo nga anëtarët e Partisë? Mos vallë kështu e kemi Partinë në rregull? Një pikëpamje si kjo nuk duhet të pranohet. Në qoftë se në një vend kemi vjedhje dhe dëmtime, kjo do të thotë se atje Partia nuk është në rregull. Kudo që shfaqen të tilla fenomene, duhet të mendojmë se atje organizata-bazë e Partisë është e dobët, prandaj t'i vëmë rëndësi të madhe, në radhë të parë, çështjes së edukimit të Partisë dhe të bëjmë një punë më të organizuar në të gjitha drejtimet.

Është e nevojshme, si në bazë dhe në qendër, që puna jonë vendimtare të konsistojë në forcimin e Partisë. Çdo rregullore, çdo metodë pune që kemi vendosur në të gjithë sektorët dhe drejtimet, çdo ndarje pune etj., të gjitha këto duhet t'i shikojmë me syrin e forcimit të Partisë. Forcimi i Partisë nuk duhet parë vetëm nga ana administrative, nga pikëpamja e zbatimit të rregulloreve të Partisë, të Statutit etj., etj., por nga pikëpamja e ideologjisë, për edukimin e njerëzve nëpërmjet formave që kemi, të cilat duhet të studiohen e të zbatohen rreptësisht dhe në mënyrë frytdhënëse. Jo

vetëm kaq, por forcimin e Partisë ne duhet ta shohim gjithashtu edhe në drejtimin ekonomik, industrial ose bujqësor, në të gjithë vendin. Komunistët të gjitha këto drejtime duhet t'i shohin nën prizmin e forcimit të Partisë. Po të jenë anëtarët e Partisë të fortë dhe në lartësinë e duhur në të gjitha këto drejtime, çështja e socializmit dhe e komunizmit, edukimi i njerëzve, uniteti ideopolitik i tyre dhe realizimet ekonomike në vendin tonë do të shkojnë kurdoherë përpara.

Duhet kuptuar mirë se çështja nuk shtrohet që Partia të merret drejtpërdrejt me problemet ekonomike. Për këto veprime drejtpërdrejt organet ekonomike dhe organet shtetërore.

Sigurisht, lufta jonë e përditshme është luftë për bukën, për pambukun, për çelikon, për pjesët e këmbimit etj., etj. Partia duhet ta ndërtojë punën e saj për edukimin e njerëzve në mënyrë të tillë që të shikojë vazhdimisht si punojnë e si sillen ata, si mobilizohen për çështje të ndryshme, si i zgjidhin problemet atje ku punojnë, si duhet të ndreqen kur gabojnë etj.

Nga të gjitha këto Partia nxjerr konkluzione, forcon organizimin e punës, edukimin e njerëzve, zhvillon me masat referate, si për moralin komunist etj. Natyrisht, kjo është një punë shumë e rëndësishme, po jo e plotë. Mos vallë duhet të kënaqemi vetëm me disa referate të kabinetit të Partisë? Kjo nuk është e mjaftueshme. Referatat do të bëhen në Parti sipas situatave dhe ngjarjeve, por duhet të gjendet edhe burimi pse na ndodhin këto fenomene dhe ku duhet të rrahë çekani ynë për mënjanimin e tyre. Njeriu i Partisë interesohet dhe du-

het të interesohet intensivisht për këto çështje. Herë pas here duhet të bëhen analiza se kush i shkel normat e moralit komunist, cilët janë ata që dënohen për gjëra të tilla, cila është prejardhja e tyre, stazhi i tyre në Parti etj. Në qoftë se stazhi në Parti i këtyre njerëzve na del se është i ri, kjo do të thotë se ne kemi futur në Parti njerëz jo të denjë, që nuk e meritojnë emrin e anëtarit të Partisë, ose njerëz që kanë gabuar padashur dhe ndaj të cilëve ne nuk kemi bërë as detyrën më të vogël për edukimin e tyre. Mund të ketë hyrë në Parti një njeri, biografia e të cilit është e pastër, por, në fakt, këtë njeri organizata-bazë për dy-tre vjet me radhë nuk e ka përgatitur, nuk e ka kalitur me një luftë intensive, me sakrifica etj., kështu që nga puna e dobët e organizatës-bazë, pas ca kohe, ky njeri nuk ecën dot më. Prandaj ne duhet të marrim masat përkatëse për edukimin e komunistëve dhe të jemi të rreptë në pranimet në Parti.

Këto çështje janë theksuar edhe herë të tjera, por më duket se sekretarët e komiteteve të Partisë nuk i marrin si duhet në duar për t'i zgjidhur. Ka edhe çështje të tjera, për të cilat ata nuk tregojnë interesimin e duhur. Të marrim si shembull kartotekat e Partisë, plotësimin e dokumenteve që janë atje, biografitë e njerëzve, për të parë zhvillimin dhe ecjen përpara të jetës së Partisë. Ata nuk kërkojnë herë pas here nga nëpunësit e kartotekës së komitetit të Partisë që të japin informacione orientuese, për të parë ndryshimet që bëjnë komunistët gjatë jetës dhe punës së tyre. Këto dokumente që ka Partia ne i duam për forcimin e Partisë dhe forcimi i Partisë nuk ka kuptim

në qoftë se këto letra do të mbeten të mbyllura në dollapët e kartotekave.

Nuk do të hyj këtu në çështjen se si jepen dënimet. Shumë herë ato jepen drejt, disa herë nuk jepen me vend. Natyrisht, gjëra të tilla ngjasin kudo, po duhen përpjekje që kurdoherë të jepen vendime të drejta. Është e vërtetë që ka edhe disa shokë me pretendime, por ka edhe çështje për të cilat ata kanë të drejtë dhe këto të drejta duhen respektuar.

Vitet e fundit janë krijuar shumë komitete partie ndërmarrjesh ose kooperativash, të cilat varen nga komitetet e Partisë të rretheve. Në krye të organizatës-bazë të çdo ndërmarrjeje zakonisht ne kemi byronë e organizatës. Në qoftë se ne krihimin e komiteteve të Partisë në disa ndërmarrje dhe kooperativa nuk e kuptojmë edhe në drejtimin që ato të interesohen si duhet për forcimin e Partisë, për ngritjen morale, ideologjike, politike të ndërgjegjes së komunistëve, për t'i ndrequr dhe për t'i shpëtuar ata që gabojnë etj., atëherë nuk kemi përse t'i ngremë të tilla komitete, të qëndrojmë më mirë me byrotë, me organizatat-bazë dhe me kryesitë e kooperativave bujqësore. E ç'na duhet ne komiteti i Partisë në një ndërmarrje, në qoftë se ai bën një punë të çalë dhe nuk merret me detyrat që i takojnë, por merret me çështjet që duhet t'i zgjidhin organet shtetërore? Mua më duket se komitetet e Partisë s'duhet të jenë hallka që të mos kryejnë si duhet detyrat. Atje ku ne krijojmë komitete partie, në ndërmarrje ose në kooperativa bujqësore, duhet të jemi të rreptë. Në qoftë se në qendra pune bëhen shkelje të ligjeve, shkelje të normave të moralit komunist etj.,

etj., atëherë me këto çështje duhet të merret komiteti i Partisë. Nga ana tjetër, këto komitete duhet të ushqehen vazhdimisht edhe nga komiteti i Partisë i rrethit, i cili është e domosdoshme t'i ndihmojë në kryerjen e detyrave të tyre.

Nga ana shtetërore ndërmarrja ose kooperativa ushqehet vazhdimisht, ajo ka planin e vet, ka detyra të caktuara për çdo sektor, për realizimin e të cilave duhet të mobilizohen të gjithë. Por me njerëzit duhet të punohet vazhdimisht nga ana politike, ideologjike, kulturore e profesionale. Mirëpo një punë e tillë nuk bëhet si duhet nga Partia. Duke filluar që nga sekretarët e gjer tek instruktorët e komitetit të Partisë, ndiqen disa forma pune, të cilat në praktikë kanë të meta. Ne preokupohemi si duhet vetëm atëherë, kur krijohen probleme shqetësuese. Ja, për shembull, në Shkodër kanë shkuar instruktorë të Komitetit Qendror, por si nuk i kanë parë këta të gjitha ato shkelje të rënda që po bëheshin dhe të sinjalizonin? Po pse ndodh një gjë e tillë? Kjo ndodh se shokët që i kemi zgjedhur dhe i kemi marrë këtu në qendër kanë qenë në krye të organeve lokale nga njerëzit më të mirë të Partisë, me një eksperiencë të gjatë, por nuk i kemi udhëzuar sa duhet dhe ata vetë nuk mendojnë thellë për punën e tyre. Kjo ne duhet të na preokupojë shumë, ta ndryshojmë këtë situatë, të perfeksionojmë metodën e punës dhe kuptimin e direktivave të Komitetit Qendror. Kemi mundësi ta bëjmë më mirë këtë punë, sepse nuk na mungojnë as njerëzit, as orientimet, as eksperiencia dhe bazën e Partisë e kemi të shëndoshë. Duhet të mendojmë mirë, se në këtë ingranazh diçka nuk na ecën. Këtë ne duhet

ta shikojmë më thellë, ta zhvillojmë, të përpiqemi t'u hapim horizont njerëzve, t'u japim disa mundësi më shumë, të mendojmë dhe t'i udhëzojmë si duhet, por edhe vetë ata të mendojnë për të pasur iniciativë në punë, natyrisht iniciativë në rrugë të drejtë. Çështja e forcimit të Partisë është hallka kryesore e punës sonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

Ç' FSHIHET PRAPA MBLEDHJES FRAKSIONISTE TË 1 MARSIT QË PO PËRGATITIN REVIZIONISTËT HRUSHOVIANË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

16 shkurt 1965

Në datën 30 nëntor 1964, KQ i PPSH mori nga KQ i PK të BS një letër që mban datën 24 nëntor 1964. Ajo është dërguar në vijim të letrës së mëparshme të KQ të PK të BS të datës 30 korrik 1964, në të cilën ai njoftonte vendimin e udhëheqjes sovjetike për të thirrur më 15 dhjetor të vitit të kaluar mbledhjen e të ashtuquajturit komision të redaktimit, të 26 partive dhe, nga mesi i këtij viti, mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Në letrën e 24 nëntorit bëhet fjalë për çështjen e shtytjes së mbledhjes së komisionit të redaktimit nga 15 dhjetori 1964 më 1 mars 1965.

KQ i PPSH në «Letrën e Hapur anëtarëve të PK të BS», botuar më 5 tetor 1964, si dhe në materiale të tjera, ka shprehur qartë qëndrimin e PPSH lidhur me projektin hrushovian për thirrjen në kushtet e sotme të një mbledhjeje ndërkombëtare të partive komuniste

e punëtores si dhe të komisionit të redaktimit të caktuar për përgatitjen e saj. Në Letrën e Hapur të PPSH thuhej se «kjo mbledhje, si nga rrethanat në të cilat po thirret, nga mënyra se si po përgatitet, ashtu edhe nga platforma politike e saj, nuk i shërben aspak çështjes së unitetit marksist-leninist. Ajo ka për qëllim të minojë unitetin, të përçajë përfundimisht lëvizjen komuniste, të konsolidojë pozitat e lëkundura të revizionizmit dhe të forcojë luftën kundër marksizëm-leninizmit, duke i bërë kështu shërbimin më të madh borgjezisë imperialiste».

PPSH ka theksuar se në kushtet e sotme, kur ekzistojnë divergjenca të thella e parimore për çështjet më jetike të teorisë e të praktikës së komunizmit midis marksistë-leninistëve e revizionistëve modernë, thirrja e mbledhjes ndërkombëtare të partive komuniste, ashtu siç e mendojnë, e organizojnë dhe e dëshirojnë revizionistët, nuk është aspak «rruga më efektive për forcimin e kompaktësisë së partive motra, për kapërcimin me sukses të vështirësive që qëndrojnë para tyre», siç thonë revizionistët, por është rruga drejt minimumit të plotë të kompaktësisë, rruga drejt përçarjes përfundimtare.

Këtë synim kishte N. Hrushovi kur projektoi mbledhjen për më 15 dhjetor, këtë synim kanë edhe udhëheqësit e sotëm sovjetikë duke e thirrur këtë mbledhje më 1 mars. Jeta tregoi se udhëheqësit e sotëm sovjetikë e hoqën Hrushovin nga postet drejtuese në parti dhe në shtet jo pse nuk ishin dakord me kursin e tij anti-marksist ideologjik e politik, por për të shpëtuar revizionizmin, për të vazhduar rrugën revizioniste hrusho-

viane, por pa Hrushovin e diskredituar e të demaskuar. Në fakt, udhëheqja e sotme sovjetike po ndjek me besnikëri e këmbëngulje vijën antimarksiste hrushoviane në të gjitha fushat e politikës së brendshme e ndërkombëtare.

Trojka hrushoviane e Brezhnjev, Mikojanit dhe e Kosiginit ngul këmbë se do t'i qëndrojë besnike deri në fund e do të zbatojë me konsekuencë kursin revizionist të kongreseve të 20-të e të 22-të të sanksionuar edhe në programin e ri të PK të BS. Ajo vazhdon të shqelmojë me përbuzje në gjithë veprimtarinë e saj deklaratat e viteve 1957 e 1960 në çështjet më themelore të tyre. Udhëheqja e sotme sovjetike po ndjek të njëjtën vijë politike të Hrushovit për afrimin e bashkëpunimin me imperializmin, sidomos me atë amerikan, duke u përpjekur të ruajë e të forcojë aleancat e krijuara me të nga Hrushovi. Duke ecur në gjurmët e N. Hrushovit, ajo vazhdon kursin e bashkimit të plotë e të bashkëpunimit të gjithanshëm me klikën e Titos, përkrah me të gjitha mjetet renegatët e tjerë të klasës punëtore e të komunizmit. Në të njëjtën kohë, udhëheqësit e sotëm sovjetikë, ashtu si dhe N. Hrushovi, mbajnë qëndrim armiqësor ndaj partive e forcave marksiste-leniniste, në mënyrë të veçantë ndaj PPSH e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Udhëheqja e sotme sovjetike ka trashëguar jo vetëm kursin e përgjithshëm ideopolitik revizionist të N. Hrushovit, por edhe metodat antimarksiste përçarëse të tij. Kjo shprehet jo vetëm në veprimtarinë diversioniste ndaj partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, por edhe në qëndrimin ndaj gjithë

lëvizjes komuniste, dhe veçanërisht në gjithë procedurën që po ndiqet lidhur me mbledhjen e 1 marsit. Gjithë mënyra se si është thirrur dhe si po përgatitet mbledhja e partive komuniste e punëtore dhe e «komisionit» të redaktimit është krejt arbitrare dhe shkel brutalisht normat e parimet e marrëdhënieve midis partive motra, të sanksionuara në Deklaratën e Moskës të vitit 1960.

Ne nuk do të ndalemi për të provuar se sa e paligjshme është jo vetëm procedura e caktimit të «komisionit», por edhe vetë mbledhja dhe programi i punimeve të tij. Këtë Partia jonë e ka demaskuar me hollësi dhe argumente qoftë në Letrën e Hapur, qoftë në artikuj apo në fjalime të udhëheqësve të saj. Ndryshimi i datës së mbledhjes të të ashtuquajturit komision redaktimi nga 15 dhjetori 1964 më 1 mars 1965 për thelbin e çështjes nuk sjell asgjë të re.

Ato që na interesojnë dhe me të cilat do të merremi në këtë artikull janë arsyet që e diktuan një shtytje të tillë dhe çfarë fshihet pas mbledhjes fraksioniste të 1 marsit.

Udhëheqja revizioniste sovjetike shtytjen e mbledhjes për më 1 mars e argumenton me «punën e madhe» që qëndron përpara të të ashtuquajturit komision, prandaj «thirrja e komisionit më 1 mars do t'u jepte mundësi të gjithëve të bënin përgatitjet e duhura». Është e qartë se kjo është një manovër për të fshehur arsyet e vërteta. Në fakt, në qoftë se fjala është për përgatitjet e atyre partive që prej kohësh janë shprehur për pjesëmarrjen në mbledhjen e komisionit, ato vetë edhe me deklaratat zyrtare kanë theksuar se afati

deri më 15 dhjetor ishte i mjaftueshëm për përgatitje, bile në formë kërcënuese shpallën më se një herë, meqë ato përbëjnë «shumicën» (!), që afati «nuk mund të shtyhet më tutje». Nëse fjala është për partitë që janë shprehur kundër kësaj mbledhjeje fraksioniste, është e qartë se atyre nuk u nevojitet asnjë afat, sepse nuk kanë përse të përgatiten.

Arsyet e vërteta të shtytjes së mbledhjes, pra, janë të tjera.

Së pari, pas rrëzimit të N. Hrushovit, që qe një disfatë e madhe për tërë kursin revizionist hrushovian, udhëheqja sovjetike kishte nevojë për një periudhë qetësie, pa polemikë e kokëçarje, në mënyrë që të konsolidonte pozitat e saj akoma krejt të paqëndrueshme, kurse thirrja e mbledhjes më 15 dhjetor do ta demaskonte atë menjëherë në sytë e tërë botës si zbatuese të vijës së falimentuar përçarëse të N. Hrushovit.

Së dyti, shtytja e mbledhjes së komisionit të redaktimit nga 15 dhjetori më 1 mars i duhej udhëheqjes së sotme sovjetike për të mashtruar komunistët e punonjësit, për të krijuar tek ata përshtypjen e rreme se gjoja ajo është për unitetin dhe bën të gjitha përpjekjet për arritjen e tij, për të fshehur kështu veprimet e veta përçarëse dhe për t'ua ngarkuar përgjegjësinë e përçarjes partive marksiste-leniniste që refuzojnë të vijnë në mbledhje, megjithëse atyre gjoja u lihet kohë e mjaftueshme dhe u krijohen të gjitha kushtet e favorshme që të përgatiten!

Së treti, udhëheqjes sovjetike i duhej njëfarë kohe për të mbyllur të çarat serioze të shkaktuara në frontin revizionist qysh përpara rrëzimit të Hrushovit nga

lufta e vendosur e partive dhe e forcave marksiste-leniniste, për të bashkuar aleatët e vet revizionistë, të cilët, me rrëzimin e N. Hrushovit, pësuan një kontuzion të rëndë dhe shfaqën shenja të theksuara pakënaqësie, pavarësie e largimi nga udhëheqja e re sovjetike. Kurse kjo e fundit ka nevojë të shkojë në mbledhje me një front revizionist kompakt e të bashkuar, të paktën në disa vija të përgjithshme themelore.

Pra, shtytja e mbledhjes të të ashtuquajturit komision ka lidhje me qëllimet që synon të arrijë me anë të kësaj mbledhjeje të paligjshme e antimarksiste grupi i udhëheqësve revizionistë sovjetikë.

Tanimë është provuar se kur N. Hrushovi ngulte këmbë për mbledhjen e 15 dhjetorit, kishte parasysh një mbledhje fraksionistësh, e cila do të merrte «masa kolektive» kundër «dogmatikëve», ose, me fjalë të tjera, do të përjashtonte nga lëvizja komuniste partitë marksiste dhe do të krijonte kësisoj një «Internacionale të verdhë» nën drejtimin absolut të tij. Por planet e N. Hrushovit ndeshën në një rezistencë të paparashikuar edhe në gjirin e vetë revizionistëve. Kjo u shpreh publikisht nga revizionistët italianë me anë të «testamentit» të P. Toliatit dhe me nuanca e forma të ndryshme edhe nga udhëheqjet revizioniste të disa partive të tjera. Gjithë revizionistët ishin dakord me N. Hrushovin për të nxitur përçarjen në gjirin e lëvizjes komuniste dhe në fakt këtë e krijuan, por shumë prej tyre këtë përçarje e kërkonin, veç të tjerave, edhe për të dobësuar pozitat e PK të BS dhe, si rrjedhim, të vendit të parë të socializmit, në mënyrë që, me anë të

shtypësi dhe armiku më i egër i gjithë popujve të Amerikës Latine, por kjo kalohet me frazën e përgjithshme «lufta e popujve të kontinentit kundër imperializmit». Nuk flitet qartë në të as për detyrat revolucionare të këtyre popujve e të partive komuniste kundër klikave reaksionare sunduese vendase dhe as për rrugën që duhet ndjekur për zgjidhjen e problemeve të mëdha politike, ekonomike e shoqërore që qëndrojnë sot para punonjësve të vendeve të Amerikës Latine. Solidariteti me Kubën kufizohet kryesisht me propagandën. Por Kuba, që lufton në mënyrë konsekuente dhëmb për dhëmb me imperializmin amerikan, nuk mbrohet me fjalë, ajo duhet mbrojtur me vepra, me aksione revolucionare efektive kundër armiqve të Kubës, kundër imperializmit amerikan e kundërrevolucionarëve kubanë, kundër qeverive reaksionare të shteteve të Amerikës Latine, që janë kthyer në vegla të imperializmit amerikan kundër Kubës. Çështja e Kubës mbrohet jo duke mbrojtur vijën revizioniste hrushoviane, por duke luftuar kundër kësaj vije, sepse, pa luftuar me konsekuencë dhe efektivisht revizionizmin hrushovian, nuk mund të luftohet me efektivitet as imperializmi amerikan. Në pjesën mbi gjendjen në lëvizjen komuniste e punëto-re ndërkombëtare në fakt përsëriten tezat e udhëheqësve sovjetikë dhe shprehet dëshira e tyre që të pushohet polemika, që, me fjalë të tjera, do të thotë që partitë marksiste-leniniste të heqin dorë nga e drejta e tyre e ligjshme për t'u përgjigjur sulmeve të revizionistëve modernë. Në komunikatë, më në fund, kërkohet që të dënohet e ashtuquajtura «veprimtari fraksioniste», me të cilën ata kuptojnë përkrahjen që u jepet par-

tive e grupeve marksiste-leniniste që janë krijuar si rrjedhim i veprimtarisë antimarksiste të revizionistëve. Pra komunikata ka riprodhuar me besnikëri idetë dhe tezat e udhëheqësve revizionistë sovjetikë.

Duhet shënuar se me qëllime djallëzore, për të shfrytëzuar për planet e tyre antimarksiste simpatinë që gëzon Kuba në popujt e komunistët e vendeve të ndryshme, këtë mbledhje revizionistët sovjetikë e organizuan në Havanë. Por pavarësisht nga manovrat djallëzore të revizionistëve, ne duam të besojmë se revolucionarët marksistë-leninistë të Kubës nuk do të bien në kurthin e revizionistëve. Ata dhe populli kuban, ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, në luftën e tyre të drejtë kundër imperializmit amerikan, nuk do të influencohen nga udhëheqësit revizionistë të vendeve të Amerikës Latine, të cilët, duke ndjekur udhëheqjen revizioniste sovjetike, janë specializuar në lëmin e demagogjisë. PPSH dhe populli shqiptar kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë me Kubën dhe do ta mbështetin atë me të gjitha forcat në luftën e drejtë kundër imperializmit amerikan.

Në Lindjen e Largme pozitrat e revizionizmit modern janë minuar nga themeli. Prandaj udhëheqja revizioniste sovjetike punën e saj atje e zhvillon në dy drejtime: nga njëra anë, duke mbajtur me shiringa e paterica klikat revizioniste, si renegatin Dange në Indi apo grupin e Sharkit e të Diksonit në Australi, dhe nga ana tjetër, duke organizuar akte diversioni në radhët e partive komuniste besnike të marksizëm-leninizmit, si në PK të Japonisë me anë të renegatëve Shiga e Suxuki, në PK të Cejlonit me anë të Keinemanit e të grupit të

tij revizionist të përjashtuar nga partia, në PK të Indonezisë me anë të trockistëve etj., etj. Jo pa qëllim kohët e fundit «misionarë» të shumtë sovjetikë kanë ndërmarrë udhëtime në Lindjen e Lartme, si në Indi, në Japoni e gjetkë. Udhëheqja sovjetike përpiqet që revizionistët e këtij rajoni të jenë të lidhur ngushtë me «dirigjentin» e tyre dhe kurdoherë të gatshëm për t'u shërbyer qëllimeve e planeve të tij antimarksiste.

Për sa u përket partive komuniste të kontinentit afrikan dhe të Lindjes së Afërt, udhëheqja sovjetike ka ndjekur rrugën e grumbullimit në Moskë të përfaqësuesve të revizionistëve të këtyre rajoneve. Haled Bagdashi, Murat Bostanxhi e të tjerë elementë si këta, që nuk kanë asnjë kredi në komunistët afrikanë e të Lindjes së Afërt, janë kurdoherë gati dhe në dispozicion të udhëheqjes revizioniste sovjetike për çdo deklaratë apo për çdo mbledhje. Dihet se N. Hrushovi, duke u imponuar partive të këtij rajoni kursin e vet oportunist e antimarksist, synonte në fakt likuidimin e këtyre partive, sepse për të rëndësi kishin vetëm disa «përfaqësues shëtitës» si Bagdashi me shokë. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë, duke dashur t'i mbajnë gjithnjë nën fre këta «përfaqësues» dhe për t'i përdorur në çdo rast për qëllimet e tyre, kohët e fundit po u kushtojnë atyre më shumë vëmendje, duke u hapur edhe «perspektiva» të reja, në mënyrë që t'u rritet pak kredia. Fjala është për një hap të ri drejt likuidimit të plotë të lëvizjes komuniste në këto vende, për shkrirjen e plotë të saj edhe organizativisht me reaksionin, si në Irak apo në Siri. Është shumë kuptimplotë fakti që Haled Bagdashi, i dëbuar nga Siria dhe me qëndrim në Moskë, i dërgoi

mesazh përsëritës gjeneralit Amin El Hafëz, Kryetarit të Këshillit Presidencial Sirian, në të cilin aprovon plotësisht kursin e tij politik dhe i shpreh atij «përkrahjen e tij dhe të gjithë komunistëve sirianë për mbrojtjen dhe zhvillimin e socializmit në Siri»! Pothuajse një përkrahje të tillë u siguruan autoriteteve irakiane edhe «udhëheqësit» e komunistëve irakianë, gjithashtu me qëndrim në Moskë. Për të rritur «prestigjin» e këtyre udhëheqësve komunistë, gjë që i nevojitet grupit drejtues sovjetik për qëllimet e veta, veçanërisht në mbledhjen e ardhshme të «komisionit», nga koha në kohë në «Pravda» botohet ndonjë informacion mbi «takimet» në KQ të PK të BS me «Nazmi Aliun e udhëheqës të tjerë të PK të Irakut», apo ndonjë artikull «de profundis» mbi «luftën heroike të komunistëve», të cilët në fakt po vuajnë pasojat e këshillave likuidatorë të vetë revizionistëve hrushovianë.

Për udhëheqjen e sotme sovjetike problemi më shqetësues është «shporta e karavidheve», revizionistët evropianë, të cilët, më pak se revizionistët e tjerë, janë të predispozuar të tërhiqen prej hunde. Këta jo vetëm kërkojnë të jenë vetë sa më të pavarur e më të lirë nga çdo «komandë unike», por bile përpiqen të kenë zonat e tyre të influencës në lëvizjen komuniste. Në «testamentin» e tij Toliati e shtronte hapur problemin e krijimit të disa qendrave «drejtimi politik, ideologjik e veprimi» në botën kapitaliste dhe, sipas tij, këto qendra duhet të jenë PK Italiane, PK Franceze dhe ajo Spanjolle. Pas rrëzimit të N. Hrushovit këto tendenca të revizionistëve evropianë janë forcuar akoma më shumë.

Për t'i frenuar këta sa të jetë e mundur më shumë:

dhe eventualisht për t'i afruar pas vetes, udhëheqja sovjetike po manovron gjerësisht. Me udhëheqësit e partive të vendeve ish-socialiste të Evropës kohët e fundit u shtuan kontaktet legale dhe të fshehta. Në Moskë po thërriten njëri pas tjetrit përfaqësues të ndryshëm të partive evropiane. S'ka shumë kohë që atje shkoi një delegacion i PK të Francës. Po kështu, me udhëheqësit sovjetikë zhvilluan bisedime përfaqësuesit e PK të Anglisë, udhëheqja revizioniste e së cilës, siç duket nga një deklaratë e fundit zyrtare, përpiqet të largohet nga kombinacionet e revizionistëve hrushovianë lidhur me mbledhjen e ardhshme.

Nga ana tjetër, me revizionistët italianë, të cilët janë aktivizuar shumë për të zgjeruar sferën e «influençës» së tyre në partitë komuniste e punëtore të Evropës, duke përdorur për këtë qëllim edhe veprimtarinë minuese, siç bëjnë, për shembull, në radhët e PK Franceze udhëheqja revizioniste sovjetike përdor një taktikë të veçantë: kryesisht taktikën e përkrahjes së ideve revizioniste të udhëheqjes italiane, qofshin këto edhe ultrarevizioniste si ato të G. Amendolës, i cili po bën një propagandë të ethshme për bashkimin e PK Italiane me partitë socialiste dhe socialdemokrate, me qëllim që të krijohet gjoja «një parti e vetme e klasës punëtore italiane». Me këtë përkrahje udhëheqja sovjetike, nga njëra anë, synon të neutralizojë revizionistët italianë për të mos i pasur kundërshtarë kërcënues për hegjemoninë sovjetike në përgjithësi dhe për influencën e tyre në Amerikën Latine në veçanti; nga ana tjetër, ajo synon t'i përdorë italianët si mjet shantazhi kundër partive të tjera evropiane në mbledhjen e 1 marsit.

Me këto përgatitje e kombinacione udhëheqja revizioniste sovjetike mendon se do të grumbullojë gjithë revizionistët rreth platformës së saj antimarksiste dhe t'u imponojë atyre hegjemoninë e saj. Por revizionistët sovjetikë synojnë të përdorin edhe një manovër tjetër, që duket qartë nga letra e tyre e 24 nëntorit 1964. Ata mendojnë që «komisioni», në mënyrë të heshtur, të marrë formën e njëfarë organi të centralizuar, e një forumi gati të përhershëm të lëvizjes komuniste, të cilit t'i veshin gjoja funksionet e ruajtjes së unitetit të lëvizjes. Në letrën e 24 nëntorit 1964 thuhet se komisioni do të mbledhet «disa herë», atij i njihet e drejta «të konsultohet me të gjitha partitë motra» etj. Është e qartë se një organ i tillë i centralizuar, një «Internacionale e tillë e verdhë», i duhet udhëheqjes sovjetike, së pari, për të ushtruar drejtimin faktik të saj në lëvizje, në mënyrë që, me anë të tij, t'u diktojë vullnetin dhe vijën e saj të gjitha partive të tjera, si vullnet e vijë gjoja të mbarë lëvizjes komuniste; së dyti, për të maskuar me anë të këtij «forumi» luftën e saj kundër marksizëm-leninizmit dhe për përçarjen e mëtejshme të lëvizjes komuniste; së treti, për të mos dhënë llogari vetë në bisedime e takime dypalëshe lidhur me gjithë veprimtarinë e saj antimarksiste ndaj partive e vendeve vëllezër, po për këto çështje të përgjigjet «komisioni».

Loja që kërkon të bëjë udhëheqja e sotme sovjetike me të ashtuquajturën mbledhje të «komisionit» nuk mund t'i mashtrojë marksistë-leninistët. Jo vetëm kaq, por edhe në gjirin e vetë revizionistëve ajo ka ngjallur dyshime dhe frikë. Agjencitë e ndryshme të lajmeve,

ndër to edhe korrespondenti i «Borbës», njoftuan para disa ditësh se ekziston një mundësi që mbledhja e ardhshme të quhet jo më mbledhje e «komisionit», por «mbledhje konsultimi e partive të interesuara». Veç kësaj, herë pas here qarkullon mendimi se mbledhja e 1 marsit mund të mos bëhet fare. Sido që të ndodhë, bëhet mbledhja nën emrin e «komisionit» ose me emër tjetër, apo nuk bëhet fare, në të gjitha rastet revizionizmi hrushovian do të pësojë një disfatë të pandreqshme, e cila do të shpejtojë shpartallimin përfundimtar të kësaj sëmundjeje të rrezikshme në gjirin e lëvizjes komuniste.

Grupin udhëheqës të revizionistëve sovjetikë dhe gjithë pasuesit e tyre, që qëndrojnë me këmbëngulje në të njëjtat pozita të N. Hrushovit, që ndjekin hrushovizmin dhe vijën përçarëse hrushoviane, i pret po ai fati i shefit të tyre të palavdishëm. Ky është fati i tradhtarëve. Asnjë lojë, asnjë manovër, asnjë demagogji nuk do t'i shpëtojë dot renegatët e marksizmit nga shpartallimi i tyre përfundimtar.

Prandaj PPSH mendon se shokët komunistë të Bashkimit Sovjetik, gjithë bashkëluftëtarët e çështjes së madhe të socializmit e të komunizmit, do të forcojnë luftën e përbashkët kundër tradhtarëve hrushovianë. Tanimë të gjithë po e shohin se, si rrjedhim i veprimtarisë armiqtësore të udhëheqjes hrushoviane, u shkaktua përçarja e madhe e lëvizjes komuniste; u degjenerua partia e madhe e Leninit dhe po ndiqet kursi i likuidimit të saj; u krijuan anarkia dhe konfuzioni në ekonominë sovjetike dhe po rrezikohet vetë sistemi so-

vjetik socialist; u minua uniteti i vendeve të kampit socialist dhe grupi renegat i hrushovianëve po përpiqet të komprometojë rëndë socializmin në Evropë, duke i bërë koncesione ideologjike, politike dhe ekonomike imperializmit botëror, veçanërisht atij amerikan, në dëm të socializmit. Koha vërtetoi plotësisht se iluzionet që revizionistët hrushovianë përhapën për «arsyen e shëndoshë» e «dëshirat paqësore» të Kenedit apo të Xhonsanit, kishin për qëllim të justifikonin afrimin e revizionistëve me imperializmin, nënshtrimin e revizionistëve interesave të imperializmit amerikan. Për çdo njeri të ndershëm u provua se «bashkekzistenca paqësore» hrushoviane ishte një bluf, se ajo iu desh revizionistëve për të maskuar lëshimet e paparim dhe kapitullimin ndaj kërcënimeve të imperializmit, se duke përfituar nga kjo politikë oportuniste imperialistët dhe reaksioni u inkurajuan në veprimet e tyre agresive kundër popujve, kundër socializmit. Të gjithë po e shohin se sa mashtruese dhe e rrezikshme ishte politika revizioniste e të ashtuquajturit çarmatim ose e «botës pa armë», sepse në fakt imperializmi po armatohet përditë e më shumë, ai po pajis me armë bërthamore edhe aleatët e tij duke kërcënuar drejtpërdrejt, si dhe me anë të revanshistëve të Bonit, pavarësinë dhe ekzistencën e Republikës Demokratike Gjermane.

Ngjarjet në botë, agresioni imperialist kundër Kubës, lufta në Kongo apo në Laos e në Vietnamin e Jugut, dhe sidomos agresioni i tanishëm kundër RD të Vietnamit e planet kërcënuese e revanshiste kundër RD Gjermane, provojnë për çdo njeri, sadopak që ai të me-

rret me politikë, se gjithë politika e jashtme e revizionistëve hrushovianë është një politikë armiqësore. Prandaj çdo komunist e revolucionar i vërtetë nuk mund të mos nxjerrë konkluzionin e vetëm të drejtë, atë të nevojës së luftës së vendosur kundër revizionizmit, atë të demaskimit të çdo manovre mashtruese të revizionistëve modernë.

Njihet tanimë taktika demagogjike e revizionistëve. Sa herë që gjenden në pozita të vështira, sa herë që gjenden para demaskimit, ata përpiqen të maskojnë tradhtinë e tyre, fytyrën e tyre të vërtetë, me qëndrime e fraza demagogjike, krejt formale. Të gjithëve u kujtohen fjalët e bukura, bombastike dhe «kërcënuese» që nga koha në kohë thoshte N. Hrushovi kundër imperializmit, të cilin «do ta fuste në varr» etj., etj. Por ç'doli nga këto fjalë? Gjithë bota e pa që veç zhurmës demagogjike asgjë nuk mbeti prej tyre. Të njëjtin fat do të kenë edhe fjalët e qëndrimet demagogjike të kohëve të fundit të pasardhësve të Hrushovit, të cilët, të frikësuar nga komunistët e popujt, po përpiqen të mbulojnë tradhtinë e tyre me qëndrime e fraza formale. Revizionistëve nuk u duhet besuar, sepse jeta e ka provuar, dhe përsëri do ta provojë, se ata janë agjenturë e imperializmit botëror.

Në këto momente ne mendojmë se para gjithë shokëve komunistë dhe revolucionarë, çështja shtrohet kështu: ka ardhur koha që secili të marrë përgjegjësitë që i takojnë në luftën kundër renegatëve të marksizëm-leninizmit, kundër hrushovianëve dhe pasuesve të tyre. Ka ardhur koha që edhe shokët që kanë gabuar t'i ha-

pin sytë, të shohin qartë se drejt ç'gremine të tmerrshme po shkojnë duke ndjekur verbërisht udhëheqësit revizionistë; ka ardhur koha që ata të shpëtojnë nderin e tyre, socializmin dhe komunizmin.

Lufta kundër revizionizmit hrushovian, si dhe kundër revizionizmit modern në tërësi, mbetet një ndër detyrat themelore më aktuale e më të rëndësishme të çdo partie me të vërtetë revolucionare të klasës punëtore, të marksistë-leninistëve në mbarë botën. Kjo luftë duhet vazhduar deri në fund, nuk duhen lejuar udhëheqësit e sotëm revizionistë hrushovianë sovjetikë që, me manovra të ndryshme e demagogji, të sigurojnë një periudhë qetësie e heshtjeje, e cila u duhet atyre për të konsoliduar pozitat e veta të lëkundura dhe për të gjetur një rrugëdalje nga gjendja e vështirë që është krijuar për ta me falimentimin e N. Hrushovit e të politikës së tij.

PPSH, në shumë materiale e dokumente të saj, siç domos në fjalimin e mbajtur më 28 Nëntor 1964, me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, ka shprehur në mënyrë të qartë qëndrimin e vet lidhur me kushtet që duhen krijuar dhe rrugët që duhen ndjekur për rivendosjen e unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste, si dhe për organizimin e një mbledhjeje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, e cila t'i shërbejë me të vërtetë çështjes së unitetit. Marksistë-leninistët e kanë deklaruar dhe e deklarojnë hapur se kurrfarë uniteti me revizionistët hrushovianë e mbi bazën e hrushovizmit nuk mund të ketë. Uniteti i vërtetë mund dhe duhet të krijohet pa revizionistët dhe kundër

revizionistëve, në luftë parimore të papajtueshme me revizionizmin modern në të gjitha format e nuancat e tij, mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 39 (5135), 16 shkurt 1965

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 201. Tiranë, 1965

REALIZIMI I PLANIT KËRKON DITURI, ORGANIZIM, PUNË SISTEMATIKE

Fjala në Plenumin e 14-të të KQ të PPSH

18 shkurt 1965

Shokë,

Në raport dhe në diskutimet e shokëve u prekën shumë probleme me rëndësi të planit tonë për vitin 1965, u shtruan për ne detyra të mëdha dhe të rënda që duhet medoemos t'i kryejmë me kujdes, pse nga ato varet realizimi i plotë i planit të sivjetshëm si dhe realizimi i shifrave dhe i përqindjeve të caktuara për t'u realizuar si pesëvjeçar.

Realizimi me sukses i planit të këtij viti merr një rëndësi të veçantë për arsyet e njohura ekonomike të zhvillimit të vendit dhe të mirëqenies së popullit, por gjithashtu merr rëndësi nga fakti që ne do të paraqitemi përpara Partisë dhe popullit në Kongresin e 5-të. Kongresi ynë i 5-të duhet të jetë një Kongres i madh historik, politiko-ideologjik dhe ekonomik. Ky Kongres do të ketë rëndësi jo vetëm për brenda vendit, por edhe për jashtë, për arsye se do të tregojë në të gjitha aspektet dhe drejtimet frymën e drejtësisë së mendimit dhe të

veprimit të Partisë sonë, si në çështjet e brendshme ashtu edhe në problemet ndërkombëtare, si në çështjet ekonomike, politike dhe kulturore, ashtu edhe në çështjet ideologjike në arenën e lëvizjes komuniste botërore, në mbrojtjen me konsekuencë e me sukses të pastërtisë së marksizëm-leninizmit, në luftë të ashpër dhe të përkulur kundër revizionizmit modern.

Prandaj që ne të kemi sukses të plotë kudo, kjo varet nga përpjekjet e Partisë dhe të popullit, varet nga kujdesi i veçantë dhe nga mobilizimi i madh, varet nga shkalla e këmbënguljes sonë dhe e metodës së organizimit të punës. Ne do t'i mobilizojmë të gjitha forcat tona fizike dhe mendore, do t'i mobilizojmë të gjitha energjitë për t'i kryer me nder detyrat tona kombëtare dhe ndërkombëtare. Pra në punën tonë, çdo ditë e çdo orë, t'i kemi kurdoherë parasysh këto detyra, këto qëllime.

Megjithëse çështjet që do të shtroj më poshtë nuk janë të panjohura për ne dhe as të veçanta nga ato që shtroi raporti, dhe për të cilat shokët diskutuan, dëshiroj të ritheksoj disa prej tyre.

1. — Mbi investimet, ndërtimet e veprave dhe futjen e tyre sa më parë në shfrytëzim

Investimet në ekonominë tonë popullore kanë qenë dhe janë të mëdha, janë çështje kryesore, vendimtare në fatet e popullit, prandaj duhet t'u kushtojmë vëmendjen dhe kujdesin më të madh. Një gabim i vogël, një vendim i pamatur, i pastudiuar thellë mund të

na kushtojë me qindra milionë lekë në ekonominë tonë kombëtare dhe t'i rëndojë popullit. Investimet në tërësi, qofshin këto nacionale apo lokale, nuk janë konsideruar dhe nuk duhet pra të konsiderohen vetëm si çështje të veçanta, të udhëheqjes kryesore të Partisë dhe të pushtetit, të Komisionit të Planit të Shtetit ose të grupeve të ndryshme të specialistëve, të ngarkuara për të studiuar veçanërisht natyrën dhe masën e investimeve, por janë probleme ekonomiko-financiare që u përkasin gjithë Partisë, organeve të pushtetit, ndërmarrjeve ekonomike dhe kooperativave bujqësore, gjithë popullit. Këto probleme, natyrisht, janë probleme të mëdha politike. Në përgjithësi investimet tona kanë qenë të drejta, të nevojshme, të domosdoshme dhe jo vetëm e kanë zhvilluar më tej prodhimin dhe forcat prodhuese, por kanë qenë në përgjithësi me leverdi ekonomike.

Por gjatë zbatimit të këtyre investimeve konstatojmë se në sektorë të ndryshëm ne investojmë, pa e humbur më të shumtën e herës karakterin e drejtë të investimit, gjëra jo të studiuara mirë, jo vetëm nga ana thjesht teknike e veprës, por edhe nga ana e mundësive imediate materiale. Ne konstatojmë disa herë teprime të panevojshme, dëshira të porealizueshme ose të realizueshme me kosto të lartë dhe me një efekt ekonomik të ngadalshëm, duke u prirë disa herë nga dëshira dhe efektet e mira politike, por pa i llogaritur mirë anët ekonomiko-financiare të investimit. Disa herë edhe në planifikim nuk shikojmë si duhet në objekte të veçanta prioritetin e investimit në njërin a në tjetrin objekt. Nga këto të meta serioze me efekte ekonomike,

ne kemi ndonjë fabrikë që jo vetëm na ka dalë me kosto të lartë, por ekonomikisht bëhet i vështirë shfrytëzimi, pse na shkakton humbje ekonomike në materialet deficitare ku ajo do të përdoret. Kështu kemi investuar shuma të mëdha për ndërtimin e disa veprave ujore në malësi, por efektin ekonomik që ne llogaritim nuk e kemi arritur, pse ato vepra po zvarriten me vite të tëra dhe kanë dalë vështirësi të paparashikuara, të cilat nxjerrin punë mbi punë. Nga këto të meta që përmenda në përgjithësi, ne hasim vështirësi, ku më shumë e ku më pak, në objektet e ndryshme ku investojmë dhe po t'i llogaritim këto, dalin me qindra milionë lekë, të cilët mund të përdoren dhe duhet të përdoren më me nikoqirllëk. Kam besim se do t'i eliminojmë këto dobësi, që ekzistojnë akoma, pse me kënaqësi mund të konstatojmë se në të kaluarën, kur na mungonte eksperiencia, na mungonin kuadrat e kualifikuar, ne kishim më shumë të meta, të cilat gradualisht, me fitimin e eksperiencës dhe duke u mësuar nga gabimet, po i eliminojmë. Unë mendoj gjithashtu se për të metat e kësaj natyre, kemi përgjegjësi më të madhe që nga ne, anëtarët e Byrosë Politike dhe të Qeverisë, deri te shokët e Komisionit të Planit të Shtetit dhe grupet kryesore të specialistëve që bashkëpunojnë dhe konkretizojnë direktivat e Kongresit e të Komitetit Qendror. Por nuk duhet aspak t'u hiqet dhe përgjegjësia bazës, organizatave të Partisë dhe organeve të pushtetit në rreth, si dhe specialistëve që ata kanë në dispozicion dhe që çdo vit u shtohen edhe si numër edhe si kapacitet teknik. Prandaj t'i matim kurdoherë drejt dëshirat dhe mundësitë,

anën politike dhe atë ekonomiko-financiare. Të mbëshetemi kryesisht në mundësitë e brendshme, të përpiqemi t'i shtojmë këto dhe kryesisht mbi këto t'i bëjmë planet tona ose të kërkojmë shtesa plani, përmirësime, por jo jashtë mundësive tona. Ne kemi marrë vendime dhe masa për t'i forcuar në rrethe organet e pushtetit me kuadro specialistë dhe duhet kurdoherë të gjejmë formën dhe mënyrën më të përshtatshme që kuadrot drejtues dhe planifikues të ministrive, të ndërmarrjeve ekonomike të qytetit dhe të fshatit, të komiteteve ekzekutive të rretheve dhe të Partisë kudo të njihen me realitetin objektiv jo vetëm të dikasterit, të ndërmarrjes ose të rrethit të tyre, por të të gjithë vendit, të mundësive tona si Republikë, që kështu të mos bëjnë ose të kërkojnë të bëjnë kështjella mbi rërë. Një njohje të tillë objektive nacionale edhe tani kanë mundësi ta bëjnë, por edhe tendenca të mos shohin më larg nga shtëpia e tyre do t'i bëjë kuadrot tanë të kuptojnë më mirë sa i rëndësishëm është për ta realizimi i detyrës si ministri, ndërmarrje, rreth etj.

Kur vjen puna për zbatimin në jetë të investimeve, të ndërtimit të veprave të shumëllojshme të mëdha e të vogla, të vënies së tyre në shfrytëzim në kohën e caktuar dhe të shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve të tyre, të përdorimit të fabrikave e të mjeteve të punës me kujdes e me nikoqirllëk, këtu kemi shumë për të thënë dhe për të bërë. Në këtë drejtim, siç kemi suksese, kemi edhe të meta serioze. Sukseset janë të mëdha, por të metat dhe gabimet janë të hidhura. Prandaj

kundër këtyre duhet të flasim dhe të luftojmë për t'i zhdukur, pse kjo do të bëjë të shtohen edhe më shumë sukseset tona.

Që në projektimin e veprave, në zbatimin e tyre, na dalin mjaft vështirësi, vërtetohen të meta dhe gabime që e rëndojnë financiarisht veprën, zgjatin afatin e mbarimit të saj dhe pengojnë futjen në shfrytëzim në kohën e caktuar. Ky është bërë si rregull i përgjithshëm deri tani te ne. Janë fare të pakta ato vepra që na kanë kushtuar me koston e parashikuar ose më pak. Prandaj këtë «rregull» që ka filluar të na bëhet një jetë e dytë duhet ta prishim se na dëmton shumë. Ka arsye objektive dhe subjektive, këtë e dimë të gjithë dhe nuk është aspak çështja se këto nuk i kapërcejmë shumë herë me sukses dhe me heroizëm. Kjo është e padiskutueshme, por jo e mjaftueshme dhe jo e tëra. Ka rëndësi vendimtare të bëhet që në fillim një punë teknike e pastër dhe e kujdesshme. Dihet se gjatë ndërtimit do të hasim vështirësi, do të na duhet disa herë të ndryshojmë pjesërisht edhe ndonjë projekt, por fillimi i mirë i një pune dhe zbatimi i vazhdueshëm i një organizimi të shëndoshë, i cili të ketë parasysh zëvendësimin e kohës së humbur, që lyp ndryshimi i nevojshëm i projektit, në mënyrë që të ketë parasysh uljen e mëtejshme të koston që u shkaktua nga ndryshimi që iu bë veprës, do të bëjë që ajo të ndërtohet dhe të kushtojë sipas projektit dhe të vihet në shfrytëzim në kohën e caktuar. Por në të shumtat e rasteve, po u ndesh në gabime, po u has pengesa, për një arsye ose për një tjetër, atëherë afati automatikisht shtyhet, kostoja ngrihet etj. Gabimet pagu-

hen, thotë një fjalë e popullit, prandaj Partia na mëson të bëjmë më pak gabime dhe të mobilizohemi më mirë, që ato të na kushtojnë sa më pak. Në këtë çështje, shokë sekretarë të Partisë, duhet të kuptojmë mirë se rol vendimtar luajnë zanati, teknika, por rol vendimtar luajnë dhe ndërgjegjja e njerëzve, puna politike dhe ideologjike me ta, një punë politike dhe ideologjike jo shkel e shko, e sipërfaqshme, shabllone, por e lidhur ngushtë me punën, me zanatin, pse puna dhe zanati kanë politikën dhe ideologjinë e tyre; e meta dhe sukcesi në punë, në zanat, në zbatimin e teknikës, mirë apo keq, kanë si rrjedhim konkluzionet e tyre politike dhe ideologjike. Partia duhet të rrojë vazhdimisht me njerëzit, që t'i kuptojë dhe t'i ndihmojë si duhet ata. Ne udhëheqësit kemi një detyrë të madhe, të vrasim mendjen, të mos na zërë gjumi, të përgatitemi shumë kur shkojmë në bazë dhe të qëndrojmë e të mësojmë organizatën si të punojë, si të veprojë, si t'i zgjidhë çështjet. Ne do të mësojmë shumë nga njerëzit e Partisë në bazë, por edhe t'u çojmë atyre sintezën e eksperiencës së Partisë. Duhet të njohim më shumë pse këtë punë nuk e bëjmë si duhet; puna që ne duhet të kryejmë nuk është e lehtë dhe ajo që bëjmë dhe si e bëjmë është e pamjaftueshme.

A është e arsyeshme që ndërmarrjet e ndërtimit, komitetet ekzekutive dhe ministritë përkatëse, pasi mbaron e tërë vepra, si pa gjë të keq mbyllin sytë «për gjëra të vogla» që mungojnë, por që prishin punë, lënë veprën pa e mbaruar krejt ose e zvarritin afatin e dorëzimit një muaj, dy muaj, nganjëherë deri edhe një vit? Shumë vepra që duhet të kishin mbaruar qysh

më 29 Nëntor të vitit të kaluar, për vogëlsira, akoma s'po vihen në shfrytëzim.

Shteti ka harxhuar me miliarda për kanale kulluese e tharje kënetash. Për këto kanale që janë një pasuri kolosale, a ka kujdes të veçantë për mirëmbajtjen e tyre, që ato të mos mbushen? Jo, interesimi i organeve të Partisë dhe të pushtetit në bazë nuk është ai që duhet të jetë. Kanalet e mëdha ka për detyrë t'i bëjë shteti, të voglat kooperativa. E pse të ekzistojë kjo ndarje formale, sikur kanalet, si të mëdhatë ose edhe të voglat, nuk i shërbejnë fshatarësisë kooperativiste? Edhe për kanalet ujitëse interesimi është i pamjaftueshëm. Shokë, në rast se ne nuk ndërrojmë metodën e punës dhe kuptimin e drejtë politiko-ekonomik mbi bonifikimin e tokave, ka rrezik që një mëngjes të ndodhemi me kanale të mbushura dhe si pasojë do të na duhet përsëri të harxhojmë miliarda për t'i hapur edhe një herë.

Natyrisht, unë e kuptoj se ne nuk kemi aq forca krahu që të thellojmë kanalet e mëdha, këto duhet t'i bëjmë me mekanizma, megjithëse duhet pasur parasysh se mekanizmat tanë janë të kufizuar, por unë dua të theksoj se puna e fshatarësisë nuk mund të ndihmojë, kur balta në kanal vete deri në gju, por po të hiqet kjo rregullisht çdo vit, atëherë është e mundur që ta pastrojë fshatari dhe kështu do t'ia dijë vlerën kësaj pune. Është e domosdoshme që Partia, pas këtyre investimeve kaq të mëdha në fusha, të ngrejë peshë gjithë fshatarësinë në mënyrë masive, ta kualifikojë dhe ta bëjë të kujdesshme për shfrytëzimin total

të mundësive që iu krijuan dhe do t'i krijohen bujqësisë.

Ndryshime të mëdha janë bërë në fshat dhe në mentalitetin e fshatarit tonë, por të mos na gënjejë mendja se çdo gjë u arrit. Në të vërtetë shumë gjëra janë arritur me zotësi dhe me entuziazëm mobilizues. Por tashti duhet që këtë entuziazëm ta ruajmë dhe ta zhvillojmë duke e shoqëruar me organizim më të mirë dhe me teknikë më të lartë. Shokët drejtues të rretheve duhet të studiojnë vendimet që janë marrë kur kanë filluar punimet në bonifikimet e ndryshme të fushave tona. Atje ata do të gjejnë jo vetëm shifrat e investuara, por edhe të dhëna të tjera orientuese të amortizimit të këtyre investimeve. Kjo ka rëndësi të madhe dhe jo të shkohet me mendimin «ku rafsha mos u vrafsha», se «puna u krye, fusha u bonifikua, pra amortizimi le të bëhet kur të bëhet». Detyrat e marra për një periudhë të caktuar, pak a shumë të gjatë, duhet të kihet parasysh dhe të kryhen jo vetëm në bujqësi, por kudo, pse investime të mëdha s'kemi bërë vetëm në bujqësi.

Të marrim, për shembull, naftën. Edhe në këtë sektor shumë të rëndësishëm ne bëjmë investime të mëdha dhe me leverdi ekonomike. Punonjësit e naftës punojnë mirë dhe gjeologët i kanë hapur këtij sektori perspektiva në gjetjen dhe në zgjerimin e fushave të reja naftëmbajtëse.

Rëndësia e lëndëve djegëse në përgjithësi dhe ajo e naftës dhe e derivateve të saj është një problem preokupues, gjithnjë në rritje për ekonominë tonë, që duhet ta përballojmë. Përveç çështjes së kursimit të karbu-

ranteve nga entet kryesore që e përdorin, vihet detyrë dhe në radhë të parë Ministrisë së Minierave, jo vetëm të qëndrojë vazhdimisht në mënyrë të kulturuar dhe shkencore në krye të këtij sektori jetik, siç është industria e naftës, jo vetëm të zbulojë dhe të zgjerojë fushat naftëmbajtëse, por të ketë kujdes të veçantë që naftëtarët dhe drejtorët e ndërmarrjeve të mos ndizen nga entuziazmi, të lënë pas dore fushat e vjetra, pusët e vjetra të naftës dhe të jepen pas fushave dhe puseve të reja me rrjedhje më të madhe. Ne jemi akoma të detyruar në këto kushte të shfrytëzojmë edhe pusët me debite të vogla, pavarësisht se nuk janë edhe aq ekonomike, por s'ke ç'bën. Naftëtarët duhet të kenë kurdoherë parasysh që sondat dhe të gjitha mjetet e tjera të shfrytëzohen plotësisht, me efekt të plotë, pse në këtë drejtim kemi mjaft të meta, mjaft lëshime. Tani që po na hapen perspektiva për të zgjeruar fushat, neve na mbeten dy rrugë, që të dyja duhet të ndiqen: ajo e shfrytëzimit total dhe me sa më pak defekte dhe avari të sondave ekzistuese dhe sjellja e sondave të tjera plotësuese. Por si me një rrugë, ashtu dhe me tjetrën, detyra e parë qëndron e patundur: mirëmbajtja e sondave, shfrytëzimi maksimal i tyre, riparimi me kohë dhe mirë e kualifikimi kurdoherë i kuadrove të këtij sektori në veçanti dhe të të gjithë punonjësve të industrisë mekanike dhe kimike të naftës.

Rëndësi të madhe vendimtare për ekonominë tonë kanë ndërtimi dhe përfundimi në kohën e caktuar i objekteve industriale të këtij viti. Dhe këto s'janë as të pakta, as të lehta, megjithatë forcat janë matur që këto

të kryhen dhe do të kryhen, veçse duhet mobilizim total i të gjithë punonjësve të sektorit dhe i të gjitha ndërmarrjeve që kanë lidhje me këtë sektor, duhen organizim i fortë, disiplinë dhe rregull në punë, duhet një punë e gjallë revolucionare, e efektshme dhe mobilizuese e Partisë në këta sektorë dhe në rrethe ose qytete ku ndërtohen objektet. Puna e sivjetshme në këtë sektor nuk lejon që punën e sotme ta lëmë për nesër, nuk lejon zvarritje dhe burokratizëm në caktimin, në dërgimin e materialeve, ose në zgjidhjen e mjaft problemeve objektive që mund të lindin. Ministria e Ndërtimit kurdoherë duhet të ruajë përparësi në furnizim për ndërtimin dhe mbarimin e objekteve me karakter ekonomik, që këto të hyjnë në shfrytëzim menjëherë. Mund të bëjmë edhe pa muret rrethuese, edhe pa rrugë, pa godinat e administratës ose objekte të tjera të këtij lloji, por fabrikat duhet të ndërtohen në kohë.

E gjithë Partia, të gjithë ne, të gjithë ju, sekretarë të komiteteve të Partisë dhe kryetarë të komiteteve ekzekutive të rretheve, jemi të angazhuar për këtë. Dëshiroj, me këtë rast, të theksoj edhe një herë përgjegjësinë e madhe që kanë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive mbi ndërmarrjet nacionale që ushtrojnë vepërimtarinë në rrethin e tyre. Më duket se shokët e rretheve nuk e ndiejnë si duhet këtë përgjegjësi, por sikur i shmangen, duke varë duart, pse ato janë të lidhura për të gjitha, përveç punës së Partisë, me ministrinë nga të cilat varen. Kjo s'është aspak e drejtë. Pa interesimin, pa ndihmën, pa kontrollin e bazës, ministria s'ka ç'bën ose do ta bëjë punën jo si duhet.

Natyrisht, ju, shokë të rretheve, duhet të kuptoni

se puna juaj bëhet më e lehtë kur ministria është në këmbë dhe ndihmon, por ndihma juaj nuk mund të konsiderohet e kënaqshme, duke vajtur vetëm për të parë, ose për t'i bërë ndonjë telegram Komitetit Qendror. Jo, ju duhet të ndërhyjni direkt, të insistoni, të kërkoni nga ministria, nga ndërmarrja, që të plotësohen nevojat, angazhimet, detyrat. Autoriteti i vërtetë i Partisë dhe i pushtetit në bazë duhet të manifestohet kudo, në të gjitha kompetencat e tyre.

Çështjes së bujqësisë, problemeve të shumta të saj, duhet t'u kushtojmë vëmendjen dhe kujdesin më të madh. Të mobilizohemi totalisht për këtë problem jetik dhe të komplikuar, ku ndërhyjnë shumë faktorë, siç janë ata të natyrës si dhe disa të tjerë në zhvillim, që lypin punë politiko-ideologjike, kulturë, dituri, organizim, punë sistematike, të pandërprerë, që kanë karakter të theksuar subjektiv. Vitin që kaloi ne e konsiderojmë një vit të mirë bujqësor dhe kjo i detyrohet një pune më të mirë, më të kujdesshme, më të organizuar, si nga kooperativistët, ashtu edhe nga Partia, komitetet ekzekutive dhe Ministria e Bujqësisë. Ne i përgëzojmë punonjësit e bujqësisë, dhe jemi të bindur se sukseset e vjetshme do të shërbejnë si nxitje dhe mësim për sivjet për të përmirësuar më tej punën, për vërtetimin e më pak gabimeve dhe për realizimin e tejkalimin e planeve në bujqësi, në të gjitha drejtimet. Këtë vit planin e kemi të ngjeshur, prandaj edhe përpjekjet tona duhet të jenë më të mëdha. Në këtë Plenum u caktuan edhe detyra për bujqësinë dhe për blegtorinë dhe shokët diskutuan rreth këtyre detyrave. Rëndësi të madhe ka që ne të organizojmë mirë zbatimin e tyre dhe të mobili-

zojmë totalisht forcat e Partisë, të pushtetit, të fshatarësisë, të specialistëve të bujqësisë.

Nuk do të zgjatem mbi detyrat e shumta që kemi në bujqësi, por do të prek një çështje me karakter politik, që ka të bëjë me hyrjen e fshatarësisë sonë në kooperativat bujqësore.

Dihen orientimet e Komitetit Qendror në lidhje me zgjerimin e kolektivizimit të fshatrave malore që kanë mbetur pa u kolektivizuar. Vija e Partisë në këtë fushë është e matur, e arsyeshme, e drejtë dhe ka qenë e pandryshueshme dhe kurdoherë kjo vijë është theksuar, si në aktive bujqësore, ashtu dhe në mbledhje të veçanta me kuadrot udhëheqës të Partisë e të pushtetit në rrethe. Në këtë kuadër është vënë theksi edhe te kujdesi që duhet treguar për rrethet e Veriut, që të mos nxitin tash për tash krijimin e kooperativave në malësi, pse s'janë kushtet; është theksuar se atje ku ka kooperativa të përpiqemi me një punë bindëse të bëhen anëtarë të saj ata që kanë qëndruar jashtë.

Ju jeni gjithashtu në dijeni për orientimet që ka dhënë Komiteti Qendror në lidhje me organizimin, me bindje dhe kurdoherë me bindje, të kolektivave blegtoralë, atje ku s'ka kooperativa, dhe për këtë gjë janë dhënë udhëzime të qarta, janë studiuar dhe janë propozuar forma të ndryshme. Ky orientim është i matur, i arsyeshëm, i drejtë.

Po ç'ndodhi në Pukë? Atje sekretari i parë punoi me shumë nxitim, me papjekuri, me metoda të palejueshme administrative për të futur fshatarët e malësisë në kooperativë. Për një veprim të tillë nuk ishin

pjekur akoma jo vetëm kushtet ekonomike, por s'ishte bërë as kryesorja, puna politike, për të krijuar terrenin e përshtatshëm. Kjo krijoi një situatë të rëndë politike në ato fshatra, elementë armiq u aktivizuan, komunistët në këto organizata partie filluan të përçaheshin, fshati po ashtu, u hodhën parulla disfatiste, bile edhe armiqësore. Për të gjitha këto Komiteti i Partisë i Rrethit të Pukës, jo vetëm që s'vinte në korent KQ të Partisë dhe të kërkonte këshilla dhe ndihmë se si të dilte nga kjo situatë, por raportonte se çdo gjë shkonte në rregull. U desh një shok komunist i guximshëm nga Puka, i cili na shkroi një letër të gjatë, ku numëronte fill e për pe të gjitha këto veprime të gabuara, të paligjshme që po bëheshin dhe kërkonte ndihmën urgjente të Komitetit Qendror. Ky komunist i thjeshtë, por me partishmëri të lartë, zbuloi një plagë të rrezikshme, që as inspektorët e Komitetit Qendror që kishin shkuar në Pukë nuk e kishin parë. Kjo që them tash është shumë serioze për inspektorët, për instruktorët dhe për sekretarët e Komitetit Qendror që mbajnë lidhje me ta e që i kanë bashkëpunëtorët kryesorë të tyre për punën e Partisë.

E njëjta gjë na ndodhi edhe në Malësinë e Shkodrës, por me më pak virulencë. Shokët drejtues të Shkodrës kishin filluar që në verë, në formë fushate, pa punë politike, pa një studim të gjendjes politike, ekonomike, shpirtërore, të formonin kooperativa në malësi, që të dilnin me kolektivizim 100 për qind të realizuar, me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit. Mirëpo ndodhi ndryshe. Armiku punonte derë më derë dhe çdo natë nxitte njerëzit për kundërshtim, diskreditonte ata shokë komu-

nistë që luftonin për kolektivizimin, disa komunistë i lëkundi, futi grindjen në disa organizata partie e në popull. Në këtë situatë komiteti i Partisë dhe ai ekzekutiv s'e bënin «qejfin qeder», si thotë një fjalë, përpique-shin ta minimizonin çështjen dhe as vinin në korent për këto gjëra Komitetin Qendror dhe të kërkonin ndihmën e tij. Kundërshtimet, letrat e fshatarëve, ardhjet në Tiranë na sqaruan situatën.

Tash janë marrë masat e nevojshme politike, ideologjike, ekonomike, çështja është qetësuar, çdo gjë ecën normalisht, njerëzit kanë parë si kurdoherë drejtësinë e vijës së Partisë dhe ndihmën e drejtë të Komitetit Qendror e të Qeverisë. Këta fshatarë nuk ishin as kundër Partisë, as kundër pushtetit, ata ishin të revoltuar nga veprimet jo të rregullta arbitrare dhe ofenduese të disa shokëve. Ky është një mësim i madh, nga i cili duhet të nxjerrim konkluzione serioze.

Pse na ngjau kjo në Pukë, në Shkodër, pak në Kukës e fare pak në Mirditë?

E para, udhëheqja e Partisë në Pukë dhe në Shkodër e ka nënvleftësuar krejtësisht momentin politik, punën politike dhe ideologjike në këto fshatra. Ajo i ka parë çështjet thjesht në kuadër ekonomik dhe ka lënë pas dore anët politike, ideologjike dhe psikologjike, që janë të lidhura ngushtë dhe sidomos kur veprohet në kundërshtim me orientimin e përgjithshëm të Komitetit Qendror për kolektivizimin. Jo vetëm kaq, po, megjithëse u ishte theksuar të mos shpejtoheshin e të bënin shumë kujdes dhe, nga ana tjetër, u ishte dhënë direktiva të punonin për ngritjen e kolektivave blegtoralë, këtë direktivë të fundit, që ishte aktuale, nuk e kishin

marrë fare parasysh, s'e kishin vënë fare ujët në zjarr për ta zbatuar në këto fshatra. Nga kjo ne duhet të nxjerrim konkluzionin se shokët drejtues të këtyre rretheve direktivat e Komitetit Qendror nuk i studiojnë si duhet, nuk thellohen dhe nuk i zbatojnë si duhet. Kjo është shumë serioze për ta.

E dyta, shokët drejtues të këtyre rretheve, kam përshtypjen se duan t'u bëjnë ca reklamë punës së tyre dhe indirekt vetes së tyre. Çdo gjë përpiqen ta paraqesin mirë përpara udhëheqjes më të lartë, pranojnë fajet ose gabimet kur u bëhen kritika nga ne, por kur vjen puna që këto vërejtje ose gabime u vihen në dukje, nga shokë të tjerë të rangut të tyre, ose nga baza, këta i pranojnë me zor, ose s'i pranojnë fare. Kjo nuk është karakteristikë e shëndoshë e punëtorit të Partisë, prandaj duhet të korrigjohen.

E treta, këta shokë nuk mund të kritikohen se s'punojnë, se nuk lodhen, se nuk përpiqen, por, me sa duket, puna e tyre është e përciptë, nuk kanë arritur të kuptojnë gjerësinë dhe kompleksin e problemeve të jetës në zhvillim, nuk punojnë në thellësi dhe s'kanë si ndihmojnë si duhet dhe sa duhet, në radhë të parë, shokët e tyre bashkëpunëtorë që i kanë afër, që kështu të ndihmojnë si duhet dhe bazën. Një kuptim i thellë i problemeve do t'i shtyjë këta të gjejnë forma dhe metoda pune të reja, të përparuara dhe të frytshme, do t'i detyrojë ata dhe do t'u hapë perspektiva të dinë të mësojnë dhe të punojnë si duhet me njerëzit. Duhet në këtë çështje të thellohemi dhe të veprojmë në mënyrë revolucionare, se kështu do të zbatohen plotësisht direktivat e Partisë.

E katërta, këta shokë drejtues të Partisë në rreth, duke mos i kuptuar si duhet situatat politike dhe duke mos punuar mirë politikisht, kanë nënvleftësuar punën e armikut, të kulakut, të klerikut, të kriminelit, siç ndodhi në Shkodër, gjë që del edhe nga çështja që jemi duke analizuar tani.

Vetëm nga një punë e tillë e dobët politike, armiku përhapri parullën se «kooperativat, ka dhënë urdhër Qeveria, të prishen si në Pukë». A lejohet, shokë, kjo mendjelehtësi dhe punë e përciptë e shokëve tanë që drejtojnë në rreth? Ne kemi shumë suksese kudo edhe në kooperativa, dhe kjo se vija e Partisë është e drejtë dhe është zbatuar drejt. Ju, shokë, që po ju kritikojmë tash, keni kontribuar në këtë drejtim, por nuk u lejohet që të lini pas dore punën politike dhe ideologjike në malësi, si me fshatarësinë ashtu dhe me pjesën e fshatarësisë që nuk është futur akoma në kooperativë.

Kujdesi për kooperativat, fshatrat dhe fshatarët që akoma s'janë në kooperativë, duhet të jetë i madh. Por me kooperativizimin në malësi nuk kemi mbaruar. Puna e Partisë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Prandaj, shokë, t'u vëmë si duhet veshin këshillave, fjalëve, sugjerimeve dhe kritikave të bazës. Kjo të bëhet nga çdo drejtues e komunist në çfarëdo funksion që të jenë. Dhe konkluzioni i fundit që duhet nxjerrë, pa u zgjatur, është çështja se ajo çka thashë pak më sipër shfaqet në ata njerëz që u rritet mendja, që mendojnë se i dinë të gjitha, që u duket se pa ata nuk ecën puna, mjaft që të thonë një fjalë dhe çdo gjë u zgjidh, u kuptua dhe, në qoftë se nuk u binden edhe kur s'kanë të drejtë, përdorin prepotencën, arrogancën, deri dhe ofendimet per-

sonale. Këto janë jokomuniste, janë të palejueshme. Nga gabimet duhet të mësojmë dhe punën e Partisë ta forcojmë. Këtë e kërkojnë dinjiteti, detyra, karakteri i komunistit, interesi i lartë i Partisë e i popullit.

2. — T'i vëmë rëndësi të madhe veçanërisht cilësisë së eksporteve tona

Siç thuhet dhe në raport, në vitin 1965 eksporti dhe burimet e tjera në valutë nuk e përballojnë krejt importin tonë. Për këtë duhet të bëhen përpjekje të shumanshme në ekonomizimin e valutës, në shtimin e planeve, në gjetjen e burimeve të reja të eksportit. Sigurisht, edhe planet e viteve të kaluara kanë qenë parashikuar më të mëdha, por nuk janë realizuar; çdo vit kemi bërë plume të veçanta për rishikimin e planeve dhe kemi caktuar detyra rigorozë, por megjithatë, nga të metat, nga pakujdesitë tona të brendshme, me gjithë sukseset që kemi pasur, prapë nuk i kemi realizuar si duhet eksportet tona, si në sasi ashtu dhe në cilësi.

Duhet të themi se përpjekje më të mëdha nga punonjësit bëhen në drejtim të arritjes së sasisë së lëndëve të eksportit, me gjithë mungesat serioze që konstatohen edhe në këtë drejtim, kurse në drejtimin e cilësisë bëhen shumë pak përpjekje.

Drejtimesit e prodhimit dhe çdo punonjës në veçanti nuk e kanë të qartë se ekonomia jonë socialiste pasurohet jo vetëm nga sasia e sendeve që prodhon, por edhe nga cilësia e tyre. Rritja e cilësisë së mallrave të eksportit, që ajo t'u përgjigjet standardeve botërore,

bile po të jetë e mundur, në shumë raste t'ua kalojë atyre, sjell përfitime të mëdha ekonomike për vendin, përfitime për të cilat kemi nevojë. Këto përfitime nuk janë vetëm financiare, ato duhen shikuar me vëmendje të madhe edhe në disa drejtime të tjera.

Eksportimet tona në tregun ndërkombëtar zënë një vend shumë të vogël, si nga llojet, sasia, cilësia, dhe nga paraqitja tregtare. Mallrat tona, në sasinë kolosale të mallrave që shkëmbehen në tregjet ndërkombëtare, zënë një vend aq të vogël saqë edhe po të jenë mallra deficitare, ose strategjike, mund edhe të mos përfillen fare, në rast se ne nuk i bëjmë shërbimin e duhur punës. Koniunkturat politike të ndryshueshme influencojnë shumë dhe në zhvillimin e tregtisë në mes shteteve. Kjo do të thotë se këto koniunktura politike bëjnë që disa shtete, edhe sikur mallrat t'i kesh të mira, t'i bojkotojnë, nuk t'i marrin. Të mos harrojmë se ka shtete ose një komunitet shtetesh, që politikisht janë në luftë me shtetin tonë dhe marrëdhëniet tregtare i përdorin si presione politike. Këtë situatë e kemi hequr në kurriz. Kurse mund të qëllojë që një shtet i madh, që deri dje as të shikonte me sy, i detyruar nga koniunkturat politike të krijuara, kërkon të blejë nga shteti ynë jo vetëm mallra të mira, por disa herë mbyll synë edhe në cilësinë, por jo në çmimet.

Baza jonë duhet të jetë cilësia e mallrave që eksportojmë. Nevojat tona janë aq të mëdha, saqë këto mund t'i plotësojmë duke shtuar sasinë e eksportit të lëndëve të para të papërpunuara ose të punuara, qoftë edhe me një cilësi të dobët të themi. Por sasinë e mallrave tona të eksportit, me gjithë përparimet, janë ako-

ma të vogla e të pamjaftueshme, që të mbulojnë edhe anën e dobët të cilësisë. Prandaj neve na duhet t'u vëmë rëndësi si shtimit të vazhdueshëm të sasisë, ashtu edhe të cilësisë. Ne duhet të mendojmë të gjejmë tregje stabël në disa vende të botës për mallrat tona të eksportit. Tregjet e pakta, por të sakta, të qëndrueshme, që të krijojnë traditë të mirë qoftë edhe me sasi të vogla, por me cilësi të mirë të mallrave, kanë rëndësi të madhe ekonomike, politike dhe propagandistike. Këtë çështje ne duhet ta shikojmë në prizëm të drejtë me të gjitha vendet.

Një pjesë e eksporteve tona shkon në vendet e ish-demokracive popullore, të cilat, me gjithë armiqtësinë që tregojnë kundër nesh, nuk nxjerrin vështirësi serioze në tregti me ne, por ato natyrisht janë rigorozë në cilësinë e mallrave dhe bëjnë presione që të marrin nga ne mallra të vlefshme e të na japin në sasi më të vogël, mallra me cilësi të dobët dhe me çmime të larta, nga ato që ne kërkojmë dhe për të cilat kemi nevojë. Nuk do të hyj në hollësira, por dua vetëm të theksoj se ne duhet t'i ruajmë e t'i ushqejmë edhe këto tregje me mallrat që ato kanë nevojë dhe të sigurojmë e të ruajmë ato tregje që mund të na japin mallrat që ne kemi nevojë. Në këto koniunktura as ato, por as edhe ne nuk bëjmë lëshime. Në tregjet kapitaliste ne sapo kemi dalë. Kemi filluar të bëjmë tregti të vogël me disa shtete, por duke krijuar dhe njëfarë tradite. Çështja qëndron në atë që, duke dhënë disa mallra që në fillim, të krijohet dhe të vazhdohet një traditë e tillë, që jo vetëm ne të trokasim në derë të firmës së huaj, por edhe firma e huaj të trokasë në derën tonë. Kjo mund të ngja-

së me firma kapitaliste vetëm dhe kryesisht në rast se mallrat tona janë të një cilësie të lartë, të paraqitura mirë dhe të livruara në kohën e caktuar.

Por a e shikojmë këtë çështje me seriozitetin e duhur në të gjithë kompleksitetin e saj? Mjerisht jo. Ne kemi shumë për të bërë në këtë drejtim. Mua më duket se me gjithë përmirësimet që kemi në këtë fushë, se përmirësime dhe kujdes nuk mund të themi se nuk ka, duhet të bëjmë një kthesë rrënjësore në drejtimin e përmirësimit të cilësisë për të gjitha mallrat që prodhojmë, pa përjashtim, si për tregun e brendshëm, edhe për tregun e jashtëm. Duke e ngritur këtë çështje posaçërisht për tregun e jashtëm, nuk kam aspak qëllim që tregun e jashtëm ta mbivlerësojmë, kurse tregun e brendshëm ta nënvleftësojmë. Jo, për të dy tregjet duhet të tregojmë kujdes, se të dy tregjet janë të lidhura me njëri-tjetrin, kënaqin nevojat, guston, dëshirat e popullit tonë, ngrenë mirëqenien e tij nga çdo anë, forcojnë ekonominë e vendit. Këtu është vetëm çështje pune, ndërgjegjeje, organizimi, kontrolli, disipline dhe kuptimi të drejtë të problemit nga ana politike, ideologjike dhe ekonomike. Në këto drejtime Partia, pushteti dhe organizatat e masave duhet të zhvillojnë një aktivitet të dendur, të pandërprerë, të thelluar dhe jo të sipërfaqshëm, të koordinuar, siç janë të lidhura ngushtë problemet, dhe jo të shthurura, pa perspektivë, disa herë pa qëllime të qarta. Duhet të prekim ndjenjat, ndërgjegjen, patriotizmin e punonjësve, të kthjellojmë çdo ditë e më shumë mendjen e tyre, të forcojmë rregullin dhe disiplinën në punë. Partia ka mundësi të mëdha që ta kryejë me sukses këtë punë, por du-

het të punojë më mirë dhe në mënyrë më të thellë në këtë drejtim. Komitetet e Partisë dhe sekretarët e tyre, komitetet e ndërmarrjeve, byrotë e tyre dhe sekretarët e organizatave-bazë, komitetet e Partisë në dikasteret ekonomike dhe ndërmarrjet që varen prej tyre, në drejtim të rritjes së cilësisë së mallrave për eksportin nuk e kryejnë si duhet detyrën, i kalojnë përceptas një punë që nuk lejon punë të përceptë. Të gjithë ata që përmenda më lart, s'mund të kritikohen se nuk shkojnë në bazë, në kooperativa ku prodhohet, në miniera, në fabrika. Fakti është se ata venë pyesin dhe marrin shifra, ata venë në organizatat-bazë ku shtrohet çështja e cilësisë, por kjo nuk mjafton, çështja është më e komplikuar, kërkon një punë më të menduar, më të thelluar. Është shumë më lehtë të konstatosh, por është shumë më e rëndë të ndërtohet një situatë të re, e cila nuk mund të arrihet vetëm me konstatime, me masa administrative, me zbatim ligjesh, pa i edukuar njerëzit, pa i bërë të ndërgjegjshëm për çdo situatë, për çdo punë, për çdo masë. Këta kanë nevojë të shpjegohen vazhdimisht lidhur me punën, me zbatimin, me sukseset, me gabimet, me shfaqjet e jetës.

Që punëtori në torno të punojë një vegël të mirë e me cilësi të lartë, që punëtori i minierës, ose i naftës të nxjerrë mall të mirë, jo vetëm i kërkohet që të jetë i kujdesshëm, por të zhvillojë njëkohësisht dhe aftësitë e veta teknike.

Dhe Partia kërkon prej nesh, që na ka ngarkuar me këto punë, jo vetëm të jemi të kujdesshëm, po të zhvillojmë aftësitë tona politike, ideologjike dhe teknike. Detyra jonë ka edhe teknikën e saj, bile të lartë,

të vështirë, që, pa një punë serioze, degjeneron në një punë të përciptë, kthehet në një punë komandimi, në vend që të ketë karakter edukimi, organizimi. Fakt është se ne vuajmë nga cilësia e mallrave të prodhimit, pra, kemi të meta, të cilat mund t'i zhdukim.

Të shkohet kudo me mendimin dhe po kështu të veprohet, se malli, duke kaluar nga të gjitha hallkat, duhet të vejë te blerësi me cilësi të mirë. Ne mund të kritikojmë, dhe ka vend boll për të kritikuar Ministrinë e Tregtisë, kooperativat e konsumit, artizanatin e disa kooperativa të tjera dhe t'u themi që ta bëjnë punën më mirë, të jenë rigorozë në kërkesat, të sjellin nga importi mallra të mira dhe me kohë, por duhet ta kemi të qartë se në rast se ndërmarrjet e ndryshme prodhuese të vendit nuk realizojnë me kohë, në sasi dhe në cilësi detyrat e tyre, asgjë nuk mund të shkojë në rregull.

Në rast se ndërmarrjet tona që janë të lidhura me eksportin, si ato minerale, artizanale, ose edhe disa kooperativa bujqësore që eksportojnë fruta ose perime të hershme nuk i kanë parasysh nevojat dhe kushtet e eksportit, ato duhet të bëhen të ndërgjegjshme se pengojnë seriozisht ekonominë e vendit dhe pretendimet e tyre nuk mund të shkëputen nga pretendimet e të tjerëve ndaj tyre, dhe ca më pak se nuk mund të kemi pretendime nga shtetet e huaja, kur nuk jemi vetë në rregull.

Është e vërtetë se mjaft gjëra që kanë të bëjnë me ne, varen nga importi dhe pa to nuk mund të zhvillohet prodhimi as si sasi, as si cilësi. Por që të vijmë këto në kohën e duhur dhe të përmirësohet, të themi, cilësia,

duhet të paktën të realizohet plotësisht, në mos të tejkalohet, plani i prodhimit, që të krijohet kështu mundësia e shtimit të kleringut dhe të sillen nga jashtë ato që ne kemi nevojë. Po ngjet që jo vetëm cilësinë, por as sasinë s'e realizojmë dhe kërkojmë të na vijë çdo gjë sa më parë. Përveç kësaj, kur vjen puna e hartimit të planeve, siç theksohet edhe në raport, bëhen kërkesa të atilla importi, që janë të pamundura të realizohen, për mungesë kleringu dhe devize. Njerëzit në bazë vazhdojmë t'i mësojmë të mos jetojnë si duhet me situatat dhe të shtrijnë këmbët sa kemi jorganin. Kërkojnë të jenë brenda, mundësisht të kenë dhe rezerva, ngatërrojnë kështu edhe ministritë, të cilat, natyrisht, do t'i kenë parasysh kërkesat e bazës dhe shkurtojnë sa u vjen për doresh, por, kur vjen gërshëra përfundimtare, atëherë hidhen përpjetë. Situata kërkon që të shtrëngohemi dhe të mos notojmë në bollëk. Për të qenë më ekzaktë, ne nuk notojmë në bollëk, por ka sektorë që tregohen të pakujdesshëm në kërkesat e tyre dhe të pavëmendshëm në gjendjen e atyre nevojave që vënë në listat e kërkesave. Komitetet ekzekutive dhe Partia në bazë nuk kanë masën e duhur në planifikimin e importit dhe s'e lidhin atë si duhet me eksportin, me sigurimin, me shtimin e sasisë, me sigurimin dhe me përmirësimin e cilësisë.

Të marrim çështjen e duhanit, i cili është prodhimi i vendit tonë, që na siguron një klering nga më kryesorët. A e kanë të gjithë parasysh se nga eksporti i tij sigurojmë të ardhura të rëndësishme në devizë? Mund ta kenë dhe e kanë, që kur ne prodhojmë dhe eksportojmë cigare dhe duhan. Por ne jemi larg nga

ajo që baza të kuptojë rëndësinë ekonomike të prodhimit me cilësi të mirë dhe me sasi të shumëfishuar të duhanit. Pse e them këtë? Sepse ne humbasim çdo vit me miliona rubla devizë nga ky prodhim, devizë që mund ta siguronim, ta fitonim. Duhani është një kulturë shumë ekonomike, që i siguron shumë të ardhura kooperativës, por ai do t'i sigurojë asaj më tepër, në rast se kooperativa bën përpjekje të prodhojë më shumë dhe në rast se ky prodhim do të jetë i cilësisë së parë e të dytë.

Shokë të Ministrisë së Bujqësisë, shokë sekretarë të parë të rretheve ku kultivohet duhani, si të Shkodrës, të Elbasanit, të Gjirokastrës etj., duhet ta kuptoni mirë se ju bie një përgjegjësi e rëndë, kur nuk realizohet as sasia, as cilësia e duhanit. Në qoftë se ka ndonjë nga kulturat tona që duhet ta stabilizojmë dhe të përfitojmë më shumë, kjo është pikërisht kultura e duhanit. Kjo kulturë është shumë e leverdishme dhe shumë e njohur për fshatarët tanë. Është kulturë e njohur, tradicionale, por të mos kënaqemi duke thënë se të gjithë e dinë këtë zana dhe të tërë ia bëjnë si duhet shërbimet kulturore. Duhet investime për duhanin, të tilla kanë bërë shteti dhe shumë kooperativa, por kur vjen puna e dorëzimit, as cilësia, as sasia nuk janë në lartësinë e duhur. Mungesa e depove dhe e hangarëve nuk është e tëra, duhet të shtohen kujdesi e shërbimet që kur është duhani në fidanishte.

Siç duket, si për bimët e tjera dhe për duhanin ca më shumë, meqë është një e ardhur e madhe në devizë të huaj, duhet mjeshtëri që kur hidhet fara e derisa ambalazhohet për eksport. Kjo mjeshtëri, më duket

mua, nuk mësohet vetëm nga praktika tradicionale e gjyshërve, ajo duhet të mësohet intensivisht nga çdo kooperativist që merret me këtë kulturë. Të bëjmë që të mësojnë dhe të merren me këtë kulturë njerëz të veçantë, të përhershëm, të aftë, të cilët t'i specializojmë në mënyrë të atillë që të dinë dhe cila erë fryn me intensitet, ose me më pak intensitet e i shërben cilësisë së duhanit; kur atë e vënë në varg, të dinë mirë sasinë e diellit dhe të lagështirës që i duhet këtij ose atij lloji duhani. Sigurisht specialistët ia dinë të gjitha të fshehtat zanatit. Për këtë kulturë kaq të rëndësishme për ekonominë tonë, e vlen që kooperativat që e mbjellin të bëjnë sa më parë investimet e nevojshme, por edhe ne, si shtet e Parti, të mos neglizhojmë dhe të mos harrojmë detyrën tonë të rëndësishme të zhvillimit të njohurive të fshatarëve për këtë kulturë.

Çdo lëndë e parë që eksportojmë duhet të na forcojë vëmendjen për çështjet që përmenda, por rëndësi ka dhe për atë lëndë të parë që ne prodhojmë me cilësi të dobët e që detyrohemi ta blejmë jashtë me një cilësi më të mirë, me qëllim që ta përziejmë me prodhimin tonë. E kam fjalën te pambuku. Pambuku është lënda e parë bazë e disa kombinateve tona nga më të rëndësishmet. Këto kombinatë jo vetëm do të prodhojnë për popullin, por edhe për eksportin. Të kemi kurdoherë parasysh teknikën e përparuar botërore në drejtimin e stofave, në diversitetin e tyre, në përdorimin e llojeve të lëndëve. Tash në këtë drejtim nuk kemi preokupim të madh, por më vonë, në rast se nuk marrim masa, do të hasim në pengesa. Ne tash importojmë pambuk të

cilësisë së mirë, për ta përzier, por më vonë, me kombinatin e Beratit, do të ngrihet shumë kjo sasi importi.

Përse ne të vihemi në vështirësi kur kemi mundësi të prodhojmë në vend jo vetëm sasinë e nevojshme, por edhe me cilësinë e duhur? Dihet se cilësia nuk do të bjerë nga qiejt, por vetëm nga dituria, nga kujdesi, nga puna dhe nga toka jonë. Këtë çështje e theksoj se duhet që Ministria e Bujqësisë, Partia dhe komitetet ekzekutive në rrethë të mendohen thellë për këtë problem, të marrin masat për farën e mirë e të zgjedhur dhe për edukimin e specialistëve e të kooperativistëve që merren me këtë kulturë. Çdo muaj, çdo vit që ne mund t'i zvarritim këto çështje, do të na shkaktojnë dëme në ekonomi. Shokët e bazës duhet të dinë se burimet e krijimit të devizës së lirë janë të kufizuara, kurse nevojat çdo vit janë në ngritje. Ka mundësi akoma më të mëdha që të krijohet kjo devizë, sidomos nga zgjerimi i gamës së eksportimit të disa mallrave ose produkteve tona të cilësisë së lartë ose speciale që të shiten jashtë kleringut.

Vendi ynë është një vend mesdhetar, me një florë industriale të zhvilluar, natyrore, por njëkohësisht dhe të panjohur nga ne. Me zor ne filluam grumbullimin e disa bimëve mjekësore dhe jo kudo. Por sa bimë mjekësore që rriten vetë në natyrë ka te ne për t'i shitur dhe sa të tilla ka për t'i kultivuar! Duhet të interesohet tregtia e jashtme, por më parë duhet t'i themi asaj ç'kemi, sa kemi, sa i japim. Një gjë e tillë pak i preokupon udhëheqjet e rretheve, ose Ministrinë e Bujqësisë të ndërmarrin studime të veçanta dhe të organizojnë punën. Këto janë gjëra të vogla, mund të thonë

disa shokë, por nuk është kështu, prandaj ne duhet t'i kuptojmë e t'i realizojmë më mirë probleme të tilla, kaq të rëndësishme për vendin tonë.

Të marrim çështjen e mjaltit dhe të punëtores që e prodhon atë, bletës. Të gjithë e dinë rëndësinë e këtij prodhimi dhe sa i përshtatshëm për të është vendi ynë. Po atëherë, pse ky interesim kaq i paktë për këtë prodhim kaq të vlefshëm, pse kjo neglizhencë e palejueshme? Bleta nuk do as koncentrat as grurë as misër, që të bëjë mjaltë. Zgjojet e saj nuk kushtojnë miliona, për krahë pune ato s'kanë nevojë, pse bletët janë vetë punëtoret më shembullore që mund të ketë, punëtoret të disiplinuar, ekonomë, të pastra. Atëherë ç'presim, shokë? Të mbushim kooperativat me bletë, të prodhojmë sa më shumë mjaltë për popullin, të kursejmë sheqerin që sjellim nga jashtë dhe të eksportojmë në vendet e botës mjaltin tonë aromatik nga trëndelina e të tjera si kjo, të zëmë tregjet edhe ne, në mënyrë të atillë që jo t'i lutim të na e blejnë, por të na lutin ata ne, pse në mjaltin tonë do të gjejnë shijen e veçantë që i jep klima jonë me diellin e bukur e me lulet aromatike. Po ju bëj poezi, shokë të rretheve, por shumë herë ju kemi folur për këtë gjë pa poezi, mundet që këtë herë t'ju prek edhe ndjenjat dhe jo vetëm arsyen dhe logjikën.

Të marrim çështjen e sendeve të artizanatit për tregjet e jashtme. Këto janë gjëra speciale, që zakonisht shiten me çmime të larta dhe për këto gjen treg kudo. Të marrim shembull edhe nga artizanati i disa vendeve të huaja, që mbushin tregjet. Por ato që shiten në këto tregje nuk janë hekurishte e shporta të përçmuara. Ne duhet ta shikojmë realitetin në sy, artizanati ynë për

këto lloj mallrash eksporti pothuajse nuk ekziston. Nuk bëhen përpjekje serioze që ai të organizohet, të ngrihet, të përmirësohet. Ne flasim për mjeshtërinë e punimit të filigramit të argjendtë, për mendimin tim ai është lënë pas dore dhe jo vetëm kaq, por po zhduket, pse nuk po vlerësohet si duhet. Punimet që bëhen nuk janë të një niveli të lartë artistik. Në këto gjëra prej argjendi ka vlerë puna e hollë, e bukur, origjinaliteti, karakteristika e vendit, poezia e folklorit që mund të paraqitet edhe në një vath të vogël të gruas. Ne kemi mbetur me disa zanatçinj të vjetër, të paktë. Gjërat që po prodhohen jo vetëm që janë pa shije, por kushtojnë edhe shumë shtrenjtë. Kështu është edhe me përpunimin e drurit, të kostumeve, të qëndisjeve ose të gjërave të tjera karakteristike nacionale të lidhura kurdoherë me eksportin.

Shokë, duhet t'i marrim të gjitha këto çështje seriozisht, të mos i quajmë të vogla. Disa herë mjaft nga këto gjëra kanë një efekt propagandistik për vendin tonë shumë më të madh nga përfitimi ekonomik. Një qilim i mirë, një shami e qëndisur me motive të bukura popullore, një lahutë e bukur, një lugë me dru piksi të qëndisur, një send i vendosur në raft ose në mur të një evropiani ose të çdo të huaji, është një vend që zë çështja e Shqipërisë në ndjenjat, në shijen e atij personi. Këto anë gjithashtu duhet t'i vlerësojmë, pse shumë herë këto s'blihen me para. Çdo mall i mirë, me cilësi, i shitur jashtë, i sjell jo vetëm të ardhura të mira ekonomisë por propagandon shumë vendin tonë, pse në mallrat shqiptare të huajt shohin shkallën e teknikës sonë, shijen, zotësinë, nivelin e kulturës, kujdesin në pu-

në, drejtësinë e sa e sa virtyte të larta të popullit tonë, që i ka pasur, i ka zhvilluar, të cilat armiqtë tanë janë përpjekur në të kaluarën dhe përpiqen edhe sot t'i errësojnë, por kurrë s'kanë mundur e nuk do të mundin. Populli ynë ecën përpara, Shqipëria lulëzon.

*Botuar për herë të parë me
disa shkurtime, në «Raporte
e fjalime 1965-1966», f. 28.
Tiranë, 1971*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në AQP, duke përfshi-
rë edhe pjesë të papublikuara
më parë*

TROJKA HRUSHOVIANE, BREZHNJEV-KOSIGIN- -MIKOJAN, NË RRUGËN E MOHIMIT DHE TË SABOTIMIT TË LUFTËRAVE ÇLIRIMTARE TË POPUJVE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

3 mars 1965

Kanë kaluar katër muaj e gjysmë që kur Nikita Hrushovi, ideologu dhe frymëzuesi i revizionistëve modernë, u rrëzua nga postet kryesore që mbante në Partinë Komuniste dhe në qeverinë e Bashkimit Sovjetik. Relativisht, kjo nuk është një kohë tepër e gjatë, por ajo ka qenë më se e mjaftueshme për të vërtetuar se pasardhësit e tij ndjekin me besnikëri, dhe bile më me vendosmëri, vijën oportuniste, antimarksiste e kapitulluese të kryetarit të tyre famëkeq. Por largimi i N. Hrushovit nga skena politike solli njëfarë ndryshimi në taktikën e pasuesve të tij, të cilët morën përsipër të zbatonin hrushovizmin jo vetëm pa Hrushovin, por edhe në kushtet kur ai, si rezultat i luftës parimore të marksistë-leninistëve dhe të provave të kohës, ishte demaskuar keqas dhe kur revizionizmi modern kishte

hyrë në rrugën e pashmangshme të falimentimit të plotë.

Qeveria e re e Kosiginit po përpiqet të përdorë një taktikë të re demagogjike për të fshehur veprimet objektive drejt afrimit sa më të madh të politikës së saj me atë të borgjezisë imperialiste, dhe veçanërisht asaj amerikane, në bazë të së famshmes «bashkekzistencë paqësore» hrushoviane.

Duhet thënë se udhëheqja e re revizioniste sovjetike e kuptoi humbjen e madhe që i solli asaj rruga e vrullshme tradhtare kur kishte në krye Hrushovin. Revizionistët sovjetikë shpresuan shumë te krerët e imperializmit amerikan, ata u bënë atyre koncesione të bujshme dhe për vete korrën disfatën. Me Hrushovin në krye, revizionistët modernë kishin hyrë në një darë të tmerrshme, e cila çdo ditë që kalonte po mbyllej. Jo vetëm kaq, por vrulli i kursit të tyre ishte i atillë që revizionistëve u duhej të merrnin masa serioze, ose të binin si një kërmë e qelbur nën thundrën e imperialistëve. Prandaj heqja e Hrushovit ishte bërë një konditë sine kua non për ata, duke marrë parasysh edhe humbjen e madhe politike që do të pësonin. Por, nga ana tjetër, nuk duhet të harrohet se ky ishte një operacion i vështirë, që jo vetëm nuk mënjanonte kundërshtimet dhe luftën e vazhdueshme të marksistë-leninistëve e të popullit sovjetik, por nuk mund të mos u shkaktonte revizionistëve dhe kundërshtime të hapëta dhe të fshehta nga hrushovianët e tjerë.

Trojka Brezhnjev-Kosigin-Mikojan nuk e demaskoi haptazi Hrushovin, si për arsye se vija e tij do të ndiqej me besnikëri, ashtu edhe pse këtë vijë ata e

kishin përpunuar së bashku. Ata e «kritikuan» pak Hrushovin brenda, jashtë nuk e kritikuan aspak dhe kështu i «shpëtuan» demaskimit të tyre, «shpëtuan» vijën e vet, evituan kundërshtimin me ultrahrushovianët dhe «opozita» e këtyre të fundit, në qoftë se mund ta quajmë kështu, u kufizua në një çështje subjektive sentimentale që koha do ta cikatrizojë.

Por revizionistëve që rrëzuan Hrushovin u duhej të mendonin seriozisht për një ndryshim taktike që t'u lejonte të rimerrnin veten, të vazhdonin vijën dhe të evitonin goditjet nga ana e marksistë-leninistëve.

Kundërshtimet tona me revizionistët modernë kanë qenë dhe janë të thella, të pakapërcyeshme, në të gjitha çështjet. N. Hrushovi dhe shokët e tij u përpoqën të na fusnin në thes, të na impononin pikëpamjet e tyre tradhtarë. Ata dështuan dhe u detyruan të futeshin në luftë frontale për të gjitha çështjet me ne, por edhe këtu i humbën një nga një betejat, kalatë e tyre u shkaktërruan. Atëherë Hrushovi dhe shokët e tij u përpoqën, bënë thirrje që të pushohej polemika, ose më mirë që ne ta pushonim polemikën dhe ata të vazhdonin kursin e tyre tradhtar në qetësi. Dhe këtu ata pësuan disfatë.

Pas rrëzimit të Hrushovit, shokët e tij që mbetën në fuqi, nuk bënë tentativa të bujshme si të Hrushovit duke i rënë gjoksit me grushte që të pushohej polemika, por, pa e harruar këtë thirrje, me zë të ulët, ata, siç duket, kanë adaptuar taktikën jo ta kërkojnë me «të gërthitura» shuarjen e polemikës, por të gjejnë atë sektor të vijës së përgjithshme ku mund të zërë vend demagogjia e tyre dhe kështu të fishkin polemikën. Për këtë çështje ata kanë gjetur hallkën e politikës së jashtë-

me, ose të frontit antiimperialist. Ky front antiimperialist është fusha e parë e eksperimentit të tyre.

Tani duket fare qartë se përpjekjet kryesore të udhëheqësve të rinj revizionistë sovjetikë synojnë të fshehin nga komunistët dhe opinioni publik qëllimet dhe rrugën e tyre të vërtetë. Ata mundohen të arrijnë të njëjtët objektiva që dëshironte Nikita Hrushovi, por pa bujë, pa reklamë të madhe dhe pa zhurmë demonstrative, duke u munduar me të gjitha mjetet të hedhin gurin e të fshehin dorën. Karakteristikë e udhëheqësve të rinj sovjetikë është përdorimi me bollëk i një demagogjie të rafinuar, që synon të mashtrojë naivët dhe të turbullojë të lëkundurit.

Bashkëpunimi i mirë dhe i frytshëm sovjeto-amerikan vazhdon, por pa zhurmë, pa fjalime e të gërthitura, siç bënte N. Hrushovi. Revizionistët sovjetikë nënshkruan marrëveshje të shumta me imperialistët amerikanë; ata kanë rënë dakord në OKB që kjo të mos vazhdojë punimet në rregull; amerikanët vazhdojnë punën e vet në Kongo e gjetkë pa u shqetësuar; bombardojnë Republikën Demokratike të Vietnamit dhe Kosingini mban një fjalim për të kaluar radhën dhe mendon se hodhi hapin e parë të taktikës së re demagogjike të kapjes së hallkës së frontit antiimperialist. Tani revizionistët sovjetikë e kanë ngritur një çikë më lart zërin duke thënë se janë kundër imperializmit amerikan. Gazetat revizioniste sovjetike tani flasin jo vetëm kundër «të tërbuarve», por ngandonjëherë zënë në gojë edhe administratën e Xhonsnit; ata e kanë vënë në surdinë mburrjen e njeriut «të arsyeshëm» amerikan etj. Në mbledhjet ndërkombëtare ata përpiqen të mbajnë qën-

drime gjoja antiimperialiste, por kurdoherë me ton të moderuar, dhe përpiqen kështu të hiqen me demagogji; sikur vija jonë e drejtë marksiste-leniniste kundër imperializmit amerikan nuk ka ndonjë diferencë të madhe, qoftë në parim, qoftë në praktikë me atë të revizionistëve modernë.

Nuk është vështirë, gjithashtu, të vihet re se tani udhëheqësit revizionistë sovjetikë, sa për sy e faqe, thonë se përkrahin luftën nacionalçlirimtare të popujve, se edhe ata bëjnë pjesë në frontin e përbashkët antiimperialist, pavarësisht se me vepra janë kundër luftës çlirimtare të popujve të shtypur, pavarësisht se përkrahin me të gjitha mënyrat imperializmin dhe luftojnë për ruajtjen e statukuosë së sotme në botë, që i intereson imperializmit. Një nga aspektet esenciale të taktikës së re të adaptuar nga udhëheqësit sovjetikë në luftën e tyre kundër marksizëm-leninizmit, kampit socialist, lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe luftës revolucionare çlirimtare të popujve, është ndjekja e vijës tradhtare të N. Hrushovit, por e kamufluar me një tym të madh demagogjie.

Kjo taktikë e rrezikshme u duk qartë edhe në fjalimin e Kosiginit mbajtur më 26 shkurt, nëpërmjet televizionit të Moskës, lidhur me vizitën që ai bëri në RD të Vietnamit dhe në RDP të Koresë. Ai e vuri në përdorim fare pa rezerva artin e demagogjisë revizioniste për t'u paraqitur sikur udhëheqësit e rinj sovjetikë mbështetin luftën çlirimtare të popujve të Azisë, sikur edhe ata dënojnë veprimet agresive të imperializmit amerikan në Azinë Juglindore. Por, pavarësisht nga fjalët e zgjedhura me shumë kujdes dhe të ndonjë

shprehje të ashpër në dukje kundër imperializmit, Kosigini nuk mundi ta fshehë të vërtetën e pamohueshme se udhëheqësit e sotëm sovjetikë nuk janë me luftën çlirimtare të popullit heroik të Vietnamit të Jugut, nuk kundërshtojnë politikën agresive të imperializmit amerikan në Azinë Juglindore dhe nuk luftojnë aspak për demaskimin e rrezikut konkret imperialist që kërcënon tani vendet socialiste të Azisë.

Ka mjaft vjet që populli i Vietnamit të Jugut ka rrëmbyer armët dhe lufton me trimëri për të dëbuar nga vendi i tij pushtuesit amerikanë, për lirinë e pavarësinë e atdheut të tij të shumëvujtur. Regjimi ultra-reaksionar i Sajgonit, edhe pse ka mbështetjen e fuqishme të imperializmit amerikan, mezi mbahet në këmbë. Tani është fare e qartë se po të mos ishin ushtritë amerikane që marrin pjesë drejtpërdrejt në operacionet kundër forcave çlirimtare, populli i Vietnamit të Jugut do të kishte mundur me kohë të vendoste vetë fatin e tij. Populli i Vietnamit të Jugut është i detyruar të luftojë për liri e pavarësi pasi luftën ia kanë imponuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përderisa imperializmi amerikan e mban të pushtuar, nuk mund të ketë paqe në këtë vend.

Sigurisht, zhdukja e vatrës së rrezikshme të luftës të krijuar nga imperialistët amerikanë në Vietnamin e Jugut preokupon seriozisht jo vetëm Vietnamin dhe popujt e tjerë të Indokinës e të Azisë, por edhe mbarë popujt e botës. Por si mund të zgjidhet kjo çështje? Imperialistët amerikanë kërkojnë që populli i Vietnamit të Jugut të kapitultojë, të hedhë armët, t'u nënshtrohet Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Populli i

Vietnamit të Jugut dhe të gjitha forcat paqedashëse të botës kërkojnë që imperialistët amerikanë të largohen nga Vietnami i Jugut dhe ta lënë të qetë popullin e këtij vendi për t'i vendosur vetë fatet e tij. Kjo zgjidhje u përgjigjet plotësisht si interesave jetike të popullit të Vietnamit të Jugut ashtu edhe interesave të paqes së përgjithshme, sigurimit ndërkombëtar në Azi dhe në mbarë botën. Pra, e vetmja alternativë është largimi i trupave amerikanë nga Vietnami i Jugut, si kushti esencial paraprak për çdo zgjidhje të mundshme të problemit të Vietnamit.

Pikërisht këtë kërkesë të qartë dhe realiste — largimin e trupave amerikanë nga Vietnami i Jugut — nuk e shtron Kosigini, pasi revizionistët sovjetikë i tremben kësaj. Duke paraqitur pikëpamjet e qarqeve diplomatike perëndimore në Moskë, korrespondenti i agjencisë franceze të lajmeve shpreh kënaqësinë e tyre «që kryeministri sovjetik nuk vuri si kusht të domosdoshëm tërheqjen e trupave amerikanë nga Vietnami për çdo bisedim».

Në fjalimin e tij Kosigini deklaroi se «për krijimin e kushteve për gjetjen e rrugëve që çojnë drejt normalizimit të gjendjes në Indokinë kërkohet në radhë të parë ndalimi i akteve agresive të SHBA-së kundër RD të Vietnamit». Patjetër aktet e rënda të agresionit që imperialistët amerikanë kryejnë prej disa kohësh kundër sovranitetit dhe integritetit tokësor të RD të Vietnamit, janë veprime të palejueshme që kanë ngjallur një zemërim të madh dhe një valë të fuqishme protestash në gjithë botën. Pa u dhënë fund atyre as që mund të bëhet fjalë për zgjidhjen e problemit të Indokinës në

tërësi dhe të Vietnamit të Jugut në veçanti. Por bombardimet e aviacionit dhe të marinës amerikane në Vietnamin e Veriut janë pasojë e pushtimit ushtarak të imperializmit amerikan të Vietnamit të Jugut, e luftës së ndyrë që ai bën kundër popullit trim vietnamez, janë shprehja e tërbimit të tij për goditjet dhe disfatat e rënda që ka pësuar në Vietnamin e Jugut. Imperialistët amerikanë kryejnë akte agresioni kundër RD të Vietnamit, pasi ushtritë e tyre ndodhen në Vietnamin e Jugut, pasi ata kërkojnë me çdo kusht e çdo mjet të ruajnë sundimin e tyre në këtë vend. Prandaj, pa zhdukur shkakun, domethënë pa largimin e trupave pushtues amerikanë nga Vietnami i Jugut, është vështirë të mendohet se rreziku i zgjerimit të agresionit amerikan në Azinë Juglindore mund të largohet. Kërkesa e paraqitur nga Kosigini është krejtësisht minimale dhe duket se ka karakter demagogjik. Efektivisht ajo lë pa prekur statukuonë në Indokinë dhe, me sa duket, e quan normale praninë e ushtrisë amerikane brenda Vietnamit të Jugut. Prandaj kur «mbrohet» Vietnami i Veriut, dhe nuk mbrohet me vendosmëri e në mënyrë konsekuente lufta çlirimtare e popullit të Vietnamit të Jugut, kjo do të thotë jo vetëm të mos mbrosh as Republikën Demokratike të Vietnamit, por të bësh demagogji, të mundohesh që një plagë të hapët t'i vësh njëfarë melhemi për të mos u demaskuar sheshit.

«Mbrojtja» që Kosigini i bëri Vietnamit kufizohet vetëm në fraza, konstatime, thirrje e lutje. Ai thotë, për shembull, se shtresat e ndryshme të popullsisë së Vietnamit të Jugut «përpiqen për ndalimin e ndër-

hyrjes së huaj» etj., por nuk thotë esencialen, se ata përqipen për t'i dhënë fund pushtimit amerikan, se «raprezaljet vetëm shtojnë urrejtjen ndaj ndërhyrësve të huaj», por nuk thotë se ato, para së gjithash, e forcojnë edhe më tepër luftën nacionalçlirimtare të popullit të Vietnamit të Jugut. Ai thotë se «ne kërkuam nga SHBA dhe nga pjesëmarrësit e tjerë të Konferencës së Gjenezës respektimin dhe zbatimin me rreptësi të detyrimeve të tyre». Por meqë SHBA nuk po i dëgjojnë këto kërkesa, ai nuk thotë se ç'mendojnë të bëjnë më tej udhëheqësit sovjetikë. Kosigini deklaroi se «duhet të kundërshtohet politika imperialiste e përdorimit të forcës ushtarake kundër popujve që mbrojnë pavarësinë e tyre», se «sulmeve të imperializmit kundër të drejtave të popujve u duhet dhënë fund», por ai nuk jep asnjë shpjegim se si e kundërshtojnë revizionistët sovjetikë këtë politikë imperialiste dhe si mendojnë ata se mund t'u jepet fund sulmeve të imperializmit kundër të drejtave të popujve dhe çfarë duhet të bëjë Bashkimi Sovjetik për këtë çështje të madhe.

Tipike për fjalimin e Kosiginit, dhe njëkohësisht edhe për politikën e revizionistëve hrushovianë, ishte ajo pjesë ku ai bën fjalë për Korenë. «Ne mendojmë, thotë ai, se trupat amerikanë duhet të largohen nga Koreja e Jugut». Siç duket, revizionistët hrushovianë vetëm mendojnë, por nuk kanë ndonjë mendim se si duhet të ikin amerikanët. Por e pyesim revizionistin Kosigin: Këtë, që amerikanët duhet të largohen nga Koreja e Jugut, pse nuk guxove ta shtroje dhe për Vietnamin e Jugut? Apo nuk ishte vendi ta shtroje? Jo, vendi ishte, por dëshira nuk ishte.

Sot problemi i intervencioneve të armatosura të imperializmit amerikan dhe, si rrjedhim, i largimit të ushtrive agresive amerikane që pushtojnë territoret e huaja është një problem esencial dhe kyç jo vetëm për Vietnamin e Jugut, por edhe për Kongon, edhe për Kubën (baza e Guantamos) etj. Në kohën e tij Hrushovi aprovoi dërgimin e ushtrive amerikane në Kongo nën maskën e trupave të OKB-së. Gjatë zgjidhjes së çështjes kubane, kur kapitulloi përpara presionit të SHBA-së, ai as që u preokupua fare për Guantanamon. N. Hrushovi e konsideroi gjë krejt normale vazhdimin e pushtimit të kësaj pjese të territorit kuban nga ushtritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ç'ndryshim ka tani midis politikës kapitulluese të N. Hrushovit dhe asaj të pasardhësve të tij? Absolutisht asgjë. Kosigini i shmanget me të gjitha mënyrat mbrojtjes hapur të luftës së popullit të Vietnamit të Jugut. Ai nuk kërkon largimin prej andej të forcave të armatosura amerikane, sepse nuk do të komprometojë politikën e afrimit e të bashkëpunimit të revizionistëve hrushovianë me imperializmin amerikan, sepse mundohet të evitojë çdo rast që mund të shpjerë në ndeshje me interesat amerikane, sepse për të, me sa duket, është shumë i shtrenjtë prestigji i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Po të dëgjohen udhëheqësit e sotëm hrushovianë të Bashkimit Sovjetik, do të thotë të minohet dhe të sabotohet lufta e popullit të Vietnamit për liri e pavarësi, të përjetësohet sundimi i imperialistëve amerikanë në Vietnamin e Jugut.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë, ashtu si dhe

Hrushovi në kohën e tij, kanë shumë qejf të përsëritin se janë leninistë. Por qëndrimi që ata mbajnë ndaj luftës nacionalçlirimtare të popujve, viktima të imperializmit amerikan, dhe në mënyrë të veçantë ndaj luftës së popullit të Vietnamit të Jugut, a përputhet me idetë dhe mësimet e Leninit? Kur intervencioni i 14 shteteve pllakosi Republikën e re të Sovjetëve dhe i gjithë reaksioni i brendshëm u rebelua ndaj pushtetit të ri sovjetik, Lenini nuk e zgjidhi këtë çështje duke biseduar me intervencionistët e të bardhët, por me pushkë i detyroi ata të shporreshin nga vendi i Sovjetëve.

Krejt në kundërshtim me këtë, Kosigini i këshilloi vietnamezët të bisedojnë me intervencionistët amerikanë dhe kukullat e tyre në Sajgon duke ruajtur të paprekur pushtimin e huaj në Vietnamin e Jugut. Dhe e bëjnë këtë pikërisht në një kohë kur partizanët trima të Vietnamit të Jugut po korrin fitore pas fitoreje, kur ata kanë shpërthyer një sulm të furishëm, i cili shkatërron me sukses çdo rezistencë të qeverisë kukull të Sajgonit dhe të përkrahësve të saj amerikanë, kur imperialistëve të SHBA-së po u rrëshqet toka nën këmbë dhe s'dinë nga të kapen. Me manovrat e tyre revizionistët sovjetikë përpiqen ta dobësojnë këtë luftë, ta asgjësojnë këtë avantazh dhe ta ndihmojnë imperializmin amerikan që ta ndryshojë gjendjen në favorin e tij.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë pretendojnë se ata janë të bashkuar në frontin e përbashkët antiimperialist. Me fjalë mund të jenë, por konkretisht ata janë kundër këtij fronti dhe pro imperializmit. Tani imperialistët amerikanë dhe gjithë përkrahësit e tyre kanë shpërthyer një fushatë të tërbuar duke e akuzuar

Republikën Demokratike të Vietnamit sikur gjoja ajo ndërhyr në punët e brendshme të Vietnamit të Jugut. Në fjalimin e tij Kosigini nuk bëri as më të voglën përpjekje për të demaskuar këtë shpifje të ulët. Heshtja e tij, për të mos thënë më tepër, nuk e ndihmon aspak RD të Vietnamit. Kërkesa që të mos bombardohet më Vietnami i Veriut, ashtu siç është formuluar nga Kosigini, është një lutje e zbehtë drejtuar imperializmit amerikan dhe jo një qëndrim i vendosur revolucionar. Në fakt, kjo kërkesë nuk duket se favorizon ndonjë zgjidhje rrënjësore e përfundimtare të problemit të Vietnamit të Jugut, që, siç e kemi thënë, kondicionohet nga largimi i trupave amerikanë prej andej. Thënia se aktet agresive të imperializmit amerikan nuk do të mbeten pa u ndëshkuar, as i shton as i pakëson ndonjë gjë situatës në Vietnamin e Jugut. Këtë e di mirë edhe imperializmi amerikan, i cili këto «paralajmërime» i ka konsideruar si parulla propagandistike për përdorim të brendshëm.

Imperialistët amerikanë edhe dje kryen përsëri provokacione të rënda, agresive, barbare kundër Republikës Demokratike të Vietnamit, duke bombarduar e mitraluar krahinat e saj. Pyesim Kosiginin: Çfarë do të bëjë ai tani? Apo do të përsëritë frazën e përgjithshme të fjalimit të tij të 26 shkurtit «se në qoftë se imperialistët amerikanë do të vazhdojnë veprimet e tyre agresive kundër Vietnamit socialist, konflikti në këtë rajon të botës patjetër do të dalë nga kuadri i tij fillestar»?

Ne mendojmë se provokacionet e reja të shëmtuara të imperialistëve amerikanë kundër Republikës Demo-

kratike të Vietnamit lidhen ngushtë dhe janë rezultat i inkurajimit që Kosigini u dha atyre me fjalimin e tij të përgjithshëm dhe sa për të kaluar radhën. Mos vallë qeveria sovjetike ka qenë qysh më parë në dijeni të bombardimeve të reja të qyteteve të RD të Vietnamit nga aviacioni amerikan? Nëse po — dhe ne kemi plotësisht të drejtë të mendojmë se ajo ka qenë në dijeni dhe këtë koha do ta tregojë — ne akuzojmë revizionistët sovjetikë se kanë kryer një krim të vërtetë kundër Republikës Demokratike të Vietnamit dhe popullit të Vietnamit të Jugut, duke mos e demaskuar në kohë planin barbar e banditesk të imperialistëve amerikanë.

Popujt paqedashës dhe të gjitha forcat antiimperialiste përkrahin plotësisht qëndrimin e drejtë të RD të Vietnamit, që kurdoherë ka treguar shkaqet e vërteta të gjendjes së sotme në Vietnam dhe rrugën për t'i dhënë fund sa më parë luftës agresive që imperialistët amerikanë zhvillojnë kundër popullit të Vietnamit të Jugut.

«Asnjë përpjekje e agresorëve amerikanë nuk mund t'i shpëtojë ata nga gjendja e vështirë në Vietnamin e Jugut, thuhet në deklaratën e 28 shkurtit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të RD të Vietnamit. Duke ndjekur rrugën e intensifikimit dhe të zgjerimit të luftës agresive, ata s'bëjnë gjë tjetër veçse do t'ia shtojnë edhe më shumë urrejtjen popullit vietnamez, si në Jug ashtu edhe në Veri, dhe do të gjenden përballë disfatah edhe më të rënda.

Qeveria e Republikës Demokratike të Vietnamit kërkon me vendosmëri që qeveria e SHBA-së t'u japë fund menjëherë veprimeve agresive në Vietnamin e

Jugut, të largojë të gjithë trupat dhe armët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të satelitëve të saj, të ndalojë të gjitha veprimet e luftës kundër Republikës Demokratike të Vietnamit dhe të zbatojë me korrektesi marrëveshjet e Gjenevës, për Vietnamin, të vitit 1954».

Kjo kërkesë e RD të Vietnamit është e vetmja rrugë që mund të çojë në një zgjidhje të drejtë e efektive në Vietnam.

Politika revizioniste e udhëheqësve sovjetikë, e mbërthyer në batakun e oportunizmit dhe të kapitullimit, ndodhet tani në një krizë të rëndë. Fjalimin e Kossiginit shtypi borgjez e quajti «të moderuar», siç duket, për të mos e quajtur oportunist, ose refleks të qëndrimin në bisht të politikës së Uashingtonit, Londrës e Parisit. Politika e sotme e jashtme sovjetike, e privuar nga çdo iniciativë, po tjerr leshin që i jep borgjezia imperialiste. Në fakt, ajo tani nuk ka një fytyrë të përcaktuar të sajën dhe, në më të shumtën e rasteve, zvarritet pas iniciativave perëndimore, duke u munduar të mos u dalë atyre përpara ballë për ballë, të evitohet ndeshjet që mund ta detyrojnë të mbajë qëndrime politike të qarta, të mënjanohet çdo hap për të marrë përgjegjësi të madhe ndërkombëtare.

Kjo vijë oportuniste tërheqjesh, lëshimesh e kompromisesh pa parim e udhëheqjes së re revizioniste sovjetike duket më qartë tani në qëndrimet që ajo mban ndaj problemeve kryesore që shtrihen në rendin e ditës të marrëdhënieve ndërkombëtare lufta nacionalçlirimtare e popujve të robëruar. Kjo luftë është sot strumbullari dhe faktori kryesor që ushtron influencën më

të madhe në thellimin e mëtejshëm të krizës politike të imperializmit.

Tani, kur si rezultat i rritjes së luftës së gjithanshme të popujve kundër imperializmit, kolonializmit e neokolonializmit dhe i pamundësisë së këtyre për ta shtypur atë me forcën e armëve e të dollarëve, imperialistët mundohen të thurin gjithfarë manovrash e intrigash, të bëjnë lloj-lloj propozimesh për të fituar kohë dhe për të mashtruar popujt. E vetmja politikë e drejtë dhe konsekuente që mund të ndjekin revolucionarët, është të ndihmohet me vendosmëri dhe me të gjitha mjetet lufta çlirimtare e popujve, të demaskohen manovrat dhe intrigat e imperialistëve.

Por ndaj kësaj situatë dhe ndaj këtyre detyrave revolucionare udhëheqësit revizionistë sovjetikë mbajnë një qëndrim oportunist, disfatist, kapitullues. Ata mundohen të kapen pas ndonjë «propozimi» të Shteteve të Bashkuara, ose të aleatëve të tyre, dhe ta zhvillojnë e ta paraqesin atë pastaj me gjuhën revizioniste, me qëllim që të gënjejnë popujt dhe të ndihmojnë agresorët imperialistë.

I tillë është qëllimi i Kosiginit kur ai, duke i bërë jehonë «propozimit për bisedime» të përpunuar nëpër kancelaritë e fuqive të mëdha perëndimore, nuk kërkon tërheqjen e trupave amerikanë nga Vietnam i Jugut. Kërkesat e tij të vakëta për të dënuar provokacionet kundër RD të Vietnamit kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen nga fakti se revizionizmi hrushovian bashkohet me imperializmin amerikan për ta zgjidhur problemin e Vietnamit të Jugut nga «pozitat e forcës» të Shteteve të Bashkuara. Ato synojnë të mashtrojnë po-

pujt duke krijuar përshtypjen sikur gjoja edhe revizionistët përkrahin çështjen e drejtë të popullit vietnamez.

Por sado demagogji që të bëjnë revizionistët hrushovianë, sado marifete që të përdorin për të fshehur bashkëpunimin dhe përkrahjen që ata i japin imperia- lizmit amerikan për realizimin e planeve të tij agre- sive kundër lirisë e pavarësisë së popujve, ata nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë në gjendje që gënjeshttrat t'i shesin për të vërteta. Siç ka ndodhur deri më sot, edhe në të ardhmen, zhvillimi i luftës nacionalçlirimtare të popujve, rritja e hovit antiimperialist, ngjarjet e përditshme në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare do t'ua grisnin edhe më keq maskën dhe si kurdoherë do të dalë në shesh fytyra e tyre e vërtetë, fytyra e tradhtisë së interesave të larta të revolucionit dhe të paqes.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 52 (5148), 3 mars 1965

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 216. Tiranë, 1965

SHKOLLA JONË ËSHTË POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 mars 1965

Lidhur me edukimin ideopolitik të rinisë së shkollave të mesme e të larta, në fjalën time do të përpiqem të mos zgjerohem në drejtim të detyrave që kanë shoqëria dhe organizata e BRPSH, po do të përqendrohëm në punën që bën e duhet të bëjë shkolla.

Këtë çështje nuk duhet ta nënvleftësojmë e ta lëmë pas dore, se është një nga bazat e rëndësishme të edukatës së rinisë, të nxënësve që ndjekin shkollat gjersa mbarojnë universitetin. Kjo është njëkohësisht një edukatë ideopolitike, shkencore dhe teknike nga më të rëndësishmet, mbi të cilën reflektohet edukata e shoqërisë sonë socialiste.

Dihet se në shkollë nxënësi nuk merr vetëm edukatë teknike. Shkolla jonë nuk është një shkollë apolitike, ajo është shkollë ideopolitike dhe teknike. Bile ne

1 Një ndër çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi edukimin ideopolitik të rinisë së shkollave të mesme e të larta.

e theksojmë me tendencë epërsinë që ka ana ideopolitike. Edhe shkenca e teknika kanë anën e vet politike. Çdo lëndë që jepet në shkollë ka ideologjinë dhe politikën e saj. Bile edhe matematika, që në pamje të parë duket një lëndë apolitike, në zbatimin e saj i shërben ndërtimit të socializmit, pra nuk është diçka e thatë, e shkëputur nga jeta. Prandaj shkollës, si një mjet i rëndësishëm i shoqërisë sonë socialiste dhe i Partisë, për edukimin ideopolitik të rinisë, jo vetëm duhet t'i japim rëndësi, po të bëjmë që këtë rëndësi ta kuptojnë si duhet nxënësit e studentët, të cilët të edukohen atje me ideologjinë dhe me politikën e Partisë sonë. Këtij qëllimi i shërbejnë mësuesit, pedagogët, tekstet, e gjithë puna mësimore-edukative e shkollës, natyrisht edhe organizata e rinisë; që të gjitha këto drejtohen e frymëzohen nga Partia.

Po unë këtu dua të flas veçanërisht për tekstet dhe për punën e mësuesit. Ne, në fakt, u japim nxënësve në duar libra, që ata të mësohen dhe të edukohen politikisht, ideologjikisht dhe të formohen shkencërisht, po përmbajtjen e tyre do ta interpretojë dhe do t'ua fusë të rinjve në kokë dhe në zemër mësuesi. Prandaj me mësuesit Partia dhe rinia duhet të punojnë politikisht brenda dhe jashtë shkollës, me qëllim që ata këtë ushqim ta japin si duhet dhe nxënësit ta përvetësojnë sa më mirë.

Programet që ne përgatitim, nuk ka dyshim se kanë dhe do të kenë përmirësime. Por, ndonëse nuk i njoh në hollësi, dua të shpreh mendimin tim se këto programe nuk janë të përkryera dhe të plota.

Edhe tekstet, sidomos ato të lëndëve shoqërore,

të historisë, të gjeografisë, të letërsisë, me përjashtim të marksizëm-leninizmit, që e kemi të përcaktuar mirë, më duket se duhet të përpunohen vazhdimisht dhe kështu të përmirësohen më tej. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës për këtë qëllim të zgjedhë njerëzit më të mirë, jo vetëm nga ana pedagogjike po edhe politike e ideologjike, që këta të kuptojnë se shkolla jonë është shkollë politike dhe ideologjike.

Ne duhet të largohemi edhe nga formulat e shumta nëpër tekstet tona. Me këto, tekstet tona, janë të rënduara shumë, gjë që nuk është e përshtatshme për rininë. Pra, ne duhet të ruhemi si nga formulat e shumta të huajtura nga tekstet sovjetike, gjë që nuk është as pedagogjike, ashtu dhe nga metoda borgjeze e përgatitjes së programeve dhe të teksteve.

Të marrim historinë që jepet në shkollat tona. Në qoftë se në tekstet e kësaj lënde pasqyrohen si duhet politika dhe ideologjia e Partisë sonë, ne do t'i kemi formuar drejt djemtë dhe vajzat e popullit. Për shembull, kur bëjmë tekstin e historisë së kohës së vjetër, ku paraqitet edhe historia e Romës, duhet të insistojmë që nxënësit, krahas idesë së përgjithshme mbi Perandorinë Romake dhe tendencën e rënies së saj, të mësojnë edhe luftën e skllëverve, me qëllim që, në këtë vazhdë, të mund të kuptojnë formacionet me klasa, rolin e secilës klasë në këto formacione, luftën e klasave që është fill i kuq i gjithë materializmit historik. Këtë, në një shkallë të caktuar, e kanë shprehur edhe historianët, filozofët, letrarët dhe njerëz të tjerë të shquar, të cilët kanë vënë në dukje zhvillimin materialist historik të epokës në të cilën kanë jetuar.

Kështu në shkollën tonë nëpërmjet teksteve duhet t'u mësojmë nxënësve jo vetëm formulat dhe historinë e përgjithshme, që nga lashtësia e deri më sot, por me tendencë t'u mësojmë atyre edhe konceptin marksist-leninist të zhvillimit materialist të historisë.

Kam parë edhe disa tekste të shkollës franceze. Sido që këto janë borgjeze, kam vënë re se, për shembull, ai i historisë u është përshtatur deri diku situatave të sotme të Francës, tashmë të ndryshme që nga koha kur kemi bërë ne shkollën. Francezi tani nuk mund të përdorë tekstet që ishin përgatitur në kohën tonë mbi historinë e Romës. Dyzet vjet më parë ndjenja e kolonializmit ishte e zhvilluar në kulm, kurse sot jo vetëm që popujt kanë ecur përpara, po dhe vetë fëmijët francezë nuk kanë ato pikëpamje që kishin prindërit e tyre kur ishin fëmijë. Prandaj autori ua përshtat tekstin pikëpamjeve të kohës. Ai krahas tekstit, me tendencë bën edhe një përmbledhje për çdo epokë, natyrisht kjo sipas moshës për të cilën përgatitet teksti, meqenëse ai që përgatitet për të rinjtë nuk ka as gjëra të tepërta as filozofi të madhe. Në këto përmbledhje autori fut për ilustrim edhe copëza nga Tit Livi, Zhjuvenili¹ etj.

Në hartimin e teksteve tona më duket se nuk veprohet gjithmonë kështu, por shpesh ngjarjet historike, luftërat dhe pushtimet shpjegohen në vija të trasha dhe, kur vjen puna që të shpjegojmë në to zhvillimin dhe kontradiktat shoqërore, fusim nga një formulim të thatë, në vend që të zgjedhim pjesë me tendencë për të shpjeg-

1 I pari, historian i dëgjuar romak, i dyti, poet satirik romak.

guar më mirë kontrastin e zhvillimit shoqëror të epokës për të cilën bëhet fjalë.

Historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore gjer në klasën e 11-të, ku jepet marksizëm-leninizmi, në rast se nuk bëhet kështu, duhet parë. Përse të ketë djem dhe vajza të ne që të mos dinë mirë ç'janë klasat, ç'është borgjezia, ç'është proletariati, lufta klasore etj., etj.? Të kemi parasysh që këto t'ua mësojmë më mirë edhe mësuesve, sidomos atyre që janë të rinj dhe që sapa kanë dalë nga shkolla. Mjaft gjëra, për arsyet që dihen, atyre u janë dhënë shkurt, se nuk kishim si bënim ndryshe.

Përveç këtyre që thamë, në tekst çdo epokë e historisë duhet të ilustrohet me pjesë nga vepra të shkrimtarëve, të historianëve, të filozofëve më të shquar të kohës. Ne duhet të zgjedhim për këtë qëllim ato pjesë që na nevojiten për edukimin ideopolitik të rinisë shkollore në rrugën e materializmit historik. Teksti i historisë të korrespondojë me letërsinë dhe kjo të korrespondojë me epokën. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë zhvillimin materialist të historisë. Një gjë e tillë bëhet nëpërmjet ngjarjeve historike, zhvillimit social, por edhe nëpërmjet zhvillimit të letërsisë, të artit etj. Kjo duhet të jetë si mbështetje për të ilustruar zhvillimin e njerëzimit. Njëkohësisht në letërsi duhet të orientojmë nxënësit jo në mënyrë të njëanshme, po të shumanshme mbi mendimet e filozofëve e të shkrimtarëve, të mos u flasim vetëm për elementët përparimtarë. Që t'i bëjmë të rinjtë tanë më të kalitur, nuk duhet të neglizhojmë që ata të njohin edhe pikëpamjet e kundërshtarëve të përparimit, që është bërë në zhvillimin

e mendimit, si në letërsi, në histori etj., duke i kritikuar dhe demaskuar këto nga pozitat tona marksiste-leniniste. Historia e njerëzimit nuk ka ecur si në vaj, gjatë zhvillimit të saj ka pasur luftëra nga më të ndryshmet, me armë dhe me ideologji.

Në tekstet e hartuara të historisë letërsia duhet të shfrytëzohet si një pasqyrë për ilustrimin e zhvillimit historik të ideve. Në qoftë se e bëjmë në këtë mënyrë punën, ne do të arrijmë ta kemi shkollën tonë me të vërtetë ideopolitike, ku të kaliten njerëz me kulturë të përgjithshme, me ideologjinë marksiste-leniniste, të aftë të luftojnë me vështirësitë e jetës. Duke u shtuar këtyre edhe marksizëm-leninizmin që mësohet në shkollat e mesme e që pastaj vazhdohet të mësohet më gjerë në universitet, në shkollat e tjera të larta si dhe në jetë, njerëzit tanë do të kenë sumumin e dijenive të nevojshme për jetën.

Në tekstet përkatëse, në çështjen e luftës antikoloniale, të trajtohen probleme të historisë së popujve të rinj që kanë dalë dhe po dalin në arenën ndërkombëtare. Kjo ka rëndësi shumë të madhe dhe tregon për një ndryshim jo vetëm të hartës së botës, por edhe të mendimit njerëzor, në idetë, në luftën e deritanishme. Në shkollat borgjeze akoma flitet si të zaptohen këta popuj, se ata qenkan «të egër», «inJORANTË» dhe himnizohet shtypja nga ana e tyre mbi këta popuj. Ne nuk duhet të mjaftohemi vetëm me propagandën që bëhet jashtë shkollës për këtë çështje. Duhet që edhe në tekstet tona të historisë, të gjeografisë, të letërsisë etj. të zhvillohet kjo rrymë antikoloniale e kohës. Ky do të

ishite plotësim i një boshllëku të madh në mësim mbi zhvillimin materialist të botës.

Tani të vijmë te çështja e punës së mësuesit. Kjo ka rëndësi të madhe. Ç'duhet bërë me mësuesit? Ne nuk mund të pretendojmë që mësuesit tanë të jenë të tërë të përsosur. Të vjetrit më me eksperiencë iu lënë vendin të rinjve. Një shkollë është me tradita, një tjetër është me më pak tradita. Sidoqoftë të rinjve duhet t'u jepet një formim sa më i drejtë. Këtë formim në radhë të parë e bën shkolla. Prandaj çështja e shkollave pedagogjike dhe e teksteve të ne duhet të shihet mirë, me kujdes, me qëllim që mësuesi i ardhshëm të marrë atje një bazë të shëndoshë kulturore dhe një përgatitje ideopolitike marksiste-leniniste.

Shumë seminare bëhen me mësuesit. Mundet që të tëra këto seminare janë me vend, po mendoj se seminare të metodike për të instruktuar si jepen mësimet, nuk janë të mjaftueshme. Ne duhet t'u bëjmë arsimtarëve seminare të veçanta si të zhvillojnë historinë, letërsinë, muzikën etj. dhe me to të plotësojmë edhe boshllëqet e teksteve. Me tendencë në këto seminare t'u mësojmë arsimtarëve punën që duhet të bëjnë. Po këto seminare duhet të përgatiten mirë, të mos bëhet në to propagandë boshe, ndryshe do të jetë më mirë të mos zhvillohen fare. Seminaret të jenë të kualifikuara për çështje dhe epoka të veçanta dhe në to të diskutohen probleme që jemi të bindur se në tekste mungojnë. Kështu mësuesit që ka boshllëqe nga shkolla, njohuritë mundet dhe duhet t'ia plotësojmë e t'ia zgjerojmë me referate e seminare pedagogjike dhe metodike.

Shokët e Partisë në bazë duhet të mendojnë se si

t'u vijnë sa më mirë në ndihmë mësuesve. Për sa u përket çështjeve pedagogjike e metodike, nuk ka dyshim, mësuesi është shumë më kompetent se sekretari i organizatës-bazë të Partisë, aty ku sekretari nuk është mësues. Por ky i fundit duhet t'i mbledhë mësuesit, t'i nxitë, t'u hapë perspektivë. Ai duhet të bëjë me ta mbledhje dhe të shikojë nëse puna e tyre është e nivelit që kërkohet, nëse është e nevojshme për nxënësit ajo që bën mësuesi etj. Për të tëra këto duhet të interesohen sekretarët e komitetit të Partisë që merren me problemet e arsimit dhe të kulturës. Sekretari i komitetit të Partisë duhet të merret seriozisht me përmbajtjen e punës së shkollës dhe jo të interesohet vetëm për disa çështje të tilla si sa është kalimi i nxënësve, sa kanë mbetur në klasë, probleme të bazës materiale etj. Mendoj se puna e sekretarit të Partisë nuk mund të kufizohet vetëm këtu.

Partia duhet t'u zhvillojë mësuesve dituritë gjithë jetën, prandaj duhet të zhvillojë vazhdimisht një punë shumë të madhe e të gjithanshme me ta, se nuk ka mundësi që njeriu të marrë gjithçka në dy, tre ose katër vjet shkollë. Në qoftë se bëhet një gjë e tillë, në qoftë se mësuesit do t'i ushqejmë vazhdimisht politikisht e ideologjikisht, ne do të arrijmë të kemi suksese të mëdha. Këtu e kam më shumë çështjen në rolin që duhet të luajnë ata për përgatitjen ideopolitike të nxënësve nëpërmjet mësimeve për formimin ideologjik dhe të pikëpamjeve të drejta politike të tyre.

Mendoj se në zhvillimin e dijeve dhe në edukimin ideopolitik të nxënësve, sidomos në shkollat e mesme, në përgjithësi nuk duhet të shkojmë nga specializimi.

Në specializim nuk duhet synuar në rryma e në formula, në nuanca shkollash të veçanta, po për edukim të përgjithshëm. Nxënësve ne duhet t'u japim një arsim të shëndoshë, që t'i ndihmojë ata të zhvillojnë më tej kulturën e tyre në jetë, por në rrugë të drejtë. Të mos futemi andej-këtej në rrymat e në shkollat e ndryshme. Asnjë nga ne nuk është në gjendje të numërojë dhe të bëjë përcaktime në hollësi për të gjitha këto rryma e shkolla, kurse këtë shpesh ua kërkojmë nxënësve. Kjo nuk është e drejtë. Prandaj arsimi, mësimi, edukimi, i trajtuar dhe i paraqitur mirë në tekste, është një nga bazat e edukatës së drejtë ideopolitike të nxënësve. Nuk duhet t'i rëndojmë nxënësit me gjëra të tepërta e të vështira.

Për mësuesit bëjmë pak në drejtim të ngritjes së tyre profesionale. Ne duhet të përgatitim në mënyrë shkencore monografi, metoda të veçanta shkencore për dhënien e mësimeve, disa libra metodikë, sidomos për lëndët shoqërore, me shembuj konkretë se si mësuesi ta zhvillojë këtë apo atë mësim. Edhe shkolla borgjeze i kushton rëndësi dhe kujdes kësaj çështjeje.

Duhet të mendojmë mirë që të përgatiten tekste të tilla me qëllim që t'i ndihmojmë mësuesit në lëndët që japin. Kjo gjë do të vlejë shumë për ata që, sa mbarojnë shkollat, shkojnë në fshatra të largëta.

Ka ardhur koha që në shkolla të vihet lënda «Edukatë komuniste» ose «Edukatë morale». Mendoj që kjo lëndë të zhvillohet që nga klasa e 5-të ose e 6-të. Qysh në këtë moshë fëmija duhet të dijë disa nga tiparet e moralit tonë dhe të kuptojë ç'është e huaj për ne. Këto duhet t'i njohë brezi i ri që po formohet. Deri në klasën

e 8-të, për shembull, mund të bëhet lënda e moralit komunist. Kjo punë duhet të zhvillohet në mënyrë shkencore, jo me formula të mëdha, bile kur t'u flitet të rinjve, për shembull, që vjedhja është një akt i shëmtuar, për ilustrim në tekst të zgjedhim jo vetëm pjesë nga të shkrimtarëve të huaj, por sidomos të shkrimtarëve tanë, pasazhe ku ky ta ketë konkretizuar çështjen e vjedhjes si një të keqe të madhe. Kështu i riu pas formulimit përkatës lexon edhe tekstin dhe e kupton më mirë problemin. Po kështu të veprohet edhe kur bëhet fjalë për ndihmën dhe respektin ndaj më të rriturve etj. Mendoj se një gjë e tillë është mirë të bëhet.

Për mendimin tim çështja e edukatës morale ose qytetare duhet të shihet e të diskutohet. Pavarësisht se në shkollat tona jepet lënda e marksizëm-leninizmit, fjalën e kam për nxënësit e vegjël, të cilët duhet të mësojnë për heronjtë, për demokracinë, për ndershmërinë etj. Kur i riu dhe e reja mbush 16 vjeç, merr letërnjoftimin, atëherë ai ose ajo duhet të dijë dhe të ketë mësuar diku ç'është letërnjoftimi, ç'është shteti, ç'janë këshillat popullorë, ç'është ligji, cilat janë detyrat e shtetasve ndaj shtetit, cilat janë forcat e mbrojtjes sonë popullore, si t'i duam ata etj., pra t'u flitet atyre për këto në mënyrë të thjeshtë dhe jo t'u bëhet filozofi. Gjëra të tilla të thjeshta mund të mësohen.

Për të gjitha këto një rëndësi të madhe ka mësimi i historisë së popullit tonë. Mua më duket se s'duhet të qahemi se nuk e dimë të kaluarën e lashtë të popullit tonë, se nuk kemi dokumente etj., por ato që kemi të përpiqemi t'i shfrytëzojmë. Për këtë mendoj se në përgjithësi, gjatë këtyre njëqind vjetëve të fundit, gjer në

kohën e sotme ne kemi hartuar tekste e kemi zbuluar dokumente në bazë të të cilave do të mundim ta zhvillojmë historinë e vendit tonë sipas koncepteve marksiste-leniniste, në mënyrë që nxënësit ta përvetësojnë si duhet atë. Pra me historinë e vendit tonë ne jemi në gjendje jo vetëm t'i pajisim nxënësit me dijeni për të kaluarën e popullit tonë, po duke u bërë sidomos mësimin mbi Luftën Nacionalçlirimtare të periudhës pas Çlirimit t'u zhvillojmë atyre edhe historinë e Partisë e t'u fusim në kokë dhe të drejtat e detyrat qytetare të njeriut tonë.

Në tekstet e historisë që do të përdorim duhet të zërthojmë disa momente, për të cilat e shohim të domosdoshme të sqarojmë gradualisht nxënësit e shkollave të mesme, si për shembull ç'domethënë borgjezi, klasë, proletariat, luftë klase etj. Për klasat e ulëta ne duhet t'i nxjerrim këto që thashë, t'i fusim në pjesën përkatëse të historisë që mësohet në klasat e tetëvjeçares dhe këto t'ua japim nxënësve në mënyrë të kuptueshme. Gradualisht, duke zhvilluar mirë historinë tonë në shkollat, me këtë horizont dhe ndërtim marksist-leninist, nxënësi do të ndihmohet për të kuptuar më thellë edhe historinë botërore që do ta mësojë më vonë, ai nuk do të hutohet, për shembull, kur të mësojë ç'është borgjezia e një vendi kapitalist që po rritet, do të kuptojë se kjo borgjezi që po zhvillohet, mbyl revolucionet etj., sepse ai do të jetë i njohur me këto koncepte. Në qoftë se ne i japim nxënësit formulime për formulime, zëre se nuk i kemi dhënë asgjë. Në këtë drejtim mendoj të përpiqemi të bëjmë diçka më të mirë.

Çështje tjetër është edhe puna jashtë shkollës me

rininë. Unë ua kam thënë edhe herë të tjera shokëve të rinisë dhe nuk mendoj se s'punohet në këtë drejtim, po këto gjëra duhen bërë edhe më mirë. Për punën me rininë tekstet janë të mira, po mund të jenë të pamjaftueshme. Për sa u përket mësuesve, ka prej tyre që nuk merren sa duhet me cdukimin jashtëshkollor të rinisë. Partia dhe organizata e rinisë duhet të organizojnë jashtë orarit të mësimit dhe jashtë shkollës me të rinjtë aktivitete të shumëllojshme, interesante duke aktivizuar mësuesit dhe pedagogët. Më duket se për këto probleme shokët e Partisë dhe të rinisë nuk mendohen thellë dhe nuk e vrasin mendjen të bisedojnë me mësuesit e pedagogët, t'u kërkojnë këtyre të zhvillojnë aktivitete me të rinjtë dhe vetë organizata e rinisë të sigurojë pjesëmarrjen. Për një gjë të tillë nuk punohet sa duhet. Edhe mbledhje të bëhen, po ato të jenë interesante, me lëndë instruktive dhe tërheqëse, ndryshe nuk vjen asnjëri. Kjo ka rëndësi të madhe. Kur një mësues a pedagog flet në një mbledhje, kjo konsiderohet një gjë shumë e rëndësishme si për prestigjin e vetë atij, ashtu edhe për edukimin e nxënësve e të studentëve. Po të merret kjo punë mirë në dorë nga ana e Partisë, atëherë çdo mësues a pedagog do të ishte i gatshëm të fliste përpara rinisë për një problem me rëndësi dhe kjo do të ishte një punë e lavdërueshme.

Mua më duket se në punën tonë me rininë ka shfaqje të dogmatizmit; edhe në organizatat e Partisë, edhe në ato të rinisë ka formula dhe kallëpe pune. Këto nuk janë të mira. Për rininë sidomos çështja është pak delikate. Të gjithë kemi qenë në shkollë dhe kur kemi mbaruar të mesmen kemi ndierë njëfarë lirie, sikur

dolëm në një botë tjetër; pra e kam fjalën për ndjenjat e të riut. Sot, në regjimin tonë socialist, i riu që mbaron shkollën, ku ka disiplinë dhe rregull, ndien jo vetëm ato që kemi ndierë ne, por ndien edhe atë që është i ri i një vendi socialist, i ri i një bote krejt tjetër nga ajo e brezit tonë. Në këto kushte, me formula dhe me metoda të papërshtatshme, mund t'i pritet rinisë hovi dhe dashur pa dashur i mpihen asaj edhe ndjenjat e lirisë që pret të ketë pas mbarimit të shkollës së mesme dhe daljes në jetë.

Edhe në diskutimet që organizohen në rini ka mundësi të ketë më shumë debate. Përse disa të rinjve që kanë të meta të mos u vëmë përballë në mbledhje të mirët që janë të shumtë dhe midis tyre të bëhet një diskutim i lirë, i orientuar, që të sqarohet secili? Nuk mjafton që njerëzit të këshillohen veç e veç, por është e nevojshme të diskutohet për ta në kolektiv, ku të zhvillohen debate e të shfaqen mendime lirisht. Njëri mund ta ketë të drejtë një mendim, po tjetri e ka ndryshe nga mendimi i sekretarit të organizatës-bazë, atëherë përse të lidhet pas mendimit të tij vetëm pse ky është sekretar? Kur një sekretar organizate nuk e lejon tjetrin të shfaqë mendimin e vet, dhe lejon që të flasim vetëm një e dy njerëz në mbledhje e të tjerët heshtin, kjo mënyrë pune krijon një situatë të vështirë në organizatë.

Në rast se në mbledhjet e rinisë do të ketë një luftë mendimesh, luftë të së mirës kundër së keqes, atëherë atje ka gjallëri dhe interes, por në qoftë se i vëmë të rinjtë në gjumë, ne do ta ndrydhim rininë, do

t'u lëmë shteg pëshpëritjeve andej-këtej. Vajzat, pas-taj, ca më pak nuk diskutojnë. Djali fundi, kur del nga shkolla, e ndien veten më të lirë, kurse vajza mbyllet në shtëpi, se vërtet e lirë është ajo në vendin tonë, po e kaluara rëndon akoma mbi të, një fjalë e keqe që thuhet ka pasoja. Prandaj, në qoftë se ne do të zhvillojmë një punë masive, të gjerë, të gëzuar, shkencore, në qoftë se do të bëhen diskutime të hapëta dhe të sinqerta në mbledhjet e rinisë, do të krijohet mundësia edhe për vajzën të flasë e të diskutojë.

Rëndësi ka për të rinjtë dhe zgjedhja e profesionit në jetë. Me një punë të tillë siç bëhet sot mund të krijohet dhe do të krijohet tendenca të të rinjtë e shkollave për t'u futur në zyra. Edhe ata që kanë me të vërtetë një zanat, qofshin teknikë, mjekë e të ndonjë profesioni tjetër, do të përpiqen ta kthejnë atë në një punë administrative, për të bërë një punë pa kokëçarje. Disa të rinj ose të reja mendojnë të bëhen mësues, se ashtu kanë më shumë pushim etj. Pra ka rrezik që në një jetë joluftarake dhe të paorganizuar mirë përpjekja për zgjedhje të profesionit të krijojë tendencën që jo vetëm nxënësit e studentët të pëlqejnë degët e administratës, po edhe të tjerët të kthehen me sy nga administrata, ku, sipas tyre «po zure një vend e ke të siguruar që nuk lëviz». Prandaj një punë ideopolitike e organizuar më mirë në shkolla do të bëjë që të kemi rezultate më të mira në edukimin e rinisë.

Së fundi mendoj se këto që thanë ata që morën fjalën do t'i kenë parasysh shokët e arsimit dhe të propagandës dhe do t'i studiojnë me kujdes.

Në qoftë se ka ndonjë gjë që del jashtë kuadrit të vendimeve që janë marrë dhe kërkon të merret ndonjë vendim i ri, të na paraqitet projekti, ndryshe të vazhdohet si deri tani me vendimet në fuqi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**KUR NJË POPULL QË LUFTON KA NË KRYE
QEVERINË E TIJ, U THOTË TË TJERËVE SE
AI ËSHTË ZOT NË VENDIN E VET**

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës,
Shy Gjien Guo*

16 mars 1965

Pas përshëndetjeve të zakonshme, fjalën e mori shoku Enver Hoxha.

Shoku ambasador, çështja që dëshiroj të bisedoj me ju ka lidhje me Vietnamin, me luftën që bëhet atje. Për këtë ne kemi një mendim, të cilin e formulojmë duke u mbështetur në të dhënat që kemi për gjendjen në Vietnam, për zhvillimin e ngjarjeve në këtë vend. Vitin e kaluar ne patëm rastin të takoheshim dy herë me shokët e Vietnamit të Jugut. Ata na vunë në dijeni për luftën heroike nacionalçlirimtare të popullit vietnamez, e cila ka marrë proporcione të mëdha dhe po zhvillohet me heroizëm e sukses të madh.

Me ambasadorin e Republikës Demokratike të Vietnamit unë kam pasur vetëm një takim. Ai më foli në përgjithësi se lufta atje është e ashpër, por, sipas të

dhënave më konkrete që na u dhanë gjatë dy takimeve nga shokët e Vietnamit të Jugut, tani jemi më mirë në dijeni se shumica e territorit të Vietnamit të Jugut është çliruar, domethënë ndodhet nën kontrollin e Frontit Kombëtar të Çlirimit, kurse imperialistët amerikanë dhe kukullat e Sajgonit mbajnë vetëm qytetet, disa rrugë kryesore dhe aerodromet, megjithëse edhe këto janë nën goditjet e pareshtura të partizanëve vietnamezozugorë. Duke u bazuar në këto të dhëna ne dalim me konkluzionin, që populli i Vietnamit të Jugut është me Frontin Kombëtar të Çlirimit dhe kundër pushtuesve amerikanë e reaksionit të brendshëm.

Kohët e fundit, partizanët e Vietnamit të Jugut, me luftën e tyre çlirimtare u kanë shkaktuar imperialistëve amerikanë disfata të rënda ushtarake dhe politike. Ata e kanë goditur rëndë armikun jo vetëm në përpjekje të vogla të zakonshme të pareshtura, por kanë arritur të shkatërrojnë edhe avionë, kanë fituar beteja të tëra. Veç kësaj, politika e Frontit Kombëtar të Çlirimit ka demaskuar dhe ka tronditur gjendjen e kukullave të Vietnamit të Jugut. Atje po bëhen puçë të njëpasnjëshme për të sjellë në fuqi kukulla të reja. Kjo tregon se udhëheqja reaksionare e Sajgonit është diskredituar plotësisht si vegël e amerikanëve dhe nuk bie fare erë qeveri kombëtare. Por politika e Frontit Kombëtar të Çlirimit u ka shkaktuar disfatë të rëndë imperializmit amerikan dhe kukullave të Sajgonit edhe në atë pjesë të borgjezisë dhe të elementëve fetarë budistë që janë nën ndikimin e të ashtuquajturës qeveri të Sajgonit. Prandaj edhe në këto shtresa tani në Viet-

nam ka lëvizje antiamerikane, kundër Khanit¹ e shërbëtorëve të tjerë si Khani.

Pra lufta nacionalçlirimtare e popullit vietnamez ka krijuar një situatë shumë të favorshme për çlirimin e Vietnamit të Jugut. Këtu, edhe brenda në gjirin e reaksionit po zien kazani dhe kjo tendencë është në ngjitje. Kjo, mendojmë ne, sipas gjithë këtyre të dhënavë, është një moment shumë i favorshëm. Sigurisht, ky është rezultat, në radhë të parë, i vetë luftës së popullit vietnamez, i politikës së drejtë të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut, i ndihmës së Republikës Demokratike të Vietnamit, por gjithashtu edhe i ndihmës së madhe materiale, i përkrahjes e i mbështetjes kolosale edhe në fushën politike në favor të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut që bëhet nga të gjithë marksistë-leninistët, popujt dhe opinioni publik botëror.

Tani po shohim se imperialistët amerikanë, të ndodhur përpara disfatave të rënda, kërkojnë ta zgjerojnë luftën edhe në Vietnamin e Veriut dhe për këtë qëllim ata kanë filluar bombardimet në Veri. Këto bombardime tani po bëhen thuajse çdo ditë ose çdo dy ditë. Natyrisht, ne e dimë ku drejtohen qëllimet e tyre, ato synojnë larg. Duke parë se pozitat e tyre në Vietnamin e Jugut janë të humbura, ata bëjnë plane ta zgjerojnë luftën jo vetëm në Vietnamin e Veriut, por në të gjithë Indokinën dhe të krijojnë, si të thuash, që nga India një kordon zjarri rreth Kinës. Por planet e tyre

¹ Nguyen Khani — në atë kohë kreu i qeverisë kukull, vegël e imperialistëve amerikanë.

do të dështojnë. Këto plane e përpjekje të amerikanëve janë të dëshpëruara, sepse, sipas mendimit tonë, ato as nuk i kanë frikësuar dhe as nuk i frikësojnë popujt që duan dhe luftojnë për lirinë e pavarësinë e tyre. Por, kuptohet, amerikanët s'kanë si bëjnë ndryshe, kështu do të veprojnë ata gjersa të hanë grushtin vendimtar.

Revizionistët modernë sovjetikë po i vijnë në ndihmë kësaj veprimtarie armiqësore të imperialistëve amerikanë. Tradhtinë e revizionistëve sovjetikë, partitë marksiste-leniniste e kanë shumë të qartë, sepse kanë shumë fakte në dorë. Ne nuk gabohemi kur themi se revizionistët sovjetikë janë në ujdi të plotë me imperialistët amerikanë për të arritur që të përfundojë me kapitullim lufta e popullit të Vietnamit të Jugut. Ata duan që me këto veprime të influencojnë për kapitullim edhe te shokët e Vietnamit të Veriut. Këtë synim pati me siguri edhe revizionisti Kosigin, që vajti tani së fundi në Vietnam, për të mbjellë te shokët e udhëheqjes së Vietnamit të Veriut frymën e bisedimeve me imperialistët amerikanë. Por, me sa shohim, vija e shokëve të Vietnamit të Veriut është në unitet me atë të atyre të Jugut dhe karakterizohet nga qëndrime të drejta antiimperialiste. Populli i Vietnamit të Jugut dhe të Veriut dhe Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut nuk janë për bisedime, siç duan revizionistët dhe imperialistët, ata kanë pikëpamje të drejta revolucionare. Ky është mendimi ynë.

Megjithatë nuk duhet nënvleftësuar rrezikshmëria e politikës dhe e demagogjisë së shfrenuar të revizionistëve hrushovianë ndaj Vietnamit. Ata punojnë natë e ditë që populli vietnamez dhe udhëheqja e tij,

të kenë shpresa të «ndihma» e sovjetikëve, megjithëse kohë më parë këta u kanë dërguar atyre vetëm disa armë të vjetra.

Demonstratat antiamerikane, që u bënë në Moskë dhe në Leningrad nga studentët e huaj të të gjitha kontinenteve që studiojnë në BS, ishin një aksion i madh e i drejtë dhe patën një jehonë të gjerë në botë. Studentët u plagosën, u rrahën, u shtypën nga policia sovjetike dhe me këtë u vërtetua se revizionistët sovjetikë janë dakord me imperialistët amerikanë. Shokët vietnamezë na thanë se vetëm në demonstratën e Moskës janë rrahur e janë plagosur më shumë se 100 studentë vietnamezë. Për këtë veprim armiqësor ndaj Vietnamit duhet ta ngrenë zërin të gjithë dhe të mos heshtin të shtyrë nga frika se mos prishin qejfin dhe politikën që mund të kenë me revizionistët sovjetikë. Të mbyllësh gojën dhe të mos thuash asnjë fjalë kundër revizionistëve sovjetikë për shtypjen e demonstratës, për trajtimin barbar si në kohën e Carit dhe rrahjen egërsisht të studentëve vietnamezë e kinezë, të Amerikës Latine dhe të Afrikës, të cilët u hodhën në demonstratë për të shprehur solidaritetin e plotë të tyre me Vietnamin, për të shprehur urrejtjen e për të dënuar imperializmin amerikan, është një qëndrim krejt i gabuar dhe në dëm të çështjes së Vietnamit. Në këtë rast, heshtja, sipas mendimit të Partisë sonë, nuk është një veprim i drejtë, sepse, nga njëra anë, me këtë qëndrim u jepen armë revizionistëve sovjetikë dhe, nga ana tjetër, ajo nuk është shprehje e ndjenjave të solidaritetit internacionalist në mbrojtje të luftës çlirim-

tare të popullit të Vietnamit të Jugut kundër imperialistëve amerikanë.

Qëndrime të tilla që e dëmtojnë çështjen e popullit vietnamez u ndeshën edhe në një mbledhje ndërkom-bëtare, që u mbajt kohët e fundit për paqen në Berlin. Revizionistët sovjetikë dhe ata që i pasojnë, natyrisht kërkonin që për Vietnamin e Jugut të nxirrej një rezolutë që nuk ishte as mish, as peshk. Aty u paraqit edhe një rezolutë tjetër që ishte parimisht e drejtë dhe e fortë kundër imperializmit. Në mbledhje u bënë një mijë manovra që kjo rezolutë të mos vihej në votë. Por lufta e përbashkët e forcave të shëndosha në mbledhje, i detyroi revizionistët që ta vinin në votë. Pati përfaqësues shtetesh të interesuar direkt për çështjen e Vietnamit të Jugut apo nga ata që e heqin veten si shokë e miq të popullit vietnamezjugor, që u shkëputën nga ne, abstenuan në votimin e kësaj rezolute, për arsye se, sipas tyre, toni i saj nuk qenkësh i «për-shtatshëm», që do të thotë se nuk ishte revizionist. Pra, në një forum ndërkombëtar ata nuk votuan tok me ne pikërisht për një rezolutë që kishte të bënte me Vietnamin. Kur njëri nga këta përfaqësues që abste-noi në këtë votim, e pyeti përfaqësuesin shqiptar se ç'mendonte për qëndrimin që ai mbajti, shoku ynë iu përgjigj hapur se qëndrimi i tij ishte i gabuar, pasi nuk duhej të mbahej një qëndrim i tillë ndaj popullit të Vietnamit të Jugut. Ai u përpoq të justifikohej, duke thënë se këtë qëndrim ai e mbajti gjoja se kështu do të ndihmonte për të mobilizuar popujt, ashtu siç u bë në luftën e Koresë, por shoku ynë i tha se mobilizimi

i popujve në favor të luftës së popullit të Koresë nuk u bë kështu si po bëni ju, por krejt ndryshe.

Qëndrime të tilla, si këto që thashë, na lënë përshtypjen se demagogjia dhe veprimtaria tradhtare e revizionistëve sovjetikë te disa mund të lërë dhe ka lënë gjurmë, pra, ka influencuar, ku më shumë e ku më pak.

Tani imperialistët amerikanë kanë filluar sulmet ajrore kundër Vietnamit të Veriut, të cilat janë më shumë sulme për shantazh, për të arritur në një qëllim, domethënë t'i bëjnë vietnamezët të kapitullojnë. Këtë shantazh, sikundër e dini, ata e shoqërojnë me fjalët që mund të bisedojnë në rast se qeveria e Hanoit, domethënë Vietnamit të Veriut, jep shenja se heq dorë nga ndihma dhe ndërhyrja në Vietnamin e Jugut. Ky është leitmotivi i imperialistëve amerikanë. Sipas këtyre, Vietnamit të Veriut është ai që ka shkaktuar, ka ndezur dhe ka ndihmuar luftën në Vietnamin e Jugut. Në rast se Vietnamit të Veriut heq dorë nga kjo luftë, atëherë mund të bisedohet, thonë ata. Këtë Xhonsoni e ka shprehur haptazi, bile ia shtroi edhe Titos në telegramin e përgjigjes që i dha dje.

Nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë po zhvillojnë një punë të gjerë diplomatike me amerikanët, me indianët, me Titon, me kryeministrin anglez Uilson, me Dë Golin dhe U Tanin etj. Sot vajti edhe Gromikoja në Londër dhe të tërë këta drejt kësaj çështjeje synojnë: të bisedohet pa kushte, me një fjalë, vietnamezët të kapitullojnë. Me sa dimë ne, nuk mungojnë as ndërhyrjet e hapëta për këtë qëllim. Rapacki i ka thënë ambasadorit vietnamez se vietnamezët duhet ta pu-

shojnë luftën që të mund të ujdiset kjo çështje. Duke u bazuar edhe në deklaratat e Kosiginit, i cili as nuk e përfill fare çështjen që për zgjidhjen e problemit vietnamez kusht kryesor është që imperialistët amerikanë të largohen nga Vietnam i Jugut, lihet të kuptohet se lufta në Jug u varka nga qëndrimi i qeverisë së Vietnamit të Veriut. Me këtë orientim dhe shpresë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë janë të një mendimi. Veprimtaria politike, demagogjia dhe presioni i revizionistëve në arenën ndërkombëtare dhe brenda në udhëheqjen e Vietnamit të Veriut koordinohet me shantazhin amerikan të bombardimit për të arritur që të kapitullojnë, në radhë të parë, shokët e Vietnamit të Veriut, që këta të bëjnë bisedime pa kushte me amerikanët dhe pastaj të influencojnë edhe luftën në Jug.

Partia dhe Qeveria jonë janë në kundërshtim të plotë me planet e imperialistëve amerikanë, që, në bashkëpunim me revizionistët, me ata sovjetikë në krye, synojnë të shtypin popullin e Vietnamit të Jugut. Detyra jonë është t'ua prishim atyre këto plane.

Këto që thashë, shokët kinezë i dinë shumë mirë. Ne mendojmë se përveç ndihmës kolosale që i jep tërë opinionit publik ndërkombëtar luftës së drejtë të popullit vietnamez, vendimtare është lufta që bën vetë populli në Vietnamin e Jugut. Kjo luftë do të luajë rolin kryesor për t'ua prishur planet imperialistëve dhe revizionistëve modernë. Në qoftë se shokët e Vietnamit të Jugut janë për luftën gjer në fund, pa asnjë kompromis, ndihma e madhe e të gjitha vendeve të tjera, ndihma e opinionit publik ndërkombëtar do të

kontribuojë që çështja e popullit vietnamez të triumfojë.

Presioni i madh që bëhet nga imperialistët dhe revizionistët synon të gjunjëzojë luftëtarët e Vietnamit të Jugut. Prandaj ka rëndësi që këta të tregohen të patundur. Këtu dua tani të vij në mendimin që desha t'ju shfaq. Tani, si gjykojmë ne, na duket se është momenti më i përshtatshëm revolucionar që në Vietnamin e Jugut të krijohet qeveria demokratike dhe Fronti Kombëtar i Çlirimit të ekzistojë si një organizatë e madhe politike që ka luajtur dhe do të luajë rolin e saj të madh edhe më vonë. Po të krijohet qeveria demokratike e Frontit Kombëtar të Çlirimit, lufta nacionalçlirimtare dhe populli i Vietnamit të Jugut do të kenë qeverinë e vet që do të drejtojë dhe do të vendosë për çdo gjë.

Përse themi që është momenti më i përshtatshëm për formimin e qeverisë demokratike në Vietnamin e Jugut? Ne mendojmë se momenti është i përshtatshëm duke e parë edhe në aspektin kombëtar, për Vietnamin e Jugut, edhe në aspektin ndërkombëtar.

Në aspektin kombëtar, momenti është i përshtatshëm pasi shumica e territorit të Vietnamit të Jugut është çliruar; ushtria popullore atje është në këmbë, lufton me heroizëm dhe u shkakton disfata armiqve; politikisht populli i Vietnamit të Jugut, në shumicën e vet dërrmuese, është i bashkuar me Frontin Kombëtar të Çlirimit, i cili ka luajtur rolin e madh për bashkimin dhe krijimin e unitetit të forcave brenda vendit; qeveria kukull e Sajgonit është bërë leckë; amerikanët kanë pësuar e pësojnë disfata. Në këto kushte, krijimi

i qeverisë do ta forcojë edhe më shumë luftën e popullit vietnamezjugor dhe autoritetin e saj brenda Vietnamit të Jugut. Krijimi i qeverisë do të ketë gjithashtu një influencë të konsiderueshme, mendojmë ne, edhe në elementët budistë, në grupet e lëkundshme jekomuniste, të cilat, tani që janë në grindje me kukullat e Sajgonit, me krijimin e qeverisë demokratike do të gjenden përpara alternativës që të bashkohen me këtë qeveri e të bisedojnë me të. Qeveria demokratike që do të krijohet do të bëhet një forcë tërheqëse, një forcë e madhe solidariteti e luftës nacionalçlirimtare të Vietnamit të Jugut, me të cilën të gjithë ne do të mbajmë lidhje direkte. Kjo, mendojmë ne, është një anë pozitive.

Në fushën ndërkombëtare krijimi i qeverisë në Jug të Vietnamit do të bjerë si bombë, do t'i çarmatosë amerikanët dhe revizionistët sovjetikë në propagandën që bëjnë kur thonë sikur luftën në Jug e drejton Vietnami i Veriut. Kështu, kur edhe Vietnami i Jugut do të ketë qeverinë e tij demokratike, askush nuk do të mund të luajë dot prapa kurrizit të popullit vietnamez dhe luftës heroike që ai bën. Kjo qeveri do t'u thotë të gjithëve se populli i Vietnamit të Jugut është zot në shtëpinë e vet. Edhe Algjeria gjatë luftës së saj shumëvjeçare ka pasur qeverinë e vet, edhe Kongoja (Brazavil), pavarësisht si është, ka qeverinë e vet, kudo ku zien lufta çlirimtare ka nga një qeveri. Formimi i qeverisë demokratike në Vietnamin e Jugut gjithashtu do t'i forcojë edhe më shumë lidhjet dhe ndihmën tonë për popullin vietnamez.

Ndonjë mund të bëjë pyetjen: «A mund të sjellë

kjo qeveri vështirësi në bashkimin e dy pjesëve të Vietnamit në të ardhmen?». Mendojmë se jo. Përkundrazi, ajo do t'i shtojë këto mundësi, sepse, me siguri, kur atje do të ekzistojë një qeveri e popullit dhe, pasi të hidhen amerikanët në det, çështja e bashkimit të vendit do të mbetet një çështje kohe.

Për të gjitha këto na duket se nga të tëra anët jemi përpara një momenti crucial të favorshëm për formimin e një qeverie demokratike në Vietnamin e Jugut. Këtë mendim e nxjerrim duke u nisur edhe nga eksperiencia. Ne kemi eksperiencën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Edhe ne, gjatë kësaj lufte gjetëm momentin e përshtatshëm kur duhej formuar qeveria dhe pikërisht këtë e bëmë në momente kur armikut push-tues e reaksionit të brendshëm u kishim dhënë grushte vendimtare dhe kur anglezët me amerikanët përpiqeshin të krijonin qeveri kukulla jashtë Shqipërisë për të grumbulluar rreth tyre reaksionin e brendshëm. Pikërisht në këtë kohë ne bëmë Kongresin e Përmetit, ku u morën vendime të rëndësishme, krijuam Qeverinë dhe kështu të gjitha planet e armiqve tanë ranë në ujë.

Si marksistë-leninistë dhe internacionalistë që jemi, ne do t'ua shfaqim këtë mendim shokëve vietnamezë duke u thënë se kështu na mëson eksperiencia jonë dhe ne kështu e gjykojmë gjendjen. Mendimi ynë mund të jetë i mirë ose jo, por ne do t'ua shprehim si shokë, pastaj është punë për ta. Natyrisht ata edhe mund ta hedhin poshtë. Them kështu, sepse edhe mund të mos u pëlqejë një sugjerim i tillë. Por ne, për ta bërë këtë sugjerim, nisemi nga fakti që me shokët vietnamezë jemi shokë lufte të vendosur gjer në fund për

çështjen tonë të përbashkët, për fitoren e plotë të popullit vietnamez, për çlirimin e Jugut dhe bashkimin e vendit, prandaj gjykojmë se këtë mendim e themi për të mirën e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**MBLEDHJA PËRÇARËSE, REVIZIONISTE
E 1 MARSIT — NJË KOMPLOT I MADH
KUNDËR MARKSIZËM-LENINIZMIT
DHE KOMUNIZMIT NDERKOMBËTAR**

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

18 mars 1965

Udhëheqja revizioniste sovjetike dhe ata që e pasojnë kryen një krim të madh kundër lëvizjes komuniste botërore dhe çështjes së socializmit. Pa përfillur paralajmërimet serioze të partive marksiste-leniniste, ata, nga 1 deri më 5 mars [1965], zhvilluan në Moskë mbledhjen e tyre famëkeqe dhe me këtë akt bënë një hap shumë të rrezikshëm drejt përçarjes së plotë e përfundimtare të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Ky veprim ua çori përfundimisht maskën udhëheqësve të sotëm sovjetikë dhe tregoi edhe një herë para tërë botës fytyrën e tyre të vërtetë, provoi se ata janë vazhduesit besnikë të vijës antimarksiste e përçarëse të N. Hrushovit, se ata po vënë në jetë atë që nuk arriti të realizonte kryetari i tyre, provoi se ata, krahas N. Hrushovit e bashkë me të, janë komplotistët e përçarësit më të mëdhenj që ka njohur historia e lëvizjes komu-

niste botërore, revizionistë e renegatë të pandreqshëm të marksizëm-leninizmit, aleatë e ndihmës të imperializmit.

Mbledhja që mbajtën revizionistët në Moskë u zhvillua në bazë të projektit të përpunuar nga udhëheqja revizioniste sovjetike qysh kur në krye të saj gjendej N. Hrushovi. Dihet se, sipas projektit hrushovian, kjo mbledhje, nën emrin e «komisionit të redaktimit», do të mbahej më 15 dhjetor të vitit të kaluar.

Programi i kësaj mbledhjeje u parashtrua me letrën e 30 korrikut 1964 të KQ të PK të BS dhe u aprovua me entuziazëm të papërmbajtur në deklaratat zyrtare të disa partive e udhëheqësve revizionistë. Duke gjuikuar nga platforma mbi bazën e së cilës do të punonte «komisioni», mbledhja kishte për qëllim: të dënonte partitë marksiste-leniniste, veçanërisht PK të Kinës e PPSH, si «dogmatike»; «t'i përjashtonte» ato nga lëvizja komuniste; të përcaktonte «masat kolektive» që duheshin marrë në luftën kundër këtyre partive e marksizëm-leninizmit përgjithësisht. Pra, qëllimi kryesor i mbledhjes do të ishte përçarja përfundimtare edhe në plan organizativ e lëvizjes komuniste. Revizionistët hrushovianë do të merrnin përsipër rolin e «gjuqtarëve të paanshëm» dhe «mbrojtësve të vendosur të marksizëm-leninizmit të vërtetë»! Në mbledhjen e 15 dhjetorit në bazë të platformës së paraqitur në letrën e sipërpërmendur të KQ të PK të BS, «duke marrë parasysh kushtet e reja që janë krijuar në botë», do të përpunohej nga revizionistët një dokument i ri, që do të zëvendësonte Deklaratën e vitit 1960, e cila, sipas revizionistëve, është vjetruar. Midis çështjeve më të

rëndësishme që duheshin rishikuar ishte ajo e rehabilitimit zyrtar të Titos. Më në fund, pasi të përpunonte platformën e re, komisioni do të kishte për detyrë të merrte të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që në verën e vitit 1965 të mbledhej konferenca e përgjithshme e komunizmit botëror.

Likuidimi i N. Hrushovit nga skena politike, si dhe kundërshtimi që ndeshën revizionistët lidhur me organizimin e kësaj mbledhjeje antimarksiste, shkaktuan në fillim shtytjen e saj nga 15 dhjetori për më 1 mars dhe më vonë, në prag të mbledhjes, ndryshimin e emrit të saj në «takim konsultativ të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtores». Pra, ndryshuan vetëm emri dhe koha e mbajtjes së saj, por aspak qëllimet. Kjo mbledhje është realizimi i projektit hrushovian të 15 dhjetorit.

Mbledhja e 1 marsit, ashtu siç e kanë theksuar edhe më parë PPSH dhe partitë e tjera marksiste-leniniste, mbetet një mbledhje krejt e paligjshme, sepse ajo është thirrur në mënyrë arbitrare, pa konsultime me partitë motra, pa marrë pëlqimin dhe pa përfillur kundërshtimin e tyre të vendosur. Ajo përbën një shkelje flagrante të parimeve e të normave të marrëdhënieve midis partive, një shqelmim të Deklaratës së Moskës të vitit 1960. Me gjithë pagëzimin e ri si «takim konsultativ», ajo mbetet përsëri një mbledhje antimarksiste, si çdo mbledhje që bëjnë, me rast e pa rast, për qëllimet e tyre revizionistët, dhe nuk ka asgjë të përbashkët me ato lloj mbledhjesh konsultimi dypalëshe apo shumëpalëshe që rekomandon Deklarata e Moskës.

Mbledhja e 1 marsit, e organizuar nën diktatin e udhëheqjes revizioniste sovjetike, mbetet një mbledhje **përçarëse e fraksioniste** e një grushti udhëheqësish revizionistë, një mbledhje që kishte për qëllim shkallimin e plotë të unitetit të kampit e të lëvizjes komuniste dhe drejtohet kundër partive motra e gjithë revolucionarëve të vërtetë që kundërshtojnë me vendosmëri revizionizmin modern. Kjo është një mbledhje tipike konspiratorësh të regjur, të cilët, nga njëra anë, çirren për «unitet» e «kompaktësi», kurse nga ana tjetër, fshehtazi, mprehin thikat për t'ia ngulur në kurriz revolucionit. Me anën e kësaj mbledhjeje trojka hrushoviane, Brezhnev-Mikojan-Kosigin, u përpoq të ri-grupojë forcat e çakërdisura të revizionistëve, t'i mbajë ato nën kontrollin e saj dhe, bashkë me to, të përpunojë planin e taktikës «më të përshtatshme» për një luftë më efektive kundër marksizëm-leninizmit revolucionar. Kjo ishte një orvatje fillestare për të hedhur bazat e një organizimi të veçantë të forcave revizioniste për luftën kundër marksizmit dhe gjithë revolucionarëve konsekuentë. Në këtë mënyrë udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe aleatët e tyre po ecin me këmbëngulje në rrugën tradhtare të Internacionales së Dytë dhe po bëhen qendra kryesore e falsifikimit të marksizëm-leninizmit dhe e shuarjes së lëvizjes revolucionare në botë.

Më në fund, mbledhja përçarëse e fraksioniste që u mbajt në Moskë është një mbledhje **proimperialiste**, një mbledhje që, në rrethanat e tanishme, u përgjigjet plotësisht planeve e nevojave të imperializmit amerikan. Pikërisht kur imperializmi amerikan ka shpërthyer një

valë të ashpër sulmesh kundër lëvizjes revolucionare e kundër disa vendeve socialiste, kur ai po përpiqet të mbytë me zjarr e hekur luftën çlirimtare të popujve në kontinentet e ndryshme të botës, kur ai po ndërhyr në mënyrë gjakatare në Vietnamin e Jugut, Kongo, Laos, Kamboxhia e gjetkë, kur ai po ndërmerr veprime të rrezikshme për ta shtrirë agresionin e armatosur kundër Republikës Demokratike të Vietnamit, kur më tepër se kurrë ndonjëherë është i domosdoshëm uniteti i paturtur i kampit dhe i lëvizjes komuniste, si qendra e bashkimit luftarak të të gjitha forcave revolucionare, pikërisht në këto momente të rëndësishme revizionistët hrushovianë, duke mbajtur mbledhjen e tyre përçarëse dhe duke përpunuar planet për shkatërrimin përfundimtar të unitetit të lëvizjes, inkurajojnë armiqtë e socializmit e të paqës në aktet e tyre agresive. A ka shërbim më të mirë se ky për agresorët imperialistë?

Partitë marksiste-leniniste janë përpjekur me të gjitha forcat që të evitojnë përçarjen e plotë e përfundimtare, ato kanë luftuar me vendosmëri për të ruajtur unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste. Ato i patën këshilluar më se një herë revizionistët që të hiqnin dorë nga vija dhe veprimet e tyre përçarëse dhe të ktheheshin në pozitën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar. Por më kot. Revizionistët modernë, sidomos hrushovianët, duke ndjekur këshillat e renegatëve titistë e duke bërë lojën e imperialistëve amerikanë, me vetëdije të plotë, hap pas hapi, jo vetëm provokuan përçarjen, por e thelluan atë gjithnjë e më shumë, derisa tani, me mbledhjen frak-

sioniste e komplotiste të 1 marsit, vendosën ta shpien atë deri në fund. Duke organizuar mbledhjen e tyre fraksioniste e përçarëse, revizionistët hrushovianë sovjetikë dhe pasuesit e tyre marrin mbi vete tërë përgjegjësinë e rëndë historike për këtë veprim tradhtar të pashembullt.

Mbledhja antimarksiste e 1 marsit u zhvillua në një kohë kur ylli revizionist është në rënie, kur renegatët kanë pësuar disfatat e para dhe ndodhen para disfatash të reja, akoma më të mëdha. Fakti që revizionistët u detyruan në fillim ta shtyjnë mbledhjen, ndërsa më vonë nuk guxuan e nuk mundën ta bëjnë atë haptazi e me zë të lartë si mbledhje të komisionit të redaktimit, fakti që në mbledhjen e projektuar prej tyre nuk morën pjesë 7 parti (PPSH, PK e Kinës, Partia e Punës e Koresë, Partia e Punonjësve të Vietnamit, Partia Punëtore Rumune, PK e Indonezisë dhe PK e Japonisë) dëshmon për një disfatë të re të revizionistëve hrushovianë.

Revizionistët hrushovianë e ndienë shpejt të keqen: ata po e shohin se dara e marksizëm-leninizmit dhe e revolucionit po mbyllet gjithnjë e më shumë rreth tyre, prandaj, duke ruajtur të gjitha qëllimet që kishte N. Hrushovi me projektin e tij për mbledhjen e 15 dhjetorit dhe duke u përpjekur për t'i zbatuar sa më me besnikëri ato, në komunikatën që botuan më 10 mars, ata nuk i shfaqën qëllimet e tyre armiqtësore me atë ashpërsi që i patën projektuar.

Në këtë komunikatë revizioniste janë pleksur në një të vetme demagogjia, me anën e së cilës revizionistët

përpiqen të mashtrojnë popujt e revolucionarët, frika që i ka mbërthyer renegatët nga drejtësia marksiste-leniniste dhe nga lufta parimore që bëjnë komunistët e revolucionarët kudo në botë kundër revizionizmit, urrejtja e armiqësia që ushqejnë revizionistët kundër komunizmit, revolucionit, popujve e luftës nacionalçlirimtare të tyre. Shkurt, komunikata pasqyron me besnikëri fizionominë aktuale të revizionizmit hrushovian.

Demagogjia kurdoherë ka qenë maskë e preferuar e revizionizmit modern. Por me rastin e mbledhjes së tyre të 1 marsit revizionistët hrushovianë e përdorën atë më me bollëk se asnjëherë tjetër. Në fakt, në një dokument aq të shkurtër u është lënë relativisht shumë vend betimeve të shumta demagogjike mbi preokupacionin e revizionistëve për «unitetin dhe kompaktësinë e lëvizjes komuniste e të kampit socialist», mbi «dëshirën» e tyre për t'u bashkuar gjoja «në luftën e përbashkët kundër imperializmit, kolonializmit dhe neokolonializmit», mbi «përkrahjen aktive» të lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve dhe të luftës për interesat jetike dhe qëllimet historike të klasës punëtore, mbi «respektimin e sovranitetit dhe të integritetit të të gjitha shteteve», mbi «besnikërinë» ndaj marksizëm-leninizmit e internacionalizmit proletar etj., etj.

Toni i përmbajtur dhe thirrjet «patetike» të komunikatës nuk shpjegohen vetëm me demagogjinë e revizionistëve, të cilën ata e kanë profesion, por kryesisht me frikën që kanë nga ballafaqimi i hapët e i drejtpërdrejtë me marksistë-leninistët, me gjendjen e vështirë në të cilën ndodhen revizionistët. Nga komunikata duket se udhëheqja revizioniste sovjetike nuk arriti t'i

«shtrojë» si duhet revizionistët e tjerë, pra nuk mundi të përcaktojë një vijë të përbashkët të revizionizmit dhe të zhdukë përçarjen që ekziston në gjirin e tij. Kjo vërtetohet edhe nga deklaratat që bëri, pas kthimit të tij në Romë, kryetari i delegacionit italian, i cili vuri në dukje se lidhur «me disa pikëpamje qëndrimi i komunistëve italianë ndryshon nga qëndrimi i shokëve të tjerë». Pikërisht këto janë arsyet që i kanë detyruar autorët e komunikatës të zgjedhin me kujdes fjalët, ndërsa armiqësinë e tyre kundër marksizëm-leninizmit ta mbulojnë me demagogji.

Këtë dokument demagogjik, që përputhet me tërë taktikën e re të udhëheqjes së sotme sovjetike për të ecur në vijën tradhtare të N. Hrushovit, por pa zhurmë, pa telashe e polemikë, ajo përpiket t'ia imponojë tërë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Për këtë qëllim pjesëmarrësit e mbledhjes së organizuar nga udhëheqja sovjetike ua dërguan këtë komunikatë, përpara se të botohej në shtyp, të gjitha partive komuniste e punëtoresh, në mënyrë që ato ta aprovojnë e ta sanksionojnë atë publikisht. Dhe tani udhëheqja revizioniste sovjetike po bën çmos për ta legalizuar atë dhe për ta paraqitur si një «dokument të përbashkët të të gjithë lëvizjes komuniste botërore», për ta përdorur, pra, si një mjet «presioni kolektiv» mbi partitë marksiste-leniniste. Kjo është në fakt një orvatje tjetër e udhëheqjes sovjetike për t'u imponuar partive motra të ashtuquajturin «vullnet të shumicës», me fjalë të tjera, vullnetin e udhëheqësve sovjetikë e të një grushti përkrahësish të tyre revizionistë, gjoja në emër të mbarë lëvizjes komuniste.

Toni me të cilin është formuluar komunikata e 10 marsit, sigurisht, do ta ketë dëshpëruar N. Hrushovin, kryetarin e falimentuar të revizionistëve hrushovianë. Ai ndoshta nuk e ka pritur një qëndrim të tillë frikacak nga nxënësit e tij të zellshëm. Kjo komunikatë nuk ka kënaqur as Titon, i cili përgjithësisht nuk e gëlltit dot frikën që tregojnë udhëheqësit e rinj sovjetikë qoftë për sa i përket luftës së hapët kundër marksizëm-leninizmit, qoftë edhe për sa i përket rehabilitimit zyrtar të titistëve. Moshedhja poshtë zyrtarisht e dënimin të LKJ nga Deklarata e 1960-s është një humbje e madhe për titizmin, i cili tani po bën zhurmë mbi «të mirat» e sistemit kapitalist-titist jugosllav, duke dërguar andej-këtej aktivistë të tillë si V. Vllahoviçi me shokë për të mbajtur leksione teorike mbi këtë temë (vetëm teorike, sepse rezultatet praktike janë për të vënë duart në kokë). Dhe në një kohë kur miqtë e tyre revizionistë nuk po e përcaktojnë botërisht pozitën e titizmit në lëvizjen komuniste, këto predikime i ngjasin «meshës në shkretëtirë», sepse njerëzit nuk binden as nga teoria as nga praktika titiste.

Komunikata e botuar pas përfundimit të mbledhjes përçarëse të revizionistëve, e zhveshur nga lëvozhga demagogjike, nxjerr në shesh synimet e vërteta të revizionistëve për ta bërë luftën e tyre kundër partive marksiste-leniniste sa më efektive dhe për të realizuar qëllimet e tyre kundërrevolucionare. Për të lehtësuar shqyrtimin e kësaj komunikate e të qëllimeve që fshihen prapa frazave demagogjike të saj, në këtë artikull do të ndalemi në katër çështje kryesore: 1) mbi «anti-imperializmin» e revizionistëve modernë; 2) polemika

midis marksistë-leninistëve e revizionistëve modernë; 3) revizionizmi e fraksionizmi; 4) mbi konceptet revizioniste për unitetin.

«Antiimperializëm» me fjalë, proimperializëm me vepra

Ideja themelore që përshkon komunikatën e mbledhjes përçarëse të Moskës është ajo e «antiimperializmit», ideja gjoja mbi nevojën e «unitetit të veprimeve në luftën kundër imperializmit, në çështjen e përkrahjes botërore për lëvizjen çlirimtare të popujve, në luftën për paqe të përgjithshme dhe për bashkëzistencë paqësore... në luftën për interesat jetike dhe qëllimet historike të klasës punëtore».

Pra, paraqitet çështja sikur revizionistët hrushovianë janë antiimperialistë të vendosur, luftëtarë besnikë për çështjen e lirisë e të pavarësisë së popujve, për çështjen e revolucionit. Jo vetëm kaq, por revizionistët tregohen edhe «optimistë» e «zemërgjerë»: ata theksojnë se ky unitet është plotësisht i mundshëm e i nevojshëm të arrihet, «me gjithë ekzistencën e mosmarrëveshjeve të rëndësishme për çështjet e vijës, teorisë e të taktikës», se «veprimet e përbashkëta në luftën për këto qëllime të përbashkëta janë rruga më e sigurt për kapërcimin e mosmarrëveshjeve ekzistuese».

Duhet thënë se me fjalë tema e «antiimperializmit» është bërë, veçanërisht kohët e fundit, tema më e preferuar e revizionistëve hrushovianë. Qëllimi i tyre është të mashtrojnë popujt e revolucionarët, të fitojnë besi-

min e tyre, në mënyrë që ta kenë më të lehtë zbatimin në praktikë të politikës proimperialiste.

Ideja e bashkimit të të gjitha forcave revolucionare e përparimtare të botës është një ide e madhe. Krijimi dhe forcimi i frontit antiimperialist është detyra më e rëndësishme e kohës, për t'i bërë ballë politikës agresive e luftënxitëse të imperializmit, me atë të SHBA-së në krye, politikës së shtypjes dhe të skllavërimit të popujve. Fronti antiimperialist i popujve të të gjithë botës është forca vendimtare për mbrojtjen dhe për zhvillimin e socializmit, për çlirimin e popujve, për ruajtjen dhe për forcimin e paqes në botë. Marksist-leninistët kanë qenë e janë gjithnjë për këtë front dhe qëndrojnë në radhët e para të luftës kundër imperializmit.

Por uniteti e bashkëpunimi në luftën kundër imperializmit është i mundur vetëm me forcat që qëndrojnë me të vërtetë në pozita antiimperialiste, që jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra bëjnë një luftë të vendosur kundër imperializmit dhe sidomos kundër imperializmit amerikan, që është koka dhe kështjella kryesore e reaksionit botëror, armiku më i egër i popujve të botës. Kurse revizionistët modernë, me tërë kursin e tyre politik, me gjithë veprimtarinë e tyre praktike, e kanë vënë veten jashtë frontit antiimperialist. Ata vetëm me fjalë, sa për demagogji, janë për luftën kundër imperializmit, ndërsa me vepra minojnë frontin antiimperialist, bashkëpunojnë me imperializmin, sidomos me atë amerikan, u shërbejnë në fakt politikës dhe qëllimeve të tij. Faktet provojnë se revizio-

nistët nuk qëndrojnë në pozita antiimperialiste, po në pozita **proimperialiste**.

Duke filluar qysh nga Kongresi i 20-të revizionistët hrushovianë dhe pasuesit e tyre filluan të ndjekin vijën e afrimit e të bashkëpunimit të gjithanshëm me imperializmin, veçanërisht me atë amerikan, vijën e minimumit të luftës së popujve kundër imperializmit, të sabotimit të revolucionit. Kjo vijë gjeti mishërimin e saj në të ashtuquajturën politikë hrushoviane të «bashkëzistencës paqësore», «garës paqësore» dhe «rrugës paqësore». Këtë vijë oportuniste e tradhtarë ata jo vetëm ua kundërvunë vijës së përgjithshme revolucionare të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, vijës së mbledhjeve të Moskës të viteve 1957 e 1960, por bënë çmos për t'ua imponuar të gjitha partive komuniste e punëtore e të gjitha forcave antiimperialiste, duke përdorur për këtë qëllim mjetet e metodat më të ulëta; të presionit, kërcënimit, korrupsionit, ndërhyrjes brutale në punët e brendshme e deri te puçet e komplotet kundërrevolucionare.

Me një zell të papërmbajtur revizionistët shkelën tezat themelore të marksizëm-leninizmit e të deklaratave të Moskës mbi imperializmin dhe filluan të propagandojnë me zhurmë të madhe pikëpamjet e tyre proimperialiste, të përhapin gjithfarë iluzionesh mbi ndryshimin gjoja të natyrës së imperializmit, mbi mundësinë «e zhdukjes përgjithmonë e qysh sot të luftërave nga jeta e shoqërisë», mbi krijimin që tani të «botës pa armë, pa ushtri e pa luftëra», mbi «urtësinë» dhe «arsyen» e krerëve të imperializmit — Ajzenhauerit, Kenedit e Xhonsonit me shokë, mbi «dëshirën dhe kujdesin

e tyre të singertë për paqen» etj. Në analizë të fundit, predikimet revizioniste mbi ndryshimin e natyrës së imperializmit amerikan nuk janë tjetër veçse teori kapitullante, që synojnë të përçajjnë luftën antiimperialiste të popujve. Revizionistët kanë zbukuruar imperializmin dhe kanë synuar të vënë në gjumë vigjilencën e popujve, duke deklaruar se gjoja imperialistët kanë hequr dorë nga lufta e agresioni i armatosur dhe e kanë marrë seriozisht thirrjen për «garë paqësore», se bile ata mund të ndihmojnë, sidomos me mjetet e çliruara nga çarmatimi, për zhvillimin dhe përparimin e popujve e të vendeve të prapambetura etj., etj.

Revizionistët, duke shtrembëruar idenë leniniste të bashkekzistencës paqësore me vendet kapitaliste, e shpallën atë si «vijë të përgjithshme të politikës së jashtme të vendeve socialiste», si «rrugën e vetme e më të mirë për zgjidhjen e të gjitha problemeve jetike që qëndrojnë para shoqërisë njerëzore», si «rrugën e përgjithshme të triumfit të socializmit në shkallë botërore» dhe e shtrinë parimin e bashkekzistencës edhe në marrëdhëniet midis klasave të shfrytëzuara e shfrytëzuese, midis popujve të shtypur dhe shtypësve imperialistë, e shndërruan atë në «imperativin kategorik të kohës sonë», në «detyrën themelore» të popujve të të gjitha vendeve, në «qëllimin më të lartë», të cilit duhet t'i nënshtrohet çdo gjë.

Miqësia dhe bashkëpunimi sovjeto-amerikan, siç dihet, u bënë ideali më i lartë, për të cilin kanë ëndërruar e ëndërrojnë natë e ditë revizionistët hrushovianë. Për hir të këtij «ideali» ata hoqën dorë nga lufta kundër imperializmit, i kanë bërë e i bëjnë atij lëshime pas lë-

shimesh të paparim, duke kapitulluar me turp para shantazhit të tij dhe duke komplotuar bashkë me të prapa shpinës e në dëm të popujve. Për hir të këtij «ideali» ata kapitulluan me turp në krizën e Karaibeve dhe nuk ngurruan të sakrifikojnë interesat jetike të popullit kuban, aprovuan veprimet agresive të imperia- lizmit amerikan për shtypjen e popullit kongolez dhe të lëvizjes së tij nacionalçlirimtare, firmosën traktatin famëkeq të Moskës, hoqën dorë nga përfundimi i trak- tatit të paqes me Gjermaninë dhe hynë në pazarllëqe të turpshme me revanshistët e Bonit kundër interesave jetike të RD Gjermane etj., etj.

Si shërbëtorë të imperializmit, revizionistët hru- shovianë ndoqën vijën e largimit të popujve nga revo- lucioni dhe lufta kundër imperializmit, vijën e minimit dhe të sabotimit të lëvizjes revolucionare e nacional- çlirimtare të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Ame- rikës Latine. Ata u shndërruan në propagandistë vull- netarë të shantazhit atomik të imperializmit dhe bënë një zhurmë të madhe se «lufta në kushtet e sotme do të bëhej në mënyrë të pashmangshme një luftë botë- rore», se «çdo shkëndijë e vogël mund të shndërrohet në një zjarr botëror», në të cilin do të digjeshin e do të përvëloheshin të gjithë, se për të gjitha këto arsye «duhet parë me rezerva teza leniniste mbi luftërat e drejta e të padrejta» dhe, pra, duhet hequr dorë nga lufta kundër imperializmit, i duhet bindur e nënshtruar atij. Revizionistët u përpoqën t'ia kundërvënë lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare të popujve luftës për paqe; bënë kredo të tyre «paqen me çdo kusht e me çdo çmim», «paqen me të gjithë e mbi të gjitha», duke

braktisur kështu të gjitha parimet dhe idealet revolucionare dhe duke shkarë përfundimisht në llumin e disfatizmit, të pesimizmit e të pacifizmit borgjez. Jo lufta e vendosur e popujve kundër imperializmit, por «bashkëzistenca paqësore» hrushoviane, «gara paqësore», «çarmatimi i plotë e i përgjithshëm» dhe OKB-ja janë ato që, sipas revizionistëve, do t'u sjellin popujve lirinë dhe përparimin!

Këto qëndrime proimperialiste të revizionistëve njihen mirë. Megjithëkëtë, tani udhëheqësit revizionistë sovjetikë, si dhe komunikata e mbledhjes përçarëse të 1 marsit, betohen me «antiimperializmin» e tyre. Mos vallë ka ndryshuar ndonjë gjë? Mos vallë këta njerëz kanë braktisur rrugën e tyre të mëparshme në shërbim të imperializmit dhe tani janë bërë «antiimperialistë» të vendosur? Faktet provojnë se as udhëheqja sovjetike as pasuesit e saj të mbledhjes përçarëse nuk kanë ndryshuar aspak nga e kaluara. Ata i përmbahen me vendosmëri kursit proimperialist hrushovian të kongreseve të 20-të, të 21-të e të 22-të. Udhëheqja revizioniste sovjetike ka ruajtur aleancat e vjetra dhe po krijon aleanca të reja me imperializmin amerikan, ëndërron e punon për forcimin e «bashkëpunimit të gjithanshëm sovjeto-amerikan». Ashtu si dhe N. Hrushovi, ajo vazhdon të komplotojë, bashkë me imperialistët amerikanë dhe forcat e tjera reaksionare, në kurriz të vendeve socialiste vëllezër e të popujve. Në formën më konkrete e të qartë bashkëpunimi i udhëheqësve revizionistë sovjetikë me imperialistët amerikanë u demaskua në sesionin e fundit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku, siç dihet, u zbulua marrëveshja e fshehtë

e revizionistëve hrushovianë me imperialistët për të paralizuar punimet e kësaj organizate, për të bërë të pamundur që ajo të shqyrtojë problemet që qëndronin para saj (veçanërisht çështjen e rivendosjes së të drejtave të ligjshme të RP të Kinës në OKB dhe çështjen e agresionit të imperializmit amerikan kundër RD të Vietnamit), për ta kthyer OKB-në në një vegël të bindur që t'u shërbejë interesave të tyre prej fuqish të mëdha dhe për t'u imponuar popujve të vegjël vullnetin e diktatit. Besnikë të rrugës së tyre tradhtarë, revizionistët hrushovianë votuan, bashkë me imperialistët amerikanë, kundër mocionit shqiptar që kërkonte rifillimin normal të punimeve të OKB-së dhe hedhjen poshtë të shantazhit imperialist mbi të.

«Antiimperializmi» i udhëheqjes së sotme sovjetike u duk sheshit edhe në qëndrimin e saj lidhur me agresionin e imperializmit amerikan kundër Republikës Demokratike të Vietnamit. Në një kohë kur kundër këtij agresioni shpërtheu në gjithë botën një valë e fuqishme zemërimi e protestash, në Moskë, me urdhër të udhëheqjes revizioniste sovjetike, u shtyp me egërsi dhe në mënyrë të përgjakshme demonstrata e protestës së studentëve sovjetikë e të huaj para ambasadës amerikane. Kështu ajo «konkretizoi» menjëherë deklaratën që lëshoi mbledhja përçarëse e Moskës, e cila bënte thirrje për «veprime energjike»... në favor të luftës së popullit vietnamez!! Bile qeveria sovjetike në rrugën e saj «antiimperialiste» u nxitua t'i shprehë qeverisë së SHBA-së keqardhjen e thellë dhe i kërkoi asaj ndjesë për atë çka ndodhi në kundërshtim me «dëshirat e mira» të saj! Për të justifikuar para opinionit publik

këtë gjest prej lakeu të qeverisë sovjetike si dhe për t'i ardhur në ndihmë menjëherë «antiimperializmit» të saj, qeveria e SHBA-së organizoi në Uashington njëfarë «demonstrate proteste» të disa emigrantëve kubanë kundër ambasadës sovjetike dhe menjëherë i kërkoi asaj ndjesë për atë që ndodhi. Ç'solidaritet dhe ç'ndihmë reciproke në kuadrin e «bashkëpunimit sovjeto-amerikan»!

Falsiteti i qëndrimit të udhëheqjes revizioniste sovjetike ndaj luftës heroike të popullit vietnamez duket edhe nga fakti se pikërisht në kohën kur në tokën e Vietnamit me urdhër të Xhonsonit, bien bombat e imperializmit amerikan, qeveria sovjetike, nëpërmjet Kosiginit, afirmoi edhe një herë se, pavarësisht nga ngjarjet në Vietnam, ftesa që i pat bërë presidentit Xhonson për të vizituar Moskën si «mik i Bashkimit Sovjetik» mbetet gjithnjë në fuqi. Me fjalë të tjera kjo do të thotë: Ju, amerikanë, bëni ç'të doni në Vietnam! Fjalëve që për demagogji jemi detyruar të themi ne, revizionistët, kundër administratës së Xhonsonit e imperializmit amerikan, mos ua vini veshin. Preokupacioni ynë kryesor mbetet përmirësimi i marrëdhënieve sovjeto-amerikane.

Ky «qëllim i lartë» dikton gjithë qëndrimin konkret të udhëheqjes revizioniste sovjetike ndaj luftës së drejtë të popullit vietnamez. Revizionisti Kosigin, në një fjalim të tij në televizionin sovjetik, bëri «thirrje» të mos bombardohet Vietnami i Veriut, sepse kështu konflikti «do të dalë nga kuadri fillestar», por nuk kërkoi që ushtritë amerikane dhe të satelitëve të tyre të largoheshin nga Vietnami i Jugut dhe nga gjithë Indo-

kina, që është kushti vendimtar për normalizimin e gjendjes në Azinë Juglindore. Revizionistët sovjetikë përpiqen «të zgjidhin» problemin vietnamez me anë bisedimesh, por duke ruajtur statukuonë dhe duke respektuar kërkesat e interesat e imperialistëve amerikanë, që, siç dihet, kërkojnë bisedime nga pozitat e forcës.

Ja, ky është «antiimperializmi» i revizionistëve sovjetikë! Jeta ka provuar se udhëheqësit revizionistë sovjetikë sillen si shovinistë kundrejt popujve të vegjël, qofshin këta edhe të vendeve socialiste, dhe për t'i nënshtruar përdorin edhe shkopin, kurse përpara imperialistëve amerikanë tregohen «zemërgjerë» dhe tërhiqen, duke tradhtuar interesat e socializmit e të popujve. Kundër RP të Shqipërisë, një vend i vogël e socialist, e cila kundërshtoi revizionizmin dhe mbrojti me guxim të vërtetën marksiste-leniniste, revizionistët hrushovianë nxituan të tregojnë «trimëri» të rrufeshme, duke prerë edhe marrëdhëniet diplomatike me të, ndërsa ndaj imperializmit amerikan, që hedh bomba kundër Vietnamit, thuhën vetëm fraza demagogjike dhe nuk merret asnjë masë konkrete. Me Shqipërinë socialiste u prenë menjëherë të gjitha marrëdhëniet tregtare, bile asaj nuk i shiten as libra letrarë e tekniko-shkencorë, kurse me imperializmin amerikan, që po sulmon vendet vëllezër socialiste, revizionistët hrushovianë tregtojnë e zhvillojnë të gjitha llojet e marrëdhënieve ekonomike e kulturore, bile edhe marrin prej tyre kredi. Revizionistët pretendojnë se marrëdhëniet tregtare janë të nevojshme e të domosdoshme, se ato duhet të zhvillohen pavarësisht nga mosmarrëveshjet politike e ideologjike, bile edhe nga dallimet midis sistemeve shoqë-

rore-ekonomike. Por në fakt në marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë ata nuk iu përmbajtën aspak këtij parimi, ata e përdorën prerjen e tyre si sanksion politik dhe, me anën e këtij veprimi, synonin të bojkotonin në mënyrë të gjithanshme një vend socialist. Përse një qëndrim i tillë ndaj një vendi socialist? Përse nuk merrren sanksione të tilla kundër imperializmit?

Është e qartë se këtyre pyetjeve revizionistët nuk mund t'u përgjigjen hapur. Qëndrimet e tyre me dy faqe janë të lidhura me faktin se hrushovianët janë antisocialistë dhe proimperialistë. Të pretendosh se lufton kundër imperializmit, ndërsa në të vërtetë ndjek politikën e afrimit me imperializmin, forcon marrëdhëniet ekonomike me të dhe merr prej tij kredi, ky është një mashtrim i madh.

Pra, faktet tregojnë se fjalët e bujshme të revizionistëve se gjoja ata janë për luftën kundër imperializmit dhe për krahin lëvizjen revolucionare e nacional-çlirimtare botërore, janë një bluf, një manovër demagogjike për të fshehur fytyrën e tyre të vërtetë, për të fituar njëfarë kapitali politik. I ashtuquajturi «anti-imperializëm» i revizionistëve, që propagandohet në komunikatën e mbledhjes përçarëse, si dhe nga udhëheqësit revizionistë sovjetikë, nuk është aspak ajo që i bashkon ata me marksistë-leninistët, por është pikërisht hendeku kryesor që i ndan, është çështja më themelore për të cilën ekzistojnë sot divergjenca në lëvizjen komuniste. Revizionistët kanë fshirë çdo dallim midis miqve e armiqve, ata janë futur në rrugën e bashkimit me imperializmin për të luftuar kundër socializmit, në

rrugën e bashkimit me SHBA-në dhe me reaksionin e vendeve të ndryshme për të luftuar kundër popujve dhe lëvizjes së tyre çlirimtare e revolucionare, në rrugën e bashkimit me shërbëtorët e agjentët e borgjezisë e të imperializmit, me Titon dhe krerët e djathtë socialdemokratë, për të luftuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër partive e forcave marksiste-leniniste të botës. Pra, revizionistët kanë prerë çdo lidhje me forcat e vërteta antiimperialiste dhe po bëjnë lojën e imperializmit, duke minuar frontin antiimperialist. Të bashkohesh me revizionistët në frontin antiimperialist, do të thotë të fusësh në këtë front «kalin e Trojës». Prandaj sot tingëllojnë më aktuale se kurrë fjalët e Leninit të madh se pa luftuar me vendosmëri kundër oportunitizmit e revizionizmit nuk mund të luftohet me sukses e në mënyrë efektive kundër imperializmit. **Fronti antiimperialist i popujve të botës do të rritet e do të forcohet pa revizionistët dhe në luftë të papajtueshme me revizionistët.**

Demagogjia «antiimperialiste» e revizionistëve nuk është e re në lëvizjen komuniste. Një demagogji të tillë patën përdorur në kohën e tyre, para dhe pas Luftës së Parë Botërore, edhe oportunistët e Internacionales së Dytë, Kautski e kompani, të cilët në fakt, ashtu si edhe revizionistët e sotëm, me gjithë qëndrimet e veprimet e veta u vinin në ndihmë imperialistëve për të mashtruar popujt, për të larguar vëmendjen e tyre nga lufta kundër imperializmit, për ta dobësuar e për ta minuar këtë luftë, për të zbukuruar imperializmin dhe për të maskuar politikën e tij agresive e luftënxitëse. Me qëndrimet e veta revizionistët e Internacionales së Dytë

dhe gjithë renegatët e tjerë të klasës punëtore ndihmuan imperialistët dhe u bënë bashkëpunëtorë të tyre në shpërthimin e dy luftërave botërore. Edhe revizionistët e sotëm hrushovianë, me gjithë kursin dhe veprimet e tyre, i vijnë në ndihmë imperializmit dhe i lehtësojnë atij punën për përgatitjen dhe për shpërthimin e luftërave agresive kundër socializmit e popujve, duke u bërë kështu bashkëpunëtorë e vegla të tij.

Demagogjia «antiimperialiste» e revizionistëve modernë s'është gjë tjetër veçse demagogjia e revizionistëve të vjetër, e përshtatur në rrethanat e reja të kohës sonë. Demagogjia e vjetër u demaskua në kohën e vet nga Lenini e Stalini dhe revizionistët e oportunistët e Internacionales së Dytë pësuan disfatë e falimentuan me turp. Para marksistë-leninistëve sot qëndron detyra historike të demaskojnë demagogjinë «antiimperialiste» të revizionistëve modernë hrushovianë, të zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë si shërbëtorë të borgjezisë e të imperializmit, të mos i lejojnë ata të mashtrojnë popujt e të komplotojnë me imperializmin në kurriz të tyre.

Polemika publike është e pashmangshme dhe e domosdoshme

Duke shpresuar se me kartën e tyre «antiimperialiste» mund të mashtrojnë komunistët dhe popujt, se nëpërmjet kësaj rruge do ta kenë më të lehtë të realizojnë planet për shkatërrimin e lëvizjes komuniste dhe të revolucionit, revizionistët, në komunikatën e tyre,

përpiqen të sigurojnë qetësinë, të ndalojnë polemikën. Këtë ata e justifikojnë gjoja edhe me domosdoshmërinë e sigurimit të unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në komunikatën e mbledhjes përçarëse thuhet: «Partitë e përfaqësuara në takim u shprehën për ndalimin e polemikës së hapët, që ka karakter jomiqësor e fyes për partitë motra. Në të njëjtën kohë, ato e konsiderojnë të dobishme të vazhdohet në formë shoqërore shkëmbimi i mendimeve për çështjet e rëndësishme të kohës sonë që përfaqësojnë interes të përbashkët».

Revizionistët prej kohësh kanë kërkuar, dhe bile kanë ngulur këmbë që të ndalohet polemika publike. Për këtë pat bërë thirrje disa herë edhe vetë N. Hrushovi. Me nxitjen e udhëheqjes së sotme sovjetike, këtë kërkesë e ngritën përsëri përfaqësuesit e partive të Amerikës Latine në deklaratën e tyre të njohur të fundit të vitit të kaluar.

Polemika, thonë revizionistët, është një e keqe e madhe, është shumë e dëmshme, sepse ajo largon vëmendjen nga lufta kundër armikut të përbashkët, minon unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste, krijon vështirësi serioze, sidomos për partitë komuniste në vendet kapitaliste, është në dobi të imperializmit etj., etj.

Revizionistët janë hipokritë të mëdhenj. Dihet se askush tjetër, por pikërisht revizionistët qenë ata që të parët i nxorën sheshit para armikut mosmarrëveshjet dhe që shpërthyen polemikën publike me një varg sulmesh e shpifjesh të papërmbajtura kundër Partisë së Punës të Shqipërisë nga tribuna e Kongresit të 22-të

të PK të BS. Me gjithë paralajmërimet serioze të partive motra për të hequr dorë nga kjo praktikë shumë e dëmshme dhe e rrezikshme dhe me gjithë thirrjet e tyre për të ndaluar polemikën publike, revizionistët jo vetëm nuk i ndërprejnë sulmet e tyre, por përkundrazi, në atë kohë shpallën me bujë të madhe se kjo është «në interes të mbarë lëvizjes komuniste botërore», se ky është «i vetmi qëndrim i drejtë parimor, me të vërtetë marksist-leninist».

Atëherë mbi ç'bazë revizionistët, të cilët vetë e filluan polemikën, tani kërkojnë ndalimin e saj? Përse dikur kjo polemikë paska qenë e drejtë, e dobishme, parimore, kurse tani qenka shndërruar në të kundërtën e saj? Këtu ka vetëm një shpjegim: kur polemika u leverdiste ose dukej se u leverdiste revizionistëve, ata nuk ngurruan ta fillojnë atë dhe ta shpallin si shprehjen e «principlialitetit të lartë leninist»; po kur panë se në ballafaqimin e hapët me marksistë-leninistët ata u demaskuan dhe pësuan disfata pas disfatash, revizionistëve «u erdhën mendtë» por, siç thotë një fjalë e urtë popullore, «kur vijnë mendtë s'i hanë as qentë!» dhe filluan të kërkojnë pushimin e menjëhershëm të polemikës, duke e cilësuar atë si një «katastrofë të vërtetë» për lëvizjen komuniste! Ja një shembull tipik i «principlialitetit të lartë» të revizionistëve hrushovianë, që është baras me pragmatizmin më të kulluar!

Revizionistët i kanë hequr vetes edhe të drejtën formale për të kërkuar ndalimin e polemikës. Ata kanë harxhuar letër me tonelata për shpifjet dhe për sulmet e tyre kundër partive marksiste-leniniste, kanë marrë

në kongrese e në plenumë vendime zyrtare për dënimin e partive motra. Ata nuk i kanë anuluar asnjëherë këto vendime, ndërsa literatura e tyre antimarksiste qarkulloi në sasira të mëdha dhe propagandohet me të gjitha mjetet e mënyrat. Pra, ata në fakt po e vazhdojnë polemikën, nuk duan të heqin dorë prej saj, ndërsa nga partitë marksiste-leniniste kërkojnë që të mbyllin gojën, u mohojnë atyre të drejtën t'u përgjigjen sulmeve të revizionistëve në bazë të parimit të barazisë.

Polemika e sotme është një polemikë e madhe, që ka të bëjë me çështjet më themelore të teorisë e të praktikës së komunizmit. Pasi u fillua nga revizionistët, ajo është bërë tani një gjë e pashmangshme dhe e domosdoshme, për shkak se revizionistët hrushovianë kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe e kanë zëvendësuar atë me oportunizmin e revizionizmin, kanë tradhtuar internacionalizmin proletar dhe e kanë zëvendësuar atë me shovinizmin e shtetit të madh dhe egoizmin nacional, kanë tradhtuar interesat e revolucionit e të socializmit dhe kanë bërë të vetat interesat e borgjezisë e të imperializmit, kanë tradhtuar unitetin e kompaktësinë dhe kanë shkaktuar përçarjen e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Si rrjedhim i të gjitha këtyre, në lëvizjen komuniste u vunë përballë dy rryma, dy vija të kundërta e të papajtueshme — revizioniste e marksiste-leniniste. Divergjencat në lëvizjen komuniste dolën nga kuadri i tyre i brendshëm dhe u shndërruan nga divergjenca midis marksistë-leninistëve nga njëra anë dhe oportunistëve e revizionistëve nga ana tjetër.

Polemika që zhvillohet sot bëhet për çështje të tilla të mëdha e parimore: a i duhet përmbajtur marksizëm-leninizmit, mësimeve të tij themelore, apo ai duhet shpallur i vjetruar e duhet hedhur poshtë; a duhen mbrojtur e zbatuar parimet revolucionare të deklaratave të Moskës të viteve 1957 dhe 1960, apo duhen braktisur e shqelmuar ato; a duhet luftuar kundër imperia- lizmit, kundër politikës së tij agresive e luftënxitëse, apo duhet kapitulluar përpara tij, duhet pajtuar e bashkuar me të; a duhet mbrojtur dhe çuar përpara çështja e revolucionit dhe e socializmit, apo duhet kthyer prapa drejt restaurimit të kapitalizmit; a duhen mbrojtur e forcuar partitë komuniste si parti revolucionare, apo duhen shkatërruar ato e shndërruar në parti socialde- mokratë reformiste; a u duhet përmbajtur internacio- nalizmit proletar, normave marksiste-leniniste të marrëdhënieve midis vendeve socialiste e partive komu- niste dhe të forcohet uniteti e kompaktësia, apo duhet ndjekur vija e shovinizmit të shtetit të madh dhe e për- çarjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Është e qartë se përderisa revizionistët jo vetëm nuk kanë hequr dorë, por po ecin gjithnjë më tej dhe janë të vendosur të shkojnë deri në fund në rrugën e tyre tradhtare e përçarëse, as që mund të bëhet fjalë për ndalim të polemikës. Të pushosh në këto kushte po- lemikën do të thotë të heqësh dorë nga mbrojtja e marksizëm-leninizmit dhe e internacionalizmit proletar, nga mbrojtja e çështjes së revolucionit e të socializmit, nga mbrojtja e unitetit dhe e kompaktësisë. Marksistë- leninistët, duke u qëndruar besnikë idealeve të tyre re- volucionare, janë të vendosur të vazhdojnë dhe ta

shpjen deri në fund polemikën që ka filluar. Polemika publike do të pushojë vetëm atëherë kur revizionistët modernë të jenë demaskuar plotësisht e shpartalluar përfundimisht.

Polemika publike u ka nxjerrë revizionistëve shumë telashe, i ka vënë në vështirësi të mëdha, ka zbuluar fytyrën e tyre tradhtare, ka shtuar e ka thelluar kontradiktat në vetë gjirin e grupimit revizionist, ka inkurajuar forcat marksiste-leniniste në botë dhe i ka dhënë hov luftës së tyre kundër revizionizmit. Duke kërkuar ndalimin e polemikës, revizionistët kërkojnë t'i shmangen demaskimit të mëtejshëm të tyre, të mbyllin të çarat në frontin revizionist, të konsolidojnë pozitat e tyre të lëkundura, të pengojnë procesin e diferencimit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, të veprojnë në qetësi e pa telashe për të vënë në jetë kursin e tyre tradhtar.

PPSH ka qenë dhe është plotësisht e bindur se polemika e sotme publike jo vetëm nuk është në kundërshtim me unitetin e nuk e minon atë, por përkundrazi, vazhdimi i kësaj polemike është e vetmja rrugë e drejtë për rivendosjen dhe forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste mbi bazën e vetme të mundshme — mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar. Përderisa divergjencat janë për çështje të mëdha, themelore, parimore, strategjike, janë divergjenca midis marksistë-leninistëve e revizionistëve, ndalimi i polemikës publike do të ishte vetëm në dobi të revizionistëve, ndërsa vazhdimi i saj do të ndihmojë të sqarohet më mirë e vërteta dhe të arrihet, nëpërmjet luftës, në një unitet të ri, mbi një bazë të re, në unitetin e vërtetë

marksist-leninist, pa revizionistë e kundër revizionizmit.

Pasi dështuan në orvatjet e tyre për të ndaluar drejtpërdrejt polemikën, për t'u mbyllur gojën marksistë-leninistëve, revizionistët, në komunikatën e mbledhjes së tyre të 1 marsit, përpiqen t'ia arrijnë qëllimit në një formë të re: ata luten «vetëm» të hiqet dorë nga «termat e ashpër» e «sulmet reciproke», nga «toni armiqësor e fyes» dhe të zhvillohet ajo në formën e një «diskutimi shoqëror për shkëmbimin e mendimeve»!

Me këtë manovër të re revizionistët përpiqen të shtrembërojnë karakterin e vërtetë të divergjencave të sotme në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, t'i paraqesin ato jo si divergjenca midis marksistë-leninistëve e revizionistëve, por si divergjenca midis shokësh, midis marksistë-leninistësh, që kanë mendime të ndryshme për disa çështje «të interesit të përbashkët», qofshin këto edhe të rëndësishme. Ata kanë për qëllim të masojnë kështu vijën dhe qëllimet e tyre të vërteta.

Duke kërkuar që të hiqet dorë nga toni i ashpër, «armiqësor e fyes» i polemikës, siç thonë revizionistët, ata kërkojnë që marksistë-leninistët të zbukurojnë revizionizmin, të mos i quajnë gjërat me emrin e tyre të vërtetë, të heqin dorë pikërisht nga demaskimi i revizionistëve si renegatë e përçarës, pra, në fakt të heqin dorë nga polemika, nga lufta kundër revizionizmit. Marksistë-leninistët nuk kanë përdorur e nuk kanë përse të përdorin sharje, fyerje e shpifje, ata thonë kurdoherë dhe hapur, pa doreza e diplomaci, vetëm të vërtetën marksiste, por është pikërisht kjo e vërtetë që u

djeg revizionistëve, prandaj e cilësojnë atë si «sharje», «fyerje» e «shpifje». Vetëm revizionistët, të cilët janë në kundërshtim me të vërtetën, janë përpjekur ta zëvendësojnë atë me sharje, sulme të ulëta e akuza false. Dihet nga tërë bota se ishin pikërisht kryetari i revizionizmit modern, N. Hrushovi, dhe përkrahësit e tij ata që kanë përdorur fjalorin më banal e më vulgar, të cilin mund t'ua kenë zili edhe rrugaçët më të këqij.

Pra, revizionistët kërkojnë tani një polemikë «akademike», që t'i përshtatet demagogjisë së tyre të përditshme dhe këtë lloj polemike ata e quajnë «shoqërore», «të kulturuar». Kjo ngjan si dy pika uji me manierat dhe sjelljet e atyre politikanëve e të diplomatëve borgjezë, që nga njëra anë të buzëqeshin e sillen si xhentëlmenë dhe nga ana tjetër të ngulin thikën pas shpine! Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që revizionistët të shpëtojnë nga demaskimi dhe të kryejnë në qetësi veprën e tyre tradhtarë, t'i vënë kazmën çështjes së socializmit e të komunizmit.

Por më kot revizionistët përpiqen të mashtrojnë marksistë-leninistët me manovrën e tyre të re. Ata nuk do t'ia arrijnë dot kurrë qëllimit të tyre. Marksistë-leninistët do ta vazhdojnë në mënyrë parimore polemikën dhe nuk do të ndryshojnë qëndrimin e vet ndaj saj. Polemika e sotme është një luftë e madhe me rëndësi historike për fatet e lëvizjes revolucionare e çlirimtare botërore. Në procesin e kësaj lufte rriten e kaliten forcat marksiste-leniniste në botë, zhvillohet e pasurohet doktrina jonë revolucionare, merr hov e ngrihet gjithnjë më shumë lëvizja revolucionare botërore. Ashtu si dhe polemikat e tjera në të kaluarën, polemika e sotme

e madhe do të çojë në mënyrë të pashmangshme në fitore të reja të marksizëm-leninizmit, të socializmit e të komunizmit.

Përçarësit e fraksionistët maskohen me britma kundër përçarjes e fraksionizmit

Në frymën e përgjithshme demagogjike që përshkon tërë dokumentin e mbledhjes përçarëse të 1 marsit, revizionistët, të preokupuar gjoja për çështjen e unitetit, dalin si partizanë të mbrojtjes së parimeve të internacionalizmit proletar, të normave marksiste-leniniste të marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtorë e midis vendeve socialiste. Në komunikatë thuhet se «pjesëmarrësit e takimit shprehen për respektimin me rreptësi të normave të marrëdhënieve midis partive, të përcaktuara në mbledhjet e viteve 1957 e 1960, kundër ndërhyrjes së disa partive në punët e brendshme të partive të tjera».

Një nga shkaqet kryesore të përçarjes në lëvizjen komuniste është pikërisht shkelja e parimeve të internacionalizmit proletar, ndërhyrja në punët e brendshme të partive të tjera, marrja nëpër këmbë e normave të marrëdhënieve midis partive motra e vendeve socialiste vëllezër. Prandaj pa u kthyer në respektimin me rreptësi të këtyre normave e parimeve nuk mund të bëhet fjalë për unitet.

Por kush i ka shkelur këto norma e parime? Kush ka ndërhyrë brutalisht në punët e brendshme të partive e vendeve të tjera?

Duke tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe duke ndjekur e duke propaganduar një vijë antimarksiste, revizionistët modernë minuan bazën ideologjike e politike të unitetit të kampit e të lëvizjes komuniste. Por largimi nga parimet e marksizëm-leninizmit, tradhtia ndaj tyre, i çoi në mënyrë të pashmangshme revizionistët edhe në largimin e tradhtinë ndaj parimeve të internacionalizmit proletar, në shkeljen e parimeve dhe të normave të marrëdhënieve midis vendeve socialiste e partive komuniste, në shkarjen në pozitat e shovinizmit të shtetit të madh e të egoizmit nacional.

Qysh nga Kongresi i 20-të, grupi hrushovian, nën pretekstin e «luftës kundër kultit të individit dhe të pasojave të tij», ka ndërhyrë brutalisht në punët e brendshme të partive dhe të vendeve të tjera, për të ndryshuar, sipas dëshirës së vet, udhëheqjet e tyre, duke përkrahur e duke sjellë në fuqi njerëzit e vet revizionistë. Ai ka shkelur në mënyrë flagrante parimin e barazisë e të pavarësisë së partive motra e të vendeve vëllezër dhe ka vendosur në kampin socialist e në lëvizjen komuniste marrëdhënie nënshtrimi e sundimi, ka futur konceptin e metodën e «shkopit të dirigjentit» e të «partisë mëmë», së cilës duhet t'i binden e t'i gjujnzohen të gjithë. Ai ka shkelur parimin e përpunitit të pikëpamjeve të përbashkëta me anën e konsultimeve dhe ka futur në lëvizjen komuniste parimin e komandimit, të marrjes së vendimeve për çështje të rëndësishme e që i përkasin gjithë lëvizjes komuniste në mënyrë krejt arbitrare, pa pyetur njeri dhe duke i vënë të tjerët përpara fakteve të kryera.

Për t'i vënë nën kontrollin e vet të gjithanshëm ve-

ndet socialiste, grupi i Hrushovit është përpjekur të shkelë sovranitetin, ka ndërhyrë brutalisht në punët e brendshme, ka organizuar kundër tyre veprimtari minuese. Nën pretekstin «e ndarjes ndërkombëtare të punës», «të specializimit dhe të kooperimit të prodhimit», ai është përpjekur të shfrytëzojë vendet e tjera socialiste, të pengojë zhvillimin e ekonomisë së tyre të pavarur, t'i lërë vendet më pak të zhvilluara pa industri kombëtare, si burime lëndësh të para e tregje për shitjen e prodhimeve të veta industriale.

Grupi udhëheqës sovjetik është ai që, për t'u imponuar të tjerëve kursin e vet tradhtar, i shtriu mosmarrëveshjet ideologjike në fushën e marrëdhënieve shtetërore me vendet socialiste, bëri ndaj tyre presione të gjithanshme politike, ekonomike e ushtarake, duke arritur deri në vendosjen e bllokadave ekonomike, në organizimin e provokacioneve ushtarake e prerjen e marrëdhënieve diplomatike. Ishin pikërisht revizionistët hrushovianë ata që arritën deri atje sa të marrin hapur në mbrojtje armiqtë e pushtetit popullor, agjentët e imperializmit dhe të bëjnë thirrje publike për kundërvolucion në Shqipëri. Udhëheqja sovjetike mori hapur anën e reaksionit indian në konfliktin kino-indian, përkrahu agresionin e Indisë dhe e ndihmoi këtë me armë për të luftuar kundër Kinës popullore.

Të tilla janë faktet, të cilat i njeh tanimë e tërë bota. Në qoftë se udhëheqja e sotme sovjetike dhe përkrahësit e saj do të ishin me të vërtetë për respektimin e normave internacionaliste të marrëdhënieve midis partive motra e vendeve socialiste dhe për mosndërrjen në punët e brendshme të të tjerëve, atëherë pu-

na e tyre e parë duhet të ishte autokritika e hapët dhe e sinqertë, dënimi dhe korrigjimi i guximshëm e parimor i të gjitha veprimeve e masave armiqësore që ata kanë ndërmarrë kundër partive motra dhe vendeve vëllezër. Kurse udhëheqësit e sotëm sovjetikë jo vetëm nuk kanë bërë asnjë hap pozitiv në këtë drejtim por edhe as që kanë ndër mend të bëjnë. Ata asgjë nuk kanë pranuar e nuk kanë korrigjuar në marrëdhëniet me PPSH, përkundrazi, qëndrojnë në të njëjtat pozita anti-shqiptare të N. Hrushovit. Për më tepër, vazhdojnë vepërimtarinë minuese kundër partive motra, si kundër PK të Japonisë apo asaj të Indonezisë, ndjekin, si edhe më parë, por në forma të reja, vijën e shovinizmit të shtetit të madh, të «shkopit të dirigjentit» e të «partisë mëmë». Organizimi prej tyre në mënyrë arbitrare e të paligjshme i mbledhjes fraksioniste të 1 marsit është një provë tjetër e gjallë se udhëheqja e sotme sovjetike ecën në të gjitha çështjet në gjurmët e N. Hrushovit.

Duket qartë se kur në komunikatën e mbledhjes përçarëse flitet për respektim të normave e për mosndërhyrje në punët e brendshme të partive të tjera, revizionistët sovjetikë dhe përkrahësit e tyre sulmojnë partitë marksiste-leniniste. Ata e kanë hallin të përkrahja që këto parti u japin forcave të reja revolucionare marksiste-leniniste që po lindin, rriten e forcohen kudo në botë. Me «ndërhyrje në punët e brendshme» revizionistët nënkuptojnë pikërisht këtë përkrahje dhe kërkojnë që partitë marksiste-leniniste të heqin dorë nga kjo «veprimtari fraksioniste», siç e quajnë ata. Me të vërtetë paturpësia e revizionistëve nuk ka kufi! Janë

pikërisht revizionistët ata që kanë zhvilluar e zhvillojnë një veprimtari të gjithanshme fraksioniste e subversive në gjirin e partive komuniste e punëtore, që kanë marrë nën mbrojtje e kanë përkrahur me të gjitha mjetet e mënyrat renegatët e klasës punëtore e të çështjes së socializmit, fraksionistët e tipit të Danges në Indi, Shigës e Suxukit në Japoni, Kejnemanit në Cejlon, Sharkit e Diksonit në Australi etj. Janë ata që, me mbledhjen e tyre të 1 marsit, vepruan si fraksionistët e konspiratorët më të këqij në dëm të mbarë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Dhe pikërisht në emër të kësaj mbledhjeje përçarëse e fraksioniste akuzojnë të tjerët për fraksionizëm!

Revizionistët përpiqen ta paraqesin krijimin e partive, grupeve e organizatave të reja marksiste-leniniste si diçka të nxitur e të organizuar nga jashtë — nga partitë tona marksiste-leniniste, të cilat i akuzojnë se po minojnë kështu unitetin e partive të ndryshme komuniste e punëtore, si dhe unitetin e lëvizjes komuniste në tërësi! Kjo është një orvatje për të shtrembëruar shkakun e vërtetë të përçarjes që ka ndodhur në shumë parti të vendeve të ndryshme ku në udhëheqje janë revizionistët dhe për të fshehur karakterin fraksionist të vetë mbledhjes antimarksiste të 1 marsit.

Përçarja në gjirin e shumë partive është shkaktuar për faktin që udhëheqja e PK të BS dhe përkrahësit e saj u kanë imponuar partive të ndryshme vijën e tyre revizioniste. Përhapja e revizionizmit nuk mund të mos ndeshte rezistencën dhe kundërshtimin e vendosur të atyre revolucionarëve që u qëndrojnë besnikë idealeve të komunizmit. Ky është një proces krejt i ligjshëm e i

pashmangshëm: kudo që shfaqet revizionizmi, atje nuk mund të mos ngrihen marksistë-leninistët e të luftojnë kundër tij. Këtë proces e thelluan dhe po e thellojnë më tej vetë revizionistët me qëndrimet dhe me veprimet e tyre. Në kundërshtim me parimin e centralizmit demokratik dhe me normat e jetës së brendshme të partisë, ata nuk kanë lejuar e nuk lejojnë në partitë e tyre shprehjen e lirë të mendimeve, organizimin e diskutimeve të gjera për çështjet e vijës së partisë e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Bile revizionistët kanë marrë masa kundër komunistëve revolucionarë duke i ndjekur, persekutuar e përjashtuar nga partia. Në këto kushte marksistë-leninistëve nuk u mbetet rrugë tjetër veçse të organizohen në grupe e në parti të reja për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të çuar përpara çështjen e revolucionit e për të luftuar revizionizmin. Pra, është e qartë se lufta që zhvillohet sot brenda ose jashtë partive komuniste të veçanta në vende të ndryshme ku në udhëheqje janë revizionistët, s'është gjë tjetër veçse një shfaqje e po asaj lufte që zhvillohet në shkallë ndërkombëtare midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern, është luftë midis këtyre dy vijave të kundërta në shkallë kombëtare.

Zhurma e revizionistëve për të ndaluar të ashtuquajturën veprimtari fraksioniste dhe shpifjet e akuzat e tyre kundër komunistëve revolucionarë të grupeve e të partive të reja marksiste-leniniste, të cilët ata i quajnë «renegatë», «elementë antiparti», «dezertorë» etj., dëshmojnë vetëm për një gjë: për frikën e madhe që i ka pushtuar revizionistët përballë procesit të shpejtë të diferencimit të forcave që po bëhet në partitë e

veçanta dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare në tërësi. Por shpifjet, akuzat dhe sulmet e revizionistëve jo vetëm nuk i trembin komunistët revolucionarë, por përkundrazi, ua forcojnë akoma më shumë besimin se janë në rrugë të drejtë, shtojnë urrejtjen për revizionistët dhe rritin përpjekjet e tyre për zhvillimin e lëvizjes revolucionare. Sado me përbuzje të flasin revizionistët për komunistët revolucionarë, sado intriga e komplete të organizojnë ata bashkë me reaksionin kundër tyre, ata nuk do të mund ta ndalin dot rritjen dhe forcimin e partive dhe grupeve të reja marksiste-leniniste, luftën e tyre revolucionare.

Për sa i përket përkrahjes që partitë motra marksiste-leniniste u japin shokëve komunistë revolucionarë në vendet e ndryshme të botës, PPSH e ka konsideruar dhe e konsideron këtë si një detyrë të lartë internacionaliste. Marksistë-leninistët kanë të drejtë dhe detyrë të përkrahin me të gjitha forcat komunistë revolucionarë që qëndrojnë në pozitë e marksizëm-leninizmit, që luftojnë me vetëmohim kundër imperializmit e revizionizmit modern, që mbrojnë partitë revolucionare të klasës punëtore nga degjenerimi revizionist, që ndjekin një vijë të vendosur revolucionare.

PPSH i ka ndihmuar e do t'i ndihmojë edhe më tej pa rezerva forcat e reja marksiste-leniniste, sepse në rritjen dhe në zhvillimin e tyre ajo sheh të ardhmen e lëvizjes komuniste e revolucionare, sheh triumfin e marksizëm-leninizmit mbi revizionizmin.

Revizionizmi është e kundërta e unitetit, është minimi i çdo uniteti

Revizionistët në komunikatën e botuar i kushtojnë një vend të rëndësishëm problemit të thirrjes së mbledhjes ndërkombëtare të partive. Pra, udhëheqësit e sotëm sovjetikë dhe përkrahësit e tyre, megjithëse mbledhjen e 1 marsit e pagëzuan si «takim konsultativ» e jo si «komision redaktimi», e ruajtën të paprekur projektin hrushovian të thirrjes së një mbledhjeje ndërkombëtare përcarëse, por të detyruar nga rrethanat i bëjnë këtij projekti disa korrigjime.

Dihet se në të kaluarën revizionistët patën bërë një zhurmë të madhe mbi nevojën e ngutshme të mbledhjes, që ajo të bëhej sa më parë, që të mos lejohej asnjë shtytje e mëtejshme e saj. Kurse tani, në komunikatën e mbledhjes së 1 marsit, ata nuk i përmendin më këto gjëra, nuk caktojnë asnjë afat për këtë mbledhje, por theksojnë vetëm se ajo duhet bërë në një «kohë të përshatshme». Ky është një diskreditim i madh dhe një disfatë për revizionistët dhe për vetë idenë e tyre të mbledhjes përcarëse.

Po kështu, më parë revizionistët sovjetikë thoshin në mënyrë të prerë se lidhur me thirrjen e mbledhjes ishin bërë të gjitha përgatitjet, ishin kryer të gjitha konsultimet e nevojshme dhe «ishtë shprehur qartë vullneti i lëvizjes komuniste», se bile partitë motra kishin të drejtë të fillonin menjëherë nga puna praktike. Ndërsa tani, në komunikatën e takimit revizionist të 1 marsit, thuhet se «për të thirrur e për të mbajtur me

sukses një mbledhje të re, ajo duhet përgatitur si nga pikëpamja e përmbajtjes ashtu edhe nga pikëpamja organizative», se për këtë duhen bërë përpjekje që të përmirësohet atmosfera në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, se për përgatitjen e kësaj mbledhjeje duhen bërë konsultime dypalëshe e shumëpalëshe, bile edhe një takim konsultativ paraprak me përfaqësuesit e 81 partive që morën pjesë në mbledhjen e vitit 1960. Pra, përsëri diskreditim e disfatë për revizionistët!

Nga komunikata del qartë se udhëheqja sovjetike nuk mundi t'ia arrijë dot qëllimit të saj për të thirrur sa më parë të ashtuquajturën mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, tek e cila kishte mbështetur shpresa të mëdha për t'u dhënë një «goditje të vendosur kolektive» partive marksiste-leniniste dhe për t'u hedhur kapistrën në qafë gjithë revizionistëve të tjerë. Ky dështim i dyfishtë iu shkaktua udhëheqjes sovjetike nga lufta e vendosur e partive marksiste-leniniste, e cila demaskoi karakterin dhe qëllimet antimarksiste e përçarëse të kësaj mbledhjeje dhe thelloi kontraktat në gjirin e vetë revizionistëve. Komunikata dëshmon për një triumf të tezave e të taktikës së revizionistëve toliatistë, të formuluar qartë në «testamentin» e P. Toliatit, të cilët shprehen kundër vijës monocentriste të udhëheqjes sovjetike, janë për një taktikë më të rafinuar e, sipas tyre, më efektive për luftën kundër të ashtuquajturve «dogmatikë», ndjekin vijën e evitimit maksimal të përçarjes së plotë e të ballafaqimit të hapët me marksistë-leninistët, nga të cilët kanë frikë për vdekje.

Se për ç'mbledhje e kanë fjalën revizionistët, kjo

duket qartë nga rrugët që ata përcaktojnë për përgatitjen e saj. Si kushte të domosdoshme për arritjen e unitetit dhe thirrjen e mbledhjes revizionistët konsiderojnë: të lihen mënjanë divergjencat dhe të realizohet bashkimi në të ashtuquajturin front të tyre «antiimperialist»; të ndalohet polemika, ose të paktën të zhvillohet ajo në formën e një diskutimi socialdemokratik e liberalo-borgjez; të ndërpritet e të dënohet e ashtuquajtura veprimtari fraksioniste; të bëhen konsultime me partitë motra, por pa krijuar asnjë premisë paraprake të domosdoshme për to.

Duket sheshit se udhëheqësit sovjetikë dhe përkrahësit e tyre janë kundër unitetit të vërtetë, ata janë për një unitet antimarksist, për një unitet revizionist e mbi bazën e revizionizmit. Ata duan një mbledhje që t'i shërbejë pikërisht një «uniteti» të tillë.

Por uniteti i lëvizjes komuniste nuk është ngritur e nuk mund të ngrihet kurrë mbi bazën e revizionizmit. Revizionizmi është e kundërta e unitetit, është minimi i çdo uniteti. Uniteti i vërtetë luftarak e revolucionar i lëvizjes komuniste ndërkombëtare mund të ngrihet vetëm mbi një bazë — mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar. Ky unitet i vërtetë është i mundur vetëm në luftë me revizionistët, pa ta e kundër tyre.

Revizionistët hrushovianë, si në të gjitha çështjet, përpiqen të spekulojnë me idenë e unitetit, me preokupacionin e sinqertë të komunistëve dhe të revolucionarëve për arritjen e tij. Por fjalët e tyre për unitet janë vetëm demagogji. Këtyre fjalëve u ka dalë boja, ato nuk mund t'i mashtrojnë marksistë-leninistët, të cilët i

njohin mirë se kush janë revizionistët dhe cilat janë veprat e tyre.

Në artikujt që janë botuar në disa vende evropiane të ish-demokracisë popullore, në të cilët shpjegohen idetë e komunikatës së takimit të 1 marsit, bëhen gjithashtu shumë betime për unitetin, thuhet se ata kanë bërë dhe do të bëjnë të gjitha përpjekjet për forcimin e unitetit. Por na lejoni të pyesim: A jeni ju në rregull me qëndrimin tuaj ndaj RP të Shqipërisë, ndaj një vendi socialist, ç'keni bërë ju për të përmirësuar marrëdhëniet me të dhe a keni ndër mend t'i korrigjoni gabimet e fajet e rënda që keni kryer ndaj saj? Për unitetin duhen vepra dhe jo fjalë. Marksistë-leninistët prej kohësh kanë shprehur qartë mendimin e tyre se për rivendosjen e për forcimin e unitetit të vërtetë të lëvizjes komuniste e të kampit socialist dhe për të krijuar kushtet për thirrjen e një mbledhjeje ndërkombëtare që t'i shërbejë këtij uniteti, duhen marrë masa rrënjësore.

Para së gjithash, për këtë është e domosdoshme të hidhet poshtë vija oportuniste e revizioniste e kongreseve të 20-të, të 21-të e të 22-të, vija e të ashtuquajturave «bashkekzistencë paqësore», «garë paqësore», «rrugë paqësore», «çarmatim i plotë e i përgjithshëm», «bashkëpunim i gjithanshëm sovjeto-amerikan», «antistalinizëm», «shtet i gjithë popullit» dhe «parti e gjithë popullit» etj. Duhet hedhur poshtë vija e afrimit dhe e bashkimit me imperializmin amerikan dhe imperialistët e tjerë, me klikën e Titos, me krerët e djathtë socialdemokratë, me qarqet e ndryshme reaksionare dhe me gjithë armiqtë e klasës punëtore, të socializmit e të popujve. Pikërisht kjo vijë tradhtarë e revizionistëve është

shkaku i thellë ideologjik e politik i përçarjes, prandaj pa e flakur tej këtë vijë as që mund të bëhet fjalë për unitet.

Është gjithashtu e domosdoshme të hidhet poshtë vija e shovinizmit të shtetit të madh dhe e egoizmit nacional, vija e shkeljes së parimeve të internacionalizmit proletar, e marrjes nëpër këmbë të normave marksiste-leniniste të marrëdhënieve midis partive komuniste e vendeve socialiste, vija e presioneve, shantazheve, masave hakmarrëse, e diktatit dhe e ndërhyrjeve të palejueshme në punët e brendshme të të tjerëve, vija e shkeljes së sovranitetit, pavarësisë e barazisë së vendeve socialiste e të partive motra etj. Të gjitha këto janë burimi tjetër i thellë i divergjencave e i përçarjes. Prandaj pa dënimin e tyre të hapët e publik nga ana e atyre që i kanë bërë — e udhëheqësve revizionistë sovjetikë, dhe pa i korigjuar ato në praktikë, me vepra, gjithashtu nuk mund të bëhet fjalë për unitet.

Por revizionistët, konsekuentë në rrugën e tradhtisë, jo vetëm nuk kanë hequr dorë nga vija e tyre antimarksiste dhe nuk kanë korigjuar asgjë nga fajet e tyre të rënda, por përkundrazi, janë futur e po futen gjithnjë e më thellë në llumin e revizionizmit e të përçarjes. Vetë thirrja e mbledhjes fraksioniste të 1 marsit tregon qartë se revizionistët e sotëm hrushovianë janë të pandreqshëm, se ata janë antimarksistë të tërbuar e tradhtarë të vendosur për t'i shërbyer deri në fund imperializmit e reaksionit. Asnjë shpresë e asnjë iluzion nuk mund të ketë më tani se revizionistët hrushovianë mund të ndreqen e të kthehen në pozita të drejta pari-

more. «Gungaçit vetëm varri mund t'ia ndreqë kurri-
zin», thotë një fjalë e urtë popullore.

Me veprimet e tyre përçarëse revizionistët vetëm shpejtojnë demaskimin e plotë, afrojnë disfatën e tyre përfundimtare, lehtësojnë e shpejtojnë krijimin dhe forcimin e unitetit të vërtetë marksist-leninist e revolucionar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Marksistë-leninistët dhe gjithë revolucionarët e vërtetë, si rrjedhim i hapit të ri tradhtar që kryen revizionistët duke organizuar mbledhjen përçarëse e fraksioniste të 1 marsit, ndodhen përpara detyrash të reja, me përgjegjësi historike për fatet e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Revizionistët u mblodhën për të përgatitur komplotet të reja kundër komunizmit, për të përcaktuar taktikën e tyre të ardhshme në luftën kundër marksistë-leninistëve revolucionarë. Ata do të përpiqen të vënë në jetë më aktivisht vijën hrushoviane të afrimit me imperializmin, të degjenerimit të partive komuniste, duke nxitur shkrirjen e tyre me partitë socialdemokrate të shkatërrimit të socializmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Përballë kësaj sfide të madhe të revizionistëve, marksistë-leninistët revolucionarë nuk do të rrinë duarkryq, ata do të nxjerrin mësimet e konkluzionet e veta dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme. Lufta parimore dhe e vendosur kundër revizionizmit modern në përgjithësi dhe kundër atij hrushovian në veçanti do të ngrihet në një shkallë më të lartë. Lufta e guximshme dhe e pandërprerë e marksistë-leninistëve do të bëjë që të hidhen në erë gjithë planet e tradhtarëve,

kjo luftë do të demaskojë demagogjinë e tyre djallëzore dhe do të grisë maskën mashtruese të revizionistëve në sytë e popujve e të revolucionarëve të të gjithë botës.

Marksistë-leninistët revolucionarë do t'i përgjigjen mbledhjes fraksioniste të revizionistëve duke shtrënguar edhe më shumë radhët, duke forcuar solidaritetin e bashkëpunimin e tyre si në plan kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, në mënyrë që jo vetëm t'u bëjnë ballë kompleteve revizioniste, të tanishme e të ardhshme, por që me luftën parimore, të vendosur e të koordinuar t'u shkaktojnë disfatë të plotë revizionistëve hrushovianë dhe planeve që ata kanë thurur.

Komunistët e vërtetë të vendeve të ndryshme që sot militojnë brenda ose jashtë partive të drejtuara nga revizionistët, do të shtojnë luftën dhe përpjekjet e tyre që t'i shpëtojnë partitë komuniste nga rruga e rrezikshme tradhtare ku duan t'i çojnë revizionistët. Tanimë shkëputja nga revizionistët është e pashmangshme. Hrushovianët, me mbledhjen e tyre fraksioniste, shkëputjen e shtruan në rendin e ditës. Tani janë më aktuale se kurrë fjalët e Leninit të madh se

«...nuk mund të plotësohen detyrat e socializmit, nuk mund të arrihet uniteti i vërtetë ndërkombëtar i punëtorëve pa u shkëputur në mënyrë të vendosur nga oportunizmi dhe pa i sqaruar masat për fiaskon e pashmangshme që ai do të pësojë»¹.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 19.

Revizionistët po ecin me shpejtësi drejt greminës. Kush dëshiron të shpëtojë nga katastrofa, duhet ta ketë të qartë se ka ardhur momenti për të vendosur përfundimisht, për t'u hedhur në një luftë të guximshme e pa rezerva kundër revizionistëve modernë. Pritja, ngurrimi, shpresat dhe iluzionet për pajtim e unitet me revizionistët janë tani më të rrezikshme se asnjëherë tjetër dhe dëmtojnë shumë rëndë interesat jetike të komunizmit, të lëvizjes revolucionare.

Duke organizuar mbledhjen fraksioniste e përçarëse të 1 marsit, udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe pasuesit e tyre sfiduan tërë lëvizjen komuniste e punëto-re ndërkombëtare. Marksistë-leninistët kanë plotësisht të drejtë, bile është detyra e tyre e lartë dhe e ngutshme që të forcojnë luftën për demaskimin dhe për shpartallimin e komplotistëve revizionistë, që të ngrenë edhe më lart flamurin e revolucionit, të çlirimit të popujve e të socializmit, flamurin e luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 65 (5161), 18 mars 1965

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 229. Tiranë, 1965

**TË MBROSH ME GJAK LIRINË E PAVARËSINË
E VENDIT TËND ËSHTË PATRIOTIZËM I MADH,
VIRTYT I MADH**

*Nga biseda me një delegacion të PK të Kolombisë
(marksiste-leniniste), i kryesuar nga shoku
Pedro Vaskues¹*

20 mars 1965

Shoku Enver e priti mysafirin përzemërsisht dhe u interesua për shëndetin e tij e të shokëve. Pasi i shprehu keqardhjen se nuk mund të flisnin në ndonjë gjuhë të njohur nga të dy, shoku Enver Hoxha tha:

E rëndësishme është, shoku Pedro, se, megjithëse flasim gjuhë të ndryshme, e kuptojmë shumë mirë njëri-tjetrin, pasi jemi marksistë, kemi një qëllim dhe objektiv të përbashkët, që ne do t'i arrijmë me luftën tonë të vendosur kundër imperializmit, revizionizmit dhe të gjitha rrymave antimarksiste. Prandaj rëndësi kanë, në radhë të parë, idetë tona.

¹ Sekretar i KQ të PK të Kolombisë (marksiste-leniniste), rënë heroikisht në fushën e betejës për çështjen e revolucionit kolombian, më 1968.

SHOKU PEDRO VASKUES: Sidoqoftë ditja e gjuhëve të huaja është një gjë shumë e mirë. Të dish gjuhë të huaja është kulturë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është. Kultura është një pasuri e madhe e gjithë njerëzimit, e krijuar gradualisht qysh nga lindja e shoqërisë e gjer në shkallën e lartë të saj në kohën tonë. Mendimi njerëzor nuk është zhvilluar vetëm pas daljes së doktrinës së Marksit, por kjo doktrinë e madhe i kanalizoi dhe i kristalizoi mirë mendimet njerëzore. Jo vetëm kaq, por marksistët janë ata që dinë ta vlerësojnë drejt kulturën botërore, të pastrojnë në të «hauret e Avgjisë»¹. Duke shtënë në dorë armën e marksizëm-leninizmit, njerëzimi mund ta kuptojë më drejt ç'është e mirë dhe ç'është negative në kulturën e madhe botërore, cila është ana pozitive, progresiste e mendimit njerëzor që të jep hov të ecësh përpara.

Duke iu përgjigjur pyetjes së shokut Enver se si po i duket Shqipëria, mysafiri foli për përshtypjet shumë të mira që kishte nga vizitat nëpër vendin tonë dhe shprehu ndjenjat e respektit të thellë për PPSH dhe vijën e saj të drejtë, parimore, marksiste-leniniste. Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju falënderoj për vlerësimin që u bëni Partisë sonë dhe popullit shqiptar. Ne, komunistët shqiptarë, me sa mundemi, përpiqemi për çështjen e përbashkët dhe e quajmë luftën tonë një pjesë modeste të luftës kolosale

¹ Sinonim i papastërtisë së madhe. Sipas mitologjisë greke, për të pastruar hauret, shumë të pista të mbretit Avgji, u desh të lëshohej lumi.

që bëjnë të gjitha forcat revolucionare marksiste-leniniste në botë. Ju thatë se për udhëheqjen me sukses të luftës së popujve, ne duhet të shfrytëzojmë edhe eksperiencën kolektive. Kjo është e drejtë. Ne e ndiejmë shumë nevojën për të marrë eksperiencë nga të gjitha partitë marksiste-leniniste, edhe nga partitë marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine. Sot, kudo në botë, vendimtare për fitoren është lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Për këtë po luftohet kudo. Edhe në kontinentin amerikan, veçanërisht në Amerikën e Jugut, gjendja është shumë revolucionare, kurse në Evropë, siç mendojmë ne, revolucioni ka pësuar goditje shumë të rënda. Detyra e madhe internacionaliste e të gjithë marksistëve është që, duke forcuar kudo luftën e tyre, të zgjojnë dhe të rritin hovin revolucionar edhe në Evropë.

Revizionistët modernë paraqiten aktualisht si një forcë e madhe, ashtu sikurse paraqitet edhe imperializmi amerikan, i egër, provokator, agresor, por në bren dinë e tyre ata janë të dobët dhe vazhdimisht po dobësohen.

Të marrim revizionizmin hrushovian. Ky u shfaq me tërë rrezikshmërinë e tij në Kongresin e 20-të të PK të BS. Qysh prej asaj kohe ne shohim jo rënie, por një rrokullisje të tij drejt greminës. Kjo nuk është një formulë agjitative jona, e komunistëve, por kështu është realiteti. Në Kongresin e 20-të të PK të BS revizionistët modernë hrushovianë morën frerin në dhëmbë dhe nisën të ngjiteshin në kursin e tradhtisë, duke menduar se nuk do të gjenin pengesë. Duke i mbështetur shpresat te demagogjia e tyre e madhe, te forca ekonomike

dhe ushtarake e madhe e BS, te prestigji i tij si shteti i parë socialist, të prestigji i PK të BS në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, revizionistët modernë kishin krijuar bindjen se vija e tyre reformiste, revizioniste do të shkiste si në gjalpë. Të gjitha këto, si dhe pikëpamjet e shovinizmit të shtetit të madh, i bënë ata që të nënvleftësonin forcën kolosale të marksizëm-leninizmit, të viheshin kundër tij dhe të bëheshin armiq të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ata kishin edhe bindjen se imperializmi botëror, veçanërisht ai amerikan, të cilin e mendonin si pikëmbështetje dhe aleat të mundshëm për shkatërrimin e socializmit dhe mbytjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare, do të binte pa vështirësi në ujdi me pikëpamjet e tyre mbi bashkëzistencën paqësore, çarmatimin e përgjithshëm e të plotë, zgjidhjen e problemit gjerman, ndarjen e zonave të influencës në botë etj. Ata ishin të bindur për këtë, sepse mendonin (dhe këtu nuk mendonin gabim) që anti-komunizmi i tyre puqej me qëllimet e imperializmit amerikan.

Mirëpo punët nuk shkuan si menduan ata, por krejt ndryshe. Në qoftë se i hedhim një vështrim të shpejtë gjithë aktivitetit të Hrushovit dhe njerëzve të tij, nuk mund të mos kujtojmë se si ai u mobilizua në këtë rrugë tradhtare me diskure, me shëtitje, me bisedime «mbi leverdinë» e bashkëpunimit me imperializmin dhe duke goditur rezistencën e partive marksiste-leniniste e të elementëve revolucionarë që do t'i dilnin përpara. Hrushovianët ishin në ethe që ta realizonin sa më shpejt vijën e tyre, sepse e parashikonin luftën dhe rezistencën që do të kishin nga partitë e tjera marksiste-leniniste.

niste. Dhe këto nuk munguan. Kundërshtimet që iu bë- në kësaj tradhtie nga Partia jonë dhe nga partitë e tjera që qëndrojnë në pozitë e marksizëm-leninizmit vunë gurë në rrotat e makinës revizioniste. Kundër kësaj goditjeje që pësuan, revizionistët hrushovianë nisën të përdornin të gjitha metodat, që nga përkëdheljet e gjer te komplotet. Këto natyrisht, shkuan kreshendo, por marksistët nuk u trembën, prandaj revizionistët nuk patën sukses. Gjatë kohës kur vepronin ata, vepronte njëkohësisht, në të kundërtën e ideologjisë së tyre, edhe marksizëm-leninizmi dhe lufta jonë ua çori maskat atyre. Me një fjalë, politika dhe ideologjia e hrushovianëve pësuan disfatë, u penguan seriozisht dhe u demaskuan.

Sa më e fortë të jetë lufta jonë, aq më shpejt do të bëhen diferencimi dhe shkatërrimi i revizionistëve. Prandaj ata duan qetësi, pushimin e polemikës, sepse nuk i qëndrojnë dot përballë luftës sonë. Pra, po ta gjykojmë gjendjen e armiqve tanë revizionistë, ajo është në rënie. Kjo i detyroi revizionistët të heqin udhëheqësin dhe ideologun e tyre kryesor, Hrushovin. Kjo, natyrisht, ishte një humbje e madhe për ta dhe një fitore e madhe për ne, fitore e cila u arrit nga lufta e marksistë-leninistëve.

Revizionizmi është armik jo vetëm i unitetit të marksistë-leninistëve, por edhe i unitetit të vetë revizionistëve. Revizionizmi në vetvete përmban gangrenën, ai është pjellë e ideologjisë borgjeze, e cila ngjall e zhvillon mosmarrëveshje në gjirin e vetë revizionistëve. Prandaj revizionistët hrushovianë dështuan në mendimet se gjatë zbatimit të vijës së tyre do të gjen-

deshin në unitet të plotë me njëri-tjetrin, se ne do të na shpartallonin. Ata as na shkatërruan, as na dobësuan, përkundrazi, ne u bëmë më të guximshëm dhe fituam një eksperiencë kolosale në luftën kundër tyre. Por fakti është se lëvizjen komuniste ndërkombëtare ata me të vërtetë e përçanë. Tani uniteti ekziston i çeliktë vetëm midis atyre partive që mbështeten fort në marksizëm-leninizmin. Kudo në botë po ngrihen të gjithë komunistët konsekuentë dhe po bashkohen në një unitet të vërtetë. Në këtë drejtim ne po fitojmë terren, kurse revizionistët po shkojnë drejt shkatërrimit. Këtë ua shkakton vija e tyre revizioniste dhe lufta e partive marksiste-leniniste. Ata vërtet e hoqën Hrushovin, por këtë e bënë me qëllim që të vënë në jetë disa taktika të reja.

Duke e ndierë edhe vetë se marksistë-leninistët nuk do të gënjuheshin me heqjen e Hrushovit, revizionistët modernë sovjetikë vazhduan luftën demagogjike. Por edhe kësaj demagogjie partitë marksiste-leniniste iu përgjigjën me një luftë parimore konsekuente, e cila ua prishi revizionistëve planet e shpresat dhe njëkohësisht bëri që ata të humbasin të ashtuquajturin unitet midis tyre. Në radhët e revizionistëve filluan të veprojnë forca centrifuge. Revizionistët italianë, për shembull, nuk kanë më respekt për revizionistët sovjetikë, kurse revizionistët si Gomulka, Ulbrihti e Novotni kanë kontradikta me revizionistët sovjetikë, bile të mëdha, por ka akoma edhe gjëra që i lidhin me njëri-tjetrin. Të gjithë këta janë po aq shovinistë sa edhe revizionistët sovjetikë, por ua kanë nevojën këtyre dhe njëri-

-tjetrit, ashtu siç kanë shumë nevojë për ta edhe revizionistët sovjetikë.

Tani shohim që udhëheqësit e rinj sovjetikë po synojnë të konsolidojnë stanin revizionist, por shkopi i tyre i dirigjentit është thyer. Për një gjë të tillë flet fare qartë edhe komunikata e mbledhjes së 1 marsit, që dëshmon për një disfatë të plotë të revizionistëve. Qëllimet që kërkonin të arrinin revizionistët me mbledhjen që caktoi Hrushovi nuk u arritën. Partitë tona nuk shkuan në këtë mbledhje. Kjo që për ta një disfatë e madhe. Ata nuk e mblodhën dot komisionin e redaktimit, nuk i dhanë dot komunikatës ngjyrën që dëshironin për të nxjerrë një program të ri në luftën kundër nesh. Ata e pohuan vetë se mbledhjen e 81 partive nuk e bënë dot. Pra edhe mbledhja, edhe komunikata që përpiluan ishin një disfatë për ta.

Edhe në ato pika që përbëjnë vijën e tyre kryesore, si mbi bashkekzistencën paqësore etj., për të cilat janë dakord të gjithë revizionistët, prapëseprapë nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet organizativ dhe unitet veprimi në mes tyre, sepse në gjirin e revizionizmit ka tendenca të shumta.

Ne shohim qartë se në vijën e tyre të përgjithshme kursi i revizionistëve lëviz në drejtim të imperializmit. Ata mendojnë se nga imperializmi ose kapitalizmi botëror do të trajtohen si partnerë, kurse në fakt po i përdorin vetëm si shërbëtorë. Rruga e tradhtisë që ndjekin revizionistët po i çon drejt kapitullimit dhe diskreditimit të plotë. Kjo duket e do të duket gjithnjë e më shumë në platformën kombëtare, por ne po e shohim edhe në platformën ndërkombëtare,

sidomos në marrëdhëniet midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë. Këta të fundit u lëshuan gishtin amerikanëve, të cilët tani u kanë kapur krahun, po i komprometojnë dhe njëkohësisht vazhdojnë presionet ndaj tyre.

Duke qenë se pozitat e revizionistëve modernë sa vijnë dhe dobësohen, gjë që reflektohet në dobësinë politike, ideologjike dhe ekonomike të vendeve të tyre, për ne marksistë-leninistët krijohet vazhdimisht një situatë e favorshme, që pasqyrohet edhe në ndryshimet që ndodhin brenda vendeve revizioniste. Ne besojmë se në Bashkimin Sovjetik ka bolshevikë të vërtetë që mendojnë për organizimin e luftës kundër klikës revizioniste që është në pushtet. Është e vërtetë që lëvizja e tyre po ecën ngadalë, por topi me borë, duke u rrokullisur poshtë, vazhdimisht do të rritet dhe përpara ortekut marksist-leninist revizionistët do t'i presë një fund i tmerrshëm. Ne kemi besim te marksistët e vërtetë sovjetikë dhe të vendeve të tjera, ku sundojnë revizionistët, se me punën e tyre do të bëjnë që popujt revolucionarë të këtyre vendeve të zgjohen, nëse i ka zënë gjumi, dhe të ngrihen në revolucion.

Revizionistët, pra, janë dobësuar dhe një nga faktorët që e ka shkaktuar këtë dobësim është lufta e marksistë-leninistëve në botë, luftë kjo e pandërprerë, aktive dhe jo e fjetur siç e duan revizionistët. Pasardhësit e Hrushovit si dhe ai vetë përpiqen me zell për pushimin e polemikës. Por ne mendojmë se gjersa do të ekzistojë revizionizmi, polemika me ta nuk mund e nuk duhet të pushojë. Kjo polemikë duhet të jetë e përditshme, në mënyrë që revizionistët të mos kenë kohë

të marrin frymë. Prandaj për çdo veprim të tyre anti-marksist ne duhet t'i demaskojmë ata.

Në këto situata, kur lëvizja revolucionare në botë po ngrihet, kur politika e revizionistëve modernë ka pësuar disfatë edhe imperializmi, që ka në natyrën e tij grabitjen, shtypjen dhe agresionin, po dobësohet, ka pësuar e po pëson gjithashtu një disfatë të madhe dhe po demaskohet vazhdimisht. Politika e koordinuar e imperialistëve dhe e revizionistëve nuk mund të shuan- te luftën nacionalçlirimtare që po merr vrull në të gjitha kontinentet, veçanërisht në Amerikën Latine, në Azi dhe në Afrikë. Këtë nuk mundi ta bënte as politika re- vizioniste e «bashkekzistencës paqësore», as ajo e «bo- tës pa armë» etj. Këto u hodhën poshtë nga marksistë- -leninistët, lufta e të cilëve kundër revizionizmit dhe imperializmit mori çdo ditë e më shumë përpjesëtime të gjera. Edhe vetë kreu i imperializmit, imperializmi ame- rikan, tani ndodhet në situata të vështira. Ai është i detyruar të godasë, ku mundet dhe të mbajë ndezur vatra lufte.

Çështjet, pra, shkojnë ashtu si i kemi parashikuar ne. Aktualisht asistojmë në një përçarje të brend- shme të grupimeve revizioniste, por, nga ana tjetër, edhe në një përçarje të kampit imperialist. Në mes im- perializmit amerikan dhe atij francez, për shembull, ka kontradikta të thella.

Borgjezia kapitaliste franceze është revoltuar nga veprimet e amerikanëve dhe kërkon t'u shpëtojë zinxhi- rëve të imperializmit amerikan. Por merita për përçar- jen e kampit imperialist nuk qëndron te kapitalizmi francez, por veçanërisht te lufta e madhe e marksistëve

dhe e popujve revolucionarë të botës. Kjo luftë i sjell këto diferencime të mëdha dhe thellime të kontradiktave në gjirin e imperializmit. Ky është një proces i tërë. Ne shikojmë se tani NATO-ja nuk është ajo e para, sepse ka një rivalitet të fortë në botën kapitaliste. Amerikanët në Evropën tonë plakë po përpiqen të forcojnë Bonin, i cili është mbështetja e tyre kryesore në luftën kundër marksizëm-leninizmit e vendeve socialiste dhe mjet presioni kundër revizionistëve sovjetikë për t'i detyruar këta të gjunjëzohen dhe t'i bëjnë edhe më tej lëshime imperializmit amerikan, për ta shitur RD Gjermane, kurse Dë Golin ta izolojnë. Nga ana e tij Dë Goli përpiqet të krijojë aleanca të reja e po të mundë të lidhet edhe me Gjermaninë Perëndimore për të mënjanuar influencën amerikane nga Evropa. Kësisoj Gjermania e Bonit është bërë për fuqitë imperialiste si një vajzë e bukur me maskë, por që përbrenda në fakt është një dem i koracuar.

Në këto situata, mund të themi se imperializmi nuk gjendet në apogjeun e tij, sidomos në Evropë. Përkundrazi, ai gjendet në pozita të vështira dhe nuk është në gjendje të bëjë dot luftë, sepse që të bësh luftë duhet të jesh i përgatitur, i lidhur në aleanca. Pikërisht këtë përpiqen të bëjnë tani imperialistët, të lidhin aleanca me njëri-tjetrin.

Aktualisht të gjitha forcat e imperialistëve dhe të revizionistëve janë përqendruar në Azi, duke vënë në shenjë Kinën me synimin që ta bëjnë me çdo kusht të tyren. Por kur ke të qartë vijën marksiste-leniniste, ke të qartë interesin e atdheut, interesin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të luftës për liri, atëherë qar-

tësia të largon nga çfarëdo frikë e lëkundje, të jep besim të plotë në vetvete, të bën të qëndrosh e të mbrosh me konsekuencë fitoret e arritura e të mos biesh as në prehrin e imperializmit amerikan, as në atë të revizionistëve hrushovianë.

Le të marrim partinë tuaj. Mos vallë ngaqë keni në vendin tuaj një borgjezi të fortë dhe imperializmi amerikan ka hedhur ganxhat, ngaqë keni kundërshtarë të tërbuar revizionistët, apo ngaqë një pjesë e mirë e studentëve kolombianë janë të infektuar nga një frymë jo e drejtë, ju duhet të lëkundeni? Në asnjë mënyrë! Këto pengesa nuk ju lëkundin. Vështirësitë vërtet i keni të mëdha, por ato nuk mund e nuk duhet ta pengojnë luftën revolucionare të partisë suaj. Ju e dini më mirë nga ne gjendjen në vendin tuaj, por në situatat revolucionare dhe të vështira që keni përpara, mendoni kurdoherë ruajtjen e partisë nga rrymat e huaja ideologjike dhe nga goditjet e çfarëdollojta të armikut.

Forca e partisë suaj qëndron në radhë të parë në mbështetjen dhe në lidhjet e ngushta me popullin, me masat e klasës punëtore dhe të fshatarësisë revolucionare. Natyrisht, nuk duhet lënë pas dore as puna me studentët për të luftuar atë frymë jo të shëndoshë që ekziston sot në radhët e tyre. Studentët janë njerëz me kulturë, ata kanë besim dhe kurajë në vetvete dhe, kur bëhen të ndërgjegjshëm, luftojnë; puna është se kush i udhëheq. Ne kemi besim se vija e drejtë e partisë suaj, në mos sot, nesër, do t'i bindë ata që janë infektuar nga idetë e gabuara, në mos të gjithë menjëherë, dalngadalë. Ne mendojmë se çfarëdolloj influence që do të ushtrohet mbi ta nga ideologjitë e huaja antiprole-

tare, nuk mund t'i gënjejë për shumë kohë, sepse, nuk mund të mashtrohen gjatë njerëzit që ngrihen në revolucion për të shpëtuar popullin. Idetë e shtrembra, që kanë depërtuar në mendjet e disa njerëzve, sado joshëse që të duken në fillim, nuk mund të zënë rrënjë, sepse gjatë zhvillimit të luftës, do të vërtetohet që ato nuk janë në baza të drejta marksiste-leniniste, gjë që do të thotë se nuk lidhen me aspiratat e vërteta të popullit, prandaj dhe nuk mund të kenë sukses.

Për sa i përket eksperiencës sonë mund të themi se kur filluam Luftën Nacionalçlirimtare, kushtet i kishim disi më ndryshe nga tuajat. Ku qëndronin këto veçori, të cilat Partia jonë i njohu dhe i shfrytëzoi me sukses? Së pari, borgjezia jonë nuk ishte e organizuar si juaja, ajo ishte akoma e dobët, porsa kishte filluar të rritej politikisht. Së dyti, ne na favorizonte edhe momenti nacional, kur në plan të parë kishte dalë nevoja e luftës kundër pushtuesit të huaj. Prandaj Partia jonë e re, duke përcaktuar një vijë të drejtë në përshtatje me kushtet konkrete, e bëri popullin me vete dhe ishte e sigurt se do ta fitonte luftën, se do të kapërcente çdo vështirësi. Së treti, ne kishim ideologjinë marksiste-leniniste, stalinizmin — leninizmin e kohës, që e përvetësuam, ia futëm edhe popullit në gjak e në shpirt, prandaj ai luftoi me vendosmëri për vijën e drejtë të Partisë, kishim gjithashtu eksperiencën e Bashkimit Sovjetik, ndihmën e tij si faktori kryesor i jashtëm.

Kurse ju keni veçoritë tuaja konkrete, keni vështirësitë tuaja, bile shumë serioze, por megjithatë do të fitoni, se vijën e keni të drejtë dhe nuk jeni vetëm. Pothuajse në të gjitha vendet e Amerikës Latine po kri-

johen parti të reja marksiste-leniniste. Rreth tyre po grumbullohen forca të shëndosha, si dhe po organizohet lufta e armatosur kundër armiqve. Rëndësi ka çështja që partitë marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine të lidhen me njëra-tjetrën, me qëllim që propaganda dhe diversioni revizionist të goditen kudo në mënyrë të organizuar. Një rol të veçantë gjatë luftës së partisë luan bërthama e saj, udhëheqja. Kjo duhet të jetë e qartë, e fortë, konsekuente dhe të karakterizohet nga uniteti i çeliktë. Le të jetë e vogël, e paktë në numër një parti, rëndësi ka përbërja e udhëheqjes së saj, që elementët e udhëheqjes të jenë njerëz të vendosur e parimorë, me gjykim të thellë marksist-leninist, që të dallojnë kryesoren nga jo kryesorja, të rëndësishmen nga e parëndësishmja, të drejtën nga e shtrembra. Në një situatë ideologjike si kjo që ekziston sot në lëvizjen komuniste botërore, udhëheqësit e partive marksiste-leniniste nuk duhet të priren kryesisht pas gjërave të vogla që ndodhin, por, pa i injoruar ato, të kapen fort pas çështjeve të mëdha principiale që preokupojnë kauzën tonë të madhe. Ne i kemi vënë kurdoherë rëndësi kësaj çështjeje dhe jeta ka vërtetuar se e kemi pasur shumë drejt. Populli ynë thotë një fjalë: «Peshku qelbet nga koka». Ja ç'ngjau në Bashkimin Sovjetik! Në udhëheqjen e partisë e të shtetit sovjetik lindi revizionizmi, që andej u zhvillua e u përhap në gjithë trupin.

Revizionistët hrushovianë u orvatën të likuidonin udhëheqjet marksiste në shumë parti dhe në vend të tyre të sillnin revizionistët. Atje ku ata nuk mundën ta bënë dot një gjë të tillë, u përpoqën të korruptonin udhëheqjet ekzistuese, të krijojnë në to tendenca të

ndryshme dhe, atje ku mundën, i krijuan. Kurse në partitë tona marksiste-leniniste atyre nuk u eci, sepse në udhëheqjet tona ka pasur dhe ka unitet parimor marksist-leninist, që u provua e u kalit në luftë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka mbi 20 vjet që po lufton me titistët. Kemi luftuar dhe po luftojmë edhe kundër agjentëve të fshehtë të imperializmit. Tani po bëjmë një luftë të ashpër edhe me revizionistët hrushovianë, dhe në këtë mënyrë vazhdimisht e kemi pastruar Partinë tonë nga të lëkundurit, nga armiqtë e fshehtë dhe nga njerëzit e pavendosur. Ne kurdoherë kemi qenë përpara situatave revolucionare, përpara vështirësish të shumta dhe pikërisht në to është provuar se kush do të duronte e kush do të thyhej. Kishte edhe elementë që kishin gabuar, por që me punën e Partisë mund të ndreqeshin. Dhe në fakt shumë i kemi ndrequr, i kemi shpëtuar dhe ka nga ata që sot janë edhe në forume udhëheqëse të organizatave të Partisë.

Ne ju flasim hapur dhe sinqerisht se jemi krenarë për luftën e Partisë Komuniste të Kolombisë (marksiste-leniniste) dhe të të gjithë shokëve marksistë-leninistë që luftojnë në Amerikën Latine për çështjen e madhe të popujve, të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë i kupton shumë mirë vështirësitë që keni përpara, prandaj ka një admirim të veçantë për luftën dhe përpjekjet e partisë suaj. Sigurisht, është vështirë të luftosh në kushtet e vendit tuaj. Ju jeni duke organizuar partinë nën tytat e armëve të reaksionit, jeni vazhdimisht nën tensionin e arrestimit, të burgjeve dhe të vrasjeve. Kur futesh plotësisht në ilegali-

tet, nuk do të thotë të qëndrosh në pasivitet, por, duke pasur armët në dorë, të qëllosh mbi armikun që të del përpara. Pra, duhet të zhvillohet patjetër lufta me armë, sepse lufta e armatosur kundër armiqve i lan hesapet. Ndryshe është çështja në kushtet e legalitetit.

Prandaj është e nevojshme të njihen mirë të gjitha llojet e luftës dhe problemet që lidhen me to, sepse secila ka rëndësinë e vet. Komandimi i drejtë i luftës së armatosur, lufta në ilegalitet, puna e partisë me fshatarët, me punëtorët, kombinimi i luftës së armatosur me grevat politike dhe ekonomike, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, me studentët etj., janë probleme të çdo partie marksiste-leniniste në vendet kapitaliste. Rëndësi të madhe ka gjithashtu futja e anëtarëve të partisë në lëvizjen sindikale, ashtu siç na mëson Lenini. Partitë marksiste-leniniste të vendeve kapitaliste duhet të vënë dorë në sindikatat për organizimin e klasës punëtore. Në këto situata ato duhet të luajnë rolin e pararojës së klasës punëtore. Por në asnjë mënyrë nuk lejohet që të lihet mënjanë fshatarësia, sepse edhe kjo është një forcë e madhe revolucionare dhe e shtypur. Këtë ne e provuam me fshatarësinë tonë, që vërtet ishte e prapambetur nga pikëpamja ekonomike dhe kulturore, por ishte tërë zjarr revolucionar dhe shquhej për pjekurinë e saj të madhe patriotike revolucionare. Ne u futëm në luftë me një klasë punëtore në formim e sipër, por kishim fshatarësinë, e cila mbajti mbi supë një barrë të madhe dhe qëndroi e patundur në Luftën Nacionalçlirimtare.

Ne kemi mendimin se e tillë është edhe fshatarësia e vendit tuaj. Çështja që fshatarësia të jetë e përparuar

nuk mund e s'duhet të vlerësohet nga fakti që të jetë e veshur si evropianët. Nga sa kam lexuar unë, në vendet e Amerikës Latine ka akoma varfëri e prapambetje të madhe ekonomike, por fshatarët amerikano-latinë kanë tradita të mëdha patriotike. Kolonizatorët spanjollë i konsideronin të egër popujt e Kilit e të Tokës së Zjarrtë, sepse këta qëndruan burrërisht dhe i rezistuan zgjedhës së huaj. Por të mbrosh me gjak lirinë e pavarësinë e vendit tënd, të luftosh për ekzistencën e vendit e të popullit tënd, nuk është egërsi, por patriotizëm i madh, virtyt i madh.

Lidhjet e partisë me masat kanë rëndësi shumë të madhe. Gjatë kohës së luftës bazat tona të punës ilegale në Tiranë e kudo ne i kishim në shtëpitë e popullit. Sado që qyteti ishte mbushur nga të katër anët me agjentë, fashistë, karabinierë, milicë etj., njerëzit e thjeshtë të popullit rreth e rrotull, kudo ku punonin dhe jetonin, kur e kuptonin se komunistët po bënin mbledhje në një vend, vetë, vullnetarisht, bënin roje për t'i ruajtur. Në rastet kur kapej ndonjëri prej këtyre njerëzve të thjeshtë nga agjentët e armikut dhe kur pyetej se çfarë bënte në atë kohë në rrugë, ai i përgjigjej: «Ja, po pres djalin të më vijë nga puna», zihej me milicin, bile edhe bërtiste, me qëllim që ta dëgjonin shokët më tej që po bënin mbledhjen dhe të kishin kujdes të ruheshin se armiku ishte pranë tyre. Masat e dinin që komunistët luftonin për lirinë e popullit, prandaj dhe i mbronin.

Ne dëshirojmë t'i forcojmë lidhjet midis dy partive tona. Për ne është një kënaqësi e veçantë, por njëkohësisht edhe një ndihmë e madhe kur ju, miq, vini në

vendin tonë. Marksistë-leninistët kanë shumë nevojë për ndihmën e njëri-tjetrit, sepse çështja për të cilën luftojnë ata nuk është diçka e izoluar dhe specifike për çdo vend, por e përbashkët. Prandaj duhet të përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit, jo vetëm nëpërmjet materialeve të ndryshme të partive, por edhe me kontakte e me bisedime të shpeshta. Natyrisht eksperiencia e tjetrit nuk duhet zbatuar shabllon, por sipas kushteve konkrete të secilit vend.

Edhe ne, komunistët shqiptarë, ndonëse militojmë në një vend të vogël siç është Shqipëria, me sa mundemi, do t'i ndihmojmë me të gjitha mënyrat shokët revolucionarë të vendeve të tjera. Duke u nisur nga pozita krejt shoqërore dhe internacionaliste, e kemi për detyrë t'ua japim atyre këtë ndihmë, sepse luftojmë për një çështje të përbashkët. Komunistët, kudo ku revolucionin nuk ka fituar akoma, nuk duhet të lihen të izoluar. Kur bien bombat amerikane në Vietnamin e Veriut, ne shqetësohemi njëllor sikur bien mbi vendin tonë. Kur çlirohen pjesë të tëra të territorit në Vietnamin e Jugut, ne gëzohemi e krenohemi njëllor si vëllezërit vietnamezë. Kur në vendet e Amerikës Latine rriten forcat marksiste-leniniste, kur partia juaj korr suksese etj., të gjitha këto janë fitore për të gjithë ne, sepse në këtë mënyrë fiton çështja e popujve dhe e marksizëm-leninizmit, dobësohet imperializmi dhe shkon drejt shkatërrimit.

Shqipëria dhe komunistët shqiptarë nuk janë të izoluar. Me ne janë të gjithë popujt liridashës dhe revolucionarët e botës. Lufta revolucionare që zhvillojnë ata kundër imperializmit, kolonializmit, reaksionit dhe

kundër revizionizmit ndihmon që Shqipëria të qëndrojë e patundur në rrugën e saj. Natyrisht, në radhë të parë, garanci për këtë është vetë populli ynë, i cili vazhdimisht qëndron vigjilent e sypatrembur, sepse Partia e Punës e udhëheq atë në rrugë të drejtë. Por edhe fakti që sot në botë janë rritur forcat revolucionare marksiste-leniniste ndihmon që Shqipëria socialiste të qëndrojë e të përparojë në rrugën e socializmit. Liria e Shqipërisë është skuqur vërtet me gjakun e popullit tonë, por te liria jonë ne shohim edhe gjakun e komunarëve të Parisit, edhe gjakun e punëtorëve të Çikagos, të heronjve të Revolucionit të Madh të Tetorit, të miliona e miliona të rënëve në luftën e madhe që bënë popujt e botës gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër fashizmit, edhe gjakun e luftëtarëve revolucionarë të vendeve të Amerikës Latine e të çdo vendi tjetër. Mbi këto themele është ngritur revolucioni, mbi to është ngritur edhe Shqipëria e vogël socialiste. Prandaj kanë rëndësi të madhe lidhjet dhe ndihma internacionaliste. Është për këtë arsye që revizionistët modernë përpiqen të shkatërrojnë këto lidhje, këto forca, por ata nuk ia kanë arritur dhe nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit të tyre.

Ne ju falënderojmë për vizitën që bëtë në Shqipëri, por kjo të mos jetë e para dhe e fundit. Qoftë ju, qoftë shokët tuaj, kur të dëshironi, ejani në Shqipëri. Ne i kuptojmë hallet dhe shqetësimet tuaja të mëdha, por një qëndrim juaji ose i shokëve tuaj në vendin tonë do të shërbente edhe për punë, domethënë për bisedime, edhe për t'u çlodhur. Ne do t'ju presim kurdoherë me krahë hapur, me zemër të ngrohtë, si bashkëluftëtarë, shokë dhe miq të ngushtë. Ne ju sigurojmë,

dhe këtë ua thoni edhe shokëve tuaj, udhëheqjes së partisë suaj, se te Partia e Punës e Shqipërisë dhe te populli shqiptar ju keni e do të keni miq besnikë të marksizëm-leninizmit, që do të luftojnë gjer në fund pa u përkulur për mbrojtjen dhe pastërtinë e tij.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**SHQIPËRIA SOCIALISTE I KA KRYER DHE DO T'I
KRYEJË DERI NË FUND DETYRAT E SAJ
PËR TRIUMFIN E MARKSIZËM-LENINIZMIT**

*Nga biseda me delegacionin e partisë e të qeverisë
së Kinës, të kryesuar nga Çu En Lai*

27-28 mars 1965

I dashur shoku Çu En Lai,

Të dashur shokë të delegacionit kinez,

Ardhja juaj te ne ka shkaktuar një gëzim të madh. Populli dhe Partia jonë janë në festë, sepse për të dytën herë¹ ata kanë në mes tyre shokun Çu En Lai. Shqipëria dhe Kina janë të lidhura ngushtë në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit dhe luftojnë, rrojnë, fitojnë, përparojnë të dyja së toku.

Ne e ndjekim çdo ditë zhvillimin e vullshëm dhe plot sukses të vendit tuaj të madh, politikën e brendshme dhe të jashtme të partisë dhe të qeverisë suaj, luf-

¹ Republikën Popullore të Shqipërisë për herë të parë ai e vizitoi në janar të vitit 1964.

tën tuaj kundër imperializmit botëror dhe kundër revizionizmit modern.

Të gjitha delegacionet tona që kthehen nga Kina, flasin me entuziazëm për çdo gjë, veçanërisht e mbi të gjitha për miqësinë e ngrohtë e të sinqertë që ushqen populli kinez për popullin shqiptar. Të gjitha këto na gëzojnë e na forcojnë, na japin mundësi të ndjekim nga afër jetën dhe luftën e vrullshme të popullit dhe të partisë suaj.

Evenimente të rëndësishme ngjajnë sot në botë, probleme të koklavitura dalin për popujt, luftëra të karaktereve të ndryshme, me intensitete të ndryshme po zhvillohen, aleanca lidhen e zgjidhen, udhëheqës rrëzohen, të tjerë u zënë vendin, intriga thuren e shturen nga armiqtë imperialistë dhe aleatët e tyre, revizionistët dhe reaksionarët e tjerë të të gjithë botës. Por, mbi të gjitha këto, ne shohim se çështja e drejtë e popujve, e ndritur nga doktrina e marksizëm-leninizmit, ecën përpara dhe, si një peshë vigane, shtyp nën vete, pa mëshirë botën e vjetër që po kalbëzohet dhe jep shpirt, duke bërë që të lindë e të forcohet e reja. Partia dhe populli ynë, duke parë se kjo luftë zhvillohet në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit e kanë për nder dhe për detyrë të japin kontributin e tyre modest në këtë luftë kolosale. Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia jonë do t'i qëndrojnë besnikë përjetë marksizëm-leninizmit dhe gjithë atyre partive që në veprimtarinë e tyre udhëhiqen kurdoherë nga parimet e paturdura të doktrinës sonë fitimtare. Ne, duke ecur kurdoherë në këtë rrugë, do të jemi kurdoherë së toku dhe do ta forcojmë luftën tonë të përbashkët.

Ardhja juaj këtu dhe shkëmbimi i mendimeve që do të kemi me ju do të na ndihmojnë në forcimin e luftës sonë të shumanshme.

Më lejoni të them disa mendime tonat:

Një nga preokupacionet e Partisë sonë, gjatë periudhës që nga ardhja juaj vjet në Shqipëri, ka qenë konkludimi i projektplanit të katërt pesëvjeçar. Ne kemi synuar që ky projektplan të pasqyrojë sa më drejt vijën e Partisë, të mbështetet në radhë të parë në rezultatet e deritanishme dhe në shfrytëzimin sa më real e racional të mundësive të brendshme, ashtu dhe në përgatitjen tonë në kohën e duhur për t'i vënë me sukses në jetë planet e zhvillimit tonë ekonomik e kulturor.

Kur të gjendet e përshtatshme, një delegacion qeveritar i RPSH mund të vijë në Kinë për të përfunduar marrëveshjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin tonë ekonomik.

Gjatë punës për përpilimin e detyrave të mëdha të ekonomisë sonë, për zhvillimin e drejtë dhe real të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, për harmonizimin e drejtë të investimeve kapitale që kanë një rëndësi të dorës së parë për zhvillimin imediat dhe në perspektivë të ekonomisë sonë socialiste etj., ne jemi udhëhequr nga parimi marksist-leninist i mbështetjes në forcat e brendshme, parim i cili ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë në bazë të politikës sonë për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit. Në projektimin e pesëvjeçarit të ardhshëm ne i kemi vënë rëndësi të madhe zhvillimit të mëtejshëm të industrisë sonë, si sektori vendimtar dhe drejtues i ekonomisë socialiste. Për këtë, një vëmendje të veçantë po i kushtojmë punës që

duhet të bëjmë për shfrytëzimin e burimeve tona të brendshme minerare, për përpunimin e mineraleve në vend, sa më mirë e sa më racionalisht, veçanërisht të mineralit të hekur-nikelit e të ferro-kromit, punës për zhvillimin e energjisë elektrike që është lidhur ngushtë me to, si dhe për përpunimin e mëtejshëm të naftës.

Siç jeni në dijeni, minerali ynë i hekur-nikelit është një nga burimet më të rëndësishme ekonomike të vendit tonë, si nga sasitë industriale dhe rezervat e njohura deri tani, ashtu edhe nga cilësitë e komponentëve të tij. Nevojat e vendit tonë për hekur e çelik janë të shumta dhe kurdoherë në rritje. Për plotësimin e këtyre nevojave, këto lëndë të përpunuara i sjellim nga importi. Mirëpo revizionistët e ndryshëm, si ata polakë dhe çekë, nuk janë korrektë në zbatimin e marrëveshjeve, nuk na i plotësojnë nevojat, nuk na japin sasitë dhe cilësitë e kontraktuara, duke u karakterizuar kurdoherë, në marrëdhëniet me ne, nga një shpirt antimarksist, kapitalist e tregtar. Kjo duket në presionet e vazhdueshme që na bëjnë revizionistët në shumë drejtime. Ata ose s'na marrin sasinë e caktuar të mineralit, ose duan që ne t'u ulim çmimet, ose nuk na japin sasinë e çelikeve, të kamionave etj.

Tani që kemi filluar ndërtimin e uzinës së petëzimit të çelikut në Elbasan, ne kemi hyrë në rrugën e drejtë të zgjidhjes së këtij problemi jetik të ekonomisë sonë. Kjo punë do të shkojë më tej me ngritjen në Elbasan të uzinave të tjera, të cilat në pesëvjeçarët e ardhshëm do të shkrijnë mineralin e hekur-nikelit. Të gjitha këto janë të domosdoshme për jetën e vendit tonë, për sigurimin e zhvillimit konkret, real të ekonomisë

ato janë jetike për ne. Në rast se i realizojmë ato, dhe kemi bindjen e plotë se do t'i realizojmë me forcat tona të brendshme, do të jetë një fitore e madhe për Shqipërinë.

Plotësimin e detyrave të zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste e shohim në kuadrin e gjithë atyre detyrave kolosale të karakterit kombëtar e ndërkombëtar që u dalin vendeve tona dhe që i shërbejnë çështjes së revolucionit e të socializmit në botë. Ne ju sigurojmë se zhvillimi i mëtejshëm në rrugë të drejtë i ekonomisë sonë socialiste nuk ka një qëllim, si të thuash, të një interesi të ngushtë e të mbyllur kombëtar, por një karakter të theksuar e të rëndësishëm ndërkombëtar. Zhvillimi i drejtë, në mënyrë të harmonishme i Shqipërisë socialiste, në këtë Evropë të plakur kapitaliste dhe të degjeneruar nga revizionizmi modern, na duket se merr një rëndësi të veçantë, si shembull i një shteti të vogël socialist në oqeanin e Evropës kapitalisto-revizioniste, që jo vetëm u reziston këtyrë sistemeve shfrytëzuese e skllavëruese, por fiton mbi ta. Vërtet fuqia ekonomike e Shqipërisë është shumë e vogël në krahasim me potencialin e shumë shteteve të tjera, por, pavarësisht nga kjo, Shqipëria socialiste i ka kryer dhe do t'i kryejë deri në fitoren e plotë detyrat e saj si shtet socialist dhe të gjitha fuqitë e saj do t'i vërë totalisht në shërbim të luftës sonë të shenjtë për triumfin e marksizëm-leninizmit, të socializmit dhe të komunizmit, të luftës së paepur kundër imperializmit botëror e atij amerikan në veçanti dhe kundër revizionistëve modernë me ata sovjetikë në krye.

Në luftën për zhvillimin e ekonomisë sonë socia-

liste dhe në orientimin e planit tonë të ardhshëm pesëvjeçar ne mbajmë parasysh të gjitha momentet politike e ideologjike, koniunkturat ndërkombëtare, të priturat dhe të papriturat që mund të rrjedhin dhe sigurisht do të rrjedhin prej tyre. Ne e konsiderojmë vendin tonë në luftë të madhe me armiq të shumtë. Gjatë kësaj lufte, duke luftuar e duke fituar, rritim prestigjin e atdheut tonë, të Partisë sonë dhe të marksizëm-leninizmit, nga i cili udhëhiqemi.

Edhe plani ynë i ardhshëm pesëvjeçar është një përgatitje për luftë në këtë kohë «paqeje» të armatosur e plot luftëra. Mendojmë dhe kemi bindjen se edhe ju mendoni kështu, se brenda këtyre kohërave të turbullta, të kësaj «qetësie» relative, duhet dhe e lyp nevoja urgjente dhe imperative për Republikën e vogël Popullore të Shqipërisë, që kjo të forcojë aftësinë e saj mbrojtëse dhe ritmet e ndërtimit të ekonomisë, sidomos të sektorëve jetikë, për t'u bërë ballë çfarëdo të papriturash të mundshme dhe të luftojë me sukses të plotë edhe në kushtet e rrethimit të egër armiqësor. Ne i kemi kushtuar vëmendje të posaçme përgatitjes ideopolitike dhe ngritjes së gatishmërisë luftarake të forcave tona të armatosura për t'i pasur ato kurdoherë në nivelin e duhur të mbrojtjes së vendit. Teknika ushtarake me të cilën e ka pajisur Partia Ushtrinë tonë Popullore po përvetësohet çdo ditë e më mirë.

Jemi të ndërgjegjshëm se plani ynë i ardhshëm, duke qenë real dhe plotësisht i mundshëm për t'u realizuar, është njëkohësisht shumë i ngjeshur dhe lyp nga ana e popullit dhe e Partisë sonë një mobilizim to-

tal, lyp sakrifica të mëdha. Ne jemi në gjendje t'i bëjmë dhe do t'i bëjmë këto sakrifica dhe shpresojmë se me një mobilizim total do të dalim faqebardhë edhe këtë vit dhe do të shkojmë në Kongres¹ e përpara popullit me rezultate të kënaqshme.

Uniteti i Partisë sonë dhe uniteti Parti-popull, janë më të fortë se kurrë dhe çdo ditë forcohen, kaliten në luftë revolucionare. Ne jetojmë e punojmë të rrethuar nga armiqtë e jashtëm imperialisto-revizionistë. Prandaj popullin, ushtrinë, kufitarët dhe mbi të gjitha Partinë i mësojmë të jenë vigjilentë, kurdoherë vigjilentë, me qëllim që asnjë «qetësi» të mos i gënjejë, por të jenë kurdoherë zgjuar, sepse siç thotë populli «uji fle, por hasmi s'fle».

Pasi e njohu Çu En Lain me rezultatet e kënaqshme të arritura gjatë punës për realizimin e planit të vitit 1964, me entuziazmin, gatishmërinë dhe mobilizimin e madh të masave tona punonjëse për kryerjen e të gjitha detyrave të ngarkuara, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Si e shikojmë ne gjendjen ndërkombëtare, mcsimet që duhet të nxjerrim dhe masat që duhet të marrim në lidhje me zhvillimin e situatave.

Ne mendojmë se Partinë Komuniste të Kinës dhe Qeverinë e RP të Kinës, Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Qeverinë e RP të Shqipërisë zhvillimet e situatës ndërkombëtare nuk i kanë gjetur në befasi, por ato në përgjithësi i kanë parashikuar drejt dhe, duke vepruar në mënyrë revolucionare, kanë ditur të influencojnë në

¹ Kongresi i 5-të i PPSH i zhvilloi punimet në Tiranë nga 1-8 nëntor 1966.

to, të lënë gjurmë të theksuara revolucionare në këto situata, duke nxjerrë përfitime të shumta në forcimin e kauzës së socializmit e të komunizmit, në forcimin e paqes së shëndoshë, në forcimin e luftërave çlirimtare të popujve. Njëkohësisht, lufta e vazhdueshme, e pae-pur, konsekuente, marksiste-leniniste e partive tona ka demaskuar keqas në sytë e popujve të botës dhe të komunistëve natyrën dhe veprimtarinë agresive e luftë-nxitëse të imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, si edhe tradhtinë e madhe të revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye.

Ne mendojmë se karakteristika sunduese e kësaj etape është bashkëpunimi dhe rivaliteti gjithnjë e më i hapur në mes imperializmit amerikan dhe revizionistëve modernë, të udhëhequr nga revizionistët sovjetikë. Imperializmi amerikan ka gjetur te revizionistët hrushovianë aleatë dhe miq për zbatimin me sukses të politikës dhe të strategjisë së tij botërore, për luftën dhe shkatërrimin e kampit të socializmit dhe të komunizmit në përgjithësi, për ndarjen e zonave të influencës në botë, për krijimin e një kolonializmi të ri, të dominuar nga dy fuqitë e mëdha, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik.

Të dy këto fuqi botërore, duke pasur si objektiv të përbashkët luftën kundër socializmit, përpigën njëkohësisht të fitojnë, të ruajnë dhe të forcojnë supremacinë kundër njëra-tjetrës, të forcojnë grupimet e sate-litëve të tyre rreth vetes, të luftojnë grupimet e njëra-tjetrës në drejtimin e shpëputjes mundësisht të aleatëve të tyre, për forcimin e grupimit të gjithsecilit

dhe, në aleancë, të goditin bashkërisht vendet socialiste e, në radhë të parë, Kinën e Shqipërinë.

Aleanca sovjeto-amerikane që po zhvillohet e konkretizohet çdo ditë, natyrisht jo pa vështirësi e kontradikta, në lëmin ndërkombëtar përbën një eveniment politik me rrezikshmëri të madhe për fatet e botës dhe një objektiv të madh për ne për ta luftuar me forcë të madhe. Kjo aleancë po zhvillohet në të gjitha drejtimet, në sferën politike, ideologjike, ekonomike dhe kulturore: Ajo në shumë drejtime është formuluar dhe pranuar në dokumente zyrtare, në traktate, marrëveshje e kontrata, ajo është koordinuar ideologjikisht nga të dy drejtimet dhe në luftë kundër doktrinës marksiste-leniniste. Në të gjitha këto drejtime ne do të jemi dëshmitarë të shtimit të marrëveshjeve, të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të planeve në mes këtyre dy fuqive të mëdha, derisa të arrijnë edhe në traktate të bujshme ushtarake, për «stabilizim të aleancave» të tyre politiko-ushtarake.

Natyrisht, në tendencat e veprimeve të këtyre dy fuqive, që duan të dominojnë botën duke shtypur socializmin, lirinë dhe pavarësinë e popujve, ka ndryshime. Shtetet e Bashkuara të Amerikës veprojnë me zjarr e me hekur, përdorin shantazhin atomik dhe çfarëdolloj presioni, që nga lufta e deri te korrupsioni. Kurse revizionistët sovjetikë, duke iu nënshtruar presionit dhe shantazhit amerikan dhe duke i kundërshtuar veprimet e tyre agresive sa për sy e faqe vetëm me fjalë, përdorin të gjitha mjetet dhe metodat për të krijuar zonën e tyre të influencës, për të vendosur sundimin e tyre mbi popujt. Hëpërhë ata s'i kanë përdorur metodat e luftës së hapur shtypëse, por rruga që

ndjekin, pa dyshim, edhe atje do t'i çojë. Njëkohësisht, këta, duke luftuar socializmin dhe vendet tona, konkretisht, në bashkëpunim dhe në rivalitet të hapur me SHBA-në, mendojnë se do t'ua arrijnë qëllimeve të tyre djallëzore.

Revizionistët sovjetikë, me vijën e tyre të përgjithshme të bashkekzistencës paqësore, nuk mund të mendojnë se do ta evitojnë luftën, por ata kanë qëllim të fitojnë kohë për të luftuar socializmin e vendet tona dhe gjatë kësaj kohe të forcojnë pozitat e tyre botërore në drejtimet që thamë më parë. Revizionistët sovjetikë, është e kuptueshme, që luajnë me zjarrin, sepse për t'ua arritur qëllimeve të tyre djallëzore, duke i lënë të lirë amerikanët të veprojnë me zjarr e me hekur kundër popujve që luftojnë për t'u çliruar dhe për t'u mbrojtur, mendojnë t'i dobësojnë amerikanët ekonomikisht, ushtarakisht dhe politikisht. Nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë veprojnë me të gjitha metodat e tyre për të minuar, korrumpuar, degjeneruar, sunduar e skllavëruar popujt. Por, natyrisht, këto qëllime e veprime të tyre nuk zhvillohen e nuk mund të zhvillohen si duan këta. Forca të tjera kolosale veprojnë në botë dhe këto janë forcat e socializmit, të popujve, të cilat u prishin planet imperialisto-revizionistëve dhe u shkaktajnë atyre disfata të mëdha e të njëpasnjëshme.

Ndërtimi i kësaj aleance të re sovjetiko-amerikane nuk mund të mënjanojë rivalitetin dhe kontradiktat e thella midis tyre, nuk mund të zhdukë ligjin e xhunglës. Përkundrazi, ajo e acaron atë ligj çdo ditë, jo vetëm në mes këtyre dy fuqive imperialisto-revizioniste, njëra Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e formuar me

kohë, tjetra, Bashkimi Sovjetik, që po bëhet e tillë me hapa të vrullshëm, por edhe në mes shteteve të tjera kapitaliste dhe vendeve të tjera ku sundojnë revizionistët modernë, sikurse janë vendet ish-socialiste të Evropës, që gjithashtu po degjenerojnë në vende kapitaliste. Degjenerimi i BRSS dhe i vendeve të tjera ish-socialiste të Evropës solli me vete edhe «ligjin e xhunglës» në mes tyre dhe, të gjithë së toku e veç e veç, po vijnë vërdallë si ujë në pyllin ndërkombehtar, tok me ujë e tjerë imperialistë.

Ne asistojmë aktualisht në fenomene të tilla siç janë ato të dekompozimit të aleancave të vjetra imperialiste në mes tyre, por edhe të dekompozimit të influencës sovjetike në vendet e ish-demokracisë popullore dhe në çarjen e dobësimin e aleancave midis tyre. Pra, të dy grupimet imperialiste dhe revizioniste janë pleksur në kontradikta të pakapërcyeshme, në luftë brenda-përbrenda grupit, me njëri-tjetrin dhe në luftë e në kontradikta të shumta e të pazgjdhshme të jashtme, grupim me grupim.

Këto kontradikta të pakapërcyeshme pasqyrohen në çdo veprim të tyre, ato pasqyrohen në NATO, në OKB, në Tregun e Përbashkët Evropian, në Bashkimin Evropian, në pjesëmarrjen në luftën e Vietnamit, të Laosit e të Kongos, në çështjen gjermane, në Traktatin e Varshavës, në mbledhjen e 1 marsit në Moskë, në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke, në marrëdhëniet e vendeve të «demokracisë popullore» të Evropës në mes tyre, edhe ndaj fuqisë ende dominuese sovjetike.

Ky është një kompleks çështjesh, por që ne duhet

të orientohemi në këtë pyll, të ndjekim mirë fillin, të dalim me konkluzione të drejta dhe të ndërtojmë, në bazë të shkencës sonë të pagabuar marksiste-leniniste, strategjinë dhe taktikën e luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Në përgjithësi ne duhet të themi që tani situatat ndërkombëtare janë në favorin e forcave të socializmit dhe të popujve. Imperializmi në tërësi, dhe veçanërisht ai amerikan, është në dekadencë, ai po humbet terren e po demaskohet me të madhe në të gjitha veprimet e tij. Revizionizmi modern, e veçanërisht revizionizmi hrushovian, që shkaktoi krizën në gjirin e kampit të socializmit e të komunizmit ndërkombëtar, i shkaktoi dëme të rënda çështjes sonë të madhe, por, duke e pranuar këtë fakt, zbulimi, demaskimi dhe lufta e ashpër që i kemi bërë dhe do të vazhdojmë t'i bëjmë kësaj murtaje në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ka bërë që ai të humbasë dita-ditës terren dhe forcë.

Thellimi i kontradiktave, që shkon duke u shtuar në gjirin e fuqive imperialiste, shkakton dobësimin e pandërprerë të imperializmit amerikan, këtij armiku të madh e kryesor. Kontradiktat në gjirin e imperialistëve kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë kurdoherë, gjë që po i bren e po i dobëson, por aktualisht ato janë acaruar shumë.

Vendeve imperialiste, që dolën të dobësuara nga Lufta e Dytë Botërore, iu desh të merrnin veten për një kohë relativisht të gjatë dhe të pranonin me dashje ose pa dashje «ndihmën amerikane», të shoqëruar me dominimin e imperializmit amerikan. Sidoqoftë, për një kohë të gjatë imperializmi amerikan, i ndihmuar edhe

nga ai anglez mundi t'i inkurajojë partnerët e tij të dobësuar nga lufta në aleanca ushtarako-politike, ku ai diktonte ligjin e vet. Me ndihmën e këtyre aleancave, nën ngjyrën e «ndihmës» ekonomike për të rimëkëmbur ekonominë e këtyre vendeve të shkatërruara nga lufta, imperializmi amerikan krijoi bazat e veta në shumë vende kapitaliste të botës. SHBA, njëkohësisht, u diktonin këtyre vendeve për një kohë të gjatë vullnetin e tyre në lëmin e ekonomisë, të investimeve, të tregtisë etj. S'ka dyshim se në këto situata SHBA u diktonin këtyre vendeve mënyrën e jetesës, të mendimit politik dhe ideologjik. Nga ana tjetër, imperializmi amerikan financoi mëkëmbjen ekonomike të Gjermanisë së Bonit dhe siguroi armatosjen gjer në dhëmbë të saj, ringjalljen e militarizmit, të fashizmit dhe të revanshizmit. Në planet e imperializmit amerikan kanë qenë dhe mbeten ideja e veprimi i krijimit të një Gjermanie fashiste të fortë, e cila të jetë aleate e tij deri në fund dhe forca goditëse kryesore kundër socializmit dhe, njëkohësisht, forca frikësuese dhe e shantazhit ndaj aleatëve të tij të lëkundshëm.

Pra, ky rigrupim kapitalist, nën drejtimin absolut të amerikanëve, ishte, natyrisht, një rrezik kërcënues lufte. Ai edhe tani mbetet kërcënues për një luftë agresive botërore, por ajo forcë nuk është më monolite, sikurse ishte më parë.

Tani Franca kapitaliste në NATO qëndron formalisht, ajo ka hyrë në rrugën e kundërshtimit të hapët me imperializmin amerikan. Kapitali i madh francez, i mëkëmbur, nuk mund të durojë darën dhe diktatin amerikan, nuk pranon t'i zihet fryma. Franca e ndien

veten mjaft të fortë për t'u rezistuar SHBA, ndaj këto po hasin në kundërshtimin e saj. Kjo, natyrisht, e ka tronditur dhe e ka dobësuar mjaft forcën ushtarake dhe politike të NATO-s. Kjo situatë pozitive e krijuar, në realitet, nuk është vetëm rezultat i zhvillimit të kapitalit francez, por është rrjedhim direkt i luftës së vendeve tona socialiste dhe i gjithë luftërave nacionalçlirimtare të popujve kundër imperializmit amerikan. Lufta jonë e dobësoi atë dhe kapitali francez shfrytëzoi momentin për të kundërshtuar dominimin e imperializmit amerikan. Ne, marksistët, duhet t'i shfrytëzojmë këtë situatë dhe këtë moment krize të rëndë në gjirin e kapitalizmit botëror. Ne nuk kemi as iluzionin më të vogël për kapitalizmin francez, i cili, megjithëse është në kontradikta të mëdha me imperializmin amerikan, në thelbin e tij është po ai kapitalizëm që ka qenë edhe më parë, me qëllime të njëjta dominuese e me taktika të reja për të luftuar socializmin dhe komunizmin, për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt. Fenomenet e reja në kontradiktat që po shfaqen ndërmjet vendeve kapitaliste, janë parashikuar qysh më parë nga Stalini dhe tani realizohen ashtu siç i kishte parashikuar ai¹.

1 «Nga ana e jashtme duket sikur çdo gjë shkon «mbarë»: Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vënë në grazhd Evropën Perëndimore, Japoninë dhe vende të tjera kapitaliste; Gjermania (Perëndimore), Anglia, Franca, Italia, Japonia, që kanë rënë në kthetrat e SHBA, zbatojnë me servilizëm urdhrat e SHBA. Por do të ishte gabim të mendohej se kjo «mbarëvajtje» mund të vazhdojë «për jetë të jetëve», se këto vende do t'i durojnë përgjithmonë sundimin dhe zgjedhën e Shteteve të Bashkuara

Ne mendojmë se imperializmi amerikan kudo po dobësohet dhe veprimet e tij agresive, të shoqëruara me shantazhin atomik, tregojnë dobësinë dhe jo forcën e tij. Në Evropë ai ka shqetësime të mëdha dhe pozitat e tij dominuese nuk janë stabël. Ai përpiqet të rindërtojë pozita të reja duke u mbështetur fuqimisht, duke u përpjekur të mbahet në strumbullarin më të fuqishëm dhe më agresiv, në Gjermaninë e Bonit.

Gjermania e Bonit, mendojmë ne, është kaporali në Evropën kapitaliste. Amerikanët përpiqen që qeveria revanshiste e Erhardit¹ të qëndrojë në pozitat pro-amerikane dhe për t'ia arritur kësaj bëjnë ç'është e mundur që t'ia plotësojnë kësaj të gjitha kërkesat, dhe sidomos pajisjen me armët atomike. Nga ana tjetër, amerikanët bëjnë çmos që sovjetikët t'i gjunjëzojnë për të arritur në bashkimin e dy shteteve gjermane sipas kushteve të amerikanëve e të revanshistëve të Bonit. Në rast se SHBA ia arrijnë kësaj, ato, rrjedhimisht, kanë forcuar pozitat e tyre në Evropë, kanë kundërbalancuar dobësimin që u ka shkaktuar Franca dhe deri diku e kanë izoluar Francën. Në këtë lodër SHBA synojnë ta izolojnë Francën, ta ndalojnë atë në krijimin e ndonjë aleance efektive me Bonin dhe, në pamundësi që Franca ta arrijë këtë, t'i shkatërrojnë asaj çdo përpjekje për të krijuar aleancat e vjetra me so-

të Amerikës, se ato nuk do të përpiqen të dalin nga robëria amerikane dhe të vihen në rrugën e një zhvillimi të paqarur». (J. V. Stalin, «Probleme ekonomike të socializmit në BRSS», f. 39. Tiranë, 1968).

1 Në atë kohë kancelar i RF Gjermane.

vjetikët, gjë që do ta izolonte Gjermaninë e Bonit dhe, pra, dominimin amerikan.

Në mënyrë përmbledhëse ne mund të themi se SHBA përpiqen të shkatërrojnë synimet e Francës, e cila kërkon të ringjallë aleancat e vjetra me vendet e Lindjes dhe të Evropës Qendrore e Juglindore e, njëkohësisht, të jetë e lidhur edhe me Gjermaninë e Bonit, për të luftuar kështu më mirë komunizmin dhe dominimin amerikan. Kështu Franca përpiqet të përhapë dominimin e saj. Këtë qëllim kanë avancat goliste ndaj vendeve të «demokracisë popullore» të Evropës Lindore, dhënia e kredive e zhvillimi i marrëdhënieve kulturore me to.

Në këto situata vullneti dhe pikëpamjet e anëtarëve të tjerë të NATO-s nuk llogariten, me përjashtim të Bonit dhe të Londrës. Qeveria angleze, cilado qoftë, e çfarëdo ngjyre qoftë, do të bëjë një politikë tradicionale të balancës, por balanca do të anojë kurdoherë nga ana e amerikanëve, që, megjithëse e kanë dërrmuar Anglinë, prapëseprapë traditat, interesat dhe loja e aleancave të vjetra, sidomos dy luftërat e mëdha botërore të fundit, e shtyjnë Anglinë të anojë nga aleanca me amerikanët. Megjithëkëtë, kontradikta midis tyre ekzistojnë dhe do të ekzistojnë kurdoherë.

Sa për synimet e qeverisë revanshiste të Bonit, ato dihen. Ajo përpiqet të sigurojë armatimin atomik, të dominojë tok me SHBA-në në Evropë e në NATO, të gëlltitë Gjermaninë Lindore, të rivendosë kufijtë e vjetër të Rajhut të Tretë, të riorganizojë aleancat e reja në favorin e saj dhe të kërcënojë e të nderë një luftë

të re në një kohë që ajo dhe partnerët e saj do ta gjejnë të volitshme. Me një fjalë, qeveria e Bonit, duke ndjekur dy qëllime kryesore imediate, atë të pajisjes me armë bërthamore dhe gëlltitjen e Republikës Demokratike Gjermane, mbështet politikën amerikane, përpiqet të mos i shkelë në kallo Anglisë, nuk i acaron e as i pret urat me Dë Golin dhe bën orvatje të fshehta e të hapëta të bjerë në bisedime e në ujdi me revizionistët sovjetikë. Nga ana tjetër, me të ashtuquajturat vende të demokracisë popullore të Evropës Boni bën tregti, jep kredi, bile shkëmbime tregtare bën edhe me Republikën Demokratike Gjermane.

Siç mund të gjykojmë nga një zhvillim i tillë i situatës, koalicioni imperialist në Evropë nuk është në gatishmëri për luftë. Çështja franceze e prishi balancimin dhe duhet njëfarë kohe të stabilizohet. Nga ana tjetër, kapitullimi i revizionistëve sovjetikë, në radhë të parë, dhe i satelitëve të tyre evropianë, ka krijuar për imperialistët një fushë të re pune, shprese, përpjekjesh, mundësish, koalicionesh të reja, të cilat, hëpërhë, nuk i lejojnë ata të humbasin momentet e favorshme që nxorën në shesh hrushovianët dhe të hyjnë në aventura e konflikte të armatosura në Evropë.

Ne mund të dalim me konkluzionin se aktualisht në Evropë dominon një re e zezë, se ajo është bërë një fushë intrigash imperialisto-revizioniste dhe, me gjithë kontradiktat e thella që ziejnë në mes të gjithë këtyre shteteve imperialisto-revizioniste, në Evropë ende nuk ekzistojnë forca të atilla që të përfitojnë nga këto kontradikta për ta kthyer Evropën në një gjendje revolucionare. Të vetmet forca të plota revolucionare

këtu janë Partia e Punës e Shqipërisë, Republika Popullore e Shqipërisë, dhe në një shkallë të vogël grupet marksiste-leniniste në disa vende të Evropës Perëndimore¹. Ndaj, për interes të revolucionit e të socializmit, pësha e madhe e Republikës Popullore të Kinës duhet të ndihet fuqimisht në Evropë, t'i shfrytëzojë këto kontradikta.

Me plot kontradikta paraqitet gjendja edhe në stalin revizionist. Uniteti i tyre politiko-ekonomik mund të themi se është dobësuar, megjithëse formalisht ai ekziston. Traktati i Varshavës ekziston dhe ne besojmë se ai do të vazhdojë të ekzistojë si një «mburojë» e politikës ekspansioniste të revizionistëve hrushovianë. Këtë traktat ata do ta përdorin, e në radhë të parë revizionistët sovjetikë, për të ruajtur hegjemoninë e tyre ushtarake, për të pasur nën kontroll e në vëzhgim forcat dhe armatimin e partnerëve, për të dominuar me qëllime të caktuara, me anën e frikës së «ndonjë sulmi», partnerët e dobët, të frikshëm dhe «të paarmatosur» prej tyre, për të ndërhyrë, mundësisht bashkërisht, në rast se ndonjë nga partnerët e tyre lëviz bishtin². Revizionistët sovjetikë në Traktatin e Varshavës vënë shumë shpresa që ushtrinë e satelitëve ta kenë si mish për top, vakuum, treg për t'u shitur armët e vjetruara dhe, mbi të gjitha, për t'i mbajtur në fre.

Partnerëve të tjerë revizionistë, në këto situata po-

1 Këtu është fjala për grupet fillestare të viteve 1960-1965.

2 Jeta e vërtetoi plotësisht këtë parashikim. Në gusht 1968 BS i përdori forcat e Traktatit të Varshavës për të pushtuar Çekosllovakinë «që po i shpëtonte nga dora».

litike të pastabilizuara, në këto kohë tratativash të shumanshme me imperialistët amerikanë e të tjerë, në këto situata të vështira ekonomike, politike dhe ideologjike të brendshme, Traktati i Varshavës u duhet si mburojë nga çdo kërcënim eventual i jashtëm dhe i brendshëm. Por ne mendojmë se brenda këtij stani s'ka harmoni, s'ka unitet, ka pakënaqësi, ka mosbesim.

Në qëllimet e përbashkëta për tratativa ujdje me imperialistët, dhe në radhë të parë me ata amerikanë, ka tendenca sidomos nga ana e revizionistëve sovjetikë, që çdo gjë, çdo rezultat të arritur, çdo tratativë që bëjnë, t'i trajtojnë në mënyrë të tillë që t'i bindin të tjerët e këta ta pranojnë. Sigurisht, këto përpjekje të revizionistëve sovjetikë nuk mund të arrihen lehtë sepse forcat centrifugale veprojnë. Ekziston, pra, tendenca tjetër (e gati të gjitha shteteve të tjera revizioniste, dhe kjo ushqehet fuqimisht nga amerikanët, francezët, anglezët, Boni), e cila nuk e pranon plotësisht diktatin sovjetik. Këto shtete bisedojnë dhe konkludojnë disa herë veças, përpiqen veças të influencojnë në platformën shtetërore kombëtare dhe në interesat kombëtare që trajtojnë, me një fjalë ato frenojnë, përçajnë, sabotojnë, i bëjnë amendamente, i nxjerrin pengesa vijës hegjemoniste sovjetike.

Kjo tendencë i ka acaruar kontradiktat në mes vendeve revizioniste, gjë që reflektohet në dobësitë e tyre të brendshme e të jashtme. Çështja gjermane vihet nga ana e tyre si çështja kryesore politiko-ushtarake. Ato gjoja mbajnë qëndrim të njëjtë, gjoja janë të vendosura. Por realiteti s'është e s'mund të jetë ky. Është e vërtetë se ky është një preokupim i të gjithëve, por oido

prej tyre dëshiron ta heqë qafe këtë problem sipas pikëpamjeve të tij. Të gjithë manovrojnë në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane. Thirrjet e Ulbrihtit, memorandumet e tij, mbledhjet e Traktatit të Varshavës s'përfillen dhe komunikatat e mbledhjes janë demagogji e bluf, ato nuk pasqyrojnë të vërtetën. Asnjë nuk është për mbrojtjen me të vërtetë si duhet të Republikës Demokratike Gjermane. Të gjithë kanë frikë nga përlëshja, nga lufta. Gomulka është gati t'i imponojë Republikës Demokratike Gjermane kushte të rënda kapitulluese ndaj Bonit, mjaft që shtetet imperialiste të njohin zyrtarisht kufirin Oder-Najse. Çekosllovakia, po ashtu, ecën drejt normalizimit të aleancave të vjetra, mjaft që revanshistët e Bonit të heqin dorë nga pretendimet për Sudetët. Hungaria as që ka ndonjë zell të futet në luftë për problemin gjerman. Ajo synimet i ka gjetkë, në territorin e fqinjve dhe në forcimin e regjimit kapitalist që po rivendos në vend.

Prandaj si sovjetikëve ashtu edhe të tjerëve u leverdis shumë që të likuidohet çështja gjermane, me pak dhembje e me shumë demagogji, dhe për këtë ata s'duan tjetër veçse njëfarë sigurie, qoftë edhe të përkohshme, për një qetësi relative nga ana e Bonit. Republika Demokratike Gjermane, për mendimin tonë, përdoret në këtë periudhë nga Bashkimi Sovjetik dhe aleatët e tij si monedhë tregu për tratativat, shantazhet, pazarllëqet në mes imperialistëve e revizionistëve modernë. Sigurisht, ky është një shkak tjetër i madh që i thëllon kontradiktat në mes revizionistëve dhe dobëson pozitën e tyre të brendshme e të jashtme. Ata vetë demaskohen pa pushim.

Për sa u përket marrëdhënieve politike të vendeve ish-socialiste me shtetet e tjera borgjeze të botës, ato nuk ndjekin një vijë të përgjithshme të përbashkët, por gjithsecili punon për llogaritë e tij kombëtare. Shumë herë njëri shtet, i nisur nga motivi «gjithkush për vetë», i nxjerr sytë partnerit të tij, revizionist, për të siguruar përfitime ekonomike, politike ose «të prestigjit dhe të përkrahjes për veten e tij», duke shkelur vazhdimisht parimet e, më të shumtat e herës, edhe në kurriz të shokut, edhe ky revizionist. Pra, ligji i xhunglës është futur në marrëdhëniet e tyre. Kjo, natyrisht, i thëllon kontradiktat, i dobëson e i demaskon ata.

Marrëdhëniet ekonomike në mes revizionistëve ekzistojnë dhe revizionizmi sovjetik, si fuqia më e madhe ekonomike, dominon dhe bën akoma ligjin, por jo si më parë. Ai dominon ekonominë e dobët të partnerëve të tij me fuqinë e vet ekonomike dhe me vendosjen e disa kyçeve e hallkave të rëndësishme, që hëpërhë partnerët nuk mund t'i thyejnë e t'u shpëtojnë. Këtej lind presioni i madh sovjetik mbi ta dhe ky presion nuk është vetëm ekonomik. Të gjitha këto marrëdhënie midis sovjetikëve dhe partnerëve revizionistë janë kapitaliste, skllavëruese. Asnjë nuk është i kënaqur nga tjetri, kudo ka grindje, mosmarrëveshje, shantazhe, kërcënime. Këtu ekzistojnë kontradikta të shumta, të thella, të pakapërcyeshme, minuese. Këto influencojnë në degjenerimin e mëtejshëm të tyre.

Asnjë nga shtetet revizioniste nuk udhëhiqet nga parimi internacionalist për të ndihmuar shoku-shokun në ekonomi, përkundrazi, secili synon të përfitojë më shumë dhe në mënyrë kapitaliste nga tjetri. Kështu që

çdo gjë, çdo marrëdhënie ekonomike në mes tyre, shikohet e zhvillohet vetëm në frymën kapitaliste. Por kriza ekonomike nuk e lejon më Bashkimin Sovjetik «të ndihmojë» dhe të përballojë nevojat kurdoherë në rritje të aleatëve të tij revizionistë, të cilët, gjithashtu, i kanë mbuluar kriza. Atëherë, në këto kushte, rrugëdalja për këta kapitalistë të rinj është thirrja e kapitalit të huaj — amerikan, francez, anglez, gjerman. Kreditë amerikane e të tjera kanë filluar të hyjnë, të shtohen e të shtrihen si shushunja në ekonominë e BS dhe të vendeve të ashtuquajtura të demokracisë popullore të Evropës. Kjo sjell me vete influencën politike, ideologjike, degjenerimin e regjimit, gllabërimin politik, ekonomik dhe ushtarak të këtyre vendeve, të cilat, pak nga pak dhe kush më shpejt e kush më vonë, të bëhen vende të varura nga imperialistët e ndryshëm dhe të shndërrohen në zona influence të tyre.

Kjo, natyrisht, i shton kontradiktat në mes vendeve revizioniste të Evropës dhe revizionistëve sovjetikë që humbasin dominimin e tyre absolut politik dhe ekonomik mbi këto vende. Kjo shton e thellon kontradiktat në mes popullit dhe marksistë-leninistëve të vërtetë, nga njëra anë, dhe krerëve revizionistë të çdo vendi, nga ana tjetër; kjo i varfëron këto vende, polarizon forcat e reaksionit e të popullit dhe krijon fushë të gjerë për kushte të favorshme për revolucion në këto vende.

Si mund t'i përcaktojmë tani «unitetin» ideologjik të revizionistëve dhe luftën që ata i bëjnë marksizëm-leninizmit, e veçanërisht Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë?

Armiqësia e revizionistëve modernë kundër mar-

ksizëm-leninizmit dhe kundër dy partive tona është e vendosur dhe në këtë gjë tek ata ekziston uniteti i mendimit dhe i veprimit. Krerët revizionistë, jo vetëm ata që janë në udhëheqje të partive dhe të shteteve «të demokracisë popullore» në Evropë, por edhe të gjithë ata krerë që gjenden në krye të partive komuniste të vendeve kapitaliste, kanë hyrë dhe janë komprometuar thellë dhe pa asnjë shpresë në rrugën antimarksiste. Ata kanë kristalizuar vijën e reformizmit dhe të degjenerimit të marksizëm-leninizmit dhe lidërsip i tyre është klika revizioniste e Moskës; orientimi dhe baza e tyre janë kongreset e 20-të, 21-të e 22-të të PK të BS. Këtë vijë të përgjithshme këta e zbatojnë në bazë të situatave konkrete të partive dhe të vendeve të tyre. Sigurisht, rreth këtij orientimi të përgjithshëm revizionist, ka e do të ketë edhe tendenca të ndryshme, të cilat janë shfaqur e do të shfaqen në funksion të prirjeve të këtyre krerëve, të diktuar nga presioni i borgjezisë, nga rezistenca e partisë, nga gjendja politiko-ekonomike e vendit, nga lëvizja revolucionare e shkalla e ngritjes së saj dhe nga shumë faktorë të tjerë.

Duke ruajtur të paprekshme qëllimet dhe duke luftuar për të arritur objektivat antimarksistë, revizionistët modernë aktualisht po shfaqen me disa tendenca të theksuara. Revizionistët titistë ndjekin një rrugë të caktuar, të hapur, pa maskë, ata veprojnë në unitet të plotë e të hapur me borgjezinë kapitaliste, me socialdemokracinë dhe në aleancë e në shërbim të hapur me imperializmin amerikan. Deri atje ka shkuar puna e këtyre, saqë revizionistët e tjerë, megjithëse në fakt janë solidarë plotësisht me ata jugosllavë, megjithëse i ma-

rrin si shembull veprimi dhe adoptojnë format titiste në degjenerimin e partive e të shteteve të tyre, nuk guxojnë dot t'i rehabilitojnë hapur. Megjithëse ata kurdoherë bashkëpunojnë ngushtë me titistët, duke deklaruar se janë dakord me politikën e tyre, duke zbatuar në jetë reformat kapitaliste titiste, prapë shtojnë se «kanë disa mosmarrëveshje me ta». Kjo është demagogji dhe bluf. Fakti është se krahu revizionist-titist ka kaluar plotësisht në pozitën e borgjezisë, kurse vendin e krahut ekstrem të djathtë mund të themi se aktualisht e mbajnë krerët revizionistë italianë — toliatistët. Këta kanë marrë rolin e zbatimit deri në fund të revizionizmit në vendet kapitaliste, atë të likuidimit të partisë e të diktaturës së proletariatit, të shuarjes së luftës revolucionare, të shuarjes së kontradiktave me socialdemokracinë, të unitetit me të, të shkrirjes me të dhe të bashkëpunimit të plotë ideologjik e politik me borgjezinë. Me një fjalë, ata janë për zhdukjen e luftës së klasave dhe për nënshtrimin ndaj pushtetit fuqplotë të borgjezisë. Këta, duke mos qenë në fuqi, duan të shkojnë edhe më larg se titistët, të cilët e kanë pushtetin në dorë dhe nuk lejojnë ta ndajnë me kërkënd. Por, përveç këtij likuidimi total, revizionistët italianë duan t'i bashkërendojnë veprimet e shteteve aktuale revizioniste, prej të cilave ata kërkojnë të shpejtojnë degjenerimin e tyre, t'i venë deri në fund dhe në mënyrë konsekuente vijës së përgjithshme revizioniste të Kongresit të 20-të të PK të BS. Këto rezultate revizionistë italianë mendojnë se mund t'i arrijnë më shpejt duke zhvilluar teorinë e tyre «policentriste», që është në fakt shqelmimi i autoritetit të revizionistëve sovjetikë, përçarja në mes

revizionistëve për t'i shpartalluar më mirë e më shpejt në kuadrin e përgjithshëm të ofensivës ideologjike të kapitalit monopolist për degjenerimin e plotë të partive dhe të shteteve revizioniste. Revizionistët italianë, natyrisht, janë aventurierë me tërë kuptimin e fjalës. Ata duan shpejtimin e procesit të degjenerimit. Sigurisht, revizionistët sovjetikë nuk mund të jenë me këtë taktikë, e cila u heq menjëherë çdo armë demagogjike. Këndeji lindin edhe kontradiktat e ndryshimet në taktikat e tyre.

Skercet e taktikës së revizionistëve polakë janë demagogji për të na bindur mundësisht të zbutim polemikën, dhe sidomos për të treguar gjoja «independencën» e tyre kundrejt revizionistëve sovjetikë në çështjen e taktikës. Por ata janë në radhën e armiqve më të egër të marksizëm-leninizmit, të Partisë Komuniste të Kinës, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shteteve tona socialiste. Ata janë nga revizionistët shovinistë më të mëdhenj. Sovjetikët llogaritin shumë tek ata, pavarësisht nga kontradiktat që kanë me ta. Sovjetikët ua kanë shumë nevojën atyre, sepse një shkëputje e Polonisë në drejtim të imperialistëve në mënyrë të hapur, do ta shpejtonte katastrofën përfundimtare të staniit revizionist.

Revizionistët e tjerë evropianë, me gjithë nuancat e tyre, të cilat janë më të theksuara tek Ulbrihti e te Kadari, ndjekin deri diku në përgjithësi kursin dhe taktikat sovjetike në luftën kundër marksizëm-leninizmit, e veçanërisht kundër të dy partive tona. Por, në përgjithësi mund të thuhet se në ta nuk ekziston më ai besim qorr ndaj revizionistëve sovjetikë. Kjo mund

të thuhet edhe për partitë e tjera në botë ku sundojnë revizionistët. Besimi ndaj udhëheqjes sovjetike është dobësuar, besimi dhe forca tërheqëse qëndron te rubla që i financon në veprimet antimarksiste dhe antisocialiste.

Natyrisht, të gjitha kundërshtimet që kanë midis tyre revizionistët s'janë gjë tjetër veçse përpjekje për sigurimin e pavarësisë së veprimit ose të rigrupimeve të reja regjionale.

Revizionistët sovjetikë kanë pësuar disfata të mëdha. Lufta e partive marksiste-leniniste kundër tyre mund të themi se ka qenë faktori vendimtar i këtyre disfatave. Qëndrimet tona parimore dhe luftarake i demaskuan revizionistët sovjetikë, i pengojnë seriozisht në veprimtarinë e tyre minuese, shpartallojnë demagogjinë e tyre helmuese dhe mbytëse. Partitë e vendet tona u rezistuan dhe dolën fitimtare ndaj shantazheve, presioneve të çfarëdollojta të tyre. Lufta jonë e paepur pengoi shpejtimin e veprimeve tradhtarë të revizionistëve, ajo sqaroi dhe sqaron komunistët në botë, u tregon të vërtetën popujve dhe demaskon marrëveshjet e arritura në mes revizionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë.

Revizionistët sovjetikë, që nga Kongresi i 20-të, e morën frerin në dhëmbë dhe menduan, e ishin të bindur, se nuk do të gjenin rezistencë serioze në rrugën e tradhtisë. Edhe në rast se gjenin, ata, me pikëpamjet e tyre të shovinizmit të shtetit të madh, me fuqinë e tyre të madhe ekonomike dhe ushtarake dhe duke u fshehur e duke u maskuar pas prestigjit të madh politik dhe ideologjik të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Ko-

muniste të BS, mendonin se do ta likuidonin shpejt këtë rezistencë, pa dhembje, pa bujë. Nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë ishin të bindur se nga ana e imperialistëve amerikanë do të gjenin një mirëkuptim dhe një bindje të menjëhershme përpara propozimeve dhe lëshimeve të tyre të mëdha. Kështu, revizionistët sovjetikë mendonin se vija e tyre ideologjike e politike revizioniste «do të triumfoje dhe do të ndriste me shkëlqim». Kështu që nuk do të kishe kohë të hapje e të mbyllje sytë përpara «mrekullisë» që do të arrihej tamam si lodrat në panaire dhe, këtë lodër, të mos ia hamë hakun, e luajti si një kloun i vërtetë panairesh Nikita Hrushovi, kryetari i revizionistëve sovjetikë.

Revizionizmi mban në vetvete disfatën. Ai sjell disfatën për ata që janë infektuar prej tij sepse revizionizmi është tradhti, është disfatizëm, kapitullim, shkatërrim. Revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, sillte me vete të gjitha të këqijat. Ai e dobësoi Bashkimin Sovjetik, uli prestigjin e tij dhe të Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit, filloi degjenerimin ideopolitik të Bashkimit Sovjetik, dobësoi forcat revolucionare, hodhi në kaos e në dekadencë të vazhdueshme ekonominë socialiste të Bashkimit Sovjetik, i bëri koncesione të mëdha imperializmit amerikan dhe vazhdon ta shkallmojë forcën sovjetike e ta vërë atë nën mëshirën e një klase të re borgjeze kapitaliste, që çdo ditë e më shumë bëhet vartëse e interesave të kapitalizmit ndërkombëtar.

E tërë vija e tyre ideologjike pësoi një fiasko, si në zhvillimin e saj ideorganizativ ashtu edhe në atë të politikës së jashtme e të brendshme, gjithashtu edhe në

lidhje me kampin socialist dhe komunizmin ndërkombëtar.

Para daljes në skenë të revizionistëve hrushovianë, është fakt se uniteti i kampit socialist dhe i lëvizjes komuniste ndërkombëtare ishte i fortë dhe qëndronte monolit përpara ideologjisë borgjeze, për arsyen e vetme se udhëhiqej nga marksizëm-leninizmi. Bashkimi Sovjetik, përpara ardhjes së revizionistëve në fuqi, ishte në rrugë të drejtë, udhëhiqej, frymëzohej dhe frymëzonte shokët, miqtë dhe aleatët me frymën revolucionare marksiste-leniniste.

Me ardhjen e revizionistëve në fuqi nuk mund të ekzistonte më uniteti marksist. Teza jonë e drejtë se uniteti ekziston atje ku është në fuqi marksizëm-leninizmi, triumfoi. Blofi dhe demagogjia revizioniste, sharrjet dhe shpifjet e tyre se gjoja Stalini, «kulti i tij», «terrori», «vrasjet», «kërcënimet», ishin «faktorët» e këtij uniteti që ekzistonte, pësuan një disfatë të turpshme. Jo vetëm që marksistë-leninistët janë ngritur kudo kundër revizionistëve dhe po farkëtojnë unitetin e vërtetë nën drejtimin dhe frymëzimin e marksizëm-leninizmit, por ne shohim që revizionistët sovjetikë jo vetëm shkallmuan unitetin e kampit socialist e të komunizmit ndërkombëtar, por ata shkaktuan, dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, përçarjen në mes tyre. Revizionistët janë vetë të përçarë dhe do të përçahen akoma më shumë. Ata kanë vdekjen me vete.

Dhe kur, si rezultat i luftës sonë konsekuente, marksiste-leniniste, revizionistët sovjetikë u gjendën përpara disfatës së madhe dhe përpara së keqes së madhe preferuan të keqen më të vogël: likuiduan udhëheqësin

dhe ideologun e tyre, Nikita Hrushovin. Ata ia ngarkuan indirekt të gjitha fajet dhe, pa ndërruar asnjë pjesë nga vija e tij e vjetër, shokët e tij, bashkëpunëtorët, bashkëkomplotistët e tij dolën në skenë për të zbatuar hrushovizmin pa Hrushovin.

Koha që prej likuidimit të Hrushovit vërtetoi se revizionistët sovjetikë janë po aq tradhtarë sa ai dhe ndjekin me besnikërinë më të madhe tezat tradhtarë anti-marksiste të tij. Ata bile e kanë kaluar Hrushovin në tradhti, sepse, duke pasur parasysh gabimet e tmerrshme të Hrushovit, edhe pas rrëzimit të tij, nuk vunë mend. Është e vërtetë se ata përpiqen të krijojnë dhe të zbatojnë një vijë «të re», por që është po aq revizioniste e skandaloze sa ajo e Hrushovit.

Taktika e tyre, në radhë të parë, ka vetëm gjëra formale të përcipta: ata kanë lënë bujën dhe llogjet me daulle të Hrushovit. Hëpërhë, revizionistët sovjetikë që zëvendësuan Hrushovin nuk mbajnë fjalime, heshtin, për të dhënë përshtypjen se «reflekojnë», se «janë të matur e të urtë», se «nuk janë daulle e shpuar», por në praktikë po hidhet çapi i parë dhe po bie po ajo daulle.

Revizionistët sovjetikë me amerikanët ruajnë dhe forcojnë lidhjet, kapitullojnë çdo ditë e më tepër. Me largimin e Hrushovit ata nuk u forcuan, përkundrazi u diskredituan. Tani pasardhësit e Hrushovit përpiqen të ngjitin ato që theu Hrushovi, ata nuk kanë asnjë shpresë nga ne që të gënjehemi, por hallin e kanë te partnerët e tyre që po u ikin nga duart. Ata duan të krijojnë njëfarë «uniteti» në mes tyre, në baza të reja, për të përballuar katastrofën që i pret. Këtu është një nga synimet e tyre kryesore aktuale. Mbledhja fraksioniste e

1 marsit që u mbajt në Moskë, më shumë nga çdo gjë, synonte pikërisht këtë objektiv: të gjendej një platformë e përbashkët ideopolitike, e përshtatshme me rrethanat aktuale të reja, në mes revizionistëve, sesa të shpresohej për të na gënjer ne. Natyrisht, në formë, komunikata që lëshuan pas mbledhjes së 1 marsit, ka demagogjinë e gjithë vijës së tyre, por unë mendoj se çështja më shumë qëndron në krijimin e njëfarë «uniteti» revizionist. Ky «unitet», shpresonin sovjetikët, mund të arrihej pasi i siguruan në mënyrë të fshehtë partnerët e tyre se ata asgjë nuk ndryshonin në vijë dhe publikisht gjatë kësaj kohe, me qëndrimet e tyre, vërtetuan se asgjë s'ndryshoi me largimin e Hrushovit.

Por a u arrit ky unitet kaq i dëshiruar nga udhëheqja sovjetike? Jo, aspak. Me unitet, sovjetikët, si revizionistë që janë, kuptojnë dominim, drejtimin absolut mbi të tjerët. Mjerisht, për sovjetikët, të tjerët janë bërë më të pavarur se kurrë, ata nuk qenë për Hrushovin, ata u gëzuan që u qërua, sepse ai ishte arrogant dhe i kërcënonte. Por pas rrëzimit të Hrushovit revizionistët e tjerë donin të siguroheshin se mos, kushedi, udhëheqja e re sovjetike kthente fletën «nga ana jonë». E tillë frikë u kishte hyrë në palcë. Kur u siguruan për këtë, pozitat e pavarësisë së tyre ndaj «dirigjentit» u forcuan dhe, sipas informatave, në mbledhjen e tyre të fundit nuk kishte unitet, megjithëse të gjithë janë revizionistë me mjekër.

Në komunikatën që lëshuan revizionistët modernë, u dukën haptaz konfuzioni dhe paniku që i kanë mbuluar nga disfatat që u kemi shkaktuar dhe që nuk kanë mundur të gjejnë asgjë të re për t'u shtruar përpara

adeptëve të tyre. U duk se ata nuk e kanë iniciativën. Ata janë të thyer, janë të dobët, janë në difensivë. Në komunikatë ndihet vërtetimi se revizionistët sovjetikë nuk e bëjnë dot ligjin hapur mbi partnerët e tyre revizionistë, nuk mund të imponohen dot si më parë: përçarja, «pavarësia», shkarja nga duart është e madhe, hendeku është i thellë. Revizionistët sovjetikë, me mjete të tërëfhorta, do të përpiqen të shpëtojnë prestigjin e autoritetin mbi partnerët dhe të aktivizojnë, të inkurajojnë, të organizojnë dhe të drejtojnë luftën kundër partive e shteteve tona.

Pra, mund të themi se kjo periudhë pas rënies së Hrushovit i ka dobësuar më shumë revizionistët sovjetikë. Në radhë të parë atyre u ka shkaktuar disfatë qëndrimi ynë luftarak, vazhdimi i polemikës nga ana e partive tona. Kjo është njëra anë e zjarrit që i përvëlton revizionistët e hallakatur dhe revizionistët sovjetikë me të gjitha problemet që u rëndojnë në qafë. Edhe SHBA u siguruan gjatë kësaj periudhe se revizionistët sovjetikë jo vetëm që nuk ndryshojnë pozita, por dobësohen edhe më shumë. Kështu amerikanët forcojnë dozën e shantazhit për t'i lidhur më mirë pas vetes sovjetikët, për t'i komprometuar më thellë. SHBA shohin se «dadaja» e sovjetikëve për gjoja «luftë antiimperialiste», «front antiimperialist», është thjesht një demagogji, prandaj imperializmi amerikan po thekson agresivitetin e tij për t'ua vënë këmbët në një këpucë revizionistëve sovjetikë, për t'i demaskuar e për t'i diskredituar më shumë që të kapitullojnë më shpejt.

Ideve hrushoviane të «bashkekzistencës paqësore», të «botës pa luftëra, pa armë», u ka dalë fare boja, as

që u beson njeri. Fakti është se me luftën në Kongo, në Laos, në Vietnamin e Jugut, dhe me bombardimet pirateske amerikane në Vietnamin e Veriut amerikanët po i vënë sovjetikët jo vetëm përpara kapitullimit dhe demaskimit, por, nën terrorin e luftës, i kanë bërë ata që të ndërmarrin veprime diplomatike në favor të tezave imperialiste mbi Vietnamin dhe për shuarjen e luftës çlirimtare. Vajtja e Kosiginit në Republikën Demokratike të Vietnamit ka pasur qëllime djallëzore mashtruese, demagogjike, diversioni dhe kapitullimi. Por ai pësoi disfatë. Ndihma për t'i dhënë gjoja armë Republikës Demokratike të Vietnamit nuk është veçse demagogji dhe kurth. Në të vërtetë revizionistët sovjetikë po përpiqen, nga ana tjetër, të organizojnë me shtetet kapitaliste konferenca ndërkombëtare për çështjen e Vietnamit, pa Vietnamin. Duhet menduar dhe duhet përgatitur seriozisht ushtarakisht, sepse mundësitë janë të mëdha që revizionistët sovjetikë qysh në kohën e Hrushovit, por edhe tani, mund të jenë marrë vesh me amerikanët që sovjetikët t'u lënë dorë të lirë amerikanëve «të ngjitin shkallët» në Vietnamin e Veriut dhe të shkojnë edhe më tej, domethënë të zgjerojnë konfliktin. Sovjetikët mund të mjaftohen edhe në mënyrë të heshtur me deklaratata bombastike demagogjike, të bëjnë «protesta» të bujshme dhe, nga ana tjetër, të mbledhin «fakte e dokumente» sikur gjoja Republika Demokratike e Vietnamit dhe Kina nuk lejuan që Bashkimi Sovjetik t'i jepte Vietnamit një ndihmë konkrete me armë dhe me njerëz. Sigurisht, revizionistët sovjetikë luajnë me zjarrin, por ata mendojnë se kështu mund «të fitojnë», duke dobësuar të dy palët, duke futur në

telashe lufte Kinën, duke e rrethuar atë me një kordon zjarri dhe kordon «miqsh» të revizionistëve sovjetikë, siç janë indianët. Këto plane sovjetikëve duhet t'ua mbytim që në embrion.

Ne mendojmë se «problemi i çarmatimit të përgjithshëm», «çështja e Gjermanisë dhe e Berlinit» ngrihen dhe fryhen me qëllim prej revizionistëve për të tërhequr vëmendjen. Këto probleme në fakt për ta janë tym propagandistik për t'u maskuar dhe për të larguar vëmendjen nga Indokina etj., ku zien lufta kundër imperializmit. Këtu i kanë përqendruar përpjekjet të dy armiqtë tanë kryesorë.

Revizionistët sovjetikë, tok me amerikanët, francezët, Bonin, përpiqen që popujt e vendeve në zhvillim t'i preokupojnë në çështjet regjionale dhe të mos i lënë të preokupohen për çështje më aktuale, ose të goditin në mënyrë të koordinuar kudo. Për shembull, ne shohim që si amerikanët dhe sovjetikët luftojnë që vendet e Afrikës të interesohen vetëm për çështjet e Afrikës, siç po konkretizohet në çështjen e Kongos, që në vetvete është me aq rëndësi; që arabët të preokupohen vetëm për rrezikun që u paraqet Izraeli; Evropa për lidhjet me Bonin ose me Ulbrihtin dhe të neglizhohen, ose pak të interesohen për Indokinën e për problemet e një kontinenti tjetër. Në Amerikën Latine sovjetikët ia kanë hedhur mirë kapistrën ndonjë udhëheqësi të vetëquajtur «komunist», pikëpamjet ekuivoqe të të cilit jo vetëm që nuk shërbejnë për unitetin e forcave të vërteta marksiste-leniniste revolucionare, por i dobësojnë ato dhe ndihmojnë krerët revizionistë të

partive të tjera komuniste e punëtore të vendeve të Amerikës Latine e gjithë revizionistët modernë.

Neve na duket se ka një tendencë të përgjithshme nga ana e revizionistëve modernë, në bashkëpunim me imperializmin, për të hallakatur dhe për të preokupuar forcat revolucionare për çështje të shkëputura, ose për t'i shkëputur enkas, për t'i çoroditur.

Fakt është se në mbledhjet e ndryshme me karakter ndërkombëtar kjo tendencë shfaqet në vendet e Azisë, të Afrikës, Amerikës Latine, të cilat nuk tregohen koherente, ose shpartallohen dhe izoloohen, ose «bin-den» prej sovjetikëve të qitin një sërë pengesash që mbledhjet e rëndësishme ndërkombëtare ose regjionale që janë vënë në kalendar, të shtyhen, të mos bëhen etj. Kjo çështje, na duket neve, duhet rishikuar, duhet ndërtuar taktika e re që të revolucionarizojë gjendjen.

Si duhet ta vazhdojmë luftën tonë në këto situata të përgjithshme, siç u përpoqëm t'i përshkruajmë, sipas mendimit tonë dhe në bazë të koniunkturave aktuale?

Ne mendojmë se duhet ta shumëfishojmë e ta mprehim më tej polemikën tonë kundër revizionizmit modern e në radhë të parë kundër revizionistëve sovjetikë. Këta janë të dobësuar, kanë nevojë për pushimin e polemikës. Detyra jonë është të mos i lëmë të marrin frymë, t'i goditim e t'i demaskojmë pa pushim ideologjikisht dhe politikisht. Të demaskojmë çdo veprim të tyre në lëmin ndërkombëtar dhe në lëmin e marrëdhënieve në mes tyre për të theksuar divergjencat që i brejnë, për të mos lejuar grupimin e tyre dhe aksionet e përbashkëta ose të veçuara të tyre kundër popujve, kundër revolucionarëve dhe kundër partive e shteteve

tona. Çdo «lëshim» i tyre, çdo taktikë gjoja afruese me ne, të shfrytëzohet në rrugën marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet, edhe për demaskim, edhe për çarmatim, edhe për kapitullim të tyre.

Ne mendojmë se luftën tonë kundër tyre duhet ta organizojmë dhe ta koordinojmë më mirë. Të dy partitë tona edhe pa një punë të koordinuar organizativisht, luftën, detyrën e kanë kryer dhe e kryejnë të plotë, ato e kanë të qartë çdo gjë dhe qëndrojnë të patundura në vijë të parë. Por nuk mund të themi se ndodh kështu edhe me parti të tjera marksiste-leniniste që pak a shumë qëndrojnë në pozita të shëndosha. Ka parti të tjera që të paktën me Partinë tonë kanë kontakte të dobëta. Ka prej tyre që mund ta quajnë Partinë e Punës të Shqipërisë «të ashpër», kurse veten e tyre në rrugë «të drejtë», sepse tregohen «të matur».

Kjo vijë «e drejtë», «e matur», mendojmë ne, nuk ka të bëjë aspak me pjekurinë marksiste dhe me kuptimin real të gjërave si zhvillohen ngjarjet dhe kë kemi përpara si kundërshtarë, nuk ka të bëjë aspak me vlerësimin e vërtetë të rrezikshmërisë së kundërshtarit, me dinakërinë e armiqtësinë e vendosur të tij kundër vendeve dhe partive tona, kundër marksizëm-leninizimit, ashtu siç i vlerëson drejt këto probleme Partia e Punës e Shqipërisë.

Për të arritur në një unitet mendimesh e veprimesh, ose për t'i shpjeguar e për t'i sqaruar shoku-shokut arsyet e veprimeve taktike të çdo partie, ne mendojmë se duhet të bëhen bisedime në mes partive. Sipas HSINHUA-së, ju praktikoni bisedime të tilla me partitë e Azisë dhe kjo është shumë mirë. Ne me par-

titë e Azisë nuk e bëjmë këtë, jo pse nuk duam, por rasti s'na është dhënë. Ne kemi shfrytëzuar çdo takim që kemi pasur edhe me shokë të këtyre partive që kanë marrë pjesë në festat tona, u kemi shfaqur mendime, por këto nuk kanë qenë siç duhet të jenë, bisedime apostafat dypalëshe, për diskutim të dyanshëm të problemeve, për shkëmbim mendimesh. Neve na duket se ky është një boshllëk.

Ne mendojmë se komunistët vazhdimisht kanë nevojë të sqarohen, kanë nevojë për interpretim të drejtë të ngjarjeve. Fakt është se në vendet borgjeze e revizioniste komunistët e vërtetë janë të shtypur, ndodhen nën vëzhgim, shumë prej tyre s'dinë asgjë për të vërtetën, shumë janë të trullosur nga gënjeshttrat e demagogjia, shumë të tjerë i marrin me mend, disa janë të qartë, dëgjojnë radiot tona, nxjerrin konkluzionet, mundet që edhe organizohen, organizojnë në ilegalitet rezistencë etj. Megjithatë, ne duhet të bëjmë detyrën tonë internacionaliste, sepse për komunizmin ndërkombëtar kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Në vendet ku sundojnë revizionistët rezistenca dhe organizimi i marksistë-leninistëve është faktori vendimtar. Ne do ta ndihmojmë nga jashtë nëpërmjet propagandës me radio, shtyp etj. Puna brenda kalasë revizioniste duhet të bëhet nga vetë marksistët dhe nga populli i këtyre vendeve.

Për sa u përket lidhjeve tona me partitë e reja dhe grupet marksiste-leniniste të vendeve kapitaliste, këto deri diku janë krijuar. Marksistë-leninistët revolucionarë në këto vende, ku me sukses, ku me vështirësi, ku me lëkundje dhe përpëlitje, po organizohen, po luftojnë.

Detyra jonë është që t'i ndihmojmë, sepse shokët e ndiejnë shumë nevojën. Ne, natyrisht, as kemi ndërhyrë e as nuk duhet të ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme, por të tregojmë kurdoherë durim, takt e vigjilencë dhe, sa herë që të kërkojnë, t'u japim atyre eksperiencën tonë, me qëllim që të evitohen sa më shumë gabime. Revizionistët po na pengojnë, imperialistët po na pengojnë, këto duhet t'i kemi parasysh edhe ne, edhe shokët tanë revolucionarë në vendet kapitaliste e revizioniste, sepse pseudomarksistët, agjentë të revizionistëve dhe të kapitalistëve, do të përpiqen që me maskë e parulla revolucionare të futen brenda radhëve të partive të reja për të sabotuar. Prandaj shokët tanë revolucionarë dhe ne duhet të mprehim vigjilencën, të ruhem nga «entuziazmi pa baza», nga «besimi i tepruar» që mund të shfaqë ndonjëri pa dhënë prova në luftë. Ne dhe ata të ruhem dhe t'i provojmë në jetë «fjalët e bukura plot revolucionarizëm» të disave.

Uniteti i mendimit dhe i veprimit i të dy partive tona, gjersa mbështetet në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ka qenë dhe është i plotë.

Në një kohë kur imperialistët amerikanë po zgjerojnë luftën në Vietnam, kur ata synojnë të goditin Kinën e madhe, në një kohë kur revizionistët, me udhëheqësit sovjetikë në krye, po intensifikojnë veprimtarinë e tyre tradhtarë kundër komunizmit, ne mendojmë se duhet të forcohet lufta e të gjitha partive marksiste-leniniste kundër revizionizmit sovjetik. Mendimi ynë është se në këto momente, kur armiqtë na sulmojnë dhe lufta ka ardhur te pragu, siç është kërcënimi amerikan në Vietnam, qëndrimet e vakëta ose jo shumë aktive,

për të mos thënë pasive, të ndonjë partie motër dhe të marksistë-leninistëve të ndonjë vendi, nuk e ndihmojnë gështjen tonë të përbashkët.

Mendimi ynë është se duhet shfrytëzuar çdo rast dhe në çdo vend që imperialistëve amerikanë dhe aleatëve të tyre, revizionistëve, t'u digjet toka nën këmbë nga zjarri i luftës së popujve dhe të marksistë-leninistëve.

Është e qartë se synimi i përgjithshëm dhe konkret i imperializmit amerikan, i revizionistëve sovjetikë dhe i reaksionarëve të botës është të ndezin luftën në Azi, kundër Kinës dhe vendeve të tjera socialiste të Azisë, duke kaluar nga luftërat lokale në një konflagracion të përgjithshëm. Revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë po i armatosin me të gjitha forcat dhe me shpejtësi reaksionarët indianë për t'i pasur si reparte sulmi në hapjen e vatrave të reja të agresionit. Revizionistët sovjetikë s'ka asnjë dyshim, se, nën maskën e mbrojtjes së territorit të vet, do të forcojnë kufijtë e tyre me Kinën, për ta vënë këtë nën presion dhe shantazh të vazhdueshëm dhe do të përpiqen me të gjitha mjetet të neutralizojnë shtete rreth e rrotull, në mos i shkëputshin dot nga miqësia tradicionale me Kinën. Nga ana e tij, imperializmi amerikan do të përpiqet të forcojë lidhjet dhe dominimin, preponderancën¹, në Japoni, për ta pasur atë nën drejtimin e tij dhe ta nxitë në agresion, po të mundë. Amerikanët kanë mjaft shpresa të bashkëpunojnë më afër me Anglinë për agresion, e cila rrezikohet në kolonitë e saj në Azi. Në këto

1 Preponderancë (frëngj.) — mbizotërim.

situata ne ndjekim përpjekjet që bën RP e Kinës për afrimin dhe konsolidimin e miqësisë e të marrëveshjeve me vendet e tjera të Azisë dhe të Afrikës veçanërisht, ku imperializmi amerikan po zhvillon agresion të hapur. Ne mendojmë se duhet të afrohem dhe të punojmë me vendet e Azisë Juglindore, jo vetëm që këto të bëhen të ndërgjegjshme për rrezikun e madh të një lufte, që po mërr gjithnjë e më tepër forma të acaruara, por të arrijmë që ato të kundërshtojnë aktivisht agresionin amerikan dhe qëllimet e tij për zgjerimin e luftës.

Ne mendojmë, nga ana jonë, t'i intensifikojmë akoma më shumë luftën, propagandën dhe demaskimin e imperializmit luftënxitës amerikan dhe të revizionistëve modernë sovjetikë, të titistëve e të përkrahësve të tyre tradhtarë. Të atakojmë me intensivitet aleancat dhe çdo marrëveshje të tyre, t'u bëjmë thirrje popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera që të marrin masa dhe të bllokojnë e të shqelmojnë të gjitha këto marrëveshje me imperialistët amerikanë, t'u bëjmë thirrje për të bllokuar totalisht imperialistët agresorë, t'u bëjmë thirrje popujve, klasës punëtore, fshatarësisë dhe inteligjencies progresiste të botës të ngrihen peshë në këmbë për të bllokuar agresionin amerikan, këtë hitlerizëm të ri, që kërcënon botën me zjarr dhe me hekur.

Për sa i përket luftës heroike të Vietnamit të Jugut, për sa i përket qëndrimit të patundur të Vietnamit të Veriut, për sa u përket qëndrimeve tuaja ndaj popullit vëlla vietnamez, ndihmës që ju i jepni dhe përkrahjes suaj, këto ne i dimë. Lufta juaj është lufta jonë, është lufta e të gjithë antiimperialistëve, antire-

vizionistëve, është lufta e socializmit kundër imperia-
lizmit e shërbëtorëve të tyre, revizionistëve modernë
dhe reaksionit botëror.

Populli vëlla vietnamez, që po bën një luftë heroi-
ke, meriton çdo përkrahje. Imperializmi amerikan kun-
dër luftëtarëve të Vietnamit të Jugut po përdor edhe
gazrat helmuese, kurse mbi Vietnamin e Veriut siste-
matikisht po hedh bomba vdekjeprurëse. Është detyra
e shenjtë e të gjithë popujve dhe e revolucionarëve që
të mbrojnë çështjen e drejtë të popullit vëlla vietnamez
dhe të ndihmojnë me çdo mjet që ai të dalë fitimtar.

Në përfundim, ne dëshirojmë të theksojmë edhe
një herë atë që ju shprehni aq drejt dhe hapur në qën-
drimet e fundit ndaj mbledhjes përçarëse të Moskës,
se duhet të forcojmë unitetin e mendimit dhe të veprim-
it, të armatosemi dhe të kalitemi çdo ditë e më shumë
për luftërat që na presin. Ne, të bazuar në mësimet e
marksizëm-leninizmit, me të gjitha forcat tona do të luf-
tojmë tok me ju e me të gjithë revolucionarët e tjerë
marksistë-leninistë për triumfin e çështjes sonë të ma-
dhe. Kjo është fjala jonë e fundit, fjala e Partisë dhe e
popullit shqiptar.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 195 (9054), 14 gusht 1977*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në AQP, duke përfshi-
rë edhe pjesë të papublikuara
më parë*

RINIA — FORCË E MADHE PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT

*Nga fjala në konferencën e Bashkimit të Rinisë
së Punës të Shqipërisë të rrethit të Elbasanit*

4 prill 1965

Përpara se konferenca të fillonte punimet po qanim hallin me shokun Jashar¹ për çështjen e diskutimeve, thamë se sekretari i parë i komitetit të rinisë të rrethit e ka lehtë, se do të lexojë raportin e përgatitur që më parë, dhe, nga ana tjetër, ai është një shok me eksperiencë, është mësuar të flasë para kuadrove të Partisë, ka ardhur dhe në Sekretariatën e Komitetit Qendror, po si do t'i bëhej punës së mëtejshme të konferencës, si do t'u bëhej diskutimeve, thoshim se mos të rinjtë dhe të rejat delegate do të druhen të flasin lirisht përpara konferencës e sidomos në praninë tonë. Mirëpo jo vetëm pati diskutime të shumta, por dhe nga përmbajtja ato ishin të një niveli të lartë. Shokët

1 Jashar Menzelxhiu, në atë kohë ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

dhe shoqet e rinisë që diskutuan folën këtu fare lirisht. Kjo ndodh, së pari, se ato që thoshin jo vetëm i ndienin, por i kanë kuptuar mirë, i kanë kuptuar thellë, prandaj edhe i shprehën në një nivel aq të lartë.

Përpara diskutimeve tuaja të një niveli të lartë mund të them se edhe unë nuk e kam lehtë të diskutoj. Këtu dëgjuam diskutimin e shoqes nga Dragoti. Do të përpiqem t'i afrohem me diskutimin tim. Ajo jo vetëm këndon aq mirë, dhe si ajo ka me siguri me dhjetëra të tjerë në këtë konferencë, por njëkohësisht është edhe amatore në shtëpinë e kulturës, edhe autore këngësh. Është kënaqësi kur shikon se punonjës nga rrethi i Elbasanit dallohen edhe në lëmin e muzikës, të poezisë, të artit dhe të kulturës, që janë të lidhura shumë ngushtë me tërë zhvillimin e vendit tonë.

Besoj se nuk prish punë për ju të rinjtë që diskutimin tim po e filloj nga arti dhe kultura, në vend që ta filloja nga sektorët e punëve më të vështira, të cilat nuk ju trembin, por do të vij edhe atje. Çështja është; si të thuash, për të përgatitur një çikë edhe terrenin, duke ecur sipas shembullit të Gostimës dhe Shalësit ku shokët e rinisë, pasi përgatitën mirë terrenin me pleqtë, arritën që xhaminë e fshatit ta fluturojnë nga themelet. Tani ata janë të preokupuar se si do t'i bëhet hallit me disa pleq që duan të ngrenë një xhami tjetër. Që të ngrenë tjetër, dihet se nuk do t'ia arrijnë, por puna është se të rinjtë kërkojnë njëfarë ndihme, si t'ia bëjnë në kësaj pune me pleqtë. Mendoj se ata edhe në këtë çështje do ta gjejnë rrugën për t'i kënaqur të gjithë pleqtë, edhe ata më besimtarët, jo duke ndërtuar një xhami tjetër, por duke organizuar më shumë shfaqje

për kooperativistët, duke realizuar më mirë normat në bujqësi për të mbushur hambarët me prodhime, duke i çuar herë pas here gjyshit apo gjyshes në shtëpi ndonjë dhuratë të vogël nga rroga, për shembull, duke i blerë ndonjë kuti llokume, ndonjë paqetë cigaresh a një shami etj. Po të bëjnë kështu të rinjtë, pleqtë do ta harrojnë xhaminë dhe kishën, Muhametin dhe Krish-tin, ata do të kënaqen kur të shikojnë fëmijët e tyre të lumtur dhe të gëzuar. Në këtë drejtim ne kemi akoma shumë për të bërë.

Ne rrojmë sot në momente të lumtura e të gëzuara që Partia krijoi për popullin, por ato janë arritur e arrihen me luftë, punë e duke kapërcyer shumë vështirësi. Në vendin tonë punët ecin vazhdimisht përpara, kemi rezultate të kënaqshme në çdo drejtim, duke përfshirë edhe ndërtimin ekonomik dhe zhvillimin e kulturës. Në luftën e madhe për ndërtimin e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë, rol të madh luani ju, të rinjtë dhe të rejat. Këtë nuk e them për t'i bërë qejfin rinisë, për ta entuziazmuar atë, por është fakt se rolin vendimtar në ndërtimin e socializmit, që po realizohet në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, e luani ju, të rinj dhe të reja, që po e kryeni me sukses këtë detyrë të madhe.

Rininë tonë, si përpara luftës, si gjatë periudhës së vështirë të Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe gjatë ndërtimit të socializmit, e kanë karakterizuar disa tipare që janë me të vërtetë për t'u lavdëruar. Ajo ka qenë kurdoherë e ndershme, punëtore, e etshme për dituri, por energjite e saj më përpara nuk gjenin asnjë fushë zhvillimi. Regjimet e kaluara ishin armiq të të

gjithë popullit, pra edhe të rinisë, ato me të drejtë kishin frikë nga rinia, sepse ishin prapanike, ishin kundër zhvillimit të shoqërisë në rrugën e përparimit, kundër zhvillimit të një shoqërie të lirë, ku çdo njeri të kishte jo vetëm detyra, po edhe të drejta. Të drejtat i ishin mohuar rinisë sonë.

Rinia jonë në çdo periudhë është karakterizuar nga ndjenja e sakrificës. Këtë e tregoi sidomos Lufta Nacionalçlirimtare, që u bë nën udhëheqjen e Partisë, gjatë së cilës rinia luftoi me heroizëm të pashembullt. Të gjithë sa ishim në atë kohë në Parti, ishim të rinj. Kishte të rinj 18-vjeçarë atëherë që ishin komandantë brigade, 20-vjeçari ishte komandant divizioni. Sot ata janë 35-40-45-vjeçarë, por përpara 20 vjetëve të tërë ishin të rinj. Vetë Partia jonë u formua nga të rinjtë. Si gjatë luftës, ashtu edhe pas luftës rinisë sonë iu besuan detyra të mëdha e të vështira, të cilat ajo i kreu me sukses, me heroizëm dhe me pjekuri.

Gjatë luftës Partia pati te të rinjtë dhe të rejtat, që mbushën radhët e saj, ushtarët më të vendosur, bijtë më të mirë të popullit që jo vetëm u treguan entuziastë dhe heroikë, por edhe të pjekur. Pas Çlirimit Partia i besoi rinisë detyrën e madhe të ndërtimit të socializmit. Në qoftë se Partia i besoi rinisë njëqind herë gjatë luftës për çlirim, dhe ajo e kreu me nder këtë detyrë të lartë, tani, në fazën e re të ndërtimit të socializmit, ia besoi dhe përsëri duhet t'ia besojë një mijë herë rinisë edhe këtë detyrë të re.

Vendosja e pushtetit popullor është një fitore kolosale, ajo krijoi për rininë, për brezin tuaj, një situatë të favorshme që ju të kaliteni me shembullin e baba-

pullit tonë. Asaj duhet t'ia bëjmë të njohura mungesat e vështirësitë e asaj kohe për ta kuptuar më mirë të tashmen. 40-45 vjet përpara, kur ne ishim të rinj si ju, Gjirokastra, ku kam jetuar unë vegjëlinë, nuk ishte një qytet i prapambetur për atë kohë, bile hiqej si një qytet nga më të kulturuarit e Shqipërisë. Qytetarët e Gjirokastrës shkonin mësonin jashtë në Turqi, dilnin gjykatës apo avokatë, disa mësonin në Greqi etj., disa ishin tregtarë apo zanatçinj. Megjithatë në gjithë Gjirokastrën në atë kohë kishte vetëm 3-4 mandolina, violinës i binte vetëm një plak i quajtur Ramo Evgjiti, kishte edhe dy cule, njëri i binte Vehip Qorri dhe tjetri Selman Qorri, edhe këta pleq si gjyshi im. Kjo ishte e tërë jeta muzikore e Gjirokastrës së asaj kohe. Ne studentët kishim një të ashtuquajtur shtëpi kulture që përbëhej prej një dhome të vogël pasi të kishe ngjitur gjithë ato shkallë si të minaresë. Me ato pak lekë të studentëve mezi blemë një dollap ku vendosëm disa libra të grisur. Kjo dhomë kishte dhe një ballkon nga qafa e pazarit. Atëherë njerëzit nuk kishin as punë edhe ata që punonin nuk merrnin më tepër se dy lekë në ditë. Një kilogram bukë bënte një lek. Kështu punëtorit gjysma e rrogës i duhej të blente vetëm bukën për veten e tij dhe me një lek, që i mbetej për familjen, ç'të blente më parë? Këtu nuk e kam fjalën për agallarët, po për punëtorët. Në ato kohë të vështira, pra, njerëzit mblihdeshin në qafë të pazarit dhe dëgjonin mandolinatën tonë. Përgjegjësi i «shtëpisë së kulturës» ishte njëfarë Kamber Bilali, njeri fukara, me pantallona të grisura. Atje na vinte çdo ditë njëri që e quanin Samuel. Gjithë ditën ai dilte me stufa në krahë për të shitur ndonjë

metër dhe në darkë, sado i lodhur, vinte në «shtëpinë e kulturës», ku ne i luteshim të na fliste për libra si «Konti i Monte Kristos» etj. Kështu Samueli na tregonte historinë e romaneve që kishte lexuar e lexonte vetë.

E tillë ishte koha jonë. Kurse tani çdo kooperativë bujqësore ka shtëpinë e vet të kulturës dhe jo më një mandolinatë, po orkestër me violina, mandolina, kitarra, fizarmonika etj., grup teatral, këngëtarë, fusha e skuadra sportive etj., etj., pa bërë fjalë pastaj për qyte të tilla si Elbasani, Tirana etj. Prandaj po të bëjmë krahasim, do të shikojmë ç'ndryshime kolosale janë bërë në vendin tonë pas Çlirimit nën udhëheqjen e Partisë. Ne tani kemi hedhur një bazë të mirë në këtë drejtim, por duhet të ecim edhe më përpara. Prandaj themi se duhet ta njohim që kapaciteti mendor, puna dhe energjia e rinisë së kohës sonë, janë jashtëzakonisht të mëdha e të një niveli shumë më të lartë se ai i brezit tonë të kaluar. Është kjo një arsye e fortë që pas Çlirimit janë bërë dhe po bëhen vepra kaq të mëdha. Këto ndërtohen sepse popullin e ndriçon ideologjia e Partisë, këto i ndërtojnë duart e arta të popullit me pjekurinë, diturinë dhe mençurinë e Partisë, e cila përbën shumën e gjithë ditorisë së popullit. Duke u bazuar në këtë thesar të madh që ka krijuar Partia, ju paskëtaj do të ecni edhe më përpara. Ne kemi përpara shumë vështirësi, po do t'i kapërcejmë ato dhe do të ecim më tej me ritme edhe më të shpejta. Në të ardhmen do të ndërtojmë me të vërtetë vepra më të mëdha e më të rëndësishme se ato që kemi ndërtuar dhe jemi të bindur që do t'i ndërtojmë edhe më të mira, sepse dita-ditës dhe

çdo vit Partia po krijon me mijëra kuadro të aftë në çdo drejtim, të cilët janë e kurdoherë më shumë do të jenë në gjendje që, më lehtë, më bukur dhe më lirë, të ndërtojnë vepra të reja për të zbukuruar atdheun, për të shtuar prodhimin dhe begatinë e vendit tonë, për të zbukuruar jetën e popullit. Për këtë jemi plotësisht të bindur.

E gjithë puna e Partisë dhe e Qeverisë zhvillohet në mënyrë të harmonishme për forcimin dhe për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, për begatinë e atdheut, por pa harruar njëkohësisht zhvillimin e kulturës e të arsimit, në radhë të parë të rinisë, që është e ardhmja e vendit tonë, forca më e madhe aktuale dhe e përherëshme e vendit tonë.

Me këtë rast që ndodhem këtu, dua t'ju falënderoj së pari për besnikërinë e madhe që ka ushqyer dhe ushqen rinia e Elbasanit për Partinë dhe popullin tonë. Ajo e ka treguar këtë besnikëri në çdo moment edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare me sakrificat e mëdha që ka bërë. Dihet se me dhjetëra e dhjetëra djem e vajza nga Elbasani ranë në fushën e luftës për çlirimin e atdheut dhe lirinë e popullit. Besnikërinë e madhe ndaj Partisë dhe popullit rinia e Elbasanit e tregon edhe sot me punën e saj të palodhur për ndërtimin e socializmit. Prandaj më lejoni t'ju sjell me këtë rast përshëndetjet më të nxehta nga ana e Komitetit Qendror dhe e Qeverisë dhe t'ju them se Partia jonë ka te rinia e Elbasanit një detashment të çeliktë, të vendosur deri në fund për ndërtimin e socializmit. Prandaj detyrat e mëdha që i vihen rrethit tuaj për të ardhmen, Komi-

teti Qendror i Partisë ka bindjen se ju do t'i realizoni me sukses.

Problemet që i shtrohen rrethit tuaj janë të njëjllota me ato që i shtrohen gjithë rinisë së vendit tonë. Këto janë probleme të të gjithë Partisë. U gëzova shumë kur pashë në kalendarin e punës së rretheve se në Elbasan do të bëhej këto ditë konferenca e rinisë. U thashë shokëve se kisha dëshirë të vija në Elbasan për të parë si i gjykon rinia e këtij rrethi problemet e mëdha të vendit tonë, problemet që e preokupojnë atë vetë, sa thellohet dhe si i zbaton ajo ato. E kam zakon që nga koha e luftës që në xhep mbaj një defter shënimesh për probleme të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime për kuadrot që diskutojnë në raste të ndryshme. Gjatë diskutimeve që u zhvilluan këtu mbajta shënime edhe për shokët delegatë, të rinj e të reja, që morën fjalën në këtë konferencë. Për mua dhe për Komitetin Qendror këto shënime janë shumë të vlefshme. Mundet që gabohem, po njëfarë eksperience kam në këtë punë. Kështu, kur flet një shok, unë e ndjek atë për të parë sa thellohet në problemin që diskuton.

Po ju flas konkretisht: mua më kanë informuar se përgjegjësit e shtëpive të kulturës në fshatra i kemi shumë të dobët. Mirëpo, nga disa shokë që folën në konferencë, krijova përshtypjen se ata janë shokë plotësisht të aftë për të drejtuar shtëpitë e kulturës në fshatrat e tyre; unë mendoj se me të tillë ne mund të ecim, si i thonë fjalës, në det me këmbë. Ata e kuptojnë mirë rëndësinë e kulturës dhe bëjnë përpjekje ta përhapin atë në masë; janë njerëz që nuk thonë vetëm disa fjalë të bukura, po edhe punojnë, fjalët i shoqërojnë me ve-

pra dhe kjo duket nga fakti se me punën e tyre e kanë ndryshuar pamjen e fshatit ku punojnë. Është e vërtetë se ka edhe disa mësues që nuk interesohen sa duhet për çështjen e kulturës, për luftën kundër mbeturinave mikroborgjeze e prapanike në masa etj. Po kur dëgjova shoqen mësuese nga Shpati, që diskutoi në mënyrë aq të zjarrtë dhe të zgjuar, u binda se ajo i ka kuptuar drejt problemet dhe detyrat e saj atje ku punon e lufton për t'i zbatuar në jetë ato që thotë. Këtu diskutoi edhe shoqja Liri Gjoshi nga fshatrat e Dumresë. E vogël është ajo nga trupi, po me një shpirt të zjarrtë luftarak. Shokët e Partisë më kanë folur për historinë e saj. Në fund të diskutimit të gjithë delegatët e duartrokitën dhe jam i bindur se e duartrokitën jo vetëm për diskutimin e saj të pjekur, por edhe për personalitetin e saj, sepse ajo si e re dhe komuniste lufton me vendosmëri kundër së vjetrës bile edhe brenda në familjen e saj. Kam marrë vesh se shoqes Liri prindërit i imponuan një të fejuar që as e njihte, as e donte, kurse ajo zgjodhi për bashkëshort një djalë që donte vetë, prandaj e refuzoi atë që i dhanë prindërit kundër vullnetit të saj. Pikërisht për këto e duartrokitën atë shokët e konferencës, për guximin dhe qëndrimin e saj të drejtë. Kjo nuk do të thotë se Liria i ka përbuzur prindërit. Jo. Natyrisht, këshillat dhe mendimet e më të vjetërve duhen dëgjuar, por vullneti i rinisë duhet të merret parasysh, të mos thyhet ky vullnet, ta dëgjojmë rininë dhe jo t'i imponojmë dëshirën tonë.

Një shok tha, me të drejtë, se rinia mund të bëjë çdo gjë, mund të ndërtojë çdo vepër në qoftë se bindet për atë që do të bëjë. Dhe puna e Partisë me rininë

është një punë bindëze, edukative. Binde rininë dhe pastaj ajo me siguri bën çdo gjë. Rinia është e pastër si kristali, i cili po s'tregove kujdes, thyhet. Prandaj Partia duhet ta mbajë rininë kështu siç është, të pastër dhe ta kalitë atë gjithnjë e më shumë. Me një rini të tillë heroike, punëtore, të zgjuar dhe besnike çdo gjë mund të bëhet në vendin tonë.

Nga raporti që dëgjuam, nga sa kemi lexuar në shtyp dhe nga diskutimet që u bënë në konferencën tuaj, formova bindjen se në Elbasan ka një rini të shëndoshë, punëtore, të zgjuar dhe entuziaste, tek e cila Partia duhet të mbështetet fuqimisht, në qoftë se duam që Elbasani të përparojë me hapa edhe më të mëdhenj përpara. Rrethi i Elbasanit ka një rëndësi shumë të madhe për vendin tonë. Ju e dini si i këndohej kënga në të kaluarën Elbasanit:

Elbasan qytet i bukur,
Në kërthizë të Shqipërisë

Edhe sot Elbasani është një pikënyje që vizitohet nga shumë njerëz të rretheve të tjera. Elbasani si qytet në qendër të Shqipërisë ka mundësi dhe duhet të bëhet shembull për të gjitha rrethet e tjera në çdo drejtim. Në disa çështje Elbasani mbahet me të drejtë për mirë në gojë, si për shembull për «Shkollën Normale», për pionierët e parë që ka nxjerrë për lëvizimin e gjuhës shqipe, baza e kulturës sonë kombëtare, që ka luajtur një rol me aq rëndësi në jetën e popullit tonë. Këtë Elbasani e ka fituar dhe si kurdoherë edhe sot e mban lart flamurin

në këtë drejtim. Për këtë është shkruar dhe po shkruhet jo vetëm në historinë e vendit tonë, por dhe në enciklopeditë e huaja. Ruajeni këtë traditë të lartë që ka fituar Elbasani, shokë të rinisë. Por nuk është vetëm kjo që duhet të synoni. Elbasani ka mundësi dhe duhet të ndritë gjithashtu edhe nga ana e zhvillimit ekonomik, sepse konditat i ka shumë të mira. Sot në rrethin tuaj, pa i zënë në gojë me emra, janë të shumta fabrikat dhe uzinat që janë ndërtuar pas Çlirimit. Tani janë duke u ndërtuar vepra të tilla të mëdha si ajo e metalurgjisë së zezë dhe fabrika e çimentos.

Metalurgjia veçanërisht është për t'u përmendur si ndërmarrja më e rëndësishme e gjithë vendit tonë; përpara së cilës nuk mund të vihet asnjë. Mund të krijohen në rrethe të tjera ndërmarrje më të mëdha nga vëllimi, po shkrirja e hekurit për ekonominë e një vendi është vendimtare. Kur të jetë ndërtuar e gjithë kjo vepër, atëherë ne do të themi me të drejtë se tashmë Shqipëria mund të ecë fort me këmbët e veta, se këtu në qendrën e Shqipërisë, po ngrihet ajo industri e rëndë e vendit tonë, që është kolona e saj vertebrale. Prandaj Komiteti Qendror, Qeveria, Partia, gjithë rinia, pushteti, të gjithë, i kanë vënë rëndësi të madhe kësaj veprë që po ndërtohet në Elbasan. Më gëzoi shumë vullneti dhe entuziazmi i madh që po tregon rinia e shkollave dhe e qendrave të punës të qytetit tuaj, e cila ka marrë zotimin dhe ka premtuar të derdhë djersën e saj në themelet e kësaj veprë të rëndësishme. Do të jetë një nder i madh për ata që do të punojnë në metalurgjinë e zezë. Prandaj Partia, pushteti, organizata e rinisë, këtë vullnet e entuziazëm të madh të të rinjve dhe të të re-

jave ta kanalizojnë drejt që në metalurgji të mos shkohet sa për t'u dukur dhe njerëzit të mos gjejnë as vegla për të punuar. Rëndësi ka që puna atje të organizohet në mënyrë të atillë që ky objekt të përfundojë në kohën e duhur. Kjo është një detyrë e madhe ekonomike, por në radhë të parë një detyrë e madhe morale dhe politike. Metalurgjinë e zezë që do të ndërtojmë duhet ta përfundojmë në kohën e caktuar se veçanërisht për këtë objekt afati ka një rëndësi të jashtëzakonshme, se është një vepër e madhe, dhe në vendin tonë ndërtohet për herë të parë një objekt i tillë. Prandaj këtë vepër ne duhet ta mbarojmë medoemos në afatin e caktuar, se na vjen plani tjetër që parashikon punime edhe më të mëdha për metalurgjinë. Për nevojat e vendit tonë do të ndërtohen disa vepra të industrisë së rëndë, siç janë metalurgjia e zezë, hidrocentralet e një fuqie më të madhe, industria e naftës etj. Ndërtimi i metalurgjisë së zezë do të jetë një fitore kolosale për vendin tonë. Natyrisht, për ta ndërtuar plotësisht këtë vepër do të duhet një punë e madhe dhe e kualifikuar. Po kjo nuk na frikëson, pse ja rezultatet, në gjithë këto fabrika që po ndërtohen, sot punojnë kryesisht kuadrot tanë, edhe specialistë kinezë, ka po shqiptarët po e përvetësojnë shpejt mjeshtrinë dhe po marrin drejtimin e prodhimit. Prandaj jemi plotësisht të bindur se do ta realizojmë edhe ndërtimin e reparteve të tjera të metalurgjisë së zezë. Ju e kuptoni, shokë, sa rëndësi të madhe ka për shtetin, Partinë dhe veçanërisht për Elbasanin ngritja e metalurgjisë së zezë. Kjo i vë detyrë komitetit të Partisë dhe juve,

rinisë, të përgatitni kuadro për ndërtimin e këtyre veprave. Për kuadro, natyrisht, do t'ju ndihmojmë edhe ne ca, se do t'ju duhen mjaft, sidomos gjatë hovit më të madh të punës në muajt që vijnë. Por ju duhet të bëni përpjekje të krijoni edhe vetë kuadro, këtu, në punë. Kujdesuni që djemtë e shkollës së rezervave t'i mësoni dhe t'i përgatitni sa më mirë, që ata të bëjnë punë teknike të mirë, kështu që kërkesat në qendër për kuadro nga ju të jenë sa më të pakta. Kini parasysh, shokë, se në të katër anët e atdheut po ndërtojmë vepra të komplikuarra. Tani në shumë prej tyre jemi në fazën e montimeve. Në të gjitha na duhen montatorë, axhustatorë, elektrikistë etj. Prandaj e kanë kot disa që bërtasin t'u dërgojmë kuadro nga lart. Nga 100 të tillë që mund të kërkonin, qendra mund t'ju dërgojë 5 ose 6, se ku t'i gjejë të tjerët? Prandaj përvishuni ta hidhni lumin me forcat tuaja. Nevoja do t'ju nxitë të përgatitni dhe të nxirrni kuadro të rinj.

Në Elbasan duhet ngritur gjithashtu sa më parë edhe fabrika e çimentos, se nevojat për çimento për ndërtimin e veprave që po bëjnë janë jashtëzakonisht të mëdha. Kudo te ne ndihet mungesa e çimentos. Vështrësitë e transportit të çimentos nga jashtë kanë bërë që ndërtimi i shumë veprave të pengohet, që fshatarësisë të mos i japim dot sasinë e çimentos që i duhet. Për këtë lëndë edhe llogaritë nuk janë bërë mirë nga specialistët tanë. Prandaj vjet për këtë arsye u detyruam që çimenton e destinuar për disa objekte ta ndërpritnim, me qëllim që të furnizonim rregullisht objektet më të rëndësishme derisa na erdhi nga jashtë çimentoja e porositur. Në këto kushte ngritja në kohën e duhur e

fabrikës së çimentos ka rëndësi të madhe. Por ajo ka shumë rëndësi gjithashtu edhe nga një anë tjetër. Tani jemi vërtet në kohë paqeje, «qetësie», po në realitet kohët nuk janë të qeta. Prandaj në këto situata duhet t'i shpejtojmë ndërtimet, bile po të jetë e mundur çdo vepër ta ndërtojmë para afatit. Për këtë duhet të mobilizohemi totalisht, në mënyrë që objektet që ndërtojmë të përfundojnë dhe menjëherë të vihen në funksionim. Këtë ka mundësi ta bëjmë, llogaritë janë bërë, tani mbetet vetëm që Partia të organizojë mirë punën. Në radhë të parë është çështja që punëtorët të bëhen të ndërgjegjshëm. Kjo është një detyrë shumë e madhe, urgjente dhe shpëtimtare për vendin tonë. Asnjë nuk duhet të mbetet prapa në punë, edhe ai më i thjeshti të mobilizojë në shkallën maksimale të gjitha energjitë që këto vepra të mbarojnë sa më parë për të mirën e atdheut, të popullit dhe të secilit.

Detyrë tjetër me rëndësi shumë të madhe për vendin tonë edhe për ju në Elbasan është edhe bujqësia. Veçanërisht për momentet që po kalojmë bujqësia ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Në Elbasan janë shënuar përparime, sidomos në drejtim të sistemimit të tokave, të ujitjes, të kolektivizimit, të mekanizimit etj. Pra, bujqësia edhe te ju ka shkuar përpara, janë bërë shumë gjëra të mira. Sidomos kooperativat e zonave fushore janë zhvilluar në një nivel të kënaqshëm, se duken ndryshime të konsiderueshme në zhvillimin e bujqësisë, në forcimin e kooperativave bujqësore dhe në ngritjen e nivelit të jetesës së fshatarësisë.

Por të mos harrojmë se malësia e Elbasanit akoma nuk ka ecur sa duhet përpara, prandaj duhet ta shtoj-

më kujdesin dhe punën tonë që edhe kooperativat e zonave kodrinore dhe malore të ngrihen në një nivel më të lartë bujqësor, të forcohet më mirë ekonomia e tyre. Në radhë të parë, vetë popullsia e zonave malore ta kuptojë rëndësinë e madhe të zhvillimit të bujqësisë jo vetëm si një detyrë thjesht ekonomike, për ngritjen e mirëqenies së fshatarësisë së zonave malore, por edhe si një detyrë të madhe luftarake dhe politike që sot na e ka vënë përpara me forcë Komiteti Qendror. Malësitë ne duhet t'i ndihmojmë në këtë drejtim.

Ne kemi bërë edhe studime për zhvillimin ekonomik të zonave malore. Për këtë kanë ndihmuar të gjithë. Në planin e ri pesëvjeçar parashikohet që këtyre t'u jepet një ndihmë e veçantë sidomos në lidhje me ujitjen, hapjen e tokave të reja dhe shtimin e kafshëve të punës. Por Komiteti Qendror na ka vënë edhe një detyrë tjetër, që malësitë, ashtu siç kanë qenë kështjella luftarake, në çdo kohë rreziku për popullin, të bëhen të tilla edhe në eventualitetin e ndonjë rreziku të ri. Partia, shteti dhe i gjithë populli të punojnë që edhe ato t'i ngrenë ekonomikisht, t'i bëjnë të afta që ta sigurojnë vetë bukën, të shtojnë blegtorinë në numër dhe prodhueshmërinë e saj, me qëllim që edhe në kohë rreziku ato të bëhen prapavija e shëndoshë e popullit kundër një agresioni eventual.

Ju në Elbasan, shokë, keni për detyrë që kooperativat bujqësore fushore dhe ato të zonave të buta kodrinore t'i udhëhiqni që të ecin edhe më përpara nga niveli që kanë arritur dhe për këtë mundësitë i keni. Në këtë drejtim rinia duhet të jetë një nga faktorët më vendimtarë. Ka ikur koha kur nënvleftësoheshin të

rinjtë dhe të rejat nga ata me moshë të kaluar. Me luftën dhe punën e saj, rinia jonë tashmë ka kohë që ka fituar respektin e më të moshuarve në fshat, sepse ka ndjekur kurdoherë me besnikëri dhe drejt mësimet e Partisë, se ajo u hodh pa rezerva në luftë dhe pas Çlirimit u fut në shkollë dhe në punë dhe po realizon detyrat në mënyrë shembullore. Sot në fshat rinia bën më tepër se kushdo ditë-punë, çon më shumë prodhime dhe të holla në shtëpi, prandaj pleqtë tani i çmojnë më shumë të rinjtë dhe të rejat.

Në kooperativat bujqësore ju, të rinjtë dhe të rejat, jeni forca më e gjallë. Mos harroni të rejat, shokë, edhe ato janë gjithashtu një forcë e madhe. I konsideroni ato si shoqet tuaja të jetës dhe të luftës, silluni me to si shokë dhe si vëllezër, marrëdhëniet me to duhet t'i keni shoqërore, të hapëta, të sinqerta, të ndershme. Por në botë ekziston edhe dashuria që ka lindur bashkë me njeriun. Natyrisht, vjen koha dhe i riu do të martohet me të renë, por marksizëm-leninizmi na mëson që në këtë drejtim duhet të na prijë kurdoherë morali i proletariatit. Kur dy të rinj duhen ndershmërisht, le ta marrin njëri-tjetrin dhe jeta e tyre të shkojë përpara, të bëhet e lumtur. Por në punë nuk kemi të bëjmë me dashurinë, por me një qëllim më të madh, me ndërtimin dhe lulëzimin e atdheut, me lulëzimin dhe begatinë e gjithë popullit, pra, me një interes më të lartë. Kur të përparojë atdheu, kur të përmirësohet jeta e popullit, do të zbukurohet edhe jeta e çiftit të ri, atëherë ambienti edhe në familje do të bëhet më i ëmbël. Në punë, pra, kontaktet midis të rinjve e të rejave të jenë shoqërore, të hapëta, të sinqerta.

Jepuni kurajë të rejave të flasin dhe të diskutojnë nëpër mbledhje, t'ju kritikojnë edhe ju kur gaboni. Mos u zemëroni me to kur ju kritikojnë. Do t'i duhet shumë kohë akoma burrit shqiptar të kuptojë që nuk qëndron më lart nga gruaja. Burrat kurdoherë qëndrojnë një çikë si kaposhtë. Vjen vetvetiu, shpesh, pa dashje, kjo dreq mbeturinë e ngulitur me shekuj, prandaj, sado që punon Partia, ka raste që te ne dalin shenjat e atavizmit të vjetër dhe i duket tjetrit se po nuk komandoi një çikë burri nuk mund të quhet burrë. Prandaj ne, komunistët dhe sidomos të rinjtë, ta kemi parasysh këtë, të jemi zemërgjerë me vajzat se edhe ato kanë po ato të drejta, janë po aq të zgjuara sa edhe djemtë. Sot shkenca dhe realiteti i kanë rrëzuar teoritë obskurantiste borjeze që janë kundër zgjuarsisë së gruas. Përpara thoshin se gratë janë «leshragjata dhe mendjeshkurtra», por shkenca ka provuar se aq sa ka mend burri ka edhe gruaja. Në qoftë se ka burra gjeni, ka edhe gra gjeni. Të tilla kanë qenë Irenë Kyri dhe Mari Kyri. Meqenëse dëshirojmë që shoqet tona të ecin përpara, në radhë të parë duhet që ato të kenë mbështetjen e shokëve. Prandaj në qoftë se e kuptojmë drejt vijën e Partisë dhe të gjithë e kanë të qartë këtë vijë, atëherë, për ta realizuar, duhet të mobilizojmë edhe forcat kolosale të të rejave.

Të gjithë ne e dimë ç'është kolektivizimi, ç'rëndësi ka kullimi i tokave, prashitja e kulturave bujqësore, pastrimi nga barërat e këqija, ujitja, zgjedhja e farës etj., etj. faktorë që përbëjnë kodin agroteknik. Shkenca agroteknike është një shkencë e gjerë që ju të fshatit, sidomos, duhet ta dini më mirë. Duke mësuar dhe du-

ke punuar drejt, me ndërgjegje, pa u lodhur në praktikë, ne do të kemi çdo vit rezultate më të mëdha. Fakti është se edhe në bujqësi ne kemi rezultate. Bujqësia jonë sot ka ndryshuar si nata me ditën nga ajo e së kaluarës.

I thashë shokut sekretar se rinia e rrethit tuaj ka bërë mirë që ka zgjedhur në komitetin e saj edhe kua-dro të lartë që merren me bujqësi. Unë dëgjova këtu me vëmendje diskutimin e një shoku veteriner, i cili foli mjaft mirë për rëndësinë e edukimit të rinisë me problemet e bujqësisë. U thashë shokëve se do të bëhej shumë më mirë që nëpërmjet këshillave e udhëzimeve mbi problemet bujqësore, si mbi rritjen e bimëve, mbi luftimin e sëmundjeve të tyre etj., t'u flitej të rinjve e të rejave edhe për disiplinën, për moralin, për drejtësinë, për ndershmërinë sesa t'u flasësh në mënyrë formale me nga një leksion të thatë, apostafat për këto gjëra. Shokët tanë që merren me rininë dhe që kanë kulturë të lartë ose të mesme, nëpërmjet këtyre këshillave mund t'u mësojnë të rinjve e të rejave për shembull, që të jenë të disiplinuar, pa qenë nevoja t'u bëhet një konferencë e veçantë për disiplinën. Kështu, kur specialisti i lartë u flet për problemin e farës, ai mund ta prekë çështjen e disiplinës në mënyrë indirekte, duke u vënë në dukje sa delikate është fara e duhanit e ç'kujdes kërkon ajo, prandaj, që të kemi prodhime të mira në duhan, duhet që kultivuesi i duhanit të ngrihet çdo ditë herët, qysh në mëngjes, të pastrojë farën dhe ta mbrojë atë nga ngricat në farishte, të theksojë se të gjitha shërbimet që i duhen bërë duhanit kërkojnë një disiplinë të fortë etj. Me një punë të

tillë të rinjve do t'u rrënjoset njëkohësisht bashkë me njohuritë agroteknike edhe ndjenja e disiplinës.

Specialisti i bletëve, kur t'u flasë të rinjve dhe të rejave për bletët, mund t'u theksojë njëkohësisht edhe sa punëtore, të pastra e të disiplinuar janë këto insekte. Ato nuk pranojnë çrregullime në familjen e tyre, në zgjua. Po ta vësh re me kujdes zgjoin do të shikosh se çdo gjë atje është në rregull. Prandaj edhe vendet ku punojmë dhe jetojmë ne, njerëzit, edhe rrobat, enët, veglat e punës, banesat duhet të jenë të pastra dhe t'i mbajmë ashtu sikurse i mban bleta. Me një fjalë, nëpërmjet mësimëve të tilla edhe specialistët tanë të bujqësisë mund t'u rrënjosin të rinjve dhe të rejave normat e moralit të shëndoshë komunist në vend që t'u bëhet atyre nga një konferencë ku nganjëherë del një e grin tri orë dhe nuk e merr vesh njeri se çfarë thotë. Për këtë arsye nganjëherë mbledhjet bëhen të mërzhitshme, se në to konferencierët shkojnë me formula baje, të njohura ose abstrakte e të pakuptueshme.

Këtu në konferencë diskutoi mjaft mirë edhe një delegat nga ushtria, ushtar i thjeshtë, por i zoti. Të tillë rini ka edukuar Partia. Por njerëzve të tillë të ngritur të vesh t'u flasësh vetëm disa formula nuk të dëgjojnë me qejf. Me ta duhet folur konkretisht. Udhëheqësit, instruktorët dhe inspektorët duhet të dinë tani me kë kanë të bëjnë kur flasin. Përpara 12-13 vjetësh, propaganda në forma të përgjithshme, jokonkrete, fundja edhe mund të kalonte diçka, kurse tani nuk kalon dot me gjëra të tilla; njerëzve, pra, duhet t'u flasësh më shumë nga sa dinë ata dhe të dish t'ua lidhësh mirë me aktualitetin temën që je duke zhvilluar. Pra, përpara

ushtarëve të tillë nuk del dot të flasësh gjëra të përgjithshme që ata i dinë më mirë.

Bujqësia, jo vetëm në rrethin tuaj, por në gjithë Shqipërinë, është baza e ekonomisë sonë. Ne jemi një vend i vogël i rrethuar me armiq të shumtë, që na kanë bërë dhe vazhdojnë të na bëjnë bllokadë. Për të përballuar situatat e vështira, që janë krijuar nga imperialet e revizionistët, ne duhet të bëjmë shumë më tepër përpjekje për ta furnizuar industrinë e re që kemi ndërtuar me lëndën e parë të vendit, duke filluar që nga hekuri, pambuku, panxhari etj. Çdo gjë ne nuk e bëjmë dot në vend, se jemi akoma të varfër, nuk trashëguam pasuri si të tjerët, bile akoma edhe sot s'kemi krijuar të tilla mundësi që t'i përpunojmë në vend tërë materialet që kemi dhe të mundim me to të sigurojmë devizë të huaj. Dihet se, po të kesh devizë, mund të sjellësh si i thonë edhe qumësht dallëndysheje. Një situatë të tillë ne nuk e kemi krijuar akoma. Prandaj na vihet detyrë e domosdoshme që të zhvillojmë bujqësinë me ritme shumë më të larta e të shpejta.

Kjo degë e ekonomisë sonë ka rëndësi vendimtare, se po të mos rritim si duhet, për shembull, pambukun, do të na mbeten kombinatet e tekstileve pa punuar ose do të detyrohemi të blejmë jashtë pambuk. Kështu mund të themi për panxharin, duhanin etj. Po blerja jashtë e sendeve që mund t'i prodhojmë në vend, na shkurton importin e gjërave të tjera për të cilat ka nevojë populli. Po të mos tregojmë kujdes për rritjen dhe mbarështrimin e ullinjve, do të importojmë vazhdimisht vaj që është një lëndë deficitare në tregun botëror. Bujqësisë, pra, në radhë të parë, edhe ju në Elbasan t'i vini kujdesin më

të madh se keni për të bërë shumë. Vjet ju e realizuat planin në drithëra. Disa lokalitete, si ai i Dumresë, për herë të parë siguruan gjithë bukën që i nevojitet, prandaj fshatarët janë shumë të gëzuar dhe ky është një gëzim i drejtë. Tani fshatarët e Dumresë e kuptojnë edhe më mirë rëndësinë e kolektivizimit për të cilin kishte kohë që u kishte folur Partia, kuptojnë sa me vend janë bërë investimet e shtetit për ujitjen etj. Rinia dhe gjithë fshatarësia jonë duhet të punojnë që investimet e bëra për veprat ujitëse të shërbejnë në maksimum për qëllimet e tyre.

Elbasani është një rreth duhanor dhe orizor, mirëpo në këto dy kultura të rëndësishme rrethi juaj nuk e ka realizuar detyrën. Kjo nuk është e mirë, mbasi në radhë të parë ka humbje vetë fshatarësia, njëkohësisht edhe shteti. Nga duhani shteti siguron një sasi të madhe devize, dollarë, nga ana tjetër edhe fshatarësia siguron të ardhura të konsiderueshme. Por nuk duhet të punojmë sa të nxjerrim duhan për duhan, se kështu duhani jo vetëm do të jetë i cilësisë së dobët dhe fshatarësia do të ketë humbje mbasi do të marrë më pak të ardhura, por edhe nuk do ta eksportojmë dot se nuk na e merr njeri, ose do të na e blejnë shumë lirë. Prandaj në këtë drejtim të gjithë ju duhet të mendoni mirë si për veten tuaj ashtu edhe për shtetin.

Orizi gjithashtu ka rëndësi të madhe. E gjithë bota sot lufton për shtimin e prodhimeve ushqimore duke përfshirë edhe orizin. Nuk është mirë që për nevojat e konsumit të përditshëm shteti të importojë vazhdimisht drithëra, oriz, vajra etj. Prandaj rrethe të tilla me klimë të përshtatshme si Elbasani duhet t'i kushtojnë kuj-

desin më të madh realizimit në maksimum të rendimenteve të kulturave bujqësore.

Ne besojmë që ju i shikoni si duhet detyrat që keni përpara. Vetëm kini parasysh se ky është një vit vendimtar për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, prandaj të bëjmë të gjitha përpjekjet që të shkojmë në Kongres me plan të realizuar. Sigurisht, në disa zëra ne nuk do ta realizojmë dot planin për arsye të vështirësive të mëdha që na nxorën revizionistët. Duke bërë llogari del se ata na kanë shkaktuar dëme të mëdha në ekonomi, na kanë vonuar në radhë të parë mbarimin dhe vënien në shfrytëzim në afat të shumë objekteve, por me gjithë vështirësitë, të cilat tani i kemi kapërcyer, prapë kemi arritur rezultate të kënaqshme. Sidoqoftë ky duhet të jetë një vit mobilizues e në radhët e para të jetë rinia.

Rinia, si ajo e fshatit ashtu edhe e qytetit, vazhdimisht duhet të mësojë. Pa mësuar, shokë e shoqe, nuk ecet përpara, nuk ndërtohen gjithë këto vepra të mëdha, jo vetëm në lëmin e industrisë, por as në bujqësi.

Shokët që diskutuan e theksuan mirë atë që ka thënë shumë herë Komiteti Qendror i Partisë që puna është nder. Të gjithë duhet të punojmë, burra dhe gra, natyrisht në çfarëdo pune që ka e që duhet bërë. Gratë e qytetit, në qoftë se duan të punojnë, le të shkojnë atje ku është puna dhe jo të kërkojnë të punojnë vetëm në çerdhe ose në disa vende të tjera ku ka punë të lehta. E sa çerdhe ka këtu në qytet? Pastaj ndonjëra thotë: hiq atë që është atje dhe më vër mua. Po pse të të vë ty që u kujtove të vish tani në punë, kur tjetra ka kaq vjet që po derdh djersë atje? Njerëzit, pra, nuk duhet.

të venë vetëm në disa punë të lehta, por të drejtohen në të gjitha llojet e punës, të mos kenë turp e të mos shmangen nga asnjë lloj pune. Sidomos ata që kanë bërë luftën të jenë në ballë të çdo pune. Më folën shokët e rrethit për një shok të mirë që ka luftuar dhe tani ka dalë në pension. Tani edhe ky kërkon punë. Mirëpo ndonjë specialitet e shkollë të madhe ai nuk ka, atëherë shokët i propozuan ta vendosnin në një depo. Ky pranoi, po pyeti çfarë do të bënte atje. I shpjeguan se atje do të depozitojë dengje që do t'i peshojë dhe pastaj do t'i ndajë në një numër dyqanesh. Ku jam unë për atë punë, tha ai? E po mirë, iu përgjigjën shokët, atëherë të të vendosim brigadier, ku të mbash llogarinë e punës të të gjithë punonjësve të brigadës. Jo, as këtë nuk e bëj, tha përsëri ai. E po atëherë çfarë do, i thanë edhe një herë shokët? Më vini roje në depo. Mirë, të vëmë roje dhe shokët e vendosën sipas dëshirës roje, jo natën, po ditën, po edhe këtë punë nuk e bëri. Qëndrimi i këtij shoku nuk është i drejtë. Shteti të të japë punë dhe ti të kërkosh të dredhësh zinxhirin tërë ditën, kjo nuk shkon, s'pajtohet me parimet tona socialiste. Prandaj, shokë dhe shoqe të rinisë, të marrim shembull nga njerëzit heroikë të punës që punojnë pa u lodhur dhe që çdo lloj pune e quajnë nder. Në këtë drejtim duhet të ketë një mobilizim akoma më të madh e të rinjtë të jenë shembullorë.

Më shumë e me të gjitha forcat duhet të mobilizohemi, shokë, se situatat janë të vështira. Brenda vendit tonë situata është jashtëzakonisht e shëndoshë, e fortë. Uniteti midis Partisë dhe popullit është monolit. Partia jonë është e çeliktë. Edhe gjendja jonë ekonomi-

ke po forcohet çdo ditë me ritme të shpejta. E gjithë kjo e ka bërë Shqipërinë t'i ketë të forta jo vetëm pozitat e brendshme, po edhe ato ndërkombëtare. Qëndrimet heroike të popullit shqiptar, të Partisë dhe të Qeverisë sonë si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe në këtë periudhë 20-vjeçare, kanë bërë që armiqtë rreth e rrotull vendit tonë të mos i ulin armët kundër Shqipërisë. Por në drejtim të provokimeve ata kanë shkuar duke u tërhequr. Vitet e fundit në kufijtë tanë nuk janë bërë më provokime si më parë, nuk ka më zbrazje armësh etj. Kjo ndodh jo se ata na duan, por në saje të qëndrimit heroik të Partisë dhe të popullit tonë gjatë gjithë periudhës së luftës dhe pas Çlirimit.

Qëndrimi heroik i popullit dhe i Partisë sonë e detyron edhe armikun, pra, t'i vërë gishtin kokës. Qëndrimi i drejtë politik, ideologjik e ushtarak i Partisë dhe i vendit tonë e kanë forcuar shumë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë. Fakti që disa qarqe qeveritare e reaksionare shprehen me respekt për Republikën tonë, nuk do të thotë se na duan, por se nuk kanë se ç'na bëjnë. Eksperienca e historisë tregon se po të përkulesh, armiku të merr frymën, po të qëndrosh heroikisht nuk afrohet dot të të kafshojë, bile fillon të të marrë me të mirë e të të bëjë lajka.

Qëndrimet e drejta e të vendosura të Partisë sonë janë bërë mbështetje dhe njëkohësisht shembull për popujt e marksistë-leninistët në botë. Për këtë nuk duhet të na ngrihet mendja. Qëndrimet e drejta e të përkulura të Partisë sonë janë të frymëzuara nga marksizëm-leninizmi. Është një detyrë internacionaliste që vija jonë të qëndrojë kurdoherë e patundur, luftarake

dhe të bëhet një mbështetje dhe për të tjerët. Ne krenohemi dhe gëzohemi kur të gjithë komunistët në botë thonë se vija e Partisë sonë është me të vërtetë marksiste-leniniste, se ata mësojnë nga Partia jonë, se Partia jonë është në pararojë dhe një Parti me të vërtetë e madhe. Pikërisht për qëndrimet e saj të drejta, parimore ajo ka fituar plotësisht të drejtën të quhet parti leniniste. Ajo, pa u druajtur nga askush, ia thotë të vërtetën kujtdo qoftë. Kush është marksist thotë: nuk ka si Partia e Punës e Shqipërisë, pavarësisht se kritika që më bën mua është e hidhur, ajo është e drejtë. Ne, shokë, duhet të ecim në këtë rrugë të palëkundshme.

Këtë situatë të favorshme në lëvizjen komuniste e kanë krijuar vija e drejtë e Partisë sonë dhe e partive të vërteta marksiste-leniniste. Ato kanë ndihmuar që shumë elementë të lëkundshëm në botë të orientohen drejt në situatat që janë krijuar.

Pasi foli për disa probleme të situatës ndërkombëtare dhe të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, shoku Enver Hoxha tha:

Situata, shokë, është në favorin tonë. Kjo do të thotë se lëvizja komuniste në botë është më e fortë, pavarësisht se revizionizmi përkohësisht ka zënë për gryke Bashkimin Sovjetik, shumë vende të ish-demokracisë popullore të Evropës, si edhe shumë parti komuniste në botë. Megjithëkëtë, revolucioni, marksizëm-leninizmi është në ngritje. Ne, pra, jemi më të fortë, jo me fjalë, por në realitet.

Të kuptohen drejt detyrat që na kanë caktuar Partia dhe pushteti ynë popullor. Veçanërisht të rinjtë dhe të rejat në këto situata të mobilizohen me të gjitha for-

cat e tyre të trupit dhe të mendjes për kryerjen plotësisht të këtyre detyrave, se i kemi plotësisht të gjitha kushtet për të dalë me sukses.

Të rrojë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Rroftë rinia jonë heroike!

*Botuar për herë të parë në
«Raporte e fjalime 1965-
-1966», f. 54. Tiranë, 1971*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TË NGRIHEMI NË KËMBË PËR NDËRTIMIN E VEPRËS SË MADHE TË METALURGJISË SË ZEZË NË ELBASAN

*Nga fjala para kuadrove të Partisë të rrethit
të Elbasanit*

5 prill 1965

Do të jetë mirë që këtë takim të mos e bëjmë manifestiv, por ta kthejmë në një mbledhje pune. Të mos harrojmë se pjesëmarrësit këtu s'janë dhe aq në moshë të re, siç ishin ata që morën pjesë dje në konferencën e rinisë të rrethit. Rinisë ia falim duartrokitjet dhe manifestimet, kurse ne kemi ardhur në këtë takim për një bisedë shoqërore, sido që kjo sallë nuk të jep përshtypjen e një ambienti ku mund të bësh një bisedë të tillë, sepse ka pamje zyrtare.

Pardje dhe dje m'u dha rasti të merrja pjesë në konferencën e rinisë, nga e cila dola me përshtypje shumë të mira. Natyrisht Komiteti Qendror i Partisë është informuar herë pas here për përpjekjet dhe punën e rinisë së Elbasanit. Partia e njeh mirë rininë e Elbasanit, ajo njeh patriotizmin e saj, guximin që ka

treguar në çdo rast dhe rezultatet që ka arritur në punë. Por të gjithë neve na duhet ta njohim më nga afër rininë si mendon, si gjykon dhe si vepron ajo. Veçanërisht më bënë një përshtypje të madhe të rinjtë dhe të rejat që diskutuan. Ata prekën probleme të rëndësishme dhe diskutuan me një frymë të lartë patriotike, optimiste dhe në mënyrë të thelluar. Natyrisht ka një ndryshim në mes drejtuesve të rinisë që janë anëtarë partie nga ata pa parti. Ata që janë anëtarë partie kanë më shumë halle dhe kjo bën që nganjëherë këta problemet ia paraqesin rinisë me një ton sikur të flisnin me ju këtu, nuk kanë parasysh se me rininë duhen përdorur mënyra të tjera që t'i përshtaten asaj. Kjo nuk do të thotë se shokët e rinj që diskutuan nuk u thelluan në problemet me seriozitet të madh, por ata ruajtën njëkohësisht edhe frymën e rinisë në to, gjë që është shumë pozitive dhe e domosdoshme.

Më bëri gjithashtu përshtypje që në diskutimet e konferencës së rinisë nuk pashë ndonjë diferencë të madhe midis nivelit të diskutimeve të delegatëve nga qyteti dhe nga fshati, bile mund të them se të rinjtë e të rejat e kooperativave bujqësore e të fshatrave në përgjithësi flisnin po aq lirisht sa edhe ata të qytetit dhe pa fraza pompoze. Kjo nuk do të thotë se mendimet e tyre ishin të thjeshta, ato ishin aq serioze e të thella sa edhe mendimet e të rinjve të qytetit, të rrjedhshme e të lidhura mirë si nga stili, ashtu dhe nga ana gjuhësore. Kjo të krijon përshtypjen se të gjithë ata që diskutuan kanë bërë shkollë. Njerëz të zgjuar ishin të tërë, djem e vajza. Vajzave u priste gjuha aq mirë,

sa edhe djemve, flisnin aq lirisht e me entuziazëm dhe paraqitnin mendime të thella sa edhe djemtë.

Ajo që e preokuponte më shumë rininë e rrethit tuaj ishte të zbatoheshin në jetë vendimet dhe këshillat e Partisë. Në të gjitha diskutimet dilte qartë se të rinjtë tanë e njohin në çdo drejtim vijën e Partisë, flisnin me gjuhën e saj dhe tregonin se punonin ashtu si e kërkon Partia. Ky është një sukses i madh për popullin dhe Partinë tonë. Preokupacioni i madh i tyre ishte që ta ruajnë rininë të pastër, ta edukojnë atë me frymën e punës. Një gjë e tillë u duk në të gjitha diskutimet e të rinjve e të rejave. Ata vinin në dukje, pa druajtje, anët e mira të moralit komunist të rinisë, moralin e shëndoshë të popullit tonë, si dhe të metat e veset e disa të rinjve.

Në përgjithësi rinia jonë është e pastër, e shëndoshë, e zgjuar, e etshme për punë dhe e gatshme të marrë mbi vete çdo përgjegjësi. Prandaj mendoj se do të ishte një gabim i madh nga ana e kuadrove të Partisë në qoftë se nuk do ta kuptonin këtë realitet të shkëlqyer, në qoftë se nuk do të kuptonin që ne kemi një rini heroike, të zonzjën, së cilës mund t'i besohet pa frikë çdo detyrë drejtimi dhe organizimi në punë.

U thashë delegatëve të rinisë në konferencë se brezit tonë iu desh të merrte armët dhe të luftonte. Ju mbani mend vetë, shokë, se kur morëm armët për lirinë e atdheut, të tërë atëherë ishim të rinj dhe duhet të themi hapur se atëherë ne nuk e kishim këtë zotësi, këtë pjekuri e dituri që kanë sot të rinjtë e vendit tonë. Rinia jonë e edukuar nga Partia edhe gjatë këtyre 20 vjetëve u tregua e guximshme. Ajo nuk është më

pak e guximshme nga sa ishim ne. Punët që bën rinia jonë sot kërkojnë jo më pak trimëri, vendosmëri dhe njëkohësisht edhe zgjuarsi.

Brezi ynë nga të parët tanë trashëgoi traditat e shkëlqyera të rezistencës, të luftës, të pushkës, por jo atë të ngritjes së fabrikave, uzinave, hidrocentraleve, të hapjes së tuneleve, hekurudhave etj., etj. Këto vepra u ndërtuan për herë të parë pas Çlirimit të Atdheut prej popullit tonë që mori fuqinë në dorë i udhëhequr nga Partia. Këto janë dhe mbeten vepra shumë të komplikuar, ato nuk mund t'i bëjnë njerëzit e paditur, pa shkollë, ato duan dituri, durim, këmbëngulje, guxim dhe heroizëm, cilësi këto që i ka bërë tani të sajat rinia jonë. Këtë realitet e krijoi Partia. Ajo gjatë kësaj kohe edukoi një rini me një garanci të madhe në jetë, sepse ka mijëra kuadro, të dalë nga lufta, që kanë fituar një eksperiencë të madhe si në luftën e armatosur, ashtu dhe në ndërtimin e socializmit në të gjithë sektorët. Në këtë eksperiencë të madhe mbështetet kjo rini, e cila është futur tani në të gjithë damarët e jetës së vendit. Prandaj ta përkrahim atë me të gjitha forcat kudo ku jeton e punon, në fshat e në qytet, në ushtri, në fabrika, në ara, në shkolla etj. Tani që disave nga ne po u kalon mosha, kur kemi të bëjmë me rininë duhet të jemi të duruar dhe, kur gabon, ta mësojmë, ta këshillojmë, ta korrigojmë, të përdorim me të një frymë bindëse, afrimi, ngrohtësie, se rinia është delikate. Kurse ndaj të metave dhe gabimeve të atyre që kanë vite në punë të jemi më të rreptë.

Ndjenjat e rinisë, që në përgjithësi janë të pastra, nuk duhet t'i ndrydhim; nuk duhet t'i krijojmë asaj

pengesa dhe shqetësime të paarsyeshme. Prandaj, shokë, detyrat që caktoi konferenca e rinisë të mbështeten nga të gjithë, në radhë të parë nga kuadrot e komunistët.

Kush ka rininë me vete, ka të ardhmen të sigurt. Frymën për një disiplinë të ndërgjegjshme mbi të cilën diskutoi në konferencë në mënyrë të mrekullueshme një i ri i pjekur, duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë në gjithë rininë tonë. Në këtë drejtim t'u sigurojmë atdheut, ushtrisë, ekonomisë kuadro të rinj, që të jenë medoemos të pastër, të mirë, të zhvilluar. Prandaj kuadrot e Partisë dhe të pushtetit duhet të punojnë që ta kryejnë këtë detyrë, ta bëjnë atë sa më mirë.

Të kemi kujdes që të sillemi sa më mirë me njerëzit. Veçanërisht të rinjtë t'i edukojmë me frymë të shëndoshë, t'i mësojmë të na zëvendësojnë, t'i pastrojmë nga çdo mbeturinë mikroborgjeze, ambicieje etj. dhe t'i sigurojmë kështu atdheut të ardhmen. Ju, shokë, ia sigurovat atdheut këtë të sotme me luftën, me sakrificat dhe me kokën tuaj. Aq sa kishit i hodhët në balancë dhe kështu u sigurova liria, ndërtimi i socializmit dhe u bënë përparime kolosale. Tani sukseset e arritura gjer më sot duhet të vlejnë si një bazë nga ku të nisen të rinjtë që do të na zëvendësojnë, për të punuar me guxim dhe me vrull revolucionar. Prandaj ju rekomandoj që të tregoni kujdes të madh për edukimin e rinisë, të keni besim te rinia dhe ta ndihmoni atë.

Brenda vendit ne kemi suksese në realizimin e planeve tona ekonomike. Planet në përgjithësi i realizojmë, sidomos në industri, por edhe në bujqësi kemi

ecur përpara. Pra, në përgjithësi, mund të themi se kudo kemi suksese. Viti i kaluar ishte i mbarë për bujqësinë. Mirë dolëm me drithërat, prodhimi ka qenë i kënaqshëm, megjithëse parashikimet nuk u realizuan. Bujqësisë ne duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, për arsye se ajo është në realitet baza e ekonomisë sonë socialiste dhe industria dega udhëheqëse. Të dy këta sektorë Partia i ka zhvilluar në rrugë të drejtë marksiste, duke u mbështetur në forcat e veta. Por duhet thënë se udhëheqja e drejtë e Partisë, djersa e popullit, puna edhe në ekonomi zënë peshën kryesore në zhvillimin e vendit tonë. Çështja është që edhe në qoftë se shohim që gjatë këtyre kohëve kemi pasur dhe kemi përparime në lëmin e bujqësisë, këtej e tutje nuk duhet të kënaqemi me këto që kemi arritur, bujqësia duhet të ecë edhe më përpara dhe të bëhet me të vërtetë një bazë e shëndoshë e ekonomisë, në radhë të parë në prodhimin e drithërave të bukës. Me këtë nuk them ndonjë gjë të re, po e theksoj, sepse pikërisht në drejtim të bujqësisë duhen bërë shumë përpjekje, së pari se nga bujqësia sigurohet ushqimi për popullin. Pastaj duhet të kemi kurdoherë parasysh situatat e vështira ndërkombëtare. Dhe këto do t'i përballojmë duke u mbështetur në radhë të parë në forcat tona. Kështu, duke zbatuar këtë parim të madh, Partia jonë arriti të kolektivizojë bujqësinë, ta pajisë atë me një fuqi motorike të konsiderueshme, të grumbullojë një eksperiencë të madhe, me anën e së cilës ne mundet dhe duhet ta çojmë me hapa më të mëdhenj përpara bujqësinë tonë. Prandaj shokët që punojnë në pushtet, në organet e Partisë dhe në kooperativat bujqësore, duhet të

luftojnë kundër të metave që ekzistojnë në sektorin e bujqësisë, në radhë të parë kundër të metave organizative.

Të gjithë themi dhe shohim se pa traktorë nuk mund të ecë bujqësia jonë. Megjithatë konstatojmë se ka të meta në drejtim të riparimit dhe të përdorimit si duhet e me efikasitet të plotë të traktorëve nga traktoristët dhe nga vetë kooperativistët. Për këtë çështje duhet të vendoset një bashkëpunim i ngushtë në mes tyre. Pra, këtë ta përdorim si duhet, në shkallë të gjerë, të mekanizojmë sa më shumë procese pune, t'i kryejmë ato në kohën e duhur dhe makineritë të ruhen, t'i mbajmë mirë që të punojnë për një kohë shumë të gjatë, se ne akoma nuk e kemi industrinë tonë mekanike në atë shkallë sa të plotësojë si duhet dhe kur duhet të gjitha nevojat me vegla këmbimi. Për këtë qëllim tani jemi duke ndërtuar uzinën për prodhimin e pjesëve të këmbimit për traktorë. Duke prodhuar vetë pjesët e këmbimit, shkurtojmë importin dhe, si rrjedhim, do të harxhojmë më pak valutë.

Sidoqoftë, edhe sikur të kishim industri mekanike të zhvilluar për të gjitha nevojat, prapëseprapë tani dhe kurdoherë për ne mbetet detyrë e madhe ruajtja dhe zgjatja e jetës së makinerive, në radhë të parë të traktorëve, meqenëse fjalën e kemi për bujqësinë.

Në kooperativat bujqësore duhet të ekzistojë harmonia dhe uniteti, sepse me një unitet të fortë realizohet çdo gjë, prandaj këto të kaliten më tej nga Partia. Në radhë të parë për këtë qëllim Partia të përdorë rininë e fshatit, se ajo është forca më përparimtare, është e tillë që edhe ata pleq që besojnë te feja

arriti t'i bindë për nevojën e prishjes së xhamisë në fshat. Këtë forcë të madhe të rinisë në fshat duhet ta përdorim edhe për punë, edhe për të forcuar ndjenjën e së resë dhe unitetin e punonjësve të fshatit që të rrënjoset te këta ndjenja e punës kolektive për ecjen përpara të bujqësisë në rrugën socialiste. Ndjenja e punës kolektive që ka hyrë në fshat duhet kalitur vazhdimisht. Udhëheqja e kooperativës bujqësore dhe e Partisë në kooperativë të mos harrojnë se në fshat ekzistojnë mbeturinat e vjetra, të cilat pengojnë, frenojnë në një formë ose në një tjetër, ku më shumë e ku më pak. Mbeturinat ekzistojnë edhe te njerëz të mirë, bile edhe te komunistë. Të tillë njerëz janë gati të bëjnë çdo gjë, megjithatë e vjetra në një moment u del përpara dhe i pengon, por me këmbënguljen e tyre dhe me punën e vazhdueshme që bën Partia ata e kapërcejnë atë. Kështu bëhet gradualisht transformimi i njeriut të ri. As me dekret, as brenda një kohe të shkurtër nuk bëhet ky transformim, por me luftë dhe punën këmbëngulëse të Partisë.

Kooperativa bujqësore dhe kryetari duhet të jenë të kënaqur kur kanë një agronom dhe disa teknikë të mesëm në kooperativë, po ata duhet të luftojnë dhe të punojnë që të gjithë kooperativistët të ngrihen në nivelin e teknikëve të mesëm të bujqësisë. Prandaj drejtuesit e kooperativave bujqësore duhet të vënë të gjitha forcat që të krijojnë bindjen te të gjithë kooperativistët, të cilët të marrin pjesë në punë, duke dhënë maksimumin e energjive të tyre. Kjo do të bëjë që kooperativat bujqësore të lulëzojnë. Në këtë drejtim një punë e madhe u del kuadrove. Të mos kujtojmë, sho-

kë, se këto bëhen aq lehtë. Në qoftë se një kuadër bën lëshime, të ketë parasysh që kooperativisti do të mbetet akoma shumë larg kryerjes së detyrës. Sa humbje të madhe do të kemi nga kjo, sepse rritja e kulturave të ndryshme bujqësore dhe e rendimenteve, sistemimi i tokave, pastrimi i kullotave etj. duan djersë, punë dhe dituri.

Pa hyrë në detaje, është fakt se me përpjekje të mira të Partisë, vitin e kaluar rrethi i Elbasanit ka arritur rezultate të kënaqshme në bujqësi, sidomos në drithëra. Por në disa kultura ka pasur edhe deficite. Çështja nuk është se ju nuk keni punuar, por mund të kishit punuar edhe më mirë. Mundet që punohet mirë, për shembull, në kooperativën e Shirgjanit, por kryetari i kësaj kooperative është aq i shtrënguar, saqë rinisë nuk i jep një copë të vogël toke për terren sportiv. Kurse është e arsyeshme që në kooperativa të ketë jo vetëm terren sportiv, po edhe shtëpi kulture. Shumë kooperative bujqësore janë krijuar në rrethin tuaj. Gradualisht ato janë pasuruar dhe jeta e fshatarëve është përmirësuar, po ngrihet kultura e tyre. Megjithatë ne mendojmë se duhet bërë edhe më shumë. Ju në Elbasan, siç e theksova edhe në konferencën e rinisë, keni sidomos malësitë që janë prapa, ato duhen ndihmuar konkretisht që të forcohen kooperativat bujqësore malore, të ndihmohen me farëra të mira, me kredi, të shfrytëzohen sa më mirë tokat e tyre, sidomos kullotat etj.

Është bërë sëmundje, shokë, dobësia në drejtim të pastrimit të kullotave. Ne shtrojmë paralelisht dy probleme: të rritim rendimentet dhe të shtojmë to-

kat e bukës. Natyrisht, për këtë do të na duhet të marrim toka edhe nga kullotat për të prodhuar bukë, por që ta lëmë bagëtinë të na ngordhë, edhe kjo do të ishte humbje e rëndë. Është karakteristike për bujqësinë në përgjithësi, aq më tepër për atë të zonave kodrinore e malore, që duhet të ketë medoemos edhe blegtori. Duhet t'i matin këto gjëra, po për të zhvilluar blegtorinë nuk ka rrugë tjetër veçse duke rritur kapacitetin e kullotave. Këto çështje janë caktuar, janë planifikuar se si do t'ia sigurojmë ushqimet blegtorisë. Kjo do të arrihet duke mbajtur si duhet kullotat dhe duke i pasuruar vazhdimisht ato.

Çështja e pasurimit artificial të kullotave duhet të futet në shpirtin e fshatarësisë, duhet bile të hidhet edhe farë në to e të përmirësohen, ndryshe nuk ka blegtori. Shteti do t'ju ndihmojë në këtë drejtim. Byroja Politike ka pasur kurdoherë parasysh që zhvillimi i bujqësisë dhe i blegtorisë në malësitë dhe në zonat kodrinore të ndihmohet në mënyrë të posaçme, që jeta e fshatarëve në këto zona të përmirësohet, se ka ndryshim të madh në këtë drejtim në mes të fushës dhe të malësisë, në mes të të ardhurave nga oborret dhe pronës kolektive në malësi. Kjo gjendje duhet të ndryshojë medoemos. Ka kooperativistë në zonat malore që marrin gati më shumë nga oborri sesa nga prona kooperativiste, por me një ndihmë dhe me një organizim më të mirë të punës në kooperativë ka mundësi që të ardhurat nga prona socialiste të jenë shumë më të mëdha nga ato të oborreve. Kjo kërkon që fshatarët në malësi të ndihmohen, të sqarohen dhe puna me ta të organizohet mirë. Në malësi sot për sot nuk kemi mundësi të

çojmë traktorë, po atje duhen që të shëndoshë e plugje të mira. Tani që të mungojnë, nuk ka sa duhet. Kështu si po veprohet nuk mund të arrihet shtimi i qëve. Numri i tyre do të rritet vetëm nga mostherja e viçave. A duhet ta bëjmë një sakrificë të tillë? Në parim të gjithë janë dakord për të shtuar që të, por në praktikë kjo s'bëhet si duhet. Të tërë flasin për sakrificat, po sakrificat duhen bërë.

Këta dy-tre vjet ne duhet të bëjmë një sforcë dhe t'i japim ndihmë në që malësisë. Prandaj të kujdese mi që që të të ushqehen mirë. Duhet marrë masa për çdo moment të vështirë e të mos ndodhë si këtë vit që bëri dimër i fortë dhe fshatrat e fushës i gjeti të papërgatitura. Borë nuk bie, thonë shokët e fushës, por dimër kemi, dhe kashtën e misrit e lënë të kalbet. Pra Partia duhet të bëjë një punë të madhe me fshatarësinë për të luftuar këto koncepte dhe ta bindë që, për të realizuar këtë detyrë, duhet të bëjë silazh, pavarësisht nëse do të ketë ose jo dimër të madh. Mundësi për të grumbulluar ushqime për bagëtinë ekzistojnë. Për bujqësinë dimri solli disa të mira, se bora shfarosi barërat e egra e insektet e dëmshme dhe të lashtat i mbajti ngrohtë. Pra, po t'u vëmë rëndësinë e duhur këtyre detyrave, kemi mundësi t'i realizojmë.

Në Elbasan zhvillohen edhe kultura të tjera. Rritja e duhanit në këtë rreth është traditë, po mos qëndroni në bisht, si për sasinë, ashtu edhe për cilësinë. Vitin e kaluar ju patët deficite në këtë kulturë, e cila u sjell të ardhura të mira si fshatarësisë, ashtu edhe shtetit. Nga tregjet e botës kërkohet që duhani të jetë i cilësisë së mirë dhe të jetë i ambalazhuar mirë

etj. Unë nuk jam specialist, siç ka qenë, për shembull, Xhaf Hakani¹, por dihet mirë sa kujdes e dituri do zanati në kultivimin e duhanit. Nga pakujdesia e padituria ekonomitë tona kooperativiste dhe shteti kanë humbje të konsiderueshme nga ai. Si është e mundur që vendi ynë, vend duhanor, të ketë në disa rrethe vetëm duhan të cilësisë së tretë dhe të katërt dhe jo të cilësisë së parë dhe të dytë?

Ne kemi besim se Partia, pushteti dhe kuadrot kooperativistë do të mobilizohen për realizimin e detyrave që kemi përpara, ata e kuptojnë rëndësinë e madhe të zhvillimit të bujqësisë, vendin që zë ajo në ekonominë tonë, në jetën e popullit, në forcimin e atdheut. Këto të mos i harrojmë. Duhet të mendojmë kurdoherë për rezerva dhe të vëmë rregull edhe në përdorimin e pasurisë.

Ne përpiqemi të mos ketë luftë, po rreziku i saj gjersa është gjallë imperializmi ekziston kurdoherë. Prandaj të mendojmë dhe të punojmë që të prodhojmë për përmirësimin e jetës së popullit.

Natyrisht, të meta dhe mungesa ka, por është fakt se në popull nuk ka pakënaqësi në lidhje me furnizimet. Ju nuk e dini ç'bëhet gjetkë, për shembull, në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës, për mish, gjalpë, sheqer, bukë etj., megjithëse këto vende kanë një ekonomi dhe industri më të zhvilluar se të Shqipërisë. Në Jugosllavi situata është akoma më e keqe. Ato që botohen herë pas here në shtypin e tyre nuk

¹ Xhaferr Hakani — patriot, dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

tregojnë krejt realitetin. Në fakt, në Jugosllavi herë pas here ngrihen çmimet, gjer te biletat e hekurudhave. Klika e Titos e ka shndërruar Jugosllavinë në një vend kapitalist. Vetë Titoja thotë haptazi se çmimet në Jugosllavi janë të ulëta, se ato nuk janë caktuar mirë, prandaj duhet të ngrihen. Revizionistët jugosllavë flasin fare pa turp për ngritjen e çmimeve, ata tashmë kanë krijuar format kapitaliste të ekonomisë. Bashkë me ekonominë kapitaliste të vendit, edhe kapitali imperialist ka hyrë brenda në Jugosllavi, ku ka bërë shumë investime. Këto investime imperialistët nuk i bëjnë për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit jugosllav, po për vete, për t'i thithur këtij edhe pikën e fundit të gjakut, për të mbajtur njëkohësisht nën zgjedhë edhe vetë klikën e Titos, që është shërbëtore e tyre dhe ta detyrojnë që të bëjë atë që i thonë ata.

Në jetën e popullit tonë janë bërë përmirësime të mëdha, përparime të pakrahasueshme, janë arritur kudo suksese. Por edhe gabimet e të metat që vihen re në sektorë të ndryshëm, si në atë të tregtisë, populli i vë në dukje. Të metat duhet t'i luftojmë seriozisht, në lokalet e tregtisë të kryhet një shërbim më i mirë për popullin; populli t'i kritikojë ata që gabojnë, dhe të mos kufizohet kritika vetëm te përgjegjësi. Ai që gabon, kur të dalë përpara popullit, do të shkundet mirë, sepse valon kritika dhe njeriu ndreqet. Populli është i drejtë, por, po s'u ndreqe, atëherë ta tregon vendin. Pra, të luftojmë që t'i zhdukim të metat.

Elbasani u bë një rreth industrial. Në të ardhmen ai do të zhvillohet edhe më shumë. Qysh tani ky qytet po bëhet qendra e industrisë së metalurgjisë së zezë,

degë me rëndësi të madhe ekonomike për vendin tonë. Kjo do të thotë se rrethi juaj po zë vend me rëndësi në industrinë tonë, për arsye se të gjitha veprat që ndërtohen në Shqipëri kërkojnë hekur dhe çelik që tani i sjellim nga jashtë me vështirësi të mëdha. Por, nuk do të kalojë shumë kohë dhe jo vetëm që ato do t'i prodhojmë në vend, po kapacitetin e kësaj vepre do ta zgjerojmë.

Metalurgjinë e zezë duhet ta mbarojmë medoemos në kohën e caktuar. Për këtë qëllim duhet të marrë pjesë i gjithë populli i rrethit tuaj. Kuadrot në çdo sektor ku punojnë, të ndihmojnë që kjo vepër të mbarojë dhe të futet në shfrytëzim sa më parë, bile të bëhet që të punojë me tri turne. Me një fjalë të luftojmë që të zbatohet projekti në kohë dhe, po të jetë e mundur, para afatit. Prandaj të punojmë që ta ndërtojmë me kohë këtë vepër të madhe, po për t'ia arritur kësaj ne duhet të përgatitim kuadrot nga radhët e rinisë. Metalurgjia do të shërbejë si bazë e fuqishme për zgjerimin e industrisë sonë. Kur ta përfundojmë atë, e gjithë Shqipëria do të gëzohet, se hekuri dhe çeliku duhen kudo. Ne po ndërtojmë dhe në të ardhmen do të kemi edhe uzina të tjera. Prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit do të kërkojë lëndë të parë dhe çelike të ndryshme. Kështu do të shpëtojmë nga importi për të tillë artikuj, për të cilët ekonomia ka shumë nevojë. Çekët dhe polakët tani na bëjnë presione dhe shantazhe, herë na japin, herë nuk na japin. Disa herë përpiqen të na i shesin më shtrenjtë ose nuk na japin kamionë, ose edhe kur na i shesin, ata janë në sasi të pamjaftueshme. Ata veprojnë kështu ndaj nesh sepse ne akoma nuk e

kemi ngritur kombinatin tonë metalurgjik. Fabrika për përpunimin e hekurit tonë, për të ndarë hekurin nga nikeli, duhet të ishte ndërtuar në Shqipëri dhe jo në Çekosllovakia. Po çekët nuk donin. Ata ngritën një uzinë në Çekosllovakia për përpunimin e hekur-nikelit shqiptar. Për këtë arsye ata kanë importuar nga nëlëndë të parë dhe bile tani, mbasi kanë krijuar edhe rezerva për dy vjet, po na nxjerrin avaze në tërheqjen e mineralit. Mirëpo kur ne të ndërtojmë metalurgjinë tonë, ata nuk do të mund të veprojnë më kështu.

Kjo vepër e madhe industriale ndërtohet në qytetin tuaj. Prandaj i gjithë Elbasani duhet të ngrihet në këmbë, që ajo të ndërtohet e të vihet në shfrytëzim në kohën e duhur. Të gjithë të interesohen, e jo vetëm të rinjtë, që kanë premtuar se do të shkojnë të punojnë atje nga një deri në dy muaj vullnetarisht. Puna është të organizohet mirë çdo gjë, në mënyrë të tillë që sa mbaron koha e një turni, të fillojë menjëherë turni tjetër pa humbur kohë, domethënë të punohet efektivisht, jo për t'u dukur. Kjo është kalitje dhe shpejtim për sigurimin në kohë të veprës.

Ne kemi bindjen se populli i Elbasanit dhe ju, kuadrot e të gjitha kategorive, që drejtoni punët në rreth, e kuptoni shumë mirë vijën e Partisë, veçanërisht rëndësinë e ngritjes së ekonomisë e në radhë të parë ngritjen e fabrikave të mëdha që kanë rëndësi kolosale për ekonominë tonë dhe që janë bazë për të ardhmen. Prandaj ta koordinoni më mirë punën tuaj, të shumëfishoni përpjekjet në drejtimin konkret të punëve për të cilat jeni ngarkuar, të shkundeni nga burokratizmi, ta luftoni këtë në çdo mënyrë. Të gjithë ata që kanë të meta

të shkunden nga këto mbeturina, ta marrin punën mirë në dorë, ta kryejnë, të dëgjojnë të tjerët me vëmendje, të luftojnë ambiciet, meritë dhe zemërimet që mund të lindin midis tyre, ta kuptojnë se këtu s'kemi të bëjmë me çështje personale, por me ndërtimin e Shqipërisë, me jetën e popullit. Mosmarrëveshjet e vogla, meskine, duhet të zgjidhen. Njerëz të tillë duhet të vijnë në vete se përpara kemi një çështje të madhe.

Puna duhet të jetë nder për të gjithë. Asnjë punë që i shërben popullit nuk është e turpshme, nuk është poshtëruese. Të gjithë duhet ta kuptojnë realitetin, se as Partia, as pushteti ynë nuk duan të mbetet njeri pa punë. Kjo është dëshira e tyre e zjarrtë. Po ka edhe njerëz që e zgjedhin punën. Një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë. Sigurisht nëpër aparatet shtetërore dhe ekonomike ka edhe nga ata që bëjnë hatëre dhe preferenca. Të tillë duhet të kritikohen. Por ekziston edhe fakti që megjithëse ka punë disa nuk duan të venë atje ku paraqitet nevoja. Të gjitha punët që hapim janë për të mirën e popullit, prandaj kur një njeri është pa punë, duhet të hyjë në marrëdhënie pune. Në këtë drejtim duhet të luftohet me durim dhe me bindje, se e dimë të kaluarën dhe konsideratën që kishin klasat shfrytëzuese për punën. Por Partia bëri një mrekulli në këtë drejtim, duke futur te masat dashurinë për të dhe tani te ne ka ndryshuar ky koncept. Ka njerëz të thjeshtë, punëtorë dhe zanatçinj të zotë, që sot janë bërë heronj.

Shokë, duhet t'u mësojmë njerëzve dhe veçanërisht të rinjve e të rejave zanate, të bëhen punëtorë të kualifikuar, të kategorisë së tretë, të katërt dhe të

pestë. Përpyekje nuk duhet të bëjmë vetëm për të nxjerrë kuadro të lartë, me universitet. Për nxjerrjen e kuadrove të lartë ka edhe njëfarë kufiri. Po metalurgjinë nuk do ta ngrenë vetëm inxhinierët, krahas tyre duhen shumë më tepër edhe kuadro të mesëm e punëtorë të kualifikuar. Natyrisht, inxhinierët janë shtylla, por janë me qindra kuadrot e mesëm dhe punëtorët e kualifikuar për të cilët kemi nevojë. Nuk na duhet vetëm projekti i një pallati. Për t'i ngritur ata na duhen edhe muratorë, karpentierë, edhe elektrikistë, me dhjetëra teknikë të mesëm, djem dhe vajza me kulturë, me gjimnaz apo me tetëvjeçare, që sot kudo ku janë ndihmojnë me punën e tyre për zbukurimin e atdheut. Sigurisht një, dy ose pesë agronomë në një kooperativë bujqësore do t'i japin hov punës, po kur të kesh teknikë të mesëm për çdo kulturë, ata do të bëhen një forcë e madhe në kooperativë, ata do të jenë ushtria, kurse agronomët — oficerët e kësaj ushtrie. Por dihet se pa ushtarë nuk bën dot asgjë. Mund të tregosh trimëri të madhe, por po s'pate ushtarë, nuk ke fitore. Prandaj ushtria e teknikëve në vendin tonë duhet të rritet jo me urdhra, por me bindje.

Ju në Elbasan, shokë, keni një shkollë të rezervave të punës. Djem të zgjuar ka atje. Por ka prindër në Elbasan që nuk i dërgojnë djemtë e tyre në këtë shkollë, se është e «rezervave» thonë, dhe përpiqen t'i dërgojnë në shkollën pedagogjike ose në gjimnaz. Unë ju këshilloj t'i dërgoni djemtë e vajzat tuaja edhe në këtë shkollë, që atje të përgatiten dhe pastaj t'i shpërdajmë në objekte të ndryshme që ndërtojmë, të bëhen teknikë të zotë. Të rinjtë e duan jetën dhe zanatin, ata

punojnë dhe duan të punojnë. Në këtë drejtim mundësitë i kemi, prandaj të përpiqemi që të krijojmë një numër sa më të madh kuadrosh dhe teknikësh të mesëm e jo vetëm kuadro të lartë.

Ne themi se puna është nder, po në praktikë ka raste që dikujt i thyhet xhami në shtëpi e nuk e vë vetë, po duhet të vijë tekniku i pasurisë së shtetit ta vërë, në vend që secili të blejë një sharrë dhe një çekiq, të ketë dhe disa gozhdë në shtëpi dhe të bëjë vetë disa punë të vogla të thjeshta.

Tani le të flasim pak për situatën. Gjendja në Vietnam është e acaruar. Përse po e filloj nga kjo zonë e botës çështjen e situatës? Sepse në Vietnam po bëhet luftë kundër imperializmit amerikan, një nga luftërat më të mëdha aktuale. Shokët e Vietnamit të Jugut, që kanë 25 vjet duke luftuar kundër armiqve pushtues, kanë fituar një eksperiencë të madhe dhe kanë arritur që t'u vënë këmbët në një këpucë imperialistëve amerikanë, t'i gozhdojnë në vend, pa shpresë dhe rrugëdalje për ta, ose me të vetmen rrugëdalje, largimin me turp nga Vietnami ose hedhjen e tyre në det nga ana e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Vietnamit të Jugut. Ky do të ishte një diskreditim total për ta. SHBA janë angazhuar shumë keq në Vietnam. Vietnamezët luftojnë që Amerika të dalë andej e thyer, e mundur, e shpartalluar.

Dikush mund të thotë se Amerika është e fortë dhe nuk do të dalë nga Vietnami, po në realitet nuk është e fortë. Po të ishte e fortë, me kohë do t'i kishte dalë mbanë luftës në Vietnam, por në realitet Ame-

rika «e fuqishme» po thyhet nga partizanët vietnamezë, të cilët i kanë mbyllur armiqtë në qytete të mëdha, në disa porte, rrugë dhe aerodrome. Ushtria e kukullave, e mbyllur në qytetet, aerodromet, portet dhe rrugët kryesore, nuk guxon të dalë më tej, se shpartallohet. Në të tilla pozita kaq të vështira është vënë ushtria kukull e Vietnamit të Jugut, saqë amerikanët janë detyruar të sjellin forca të këmbësorisë së tyre për ta zëvendësuar atë dhe për të marrë vetë në dorëzim qytetet e mëdha, aerodromet dhe portet. Amerikanët e drojtojnë ushtrinë kukull të shkojë të luftojë kundër partizanëve, mirëpo kjo është e rraskapitur, me moral shumë të ulët, nuk i ka ditët të gjata. Lufta popullore ka bërë që qeveria e Sajgonit të diskreditohet dhe të urrehet.

As në SHBA nuk aprovohet nga shtresat e gjera të popullit amerikan lufta që bëjnë imperialistët amerikanë në Vietnam. Ato pyesin, përse bëhet lufta, përse ndodhin këto disfata. Ata nuk duan t'u vriten bijtë e tyre në xhunglat e Indokinës. Kështu pra në vetë SHBA ka reagim nga ana e popullit kundër politikës së qeverisë. Tani imperialistët amerikanë përpiqen të gjejnë rrugëdalje me bisedime, të cilat duan t'ua imponojnë me forcë vietnamezëve, duke arritur gjer atje sa të bombardojnë edhe Vietnamin e Veriut.

Po përse imperialistët amerikanë luftën në Vietnamin e Jugut e shoqërojnë me bombardimin e Vietnamit të Veriut? Ata e bëjnë këtë sepse jo vetëm janë të dobët dhe të kalbur, po janë edhe në situata shumë të vështira me aleatët e tyre. Tashmë NATO-ja është çarë, Franca nuk po e pranon më diktatin amerikan. Midis saj dhe SHBA-së ka kontradikta, njëri përpiqet

të forcojë pozitën që ka humbur, tjetri të fitojë pozitën të reja. Pra SHBA në NATO nuk janë më ato që kanë qenë përpara.

Përveç Francës, në aleancat perëndimore ka filluar të lëkundet edhe Anglia. Te kjo është parë kurdoherë tendenca për t'u lidhur me Amerikën, megjithëse SHBA gjatë dy luftërave botërore e kanë zhveshur lakuriq Anglinë dhe tani po dominojnë në të gjitha kolonitë angleze. Kapitali amerikan në Indi e gjetiu është futur thellë në Perandorinë Britanike. Megjithëkëtë, anglezët përpiqen të bëjnë politikën e balancimit. Ata, fundi i fundit, e dinë se janë në Evropë, dhe me këtë kontinent janë më shumë të lidhur, pastaj janë edhe ata imperialistë, duan edhe ata të sundojnë, të kenë influencë në vendet e ndryshme që përpiqen t'i rrjepin. Tani vetë qeveria laburiste është në pozitën të vështirë ta mbështetë plotësisht apo jo imperializmin amerikan. Në qoftë se e mbështet në veprimet e tij agresive imperializmin amerikan, qeveria angleze e di se opinioni publik në Angli nuk e shikon me sy të mirë një gjë të tillë. Prandaj një pjesë e deputetëve laburistë, për të mos humbur influencën përpara zgjedhësve, e kundërshtojnë politikën e qeverisë dhe i kërkojnë kësaj të ndërhyjë që Amerika të pushojë bombardimet në Vietnam. Anglezët pastaj e dinë se në qoftë se zgjerohet lufta në Azinë Juglindore atëherë edhe ata do të humbasin kolonitë e tyre.

Gjermania Perëndimore është një aleate e SHBA-së, politika e saj anon më shumë nga SHBA, sepse ka për qëllim që të sigurojë armët atomike për t'i përdorur kundër vendeve socialiste dhe në radhë të parë

për të gllabëruar RD Gjermane, domethënë për të realizuar bashkimin e dy gjermanive nën drejtimin e vet.

Përveç këtyre, imperialistët amerikanë, në aleancë me revizionistët sovjetikë përpiqen të krijojnë aleanca të reja në Evropë, sepse e shohin që këtu nuk e kanë të sigurt situatën. Revizionistët sovjetikë po afrohen gjithnjë e më shumë me imperialistët amerikanë. Për bombardimet në Vietnamin e Veriut, imperialistët amerikanë janë në ujdë të plotë me revizionistët sovjetikë dhe këta politikisht dhe ideologjikisht janë vënë në shërbim të imperializmit.

Gazeta jonë «Zëri i popullit» e demaskoi qëllimin e vajtjes së Kosiginit në Vietnam. Kjo vizitë kishte për qëllim të mashtronte Vietnamin e Veriut për ta bindur që të hynte në bisedime me amerikanët, pa kushte. Në të njëjtën kohë Brezhnjevi deklaroi që «amerikanët duhet të largohen nga Vietnam!» Kjo është një taktikë e revizionistëve sovjetikë, të cilën ata e mbulojnë me demagogji, duke thënë se «ne nuk do ta lëmë vetëm popullin vëlla vietnamez» etj. Në fakt, ne jemi në dijeni se edhe ato armë që i shkojnë Vietnamit nga Bashkimi Sovjetik janë në sasi qesharake. Qëllimet e revizionistëve sovjetikë janë djallëzore, janë krejt të ndryshme nga ato që vetëm deklarojnë.

Në Vietnam imperializmi amerikan po pëson disfatë. Vietnamit është bërë sot pika më nevralgjike për imperializmin botëror. Xhonsoni, Vilsoni, U Tani, Dë Goli etj. janë gati të venë ku të jetë dhe të bisedojnë me cilindo qoftë për të mbrojtur interesat e tyre imperialiste. Kjo tregon sa shumë i tronditur është imperializmi në përgjithësi dhe ai amerikan në veçanti,

kurse luftërat revolucionare të popujve janë në ngritje.

Edhe revizionistët janë në pozita jashtëzakonisht të vështira, sepse të gjitha taktikat e tyre tani janë demaskuar. Lufta që zhvillon Partia jonë, partitë e tjera marksiste-leniniste dhe grupet e reja marksiste-leniniste e kanë bërë të qartë politikën tradhtare të Hrushovit dhe të hrushovizmit në masat e popujve të të gjithë botës. Tani askush nuk beson në propagandën dhe në vijën hrushoviane të bashkekzistencës paqësore. Ku ka bashkekzistencë paqësore, kur në fakt lufta po zien në të katër anët e botës, kur imperializmi amerikan po derdh me tonelata bomba jo vetëm në Vietnamin e Jugut, por edhe kundër Vietnamit të Veriut? Ç'kuptim ka një bashkekzistencë e tillë? Kjo është tradhti e madhe. Edhe parulla e çarmatimit është, si kurse e ka thënë Partia jonë, një tradhti e madhe, këtë e tregon i gjithë zhvillimi i luftës.

Hrushovianët flasin për «botë pa armë dhe pa luftëra». Po si mund të ketë një botë pa armë e pa luftëra, kur në çdo kontinent po luftohet dhe kur shtetet imperialiste dhe revizioniste po armatosen kush e kush të ketë më tepër armë dhe sa më moderne? Edhe kjo parullë ka qenë një bluf, një tradhti nga ana e revizionistëve. Qëllimi ishte për të na çarmatosur ne, se është e qartë që imperialistët nuk çarmatosen. Kuptohet se revizionistët me këtë donin të pengonin dhe të sabotonin luftën revolucionare të popujve dhe të partive marksiste-leniniste. Pra në fakt nuk ka as botë pa armë dhe pa luftëra, as çarmatim, as bashkekzistencë paqësore. Prandaj e gjithë vija e revizionistëve modernë është demaskuar dhe po dështon.

Është demaskuar gjithashtu edhe vija ekonomike e revizionistëve modernë, qoftë në Bashkimin Sovjetik, qoftë në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës, ku ekonomia socialiste ka marrë të tatëpjetën. Kjo është e natyrshme, mbasi revizionistët ekonominë socialiste përpiqen ta transformojnë në një ekonomi kapitaliste, gjë që sjell pasurimin e klikës revizioniste dhe varfërimin e madh dhe më në fund shkatërrimin e sistemit socialist kolkozian, pasurimin e drejtuesve në kolkoze.

Edhe në industri politika e ndjekur nga revizionistët modernë ka sjellë transformimin gradual të industrisë socialiste në një industri kapitaliste. Kjo situatë ka bërë që në vendet revizioniste të ketë krizë të madhe ekonomike, populli të mos gjejë mallrat e duhura në treg. Kjo krizë aktualisht u vërtetua në Bashkimin Sovjetik, ku u mbaruan rezervat dhe revizionistët u detyruan të importojnë edhe ushqime. Ata janë detyruar gjithashtu që edhe politikën e tyre ta lidhin me atë të SHBA-së. Tani po përpiqen që të fusin në vendin e tyre kapitalin anglez, amerikan, francez, të Gjermanisë Perëndimore etj. Këto mjete ata përpiqen t'i shfrytëzojnë për mbështetjen e klikave të tyre tradhtarre borgjeze kapitaliste që po rimëkëmben dhe ndihmojnë për transformimin e vendeve socialiste në vende kapitaliste.

Ky kurs po vërtetohet në jetë parashikimet e drejta të Partisë sonë për degjenerimin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të partive të tjera të vendeve socialiste, të cilat po kalojnë një krizë shumë të rëndë. Ato tani janë duke u transformuar në parti borgjeze,

në to po ngrihet llumi i tradhtisë borgjeze, trockiste, buhariniste që ishin fshehur në Bashkimin Sovjetik, por që pas vdekjes së Stalinit ngritën krye dhe morën në dorë frenat e partisë dhe të shtetit. Në këto vende po ngrihen gjithashtu me shpejtësi elementët kundër-revolucionarë, atje po shuhet lufta e klasës dhe po merren nëpër këmbë interesat e klasës punëtore. Në këto parti revizionistët po punojnë me forca të mëdha për ta shuar ideologjinë tonë marksiste-leniniste dhe për të futur në masa ideologjinë borgjeze.

Kjo tradhti e revizionistëve i ka bërë marksistë-leninistët të shohin më qartë vijën e drejtë të Partisë sonë dhe të interesohen, ta njohin, ta ndjekin, ta duan dhe ta mbështetin këtë vijë. Për ne, veçanërisht, ky është një nder i madh. Nuk ka në botë komunist apo njeri përparimtar që të mos thotë se vija e Partisë së Punës të Shqipërisë është një vijë e drejtë, e guximshme dhe heroike. Këtë nuk e fshehin dot as armiqtë.

Lufta që u bëjnë partitë marksiste-leniniste revizionistëve modernë ka sjellë që këta të mos jenë të bashkuar. Revizionistët udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga ideologjia borgjeze. Midis tyre ekzistojnë kontradikta të shumta që vazhdimisht vijnë duke u shtuar. Revizionistët nuk mund të kenë unitet mendimi dhe veprimi. Ata i bashkon vetëm lufta kundër marksizëm-leninizmit, revolucionit dhe popujve. Unitet mendimi dhe veprimi ka vetëm midis partive marksiste-leniniste. Revizionistët modernë nuk mund t'i qëndrojnë dot forcës në ngritje të revolucionit, forcës së madhe të popujve, që një ditë, ku më parë e ku më pas, do të pëlcasë. Ata ndjekin vijën kapitaliste, prandaj edhe përpiqen si

e si të lidhen e të afrohen me ata imperialistë, që u japin më shumë para. Kjo bën që në gjirin e revizionistëve modernë të duken sot tendenca centrifugale dhe të mospranimi të shkopit të dirigjentit. Kush interesohet për forcimin e kapitalit të brendshëm të vendit të vet, kush interesohet të marrë ndonjë kredi nga imperializmi amerikan, kush afrohet nga Anglia, Franca apo Gjermania Perëndimore, me një fjalë nga ai që i jep më shumë.

Në KNER revizionistët hahen si kapitalistët. Kursi që ndjekin u ka shkaktuar një disfatë të madhe jo vetëm në fushën ideologjike dhe politike, por edhe në atë ekonomike. Kjo u ndie sidomos me rastin e heqjes së Hrushovit. Ata e hoqën Hrushovin jo se nuk ishin dakord me vijën e tij, por për të mashtruar, për t'ia hedhur fajin atij për të gjitha disfatat që kanë pësuar revizionistët, në ideologji, në politikë, në ekonomi etj. Atyre u duhej t'ia hidhnin dikujt fajin për të rifilluar pas këtij veprimi një taktikë të re. Qëllimi ishte që me të rrëzuar Hrushovin, të afroheshin me ne duke përdorur fjalë të ëmbla se «ne jemi komunistë, luftojmë për një çështje të madhe, prandaj edhe duhet të pushojmë polemikën». Por ne nuk ramë në grackën e tyre për shuarjen e polemikës. Përkundrazi, polemika do të vazhdojë gjer në shkatërrimin e plotë të revizionistëve. Kështu manovrat e revizionistëve pas rrëzimit të Hrushovit ne nuk i hamë.

Udhëheqja revizioniste sovjetike dhe ata që e pasojnë bënë mbledhjen e 1 marsit, e cila kishte për qëllim shkatërrimin e plotë të kampit socialist e të lëvizjes komuniste dhe drejtohej kundër partive mark-

siste-leniniste e gjithë revolucionarëve të vërtetë që kundërshtonin revizionizmin modern. Ata e kishin të qartë se ne nuk do të venim në mbledhjen e tyre përçarëse, megjithatë ishin të detyruar ta bënë mbledhjen e 1 marsit. Ju jeni në dijeni të komunikatës së tyre dhe të përgjigjes që dhamë ne me artikullin që botuam në «Zërin e popullit» më 18 mars 1965¹. Mbledhja e 1 marsit ishte një disfatë tjetër për revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre.

Në këto situata me përgjegjësi të madhe të brendshme dhe ndërkombëtare, shtetërore dhe partie, Partia dhe shteti ynë, me luftën e tyre heroike në lëmin ideologjik dhe politik kanë fituar një simpati dhe besim të madh të gjithë komunistët, njerëzit përparimtarë dhe shtetet demokratike në botë. Prandaj për ta ruajtur e forcuar prestigjin e madh që ka fituar Partia jonë, të gjithë ta kryejmë deri në fund detyrën, që nga i vogli e gjer te më i madhi, të jemi të ndërgjegjshëm në punët që na ka ngarkuar Partia. Kjo do të ketë një rëndësi të madhe për vazhdimin e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Çdo veprim i bërë nga ne ndiqet me vëmendje. Partia jonë e vogël mban lart të papërlyer flamurin e marksizëm-leninizmit. Prestigji i vendit tonë rritet kurdoherë e më shumë. Fjala e Partisë sonë dëgjohet me respekt në OKB dhe kudo.

Kohët e fundit në OKB², përfaqësuesi i Shqipërisë

1 Shih në këtë vëllim f. 192.

2 Është fjala për sesionin e 19-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që zhvilloi punimet nga 1 dhjetor 1964 — 1 shtator 1965.

demaskoi përfaqësuesit e SHBA-së dhe të Bashkimit Sovjetik, që përpigëshin të manipulonin organizatën dhe mbledhja e saj të zhvillohej në kushte jonormale, duke mos shqyrtuar asnjë çështje që kërkonte votim. Insistimi i përfaqësuesit shqiptar bëri që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të hidhte në votë propozimin tonë dhe si përfundim ajo filloi rregullisht punimet. Një qëndrim i tillë luftarak i Shqipërisë në OKB shkaktoi jehonë në të gjithë botën, shtypi i vendeve të ndryshme shkroi për Shqipërinë, që mbron parimet dhe lufton me vendosmëri kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik dhe gjithë reaksionit botëror.

Ne kemi për detyrë, me qëndrimet tona të drejta e të matura, ta forcojmë dhe ta intensifikojmë luftën tonë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, në favor të revolucionit. Dhe që ta bëjmë mirë këtë luftë, jemi të ndërgjegjshëm se duhet të kryejmë edhe më mirë detyrat tona të brendshme, të ngremë ekonominë, të realizojmë planet, të kalitim unitetin Parti-popull, ta duam Partinë me të gjitha forcat dhe ta mbrojmë atë. Duke bërë këtë punë ne ndihmojmë kalitjen e Partisë që është udhëheqësja e sprovuar e popullit tonë.

Në këto kushte kaq të favorshme për ne duhet të jemi shumë vigjilentë, të mos na rritet mendja dhe të mos themi se çdo gjë është shesh me lule. Jeta ka edhe fitore edhe disfata, por në fund fitorja do të jetë e marksizëm-leninizmit. Ai që është i qëndrueshëm në rrugë të drejtë, i vendosur dhe guximtar, ai me siguri fiton. Këto karakteristika i kanë Partia, populli, kuadrot që ka kalitur ajo në luftë dhe në vështirësi të pa-

numërta. Ata e kuptojnë dhe e zbatojnë si duhet vijën e Partisë.

Prandaj me këtë rast, shokë, në emër të Byrosë Politike ju përsëhendes dhe ju uroj shëndet dhe punë të mbarë në forcimin e mëtejshëm të organizatës së Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të rrethit tuaj, për lumturinë e popullit tonë. Punoni që fitoret tona të jenë kurdoherë të njëpasnjëshme dhe në rrugë të drejtë.

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

INVESTIMET T'I MATIM ME REZULTATET QË ARRIJME

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 prill 1965

Vërejtjet që bënë shokët e Byrosë Politike me diskutimet e tyre duhet të shërbejnë për t'i përmirësuar më tej studimet për problemet e bujqësisë dhe të blegtorisë në zonat kodrinore e malore. Disa prej tyre duhet të shërbejnë gjithashtu edhe për planin pesëvjeçar, prandaj të shikohet se çfarë mund të inkuadrohet në këtë plan, duke u nisur nga mundësitë financiare, materiale, forcat e punës etj.

Ne duhet të ecim sipas parimit që investimet në bujqësi duhet dhe do të bëhen, se kemi nevojë. Dëshira jonë është që Shqipëria të bëhet një kopsht i vërtetë, por ka rëndësi që të investojmë dhe të ndje-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi masat për një rritje më të shpejtë të prodhimit bujqësor e blegtoral në zonat kodrinore e malore.

kim frytet e këtyre investimeve. E them këtë se në disa drejtime, si për shembull në frutikulturë, shteti dhe kooperativat bujqësore kanë pasur dëme financiare. Prandaj e kaluara duhet të na shërbejë që investimet shtetërore dhe ato të kooperativave bujqësore t'i matim me rezultatet që arrijmë. Në drejtim të frutikulturës të mbajmë parasysh edhe mentalitetin e fshatarëve, moszënien e fidanëve, prishjen e dëmtimin e tyre para, gjatë dhe pas mbjelljeve etj.

Gjithë këto miliarda që parashikojmë për ujitjen, përveç investimeve të tjera që bëhen për bujqësinë, kur të inkuadrohen në planin pesëvjeçar, më duket se është e nevojshme të harmonizohen. Po të marrim parasysh se mbi 50 për qind e prodhimit bujqësor merret nga zonat kodrinore e malore, duhet të dalim me konkluzionin se në fushë, ku ne kemi bërë investime të mëdha për ujitjen, bonifikimet, mekanizimin, sistemet etj., duket se nuk e kemi bërë detyrën si duhet. Atje duhet të luftojmë më shumë që t'i rritim më tej rendimentet e prodhimeve bujqësore. Nuk është e drejtë që planin pesëvjeçar për zonat fushore ta fryjmë me investime kaq të mëdha, kurse prodhimin ta kemi pak më të lartë nga malësitë.

Është e qartë që në zonat fushore ne kemi arritur disa rezultate, por kur futemi në shifra, shohim se këto rezultate nuk janë në shkallën e duhur. Qeveria duhet të marrë masa për të përmirësuar më tej gjendjen, por është e domosdoshme që të punojë më mirë e gjithë Partia. Masa të jashtëzakonshme, si shtimin, ta zëmë, të dy mijë agronomëve, ose shtimin e mekanizmave të ndryshëm bujqësorë në malësi, nuk kemi

si marrim më shumë nga sa kemi marrë. Mbi planin që kemi caktuar, pra, nuk bëjmë dot më tepër.

Çështjet e bujqësisë nuk zgjidhen duke shtuar një kuadër në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, siç bëmë kohët e fundit me shtesat në seksionin e bujqësisë. Nga kjo anë Ministria e Bujqësisë nuk ka përse të qahet, megjithëse nuk është kjo që e zgjidh çështjen. Gjithashtu çështja nuk qëndron në atë që Ministria e Bujqësisë ose Drejtoria e Bujqësisë pranë Komitetit Qendror të jenë ditë e natë nëpër fusha. Rëndësi për këtë ka puna e Partisë dhe e pushtetit në rreth si dhe puna e organizatës së Partisë dhe e kryesisë së kooperativës bujqësore. Në qoftë se këta u qëndrojnë detyrave në krye, atëherë, të jemi të sigurt se do të merren më shumë edhe prodhime bujqësore.

Ne nuk duhet të kënaqemi me atë punë që bëjnë komitetet e Partisë të rretheve dhe kooperativat bujqësore. Edhe pse në disa kooperativa sigurohen prodhime më të larta dhe mobilizimi i njerëzve në punë është më i mirë, ne nuk duhet të mjaftohemi me kaq. Përse? Për arsye se drejtuesit në rrethe interesohen për bujqësinë, por disa herë ky interesim është akoma në vija të përgjithshme, i përsëritur, statistikor, jomobilizues, jorevolucionar, joedukues, jokontrollues dhe jondihmues për detyrat që caktohen.

Kam përshtypjen se edhe këtej, nga lart, jepet një orientim i përgjithshëm që shpeshherë nuk është shumë praktik. Ju, shokë të Ministrisë së Bujqësisë, duhet të bëni një punë më të organizuar e më këmbëngulëse për përhapjen e eksperiencës pozitive në bujqësi dhe për këtë të caktohen detyra të rrepta. Në kooperativat

bujqësore, megjithëse relativisht ecet përpara problemet nuk ndiqen në gjerësinë, thellësinë dhe në kohën e tyre, në të gjitha drejtimet, në ujitje, në prashitje, në rritjen e bletëve, të shpendëve etj.; kooperativa bujqësore nuk ka arritur të funksionojë si një ekonomi e madhe dhe e fuqishme, ku të gjithë të mobilizohen dhe të kryejnë detyra të caktuara me dituri dhe me një nivel sa më të lartë teknik.

Tregohet interesim i madh për të mbjellë grurë, duhan etj. dhe në këtë drejtim kemi arritur disa suksese. Njerëzit mobilizohen, por ky mobilizim nuk shkon gjer në fund të prodhimit me ritmet e dëshiruara, në mënyrë që ashtu siç mbillet misri, ashtu edhe të prashitet, të ujitet, të korret, të mos shkojë dëm kashta etj. Një edukim i tillë nga organizata e Partisë, nga organet e pushtetit dhe nga organizatat e masave, nuk bëhet si duhet. Natyrisht, kjo është një punë e vështirë, por duhet kryer.

Shohim se udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth interesohen më shumë për çështjet komunale në qytete, për problemet e industrisë, ku ka specialistë, teknikë dhe punëtorë që punojnë në kushte shumë më të favorshme, kurse në fshat, shokët e rrethit më duket se nuk ndihmojnë sa duhet. Me këtë nuk dua të them që të mos interesohemi për industrinë ose për komunalen, por një interesim i disbalancuar, me atë prapambetje që ka akoma fshati ynë, me ato vështirësi të mëdha që ka bujqësia, mendoj se nuk duhet lejuar. Në këtë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të ecet. Nuk them se në rrethe s'punohet, por në këtë drejtim ka rezerva kolosale, të cilat qëndrojnë në vetë punën e njerëzve, në

metodën e drejtimit. Njerëzit nuk janë automatë, ata kanë të mirat dhe të metat e tyre. Prandaj, një interesim më i madh jo me fjalë, por me punë konkrete, mendoj se është shumë i nevojshëm. Edukimi i njerëzve duhet të bëhet në punë e sipër, në punën e gjallë, të edukohen në procesin e punës. Po të veprohet kështu, do të realizohet më mirë plani dhe, në këtë mënyrë, investimet që bëjmë në bujqësi, do të sjellin më tepër përfitime.

Unë jam për atë që investimet t'i kombinojmë në mënyrë sa më racionale, që malësitë të ndihmohen jo vetëm në drejtim të ujitjes, por edhe në drejtime të tjera. Ujitja, siç u arsyetua këtu, është një punë shumë e komplikuar, por që mund të realizohet. Mirëpo në bujqësi ka edhe probleme të tjera. E mira është që ne të investojmë për ujitje atje ku ka më pak toka nën ujë. Ne nuk duhet të harrojmë orientimin që malësitë t'i bëjmë të pavarura ekonomikisht. Kjo do të thotë që atje ta shtojmë prodhimin. Gjithashtu, të investojmë atje ku kapaciteti i kanaleve ujitëse ka mundësi të rritet, por në disa zona të bëjmë më parë sistemimin dhe më vonë të ndërtojmë vepra për ujitje.

Edhe për kullotat, për të cilat jemi preokupuar të gjithë, duhet të llogaritim ç'rezultate ekonomike na ka dhënë puna e bërë gjer tani, ç'leverdi kemi prej tyre, ç'na kanë dhënë investimet për hapjen e tokave të reja dhe mbjellja e tyre me dritë. Kurdoherë ne kemi folur se duhen pastruar kullotat, por më duket jemi shumë larg realizimit të kësaj detyre. Sigurisht, po të mobilizohet si duhet fshatarësia, edhe kjo detyrë me rëndësi mund të realizohet, por fakti është se një punë e tillë

nuk bëhet siç kërkohet. Ne duhet ta konsiderojmë si një detyrë shumë të rëndësishme punën për të prodhuar më tepër mish, bulmet etj., sepse në qoftë se prodhimi i tyre është më i madh se konsumi i tanishëm, edhe drithëra buke nga jashtë ne do të sjellim më pak. Prandaj duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që të shtojmë prodhimin e blegtorisë. Mirëpo pa ushqim blegtorial nuk mbahet dhe këtë problem nuk po e zgjidhim si duhet. Atëherë çfarë të bëjmë? Këtë çështje duhet ta studiojnë specialistët duke bërë llogari. Në qoftë se nuk pastrojmë kullotat, në qoftë se nuk do të bëhet përmirësimi i tyre me barëra shumëvjeçare, atëherë direktivat do të qëndrojnë vetëm në letër, prodhime blegtoriale nuk do të kemi, kurse prodhimet bujqësore e blegtoriale për ne kanë rëndësi vendimtare. Nuk është aspak e drejtë që malësia, e cila ka shumicën dërrmuese të bagëtisë, të na japë 51 për qind të sasisë së mishit që na nevojitet. Ky nuk është një bilanc i rregullt. Edhe rendimenti i qumështit në malësi është i ulët. Prandaj, pa harruar çështjen e drithërave të bukës që është kryesorja, këtë problem nuk duhet ta zgjidhim pa e gjykuar mirë, në kompleks, duke përfshirë edhe problemin e ushqimit për blegtorinë.

Kam mendimin se kooperativistët në kooperativat tona bujqësore nuk kanë arritur akoma të mendojnë si një familje e madhe e vetme për shtimin e ekonomisë së tyre kolektive. Po edhe ne i pengojmë ata në disa drejtime. Ne hapim baxho, por në fakt grumbullimin e qumështit nuk jemi në gjendje ta realizojmë tërësisht. Një pjesë të madhe të qumështit e ha vetë fshatarësia, duke bërë edhe gjalpë, djathë etj. Po përse të mos me-

ndojnë kooperativat bujqësore, kudo që ato janë, të bëjnë vetë djathë e gjalpë? Ato kooperativa bujqësore që janë larg baxhove, pse të mos grumbullojnë vetë qumështin e bagëtive të tyre dhe të oborreve kooperativiste e ta përpunojnë duke bërë djathë, gjalpë, gjizë etj.? Fshatarësia jonë ka tradita dhe i nxjerr vetë të tilla prodhime. Djathin e napave, për shembull, që bënte fshatarësia jonë, ne e kemi ngrënë tërë jetën. Kurse tani gjendja ka ndryshuar, njerëzit kanë përparuar, kërkesat janë rritur. Atëherë përse nuk i vëmë njerëzit në pozita luftarake të prodhojnë? Në qoftë se duhen kusi, kazanë etj., le të prodhohen këto e t'u jepen kooperativave bujqësore dhe të ngrihen punishte të tilla për përpunimin e bulmetit, të cilat mund të vendosen edhe në një strehim të thjeshtë, natyrisht duke mbajtur pastërti. Një aktivitet i tillë plotësues në kooperativë krijon ndjenjën e një ekonomie familjare të shumanshme, kooperativa nuk kufizohet vetëm të prodhojë drithëra, perime, fruta etj., por prodhon edhe djathë, gjalpë, gjizë etj., pra zhvillon një ekonomi të gjithanshme. Kështu mund të krijojmë edhe aktivitete të tjera në kooperativat bujqësore.

Studimi që na paraqitet, për një rritje më të shpejtë të prodhimit bujqësor e blegtoral, ka rëndësi të madhe. Pa pritur të përfundojë plani pesëvjeçar, shokët e rretheve e të bazës duhet të kenë parasysh që të marrin vetë iniciativë për fillimin e disa punimeve. Shokët tanë t'i mësojnë kooperativat bujqësore që të veprojnë me mjetet, fondet dhe fuqinë e tyre punëtore e të mos presin vetëm ç't'u thonë nga lart. Partia dhe shteti orientimin e përgjithshëm e kanë dhënë, prandaj në

këto kushte iniciativa e çdo kooperative bujqësore duhet të jetë e madhe.

Kisha edhe një vërejtje tjetër si për ne këtu në qendër, ashtu edhe për komitetet e Partisë. Dihet se kur shqyrtohen probleme në Byronë Politike, mund të ketë dhe ka mjaft gjëra të reja. Kjo përbën një eksperiencë të madhe. Kështu ndodh kur shqyrtohet një problem edhe në komitetet e Partisë të rretheve. Por këto diskutime dhe orientime që jepen nga forumet e Partisë, nga udhëheqja, duhet të çohen seriozisht edhe në bazë. Siç u informova, për sa i përket problemit të arkivave del se për diskutimet që zhvillohen si këtu në qendër, ashtu edhe në komitetet e Partisë, pas mbledhjeve s'bëhet asgjë, po materialet mbyllen në kasafortë. Kjo do të thotë: dëgjuam ç'dëgjuam nga njëri-tjetri, ato që folëm mbetën po këtu. Atëherë përse i marrim në shqyrtim këto probleme, përse diskutojmë? Nuk mjafton që këtu asistojnë edhe disa sekretarë të parë ose ndonjë kuadër tjetër i rrethit apo i ministrisë, të cilët mbajnë edhe shënime, por ne, së pari, e dimë se sa shënime mund të mbahen në një mbledhje. Së dyti, kur largohet i ftuari nga mbledhja dhe kthehet në rreth, shumicën e mendimeve që u shfaqën i mënjanon, se kuptohet nuk mund t'i mbajë mend të gjitha, dhe ai shtron në bazë vetëm atë që i është fiksuar në kokë. Kështu, puna në bazë vazhdon si edhe më parë, pa u bërë asnjë ndryshim. Kjo është shumë serioze, shokë. Një gjë e tillë duhet të na preokupojë shumë. Nuk është çështja për të dhënë citate, puna është se në udhëheqjen e Partisë rrihen mendime. Kjo ndodh edhe në organet shtetërore, në Qeveri dhe në komitetet ekzekutive.

Ja, në këtë mbledhje të gjithë diskutuam për problemet e ndryshme që na preokupojnë për zhvillimin e bujqësisë në zonat kodrinore e malore, për ujitjen, për agroteknikën etj. Natyrisht, diskutimet e Byrosë Politike jo se nuk mbahen parasysht, por mendoj se me to është e domosdoshme që të organizohet më mirë puna. Këto çështje ne t'ia çojmë si duhet hallkës së dytë, e cila me vërejtjet dhe plotësimet e saj t'ia çojë medoemos hallkës së tretë, kurse tani te hallka e tretë, domethënë në bazë, shkon vetëm kashtë.

Më kanë thënë se ka organizata-bazë partie ku bëhet shpesh një punë formale. Për shembull, në mbledhjen e organizatës-bazë të një kooperative bujqësore, tani në prill, kur problemet më preokupante janë ato të bujqësisë, ishte vënë në rendin e ditës pastërtia. Domethënë pikërisht në këtë periudhë, kur fshatari do të jetë me djersë dhe me baltë se është vala e punës, organizata-bazë flet për pastërtinë! Një punë e tillë është formale. Është koha kur mund të diskutohet se s'na duhet as jorgani dhe as jastëku, sepse tani fshatari duhet të flejë në fushë, në arë, që të përballojë punët e stinës. Prandaj t'i kemi shumë kujdes këto çështje, ta bëjmë edukatë te njerëzit tanë që të luftohet formalizmi.

Mbledhja e organizatës-bazë duhet të zhvillohet në një nivel të lartë, ku, pasi të jepet orientimi, komunistët të veprojnë me iniciativë për të zbatuar vendimet dhe detyrat e organizatës. Të mos harrojmë se jeta e Partisë është e gjithanshme dhe zhvillohet në bazë, ajo nuk mbaron me mbledhjen. Jeta e Partisë ka të bëjë kurdoherë me njerëzit, bile disa herë në ditë komunistët zhvillojnë bisedime me punonjësit për punën, për hallet

e tyre, diskutojnë për detyrat, për sjelljen dhe qëndrimin e njerëzve etj., etj. Në qoftë se kemi formuluar e kemi vendosur disa rende dite, edhe pse janë të drejta, mund të ndryshohen, në të kundërtën ato shtrohen në mbledhje formalisht, siç përmenda rastin më sipër. Problemet duhet t'u përshtaten kohës, terrenit, ndryshe jeta e komunistëve nuk është revolucionare.

Si përfundim, vërejtjet që u bënë lidhur me planin propozoj që Komisionit të Planit të Shtetit dhe juve, shokëve të Ministrisë së Bujqësisë, t'ju shërbejnë për të rishikuar studimet, për të bërë parashikime më të sakta në planin e ardhshëm pesëvjeçar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PUNA SHKENCORE KËRKON PASION, DISIPLINË, METODE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 prill 1965

Nga raporti dhe diskutimet që dëgjuam del se në Institutin e Studimeve dhe të Kërkimeve Gjeologjike e Minerale ka mjaft detyra që duhen zgjidhur më mirë. Ca kohë më parë laboratorit i Ministrisë së Minierave e i Gjeologjisë u kthye në institut. Ne kemi parasysh që ky institut është akoma i ri, prandaj kuptohet që transformimi i tij nuk mund të bëhet menjëherë.

Kthimi i laboratorit në institut u bë jo formalisht, por me qëllim që të zhvillohet një punë më e mirë shkencore. Kjo do të thotë që në këtë organizëm të ri, vendin e parë duhet ta zërë instituti dhe jo laboratorit,

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi veprimtarinë e organizatës së Partisë të Institutit të Studimeve dhe të Kërkimeve Gjeologjike e Minerale për rritjen e ndërgjegjes së punonjësve në punë.

i cili të jetë një mjet për vërtetimin e studimeve që bën dhe që duhet të bëjë. Instituti tashmë nuk mund të funksionojë si një laborator i thjeshtë. Kjo duhet të jetë e qartë në kuptim dhe në veprim, megjithëse jemi akoma larg asaj që instituti të funksionojë krejtësisht si një institucion shkencor dhe të kryejë detyrat e tij të rëndësishme. Edhe vetë Ministria e Minerave dhe e Gjeologjisë nuk e ka kuptuar si duhet këtë çështje. Jo vetëm ministria, po edhe kuadrot që punojnë në institut, si dhe vetë drejtuesit e tij, nuk i kanë kuptuar mirë detyrat e mëdha që kanë.

Siç doli edhe nga shokët që diskutuan, lind me të drejtë pyetja: me se merren gjithë këta kuadro të lartë dhe të mesëm që ka sot instituti, me punë laboratorike apo me studime, që vërtetohen në laborator? Faktet tregojnë se në përgjithësi kuadrot e lartë të institutit merren edhe me studime, por jo sa kërkohet, në punën e tyre zënë vend më shumë analizat laboratorike; s'jemi që analiza të tilla të mos bëhen, por këtu është fjala që të ketë analiza në funksion të studimit. Kini parasysh, shokë, se nuk na lejohet ta nënvleftësojmë forcën e kuadrove të lartë. Nuk na lejohet gjithashtu të kërkojmë kuadro të shumtë, në një kohë kur edhe këta që kemi nuk merren si duhet me studime. Në të kaluarën Shqipëria ka bërë edhe me fare pak kuadro të lartë, kurse tani vetëm një institut si ky i studimeve dhe i kërkimeve gjeologjike e minerale ka 53 kuadro të lartë. Me këtë s'dua të them se nuk do t'i shtojmë më tej kuadrot e lartë, kjo do të bëhet se perspektivat janë të qarta, po duhet kuptuar mirë se specialistë të veçantë për sektorë të shumtë duan kohë që të përgatiten. Atë-

herë çfarë do të bëjmë, të rrimë të qajmë? Jo! Revolucionarët nuk qajnë, por me ata kuadro që kemi të përballojmë punën dhe, kur të nxjerrim kuadro të rinj, hap pas hapi të plotësojmë boshllëqet.

Kuadri i lartë që punon në këtë institut duhet konsideruar një forcë e madhe dhe të mos thuhet se «kemi pak». Kuadrot nuk i nxjerrim me makinë. Mundet që gaboj, por në qoftë se në institut bëhet një punë më e mirë, kjo është rezultat i punës së gjerë shkencore të kuadrove të lartë të tij. Mirëpo kjo s'mund të arrihet nëse punën që u takon laborantëve, do ta bëjnë kuadrot e lartë. Në qoftë se ata janë të pamjaftueshëm, duhet dhe mund të shtohen, sepse të përgatitësh laborantë është më e lehtë sesa të përgatitësh kuadro të lartë. Pra laborantët edhe në qoftë se nuk i keni, i përgatitni. Puna e laborantit është punë laboratorit, kurse puna shkencore është e një niveli më të lartë.

Është e papranueshme që në kushtet tona të kemi në një institut sa kuadro të lartë, aq edhe të mesëm. Në qoftë se e konsiderojmë të drejtë që për këtë situatë kuadrot e lartë të këtij instituti janë të mjaftueshëm, atëherë këtyre duhet t'u japim mundësinë që të bëjnë me të vërtetë punën e tyre, t'i shkarkojmë nga një mori punësh të tjera, që mund t'i bëjnë laborantët. Nuk është aspak e lejueshme që kuadrot e lartë të kujdesen edhe për gjetjen e epruvetave, të acideve etj., etj.

Për këtë gjendje që ekziston në institut ka përgjegjësi edhe Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë që është pajtuar me një situatë të palejueshme e që nuk është as ekonomike as shkencore. Përse lejon kjo ministri të trefishohen analizat në institut? Nuk them që

laboratorit të institutit të mos i caktojmë të bëjë edhe një pjesë të analizave të ndërmarrjeve të ministrisë. Edhe kjo duhet bërë, por në mënyrë të balancuar. Duhet vënë në dukje se studimet që bën instituti nuk janë studime në erë, por ato i interesojnë gjithë vendit dhe janë të përshtatshme për probleme që i dalin ministrisë. Përse e kemi ngritur këtë institut pranë Ministrisë së Minierave dhe të Gjeologjisë? Për arsye se studimet dhe puna laboratorike që kryhen në këtë institut janë të domosdoshme për ekonominë e vendit dhe për vetë veprimtarinë e ministrisë. Mua më duket se në këtë rrugë duhet të ecet për kuadrot e lartë dhe t'u vëmë një rëndësi akoma më të madhe edhe kuadrove të mesëm dhe laborantë. Ndoshta gabohem, por më duket se pa pasur laborantë, kuadri i lartë i ka të prera duart. Fizikani, gjeologu, inxhinieri etj. i kanë më se të domosdoshëm laborantët, prandaj kurset për laborantë duhet të jenë në qendër të vëmendjes, ato të preokupojnë si drejtuesit e institutit, edhe vetë ministrinë, sepse laborantët e kualifikuar ndihmojnë që shumë nga studimet e shkencëtarëve të jenë me nivel të lartë, ashtu sikurse laborantët e pakualifikuar ka rrezik t'i fusin këto studime në qorrrokak. Puna e laborantit nuk është një gjë e vogël, prandaj i vini rëndësi specializimit të tyre.

Shokët e dinë më mirë gjendjen e ndërmarrjeve gjeologjike, po, me sa jemi informuar, secila ka nga një laborator. Në qoftë se këta laboratorë nuk janë plotësuar me çdo gjë, për të bërë analizat që na duhen, atëherë t'i kompletojmë. Analizat që ka çdo laborator në nomenklaturën e vet duhet t'i bëjë me përgjegjësi

dhe jo për të kaluar kohën dhe për të harxhuar të holla, duke menduar se këto analiza do të provohen edhe në laboratorin e institutit. Po të ecet me këtë pikëpamje, laboratorët e ndërmarrjeve nuk tregojnë dhe as që kanë për të treguar kujdes. Kjo nuk është e rregullt. Analizat që i takojnë ndërmarrjes t'i bëjë laboratorin i saj dhe në qoftë se analiza nuk del në rregull, ky laborator të vihet përpara përgjegjësisë, kurse instituti të bëjë vetëm analizat që i përkasin. Prandaj ministria ta shikojë mirë çështjen e institutit, që ky të mos bëjë punën e ndërmarrjeve, por të kryejë detyrat për të cilat është krijuar.

Nuk mund të kuptohet dhe të pranohet që këshilli shkencor i institutit të mblidhet rrallë. Pse ndodh kështu? Na thuhet se janë bërë shumë studime, por në qoftë se këshilli shkencor i institutit nuk mblidhet për të diskutuar mbi to, për të kritikuar dhe për të aprovuar studimet e bëra, atëherë si mund të quhen studimet të përfunduara? Kjo vërteton atë që thuhet se instituti është larg detyrave të tij. Prandaj duhen marrë masa sa më parë për ndryshimin e kësaj gjendjeje.

Kryesorja është të bëhen studime shkencore. Për këtë të hartohet një plan pune, të shtrohen e të diskutohen tema shkencore dhe të vërtetohen këto me eksperimente laboratorike.

Ju, shokë të institutit, duhet ta kuptoni mirë se po të merreni me punë praktike dhe jo me punë që është vërtet shkencore, do të mbeteni pas. Prandaj futjuni me guxim një punë më të organizuar, thëlloni dituritë tuaja, ngarkoni edhe të tjerët me përgjegjësi, se vetëm

kështu ata do të ngrihen, vetëm kështu secili do të mendojë më mirë për të kryer si duhet detyrën që i ngarkohet. Ngarkimi i të tjerëve me përgjegjësi jo vetëm do t'ju lehtësojë juve, por një gjë e tillë do të vlejë njëkohësisht për t'i ngritur edhe ata. Në këtë mënyrë do të ecni përpara edhe ju të vjetrit, edhe ata më të rinjtë.

Të gjithë kuadrot, kudo që punojnë, po veçanërisht ju, kuadrot e lartë, duhet të jeni njerëz të pasionuar për studime. Ju duhet të keni pasion të madh për zgjerimin e njohurive tuaja shkencore, të bëheni shembull i punës metodike. Njerëzit e shkencës nuk mund të punojnë pa një metodë të tyre rigoroze shkencore. Kjo nuk do të thotë që metoda në punë duhet të jetë medoemos e njëlllojtë për të gjithë shkencëtarët. Kush mendon kështu, e ka gabim. Çështja është që secili nga ju që merret me punë shkencore të jetë metodik në punë. Këtë e lypin shkencat ekzakte. Puna shkencore kërkon pasion, disiplinë, metodë. Që të tria këto duhet të zhvillohen te ju, ndryshe nuk mund t'ia arrini qëllimit për të cilin ju ka ngarkuar Partia.

Në raport flitet edhe për dobësi të tjera nga të cilat duhen nxjerrë disa konkluzione. Aty flitet, për shembull, edhe për javashllëk në punë. Në qoftë se me javashllëk kuptohet përtesa dhe një gjë e tillë vërtetohet në punën e institutit, atëherë duhet kuptuar mirë se të përtosh do të thotë të mos kesh rezultate në punë. Njerëzit përtacë duhen dërguar më parë në bazë, ku në luftë me jetën, me praktikën, të shërohen, të kaliten.

Por ka edhe një javashllëk të një natyre tjetër, kur

bën një studim të thellë, serioz, të gjerë, të komplikuar, të vështirë, i cili kërkon kohë. Ky javashllëk mund të jetë i lejueshëm e nuk mund të quhet në çdo rast përtaci, sidomos kur problemet që po studiohen janë të vështira, të ndërlikuara dhe kërkojnë kohë për t'u zgjidhur. Ka njerëz që punojnë pa u lodhur dhe nuk i zëgjumi për të kryer detyrat, pavarësisht se frytet e punës së tyre nuk janë të shpejta, kjo nuk mund të konsiderohet javashllëk, sepse puna e vështirë e shkencëtarit kërkon kohë. Prandaj Partia duhet t'i përkrahë shkencëtarët që janë të palodhur në punë edhe kur disa herë duket sikur ecin ngadalë.

Këtu u tha se në institut ka edhe shumë aparate. Këto mjete, jo vetëm duhet të mbahen mirë, po edhe të shfrytëzohen për qëllimet që janë, se e tërë puna e këtij instituti ka të bëjë me aparatura dhe me studime. Neve nuk na vjen mirë që në institut të ketë një laborator të pasur dhe shumë aparate të vlefshme dhe ato jo vetëm të mos shfrytëzohen si duhet, por edhe të prishen e të mos merren masa të paktën për t'i ndrequr. Të mos jenë në gjendje pune këto aparatura të vlefshme nuk është aspak e pëlqyeshme. Unë laboratorin tuaj nuk e kam parë, por bazohem në ato që u thanë në këtë mbledhje. Ne tani i kemi siguruar këto aparatura, atëherë përse nuk i shfrytëzojmë? Kjo çështje duhet parë më nga afër, aparaturat duhet të përdoren dhe në qoftë se nuk i përdor instituti, atëherë t'u jepen institucioneve të tjera, si për shembull universitetit, që mund t'i përdorë dhe të nxjerrë përfitime prej tyre.

Edhe dy fjalë për punën e Partisë në institut. Më

duket se puna e Partisë në institut nuk duhet të jetë e thjeshtë, e kufizuar vetëm në edukimin moral dhe politik të punonjësve. Kjo është vetëm njëra anë. Organizata e Partisë në këtë institut duhet të synojë njëkohësisht edhe në kryerjen e detyrave kryesore që ka institucioni, për zbatimin drejt të orientimit që i është caktuar atij, për kryerjen e punës shkencore, për zhvillimin e diskutimeve në përfundimin me sukses të temave shkencore, për plotësimin e planit të studimeve. Në këto drejtime ne shikojmë shumë dobësi. Më duket se në Universitetin e Tiranës ka një eksperiencë më të mirë, që mund të shfrytëzohet. Shoku Kahreman Ylli dhe bashkëpunorët e tij të ngushtë bëjnë një punë të mirë për të vënë në jetë orientimet që jep Partia për punë shkencore. Puna e Partisë në universitet nuk kufizohet vetëm me problemet e edukatës morale e politike, për t'i përgatitur studentët e universitetit që të jenë të qartë politikisht, ideologjikisht, por puna mësimore me studentët, leksionet të jenë të një niveli më të lartë shkencor. Dhe kjo, midis të tjerave, është për universitetin një punë e rëndësishme partie. Shokët e universitetit e bëjnë çdo ditë këtë punë. Kështu duhet të bëni edhe ju, shokë komunistë. Nuk është çështja vetëm të mblidheni në organizatën-bazë dhe atje të kritikoni vetëm të metat. Edhe këtë ta bëni, por puna është që problemet të çohen gjer në fund. Në të gjithë komunistët e organizatës suaj duhet të ketë kurdoherë një disiplinë të fortë në çdo drejtim: në studimet, në diskutimin e temave shkencore, që këto të përpunohen në rrugë marksiste-leniniste, të luftohet në to çdo shfaqje idealiste, që temat t'i përgjigjen realitetit aktual të

nevojave tona ekonomike. E gjithë kjo është punë e rëndësishme partie. Këtu duhet të plekset edhe edukimi i kuadrove tanë me moralin komunist. Prandaj në këto drejtime të merren të gjitha masat që puna të përmirësohet rrënjësisht.

Me vërejtjet dhe kritikrat që ju bëmë në këtë mbledhje nuk duhet menduar se ne kemi një mendim të keq për këtë institut, ose e bëmë të zezë punën e tij. Në asnjë mënyrë! Kjo të jetë e qartë. Ne, me vërejtjet dhe kritikrat tona u përpoqëm t'ju ndihmojmë për ta ngritur në një shkallë më të lartë punën e rëndësishme të këtij instituti. Në fakt, ju keni arritur disa rezultate, por qëllimi është ta çoni punën më përpara. Ju jeni akoma të rinj në punë, por mendoj se nuk duhet as ta mbivlerësoni, as ta nënvleftësoni veten. Jeni specialistë për detyrat që duhet të kryejë instituti, prandaj atje Partia nga ju pret më shumë. Ne nuk i dimë gjërat më mirë se ju. Problemet e institutit më mirë se kushdo i dini vetë, por këshillat dhe vërejtjet tona besoj se do t'ju ndihmojnë. Ne kemi bindjen se do ta përmirësoni gjendjen në institut.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

GRUPI TRADHTAR I REVIZIONISTËVE SOVJETIKË PËRKRAH IMPERIALISTËT AMERIKANË NË AGRESIONIN KUNDËR VIETNAMIT

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

20 prill 1965

Agresioni imperialist në Vietnam ka tërhequr vëmendjen e gjithë popujve. Ngjarjet në atë vend ndiqen me shqetësim nga të gjithë njerëzit e ndershëm në botë. Sot Vietnami është bërë një gur prove për të gjykuar mbi qëndrimin revolucionar apo kundërrevolucionar të njerëzve e të popujve, të partive e të shteteve të ndryshme. Për të gjithë njerëzit e gjithë popujt që e kanë të shtrenjtë çështjen e lirisë e të paqes në botë, për të gjitha partitë revolucionare është e qartë se në Vietnam imperialistët amerikanë, bashkë me ta edhe të gjitha forcat reaksionare e kapitulluese, u kanë bërë sfidën më të hapur, më arrogante e më të rrezikshme lirisë së popujve e paqes. Pas disfatës që pësoi me «luftën e posaçme», imperializmi amerikan është angazhuar tani në Vietnam në një luftë të rregullt të hapët, nga e

cila s'ka asnjë dyshim se do të dalë i shpartalluar përfundimisht.

Sot problemi shtrohet kështu: ose me popullin vietnamez dhe kundër imperializmit amerikan e bashkëpunëtorëve të tij, ose kundër luftës heroike të popullit vietnamez dhe me komplotet dinake imperialisto-revizioniste, për «bisedime pa kushte» që legalizojnë pushtimin dhe agresionin imperialist.

Si kudo gjetkë në botë, në Azi, Afrikë, Amerikën Latine, edhe në Vietnam imperializmi amerikan është shkaktari i luftës dhe i tensionit. Ai është pushtuesi dhe vrasësi i popullit të Vietnamit të Jugut, ai është agresori barbar kundër Vietnamit të Veriut, ai mbetet xhandari i urryer ndërkombëtar që kërcënon lirinë e popujve dhe paqen në botë. Por aktet agresive e komplotet e imperialistëve amerikanë e të bashkëpunëtorëve të tyre nuk bëjnë tjetër veç ngrenë edhe më lart vigjilencën e kompaktësinë e popujve, shtojnë urrejtjen dhe hovin e luftës së tyre revolucionare.

Vite me radhë Shtetet e Bashkuara të Amerikës po zhvillojnë në Vietnamin e Jugut një luftë të përgjakshme e barbare. Dhe prej vitesh ato po marrin goditje të rënda nga qëndresa heroike e popullit të Vietnamit të Jugut, i udhëhequr me guxim nga Fronti Kombëtar i Çlirimit. Tani imperialistët amerikanë e zgjeruan luftën e tyre agresive edhe në Veri. Ky veprim, që u dënua nga gjithë popujt e botës, nuk bën tjetër veçse e shpejton disfatën e tyre të plotë dhe i afron ditët mbarimit të turpshëm të sundimit amerikan në Indokinë. Xhonsoni dhe gjeneralët e tij shpresonin se do ta frikësonin popullin vietnamez dhe do ta gjunjë-

zonin atë me forcën e armëve e të dollarëve. Këtë qëllim dinak e mashtrues kishte edhe fjalimi i fundit i presidentit amerikan në Baltimor. Ai u orvat atje të blente për 1 miliard dollarë 100 milionë njerëz të Azisë Juglindore. Por ai nuk mundi të blente 30 milionë vietnamezë me 4 miliardë dollarë që gjer tani i ka derdhur si lumë në Vietnamin e Jugut. Dhe ky dështim i Xhonsonit ka logjikën e vet: me dollarë mund të blihet ndonjë tradhtar, por nuk mund të blihet populli, ndër-gjegjja e tij, jeta e tij.

Vietnamezët i treguan gjithë botës se janë një popull i pamposhtur. Ata iu përgjigjën thirrjes së atdheut me betimin: «Do të luftojmë gjer në fund e gjer në fitore. Ne do të luftojmë brez pas brezi gjersa në tokën tonë do të ketë agresorë amerikanë. Kjo luftë do të marrë fund vetëm kur agresorët amerikanë të shporren nga vendi ynë».

Shkaba e stemës shtetërore të Shtëpisë së Bardhë ka degën e ullirit dhe shigjetat, simbole të politikës amerikane. Por çfarë fitoi Xhonsoni nga miliardët e dollarëve që derdhi në Vietnam në emër të «degës së ullirit»? Asgjë, përveç urrejtjes së pafund të popujve dhe diskreditimit të plotë politik në shkallë ndërkombëtare. Çfarë fitoi Xhonsoni nga dërgimi i mijëra ushtarëve amerikanë dhe i mijëra tonelatave armatime në Vietnamin e Jugut, nga përdorimi i gazrave helmuese e të napalmit, nga bombarduesit amerikanë që vrasin e djegin në të dy anët e Vietnamit në emër të shigjetës? Asgjë, përveç disa qindra aeroplanëve të rrëzuar e disa mijëra amerikanëve që kthehen në shtëpi të mbyllur në qivurë.

Megjithatë, imperializmi agresor amerikan, duke vazhduar aventurën e tij, po e zgjeron luftën në gjithë Vietnamin dhe është gati t'i vërë zjarrin mbarë botës, në rast se nuk do të ndalohej me kohë dora e tij kriminale. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë bërë copë e grimë marrëveshjet e Gjenevës të vitit 1954 mbi Vietnamin. Ato kanë shkelur të tëra marrëveshjet ndërkombëtare që ndalojnë përdorimin e gazrave mbytëse, helmuese, si edhe të gjitha lëndët e ngjashme dëm-tuese, siç janë konventa e Uashingtonit e 6 shkurtit 1922 dhe protokollit i Gjenevës i 17 qershorit 1925. Ato e kanë shndërruar Vietnamin e Jugut në një poligon provash të armëve të tyre më të reja vdekjeprurëse dhe popullsinë vendase e përdorin si «kafshë eksperimentale» për provat e tyre çnjerëzore. Ato rrafshojnë përtokë fshatra e qytete të tëra, mbytin me gazra e napalm popullsi të tëra, asgjësojnë frytet e punës krijuese shumëvjeçare të një populli të shumëvuajtur. Këto janë barbarizma të pashembuj, të cilët po ua kalojnë nga cinizmi edhe atyre që kryenin në kohën e vet kriminelët hitlerianë. Por të gjitha ato vepra barbare e çnjerëzore që kryente dje Hitleri në emër të «rendit të ri» dhe që sot i kryen Xhonsoni në emër të «botës së lirë», kanë një përmbajtje dhe një emër: janë krime lufte, krime kundër njerëzimit, të dënuara nga historia, nga popujt. Ato zemërojnë thellësisht dhe çojnë peshë ndërgjegjen e njerëzimit, të gjithë popujt e botës. Prandaj nuk mjafton më të denoncohen e të dënohen me rreptësinë më të madhe këto krime përbindshe; sot duhet të ngrihen në këmbë të gjithë popujt për t'u ndalur dorën imperialistëve agresorë amerikanë, duhet t'u pritët

rruga atyre, u duhet dhënë një mësim i tillë që të mos guxojnë më të luajnë me fatin e popujve e të paqes në botë.

Populli vëlla vietnamez, me qëndrimin e tij të patundur revolucionar dhe me shembullin e tij frymëzues, ka treguar pjekuri të lartë politike dhe patriotizëm të shkëlqyer. Ai është në vijën e parë të zjarrit në luftën kundër imperializmit amerikan, kundër armikut më të tërbuar e më të rrezikshëm të popujve, të paqes e të socializmit. Prandaj kush mbron Vietnamin mbron lirinë e popujve, mbron paqen në botë, mbron socializmin. Solidariteti luftarak me popullin vietnamez, përkrahja e gjithanshme dhe ndihma e vendosur morale e materiale janë detyrë e shenjtë internacionaliste për gjithë popujt paqedashës e antiimperialistë, për të gjitha partitë revolucionare dhe njerëzit e ndershëm në botë.

Gjendja e sotme e rëndë ndërkombëtare dhe acarimi i saj, sidomos në Azinë Juglindore e në Vietnam, e kanë burimin në politikën e luftës dhe të agresionit të imperializmit amerikan. Ajo inkurajohet edhe nga politika e kapitullimit dhe e tradhtisë që ndjekin revizionistët hrushovianë, nga politika e tyre e afrimit dhe e pajtimit me kreun e reaksionit ndërkombëtar — imperializmin agresor amerikan. Ky qëndrim kapitullant e tradhtar prej frikacakësh e oportunistësh të pandreqshëm i krerëve të dinastisë hrushoviane, gatishmëria e tyre për pazarllëqe e prapaskena, i ka inkurajuar pa masë imperialistët amerikanë, jo vetëm në hartimin e «strategjisë globale» të sundimit botëror, por edhe në kryerjen e veprave konkrete agresive kundër

vendeve socialiste dhe popujve të tjerë liridashës e paqedashës të botës. Është e njohur tanimë botërisht se revizionistët hrushovianë, me qëndrimin e tyre ndaj çështjeve kryesore të jetës së sotme ndërkombëtare, janë katandisur objektivisht në një agjenturë të borgjezisë reaksionare imperialiste. Sikur të mos ishte një qëndrim i tillë kapitullues e tradhtar i udhëheqësve të sotëm sovjetikë, imperialistët amerikanë do ta kishin shumë më të vështirë të ndërmerrnin veprime të tilla kriminale si agresioni i hapët barbar kundër RD të Vietnamit.

Në themel, çfarë ndryshimi ka kërkesa e Xhonsanit për «bisedime pa kushte» me kërkesën e revizionistëve për «zgjidhje politike paqësore»? Të dyja këto kërkesa janë bërë duke shkelur interesat supreme të popullit vietnamez dhe me qëllim që ta shpëtojnë imperializmin amerikan nga disfata e pashmangshme e përfundimtare, që të përjetësojnë skllavërinë e popullit vietnamez nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë, duke i mbetur besnikë mjeshtrit të tyre Hrushov, rrahin gjoksin dhe çirren së thëni se janë «antiimperialistë të betuar», ndërsa në të vërtetë nuk janë asgjë më tepër se demagogë të pandreqshëm dhe frikacakë të neveritshëm. «Antiimperializmi» i udhëheqësve sovjetikë ka mbetur, siç ka ndodhur me të gjithë oportunistët, në kufijtë e fjalëve dhe të shprehjeve bombastike në fjalime mitingjesh dhe artikuj gazetash. Ky është «antiimperializëm» panairësh për të mashtruar naivët. Ndërsa, nga njëra anë, krekosen me pozat e «luftëtarëve antiimperialistë» dhe partizanëve të «unitetit», nga ana tjetër,

ata i shkelin syrin Xhonsonit, tregohen të gatshëm për t'u takuar me të, për t'u marrë vesh me të. Ata zgjodhën pikërisht këtë kohë për të bërë edhe mbledhjen përçarëse të 1 marsit. Ata lejojnë të nxjerrë kokën herë pas here N. Hrushovi, të cilit i pëlqen të luajë rolin e «këshilltarit politik» sesa atë të «kufomës politike». Ata shtypin me gjak demonstratat antiimperialiste të studentëve në Moskë e në Leningrad dhe u kërkojnë ndjesë imperialistëve. Ata bëjnë sondazhe për të nxjerrtur idenë e «bisedimeve paqësore» dhe për të filluar bisedime të tilla. Si mund të shpjegohen ndryshe të gjitha këto veçse me atë që antiimperializmi i tyre është fals? Në një kohë kur një popull vëlla socialist është bërë viktimë e agresionit të egër barbar imperialist, kur kundër tij është sulur me aviacionin, flotën dhe armatimet e saj fuqia më e madhe imperialiste e kohës sonë, të kërkojë bisedime «paqësore», siç i kërkojnë ato udhëheqësit e sotëm sovjetikë, është barabar si të legalizosh agresionin dhe të përjetësosh pushtimin imperialist, është barabar si të kryesh krimin e bashkëpunimit me agresorët imperialistë.

Në fakt, revizionistët hrushovianë, me politikën e tyre të zhurmës «antiimperialiste» e të pazarllëqeve të «diplomacisë së fshehtë» për «zgjidhjen politike paqësore», në çështjen vietnameze janë hedhur në një front të përbashkët me imperialistët amerikanë.

Politika e udhëheqësve të sotëm sovjetikë është një aspekt i politikës së jashtme kapitulluese dhe zbulon qëndrimin e tyre kontradiktore, të paparim, të lëkundshëm e hipokrit. I gjithë ky qëndrim bie në kundërshtim të hapët me interesat jetësore të popujve, të so-

cializmit e të paqes. Ai është një qëndrim thellësisht oportunist e tradhtar.

Qëndrimi i sotëm i udhëheqësve sovjetikë lidhur me Vietnamin karakterizohet nga demagogjia dhe kapitullimi. L. Brezhnjevi u detyrua të pohojë nëpër dhëmbë, në një nga fjalimet e tij të fundit, se «amerikanët duhet të largohen nga Vietnam». Po kjo deklaratë nuk ka habitur ata që njohin fytyrën dhe vlerën e fjalëve të revizionistëve hrushovianë, aftësitë e tyre në fushën e akrobacive politike. Brezhnjeviti i duhet kjo deklaratë demagogjike për konsum të brendshëm dhe për të kapur nga hunda opinionin publik të zemëruar nga aktet e agresorëve amerikanë. Ai detyrohet, nga e keqja, të bëjë edhe ndonjë deklaratë bombastike. Jemi mësuar me të tilla deklarata nga Hrushovi. Krejt ndryshe vepron Kosigini. Ai hesht, nuk thotë një fjalë për amerikanët; dhe ka arsyet e veta për këtë: duhet të ruajë aleancat me imperializmin, nuk duhet të bëjë asgjë që t'i prekë, sadopak, marrëdhëniet me të. I pari bëri bluf për të mashtruar, për të krijuar iluzione dhe për të qetësuar ata që, me të drejtë, revoltohen nga qëndrimi kapitullues i udhëheqësve të sotëm sovjetikë. I dyti luan rolin e pajtuesit, i kënaq imperialistët, i siguron e i qetëson ata.

Kjo është politika e mësallës me dy faqe, aspak e denjë dhe krejt e huaj për një shtet socialist. Ky qëndrim është pasojë e pashmangshme e degjenerimit të plotë politik e ideologjik të udhëheqësve të sotëm sovjetikë.

Grupi i revizionistëve sovjetikë bën zhurmë të madhe për ndihmën e tij (të ardhme) ndaj Vietnamit.

Shumë fjalë të errëta e pa kuptim tha për këtë çështje L. Brezhnjevi në një miting që u mbajt më 8 prill në Varshavë. Por zhurmat nuk gënjejnë njeri. Revizionistët hrushovianë janë mjeshtër për formula të errëta e të koklavitura kur është puna për t'iu shmangur qëndrimeve të prera. Dhe kjo nuk është e rastit, ato janë pjesë e pandarë e demagogjisë së tyre politike. Ai foli vetëm për «gatishmërinë» e Bashkimit Sovjetik që të ndihmojë Vietnamin. Për «gatishmërinë» flet ai, për «gatishmëri» flet edhe gjithë propaganda revizioniste!... Por pse flitet akoma vetëm për «gatishmëri» dhe nuk flitet për diçka konkrete?

Në një kohë kaq të rëndë për imperializmin amerikan, e ashtuquajtura qeveri socialiste e grupit Brezhnev-Kosigin-Mikojan-Suslov, e këtyre tradhtarëve të çështjes socialiste, ka rënë në gjunjë përpara imperializmit amerikan.

Potenciali politik, ekonomik dhe ushtarak sovjetik në duart e udhëheqjes tradhtarë revizioniste është kthyer në një armë kundër socializmit dhe revolucionit, i është nënshtruar politikës së përgjithshme imperialisto-kapitaliste, është vënë bile në bisht edhe të vetë koniunkturës kapitaliste ku e kanë futur ky grup tradhtarësh Bashkimit Sovjetik.

Udhëheqja e tanishme e një populli trim e revolucionar siç është populli sovjetik, është udhëheqja më frikëmanë që mund të ekzistojë në botë. Kjo është një kontradiktë që do të thellohet çdo ditë. Trimi do ta mposhtë frikëmanin. Udhëheqja e tanishme e një populli që bëri Revolucionin e Madh, siç është populli sovjetik,

është udhëheqja më dinake, më shpifarake, më gënjesh-tare, më blofiste që ka parë bota. Kjo është një kontra-diktë tjetër që do të thellohet çdo ditë dhe kjo udhëheqje s'do ta ketë jetën të gjatë. Do të vijë koha që populli sovjetik ta mposhtë këtë udhëheqje tradhtare. Populli sovjetik ka tani një udhëheqje të atillë që jo vetëm nuk mund të quhet socialiste dhe internacionaliste, por as edhe të barazohet me izolacionistët amerikanë, pasi të paktën këta adeptë të Monroes dinë të mbrojnë interesat dhe qëllimet e tyre, kurse udhëheqja tradhtare sovjetike ka shitur të huajt imperialistë interesat e vetë Bashkimit Sovjetik, pa le të popujve të tjerë.

Ne kemi të drejtë t'i pyesim shokët sovjetikë: Çfarë siguri keni ju për mbrojtjen e vetë Bashkimit Sovjetik nga kërcënimi imperialist? A nuk ka ardhur koha të kontrolloni me ashpërsinë më të madhe veprimet e udhëheqjes suaj llafazane, blofiste, hrushoviane dhe të shitur? Hrushovi dhe dishepujt e tij, që janë tani në fuqi, jo vetëm që bëjnë mburrje false për të fshehur gremi-nën, por u japin informata jetike amerikanëve për ta lënë në diell Bashkimin Sovjetik.

Vëllezër sovjetikë, i kontrolloni pak këto dhe shih-ni se a i keni në duar të sigurta armët që i kanë krijuar shkencëtarët tuaj të lavdishëm, sesa për udhëheqjen tuaj, kjo është e ditur nga gjithë bota se s'është socia-liste, por tradhtare.

Udhëheqja juaj tradhtare hrushoviane flet për flo-tën e fuqishme sovjetike. Vëllezër sovjetikë, nuk ka ardhur, vallë, koha të hidhni një sy dhe të kontrolloni-është dhe në ç'duar është kjo flotë? Ne kemi të drejtë të pyesim: ekziston apo e ka prishur atë Nikita Hrushovi?

Në qoftë se ekziston, atëherë na lejoni t'ju pyesim: E keni për të zbukuruar portet tuaja, apo për të mbrojtur vetëm Bashkimin Sovjetik? Në këto situata ne kemi të drejtë të themi se tani flotës suaj ushtarake i dëgjohet zëri fare më pak, për të mos thënë aspak, se flotës ruse të kohës së Nahimovit.

A nuk kemi të drejtë ne të themi se udhëheqja juaj tradhtare i ka lënë dorë të lirë flotës amerikane të bëjë ligjin ndër dete e oqeanë, të zbarkojë marinarët kurdo dhe kudo që ia ka qejfi, të pushtojë vende të huaja dhe të djegë popuj e vende që duan të rrojnë të lira dhe sovranë?

Është e qartë se udhëheqja juaj tradhtare, vëllezër sovjetikë, u ka lënë dorë të lirë amerikanëve, si në çdo gjë, edhe në dete. Ju mund të thoni se nuk dëshironi të provokoni. Ne as që kemi qëllimin atje. Por juve ju kujtohet fare mirë se ç'qëndrim mbajti Hrushovi kundër çankaishistëve kur ata ju kapën vaporin «Tuapse». «Heroizmi» i Hrushovit konsistoi në bërjen vetëm të një filmi. Juve ju kujtohen provokacionet e panumërta që u bëhen në dete anijeve tuaja nga amerikanët. Për këto udhëheqja sovjetike lëshon nga një komunikatë. Dhe amerikanët vazhdojnë.

Udhëheqja juaj tradhtare çarmatosi bazën tonë të Vlorës dhe u tha amerikanëve se «deti Mesdhe është juaji», ashtu siç u thotë edhe tani se «oqeani Paqësor, ngushtica e Tajvanit, gjiri i Tonkinit janë tuajat, miq imperialistë amerikanë, lëvrini me flotën tuaj, zbarkoni, provokoni, digjni, shpalluni luftë vendeve socialiste».

Çfarë po bën në këto momente krize udhëheqja

tradhtare sovjetike? Udhëheqja tradhtare sovjetike bën demagogji me dëshirën e zjarrtë të njerëzve sovjetikë për të vajtur vullnetarë në Vietnam.

A ka kuptim të dërgosh vullnetarë sovjetikë në Vietnam dhe, nga ana tjetër, të puthesh dhe të bësh intriga me amerikanët? Kësaj i thonë jo të ndihmosh Vietnamin, por të sakrifikosh jetën e vullnetarëve sovjetikë për demagogji dhe për të fshehur tradhtinë e madhe kundër popujve sovjetikë dhe atij vietnamez.

Ju kujtohen, vëllezër sovjetikë, vullnetarët tuaj që shkuan e luftuan në Spanjë? Politika e qeverisë suaj të asaj kohe, e udhëhequr nga Stalini, ishte një me dëshirat e zjarrta tuajat dhe të popullit spanjoll. Qeveria e Stalinit nuk puthej me Frankon, vaporët sovjetikë çanin dete të ngarkuara me armë dhe vullnetarë për në Spanjë, vaporët tuaj luftonin me armiqtë. A ju kujtohet juve, vëllezër sovjetikë, lufta heroike e Koresë kundër imperializmit amerikan dhe mercenarëve të tij? Ajo ishte një luftë dhëmb për dhëmb. Tok me popullin vëlla heroik korean luftuan vullnetarët e lavdishëm kinezë dhe këta ishin me qindra mijë dhe me qindra mijë lanë jetën atje, të frymëzuar me një ideal të lartë internacionalist. Stalini i madh dërgoi pa kursyer armë e municion. Në atë kohë ekzistonte unitet marksist-leninist. Tani udhëheqja juaj, vëllezër sovjetikë ju ka tradhtuar ju, partinë tuaj, socializmin, internacionalizmin.

Udhëheqja juaj tradhtare s'është tjetër veçse një tregtare armësh si famëkeqi aventurier Zaharov. Si mund t'u besohet më këtyre njerëzve pa skrupull e të çndershëm? Vëllezër sovjetikë, a nuk e shihni këtë

tradhti të madhe të udhëheqjes suaj, a mund të durohet më, a mund të lejohet të vazhdohet më një gjë e tillë?

Neve na duket dhe jemi të bindur se udhëheqja juaj tradhtare e ka mbushur kupën dhe kupa po derdhet, po derdhet gjaku i popujve për tradhtinë e udhëheqjes suaj të poshtër. Ju mbani përgjegjësi kolosale për këtë, mos harroni.

Nuk është e para herë që revizionistët hrushovianë bëjnë blofe të tilla në fushën e politikës ndërkombëtare. Kjo është një karakteristikë e tyre, është stili i punës së tyre. Kjo ka ndodhur më 1956 në rastin e Egjiptit, më vonë në rastin e Berlinit, të Kubës etj. Por në rast se blofi lidhur me Egjiptin në kohën e vet pati ndonjë rezultat, blofet e tjera revizioniste lidhur me Berlinin e Kubën dështuan plotësisht për një arsye shumë të thjeshtë: sepse imperialistët ua kënduan letrat në dorë revizionistëve hrushovianë, ua pinë lëngun përfundimisht.

E njëjta gjë po ndodh, për fat të keq, edhe me çështjen vietnameze. Imperialistët tani e dinë fort mirë se pasardhësit e N. Hrushovit, duke vazhduar politikën e blofeve, po bëjnë një bluf të ri, prandaj nuk tërhiqen dhe nuk përmbahen në vëprimet e tyre agresive, përkundrazi, i thellojnë dhe i zgjerojnë ato. Vlen të shtohet këtu se këtë lojë e kanë kuptuar tanimë edhe ata që dikur, për një arsye apo për një tjetër, kishin akoma njëfarë besimi të «principlialiteti» i politikës së qeverisë sovjetike dhe mbi këtë bazë kishin ndërtuar shpresat dhe iluzionet e tyre.

Gjer kur do t'u ecë kjo demagogji? A do të lejohet populli sovjetik të vazhdojë të mashtrohet e të tradhtohët akoma nga udhëheqësit e sotëm revizionistë, nga

kuarteti hrushovian Brezhnjev-Kosigin-Mikojan-Susllov? A do të lejojë populli heroik i Tetorit të Madh, populli i Stalingradit, populli që ngrii flamurin e kuq të fitores mbi Rajhshtag, që këta udhëheqës revizionistë të marrin nëpër këmbë traditat e lavdishme të Partisë Bolshevike, të Leninit e të Stalinit, të vënë në rrezik fitoret e Revolucionit, të bëhen bashkëpunëtorë të agresorëve imperialistë kundër popujve vëllezër të vendeve socialiste?

Popujt sovjetikë nuk do ta lejojnë një gjendje të tillë, ata do ta ndihmojnë patjetër luftën e drejtë të popullit vëlla vietnamez. Dhe ndihma e parë, kryesore, e vërtetë, e popullit sovjetik për Vietnamin është që të mos i lejojë udhëheqësit revizionistë të sotëm të bëjnë lojra kriminale, mashtrime e blofe të tilla të ulëta në kurriz të popullit vietnamez, t'i ndalojë ata të bëjnë pazarllëqe e pajtime të tjera me imperializmin, të ndalojë përkrahjen e tyre të mëtejshme të agresorëve imperialistë në luftën kundër Vietnamit, të mos lejojë kurrsesi që udhëheqësit e tij revizionistë të vazhdojnë lojën e tyre të bashkëpunimit e të tradhtisë me armikun më të keq të popullit sovjetik, të socializmit e të njerëzimit, imperializmin amerikan. Populli sovjetik duhet t'i bllokojë në çdo gjë dhe totalisht imperializmin amerikan dhe krerët tradhtarë hrushovianë.

Revizionistët hrushovianë po luajnë hapur një lojë të rrezikshme në kurriz të popullit vietnamez dhe në dëm të socializmit e të paqes. Qëllimi djallëzor i renegatëve sovjetikë është të fusin në kllapat e tyre Republikën Demokratike të Vietnamit nëpërmjet një «operacioni» gjoja me dërgim armësh dhe vullnetarësh në

këtë vend. Ky «operacion» këtë herë bëhet nëpërmjet luftës së nxehtë që kanë shpallur amerikanët.

Ky veprim i revizionistëve sovjetikë gjoja kundër imperializmit amerikan dhe «në ndihmë» të Republikës Demokratike të Vietnamit, shoqërohet nga bombardimet e amerikanëve, bombardime që do të pakësohen vetëm atëherë kur operacioni sovjetik të ketë marrë fund, domethënë kur të ashtuquajturit vullnetarë sovjetikë do të kenë zënë vendet kyç në Vietnam, gjoja nën ngjyrën e specialistëve, të teknikëve të raketave etj. Në këtë mënyrë revizionistët sovjetikë, duke përgatitur mjetet për të mbytur luftën e popullit heroik vietnamez, shpresojnë dhe përpiqen të krijojnë një situatë të favorshme, relativisht të qetë, për bisedime me amerikanët dhe ta kthejnë Vietnamin dhe Indokinën në një fushë intrigash dhe kërcënimesh kundër vendeve socialiste, atyre demokratike të Azisë e Afrikës dhe kundër partive marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të forta.

Orvatje të kësaj natyre kanë bërë revizionistët sovjetikë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe kundër pavarësisë e sovranitetit të vendeve të tjera socialiste dhe josocialiste. Kjo është një eksperiencë e madhe edhe për popullin heroik të Republikës Demokratike të Vietnamit. Populli vietnamez, i Veriut dhe i Jugut, i ka sytë hapur. Për të është i shenjtë gjaku që ka derdhur e po derdh në luftën për çlirim, për të është i shtrenjtë marksizëm-leninizmi, dhe ky «operacion» djallëzor i sovjetikëve do të dështojë me siguri, pse ai është vigjilent.

Sot gjendja është e favorshme për popujt dhe e

disfavorshme për imperialistët e revizionistët. Sa më tepër krime të përbindshme që të kryejnë imperialistët amerikanë, aq më shumë do të izoloohen ata dhe revizionistët modernë nga popujt, aq më i rëndë do të bëhet edhe dëmi kundër tyre. Është fakt i pamohueshëm se politika e agresionit kundër Republikës Demokratike të Vietnamit mund të ketë frikësuar revizionistët, por jo popujt. Përkundrazi, sulmet barbare, krimet çnjerëzore, bombardimet me fosfor e napalm kanë bërë që zemërimi i popujve të shndërrohet në një orteq të papërmbajtshëm urrejtjeje kundër agresorëve amerikanë, kanë influencuar në forcimin dhe në zgjerimin e frontit antiimperialist botëror.

Këtë front mundohet ta përçajë e ta dobësojë edhe Titoja, i cili vrapon t'i vijë në ndihmë dhe t'i shtrojë «qilimin e kuq» padronit të tij — imperializmit amerikan, me qëllim që të ulët këmbëkryq në Vietnam. Titoja, në ujdi të plotë me revizionistët, është bërë propagandisti më i flaktë i kursit amerikan të «bisedimeve pa kushte». Klika e Titos luan në këtë mes një rol shumë të poshtër e të rrezikshëm prej provokatori e përçarësi të veshur me maskën jezuite të paqedashësit e mode-ruesit. Por duke përçafuar tezën e «bisedimeve pa kushte», ai, megjithëse në rastin konkret e zhvillon vep-rintarinë në një sferë tjetër, me mjete e me parulla të tjera e mjaft të rafinuara, u vjen hapur në ndihmë agresorëve amerikanë. Kjo është një lojë e vjetër e Titos dhe një kurth i njohur i tij, në të cilin kërkon të tërheqë sa më shumë njerëz e vende, duke pasur me vete akreditimin e Uashingtonit. Shtypi dhe radioja e Titos, emisarët e tij, që kohët e fundit janë shpërnda-

rë në të katër anët e botës, nuk lodhen së vepruari në këtë drejtim. Por çfarë reklamoni në fakt Titoja? Të njëjtën gjë që kërkon, në fund të fundit, edhe Xhonsoni: «bisedime pa kushte»; konkretisht, ai kërkon që trupat amerikanë të pushtimit të mbeten përjetë në Vietnamin e Jugut. Rruga e Titos është ajo e Xhonsanit: rruga e paqes së gënjeshtërt dhe e luftës së vërtetë agresive.

Por le t'u referohemi fakteve të njohura historike nga ngjarjet e së kaluarës së afërt. Mos vallë populli egjiptian pranoi të bisedojë me agresorët anglo-franko-izraelitë duke duruar trupat e pushtimit brenda në tokën e atdheut të vet? Ç'do të kishte ndodhur po të ishte pranuar një gjë e tillë? Jo, populli egjiptian ua tregoi armiqve të tij rrugën: «Jashtë agresorët! — tha ai. — Me agresorët s'ka marrëveshje!». Mos vallë populli kuban pranoi të bisedojë me agresorët amerikanë kur Kenedi urdhëroi bllokadën e ishullit dhe kërkoi të dërgoheshin atje komisione inspektimi e kontrolli? Jo, populli kuban u tregoi rrugën dhe vendin agresorëve. Ai nuk u përkul, nuk u thye, megjithëse u gjendën mjaft këshilltarë asokohe që i bënë presione për «moderim» e «lëshime», ndër ta edhe Titoja, megjithëse N. Hrushovi pranoi «bisedimet» dhe kapitullimin e tij të turpshëm e diskreditues përpara Kenedit. Kolonialistët francezë u detyruan, më në fund, ta njohin Frontin Nacionalçlirimtar Algjerian, të hyjnë në bisedime me të dhe të shporren nga Algjeria, sepse populli heroik algjerian nuk e pushoi për asnjë minutë luftën e tij dhe nuk u mashtrua as nga pushtuesit, as nga këshilltarët e rremë.

Zgjidhje kapitulluese — ja çfarë rekomandon, pra,

Titoja, zgjidhje që do të ishte fatale për popullin vietnamez dhe shumë e dobishme për agresorët amerikanë. Dhe këtë zgjidhje Titoja dhe emisarët e tij e zbukurojnë — o ironi! — me etiketën e «preokupimit për paqen dhe stabilitetin» në Azi e në botë!...

Në këto çaste vendimtare, kur imperializmi agresiv amerikan e ndien veten të çoroditur e të izoluar, kur ai gjendet në prag të disfatës së pashmangshme, është detyrë e shenjtë e partive komuniste dhe e komunistëve në të gjitha anët e botës, të cilët janë në pozita revolucionare, është detyrë e klasës punëtore ndërkombëtare, e popujve të vendeve socialiste dhe e popujve paqedashës e liridashës të të gjitha kontinenteve që, me aksione konkrete masive e të fuqishme, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, të ngrihen në këmbë dhe të bllokojnë imperializmin amerikan, të bëjnë që ai të mos guxojë ta shtrijë agresionin në Vietnamin e Veriut dhe në të gjithë Azinë Juglindore, të mos guxojë të ndërmarrë agresione të reja. Duhet mobilizuar i gjithë opinioni publik botëror, duke krijuar një atmosferë politike të tillë të rëndë kundër agresionit, në mënyrë që të frenohet imperializmi amerikan. Të demaskohen me forcë dhe me të gjitha mjetet veprimet luftënxitëse të imperialistëve amerikanë dhe çdo veprim çmobilizues nga ana e revizionistëve, çdo veprim që ndihmon armikun e paqes e të popujve — agresorët imperialistë.

Blokimi i plotë e i gjithanshëm i imperializmit amerikan, frenimi energjik dhe i vendosur i veprimeve të tij agresive, është garanci dhe kusht për sigurimin e popujve e të paqes. Kjo bëhet e domosdoshme sidomos

tani, në kushtet kur imperialistët amerikanë kanë shpërthyer agresionin e tyre të shfrenuar në Azinë Juglindore, kur ata po bëjnë luftë kundër një shteti socialist, po sulmojnë kështu kampin socialist, po rrezikojnë paqen në të gjithë botën.

Në rrethana të tilla, kur agresioni imperialist është tanimë fakt i kryer, ç'vlerë kanë marrëveshjet e shumta që revizionistët hrushovianë me aq zell e pompozitet kanë përfunduar me imperialistët amerikanë dhe ç'kuptim kanë bisedimet sovjeto-amerikane për marrëveshje të reja? Ç'vlerë kanë traktati famëkeq i Moskës dhe një varg marrëveshjesh të tjera, pjella shtatanike të «bashkëzistencës» hrushoviane, në një kohë kur agresorët e Uashingtonit, me arrogancën e gangsterit, i kanë çjerrë dhe kanë pështyrë solemnisht mbi to? Në një kohë kur Xhonsoni sulmon një vend socialist, përse revizionistët hrushovianë vazhdojnë jo vetëm të përulen e të përgjërohen për to, por edhe të kërkojnë marrëveshje të tjera me armiqtë e socializmit? Në rast se kjo nuk është tradhti, atëherë çfarë është? «Elasticitet» hrushovian?!

Sot është krijuar një vijë demarkacioni e qartë që ndan forcat antiimperialiste botërore nga agjentura ideologjike e borgjezisë ndërkombëtare, nga revizionistët hrushovianë. Kjo agjunkturë, për të fituar pasaportën e besimit politik të diskredituar, përpiket më kot të mbulohet me xhyben e «antiimperializmit» dhe të «unitetit». Por revolucionarët e dinë se edhe në frontin antiimperialist botëror, edhe në luftën kundër agresionit imperialist amerikan në Vietnam, nuk ka dhe nuk mund të ketë bashkëpunim me përkrahësit dhe aleatët e imperializmit, me revizionistët modernë, me ata që pra-

nojnë «bisedime pa kushte», me ata që kërkojnë të përligjin agresionin dhe të përjetësojnë pushtimin imperialist.

Sot ka vetëm një rrugë të drejtë për zgjidhjen e çështjes së Vietnamit të Jugut, dhe kjo është: Të shporret edhe ushtari i fundit amerikan nga Vietnam i Jugut, t'u jepet fund sulmeve kundër Vietnamit të Veriut, të respektohen marrëveshjet ndërkombëtare mbi Vietnamin! Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, ashtu si të gjithë popujt, partitë komuniste marksiste-leniniste dhe qeveritë që qëndrojnë me vendosmëri në pozita antiimperialiste, përkrahin njëzëri qëndrimin e vendosur të popullit të Vietnamit, të shprehur nga presidenti Ho Shi Min: «Të mbrojmë me vendosmëri pavarësinë, sovranitetin, unitetin dhe tërësinë tokësore të Vietnamit. Vietnam i është një vend i vetëm, kombi vietnamez është një dhe i pandarë. Ne nuk do të lejojmë asnjëri të cenojë këtë të drejtë të shenjtë të popullit tonë. Imperializmi amerikan duhet të respektojë marrëveshjet e Gjenevës, duhet të shporret nga Vietnam i Jugut, duhet t'u japë fund pa vonesë sulmeve kundër pjesës veriore të Vietnamit».

Populli shqiptar është me mish e me shpirt pranë popullit vëlla vietnamez dhe solidar me të. Ai përkrah katër kushtet që paraqiti kryeministri Fam Van Dong për zgjidhjen e çështjes së Vietnamit të Jugut. Populli shqiptar e quan agresionin kriminal imperialist kundër RD të Vietnamit si agresion edhe kundër atdheut të tij socialist, si atentat serioz kundër sigurimit të mbarëkëmbit socialist dhe popujve të tjerë liridashës. Prandaj ai thërret që të rritet e të forcohet solidariteti luftarak

ndërkombëtar i popujve të botës për ta ndihmuar e për ta mbrojtur me të gjitha mjetet dhe në të gjitha rrugët popullin vëlla vietnamez, për t'i dhënë fund agresionit imperialist amerikan, për ta detyruar atë që të respektojë të drejtën e popujve për liri, vetëvendosje e paqe.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 94 (5190), 20 prill 1965

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 270. Tiranë, 1965

KUFITARËT TRIMA JANË KURDOHERË NË MBROJTJE TË ATDHEUT TONË SOCIALIST

Përshëndetje drejtuar forcave të kufirit

25 prill 1965

Të dashur shokë kufitarë,

Me rastin e festës suaj jubilarë, 20-vjetorit të themelimit të forcave të kufirit, jam i lumtur t'ju dërgoj në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të gjithë komunistëve dhe popullit tonë, si dhe në emrin tim personal, përshëndetjet më të zjarrta. Arma e lavdishme e Kufirit, roje vigjilente e tërësisë tokësore të Republikës sonë Popullore, është pjesë e pandarë e forcave tona të armatosura, së cilës i përket nderi i madh të qëndrojë ditë e natë syptrembur në mbrojtje të kufijve të shtrenjtë të atdheut tonë socialist. Këtë detyrë kaq të shenjtë dhe fisnike që ju është ngarkuar e keni kryer dhe po e kryeni me nder e vetëmohim, duke justifikuar plotësisht besimin e madh që ushqejnë te ju Partia dhe populli. Prandaj festën tuaj të shënuar, së bashku me ju, e gëzojnë i gjithë populli dhe forcat e tij të armatosura.

Qysh nga krijimi i tyre, 20 vjet më parë e gjer më sot, duke qenë plotësisht të ndërgjegjshme për misionin e tyre të lartë, ruajtjen e paprekur të kufijve dhe garantimin e punës paqësore të popullit tonë, që ndërton me sukses socializmin, forcat e kufirit, pa marrë parasysh vështirësi e sakrifica të panumërta, i kanë kryer kurdoherë me nder e lavdi detyrat që u ka ngarkuar Partia. Në saje të besnikërisë së pakufishme ndaj popullit, Partisë e atdheut, vigjilencës së lartë, zgjuarsisë, guximit, trimërisë dhe heroizmit të kufitarëve tanë, të përkrahur me të gjitha forcat nga populli ynë patriot e liridashës, janë kapur të gjallë ose janë shfarosur sa e sa agjentë, spiunë e diversantë të dërguar nga armiqtë e jashtëm për të penguar e për të dobësuar punën paqësore të popullit tonë, janë prapsur me sukses dhe kanë dështuar provokacionet e shumta të kurdisura nga imperialistët e revizionistët që e kanë halë në sy Republikën Popullore të Shqipërisë.

Është për këtë arsye që populli dhe Partia jonë ushqejnë një dashuri të thellë për bijtë trima kufitarë, të cilët kanë dhënë edhe gjakun e tyre të kulluar për t'i bërë të pakapërcyeshëm kufijtë e atdheut. I gjithë populli ynë, në fshat dhe në qytet, në ara, në fabrika, në shkolla e kudo punon i qetë, se e di që kufijtë e shejntë të atdheut janë në duar të sigurta.

Të edukuar nga Partia, me ndjenjat e larta të patriotizmit socialist dhe të internacionalizmit proletar, ju ushqeni një dashuri të pakufishme për atdheun tonë dhe çështjen e madhe të socializmit. Prandaj, duke bërë roje ditë e natë në kufi, ju mbroni me vendosmëri e me heroizëm fitoret historike të Luftës Nacionalçlirim-

tare, pushtetin tuaj popullor, sukseset e korrura gjatë këtyre 20 vjetëve të ndërtimit të socializmit, kur Shqipëria, e udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme që ndjek me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit, është kthyer nga një vend i prapambetur në një vend të përparuar socialist. Duke bërë roje natë e ditë në skajet më të largëta të atdheut, juve ju kujtohen nëna që ju dha gji dhe ju rriti, babai, motrat e vëllezërit, njerëzit tuaj më të dashur, fshati apo qyteti i lindjes, përfytyroni gjithë Shqipërinë, ku zien vrulli i jetës së re socialiste, prandaj forcat e vendosmëria ju qindfishohen, syri e mendja ju bëhen më të mprehtë, sepse e ndieni thellë në zemrat tuaja të çelikta detyrën aq të lartë, delikate e me shumë përgjegjësi që keni mbi supe.

Në gjendjen aktuale ndërkombëtare, kur imperia-listët, dhe në radhë të parë ata amerikanë, të përkrahur edhe nga shërbëtorët e tyre, tradhtarët e çështjes së madhe të socializmit, revizionistët hrushovianë titistë etj., po luajnë me fatet e popujve, si të gjitha forcave tona të armatosura, ashtu edhe juve, shokë kufitarë, ju vihet detyra që paskëtaj të shtoni përpjekjet për edukimin tuaj të vazhdueshëm ideopolitik, të forconi më tej vigjilencën dhe disiplinën, të rritni aftësitë tuaja tekniko-ushtarake, t'i çelikosni edhe më shumë lidhjet me masat e popullsisë kufitare, në mënyrë që ta bëni brezin kufitar të pakapërcyeshëm nga cilido armik që do të orvatej ta prekte sadopak atë.

Partia dhe populli ynë kanë besim të plotë në patriotizmin tuaj të lartë, shokë kufitarë, se, duke ndjekur traditat luftarake revolucionare të të parëve tanë dhe të paraardhësve tuaj që bënë Luftën heroike Nacional-

çlirimtare, edhe në të ardhmen do të punoni e do të luftoni për të vënë në jetë mësimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, për ta rritur më tej lavdinë e forcave të lavdishme të kufirit, për t'i bërë si kurdoherë të pakapërcyeshëm nga çdo armik kufijtë e shenjtë të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Duke përfituar nga festa juaj e gëzueshme, ju uroj, të dashur shokë kufitarë, suksese gjithnjë më të mëdha në ruajtjen dhe në mbrojtjen e kufijve të atdheut, Republikës Popullore të Shqipërisë, kësaj kështjelle të pamposhtur të socializmit dhe të paqes!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 99 (5195), 25 prill 1965

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

REVIZIONISTËT MODERNË — LIKUIDATORËT MË TË MËDHENJ NË HISTORINË E LËVIZJES KOMUNISTE NDËRKOMBËTARE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

25-26 prill 1965

Partia e Punës e Shqipërisë, bashkë me partitë e tjera motra marksiste-leniniste, më se një herë ka tërhequr vëmendjen lidhur me orvatjet e revizionistëve modernë për degjenerimin socialdemokrat të partive komuniste dhe ka theksuar se kjo shpie në mënyrë të pashmangshme, shpejt ose vonë, edhe në likuidimin organizativ të tyre, në shkrirjen e tyre të plotë me partitë socialdemokrate.

Çdo ditë që kalon po vërteton me fakte të reja se paralajmërimi i partive motra marksiste-leniniste është plotësisht i drejtë e i justifikuar. Sot çdo njeri që nuk i mbyll me qëllim sytë, nuk mund të mos e shohë se këto orvatje likuidatore të revizionistëve modernë po bëhen çdo ditë më këmbëngulëse, më konkrete e po marrin forma gjithnjë më të hapura. Në mënyrën më të qartë kjo u duk gjatë diskutimit që është hapur qysh

nga nëntori 1964 në faqet e shtypit të PK Italiane lidhur me çështjen e krijimit të së ashtuquajturës «parti të vetme të klasës punëtore». Një diskutim i ngjashëm lidhur me problemin e marrëdhënieve midis komunistëve e socialistëve u organizua edhe nga revista revizioniste ndërkombëtare «Probleme të paqes e të socializmit» në dy numrat e saj të parë të këtij viti. Në të dy këto diskutime ka marrë pjesë edhe udhëheqja e sotme sovjetike, e cila ka botuar në shtypin e saj një sërë materialesh.

Siç është bërë zakon gjatë viteve të fundit, duke filluar qysh nga Kongresi i 20-të i PK të BS, revizionistët toliatistë italianë u treguan edhe këtë herë më të avancuarit për t'i çuar gjërat deri në fundin logjik, dhe, me «sinqeritetin» e tyre, nxorën në shesh ato që revizionistët e tjerë, si ata hrushovianë dhe pasuesit e vijës e të taktikës së tyre, nuk guxojnë t'i thonë aq hapur sheshit, ata zbuluan kështu objektivat dhe qëllimet e vërteta likuidatore të të gjithë revizionistëve modernë.

Këtë radhë bajrakun e rrëmbeu G. Amendola (antar i udhëheqjes dhe i sekretariatit të KQ të PKI), i cili, me sa duket, përfaqëson të djathtën ekstreme në gjirin e udhëheqjes së sotme revizioniste të PK Italiane, në të cilën, sidomos pas vdekjes së P. Toliatit, janë kristalizuar tri rryma: e djathtë, e mesit dhe «e majtë». Të ashtuquajturat «hipoteza» të paraqitura nga Amendola ngjallën një diskutim «të zjarrtë» midis revizionistëve: pati midis tyre që e përkrahën atë plotësisht, por pati edhe të tjerë që gjoja e kundërshtuan, idetë e propozimet e Amendolës i quajtën «të nxituara» dhe mbajtën

ndaj tyre një qëndrim «kritik» (për shembull L. Longo, R. Leda e të tjerë). Me këta të fundit u bashkua edhe udhëheqja e sotme sovjetike.

Diskutimi në fjalë dëshmon të paktën për dy gjëra kryesore:

Nga njëra anë, ai tregon se revizionistët modernë të të gjitha vendeve, ngjyrave e nuancave kanë një rrugë strategjike të përbashkët — rrugën e likuidimit të partive revolucionare të klasës punëtore, të shndërrimit të tyre nga parti të revolucionit social në parti të reformave sociale, në «parti punëtore borgjeze», rrugën e bashkimit e të shkrirjes së tyre me partitë socialdemokrate edhe nga pikëpamja organizative.

Por, nga ana tjetër, diskutimi tregoi se midis grupeve revizioniste ekzistojnë divergjenca taktike për sa u përket ritmeve, formave e metodave që duhen adoptuar në këtë rrugë tradhtare të përbashkët për arritjen e qëllimeve likuidatore të revizionistëve.

Çështja që po diskutohet ka rëndësi jetike për tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Marksistë-leninistët, për të cilët është e shtrenjtë çështja e revolucionit dhe e socializmit, nuk mund të qëndrojnë duarkryq e spektatorë të paanshëm para orvatjeve të revizionistëve modernë për të shkallmuar e për t'i likuiduar përfundimisht partitë komuniste e punëtore, për të çarmatosur e për ta çorganizuar klasën punëtore, për ta lënë atë pa një shtab drejtues revolucionar përballë borgjezisë së organizuar e të armatosur deri në dhëmbë. Lufta e marksistë-leninistëve për demaskimin e veprimeve tradhtare të revizionistëve, për t'u shkaktuar disfatë objektive të tyre likuidatorë, për t'i ruajtur partitë

komuniste e punëtore nga degjenerimi e kalbëzimi socialdemokrat, merr sot një rëndësi të veçantë. Është e domosdoshme të demaskohet para komunistëve e punonjësve dhe të shpartallohet jo vetëm likuidatorizmi i hapët, ekstremist, brutal i Amendolës me shokë, por edhe manovra më dinake, më e maskuar, më e hollë e më e rrezikshme e atyre që, sa për formë ose për arsye taktike, kundërshtojnë gjoja Amendolën, por që në fakt, në thelb, qëndrojnë në të njëjtat pozita likuidatore me të dhe predikojnë të njëjtën vijë tradhtare.

I

Pikëpamjet e veta mbi «partinë e vetme» G. Amendola i ka shprehur në një sërë artikujsh, të botuar në revistën «Rinashita» në muajt nëntor-dhjetor 1964, si domos në artikullin e 28 nëntorit 1964, me titull «Hipoteza për riunifikimin».

Pozita e Amendolës mund të përmbliidhet shkurt në këtë mënyrë: a) ai dënon pa kushte përçarjen midis komunistëve e socialistëve në gjirin e lëvizjes punëtore dhe propozon krijimin e një «partie të vetme të klasës punëtore», duke e konsideruar këtë si një gjë shumë aktuale e të ngutshme; b) krijimin e «partisë së vetme» ai e konsideron si krejt të domosdoshme për të përpunuar e për të vënë në jetë një «rrugë të re, italiane, drejt socializmit», sepse gjatë 50 vjetëve të fundit në Itali, si dhe në të gjitha vendet kapitaliste të zhvilluara, as vija socialdemokrate dhe as ajo komuniste nuk kanë çuar në fitoren e socializmit; c) «partia e vetme» që

propozohet nuk do të jetë as komuniste e as socialdemokrate, por një parti krejt e re, pa «pengesa ideologjike», e hapur për komunistët, socialistët e demokratët e ndryshëm, ajo nuk do të jetë një «parti e ngushtë kuadrosh», por një «parti e gjerë masash».

Le të ndalemi rreth këtyre çështjeve.

G. Amendola dënon ndarjen me renegatët e marksizmit e të komunizmit dhe predikon bashkimin e shkrirjen me ta

Për të argumentuar tezën e tij mbi domosdoshmërinë e arritjes së unitetit midis socialistëve e komunistëve dhe të krijimit të së ashtuquajturës «parti të vetme të klasës punëtore», G. Amendola bën një ekskurSION në histori dhe radhit me ngjyra dramatike «të këqijat e mëdha» të përçarjes midis komunistëve e socialdemokratëve. «Sot, pas 50 vjetësh, shkruan ai në artikullin «Socializmi në Perëndim», mund të vlerësojmë pasojat e falimentimit të Internacionales së Dytë: përçarja që lindi si pasojë e luftës dhe që u thellua nga Revolucioni i Tetorit, prishja midis socialdemokracisë dhe komunistëve, falimentimi i socialdemokracisë, që kurrë nuk shkoi më larg se administrimi i punëve të borgjezisë... dhe paaftësia e komunistëve për të realizuar unitetin e klasës punëtore nën udhëheqjen e tyre. Kjo gjendje i shkaktoi Perëndimit 50 vjet eksperimente të dhimbshme, i dha fashizmit, luftërat, lëvizja e çlirimit nga kolonializmi mbeti pa ndihma, lëvizja punëtore në Perëndim bëri hapa prapa, në kundërshtim

me përparimin që ndodhi në botën e socializmit dhe të lëvizjes nacionalçlirimtare... Ndarja në lëvizjen punëtore të vendeve kapitaliste nuk i dha mundësi kësaj të jepte një kontribut original në luftën botërore për socializmin, një kontribut që të vërtetonte me fakte raportin e domosdoshëm midis socializmit dhe lirisë, që të shfrytëzonte thesarin e lavdishëm të grumbulluar në betejat e mëdha demokratike të viteve 800 e 900, si dhe trashëgiminë kulturore të rrymave të mëdha të mendimit modern».

Pra, Amendola, me gjithë pretendimet e tij të mëdha për «meditacione e studime të thella», për «shikim kritik e qëndrim krijues», largohet nga parimi më elementar i dialektikës, që kërkon studim konkret të çdo situatë konkrete, kalon në heshtje se për ç'arsye e në ç'rrethana ndodhi përçarja, kush ishin shkaktarët e saj dhe a mund të evitohet ajo, e dënon përçarjen *a priori* si diçka të keqe dhe, pa bërë asnjë dallim, predikon nevojën e unitetit me çdo kusht e me çdo çmim. Një trajtim i tillë abstrakt i problemit prej Amendolës është bërë për të falsifikuar historinë dhe për ta vënë atë në shërbim të tezave të tij likuidatore të sotme.

Natyrisht, çështja e unitetit të klasës punëtore është një çështje e madhe e me rëndësi jetike për zhvillimin e lëvizjes së saj revolucionare. Por në çështjen e unitetit e të përçarjes duhet mbajtur kurdoherë një qëndrim dialektik: në çdo rast konkret duhen zbuluar shkaqet dhe shkaktarët e përçarjes, në çdo rast konkret duhet parë nëse bashkimi apo ndarja i shërben çështjes së proletariatit e të socializmit. Sepse jo kurdoherë, me këdo e në çfarëdo kushtesh, bashkimi është i dobishëm e

i pranueshëm për marksistë-leninistët revolucionarë, po ashtu si jo kurdoherë ndarja i shërben çështjes së klasës punëtore.

Dihet botërisht se shkakut i përçarjes ishte tradhtia e Internacionales së Dytë, e cila, në periudhën e Luftës së Parë Imperialiste, shkau në pozitat e socialshovinizmit, u bashkua me borgjezinë dhe u vu në shërbim të qëllimeve të saj imperialiste, ndërsa pas triumfit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit kaloi haptazi në pozita antikomuniste dhe u bë armike e tërbuar e Bashkimit Sovjetik.

Të këqijat e fatkeqësitë që ka pësuar Perëndimi gjatë 50 vjetëve të fundit, për të cilat flet me aq «pasion» G. Amendola, i kanë ardhur atij pikërisht nga kjo tradhti e socialdemokracisë. Por Amendola e lë krejt pas dore këtë fakt të pamohueshëm dhe, në vend që të dënojë tradhtinë e tradhtarit, dënon vetëm përçarjen si të tillë. Për të gjitha të këqijat e fatkeqësitë ai bën fajtor vetëm përçarjen në përgjithësi, prishjen midis socialdemokracisë dhe komunistëve dhe lë të paprekur shkaktarët e vërtetë të përçarjes — tradhtinë e socialdemokracisë. Kjo është njëlloj si të dënosh luftën pa dallim si diçka të keqe e të tmerrshme, që u sjell popujve vuajtje, shkatërrime e viktima të mëdha dhe të lësh krejt pas dore, të mos demaskosh e të mos dënosh shkakun dhe shkaktarët e vërtetë të saj — imperializmin dhe imperialistët.

Nga ana tjetër, paraqitja me ngjyrat më tragjike të historisë së lëvizjes punëtore të Evropës Perëndimore, siç bën Amendola, është një orvatje për ta denigruar e për ta diskredituar këtë lëvizje, për të mohuar sukseset

dhe fitoret e saj të mëdha. Me gjithë përçarjen që u bë e pashmangshme për shkak të tradhtisë së socialdemokracisë dhe në luftë me përçarjen e përçarësit, u rrit e u zhvillua lëvizja revolucionare punëtore, u formuan e u kalitën partitë komuniste marksiste-leniniste, u arrit e u forcua një unitet i ri mbi një bazë të re, që çoi në fitore të reja të marksizëm-leninizmit e të socializmit. Në kundërshtim me shpifjet e sulmet e G. Amendolës, lëvizja komuniste e punëtore evropiane ka shkruar faqe të lavdishme në historinë e saj revolucionare dhe ka dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e procesit revolucionar botëror.

Duke mallkuar e dënuar vetëm përçarjen dhe të gjitha të këqijat e saj dhe duke marrë në mbrojtje tradhtarët e përçarësit, Amendola ngrihet në fakt kundër komunistëve që ndoqën vijën e ndarjes me përçarësit dhe të luftës kundër përçarjes. Ai e dënon këtë vijë si një vijë fatale, që solli gjithë ato të këqija e fatkeqësi për Perëndimin. Por ç'do të kishte ngjarë sikur komunistët të kishin ndjekur atëherë këshillat e sotme të Amendolës — vijën e unitetit me tradhtarët e përçarësit? Rezultati i vetëm i një vije të tillë do të ishte likuidimi i plotë i lëvizjes punëtore e komuniste revolucionare dhe sundimi absolut i socialdemokracisë tradhtare në lëvizjen punëtore.

Dihet se pikërisht një politikë të tillë të unitetit me oportunistët, socialshovinizistët e renegatët e ndryshëm ndiqte në atë kohë K. Kautski. Dhe cili qe rezultati i pozitës së tij centriste? Rezultati i pashmangshëm ishte që vetë K. Kautski shkau në pozitë e oportunitizmit, u bashkua plotësisht me socialshovinizistët dhe u bë një ar-

mik i tërbuar i pushtetit sovjetik e i socializmit, duke fituar famën e palavdishme të renegatit e të tradhtarit.

«Nga se vdiq socialdemokracia e vjetër si parti revolucionare? — ka shkruar J. V. Stalini. — Midis së tjerash, edhe ngaqë Kautski e K° përdornin taktikën «e hollë» të mbrojtjes dhe të shpëtimit të të djathtëve, taktikën «delikate» të «unitetit dhe të paqes» me Ed. Bernshtajnin e K°. Po ç'doli nga kjo si rezultat? Si rezultat doli që, në çastin kritik para se të shpërthente lufta, socialdemokratët e djathtë tradhtuan punëtorët, «ortodoksët» u shndërruan në robër të të djathtëve, kurse socialdemokracia në tërësi u bë një «kufomë e gjallë»¹.

Marksistët revolucionarë, me V.I. Leninin në krye, në kundërshtim të plotë e në luftë me pozitën pajtuese, centriste të Kautskit me shokë, ndoqën me konsekuencën më të madhe rrugën e demaskimit e të luftës së pamëshirshme e pa pajtim kundër oportunistëve, rrugën e ndarjes së qartë e të prerë me ta, si kusht i domosdoshëm për të çuar përpara me sukses veprën revolucionare të proletariatit.

«Në kohën e sotme nuk mund të plotësohen detyrat e socializmit — shkruante aso kohe Lenini — nuk mund të arrihet uniteti i vërtetë ndërkombëtar i punëtorëve pa u shkëputur në

1 J. V. Stalini. Veprat, vëll. 7, f. 65-66.

mënyrë të vendosur nga oportunisti dhe pa i sqaruar masat për fiaskon e pashmangshme që ai do të pësojë»¹.

Lenini shkruante gjithashtu:

«T'u shpjegojmë masave nevojën e domosdoshme dhe të pashmangshme të shkëputjes nga oportunisti, t'i edukojmë ato për revolucionin me një luftë të pamëshirshme kundër tij, të kemi parasysh eksperiencën e luftës për të nxjerrë në shesh gjithë poshtërsinë e politikës nacional-liberale punëtore dhe jo për ta fshehur atë — ja e vetmja vijë marksiste në lëvizjen punëtore të botës»².

Për më tepër, V.I. Lenini ka zhvilluar një luftë të pamëshirshme për të demaskuar e për të shpartalluar jo vetëm oportunistët e hapët, por edhe ata që predikonin pajtimin me oportunistët (Kautskin dhe të gjithë ata që ndiqnin një politikë centriste), duke e konsideruar këtë si shumë të rrezikshme për çështjen e klasës punëtore.

«Sofistika e tij është aq më shumë e rrezikshme dhe e ulët (domethënë e Kautskit — red.), sepse maskohet me frazat më të rrjedhshme dhe të stërholluara të poshtërsisë së oportunistë-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 19.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 140.

ve... — ka shkruar lidhur me këtë Lenini. Oportunistët janë një e keqe që duket sheshit. «Qendra» gjermane me Kautskin në krye është një e keqe e maskuar, e zbukuruar në mënyrë diplomatike, që u hedh pluhur syve punëtorëve, u merr mendtë dhe ndërgjegjen, është më e rrezikshmja nga të gjitha. Detyra jonë tani është lufta pa kushte dhe e hapur kundër oportunitizmit ndërkombëtar dhe atyre që e mbrojnë atë (Kautski)»¹.

Duke iu përgjigjur atyre që i kërkonin të pushonte luftën kundër oportunistëve e centristëve për hir të «unitetit» të socialdemokracisë, Lenini shkruante:

«. . .lufta kundër Kautskit dhe përfaqësuesve të tjerë të «qendrës» është për mua detyrë socialiste»².

Në «Kushtet e pranimit në Internacionalen Komuniste», të përpiluara prej tij, Lenini theksonte me forcë

«Asnjë komunist nuk duhet t'i harrojë mësimet e Republikës Sovjetike Hungareze. Bashkimi i komunistëve hungarezë me reformistët i kushtoi shtrenjt proletariatit hungarez»³.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 35, f. 149.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 242.

3 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 225.

Të tilla janë faktet historike, të cilat tregojnë se për shkak të tradhtisë së Internacionales së Dytë, përçarja në lëvizjen punëtore u bë e pashmangshme dhe e domosdoshme. Pa ndarjen e qartë e të prerë me oportunistët, pa luftën e pamëshirshme kundër tyre, nuk do të mund të bëhej fjalë as për triumfin e Revolucionit të Tetorit dhe as për fitoret e mëdha të mëvonshme historiko-botërore të socializmit.

Kurse G. Amendola, duke dënuar pa një analizë historike konkrete përçarjen në lëvizjen punëtore, shtrembëron historinë dhe, në fakt, ngrihet kundër vijës së ndjekur nga Lenini dhe Internacionalja e Tretë për domosdoshmërinë e ndarjes me oportunistët e renegatët e marksizmit e të socializmit; ai në fakt mbron në mënyrë të heshtur pozitën tradhtarë centriste të Kautskit. Sipas logjikës së tij revizioniste del se përçarësit paskan qenë Lenini dhe Internacionalja e Tretë, të cilët kanë zhvilluar një luftë të ashpër e këmbëngulëse, për ndarjen nga Internacionalja e Dytë dhe nga oportunistët në çdo vend!

Kjo duket qartë edhe nga mënyra se si e shtron ai problemin në artikullin «Beteja unitare për socializmin» («Rinashita», 12 dhjetor 1964), kur thotë: «...unë jam i mendimit se një punë serioze kërkimi kritik mbi zhvillimet e lëvizjes punëtore gjatë 50 vjetëve të fundit do të vlente për eliminimin e shumë skemave të së kaluarës që sot bëhen pengesë për realizimin e unifikimit politik të klasës punëtore». Për çfarë «skemash të së kaluarës» është fjala? Është e qartë se, të paktën pjesërisht, G. Amendola ka parasysh pikërisht qëndrimin e marksistë-leninistëve revolucionarë, duke filluar që

nga Lenini e këtej, ndaj socialdemokracisë si agjenturë e borgjezisë në lëvizjen punëtore dhe vijën e tyre për ndarjen e qartë të partive komuniste nga ato socialdemokrate dhe për demaskimin e këtyre të fundit.

Pra, sipas Amendolës, lufta kundër tradhtisë dhe veprimtarisë përçarëse të socialdemokracisë, e cila degjeneroi në një agjenturë të borgjezisë në lëvizjen punëtore, është një skemë e së kaluarës, nga e cila duhet hequr dorë sa më parë në emër të unitetit e të krijimit të partisë unike të klasës punëtore. Por si është e mundur kjo kur vetë Amendola detyrohet ta pranojë në artikujt e vet se, me falimentimin e Internacionales së Dytë socialdemokracia u largua nga pozitrat e socializmit dhe «nuk shkoi kurrë më larg se administrimi i punëve të borgjezisë», se ajo bile «mori pjesë në shtypjen gjakatare të shumë revolucioneve» etj.? Megjithëkëtë dhe në kundërshtim me logjikën e shëndoshë të fakteve, në kundërshtim edhe me vetveten, G. Amendola i përmbahet pikëpamjes se përçarja e sotme në gjirin e klasës punëtore, midis komunistëve, socialistëve, socialdemokratëve dhe forcave të tjera «përparimtare», është përçarje «midis rrymave të shumta e të ndryshme shoqërore që ecin objektivisht në rrugën e transformimit socialist», është copëtimi i «përfaqësisë politike të klasës punëtore».

Për të justifikuar kursin e tyre të bashkimit e të shkrirjes me socialdemokracinë, revizionistët përpiqen t'u mbushin mendjen njerëzve se gjoja në gjirin e partive socialdemokrate «janë bërë ndryshime të mëdha», se në to janë dukur «tendenca pozitive», se ato kanë

bërë «kthesë nga e majta», se ato janë «parti punëtore» e «luftojnë për socializmin».

Në artikullin e gazetës «Zëri i popullit» të 7 prillit 1964 me titull «Revizionistët modernë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat e të shkrirjes me socialdemokracinë»¹ është argumentuar me fakte të shumta se ata që kanë ndryshuar nuk janë aspak socialdemokratët, por janë «komunistët» e degjeneruar në revizionistë, se nuk është aspak stacioni socialdemokrat që po shkon drejt trenit të revizionistëve modernë, siç përpiqen të krijojnë iluzione këta të fundit, por përkundrazi, është treni revizionist që po lëviz me shpejtësi drejt stacionit socialdemokrat.

Mjafton të shohim qoftë edhe veprimtarinë politike praktike të socialdemokracisë së sotme për t'u bindur se ajo vazhdon të qëndrojë në të njëjtat pozita antisocialiste e në shërbim të borgjezisë si edhe më parë. J. V. Stalini ka theksuar me shumë të drejtë se

«Socialdemokracia në vendin e diktaturës së proletariatit është një forcë kundërrevolucionare, që përpiqet për rivendosjen e kapitalizmit dhe likuidimin e diktaturës së proletariatit në emër të «demokracisë» borgjeze. Në vendet kapitaliste, ku akoma nuk ekziston pushteti i proletariatit, socialdemokracia është ose parti opozitare kundrejt pushtetit të kapitalit, ose parti gjysmëqeveritare, që ndodhet në aleancë me borgjezinë liberale kundër forcave më

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 26, f. 237.

reaksionare të kapitalizmit dhe kundër lëvizjes punëtore revolucionare, ose parti qeveritare deri në fund, që mbron sheshit dhe haptazi kapitalizmin dhe «demokracinë» borgjeze kundër lëvizjes revolucionare të proletariatit.

Ajo bëhet deri në fund kundërrevolucionare dhe karakteri i saj kundërrevolucionar drejtohet kundër pushtetit të proletariatit, vetëm atëherë kur pushteti i proletariatit bëhet realitet»¹.

Por le t'u referohemi fakteve historike, të cilat vërtetojnë plotësisht këtë karakteristikë të saktë të profilit politik të socialdemokracisë që ka dhënë J. Stalini.

Dihet botërisht se, sidomos pas triumfit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, socialdemokracia u hodh në pozita të hapëta antisovjetike e antisocialiste: ajo u bë armike e egër e Bashkimit Sovjetik; në Hungari ajo tradhtoi revolucionin dhe çoi atje në përmbysjen e pushtetit sovjetik; në Gjermani ajo mori pjesë në shtypjen e revolucionit, ndërsa më pas, me politikën e saj oportuniste e tradhtare, spastroi rrugën për ardhjen në fuqi të fashizmit etj., etj. Pas Luftës së Dytë Botërore, pozitat e socialdemokracisë në themel gjithashtu nuk kanë ndryshuar. Dhe ja faktet:

Në shumë vende kapitaliste, si në ato Skandinave, në Angli, Francë, Belgjikë, Austri, Itali, Kanada e gjetkë, socialdemokratët ose laburistët, në mjaft raste, kanë qenë ose janë sot në qeveri, bile në disa vende në krye

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 204-205.

të qeverive. Dhe cili është rezultati? Ç'kanë bërë ato për socializmin? Në fakt, asnjë hap drejt socializmit në këto vende nuk është bërë dhe socialdemokratët në fuqi janë bërë, sipas shprehjes së Leon Blymit, «drejtues luajalë të shoqërisë kapitaliste», me fjalë të tjera, qe-hallarë të borgjezisë, mbrojtës të sundimit të saj, mbrojtës të shfrytëzimit kapitalist mbi masat e gjera punonjëse, shtypës të punëtorëve të vendit të vet dhe të popujve të vendeve të tjera, mbytës të lëvizjes së tyre revolucionare e çlirimtare.

Në Francë ishte pikërisht qeveria «socialiste» e Gi Molesë ajo që nxiti luftën kolonialiste barbare në Indokinë, që intensifikoi luftën kundër popullit algjerian dhe ndërmoi masa të rrepta policore kundër popujve të tjerë që ndodheshin nën sundimin francez, ajo që ndërmoi, bashkë me imperialistët anglezë, agresionin e armatosur kundër Egjiptit.

Në Belgjikë «socialisti» Pol Anri Spak, ish-sekretar i përgjithshëm i bllokut agresiv imperialist të NATO-s dhe tani nënkryeministër e ministër i Jashtëm i Belgjikës, si shërbëtor i imperializmit, u bë një nga xhelatët e popullit liridashës të Kongos.

Në Gjermaninë Perëndimore kryetar i Partisë Socialiste është Vili Brandi, kryetari famëkeq i bashkisë së Berlinit Perëndimor, një revanshist i tërbuar dhe armik i egër i socializmit, partizan i zjarrtë i armatimit të Bundesverit me armë bërthamore.

Në Angli që prej disa kohësh ndodhet në fuqi qeveria laburiste e Uilsonit, për të cilën G. Amendola ka shprehur shpresën se mund të bëhet baza e formimit të «një të majte demokratike evropiane». Dhe çfa-

rë? Ajo po ndjek, si në politikën e brendshme edhe në të jashtmen, të njëjtën politikë të konservatorëve, bile kohët e fundit përkrahu plotësisht imperializmin amerikan në agresionin e tij barbar kundër RD të Vietnamit.

Vetë në Itali partitë «socialiste» të Nenit e të Saragatit, me të cilat G. Amendola propozon të shkrihet PK Italiane, bëjnë pjesë në të ashtuquajturën «qeveri të qendrës së majtë» dhe, në bllok me demokristianët, ndjekin një politikë reaksionare e antipopullore. Dihet se qeveria e sotme italiane, ku bëjnë pjesë këta «socialistë», u bashkua gjithashtu plotësisht me imperialistët amerikanë në veprimet e tyre agresive kundër RD të Vietnamit, që rrezikojnë paqen botërore.

Nuk ka ndryshuar aspak qëndrimi i socialdemokracisë edhe në fushën ekonomike. Socialdemokratët kanë hequr dorë përfundimisht nga të gjitha parimet e idealet e socializmit, janë shndërruar në mbrojtës të hapët të rendit të shfrytëzimit kapitalist. «Socializmi demokratik» i tyre nuk ka asgjë të përbashkët me socializmin e vërtetë shkencor, ai është mohimi i tij, zëvendësimi i tij me disa reforma liberale-borgjeze që nuk cenojnë aspak bazat e shoqërisë kapitaliste. Socialdemokratët e sotëm kanë braktisur edhe kërkesën më elementare të socializmit — likuidimin e pronës private mbi mjetet e prodhimit. Ata e orientojnë klasën punëtore jo kundër kapitalizmit, por vetëm kundër kapitalizmit «të pakontrolluar». Ata përsëritin hapur ose tërthorazi teoritë borgjeze të modës mbi «kapitalizmin popullor», «të organizuar» e «demokratik». Ata mbrojnë parimin e «iniciativës së lirë private kudo ku ajo

është e mundur» në jetën ekonomike. Dhe ndërsa mohojnë karakterin socialist të transformimeve në vendet socialiste, ata përpiqen të mashtrojnë punëtorët në vendet e tyre duke i paraqitur shtetëzimin e një pjese të ndërmarrjeve nga shteti borgjez, krijimin e kapitalizmit monopolist shtetëror, ndërhyrjen e shtetit kapitalist në jetën ekonomike e të tjera si realizim të socializmit në kushtet e rendit kapitalist. Në të gjitha vendet kapitaliste, socialdemokracia, qoftë kur ka qenë në opozitë, qoftë kur ka qenë në qeveri apo edhe në krye të saj, me gjithë politikën dhe veprimtarinë praktike, jo vetëm nuk i ka dobësuar pozitat ekonomike të borgjezisë, por përkundrazi, i ka forcuar ato.

Pra faktet provojnë se socialdemokracia nuk e ka ndryshuar aspak qëndrimin e saj në çështjet themelore, ajo mbetet një shërbëtoreshë dhe ndihmëse e borgjezisë, një agjenturë e saj në lëvizjen punëtore, se partitë socialdemokrate vetëm formalisht janë përfaqësuese të klasës punëtore, ndërsa në të vërtetë ato janë, sipas shprehjes së Leninit, «parti punëtore borgjeze». Në qoftë se dikush ka ndryshuar qëndrimin e vet në çështjet themelore, ata nuk janë aspak socialdemokratët, por revizionistët modernë, që kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe çështjen e socializmit, që kanë shkarë në pozitat e socialdemokracisë, gjë për të cilën dëshmojnë me qartësinë më të madhe qoftë edhe pikëpamjet e G. Amendolës e të revizionistëve të tjerë.

Ashtu si dikur në kohën e Leninit, edhe sot, në procesin e luftës së klasave midis proletariatit e borgjezisë, lindi një rrymë e re e oportunitizmit ndërkombëtar

— revizionizmi modern dhe, si pasojë e pashmangshme e kësaj, — lufta e marksistë-leninistëve kundër revizionistëve. Është pikërisht tradhtia e revizionistëve modernë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj interesave jetike të proletariatit e të masave punonjëse, ndaj çështjes së socializmit e të komunizmit, janë orvatjet e tyre për të degjeneruar rendin socialist dhe për t'i shndërruar partitë revolucionare të proletariatit në parti reformiste borgjeze, janë pikërisht këto që kanë shkaktuar përçarjen në lëvizjen e sotme komuniste ndërkombëtare. Oportunizmi e revizionizmi sot, ashtu si edhe në të kaluarën, përbëjnë burimin ideologjik të përçarjes në lëvizjen punëtore e komuniste, ndërsa vetë përçarja është shprehja e oportunizmit dhe e revizionizmit në fushën organizative. Prandaj lufta e marksistë-leninistëve kundër revizionistëve modernë është luftë kundër përçarësve. Kjo luftë dhe ndarja e qartë dhe e prerë me revizionistët modernë janë sot absolutisht të domosdoshme dhe kushti numër një për arritjen e unitetit të shëndoshë, marksist-leninist, të lëvizjes komuniste, sepse lufta për mbrojtjen e këtij uniteti është e pandarë nga lufta për mbrojtjen e parimeve revolucionare të marksizëm-leninizmit prej shtrembërimeve revizioniste, sepse vetëm duke pasur një unitet të shëndoshë ideologjik e politik mbi bazën e këtyre parimeve lëvizja punëtore e komuniste ndërkombëtare mund të ketë një unitet veprimesh të organizuar e efektiv kundër kapitalizmit e për triumfin e komunizmit. Çdo «unitet» me renegatët oportunistë e revizionistë përbën një rrezik serioz për çështjen e revolucionit e të socializmit dhe pengon arritjen e unitetit të vërtetë marksist-leninist,

për të cilin ka aq nevojë lëvizja jonë në kohën e sotme. Sot tingëllojnë shumë aktuale fjalët e Leninit të madh, i cili theksonte me forcë:

«Uniteti është një punë e madhe dhe një parullë e madhe! Por çështja punëtore ka nevojë për unitetin e marksistëve, e jo për unitetin e marksistëve me armiqtë dhe shtrembëruesit e marksizmit»¹.

«Rruga italiane drejt socializmit» është një rrugë socialdemokrate për përjetësimin e kapitalizmit

Domosdoshmërinë e krijimit të së ashtuquajturës «parti të vetme të klasës punëtore» G. Amendola e nxjerr nga nevoja për të kërkuar e për të përpunuar një rrugë «krejt të re» për përparimin efektiv drejt socializmit në Itali, e cila të mundë të shërbejë bile si model edhe për vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara. Ja si e shtron çështjen Amendola: «...nevoja e një partie të vetme për klasën punëtore italiane lind nga konstatimi kritik që vijon: asnjëra nga të dyja zgjidhjet që i janë paraqitur klasës punëtore të vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore — as zgjidhja socialdemokrate dhe as zgjidhja komuniste — nuk u tregua deri më sot e aftë të realizojë transformimin socialist të shoqërisë dhe ndryshimin e sistemit. Në rast se nuk nisemi nga një pranim i tillë, njëkohësisht kritik dhe

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 20, f. 256.

autokritik, nuk mund të kuptojmë nevojën për një kthesë rrënjësore, e cila do të zhdukte shkaqet që qysh prej 50 vjetësh nuk e kanë lejuar lëvizjen punëtore të vendeve kapitaliste të përparuara të japë kontributin e saj vendimtar në përparimin e socializmit në botë... Një organizatë politike që nuk arrin objektivat e caktuar gjatë një pesëdhjetëvjeçari, të paktën me tre breza militantësh, duhet të kërkojë arsytet e këtij mospasimi dhe të transformojë vetveten». Dhe më tej: «Këtë kërkim origjinal të një rruge të re drejt socializmit le ta bëjmë së bashku me një parti të re, me një parti të vetme të klasës punëtore italiane — ja, ky është propozimi që ne u bëjmë shokëve socialistë të rrymave dhe organizatave të ndryshme...». (G. Amendola, «Hipoteza mbi riunifikimin», «Rinashita», 28 nëntor 1964).

Për sa i përket konstatimit «tepër të thellë» të G. Amendolës se «zgjidhja socialdemokrate» asgjekundi nuk ka çuar në socializëm, mendojmë se nuk ka nevojë për shumë «kërkime krijuese» e «meditacione», sepse kjo duket sheshit dhe, siç thotë një fjalë e urtë popullore, «fshati që duket s'do kallauz». Por edhe në këtë konstatim Amendola shtrembëron të vërtetën, sepse orvatet të fshehë tradhtinë e socialdemokracisë ndaj çështjes së socializmit, faktin që ajo prej kohësh është shndërruar në një qen roje të klasës së kapitalistëve, dhe e paraqet çështjen sikur socialdemokracia është përpjekur e përpiket sinqerisht për socializmin, por se «zgjidhja e propozuar prej saj» nuk ka qenë në lartësinë e duhur.

Por ajo që ka më tepër rëndësi është se G. Amendola hedh poshtë eksperiencën historike të deritanish-

me të socializmit në Bashkimin Sovjetik, e quan këtë eksperiencë të pavlefshme e të papërshtatshme për Italinë dhe për vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara të Perëndimit. Ai thotë: «Lufta jonë zhvillohet në kushte të tjera historike . . . Pikërisht për këtë arsye nuk këshillojmë si model për luftën tonë eksperiencën sovjetike por kërkojmë me një mijë mundime një rrugë të re për të përparuar drejt socializmit» («Socializmi në Perëndim», «Rinashita», nëntor 1964).

Lindi pyetja: Përse vallë kjo eksperiencë, qenka «e pavlefshme» dhe «e papranueshme» për Italinë? Cilat janë, sipas Amendolës, tiparet themelore që do të karakterizojnë kalimin në socializëm në Itali, në dallim nga rruga e ndjekur në Bashkimin Sovjetik? Amendola paraqet të paktën 6 tipare të tilla themelore, të cilat meritojnë vëmendje:

1. Sipas Amendolës, kjo do të jetë një rrugë «e veçantë», «krejt italiane», e kalimit në socializëm. Ai thotë: «Në rast se partia e vetme e klasës punëtore italiane do të formohet, ajo duhet të jetë partia e rrugës italiane drejt socializmit» («Hipotezat»).

Natyrisht, çdo vend ka veçoritë e tij të kalimit në socializëm, të cilat varen si nga kushtet kombëtare të secilit vend ashtu edhe nga kushtet e epokës historike përkatëse. Marrja parasysh e tyre është krejt e domosdoshme për të përcaktuar një vijë të drejtë, një strategji e taktikë të drejtë në revolucion, sepse nga këto veçori varen format, ritmet e metodat e kalimit të vendeve të ndryshme në socializëm. Ndërsa mosmarrja parasysh e tyre të shpie në dogmatizëm, në shkëputjen

nga realiteti objektiv e nga masat, i sjell dëm çështjes së socializmit.

Por është gjithashtu e domosdoshme të mos harrohet për asnjë moment se ekzistojnë ligje të përgjithshme të revolucionit socialist e të ndërtimit të socializmit që përbëjnë vetë thelbin e këtij procesi dhe që, për pasojë, janë të domosdoshme, të pashmangshme për cilindo vend që kalon në socializëm dhe në çdo kohë. Këto ligje të përgjithshme janë zbuluar nga marksizëm-leninizmi dhe janë vërtetuar në praktikë nga tërë eksperiencia historike e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Ato janë mishëruar sidomos në eksperiencën historike të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste, e cila, për këtë arsye, ka një vlerë të madhe për të gjitha vendet e tjera. Është me vend t'u referohemi këtu fjalëve të njohura të V. I. Leninit

«...se disa tipare kryesore të revolucionit tonë nuk kanë një rëndësi lokale, të veçantë nacionale, vetëm ruse, por një rëndësi ndërkombëtare... modeli rus u tregon gjithë vendeve diçka, bile shumë të rëndësishme, nga e ardhmja e tyre e pashmangshme dhe e afërt»¹,

si dhe fjalët e tij se «bolshevizmi shërben si model taktike për të gjithë».

Mosmarrja parasysh e ligjeve të përgjithshme të kalimit në socializëm dhe injorimi i eksperiencës the-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 5, 6.

melore historike të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera socialiste të shpie në mënyrë të pashmangshme në largimin nga pozitat e marksizëm-leninizmit revolucionar dhe në shkarjen në oportunizmin e revizionizmin më të keq. Dhe pikërisht kjo është pozita e G. Amendolës, i cili injoron ligjet e përgjithshme, vë në plan të parë veçoritë kombëtare dhe i absolutizon ato, ndërsa hedh poshtë si të papërshtatshme e të pavlefshme eksperiencën themelore të Bashkimit Sovjetik. Është e qartë se G. Amendola qëndron plotësisht në pozitën e të ashtuquajturit «komunizëm nacional», që është një variant i teorive borgjeze e antikomuniste të modës.

2. Sipas Amendolës, eksperiencia sovjetike është e pavlefshme, sepse BS ishte vend relativisht i prapambetur, kurse Italia është një vend kapitalist i përparuar. Ai thotë se problemi që shtrohet para tyre (domethënë para PK Italiane dhe partisë socialiste) është «... të ecim drejt socializmit në një vend kapitalist të përparuar, në një vend si yni, me problemet e tij historike, me lëvizjen e tij katolike, me rezistencën e shtresave të vjetra, me trashëgimin e fashizmit etj.». («Hipotezat»).

Lidhur me këtë do të vëmë në dukje disa gjëra:

Së pari, sipas Amendolës, del se paska dy lloj socializmash: një socializëm për vendet e prapambetura, rrugën drejt të cilit e ka treguar marksizëm-leninizmi, dhe një socializëm tjetër për vendet «e përparuara», për të cilin marksizëm-leninizmi deri tani nuk ka treguar ndonjë rrugë, prandaj janë angazhuar «me një mijë mundime» Amendola dhe shokët e tij që ta gjej-

në! Kjo u ngjan shumë predikimeve të njohura të propagandistëve borgjezë se doktrina marksiste pati efekt për disa vende të prapambetura, por ajo dështoi për vendet e zhvilluara!

Së dyti, Amendola shtrembëron në mënyrë trashanike historinë kur bën aluzione se gjoja deri më sot nuk ka ndonjë model të kalimit në socializëm në vendet e zhvilluara kapitaliste. Por dihet nga të gjithë se, për shembull, Çekosllovakia apo RD Gjermane, që ishin vende socialiste, më parë kanë qenë vende kapitaliste të zhvilluara.

Por këtu bie në sy edhe diçka tjetër: Amendola flet vetëm për dy modele të kalimit, ndërsa vendet e tjera socialiste as që i llogarit fare. Me sa duket, ai është i mendimit se vendet e tjera socialiste nuk kanë «rrugë të tyre» të kalimit në socializëm, por ose kanë kopjuar sovjetikët, ose mendon që në këto vende (të paktën në Evropë) revolucioni «është eksportuar» nga Bashkimi Sovjetik në periudhën e Luftës së Dytë Botërore! Nota të tilla antimarksiste e shoviniste në fakt i kemi hasur edhe më parë në shkrimet e P. Toliatit e të revizionistëve të tjerë italianë.

Së treti, për sa u përket thënieve të Amendolës se «zgjdhja komuniste» nuk ka dhënë rezultate në Perëndim, fajin për këtë nuk e ka aspak «zgjdhja komuniste», e cila ka çuar në triumfin e socializmit në një të tretën e botës, por, veç të tjerash e në një shkallë të konsiderueshme, edhe fakti që udhëheqja e PK Italiane, si dhe udhëheqjet e mjaft partive të tjera në Perëndim, prej kohësh janë larguar nga pozitat revolu-

cionare të marksizëm-leninizmit dhe janë zhytur në llumin e oportunizmit, reformizmit e të revizionizmit.

3. Sipas Amendolës, socializmi në Bashkimin Sovjetik ka triumfuar në kushtet e luftës, porse sot një rrugë e tillë është «e papërshtatshme» dhe «e padëshirueshme», për shkak se mund të çojë në një kasaphanë bërthamore shfarosëse, që do të ishte «fundi i gjithçkaje». Ai shkruan: «. . .ne duhet të kërkojmë një rrugë të re, që do të na lejonte të përparonim drejt socializmit në kushtet konkrete të krijuara nga historia jonë dhe në kohën tonë, në kohën e luftës për bashkëkzistencë paqësore; me fjalë të tjera, një rrugë italiane drejt socializmit». («Hipotezat»).

Ç'do të thotë kjo vallë? Ç'kuptim kanë këto fjalë?

Amendola këtu përsërit pak a shumë idenë e Toliatit se kalimi në socializëm deri më sot është bërë nëpërmjet dy krizave të thella botërore — të 1917-s dhe të 1945-s, të lidhura që të dyja me luftën botërore. Faktet e hedhin poshtë këtë konkluzion antimarksist, që është një shpifje kundër revolucionit e socializmit. Lufta nuk është as shkak as kusht i domosdoshëm për fitoren e revolucionit.

Duke përsëritur përsëri Toliatin, Amendola thotë se rruga e fitores së socializmit nëpërmjet luftës është e papërshtatshme dhe e padiskutueshme. Por cili marksist dhe cila parti marksiste-leniniste e ka konsideruar ose e konsideron të përshtatshme e të dëshirueshme fitoren e socializmit me anën e luftës? Kjo është një shpifje e trashë, e huajtur nga propaganda më reaksionare borgjeze. Komunistët i janë përmbajtur e i përmbahen gjithmonë tezës leniniste se revolucioni nuk mund

të eksportohet as me luftë e as me bashkekzistencë paqësore.

Po «rruga drejt socializmit në kushtet e bashkekzistencës paqësore» ç'është? Kjo është një rrugë e tillë që e vë çështjen e revolucionit në vartësi nga bashkekzistenca paqësore, që i mbështet tërë shpresat e socializmit te bashkekzistenca paqësore, që ia nënshtron çdo gjë bashkekzistencës paqësore. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që, për hir të bashkekzistencës paqësore dhe në emër të saj, të hiqet dorë nga revolucionit, nga përmbysja e borgjezisë, nga vendosja e diktaturës së proletarietit, do të thotë ta shtrish bashkekzistencën paqësore edhe në marrëdhëniet midis klasave antagoste brenda vendeve kapitaliste, për të përjetësuar rendin kapitalist.

Dhe gjithë kjo bëhet gjoja për të shpëtuar njerëzimin nga një kasaphanë bërthamore shfarosëse, që do të ishte «fundi i gjithçkaje» në botë. Por sido që të maskohen revizionistët, është e qartë se atyre u ka hyrë frika në palcë, kanë kapitulluar përpara shantazhit atomik të imperializmit, janë bërë vetë propagandistë vullnetarë të këtij shantazhi, kanë shkarë në llumin e pesimizmit e të disfatizmit, kanë humbur çdo besim në të ardhmen, kanë braktisur idealet revolucionare dhe kanë bërë të tyren paqen me çdo kusht e me çdo çmim, «paqen në tokë dhe në qiell».

4. Sipas Amendolës del se modeli sovjetik është i pavlefshëm për Italinë, sepse qenka «jodemokratik», kurse «rruga italiane drejt socializmit» do të jetë një rrugë «me të vërtetë demokratike»! Ai shkruan: «...ne po e kërkojmë me këmbëngulje këtë rrugë, këtë

rrugë italiane e demokratike drejt socializmit». («Socializmi në Perëndim»). Amendola bashkohet plotësisht me protestën e të gjithë atyre që u ngritën kundër mënyrës «antidemokratike» me të cilën u hoq Hrushovi në Bashkimin Sovjetik dhe shpreh «kritikën dhe mosaprovimin» lidhur me vonimin për të kapërcyer kontrastin që ekziston edhe sot e kësaj dite midis zhvillimit të bazës socialiste të sistemit sovjetik dhe zhvillimit të strukturave demokratike që duhet të sigurojnë «respektimin e lirive demokratike e personale» dhe «pjesëmarrjen në fakt të punëtorëve në drejtimin e gjithë jetës shoqërore...». (Po aty).

Amendola i referohet P. Toliatit, veçanërisht «testamentit» të tij të Jaltës, për t'u justifikuar para kritikuesve të tij nga e djathta se ata, domethënë revizionistët italianë, prej kohësh, qysh para rrëzimit të N. Hrushovit, kishin ngritur me forcë çështjen e «demokratizimit» dhe të «liberalizimit» të mëtejshëm e me ritme më të shpejta të sistemit sovjetik, me fjalë të tjera, çështjen e degjenerimit të mëtejshëm e me të shpejtë të rendit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore në një rend liberalo-borgjez. Edhe Amendola, ashtu si P. Toliati e duke iu referuar atij, përpiqet të bindë socialdemokratët, liberalët borgjezë, katolikët dhe aleatët e tjerë të mundshëm në «rrugën italiane drejt socializmit» se diktatura e proletariatit në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera socialiste është një «shtrembërim stalinist» që duhet likuiduar sa më parë dhe që në «Italinë socialiste» nuk do të lejohet nga revizionistët.

Kurse V.I. Lenini pikërisht diktaturën e proleta-

riatit, të cilën revizionistët modernë të tipit të Amendolës me shokë e kanë fshirë nga defteri si një rend të papranueshëm «antidemokratik», e konsideronte si rendin më demokratik që ka njohur shoqëria njerëzore. Ai ka theksuar se

«Demokracia proletare është një milion herë më demokratike se çdo demokraci borgjeze; Pushteti Sovjetik është një milion herë më demokratik se republika më demokratike borgjeze.

Këtë mund të mos e shikonte vetëm ose një shërbëtor i ndërgjegjshëm i borgjezisë, ose një njeri krejt i vdekur politikisht, që nuk e sheh jetën e gjallë duke ndenjur prapa librave borgjezë të mbuluar nga pluhuri, një njeri që është i mbujtur kokë e këmbë me paragjykime demokratike borgjeze dhe i cili bëhet kështu, objektivist, shërbëtor i borgjezisë»¹.

Ja, pra, se me çfarë çmimi — me çmimin e heqjes dorë nga revolucioni, me çmimin e diskreditimit, të degjenerimit e të likuidimit të rendit socialist, të diktaturës së proletariatit, të fitoreve të socializmit, G. Amendola dhe revizionistët e tjerë modernë duan të sigurojnë aleatë për të ashtuquajturën «rrugë italiane drejt socializmit», e cila në të vërtetë është rruga e ruajtjes dhe e përjetësimit të kapitalizmit.

5. Sipas Amendolës del gjithashtu se «rruga italiane» do të jetë rrugë «paqësore», rrugë e përparimit

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 278.

drejt socializmit nëpërmjet realizimit të «reformave të strukturës» që parashikohen në kuadrin e kushtetutës së sotme italiane! Është kuptimplotë që në këtë çështje «komunisti» Amendola është më i djathtë se borgjezi liberal N. Bobio, i cili e karakterizon kushtetutën e sotme italiane si «kushtetutë të demokracisë liberale (dhe jo të demokracisë popullore)». (Shih letrën e Bobios drejtuar Amendolës dhe botuar në «Rinashita», 28 nëntor 1964). Kurse Amendola e kundërshton këtë dhe thotë se kushtetuta e sotme italiane «nuk mund të quhet thjesht, sikundër thotë Bobio, një kushtetutë e «demokracisë liberale». Në fakt, në kushtetutë janë përfshirë kërkesa dhe institucione që gjatë këtyre 20 vjetëve as u respektuan as u zbatuan nga qeveritë e ndryshme të koalicionit të drejtuar nga Partia Demokratike, të cilat tregojnë se çfarë karakteri shoqërisht «përparimtar» duhej të kishte pasur «Republika e themeluar mbi punën». Zhvillimi i elementëve origjinalë të kësaj kushtetute, nxitja, nëpërmjet një mobilizimi të pandërprerë e të përhershëm të masave, e tensionit politik e shoqëror, do të thotë të krijosh kushtet për një transformim demokratik dhe socialist të shoqërisë nëpërmjet zbatimit të reformave të strukturës, të reformave politike dhe ekonomike». («Hipotezat»).

Siç shihet, nga fjalori i G. Amendolës, si dhe i gjithë revizionistëve modernë, janë fshirë tezat themelore të doktrinës marksiste-leniniste mbi kalimin nga kapitalizmi në socializëm: është zhdukur vetë nocioni «revolucion socialist»; është fshirë përmbyesja e borgjezisë dhe vendosja e diktaturës së proletariatit, çështje për të cilën Lenini ka thënë se në të konsiston

«...ndryshimi më i thellë midis marksistit dhe borgjezit të vogël (dhe të madh) të zakonshëm»¹

dhe se

«...kush e mohon ose e pranon atë vetëm me fjalë, nuk mund të jetë anëtar i partisë social-demokrate»².

Është hedhur tej teza e njohur e marksizëm-leninizmit mbi domosdoshmërinë e thyerjes së makinës shtetërore borgjeze si një ndër kushtet vendimtare për kalimin në socializëm, për të cilën Lenini ka thënë se

«Ky përfundim është gjëja kryesore themelore në teorinë e marksizmit mbi shtetin»³.

Për çdo njeri që njeh pak a shumë letërsinë marksiste dhe historinë e lëvizjes punëtore e komuniste gjatë 50 vjetëve të fundit, për «rishikimin kritik» të eksperiencës, për të cilën mburret shumë G. Amendola, është fare e qartë se të ashtuquajturat «kërkime krijuese e origjinale» të tij për një «rrugë të re» drejt socializmit në të vërtetë nuk janë aspak as të reja e as origjinale, por ringjallje e teorive të vjetra e të harruara reformiste të oportunistëve të së kaluarës si ekonomistët e Kautskit, të cilat prej kohësh janë hedhur

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 487.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 75.

3 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 480.

poshtë nga V.I. Lenini. Kjo mund të ilustruhet me shembuj të shumtë. Ja disa prej tyre:

Qysh në vitin 1899 V.I. Lenini shkruante:

«...R.M. «Raboçaja Misl», gazetë e «ekonomistëve» rusë flet vetëm për kalimin e prodhimit në administrimin shoqëror të tyre (të punëtorëve), ose nën administrimin e një pushteti shoqëror të demokratizuar «me anën e pjesëmarrjes aktive të tyre (të punëtorëve) në komisionet për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme të fabrikave dhe uzinave, në gjykatat e arbitrazhit, në mbledhjet, komisionet dhe konsultat e ndryshme për përpunimin e ligjeve punëtore, me anën e pjesëmarrjes së punëtorëve në vetëqeverisjen shoqërore dhe, më në fund, në institucionin përfaqësues të përgjithshëm të vendit». Pra, redaktorët e «Rab. Misl» fusin në socializmin punëtor vetëm një socializëm të tillë, i cili arrihet me rrugën paqësore, duke përfshirë rrugën revolucionare»¹.

Këtë lloj socializmi, ose më saktë këtë lloj «rruge drejt socializmit», që lë në harresë kryesoren, përmbysjen revolucionare të borgjezisë dhe vendosjen e sundimit të proletariatit, rrugë e cila ngjan si dy pika uji me predikimet e revizionistëve të sotëm italianë mbi «demokratizimin» e drejtimit të prodhimit kapitalist me anën e pjesëmarrjes aktive të klasës punëtore në

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 4, f. 314.

të, mbi rritjen e ndikimit të klasës punëtore italiane në të gjitha hallkat shtetërore e të jetës shoqërore në Itali etj., etj. (domethënë mbi «reformat e strukturës»), pikërisht këtë «socializëm» Lenini e ka cilësuar si

«...ngushtim të socializmit dhe shndërrim të tij në një liberalizëm borgjez të zakonshëm...»¹.

Ose le të shohim ç'thotë K. Kautski «...Detyra e grevës së masave — shkruan ai — kurrë nuk mund të jetë që të shkatërrojë pushtetin shtetëror, por vetëm që ta çojë qeverinë të bëjë lëshime në një çështje të caktuar, ose të zëvendësojë një qeveri që është kundër proletariatit me një qeveri që i zgjat dorën... Por kjo «(domethënë fitorja e proletariatit kundër qeverisë kundërshtarë)» nuk mund të çojë kurrë në shkatërrimin e pushtetit shtetëror, por vetëm në njëfarë zhvendosjeje të raportit të forcave brenda pushtetit shtetëror... Pra, qëllimi i luftës sonë politike mbetet, si dhe deri më sot, marrja në dorë e pushtetit shtetëror, duke fituar shumicën në parlament dhe duke e bërë parlamentin zot mbi qeverinë». Po të mos e dinte njeriu që këtë e ka shkruar K. Kautski, me siguri do të mendonte se ka të bëjë me ndonjë citat të P. Toliatit, të G. Amendolës, apo të ndonjë kolegu të tyre revizionist modern, kaq të ngjashme janë pikëpamjet e tyre mbi «kalimin në socializëm» nëpërmjet fitimit të shumicës në parlament, mbi krijimin e një qeverie «të vërtetë demokratike» e «popullore» të «bllokut të majtë» etj. me pikëpamjet e

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 4, f. 314-315.

lartpërmendura të Kautskit. Dhe ja si i ka cilësuar V.I. Lenini këto pikëpamje:

«Ky është oportunistëm nga më të kulluarit dhe më banalët; këtu, praktikisht, hiqet dorë nga revolucioni, megjithëse ai pranohet me fjalë»¹.

Dhe më tej Lenini thotë:

«...ne do të ndahemi nga këta tradhtarë të socializmit dhe do të luftojmë për shkatërrimin e gjithë makinës së vjetër shtetërore, në mënyrë që vetë proletariati i armatosur të bëhet qeveri. Këtu kemi «dy ndryshime të mëdha».

Kautski do të detyrohet të rrijë në shoqërinë e këndshme të Leginëve dhe Davidëve, Plehanovëve, Potresovëve, Ceretelëve, Cernovëve, të cilët janë plotësisht në një mendje të luftojnë për «zhvendosjen e raportit të forcave brenda pushtetit shtetëror» «për të fituar shumicën në parlament dhe për t'i dhënë parlamentit gjithë fuqinë mbi qeverinë» — një qëllim shumë fisnik, ku çdo gjë është e pranueshme për oportunistët, ku çdo gjë mbetet në kuadrin e republikës parlamentare borgjeze.

Kurse ne do të ndahemi nga oportunistët; dhe gjithë proletariati i ndërgjegjshëm do të jetë bashkë me ne në luftën jo për një «zhvendosje të raportit të forcave», por për përmbysjen e borgjezisë, për shkatërrimin e parlamen-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 581.

tarizmit borgjez, për një republikë demokratike të tipit të Komunës, ose për republikën e Sovjetëve të deputetëve punëtorë dhe ushtarë, për diktaturën revolucionare të proletariatit»¹.

Nuk është nevoja të ndalemi më gjatë për të analizuar pikëpamjet krejt oportuniste e reformiste të Amendolës e të gjithë revizionistëve toliatistë lidhur me të ashtuquajturën «rrugë italiane drejt socializmit», gjë që e kemi bërë me hollësi në mjaft materiale tonat të mëparshme, veçanërisht në artikullin «Mbi tezat për kongresin e 10-të të PK Italiane», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 17-18 nëntor 1962. Do të theksojmë vetëm se e ashtuquajtura kritikë që i bën Amendola «zgjidhjes socialdemokrate» s'është gjë tjetër veçse një manovër demagogjike mjaft e trashë. Në të vërtetë, ndërsa kundërshton në thelb edhe «zgjidhjen komuniste», domethënë mësimet themelore të marksizëm-leninizmit mbi çështjen e kalimit nga kapitalizmi në socializëm, G. Amendola propozon në thelb një «zgjidhje» socialdemokrate: në vend të përmbysjes revolucionare të borgjezisë, të shkatërrimit të aparatit shtetëror borgjez e të vendosjes së diktaturës revolucionare të proletariatit, propozon «reformat e strukturës» brenda kuadrin të legalitetit borgjez e të kushtetutës borgjeze, «ndryshimin gradual të raportit të forcave» në parlament e në të gjitha hallkat e shtetit borgjez «në favor të klasës punëtore», përdorimin e shtetit borgjez «për kufizimin e gjithë fuqisë së monopoleve» dhe «për për-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 581-582.

parimin drejt socializmit»; absolutizimin e së ashtuquajturës «rrugë paqësore» të kalimit në socializëm dhe përjashtimin e çfarëdo veprimi të vërtetë revolucionar kundër sundimit të borgjezisë; mohimin pa kushte të diktaturës së proletariatit si një rend «antidemokratik» dhe kalimin në socializëm nëpërmjet formave të «demokracisë» së sotme borgjeze etj., etj.

Ka plotësisht të drejtë N. Bobio, i cili e zbulon hapur e pa dredhira demagogjike thelbin e çështjes: «Vetëkuptohet — i shkruan ai Amendolës — se të kërkojë të bësh politikë, për më tepër politikë qeveritare, në një shtet të udhëhequr nga një kushtetutë e demokracisë liberale (dhe jo të demokracisë popullore), do të thotë të bësh një politikë socialdemokrate. Nuk duhet trembur nga fjalët... Sot në Itali një parti e vetme e lëvizjes punëtore që pranon institucionet në fuqi... dhe, si pasojë, është gati të respektojë parimet e qeverisë parlamentare, themeluar mbi respektimin e lirive civile e politike, nuk mund të bëjë tjetër veçse një politikë që është politikë socialdemokrate. Për këtë nuk arrij të kuptoj përse ke kaq bezdi kur flet në përgjigjen tënde për socialdemokracinë, duke u përpjekur të evitosh edhe dyshimin më të vogël që politika jonë mund të konfondohej me atë socialdemokrate... Lejomë të të them se në kërkesën tuaj për të marrë pjesë në qeverimin e Italisë unë shoh këtë: se tanimë ju keni formuar bindjen që sot në Itali, njëzet vjet pas luftës dhe dhjetë vjet pas luftës së ftohtë, ka mundësi vetëm për atë politikë». (Letra e N. Bobios drejtuar G. Amendolës dhe botuar në «Rinashita», 28 nëntor 1964).

Nga revizionimi i parimeve themelore të marksizëm-leninizmit në braktisjen e plotë të tij dhe në likuidimin e partisë komuniste

Në artikujt e vet G. Amendola prek edhe çështjen e karakterit, të profilit ideopolitik dhe organizativ që duhet, sipas tij, të ketë «partia e vetme e klasës punëtore». Në këtë çështje më hapur se kudo shfaqet vija tradhtarë likuidatore e Amendolës dhe e përkrahësve të tij. Por le të shohim se ç' thotë ai konkretisht.

G. Amendola e shtron problemin në këtë mënyrë: Derisa as zgjidhja socialdemokrate dhe as ajo komuniste nuk kanë dhënë rezultat në Itali (dhe përgjithësisht në Perëndim) gjatë 50 vjetëve të fundit, atëherë partia e re nuk mund dhe nuk duhet të jetë as socialdemokrate e as komuniste, por diçka «krejt e re», që qëndron më lart se të dyja këto! Amendola shkruan: «Në Itali unifikimi nuk mund të bëhet as në bazë të pozitave socialdemokrate, as në bazë të pozitave komuniste. **Nuk mund të bëhet për shkak të raportit të forcave dhe nuk duhet të bëhet në rast se duam të krijojmë një parti të re.** («Hipotezat»).

Amendola gjithashtu thotë: «Partia e re e vetme duhet të krijohet mbi bazën e një programi politik të përtëritjes, duke qenë e hapur, pa pengesa ideologjike për të gjithë ata që aprovojnë programin e saj. Ajo nuk mund të jetë as «ideologjikisht neutrale»..., as ideologjikisht e mbyllur, por një parti politikisht aktive, e aftë të tërheqë në programin e saj politik forca me prejardh-

je dhe frymëzim të ndryshëm. Partia e vetme duhet të përfshijë kontributin e rrymave më të përparuara të mendimit modern, në mënyrë që të realizojë një ballafaqim të frytshëm midis mendimit materialist dialektik që përmban e zhvillon mësimet e Marksit e të Leninit, e Labriolës e të Gramshit, dhe pozitive të tjera filozofike e kulturore. Edhe në këtë rast, vetëkuptohet, nuk mund të pretendohet që partia e vetme të krijohet mbi pozitativat ideologjike të pararojës komuniste». («Hipotezat»). Sipas fjalëve të vetë Amendolës, kjo do të ishte një parti e madhe dhe e vetme e lëvizjes punëtore, «në të cilën do të kishin vend komunistët, socialistët dhe njerëzit si Bobio, që përfaqësojnë denjësisht vazhdimin e betejës liberale...». («Socializmi në Perëndim»).

Për çdo komunist është e qartë si drita e diellit se kursi i propozuar nga Amendola është një kurs krejt regresiv e likuidator dhe përbën një tradhti të madhe ndaj interesave të klasës punëtore italiane e çështjes së socializmit.

Dihet se Marksi, Engelsi, Lenini, Stalini, gjithë revolucionarët e vërtetë proletarë kurdoherë i kanë kushtuar e i kushtojnë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre luftës për krijimin dhe për forcimin e partive të shëndosha revolucionare të klasës punëtore, të armatosura me teorinë marksiste-leniniste, për diferencimin e qartë dhe spastrimin e tyre nga oportunistët, reformistët, revizionistët, kapitullantët e renegatët e të gjitha ngjyrave, sepse pa këtë nuk mund të bëhet fjalë as për lëvizje të vërtetë revolucionare të klasës punëtore as për përmbyse të rendit shfrytëzues kapitalist dhe as për fitore të socializmit. Këtë e ka provuar në mënyrë të

pakundërshtueshme eksperiencia më se njëqindvjeçare e lëvizjes punëtore e komuniste botërore.

Ndërsa G. Amendola e bashkë me të gjithë revisionistët toliatistë italianë e të tjerë po ndjekin me rrëmbim një kurs krejt të kundërt — kursin e likuidimit të pararojës revolucionare marksiste-leniniste të klasës punëtore — të partive komuniste, duke i lënë punonjësit të çarmatosur e pa një shtab drejtues luftarak përballë borgjezisë së fuqishme e të organizuar. Kështu, ata prej kohësh e kanë vënë PK Italiane, e cila dikur ishte një parti revolucionare marksiste-leniniste, në rrugën e degjenerimit socialdemokrat, kurse tani po përpiqen ta likuidojnë atë plotësisht e përfundimisht, duke e shkrirë me socialdemokracinë në kuartrin e së ashtuquajturës «parti të vetme».

Siç del fare hapur nga thëniet e vetë Amendolës, ai kërkon të hiqet dorë nga marksizëm-leninizmi si baza ideologjike e partisë së klasës punëtore. Dhe kjo është plotësisht e kuptueshme përderisa, sipas Amendolës, «pozitat ideologjike komuniste» deri tani nuk kanë treguar ndonjë rrugëdalje dhe nuk kanë dhënë ndonjë rezultat të paktën në Itali e në Evropën Perëndimore.

Kjo do të thotë të hedhësh poshtë si krejt të panevojshme gjithë veprën titanike të themeluesve të komunizmit shkencor, të mohosh rolin dhe rëndësinë jetike të teorisë marksiste-leniniste, të heqësh dorë nga çdo ideal revolucionar komunist dhe nga çdo lëvizje revolucionare socialiste, të shkasësh përfundimisht në llumin e spontaneitetit. Për çdo komunist të thjeshtë janë të njohura idetë e klasikëve të marksizmit mbi rolin e

madh organizues, mobilizues e transformues të teorisë marksiste-leniniste, e cila u bën punonjësve të qartë qëllimin, u ndriçon rrugën, u hap perspektiva, u tregon mjetet, u shërben si busull e sigurt orientimi në luftën e tyre për socializëm e komunizëm. Marksi ka thënë se

«...teoria bëhet forcë e madhe materiale kur ajo bën për vete masat»¹,

kurse Lenini theksonte se

«Pa teori revolucionare nuk mund të ketë as lëvizje revolucionare... se rolin e luftëtarit pararojë mund ta kryejë vetëm ajo parti që udhëhiqet nga një teori pararojë»².

Revizionistët e filluan tradhtinë e tyre me revizionimin e parimeve e të mësimave themelore të marksizëm-leninizmit, kurse tani Amendola bën thirrje të hidhet poshtë e të braktiset përfundimisht marksizëm-leninizmi, të prishet e të likuidohet krejtësisht partia revolucionare e klasës punëtore e armatosur me ideologjinë komuniste. Kjo do të thotë se revizionistët po presin çdo lidhje me marksizëm-leninizmin dhe me lëvizjen revolucionare punëtore, po flakin tej edhe demagogjinë e maskën e tyre pseudosocialiste e pseudomarksiste, po zbulojnë lakuriq fytyrën e vet tradhtare, degjencrimin

1 K. Marks e F. Engels. «Mbi fenë», f. 56. Tiranë, 1970.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 434, 435-436.

e tyre të plotë në renegatë të klasës punëtore e të socializmit.

Duke hedhur poshtë «pozitat ideologjike të pararojës komuniste», Amendola thotë se partia e re nuk mund të krijohet as mbi bazën e pozitive ideologjike të socialdemokracisë, pasi edhe këto të fundit nuk kanë dhënë ndonjë rezultat. Por atëherë cila do të jetë baza ideologjike e partisë unike të klasës punëtore dhe a do të ketë kjo ndonjë bazë të tillë? Në botë ekzistojnë vetëm dy ideologji, dhe

«...çështja — ka theksuar Lenini — shtrohet vetëm kështu: ose ideologji borgjeze ose ideologji socialiste. Rrugë të mesme këtu nuk ka... Prandaj çdo zvogëlim i ideologjisë socialiste, çdo largim prej saj, do të thotë njëkohësisht forcim i ideologjisë borgjeze»¹.

Kurse Amendola thotë se «partia e vetme duhet të përfshijë kontributin e rrymave më të përparuara të mendimit modern», ajo duhet të jetë «arenë e ballafaqimit» (lexo e shartimit) të pikëpamjeve e të pozitive më të ndryshme filozofike, kulturore etj. Pra, fjala është për t'u ngritur mbi dy kampet në ideologji, për të krijuar diçka të tretë, të mesme, një shartim midis ideologjisë socialiste dhe ideologjisë borgjeze, socialdemokrate.

Orvatje të tilla për t'u ngritur mbi dy kampet në ideologji nuk janë të reja. Edhe shumë të tjerë para Amendolës janë përpjekur «të kapërcejnë njëanshmë-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 452-453.

rinë» e dy ideologjive të kundërta. Por cili ka qenë rezultati? Rezultati ka qenë që të gjithë ata që kanë bërë përpjekje të tilla kanë shkarë në pozitë e ideologjisë më të keqe e më reaksionare, janë shndërruar në shërbëtorë të borgjezisë e të reaksionit. Edhe Amendola me shokë, duke braktisur pozitë ideologjike komuniste e duke u orvatur të gjejë një rrugë të tretë, do të pësojë po të njëjtin fat. Por ajo që na preokupon këtu nuk është fati i Amendolës dhe i shokëve të tij, të cilët janë futur me ndërgjegje në rrugën e tradhtisë, por fati i lëvizjes punëtore dhe i çështjes së saj revolucionare. Duke predikuar heqjen dorë nga «pozitat ideologjike komuniste», Amendola hap dyert për nënshtrimin e plotë e pa pengesa të partisë e të krejt lëvizjes punëtore italiane ndaj influencës së ideologjisë borgjeze, të përfaqësuar nga ideologjia pseudosocialiste e socialdemokracisë, e liberalëve etj. Ky do të ishte një kapitullim i plotë e nënshtrim pa kushte i klasës punëtore dhe i partisë së saj revolucionare ndaj borgjezisë.

Duke e ndierë se një pozitë e tillë do të ishte shumë demaskuese, Amendola thotë se partia e vetme e klasës punëtore nuk do të ketë ndonjë «bazë ideologjike të përbashkët», se në të do të bashkekzistojnë në mënyrë paqësore e miqësore rrymat më të ndryshme ideologjike. Fra, ai kërkon të hiqet dorë nga parimi i partisshmërisë proletare në ideologji, të shtrihet bashkekzistenca paqësore edhe në fushën e ideologjisë, ndërsa partia të shndërrohet në një klub diskutimesh të pafund, në një parlament të tipit borgjez, në një parti llafazanësh, sepse është e qartë se pa një unitet të shëndoshë mendimi në parti mbi bazat e teorisë së socializ-

mit shkencor nuk mund të ketë as unitet veprimi. E çfarë partie mund të jetë ajo që nuk ka as unitet mendimi e as unitet veprimi, ç'mund të presë klasa punëtorë prej një partie të tillë, e cila vështirë se mund të quhet fare parti?

Baza e vetme mbi të cilën do të ngrihet partia e re, vazhdon Amendola, do të jetë «programi politik i përbashkët i luftës për socializëm». Por si është e mundur të ndiqet një politikë konsekuente socialiste pa u udhëhequr nga shkenca marksiste-leniniste, që është baza teorike e politikës proletare socialiste? Këtu janë të mundura tri gjëra: ose socializmi mund të arrihet mbi bazën e ideologjive të ndryshme, nën udhëheqjen e klasave, partive të ndryshme; ose në botë ka disa lloj socializmesh: një socializëm që arrihet mbi bazën e ideologjisë e të mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe disa «socializma» të tjerë që arrihen mbi bazën e ideologjive të tjera jomarksiste; ose për fitoren e socializmit ideologjia nuk luan ndonjë rol, ajo është, si të thuash, asnjënjë, nuk ka asnjë vlerë praktike.

Teza e Amendolës përputhet plotësisht me pikëpamjen e njohur oportuniste të P. Toliatit e të revizionistëve jugosllavë, se luftën për socializëm mund ta udhëheqin jo vetëm klasa punëtorë dhe pararoja e saj komuniste e armatosur me teorinë marksiste-leniniste, por edhe klasa, shtresa, grupe, parti e organizata që as e quajnë fare veten socialiste. Dhe të gjitha këto e kanë burimin te teza antimarksiste mbi «shtytjen spontane, objektive» drejt socializmit.

Dhe është e qartë se përderisa partia e re nuk do të ketë një bazë të vetme ideologjike, përderisa në të

do të konkurrojnë rrymat ideologjike e politike më të ndryshme, kjo parti do të jetë e hapur për këdo, për socialistët, socialdemokratët, katolikët, liberalët-borgjezë etj., etj., do të zhduket kështu karakteri i saj klasor si parti proletare, do të shndërrohet në një «parti të të gjithë popullit» italian në shembullin e «partisë së të gjithë popullit» të revizionistëve hrushovianë. Kjo, pra, nuk do të jetë një parti e klasës punëtore për udhëheqjen e luftës së saj klasore revolucionare, por një parti e të gjitha klasave për vendosjen e paqes dhe të harmonisë midis tyre.

Në kundërshtim me këto predikime të revizionistëve modernë, klasikët e marksizëm-leninizmit kanë bërë një luftë të vendosur e parimore për pastërtinë e radhëve të partive komuniste, duke theksuar se forca e tyre nuk qëndron në numrin, por në cilësinë e anëtarëve prej të cilëve ato përbëhen. Kështu, për shembull, V.I. Lenini, duke dënuar ashpër renegatët oportunistë të Internacionales së Dytë në vitin 1920, në letrën drejtuar punëtorëve gjermanë dhe francezë, shkruante:

«Pa e flakur jashtë këtë rrymë, e cila në të vërtetë, me lëkundjet e saj, me «menshevizmin» e saj... çon influencën e borgjezisë te proletariati nga brenda lëvizjes punëtore, nga brenda partive socialiste, pa e flakur jashtë këtë rrymë, pa u përçarë me të, pa i përjashtuar të gjithë përfaqësuesit e saj të shquar, është i pamundur bashkimi i proletariatit revolucionar...

Ka ardhur koha të flaken përfundimisht të gjitha këto iluzione shumë të dëmshme mbi

mundësinë e «unitetit» ose të «paqes» me Ditmanët dhe Krispinët, me krahun e djathtë të «Partisë Socialdemokrate të Pavarur» të Gjermanisë, të «Partisë Punëtore të Pavarur» të Anglisë, të «Partisë Socialiste të Francës» etj. Ka ardhur koha që gjithë punëtorët revolucionarë t'i spastrojnë partitë e tyre nga këta elementë dhe të formojnë partitë komuniste me të vërtetë të bashkuara të proletariatit»¹.

Këto pikëpamje likuidatore të G. Amendolës mbi heqjen dorë hapur nga pozitat ideologjike komuniste dhe mbi shkrirjen e PK Italiane me socialdemokratë, liberalë borgjezë e të tjerë, janë aq demaskuese saqë edhe vetë kolegët e tij revizionistë nuk guxuan t'i bëjnë publikisht të vetat, prandaj i quajtën «të nxituara», «të pamenduara mirë», «të paqarta», «jo krejt të sakta», bile edhe i «kritikuan». Por Amendola i hodhi poshtë këto «kritika» si të pajustificuara e të padrejta dhe në mbrojtje të tij nxori dy «argumente»:

Nga njëra anë, ai shkroi se atë e kanë «keqkuptuar». Në artikullin «Beteja unitare për socializmin», botuar në «Rinashita», më 12 dhjetor 1964, Amendola shkruan se nuk ka pasur aspak ndër mend të predikojë heqjen dorë nga ideologjia komuniste. Ai thotë: «Në këtë takim (domethënë në «partinë e vetme të klasës punëtore» bashkë me socialistët) ne komunistët paraqitemi me idetë tona, me forcën tonë, me thesarin tonë ideal... Kush ka thënë se duhet zhdukur ky thesar yni?

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 312-313.

Po, ky thesar yni, forca jonë, mendimi ynë politik, vullneti ynë revolucionar do të jetë kontributi ynë për partinë e re, do të jenë prika jonë». Por kjo është një dredhi fare e trashë, e cila është vështirë të mashtrojë njeri. Amendola përpiqet të mbulojë diellin me shoshë, sepse çdo njeri do të bëjë në mënyrë të pashmangshme pyetjen e thjeshtë: Përse i duhen «partisë së vetme» mendimi politik dhe ideologjia e partisë komuniste, «thesari i saj ideal», siç e quan atë Amendola, kur vetë ai, si argument themelor për nevojën e krijimit të kësaj «parti të vetme», ka nxjerrë pikërisht atë që ky «thesar» nuk paska dhënë asnjë rezultat gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit, as në Itali e as gjatë në Perëndim? Bile në po këtë artikull të 12 dhjetorit Amendola kundërshton vetveten kur thotë: «Nuk është fjala për të kërkuar «një takim në mes të rrugës» (domethënë midis pozitave komuniste e socialdemokrate —) ...Ne duam të gjejmë, përkundrazi, jo në mes të rrugës, por **më përpara**, tej pozitave të vjetra të fituara në të kaluarën, një strategji të re lufte për socializmin... me një platformë në të cilën uniteti i klasës punëtore të mund të arrihet jo duke mos marrë parasysh divergjencat e kaluara, por duke i kapërcyer ato, në një perspektivë të re avancimi drejt socializmit». Pra, pozitativat komuniste, «thesari» komunist, gjithashtu, u dashkan kapërcyer, domethënë duhet hequr dorë prej tyre! Ja në ç'pozitivë qesharake e ka vënë veten Amendola me revizionizmin e tij likuidator ekstremist.

Nga ana tjetër, Amendola mbrohet nga «kritikat» e kolegëve të vet revizionistë, duke u nxjerrë atyre para syve «autoritetin» e «mësuesit» të tyre të për-

bashkët, P. Toliati, i cili prej kohësh i pat hapur dyert e PK Italiane për elementët e rrymave më të ndryshme jomarksiste. Ai shkruan: «Atyre shokëve që nuk u durohet sa të shohin me pantallona të shkurtra partinë e re, unë dëshiroj t'u kujtoj se PK Italiane u bë ajo që është, sepse një politikë guximtare uniteti i lejoi të vihej në krye të Rezistencës dhe të transformohej, në zjarrin e luftës për çlirim, nga një parti kuadrosh në një parti të madhe masash, në një parti të tipit të ri, duke u kërkuar anëtarëve të saj vetëm angazhimin që të luftojnë për zbatimin e programit të saj politik, që ishte programi i rindërtimit dhe i ringjalljes demokratike të Italisë. Më të vjetërve, sigurisht, u kujtohen dyshimet dhe rezistenca që hasi shtruarja e paraqitur nga Toliati lidhur me formimin e partisë së re, sigurisht u kujtohet hyrja në radhët e partisë së re e «komunistëve katolikë», e pozitivistëve, e idealistëve, e anarkistëve. Bile pati edhe kritika në shkallë ndërkombëtare për atë që duhej dhe që ishte një transformim i karakterit të partisë. Por me gjithë këto shqetësime ne shkuam përpara pikërisht sepse zgjodhëm atë rrugë dhe formuam atë parti... duke ia hapur dyert e saj pa frikë e dyshime, pa shqyrtime të rrepta pranimit cilitdo që ishte gati të luftonte për zbatimin e programit politik të saj». Mendojmë se komentet janë të tepërta. Me fjalë të tjera, Amendola u thotë kolegëve të vet, revizionistëve, që tregohen më të matur e më të druajtur: Përse më bini më qafë kot së koti me «kritikat» tuaja kur ju e dini fare mirë se ne të gjithë së bashku, me Toliatin në krye, kemi kohë që ndjekim

rrugën e «transformimit» të PK Italiane dhe prej vitesh i kemi hapur dyert e saj për socialistë e socialdemokratë, demokratë-borgjezë e katolikë, idealistë e anarkistë nga më të ndryshmit? Kurse tani, që ka ardhur koha t'i kurorëzojmë përpjekjet tona shumëvjeçare me bashkimin dhe shkrirjen e plotë me «vëllezërit e klasës», socialdemokratët, në gjirin e «partisë së madhe të vetme të klasës punëtore», ju hidhni vicka e bëni sikur nuk jeni dakord! Lërin lodrat dhe hajdeni t'i futemi punës e ta krijojmë sa më parë «partinë e vetme», që është përfundimi i pashmangshëm logjik i vijës sonë shumëvjeçare! Pikërisht me një thirrje të tillë e mbyll Amendola artikullin e tij. «...unë mendoj, shkruan ai, se partia duhet të hidhet, pa rezerva ose frikë a dyshime, me të gjitha forcat e saj në betejën për unitetin politik të klasës punëtore».

Të tilla janë pikëpamjet e Amendolës lidhur me afrimin dhe me shkrirjen e Partisë Komuniste me ato socialdemokrate. Ato janë dëshmia më e qartë se revizionistët modernë janë vënë tanimë përfundimisht në rrugën e likuidimit të plotë të partive komuniste e punëtore. Likuidatorizmi — ky është stacioni ku të shpie në mënyrë të pashmangshme treni i revizionizmit.

II

Duke gjykuar mbi pikëpamjet e Amendolës, mbi diskutimin rreth «hipotezave» të tij dhe mbi tërë platformën e revizionistëve modernë, mund të arrihet lehtë në mendimin se këtu nuk kemi të bëjmë me një feno-

men të shkëputur e të rastit. Përkundrazi, faktet provojnë në mënyrë më të qartë se pikëpamjet e Amendolës janë një shprehje konkrete e vijës së udhëheqjes revizioniste të PK Italiane, të revizionistëve sovjetikë e të gjithë revizionizmit modern ndërkombëtar, janë shprehje e pamaskuar e qëllimeve të tyre tradhtarre, likuidatore. Çështja këtu është se Amendola jo vetëm i tha hapur pikëpamjet e tij, por i hoqi petën lakrorit lidhur me tërë revizionizmin modern, u hoqi perden «marksiste» pikëpamjeve likuidatore të shprehura nga P. Toliati, L. Longoja, N. Hrushovi etj. gjatë këtyre viteve të fundit dhe detyroi revizionistët e tjerë që gjithashtu t'i thonë pak më hapur pikëpamjet dhe qëllimet e tyre. Me një fjalë, ai, si revizionist ekstremist dhe agresiv, u dogji atyre kartat e taktikave «të shquara e të matura» që nisën të përdorin në situatat e reja kur kanë pësuar një varg disfatash të pariparueshme.

Në të njëjtën kohë, tezat e Amendolës dhe pikëpamjet që u shfaqën gjatë këtij diskutimi janë shprehje edhe e divergjencave që ekzistojnë në gjirin e grupeve revizioniste. Partia jonë e ka theksuar më se një herë se fasada e «unitetit» të revizionistëve modernë nuk është tjetër veçse një bluf, se ata, si armiq të marksizëm-leninizmit dhe kundërrevolucionarë, nuk mund të jenë kurrë miq midis tyre, se, tek ata vepron gjithnjë e më shumë ligji i xhunglës. Dhe këto divergjencia janë të një natyre të dyfishtë: taktika të ndryshme për arritjen e qëllimeve të njëjta, si për shembull për likuidimin e partisë; çështje më të thella që kanë të bëjnë me nënshtrimin apo pavarësinë e tyre ndaj njëri-tjetrit, me «shkopin e dirigjentit» apo policentrizmin etj. Kë-

shtu, ky diskutim pasqyron krizën gjithnjë e më të thellë që po kalon revizionizmi modern, qoftë në shkallë kombëtare (në Itali), qoftë edhe në shkallë ndërkombëtare.

Vija e G. Amendolës është vijë e gjithë udhëheqjes revizioniste të PK Italiane

Kur diskutimi rreth «hipotezave» të Amendolës ishte në zjarrin e zhvillimit të tij dhe atë nisën ta përshëndetin hapur e me entuziazëm edhe udhëheqës të Partisë Socialiste Italiane, liberale etj., vrapuan të marrin pjesë në të dhe të thonë mendimin «e tyre» edhe disa udhëheqës nga më kryesorët në PK Italiane, si sekretari i përgjithshëm i saj Luixhi Longo, anëtari i udhëheqjes Xhankarlo Pajeta, anëtari i Komitetit Qendror Romano Leda etj. Këta, të trembur nga përpjesëtimet që po merrte diskutimi dhe nga paraqitja pa maskë e mendimeve revizioniste në publik, bënë sikur gjoja i kundërshtuan pikëpamjet e Amendolës, sikur i «kritikuan» ato, gjë që u përpoqën ta shfrytëzonin edhe udhëheqësit sovjetikë për të nxjerrë versionin se gjoja udhëheqja e PK Italiane i paskësh hedhur poshtë pikëpamjet e tij. Por krahasimi i pikëpamjeve të tyre nxjerr në shesh të kundërtën dhe pikërisht:

Së pari, se «hipotezat» e Amendolës në tërësi janë në përputhje të plotë me vijën e përgjithshme revizioniste të udhëheqjes së PK Italiane;

Së dyti, se e ashtuquajtura «kritikë» e disa udhëheqësve të PK Italiane nuk drejtohet aspak kundër thelbit të pikëpamjeve likuidatore të Amendolës;

Së treti, se udhëheqja e PK Italiane nuk i ka hedhur poshtë, qoftë edhe formalisht, tezat e Amendolës.

Le ta vërtetojmë një gjë të tillë.

«Hipotezat» e Amendolës janë pjesë organike e revizionizmit toliatist, ato përputhen plotësisht me pikëpamjet dhe veprimet e P. Toliatit që pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vdekjen e tij. Është fakt se P. Toliati, duke u nisur nga koncepte krejtësisht revizioniste, ka shtruar më se një herë tezën se për socializmin në Itali e gjetkë nuk luftojnë vetëm komunistët, por edhe parti e forca të tjera. Kështu, në një mbledhje të KQ të PK Italiane në qershor të vitit 1956 ai pat thënë:

«Mund të shohim në fakt një shtytje drejt socializmit dhe një orientim pak a shumë të qartë drejt reformash e transformimesh ekonomike të tipit socialist edhe në vende ku partitë komuniste jo vetëm nuk marrin pjesë në pushtet, por nganjëherë nuk janë bile as ndonjë forcë e madhe. . . Kjo situatë paraqitet sot dhe merr një rëndësi të veçantë në ato zona të botës që janë çliuar pak kohë më parë nga kolonializmi. Por edhe në vende kapitaliste shumë të zhvilluara mund të ndodhë që klasa punëtore, në shumicën e saj, të shkojë pas një partie jokomuniste dhe nuk mund të përjashtohet që edhe në këto vende parti jokomuniste, por të bazuara në klasën punëtore, mund të shprehin shtytjen që vjen nga klasa punëtore për një ecje drejt socializmit. Bile edhe atje ku ekzistojnë parti komuniste të forta, mund të ekzistojnë, krahas tyre, parti të tjera që të kenë baza në klasën punëtore dhe një program socialist. Tendencë për të realizuar transformime ekonomike rrënjësore në një drejtim që është përgjithësisht ai i socializmit,

mund të vijë, më në fund, edhe nga organizata e lëvizje që nuk e quajnë veten socialiste». Dhe jo vetëm kaq, por mbi këtë bazë ai ka ngritur më se një herë çështjen e krijimit të një partie të vetme si një objektiv praktik e imediat.

Këto pikëpamje të tij përpiqet t'i përdorë si argument në diskutim edhe sekretari i sotëm i përgjithshëm i PK Italiane, L. Longo, i cili shkruan se lidhur me çështjen e një afrimi të veçantë të të gjitha forcave politike të organizuara që e konsiderojnë veten, në një mënyrë ose në një tjetër, të frymëzuara nga socializmi, P. Toliati ka thënë:

«Nuk është fjala, ta themi qartë, për një kthim në frontin popullor», por për «hapjen, para masave popullore, të një debati programatik, politik, e bile organizativ, për të përballuar e për të zgjidhur problemin se si, në kushtet e sotme, mund të gjendet njëfarë uniteti për të gjitha forcat që e quajnë veten socialiste». Bile P. Toliati ka qenë kundër atyre që e quanin si një «ëndërr» krijimin e një partie të vetme dhe thoshte se «ky problem ekziston dhe ne duhet ta shtrojmë» se «kemi të bëjmë me një problem që duhet të kapet e të vihet në radhët e klasës punëtore e të masave punonjëse».

Kështu P. Toliati, shumë kohë më parë se të dilnin «hipotezat» e Amendolës dhe të niste diskutimi i tanishëm, kishte përpunuar, midis të tjerash, bazat teorike të pikëpamjeve likuidatore mbi partinë dhe kishte shtruar detyrën konkrete për t'i vënë sa më parë në jetë këto pikëpamje likuidatore. Pra, Amendola dhe shokët e tij «kundërshtarë» kanë marrë hua nga P. Toliati ar-

mët me të cilat përpiqen të mohojnë rolin e partisë dhe të teorisë revolucionare, të marksizëm-leninizmit, në luftën e klasës punëtore e të masave punonjëse për socializëm, të vënë shenjën e barazimit midis partisë komuniste dhe partive borgjeze dhe t'i shkrijnë ato në një të vetme, me qëllim që ta lënë klasën punëtore të çarmatosur dhe partinë e saj ta shndërrojnë nga vegël të revolucionit e të diktaturës së proletariatit, në vegël kundërrevolucionare dhe të diktaturës borgjeze.

Ndryshe nga Amendola, i cili kapet pas shprehjeve më ekstremiste të Toliatit, udhëheqësi i sotëm i PK Italiane, L. Longo, në artikullin e vet përmend shprehje më «të buta» të tij, si ajo që Toliati ishte për «një parti masash dhe parti luftarake», cilësi këto që «mund të konkretizohen në mënyra të ndryshme, sipas situatave të ndryshme, dhe mund të lindin struktura të ndryshme». Duke e shikuar problemin në thelb e në tërësi, nuk është vështirë, pra, të zbulosh të njëjtën gjë që thotë edhe Amendola, se këtu Toliati e kishte fjalën për një parti të çorganizuar, pa disiplinë të shëndoshë, të hapur për këdo, siç shtrohet edhe në diskutimin për të cilin po bëjmë fjalë.

Natyrisht, në këtu theksuam vetëm ato pikëpamje të P. Toliatit që lidhen në mënyrën më konkrete e të drejtpërdrejtë me çështjen themelore të diskutimit të «Rinashitas», me çështjen e «partisë së vetme». Por fakti është se këto janë pjesë e së tërës, e tërë pikëpamjeve të tij revizioniste mbi «rrugën italiane drejt socializmit» dhe i shërbejnë realizimit të «socializmit» toliatist. Kjo është në përputhje të plotë me atë që shtron Amendola, me «rrugën e tretë», as komuniste e

as socialdemokrate, drejt socializmit, së cilës duhet t'i shërbejë partia «e re». Prandaj, ashtu siç janë të njëjta pikënisja dhe qëllimet, po ashtu janë të njëjta pikëpamjet mbi formën dhe përmbajtjen e mjetet për t'i realizuar këto qëllime, mbi partinë.

Po udhëheqja e sotme e PK Italiane ka apo nuk ka në thelb të njëjtat pikëpamje me Amendolën mbi krijimin e «partisë së vetme», i kundërshton apo i afirmon ato?

Për këtë do të mjaftonte të thoshim se si njëra palë ashtu edhe pala tjetër, në diskutimet e tyre, mbështeten plotësisht te P. Toliati, te fjalimet e artikujt e tij gjatë 20 vjetëve të fundit, dhe veçanërisht te «testamenti» i tij i Jaltës. Por, meqë të parët bënë disa «kritika» në adresë të të dytit, do të ndalemi pak më me hollësi në këtë çështje.

Sekretari i përgjithshëm i sotëm i PK Italiane, Luixhi Longo, nuk është se paraqitet vetëm tani me idetë e tij revizioniste e likuidatore mbi partinë, të cilat janë identike me ato të Amendolës, ndonëse, aty-këtu, më të kamufluara e me disa nuanca «mosaprovimi» të taktikës që ndjek ky i fundit. Jo. Përkundrazi, ai këto i ka shprehur qartë qysh në Kongresin e 5-të të PK Italiane afro 20 vjet më parë. Dhe që këto ide të tij aprovohen si shumë aktuale nga revizionistët toliatistë, këtë e vërteton fakti që disa pjesë të relacionit të tij të paraqitura në atë kongres, u ribotuan në «Rinashita» më 26 dhjetor 1964, në kuadrin e diskutimit nën titullin kuptimplotë: «Shkrirja për ne është një aspiratë e singertë».

L. Longo në atë kohë, midis të tjerave, ka deklaruar:

«Për ne komunistët çështja e shkrirjes nuk është, dhe nuk duhet të jetë, një shkas polemike për të luftuar ose për të përçarë partinë socialiste. Ajo është, dhe duhet të jetë, një vullnet i përcaktuar mirë për të bashkuar socialistët dhe komunistët, për të bashkuar tërë demokratët e sinqertë, sepse këtë e lyp situata dhe momenti aktual, dhe për hir të saj duhet të braktisen të gjitha konsideratat meskine personale ose partie». Dhe më poshtë vazhdon:

«Ne nuk kemi deklaruar kurrë se në bazën e partisë së vetme të punëtorëve italianë duhet të vihen metodat tona të punës, programi ynë politik dhe ideologjia jonë... Duhet të ekzistojnë garancitë se askush nuk do të detyrohet, se askush nuk do të poshtërohet, por që të gjithë do të mund të hyjnë dhe do të bashkëjetojnë në partinë e vetme me dinjitet dhe me të drejta absolutisht të barabarta, bile duke ruajtur edhe ato gjëra që janë të veçanta për të dhe që duhet të gëzojnë të drejtën e qytetarisë në një parti demokratike.

A nuk del qartë këtu jo vetëm identiteti i plotë, por edhe fakti që L. Longoja ashtu si dhe vetë Toliati, prej kohësh «e ka ndihmuar» Amendolën që të vijë në pikëpamjet e shprehura në «hipotezat», se i pari është një nga mësuesit e të dytit? Që të dy i marrin socialistët, demokratët etj. si partizanë të socializmit, që të dy janë për braktisjen e konsideratave «meskine personale ose partie», që të dy janë për heqjen dorë nga ideologjia marksiste-leniniste dhe programi politik i partisë komuniste, për një ideologji dhe program «të tretë». Këta, duke qenë se kanë hedhur poshtë prej kohësh (dhe sot bëjnë të njëjtën gjë) konceptin e luftës së klasave, kanë

hedhur poshtë edhe idetë e mëdha të Leninit mbi bazat politike, ideologjike dhe organizative të partisë revolucionare të proletariatit, duke proklamuar pikëpamjet mbi unitetin e paparim dhe me çdo kusht me çdo parti ose person qoftë, mjafton që e quan veten «socialist» e «demokrat». Këtë bënte L. Longoja 20 vjet më parë, këtë bëjnë edhe sot si ai ashtu edhe shokët e tij.

Një nga «kritikuesit» e Amendolës dhe që citohet me dashuri nga revizionistët sovjetikë në «Komunist» në «kritikat» e tyre kundër Amendolës, është edhe anëtari i KQ të PK Italiane, Romano Leda. Në artikullin e tij ky prek çështje të vijës së përgjithshme revizioniste të PK Italiane, me të cilat Amendola është plotësisht dakord, dhe arrin në pikëpamjen e përbashkët mbi domosdoshmërinë e krijimit të «partisë së vetme».

Si dhe Amendola, R. Leda i përmbahet pikëpamjes se nuk duhet hequr dorë «nga rishqyrtimi kritik i të gjitha atyre gjërave që duhet të përtërihen dhe i të gjitha atyre gjërave të leninizmit që duhet të diskutohen», se duhen arritur «përtëritja dhe kapërcimi i atyre formulimeve strategjike që u përgjigjeshin kërkesave revolucionare në të kaluarën», se «lëvizja komuniste në tërësi nuk diti t'i kapë nga pikëpamja rigoroze marksiste-leniniste» problemet e reja që shtroi zhvillimi i situatës botërore (këtu Leda shton se «Toliatit pat thënë dikur se problemi kyç për lëvizjen punëtore evropiane ka qenë hapja e një «kapitulli të ri» të marksizëm-leninizmit»). R. Leda thotë gjithashtu se «rrugët nacionale» nuk duhen konceptuar nga lëvizja punëtore perëndimore «si rrugë të ndryshme për të zbatuar të njëjtën eksperiencë revolucionare të së kaluarës, si variante me

karakter specifik nacional të një modeli të vetëm të socializmit», por «si një model i ri strategjik dhe ndërtimi socialist». A nuk del qartë këtu mendimi mbi heqjen dorë nga leninizmi dhe mohimi i rrugës revolucionare e i fitoreve të lëvizjes komuniste në të kaluarën që i bashkon këta revizionistë? A nuk është kjo në përputhje të plotë me pozitën e Amendolës mbi «një rrugë të veçantë» drejt socializmit, mbi një «socializëm» të posaçëm për vendet e zhvilluara kapitaliste, ndryshe nga ai i vendeve të Lindjes etj.? Pas kësaj duket qartë se sa formale e demagogjike është «kritika» që i bën ai Amendolës.

R. Leda qëndron në pozita krejt revizioniste e reformiste si dhe Amendola kur shtron çështjen e ekzistencës së «një raporti të ri midis reformës dhe revolucionit», kur mbron pikëpamjen e P. Toliatit se «sa më tepër zhvillohet kapitalizmi, aq më tepër reformat demokratike, politike dhe ekonomike marrin një përmbajtje socialiste», pasi shteti i sotëm në Itali gjoja qenka «i ndryshëm nga ai që kishte parashikuar Lenini». A nuk ndeshemi këtu me zbulimin e kapitalizmit dhe zëvendësimin e luftës revolucionare me reformizmin, që e gjejmë dhe tek Amendola?

R. Leda, megjithëse pranon se krahu reformist në lëvizjen punëtore (domethënë socialdemokracia) konsideron si armikun kryesor jo imperializmin e kapitalizmin, por revolucionet komuniste, dhe bile bashkëpunon me kolonializmin dhe neokolonializmin, prapëseprapë e zbuluron socialdemokracinë duke thënë se këto rrjedhin nga «keqkuptimi» dhe «paaftësia» e saj për të analizuar në mënyrë komplekse botën e sotme, se «të gjitha këto nuk mund t'i ngarkohen tradhtisë së këtij

apo të atij udhëheqësi socialdemokrat», pasi një vlerësim i tillë është «sektar». A nuk kemi të bëjmë këtu po me ato përpjekje që bën edhe Amendola për të maskuar fytyrën e vërtetë dhe bazën klasore të socialdemokracisë reformiste, për të treguar se ajo është «për socializmin» dhe, si e tillë, me të mund të bashkohesh?

R. Leda, më së fundi, bën sikur gjoja pranon doktrinën marksiste-leniniste mbi partinë dhe mbi diktaturën e proletariatit si faktor i përhershëm për kalimin në socializëm. Por me një shënim të posaçëm sqaron se «diktatura e proletariatit nuk është domosdo shtrënguese (koercitive) dhe e themeluar mbi partinë e vetme. Në këtë rrugë konkrete u zhvillua revolucioni në Rusi me Leninin dhe gabimisht një veprim i tillë u përgjithësua». Pra, edhe në mohimin e rolit të partisë marksiste-leniniste dhe të diktaturës së proletariatit në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit ai puqet plotësisht me Amendolën.

Një tjetër revizionist toliatist, anëtari i udhëheqjes së PK Italiane, Xhankarlo Pajeta, në një artikull të botuar në janar 1965 në «Rinashita» (Nr. 3), shpreh të njëjtat ide të Amendolës. Ai nënvizon se demokracia italiane ka nevojë për një parti politike të masave, dhe kjo aq më tepër se shteti dhe institucionet e tij ndërhyjnë drejtpërdrejt në problemet ekonomike e prodhuese dhe merren jo vetëm me edukimin skollastik, por edhe me edukimin e masave. Në një situatë të tillë, vazhdon ai, është e domosdoshme një parti që të jetë e zonja të sigurojë, në çdo rrethanë dhe në të gjitha nivelet e jetës politike dhe ekonomike, influencën e klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve.

Por ajo që pikëpamjet e Amendolës në esencë janë gjithashtu pikëpamje të udhëheqjes revizioniste të PK Italiane, më së fundi, u aprovua hapur si në mbledhjen e dhjetorit të kaluar të KQ të PK Italiane ashtu edhe në organin e saj «Unita» të 12 dhjetorit 1964. Kështu, duke shkruar për diskutimin e anëtarit të Komitetit Qendror, Triveli, në mbledhje, gazeta shkruan se «ai pranon vlerësimin politik të shprehur në artikullin e fundit të Amendolës, që fundja është edhe pozita e partisë sipas të cilit problemi i unitetit midis forcave që e quajnë veten socialiste dhe vetë çështja e partisë së vetme janë probleme që shtrohen qysh tani». Po kjo gazetë, duke bërë fjalë për diskutimin e një tjetri, pranon se «vetë udhëheqja e partisë si tërësi e ka ngritur prapë këtë çështje dhe në deklaratën mbi zgjedhjet shihet një aluzion për partinë e vetme».

Atëherë ku konsiston e ashtuquajtura «kritikë» që i bën Amendolës udhëheqja e PK Italiane? Le ta themi që në fillim edhe një herë se udhëheqja e PK Italiane vetëm bën sikur e kritikon Amendolën, por në të vërtetë është plotësisht dakord me të, si për çështjet strategjike ashtu dhe për çështjet taktike. Duke u trembur nga demaskimi para masës së partisë, ajo vetëm «i zbut» shprehjet e tij të hapëta, përpiqet të mos i quajë gjërat me emrin e tyre të vërtetë. Bile L. Longoja e merr nën mbrojtje Amendolën kur deklaron në artikullin e tij rreth diskutimit se «disa formulime që përmbahen në të» (në artikullin e Amendolës) «janë të nxituara dhe mund të shkaktojnë keqkuptime, sikundër e pranoi dhe vetë autori...» (Ndonëse, siç e pamë më lart, Amendola s'pranoi asgjë dhe qëndroi në pikëpamjet e tij). E vetm-

ja «kritikë me peshë» që bën L. Longoja në adresë të Amendolës (dhe kjo është kritika e shumicës së «kundërshtarëve» të tij,) është se gjoja ky i fundit nuk bën si duhet dallimin midis dy problemeve, midis sigurimit të unitetit të veprimeve me socialistët, që është një detyrë imediate, dhe krijimit të «partisë së vetme» të klasës punëtore, që kërkon një kohë më të gjatë, sepse duhen kapërcyer «ndryshimet thelbësore që akoma i ndajnë» komunistët e socialistët. Kurse Amendola problemin e dytë e shtron si detyrë imediate.

Ç'mund të thuash për një «kritikë» të tillë? Më e rëndësishmja është se edhe në këtë «kritikë» L. Longoja nuk kritikon aspak në thelb tezat e Amendolës mbi domosdoshmërinë e shkrirjes me socialdemokracinë e sotme, as tezat e tij mbi karakterin e partisë së re etj. Ai flet në mënyrë të papërcaktuar për disa «formulime të nxituara» të Amendolës. Bile duket qartë që L. Longoja këtu bën demagogji, sepse, siç e përmendëm më lart, ai ribotoi si aktual, krahas këtij artikulli, fjalimin e tij të mbajtur 20 vjet më parë në Kongresin e 5-të të PK Italiane, ku problemi i «partisë së vetme» shtrohet si detyrë imediate, sepse ai thotë që problemi nuk duhet ngritur në mënyrë aq «abstrakte», siç e ngreka gjoja Amendola, por në mënyrë sa më konkrete, sepse po vetë Longoja e pranon që çështja e ngritur nga Amendola është «shumë aktuale» etj.

Është shumë kuptimplotë lidhur me esencën e kësaj «kritike» fakti që udhëheqja e PK Italiane revoltohet qoftë edhe kundër «kritikave» të revistës së revizionistëve sovjetikë «Komunist» në adresë të Amendolës, e cila pat shkruar se gjoja udhëheqja e PK Italiane i ka

hedhur poshtë tezat e Amendolës. Jo, përgjigjet prerë «Unita»: «Është e vërtetë, natyrisht, që ne kemi mbrojtur dhe mbrojmë parimet e marksizëm-leninizmit: këtë e ka bërë tërë udhëheqja dhe e ka bërë edhe shoku Amendola. Por neve na duket ekuivok formulimi i prerë (i «Komunistit»), sipas të cilit **udhëheqja e partisë dhe organet e saj teorike kanë hedhur poshtë tezat e shokut Amendola**».

Kështu, se si qëndron e vërteta e kësaj «kritike» dhe në ç'pozita revizioniste-likuidatore qëndron e tërë udhëheqja e PK Italiane, tanimë është e qartë.

Revizionistët hrushovianë — frymëzues dhe përkrahës të kursit likuidator të revizionistëve toliatistë

Por një qëndrim «kritik» ndaj tezave të Amendolës mbajti edhe udhëheqja sovjetike, duke u nisur gjithashtu krejtësisht nga pozita revizioniste. Përse është e pakënaqur udhëheqja sovjetike nga Amendola dhe ku puqet ajo plotësisht me të?

Organi i KQ të PK të BS, revista «Komunist», në Nr. 1 të janarit të këtij viti, duke marrë pozën e shumëdashur të «dirigjentit» dhe në një formë gjoja «objektive», boton një artikull redaksional, në të cilin bën një përmbledhje të diskutimit të zhvilluar rreth tezave të Amendolës në shtypin e PK Italiane, përmend «kritikat» që i bënë atij L. Longoja, R. Leda etj. dhe shpreh pikëpamjet e saj.

Për sa i përket problemit të «unitetit», revista «Komunist» në thelb është plotësisht dakord, veçse shprehet

kryesisht me gjuhën e moderuar të L. Longos, duke kërkuar që ky proces të mos nxitohet, por më parë të arrihet «uniteti i veprimeve» etj.

Kurse për sa u përket pakënaqësive, që në instancë të fundit shprehin kontradiktat midis revizionistëve sovjetikë dhe revizionistëve italianë, revista «Komunist» flet me gjuhën kryesisht të R. Ledas, i cili është më pak policentrist dhe më i gatshëm për t'iu nënshtruar udhëheqjes revizioniste sovjetike sesa udhëheqja e PK Italiane, e cila ndjek kursin e P. Toliatit për një vijë revizioniste «të pavarur», «nacionale», antisovjetike — policentriste.

Së pari, «Komunist» e kritikon Amendolën pikërisht për tendencat e tij të tepruara «autonome» të shkëputjes nga udhëheqja revizioniste sovjetike, sepse ai i ndan «problemet e revolucionit në Perëndim nga proceset revolucionare botërore» (lexo: nga proceset e zhvillimit revizionist të Bashkimit Sovjetik), sepse ai qëndron në pozitë reformiste «të ngushtësisë nacionale» dhe nuk e kupton revolucionin sovjetik në periudhën midis dy luftërave botërore. Me një paraqitje të tillë të çështjes udhëheqja revizioniste sovjetike ndjek një qëllim të dyfishtë: nga njëra anë, të frenojë tendencat centrifugale që vihen re në grupimet e ndryshme revizioniste, sidomos në udhëheqjen e PK Italiane, nga ana tjetër, të godasë përsëri partitë marksiste-leniniste, të cilat revizionistët hrushovianë prej kohësh i kanë akuzuar në mënyrë shpifëse për «nacionalizëm», «ngushtësi nacionale» etj.

Së dyti, «Komunist» e kritikon Amendolën për shkak se ky ka shprehur hapur pakënaqësinë për rrë-

zimin e kryerevizionistit N. Hrushov, sepse nga kjo ai ka nxjerrë konkluzionin se në Bashkimin Sovjetik akoma nuk janë likuiduar «metodat antidemokratike të kohës së kultit të individit» dhe sepse ai kërkon shpejtimin e rifrimeve të «liberalizimit» në Bashkimin Sovjetik. Me këtë udhëheqja sovjetike shpreh pakënaqësinë ndaj opozicionit të disa udhëheqjeve revizioniste lidhur me heqjen e kryerevizionistit të falimentuar e të diskredituar plotësisht N. Hrushov; me këtë ajo përpiqet të fshehë realitetin se ndjek pikë për pikë hrushovizmin, ndonëse pa Hrushovin, se taktika e re, «e matur», e saj pas rrëzimit të N. Hrushovit s'është tjetër veçse bluf që i duhet për të mashtruar komunistët dhe masat punonjëse, si brenda në Bashkimin Sovjetik ashtu edhe në mbarë botën.

Së treti, «Komunist» e kritikon Amendolën për shkak të taktikave të tij «të ngutura» në të gjitha çështjet, për shkak të veprimeve pa maskë në hedhjen poshtë të leninizmit dhe për shkak të ekstremizmit të tij likuidator, gjëra këto që diskreditojnë revizionizmin modern në tërësi. Ky është një manifestim tjetër i përpjekjeve për ta ruajtur me çdo kusht qendrën e revizionizmit modern në strofkën e tij kryesore në Moskë.

Në këtë mënyrë diskutimi i hapët me «hipotezat» e Amendolës, si në shtypin e PK Italiane ashtu dhe jashtë, dëshmon për kontradiktat që ekzistojnë në gjirin e revizionizmit modern në shkallë ndërkombëtare. Por në të njëjtën kohë, për sa u përket problemeve të tjera themelore, vijës së revizionizmit modern në përgjithësi, udhëheqja sovjetike qëndron në të njëjtat pozita me Amendolën e K⁰.

Në fakt, dihet se vija e afrimit me socialdemokratët u përpunua në Kongresin famëkeq të 20-të të PK të BS dhe filloi të ndiqet në shkallë të gjerë menjëherë pas tij. Ky orientim u ritheksua në kongreset e 21-të e të 22-të. Duke folur në Kongresin e 22-të N. Hrushovi tha se afrimi dhe bashkimi me socialdemokracinë «nuk është një parullë e përkohshme taktike, por vija e përgjithshme e lëvizjes komuniste, që diktohet nga interesat rrënjësore të klasës punëtore». Ai ka thënë gjithashtu: «Në qoftë se flitet për rolin dhe vendin e partive jokomuniste, para së gjithash, duhet nënvizuar se në gjendjen e sotme për transformimin socialist të shoqërisë, bashkëpunimi i partisë komuniste me partitë e tjera është jo vetëm i mundshëm por edhe i domosdoshëm». (Përgjigjet e N. Hrushovit dhënë redaktorit të gazetës australiane «Herald» Xhon Uoters, botuar në «Pravda», 25 qershor 1958).

Dhe me të vërtetë dihet shumë mirë se që nga ajo kohë ishte pikërisht N. Hrushovi ai që ndërmoi një varg takimesh e kontaktesh «të përzemërta» me udhëheqësit e «partive borgjeze të klasës punëtore» Gi Mole, Spak, H. Uilson e mjaft të tjerë, gjatë të cilave, sikurse janë shprehur vetë këta krerë socialdemokratë, «morën satisfaksione të sigurta në shumë pika».

Është shumë kuptimplotë fakti se edhe në vetë artikullin e «Komunistit», për të cilin bëmë fjalë më lart, përmbahen disa teza që në thelb justifikojnë pozitën e Amendolës. Aty, midis të tjerash, thuhet se «është e kuptueshme që komunistët e Italisë të tregojnë një interes të vazhdueshëm për problemin e unitetit»,

se «duke e shtruar në mënyrë realiste problemin e unitetit, udhëheqja e PK Italiane nuk e ka hequr aspak problemin e krijimit të një partie të vetme» dhe se «kjo është plotësisht e natyrshme për një vend si Italia, ku drejt socializmit kanë filluar të orientohen jo vetëm punëtorët, por edhe shtresat e gjera të masave punonjëse, shtresat e mesme, inteligjencia, partitë e ndryshme që propozojnë ose pranojnë perspektivën socialiste». Bile në një vend tjetër thuhet edhe se veprimet e përbashkëta midis tyre lehtësojnë «arritjen e një marrëveshjeje më të gjerë edhe për çështjet e ideologjisë». Kështu, pra, «Komunist» justifikon si shtruarjen e problemit të partisë së vetme, si quajtjen e partive të tjera joproletare prosocialiste, ashtu edhe bashkëjetesën ideologjike me to.

Por në të njëjtën kohë, duke ndierë se në ç'dërrasë të kalbur qëndron, si dhe rrezikun e demaskimit, «Komunisti» thërret me dëshpërim dhe pa qenë në gjendje të japë asnjë argument për të vërtetuar të kundërtën: «Nuk kanë aspak të drejtë ata socialistë që përpiqen t'i paraqesin diskutimin e komunistëve italianë dhe përpjekjet e tyre për të gjetur një taktikë revolucionare më të përsosur si aprovim të kritikës dhe të revizionimit të marksizmit që është bërë prej tyre, si aprovim të interpretimit që ata i japin procesit të përtëritjes të filluar nga Kongresi i 20-të i PK të BS, të cilin socialistët e paraqesin si heqje dorë nga trashëgimi leninist, për rikthimin në shtruarjen socialdemokrate të problemeve». Mirë thotë populli ynë: ka mizën në kësulë prandaj hidhet përpjetë! Sa bukur janë lidhur midis tyre Kongresi i 20-të i PK të BS, diskutimi dhe

veprimet e revizionistëve toliatistë dhe pozitât e socialdemokracisë!

Por gjërat u thanë më qartë nga udhëheqja sovjetike pasi artikulli i «Komunistit» u kritikua nga «Rinashita», duke botuar në «Pravda» më 4 shkurt një artikull tjetër me karakter përgjithësues nën titullin «Komunistët dhe socialdemokratët». Qëllimi i këtij artikulli është fund e krye predikim dhe justifikim i afrimit dhe i shkrirjes së komunistëve me socialdemokratët.

Cilat janë pikëpamjet e revizionistëve sovjetikë të shprehura në këtë artikull dhe që përputhen plotësisht me ato të Amendolës e të revizionistëve të tjerë italianë?

Nga njëra anë, këtu i bëhet një zbulim krejtësisht i hapur socialdemokracisë; nga ana tjetër, nxihen marksistë-leninistët dhe reklamohet me të madhe malli i mykur revizionist.

Socialdemokracia paraqitet nga «Pravda» si një forcë që «ka marrë një kthesë nga e majta», e cila gjoja ka pranuar domosdoshmërinë e socializmit, ka hequr dorë nga antikomunizmi e antisovjetizmi «i hapur», është e gatshme për kontakte e bashkëpunim me komunistët etj. Dhe «për të ilustruar» këto teza ajo u referohet Partisë Socialiste Franceze, Partisë Laburiste të Anglisë etj., të cilat, siç e dimë, e kanë treguar me fakte se sa antikomuniste, shërbëtoresh të kapitalit dhe agresive janë qoftë kur kanë qenë ose janë në pushtet, qoftë kur kanë qenë ose janë në «opozitë». Për më tepër, një «kthesë» të tillë «Pravda» e lidh me faktin që komunistët (lexo: revizionistët) po ndjekin «më me vendosmëri» parimin e bashkëjetesës paqësore (të pa-

parim), politikën e evitimit të luftës bërthamore (duke kapitulluar para agresionit imperialist), «rrugën paqësore» të kalimit në socializëm etj. A ka shërbim më të mirë që u bën në këtë rast «Pravda» armiqve të komunizmit kur u thotë, as më shumë e as më pak, se komunistët më parë nuk paskëshin luftuar gjoja «me vendosmëri» kundër luftës bërthamore? Atëherë ç'paskëshin qenë ata para se të dilnin revizionistët, luftënxitës? Po këtu s'ka asgjë për t'u çuditur, pasi dihet mirë se hrushovianët quajnë «paqedashës» deri krerët e imperializmit agresiv amerikan, kurse marksistë-leninistët e vërtetë si luftënxitës.

«Pravda» në këtë artikull thotë gjithashtu hapur se komunistët (është fjala për revizionistët) kanë korrigjuar «gabimet e veta» duke filluar qysh nga Kongresi i 20-të i PK të BS, i cili goditi pozitat e tyre të mëparshme «dogmatike» e «sektare» në të gjitha drejtimit, dhe konkretisht: ata kanë ndryshuar pikëpamjet e tyre (nga leninistë në revizionistë) mbi socialdemokracinë dhe nuk e shohin më atë si agjenturë të borgjezisë; ata pranojnë rrugët «e reja» të kalimit paqësor në socializëm në vendet kapitaliste të zhvilluara, i shohin reformat demokratike (në një shtet borgjez!) si mjet për përparimin drejt socializmit në këto vende, ata kanë hequr dorë nga udhëheqja e një partie të vetme si kusht i domosdoshëm për ndërtimin socialist dhe pranojnë «sistemin e shumë partive», duke përfshirë edhe partitë legale të opozitës (domethënë pranojnë tolerimin e kundërrevolucionit dhe ndarjen e pushtetit me të) etj., etj.

Pra duket sheshit se është pikërisht udhëheqja

revizioniste sovjetike ajo që ka formuluar qartë në Kongresin e 20-të famëkeq hrushovian bazat teorike dhe që sot predikon e zbaton me zell, midis të tjerash, afrimin dhe shkrirjen me socialdemokracinë, ajo që për hir të këtij afrimi dhe të qëllimeve finale të saj kundërrevolucionare predikon dhe zbaton kursin e likuidimit të partive komuniste dhe të heqjes dorë tërësisht nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit.

Ishin pikërisht revizionistët hrushovianë ata që të parët filluan sulmin kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik duke nxirë një periudhë të tërë të lavdishme, kur në krye të saj qëndronte J.V. Stalini. Ata i imponuan partisë së madhe të themeluar nga Lenini një vijë fund e krye oportuniste antimarksiste e antisocialiste. Ata likuiduan kuadrot e shëndoshë revolucionarë dhe i zëvendësuan me gjithfarëlloj njerëzish karrieristë e revizionistë. Hrushovianët e shndërruan partinë nga një shtab politik revolucionar të klasës punëtore e masave punonjëse në një organizatë ekonomike, e copëtuan atë në «parti industriale» e «parti bujqësore», e zhveshën nga funksionet politike dhe e bënë atë një «parti të stomakut». Më në fund ata fshinë karakterin klasor, proletar të partisë komuniste dhe një ditë të bukur e shpallën atë «parti të të gjithë popullit».

A nuk del, pra, fare e qartë se ku e ka gjetur Amendola frymëzimin për të dalë me «hipotezat» e tij në publik? A nuk duket qartë lidhja organike që ekziston midis idesë mbi «partinë e vetme» në vendet kapitaliste dhe tezës së «partisë së të gjithë popullit» në Bashkimin Sovjetik? Që të dyja palët janë të njëzësh-

me në atë që, për të sabotuar revolucionin proletar në vendet kapitaliste dhe për të restauruar kapitalizmin në vendet socialiste, duhet likuiduar me çdo kusht partia revolucionare e klasës punëtore.

Ja sepse është e domosdoshme që të demaskohen me vendosmëri pozitat dhe manovrat demagogjike të udhëheqjes sovjetike, esenca po aq revizioniste e likuidatore e «kritikave» të saj në adresë të revizionistit-likuidator Amendola, fakti që jo vetëm pozitat e tyre në thelb janë të njëjta, por edhe që revizionistët hrushovianë janë gjithashtu mësues dhe mbrojtës të Amendolës e K⁰.

Për të mashtruar komunistët dhe popujt, udhëheqësit e sotëm sovjetikë po përpiqen tani të krijojnë përshtypjen se janë duke korigjuar diçka nga gabimet e së kaluarës. Por kush i bëri këto gabime? Për këtë ata nuk flasin. Dihet se për riorganizimin e partisë mbi bazën e prodhimit dhe për shndërrimin e saj në një «parti të stomakut» ka marrë vendim të posaçëm plenumi i KQ të PK të BS, bile me zhurmë e me bujë të madhe, duke e cilësuar këtë masë si një «kthesë me rëndësi historike» në jetën e partisë. Këto vendime janë marrë kolegjisht, prandaj përgjegjësia për to bie mbi të gjithë. Më kot përpiqen udhëheqësit e sotëm sovjetikë të shpëtojnë lëkurën e tyre e t'ia hedhin fajin vetëm N. Hrushovit.

Por udhëheqësit e sotëm sovjetikë mund të thonë se këto masa ua imponoi N. Hrushovi. Por pse atëherë ata nuk u ngritën kundër këtyre masave e t'i dënonin ato, apo mos vallë kishin frikë nga pasojat që mund të pësonin? Edhe Hrushovi kështu ka thënë lidhur me

shpifjet dhe sulmet e tij kundër Stalinit: ne i shihnim gabimet, por nuk mund të flisnim. Ta zëmë se, siç thonë revizionistët, atëherë kjo ngjiste për shkak se «mungonte demokracia». Po sot, pas Kongresit të 20-të, i cili, sipas revizionistëve, hapi epokën e «lulëzimit të demokracisë, ligjëshmërisë e lirisë» si mund të ngjasin këto gjëra, si është e mundur që njeriu të mos guxojë të flasë, të ketë frikë?

Blofet dhe demagogjia e revizionistëve, orvatjet e tyre për të fshehur fajtorët dhe për të shpëtuar nga përgjegjësia nuk mund t'i mashtrojnë komunistët. Sot çdo gjë po bëhet gjithnjë e më e qartë. Fytyrën e vërtetë të revizionizmit dhe të revizionistëve po e kuptojnë tani edhe parti të tilla që, nën diktatin e shkopit të dirigjentit, deri dje ndiqnin kursin revizionist hrushovian. Ato po ngrenë tani zërin e protestës dhe kërkojnë që revizionizmit hrushovian t'i grisët maska. Të tillë zëra do të ngrihen gjithnjë e më shumë e, duke u bashkuar me luftën e vendosur e parimore të marksistë-leninistëve të të gjithë botës, do t'i shkaktojnë revizionizmit disfata të reja, deri në shpartallimin e tij të plotë.

Jo një fenomen i rastit, por shprehje e qëllimeve tradhtarë të revizionistëve modernë në përgjithësi

Por pozitën likuidatore të Amendolës, të udhëheqjes revizioniste të PK Italiane dhe të revizionistëve hrushovianë janë bërë pozita të të gjithë revizionizmit modern ndërkombëtar. Kështu që diskutimi në PK

Italiane mbi «partinë e vetme», hapi i ri tradhtar e likuidator i Amendolës, nuk është një fenomen i vetëm dhe i veçuar. Ai në të vërtetë përfaqëson një nga aspektet, ndofta më tipikun dhe më të qartën, e një fushate të tërë të re që kanë filluar kohët e fundit në shkallë ndërkombëtare gjithë revizionistët modernë për afrim, bashkëpunim dhe shkrirje me socialdemokracinë. Kjo duket nga vendimet, rezolucionet dhe diskutimet në partitë e ndryshme revizioniste të Evropës Perëndimore. Për këtë dëshmojnë qartë edhe diskutimet rreth tryezës së rrumbullakët mbi problemet e «unitetit të lëvizjes punëtore dhe demokratike në vendet kapitaliste», organizuar nga revista revizioniste ndërkombëtare «Probleme të paqes dhe të socializmit», diskutime që u botuan në numrat e saj 1 dhe 2 të këtij viti.

Cilat janë pikëpamjet që u shprehën nga përfaqësuesit revizionistë të partive komuniste e punëtore të mjaft vendeve gjatë këtij diskutimi?

Tonin ua ka dhënë këtyre diskutimeve fjala e hapjes e P. Entzhes (PK Franceze). Ai, duke shtrembëruar frymën dhe përmbajtjen e Deklaratës së Moskës të vitit 1960 dhe duke u përpjekur të shesë sapunin për djathë, tha se «Deklarata krijon kushte të reja dhe na vë neve komunistëve detyra të reja për unitetin me socialistët dhe për një bashkim më të gjerë të forcave demokratike». Për më tepër, ai e konkretizoi këtë me shtruarjen e problemit në këtë mënyrë: «A mund të parashikojmë ne jo vetëm marrëveshjen mbi programin e përbashkët, por dhe arritjen e atij uniteti organizativ për të cilin Gi Mole ka thënë: «Ne, socialistët, duhet të pohojmë përsëri nevojën që uniteti të ri-

vendoset», dhe a mundet uniteti i veprimit, të cilin, ne, në fund të fundit, do ta arrijmë, të ruhet në rrugët e zhvillimit paqësor ose jopaqësor të revolucionit, si dhe më vonë, kur do të sigurohet fitorja përfundimtare e punonjësve?».

Përfaqësuesi i PK Italiane, L. Grupi, ngrihet hapur kundër orientimeve të Kongresit të 7-të të Kominternit lidhur me problemet e unitetit, justifikon dhe merr nën mbrojtje të hapët socialdemokratët. «Sipas mendimit tim — thotë ai — fakti që korrigjimi i pozitave të gabuara dhe demaskimi i rrezikut të sektarizmit në Kongresin e 7-të nuk u shoqërua nga kritika e hapët e gabimeve të bëra në të kaluarën, e dobësoi rëndësinë e kontributit që dha Kongresi i 7-të në zhvillimin e strategjisë së lëvizjes komuniste». Dhe më poshtë: «Gjatë 30 vjetëve ne kemi thënë se socialdemokracia i gënjen punëtorët. Ndërsa duheshin studiuar shkaqet objektive në saje të të cilave në disa situata dhe në disa momente shumica e klasës punëtore ka shkuar pas socialdemokracisë. Siç duket, në këto momente socialdemokracia ia arriti të shprehë kërkesat e lëvizjes punëtore, qoftë edhe në formë të mistifikuar dhe kontraktore, ndërsa lëvizja komuniste nuk mund t'i shprehë këtë kërkesa në mënyrën e duhur...».

Përfaqësuesi i PK të Spanjës, Alvares, duke fshehur fytyrën e vërtetë të socialdemokracisë, shtron deyturën: «Sot, në saje të zhvillimit të procesit revolucionar botëror dhe në saje të pozitës që disa parti socialiste dhe socialdemokracia në përgjithësi zë në kushtet e sukseseve të forcave demokratike dhe revolucionare, pozita jonë gjithashtu duhet të bëhet e saktë». Më

poshtë ai, duke e quajtur të nevojshme ruajtjen e partive socialdemokrate, thotë: «Nevoja e domosdoshme për unitet shtron para nesh këtë detyrë. Nuk duhet pritur që socialdemokracia të luftojë për socializmin së bashku me komunistët, në qoftë se para saj do të qëndrojë perspektiva e likuidimit si parti politike. Prandaj duhet t'i propozojmë socialdemokracisë një perspektivë tjetër, perspektivën e ruajtjes së saj si parti gjatë kalimit drejt socializmit. Por meqë këto arsyetime të Alvaresit sikur bien në kundërshtim me idenë e partisë së bashkuar, që ai dhe revizionistët e tjerë gjithashtu e përkrahin, vazhdon: «Kjo kërkon nga njëra anë, qartësi në çështjen e partisë së vetme të proletariatit dhe, nga ana tjetër, pranimin e shumëpartishmërisë në socializëm».

I. Lehtineni (Finlanda) kërkon të nxijë të kaluarën revolucionare dhe është për forcimin e afrimit me socialdemokracinë finlandeze me Tenerin në krye, armik i tërbuar i komunizmit. «Partia jonë — thotë Lehtineni — përpiqet për përmirësimin e marrëdhënieve me socialdemokratët. Politika e frontit unik që zhvillon tani PK e Finlandës, ndryshon shumë nga politika e mëparshme, veçanërisht nga ajo që ne zhvilluam në vitet 30-të. Parulla e frontit unik shpesh shtrohej atëherë kryesisht për demaskimin e udhëheqësve socialdemokratë». Ajo nënvizon se sot në Finlandë «midis programit dhe qëllimeve të komunistëve dhe programit e qëllimeve të rrymave socialdemokrate ka pika të caktuara takimi».

Kurse nga diskutimi i U. Keshtanit (PK të Kanadasë) duket qartë se shumë parti komuniste të Perëndi-

mit influencohen në këtë çështje nga qëndrimi i PK Italiane dhe Franceze. Ai vë në pikëpyetje vlerësimet e Leninit dhe mësimet e marksizëm-leninizmit për socialdemokracinë: «L. Grupi pjesërisht e preku temën nëse socialdemokracia përbën me të vërtetë mbështetjen kryesore të kapitalizmit në lëvizjen punëtore. Si marksistë-leninistë ne jemi edukuar duke u nisur pikërisht nga kjo tezë. Në qoftë se kjo tezë do të mbetet në fuqi, atëherë duhej bërë konkluzioni se qëndrimi taktik është një gjë, kurse mundësia e marrëdhënieve shoqërore (në qoftë se lejohet të përdoret kjo termë) me socialdemokracinë në luftën për socializëm është një gjë krejt tjetër». U. Keshtani bën thirrje të hapët për të hedhur poshtë vlerësimin që Lenini i ka bërë socialdemokracisë si agjenturë e borgjezisë në lëvizjen punëtore dhe e bën fare të qartë se ky do të jetë një hap i ri kundër marksizëm-leninizmit, një hap që ai e vlerëson si atë mbi absolutizimin e rrugës paqësore e hapat e tjerë tradhtarë të revizionistëve modernë. U. Keshtani kërkon që socialdemokracia tani e tutje të quhet «rrymë e rëndësishme në lëvizjen punëtore». «Ne duhet ta zgjidhim këtë çështje ashtu siç zgjidhëm çështjen mbi kalimin paqësor, mbi shfrytëzimin e parlamentit dhe shumë çështje të tjera».

A. Peterseni (PK Norvegjeze), në diskutimin e tij, paraqitet apologjet i hapët i socialdemokracisë dhe i kapitalizmit. Ai thotë: «Në Norvegji socialdemokracia gjatë shumë vjetëve ka qenë në pushtet. Dhe në sytë e klasës punëtore ajo dhe askush tjetër zhduku varfërinë në vend. Sipas mendimit të popullit, pikërisht socialdemokracia zhduku shtypjen dhe siguroi liritë demo-

kratike». Pasi flet për nivelin e lartë të jetesës në Ven-det Skandinave, Peterseni thekson: «Në këto kushte është vështirë të thuash se socialdemokratët janë armiq të popullit punëtor, agjentë të borgjezisë. Kjo është jo vetëm e vështirë, por edhe budallallëk. Duke u nisur nga kjo jemi munduar të ndryshojmë qëndrimin tonë ndaj socialdemokracisë, dhe jo vetëm ndaj anëtarëve të thjeshtë të kësaj partie, por edhe ndaj udhëheqjes së saj. Ne jemi detyruar të pranojmë faktin se klasa punëto-re përkrah socialdemokracinë dhe se influenca e partisë sonë në zgjedhjet po pakësohet... Duhet pranuar se ne vetë, si pasojë e pozitave tona dogmatike, e kemi ndihmuar borgjezinë në propagandën e saj. Ne e kuptuam këtë dhe u përpoqëm të nxjerrim mësim që këtëj në programin e partisë sonë, të aprovuar në vitin 1963». Me një «autokritikë» të tillë A. Peterseni mohon plotësisht rolin e partisë komuniste dhe paraqitet partizan i flaktë i socialdemokracisë.

Pas një paraqitjeje të tillë të hapët të pikëpamjeve oportuniste e kundërrevolucionare, dhe përfaqësuesi i PK të BS, E. Ambarcumov, nuk deshi të mbetej më pas, prandaj, në diskutimin e tij «përkrah mendimin e shprehur gjatë diskutimit se gjatë 2-3 vjetëve të fundit, nën presionin e lëvizjes së masave në radhët e partive socialdemokrate, është shënuar një lëvizje e caktuar nga e majta». Ai është dakord edhe me «kritikën e disa aspekteve të politikës së kaluar të lëvizjes komuniste» ndaj socialdemokracisë. Ambarcumovi thotë se në përpjekjet për unitet midis komunistëve duhet të ketë «luftë ideologjike dhe politike, por luftë aleatësh e jo armiqsh».

Kështu e shtrojnë problemin e unitetit përfaqësuesit e revizionizmit modern në vende të ndryshme. Në to s'ka asgjë të re e të ndryshme në thelb nga ato që shpreh diskutimi në PK Italiane dhe përfaqësuesi i saj më i avancuar, Amendola. Pra, lufta e revizionistëve për degjenerimin organizativ dhe shkatërrimin e partisë marksiste-leniniste, armës kryesore në dorë të proletariatit për të kryer revolucionin e për të ndërtuar socializmin, është vënë në rendin e ditës, duke dalë nga kuadri nacional dhe duke u bërë një fenomen ndërkombëtar, ashtu siç është bërë prej kohësh një fenomen ndërkombëtar tërë revizionizmi modern.

Kjo vërtetohet edhe një herë se sa larg kanë shkuar në rrugën e tyre të tradhtisë revizionistët modernë. Faktet po provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se ata tanimë s'i dallon asgjë nga socialdemokratët dhe se në të gjitha fushat janë afruar e po bashkëpunojnë jo me ta, por me vetë padronin e tyre — imperializmin botëror me atë të SHBA-së në krye.

Për këtë arsye sot shtrohet më me forcë se kurrë detyra imperative: Të shkatërrohen planet e revizionizmit modern për të çarmatosur klasën punëtore e për ta destinuar atë të rrojë ose të kthehet në shfrytëzimin e egër kapitalist. Të demaskohen taktikat demagogjike të udhëheqjes së sotme sovjetike, e cila po përpiqet të zbatojë nën rrogos hrushovizmin pa Hrushovin në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe likuidimin e partive komuniste. Tani s'mbetet më vend për iluzione.

S'ka dyshim se forcat marksiste-leniniste në vendet apo partitë ku në udhëheqje janë revizionistët, s'do ta

lënë klasën punëtore të çarmatosur dhe në mëshirë të fatit. Përkundrazi, nga gjiri i tyre, nga gjiri i proletariatit të shumëvuajtur atje po lindin një nga një filizët e partive të vërteta revolucionare të tipit të ri leninist. Ky është një proces objektiv i pandalshëm, ashtu sikundër janë objektive dhe të pandalshme vdekja e sigurt e sistemit të urryer kapitalist dhe e pjellës së tij — revizionizmit modern — dhe triumfi përfundimtar i socializmit dhe i komunizmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 124 (5220) dhe Nr. 125 (5221), 25-26 prill 1965

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 345. Tiranë, 1965

LUFTA E POPULLIT TË VIETNAMIT TË JUGUT VËRTETON PARIMIN SE LIRIA NUK DHUROHET, POR FITOHET

*Nga biseda me një delegacion të Shoqatës së
Punonjësve për Çlirimin e Vietnamit të Jugut*

30 prill 1965

*Pasi përshëndetet përzemërsisht me miqtë dhe i fton
që të zënë vend, fjalën e merr shoku Enver Hoxha:*

Jemi shumë të gëzuar për ardhjen në vendin tonë të përfaqësuesve të popullit vietnamez, të cilin ne e kemi dashur dhe e duam me gjithë shpirt, sepse është një popull heroik dhe lufta e tij përbën një shembull për të gjithë popujt e botës. Me luftën e tij, me gjakun dhe me sakrificat e tij, populli i Vietnamit të Jugut u tregon gjithë popujve, për të cilët është e shtrenjtë liria e pavarësia, se si duhet të luftojnë dhe të qëndrojnë kundër imperializmit amerikan, armikut më të madh të njerëzimit.

Gjithë populli ynë, të dashur shokë, është me ju, se e di që po luftoni me heroizëm dhe jeni duke bërë sakrifica të mëdha. Ne kemi besim se lufta juaj do të

shkojë, ashtu si gjer më sot, nga fitorja në fitore dhe se, nëpërmjet saj, ju medoemos do të korrni fitoren përfundimtare. Vietnami do të bëhet varri i imperializmit amerikan, i cili do të pësojë te ju një nga disfatat e tij më të mëdha, duke iu afruar kështu fundit të tij të pashmangshëm.

Sigurisht, ju tani po kaloni momente të vështira, por ne gëzohemi shumë kur mësojmë se katër të pestat e Vietnamit të Jugut janë çliruar dhe se imperialistët amerikanë janë grumbulluar si gaforret vetëm në Sajgon, Da Nang dhe në disa qendra të tjera të mëdha.

Lufta e popullit tuaj është një sakrificë e madhe, por ajo bën në botë një efekt shumë të madh. Kur derdh gjakun për një çështje kaq të madhe, kjo nuk mund të mos lërë gjurmët e veta në çështjen e popujve. Lufta e popullit vietnamez është një histori që po shkruhet me gjakun e tij. SHBA çdo ditë po pësojnë disfata në Vietnam dhe po diskreditohen.

Ju keni marrë vesh që ushtria amerikane është futur edhe në Santo Domingo¹ dhe sot kanë shkuar atje dhe trupa të tjerë amerikanë. Shihet, pra, se çfarë xhandari ndërkombëtar janë bërë SHBA.

Si shkon tani lufta në Vietnamin e Jugut?

Duke marrë fjalën, miqtë vietnamezë falënderojnë shokun Enver Hoxha për këtë takim të përzemërt e

¹ Është fjala për agresionin e armatosur që ndërmoren SHBA në Republikën Domenikane, duke dërguar dhjetëra mijëra ushtarë për të shtypur lëvizjen patriotike të masave dhe për të shpëtuar qeverinë e gjeneralëve ultrareaksionarë të krijuar pas grushtit të shtetit të 24 prillit 1965.

miqësor dhe shprehin ndjenjat e mirënjohjes së thellë për ndihmën e pakursyer internacionaliste që PPSH dhe populli shqiptar i kanë dhënë dhe i japin popullit vietnamez në luftën e tij për çlirim. Pasi ata e informojnë mbi gjendjen e luftës në Vietnamin e Jugut dhe për vendosmërinë e popullit vietnamez për të shkuar drejt fitores përfundimtare, fjalën e merr përsëri shoku Enver Hoxha:

Amerikanët në Vietnam janë vënë në pozita të vështira, si politikisht ashtu edhe ushtarakisht. Politikisht ata janë krejt të demaskuar. Parulla e tyre politike se gjoja kanë ardhur në Vietnam për të ndihmuar «qeverinë» e Sajgonit, ka rënë krejtësisht, pasi në Vietnamin e Jugut sot nuk ekziston një qeveri e ligjshme. Edhe parulla tjetër se gjoja mbrojnë Vietnamin e Jugut, prapë nuk pi ujë, pasi vetë populli vietnamez është hedhur i tëri në luftë kundër imperializmit agresor amerikan dhe se dihet që asnjë agresor nuk mund të jetë mbrojtës i popujve, por vrasës i tyre. Të gjithë, pra, e kanë të qartë se në Vietnam amerikanët mbrojnë vetëm interesat e tyre imperialiste. Por lufta juaj ka shpartalluar dhe po shpartallon çdo propagandë e demagogji të tyre. Edhe ushtarakisht, në Vietnam, amerikanët tani mbështeten vetëm te forca e armëve, tek aviacioni, te bombat me napalm dhe gazet mbytëse. Tjetër nuk kanë ç'të bëjnë, pasi, jashtë qendrave kryesore as kokën nuk nxjerrin dot. Në këto situata kaq të vështira për ta, ata kanë filluar të bombardojnë Vietnamin e Veriut, por edhe vetë e kuptojnë se bombardimet e tyre në Veri nuk bëjnë asnjë efekt në favor

të politikës së tyre, përkundrazi i diskreditojnë edhe më keq.

Gazetari amerikan Lipman, shërbëtor i njohur dhe besnik i imperializmit, në një artikull që ka shkruar kohët e fundit, bën pyetjen nëse duhet apo jo ta vazhdojnë SHBA luftën në Vietnam dhe ç'fitime konkrete do të kenë ato nga vazhdimi i luftës dhe prej bombardimeve. Ai, i detyruar nga realiteti dhe i deziluzionuar, përgjigjet se SHBA nuk do të kenë asnjë fitim, përkundrazi, arsyeton ai, me këto veprime amerikanët më shumë nxitin urrejtjen e madhe të popujve dhe shtojnë valët e luftërave nacionalçlirimtare. Prandaj, konkludon ky gazetar, kjo është një politikë e humbur.

Natyrisht, Lipmani nuk i thotë këto ngaqë është kundër politikës agresive të imperializmit amerikan, sepse ai është pjellë e këtij imperializmi dhe mbrojtës i tij. Ai i thotë këto sepse është i detyruar nga realiteti i hidhur për të, por edhe për t'u tërhequr vëmendjen qarqeve drejtuese të SHBA-së që të përcaktojnë e të ndjekin metoda më të rafinuara në luftën kundër lirisë dhe pavarësisë së popujve.

Lufta e popullit të Vietnamit të Jugut, të dashur shokë, është një shembull i shkëlqyer konkret që vërteton drejtësinë dhe vlerën universale të parimit marksist-leninist se liria nuk dhurohet, por fitohet, se imperializmi ka qenë e do të mbetet gjer në fundin e tij luftënxitës dhe agresor, se kundër kësaj politike të imperializmit nuk pinë ujë llafët rrotull tryezave, por aksionet, lufta e armatosur dhe e përgjithshme e popullit. Këtyre mësimëve u kanë qëndruar dhe do t'u qëndrojnë kurdoherë besnike Partia jonë dhe të gjitha par-

titë e tjera marksiste-leniniste dhe ne gëzohemi që lufta juaj mbështetet fuqimisht në këto mësim të padekshme. Duke u bazuar në këto parime, ju kurrë nuk do të mundeni, përkundrazi, kurdoherë do të fitoni. Kush ndjek këto mësim, ai do të fitojë me siguri.

Revizionistët modernë na kanë akuzuar ne si «ekstremistë», «dogmatikë», «antileninistë», «trockistë», «aventurierë», që gjoja nuk i kuptojmë mirë situatat, kurse ata vetë na qenkëshin marksistë të kulluar! Por jeta vërtetoi se kush kishte dhe kush nuk kishte të drejtë. E drejta ishte dhe është nga ana jonë. Tani ju e dini fare mirë se manovrat e revizionistëve modernë nuk kanë mbaruar. Pikëpamjet e veta për ta Partia jonë i ka thënë haptazi. Mendimi ynë është se revizionistët sovjetikë janë tradhtarë të pakorrigjueshëm. Pretendimet e tyre për «ndihmat» që japin, kanë qëllime të këqija dhe fshehin nga prapa kurthe e komplete skllavëruese. Por as partizanët e Vietnamit të Jugut, as Vietnami i Veriut, as shqiptarët, dhe të gjithë ata që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste nuk mund të gënjenen nga demagogjia e tyre.

Lufta kundër amerikanëve në Vietnam nuk filloi dje. Ajo ka mbi 10 vjet që zhvillohet e ashpër dhe e përgjakshme. Në goftë se Hrushovi dhe shokët e tij do të ishin në vijë të drejtë, jo vetëm duhet ta kishin mbushur Vietnamin me armë dhe raketa dhe me të gjitha rezervat e nevojshme, por edhe vetë duhej t'i deytironin vrasësit amerikanë që të hiqnin dorë nga agresioni në Vietnam. Këtë gjë Bashkimi Sovjetik duhet ta kishte bërë qysh 7-8 vjet të shkuara. Tani Brezhnëvi dhe Kosigini bërtasin se gjoja janë në favor të

Vietnamit, se gjoja do të dërgojnë atje vullnetarë e armë. Kapja pas Kinës këtu është një justifikim për të mbuluar tradhtinë, sepse për të çuar ndihmat në Vietnam nuk është e thënë të kalosh medoemos nga Kina, por ka edhe rrugë të tjera. Por ne pyesim: para 6 vjetësh, kur amerikanët i kishin futur thonjtë në Vietnamin e Jugut, nuk mundte dot BS ta ndihmonte konkretisht, fjala vjen, duke ndërtuar disa aerodrome të mëdha në Vietnamin e Veriut, duke i dhënë atij avionë, bombardierë e sulmues Mig-21 për të qenë i gatshëm për këtë ditë? A nuk mundte të përgatiste me kohë BS aviatorë vietnamezë? A nuk mundte dot qysh 6 vjet më parë BS t'i plotësonte me raketa nevojat e Vietnamit të Veriut për mbrojtjen e një populli vëlla? E kush do ta ndalonte atë t'i jepte këto ndihma? SHBA? Jo, këto nuk kishin të thonin asnjë fjalë, sepse ato vetë kanë mbushur me të tilla armë të gjithë aleatët e tyre.

Kur u bë sulmi anglo-franko-izraelit në Egjipt, Hrushovi u mburr sikur gjoja i paskësh bërë telegram Idenit të largonte trupat andej, ndryshe shtypej susta dhe lëshoheshin raketa në drejtim të Anglisë. Por ky ishte vetëm një bluf, gjë që u vërtetua nga fakti se, kur imperializmi u tregua kokëfortë në politikën e tij agresive, Hrushovi mburravec, që me fjalë na i bëkej imperializmit batërdinë, jo më që nuk i «shkeli sustat», por bëri çmos dhe vazhdimisht punoi që Vietnamit të çarmatosej, që Shqipëria të çarmatosej. Dhe ja tani, pasardhësit e tij besnikë, për demagogji, bërtasin se gjoja janë të dëshiruar për t'i ardhur në ndihmë Vietnamit! Ky është një spekulim nga ana e tyre. Njerëz

të vërtetë dhe trima janë ata që bëjnë shumë dhe flasin pak. Hrushovi ishte një blofer, një sharlatan dhe gënjeshtar i madh që çdo ditë lëshonte ç'mundte. Kurse Stalini pak fliste, por kur fliste, dridheshin imperialistët.

Këto dy-tri ditët e fundit më duket se nga një anëtar i Byrosë Politike të PK revizioniste Italiane është shkruar një artikull që shoqëron vajtjen e Pajetës në Vietnamin e Jugut. Në artikull, me dashje ose pa dashje, thuhet se udhëheqjes së PK Italiane i shkojnë letra nëpërmjet të cilave kërkohet llogari se çfarë bën udhëheqja e partisë për t'i ardhur në ndihmë popullit vietnamez që po lufton. Si konkluzion, autori thotë në artikull se nuk janë në gjendje t'u përgjigjen të gjitha këtyre letrave, por njofton se është nisur për në Vietnam Xhankarlo Pajeta për të biseduar me shokët vietnamezë dhe se në Itali është hapur një fushatë për të blerë një spital fushor për luftëtarët vietnamezë. Revizionistët gjithçka e bëjnë vetëm për demagogji. Pse, vallë, një spital i lypur që do të çojë Pajeta do ta shpëtojë Vietnamin? Por krerët revizionistë italianë u bëjnë bujë këtyre gjërave për të gënjer komunistët dhe popullin italian. Kështu veprojnë edhe revizionistët sovjetikë. Por edhe «ndihmat» sovjetike për Vietnamin janë kaq të parëndësishme, saqë nuk i shqetësojnë fare agresorët amerikanë. Ato jepen vetëm për demagogji. Me anë të këtyre «ndihmave» revizionistët sovjetikë synojnë të ndërhyjnë sa më shumë në Vietnam për interesat e tyre hegjemoniste e për të bërë presion mbi Vietnamin që të kapitullojë para imperializmit amerikan.

Qëndrimi që mbahet ndaj SHBA-së lidhur me problemin vietnamez ka shumë rëndësi. SHBA duhet të bllokohen nga të tëra forcat antiimperialiste në çdo drejtim. Populli vietnamez lufton kundër amerikanëve dhe është thikë më thikë me ta. Por revizionistët hrushovianë në vend që t'u ndalin dorën agresorëve, bëjnë krejt të kundërtën. Qëndrimi i tyre ndaj SHBA-së lidhur me Vietnamin karakterizohet nga demagogjia dhe kapitullimi ndaj amerikanëve, nga veprimet konkrete për të hyrë në pazarllëqe të reja me ta. Kjo duket edhe në faktin që kur studentët vietnamezë në Moskë u ngritën para pak kohësh në demonstratë për të protestuar kundër agresionit imperialist në Vietnam, udhëheqja sovjetike e shtypi demonstratën duke gjetur si shkak gjoja mbrojtjen e ambasadës amerikane. Më pas edhe studentët tuaj që janë në Leningrad u ngritën në demonstratë. Megjithëse në këtë qytet nuk ka asnjë ambasadë të huaj, sovjetikët e shtypën edhe këtë demonstratë me dhunë, duke plagosur shumë studentë. Lind pyetja: Mirë në Moskë udhëheqësit sovjetikë gjetën shkak gjoja mbrojtjen e ambasadës amerikane, po në Leningrad kë do të mbronin nga demonstruesit? Në të vërtetë ata e shtypën edhe demonstratën në Leningrad sepse kishin frikë se së bashku me studentët vietnamezë, do të mbushnin rrugët e qytetit edhe njerëzit sovjetikë, gjë që do t'i demaskonte më tej revizionistët hrushovianë. Atëherë si t'u besosh demagogjisë dhe «ndihmave» të tyre? Gjersa ata thonë se gjoja janë me Vietnamin, përse pra nuk i lanë studentët vietnamezë të bënin demonstrata kundër imperializmit? Përse patën frikë nga populli sovjetik të demon-

stronte bashkë me vietnamezët në Moskë e në Lenin-grad? Kuptohet, ata i preokuponte se çfarë do të thoshin SHBA për këtë gjë dhe kishin frikë se mos u zemërohej imperializmi e u prisheshin akordet e fshehta që kanë thurur së bashku.

Revizionistët sovjetikë janë larguar krejtësisht nga rruga e komunizmit, ata janë bërë plotësisht deviatorë dhe mendojnë se me qëndrimet dhe kombinacionet e tyre do të gënjejnë marksistët. Këtë e bëjnë se nuk mendojnë më si marksistë, se ata janë shkëputur dhe do të shkëputen gjithnjë e më shumë nga masat e popullit. Natyrisht në dorë atyre do t'u mbetet në fund të fundit vetëm terrori.

Revizionistët përpiqen të përfitojnë nga situata e tanishme. Ata mendojnë se do të përfitojnë nga derdhja e gjakut tuaj të vlefshëm. Por revizionistët duhet ta kenë të qartë se as populli i Vietnamit të Jugut, as ai i Veriut nuk luftojnë për të krijuar një bagazh politik për revizionistët sovjetikë, përkundrazi luftojnë për lirinë e vendit të tyre, për socializmin dhe komunizmin, për paqen në botë. Ne jemi plotësisht dakord me Deklaratën e Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut, sepse ajo shpreh ndjenjat e aspiratat e një populli trim, të popullit tonë dhe të popujve të të gjithë botës. E tillë është forca e kësaj deklaratë dhe jemi plotësisht të bindur se ajo do të ketë reperkusione të mëdha. Ne nuk e humbasim kurrë këtë shpresë dhe tani kanë ardhur të tilla momente që revizionistët atje dhe kudo po marrin të tatëpjetën. Ata do të dështojnë, ndërsa fitorja është me ne.

Është e vërtetë se aktualisht te ju ka shumë vështirësi, por me siguri ato do të kapërcehen. Ju thatë se «mendimet e popullit të Vietnamit të Jugut janë shumë të ngjashme me mendimet e popullit shqiptar». Ashtu është, ne kuptohemi me njëri-tjetrin, se udhëhiqemi nga ideale të përbashkëta, ushqehemi nga e njëjta ideologji, ndjekim një vijë të përbashkët. Partia jonë i njeh dhe i vlerëson qëndrimet e drejta të Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut.

Sot, në komisionin e punëve të jashtme të Kuvendit tonë Popullor, po studiohet Thirrja e Asamblesë Kombëtare të RD të Vietnamit, e cila do t'i paraqitet Presidiumit të Kuvendit Popullor për aprovim¹. Për- sa i përket ndihmës për Vietnamin, edhe ne, me të gjitha mundësitë që kemi, do t'ju ndihmojmë. Në këto momente nuk ka vështirësi më të mëdha se tuajat, prandaj shoku e ka për detyrë ta ndihmojë shokun që ka vështirësi më të mëdha. Ne jemi marksistë, prandaj dhe po mendojmë se çfarë do të bëjmë për ju. Është detyra jonë t'ju japim ndihmën tonë, pa bërë bujë si sovjetikët. Ne nuk bëjmë reklama dhe na qan

¹ Sesioni i dytë i Asamblesë Kombëtare të RD të Vietnamit, i mbajtur më 8-10 prill 1965, drejtoi një Thirrje, nëpërmjet së cilës ftonte gjithë parlamentet e botës të vepronin në forma të ndryshme për të përkrahur popullin vietnamez në luftën e tij kundër agresionit amerikan.

Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH, pasi e shqyrtoi këtë Thirrje, më 3 maj 1965 aprovoi një deklaratë në përkrahje të luftës së drejtë të popullit vietnamez.

zemra për gjakun që derdhin shokët dhe vëllezërit tanë vietnamezë.

Dhe jini të bindur, shokë, se po ta gjeni me vend që në Vietnam të vijë vullnetarë edhe nga vendet e tjera, vullnetarë do të vijë edhe nga Shqipëria për të derdhur gjakun e tyre së bashku me ju. Po dijeni se ata do të jenë vullnetarë të vërtetë dhe besnikë të çështjes së popullit vietnamez e jo si ata që do të përpiqen të luajnë rolin e kolonës së pestë. Ju, vietnamezët, jeni të regjur në luftë dhe elementëve të kolonës së pestë do t'ua zbuloni fytyrën e do t'u tregoni gardhin.

Me këto ne s'bëjmë gjë tjetër veç detyrës sonë. Edhe ju me luftën tuaj heroike po bëni një detyrë shumë të lartë ndaj çështjes së popujve dhe të komunizmit. Tani e gjithë bota pret Dien Bien Funë e dytë në Da Nang që pastaj amerikanët, prej andej, të hidhen në det. Ne besojmë plotësisht se do të vijë me doemos kjo ditë.

Duke e marrë fjalën, kryetari i delegacionit tha:

Sukseset tona janë fitore të marksizëm-leninizmit dhe disfata për revizionizmin modern. Lufta jonë ka dy qëllime, të fitojmë kundër imperialistëve amerikanë dhe të bëjmë të dështojnë edhe planet e revizionistëve modernë. Ajo ka bërë që t'u hiqen një nga një maskat e shumta, me të cilat janë mbuluar imperialistët dhe revizionistët modernë që ndihmojnë kolonializmin e ri në Vietnamin e Jugut. Kjo ka bërë që amerikanët në vendin tonë të pësojnë shumë disfata. Praktika jonë demaskoi gjithashtu edhe rrugën e bashkekzistencës paqësore me imperializmin, që predikojnë revizionistët. Revizionistët modernë bërtasin sikur janë në përkra-

hje të luftës sonë, por sa e ndihmojnë ata luftën e popullit tonë ne e kemi të qartë, ne e dimë kush na ndihmon me zemër dhe kush na e ka me hile.

SHOKU ENVER HOXHA: Dëshirojmë që të rri-
ni disa ditë dhe të bëni shumë vizita në Shqipëri, të
shikoni vendin tonë, të merrni kontakt sidomos me ma-
sat e popullit. Në takimet që do të bëni me njerëzit
tanë ju do të kryeni një shërbim të madh për forcimin
edhe më shumë të miqësisë luftarake që ekziston mi-
dis dy popujve tanë. Në këto takime ju do të ndieni
pulsin dhe të rrahurat e zemrës së popullit tonë për
popullin tuaj. Ne mund t'ju themi fjalë të mira, por
kur të shkoni e të takoni vetë popullin tonë do ta
shikoni edhe më mirë e më konkretisht sa shumë e do
ai popullin tuaj heroik.

Shokë, le ta ngremë këtë doli për lavdinë e po-
pullit heroik të Vietnamit, për fitoren tuaj, për luf-
tëtarët e Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të
Jugut, për Partinë e Punonjësve të Vietnamit dhe sho-
kun Ho Shi Min!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**LUFTËN KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE
REVIZIONIZMIT DO TA ZHVILLOJMË
DERI NË FITOREN E PLOTË
TË MARKSIZËM-LENINIZMIT**

*Nga biseda me përfaqësues të komunistëve
marksistë-leninistë të Francës*

30 prill 1965

*Pasi mysafirët priten ngrohtësisht dhe zënë vend,
fjalën e merr shoku Enver Hoxha:*

Për ne është një kënaqësi e madhe të bisedojmë me ju, shokë komunistë të rretheve marksiste-leniniste të Francës. Ju falënderoj për vizitën që jeni duke bërë në vendin tonë. Të dy palëve na lidhin bashkërisht shumë gjëra, pasi kemi të njëjtat qëllime. Shokët tanë na kanë vënë në dijeni për punën që bëjnë rrethet marksiste-leniniste të Francës dhe ne e vlerësojmë atë. Duke e konsideruar si detyrë internacionaliste, ne përpiqemi t'ju ndihmojmë sipas nevojave që ju paraqiten dhe sipas mundësive tona, duke pasur parasysh që të mos ndërhyjmë aspak në punët tuaja.

Cështja e përcaktimit dhe e zbatimit të një platfor-

me sa më të drejtë ka rëndësi të veçantë. Vija politike dhe puna e partisë duhet të konformohen edhe me anën teorike, edhe me atë praktike, pra të jenë në harmoni në të dyja këto drejtime. Natyrisht, partia e klasës punëtore mbështetet dhe udhëhiqet nga teoria revolucionare, por puna më e madhe është që, pa mbetur vetëm te formulimet teorike, ta zbatojë sa më drejt në praktikë vijën e saj.

Duke folur për eksperiencën tonë, mund të themi se në programin e Partisë ne nuk flisnim qysh në fillim se Partia do të bënte Reformën Agrare, por propagandohej se do të zgjidhej drejt çështja agrare dhe se fshatarët do të merrnin tokë. Dhe kështu u bë. Kur erdhi koha, Partia e realizoi në praktikë Reformën duke ua dhënë tokën fshatarëve, atyre që e punonin. Me këtë dua të them, pra, që Partia e proletariatit nuk ka pet pas frazave, por i kushton rëndësi zbatimit të drejtë të vijës së saj në terrenin praktik. Sigurisht, teoria nuk duhet nënvleftësuar, por thelbi qëndron te vija e përgjithshme, te përcaktimi qartë se kush është armiku kryesor dhe si duhet të goditet ai, te sqarimi, përgatitja dhe mobilizimi i masave në aksione revolucionare. Por këto nuk mund të bëhen me formula teorike, aq më pak kur janë të gjata, të errëta, të paqarta, që nuk kanë vlerë për masat, të cilat kanë nevojë për gjëra të qarta, konkrete që t'i mobilizojnë dhe t'i orientojnë si të hidhen në revolucion për përmbysjen e borgjezisë dhe jo për llafe.

Ne e ndiejmë për detyrë që t'i ndihmojmë të gjithë ata që janë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, me qëllim që të bashkohen. Në këtë drejtim ne

kemi eksperiencën e grupeve komuniste që ekzistonin në vendin tonë para formimit të Partisë. Por bashkimin e grupeve komuniste në Francë nuk mund ta bëjë kush tjetër përveç marksistë-leninistëve të vërtetë francezë që punojnë e militojnë atje, që e njohin më mirë se kushdo tjetër situatën në Francë. Këta do të jenë gjithashtu ata që do të krijojnë partinë e re komuniste në Francë në kohën e duhur. Që të krijosh partinë nuk është një punë e lehtë. Eksperienca na ka mësuar që partia kur të krijohet të jetë monolite. Prandaj në qoftë se ka mosmarrëveshje midis grupeve, është e domosdoshme që të likuidohen këto mosmarrëveshje qysh përpara krijimit të partisë, sepse, po të krijohet partia pa i likuiduar ato, atëherë, në gjirin e saj do të formohen fraksione ose do të ketë grindje. Një parti e tillë do të ishte vetëm sa për emër.

Ja, për shembull, te ne komunistët revolucionarë u ngritën mbi mosmarrëveshjet e grupeve komuniste, mbasi në vendin tonë pati edhe disa kushte të favorshme. Në radhë të parë ishte dëshira e gjithë popullit për të flakur jashtë vendit pushtuesit e huaj, prandaj grupet komuniste i lanë mënjanë mosmarrëveshjet, i dhanë fund përçarjes, u bashkuan dhe krijuan Partinë.

Mua më duket se marksistë-leninistët e Francës po veprojnë mirë në këtë drejtim. Në qoftë se organizohet mirë puna dhe merret mirë situata në dorë, atëherë ajo do të shkojë përpara. Për këtë ndihmon shumë edhe kombinimi i punës së atyre që janë ca të kaluar nga mosha, por që kanë eksperiencë të madhe pune, me atë

të të rinjve, të cilët i ndihmon mosha, janë më të hedhur dhe më të gjallë.

Krijimi i Partisë Komuniste marksiste-leniniste në Francë do të jetë një kthesë e madhe në jetën e vendit tuaj. Kjo do të jetë me të vërtetë një ngjarje me rëndësi. Ne vërtet nuk e njohim mirë situatën te ju, por nuk e konsiderojmë punë shumë të lehtë krijimin e partisë, sepse do të hasni edhe në vështirësi. Veçanërisht nuk duhet nënvleftësuar partia revizioniste franceze. Por jemi të sigurt se marksistë-leninistët e Francës nuk pajtohen me vijën revizioniste të saj. Pikërisht kjo ishte dhe arsyeja që ata u larguan prej saj me vendosmëri, megjithëse kishin milituar në të për një kohë të gjatë. Por në asnjë mënyrë nuk mund të neglizhohen masat e gjera të anëtarëve të kësaj partie dhe nuk do të ishte aspak e drejtë t'i konsideronim të gjithë anëtarët e saj tradhtarë. Ka shumë prej tyre që janë njerëz të ndershëm dhe po të punohet me ta, do të arrijnë të kuptojnë të vërtetën, do të mbajnë qëndrimin e duhur dhe kështu mund të tërhiqen në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Mbështetja më e mirë për marksistë-leninistët është klasa punëtore. Ne i njohim mirë klasën punëtore franceze, luftën dhe sindikatat e saj. Në këto situata që po kalojnë ato do të ketë edhe shokë komunistë, apo grupe që do të rrinë mënjanë, ose që do të lëkunden sa andej-këtej. Por gjendja dhe pozita e secilit duhet parë konkretisht e jo duke u nisur nga fjalët. Kështu ata që janë në rrugë të drejtë, por që kanë paqartësira, duhen ndihmuar, por edhe me ata që nuk janë në rrugë të drejtë, prapë duhen bërë përpjekje që të ndihmohen dhe

të sqarohen. Këtë e kemi nga eksperiencia jonë. Edhe ne e kemi kaluar rrugën në të cilën po kalojnë tani marksistë-leninistët e Francës. Natyrisht, për kushtet tona, ne këtë rrugë e kaluam më lehtë. Qysh pas krijimit të Partisë sonë na dolën armiq, të cilët u përpoqëm t'i bindim që të vinin në rrugë të drejtë. Mirëpo, kur më punën e tyre ata filluan ta luftojnë Partinë, atëherë kjo u tregoi vendin. Kemi pasur edhe të tjerë që i kemi duruar për vite me radhë dhe i mbanim në gjirin tonë, meqë gjatë luftës kishin bërë diçka. Por, duke parë se ata vazhdonin të gabonin dhe, kur më në fund, edhe pse ishte bërë një punë e gjatë me ta, nuk u ndreqën, atëherë i flakëm tej si të padenjë.

Duke marrë fjalën, mysafirët falënderojnë shokun Enver për këtë takim të ngrohtë, shprehën ndjenjat e tyre të dashurisë e të respektit për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar. Pasi ata i japin si dhuratë shokut Enver studimin e një profesori francez, ku flitej për lidhjet e lashta që kanë ekzistuar midis popullit francez dhe atij shqiptar, fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Ju faleminderit për dhuratën. Rëndësi ka çështja që ky profesor është interesuar për gjuhën tonë. Ka edhe mjaft historianë francezë që kanë shkruar për Skënderbeun, por shumë të tjerë janë kapur më shumë nga kultura latine, greke, sllave etj., duke lënë mënjane kulturën e pellazgëve dhe të ilirëve. Këtë boshllëk tani po e plotësojnë historianët tanë.

Revizionistët modernë kërkonin të na pengonin në ekonomi. Ata përpiqeshin të na ndërronin orientimin e drejtë që kishte dhënë Partia jonë për zhvillimin e buj-

qësisë, duke na «këshilluar» të mbillnim portokaj e limonë dhe jo drithëra, duke na thënë që të mos shqetësoheshim për bukën, sepse këtë do të na e jepnin ata.

Revizionizmi modern është një rrezik i madh për marksizëm-leninizmin dhe për gjithë njerëzimin përparimtar. Partia jonë e pa drejt dhe në kohën e duhur këtë rrezik dhe nuk u tremb as nga fuqia e madhe e Bashkimit Sovjetik, as nga demagogjia dhe intrigat e mëdha të Hrushovit. Ne jo se i pamë qysh në fillim me atë qartësi që i pamë më vonë qëllimet e Hrushovit, por disa qëndrime jo të mira politike, ideologjike dhe ekonomike të tij i kishim vënë re me kohë. Një gjë e tillë na kishte ndodhur kohë më parë edhe me revizionistët jugosllavë. Te jugosllavët, qysh në kohën e luftës, shikonim tendenca të theksuara nacionaliste, ndërhyrje nga ana e tyre në punët tona, një tendencë paternaliste ndaj Partisë sonë. Këto shfaqje na revoltuan. Por më vonë, në marrëdhëniet që patëm me ta, u bëmë plotësisht të qartë mbi tradhtinë e tyre. Një ndihmë të madhe për këtë gjetëm te letrat e Stalinit dhe Rezoluta e Byrosë Informative.

Enjëjta gjë u vu re edhe me Hrushovin. Ky, nga njëra anë, dukej sikur na përkrahte, nga ana tjetër donte të na bënte të keqen. Që në fillim nisëm të kuptonim se në marrëdhëniet e tij me ne diçka nuk po shkonte mirë. Kur ai filloi të afrohej me revizionistët jugosllavë, zuri të na fërkonte krahët, por ne bëheshim gjithnjë e më të kujdesshëm ndaj tij. Kur nisi ta diskreditojë Stalinin, atëherë mbajtëm qëndrim, sepse e pamë më qartë se s'kishim të bënim me gabime të rastit të hrushovianëve, por me një fushatë të tërë. Qëllimi i tyre

ishte që, duke goditur Stalinin, të godisnin marksizëm-leninizmin dhe veprën e madhe të Stalinit. Prandaj ne e kundërshtuam me vendosmëri grupin e Hrushovit.

Tani revizionistët sovjetikë po përpiqen të flasin diçka për Stalinin. Këtë e bëjnë jo se janë penduar, por sepse janë të detyruar nga situatat në vendin e tyre. Kush po flet tani në BS në favor të Stalinit? Pikërisht shumë nga ata që gjer dje kanë folur aq shumë kundër tij. Por ne nuk mund të pranohim kurrë poshtërsitë e mëdha që u thanë nga revizionistët për Stalinin. Këto shpifje nuk i pranohim asnjë njeri i ndershëm. Atëherë hrushovianët punonin fshehtëzi, manipulonin fakte të ndryshme, i vullën të gjitha menjëherë një ditë dhe nxorën «teorinë» e tyre të diskredituar kundër Stalinit, atë të luftës kundër «kultit të individit dhe pasojave të tij». Komunistët dhe patriotët në Bashkimin Sovjetik u ndodhën përpara një situatë mbytëse. Ata nuk u treguan vigjilentë, por dëgjonin dhe pranohnin formulat e disa marshalëve sovjetikë që me demagogji donin të vinin në dukje se gjoja Luftën e Madhe Patriotike e kanë udhëhequr këta. Kushdo e dinte dhe e di se luftën në të vërtetë e udhëhoqi Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, e në udhëheqje të kësaj partie e të kësaj veprimtarie të gjerë ishte Stalini. Por për këtë marshalët nuk thoshin asnjë fjalë, sepse shumë prej tyre qenë komprometuar nga Hrushovi. Të gjithë ata që gjatë luftës nuk e kryen si duhet detyrën e tyre karshi atdheut, Hrushovi i ngriti në përgjegjësi pa e merituar dhe përpiqet që gjithë meritat për Luftën e Madhe Patriotike t'ua dedikojë atyre, duke thënë se gjoja këta i paskëshin propozuar Stalinit për iniciativat e tyre gjatë luf-

tës. Pikërisht këta njerëz të komprometuar janë ata që tani po e kthejnë prapë fletën, duke thënë ndonjë fjalë të mirë për Stalinin. Kjo, natyrisht, është e mirë për ne dhe e keqe për ata. Ne e kuptojmë se ata e bëjnë këtë jo se e duan dhe e çmojnë vërtet Stalinin, por sepse nuk mund të shkojnë dot më tutje me shpifjet e tyre. Kjo tregon se brenda në Bashkimin Sovjetik ka lëvizje, prandaj Komiteti Qendror i PK të BS ka dhënë direktivën që të flitet pak për Stalinin, me qëllim që ta ulë këtë lëvizje. Revizionistët tregojnë kujdes që të mos thuhet shumë gjëra për Stalinin, sepse, po të thonë pak në qendër, poshtë do t'i thonë të gjitha.

Revizionistët hrushovianë na akuzojnë ne si tradhtarë ngaqë u jemi kundërvënë atyre dhe po i demaskojmë çdo ditë. Kjo nuk na prish ndonjë punë. Ne nuk kemi tradhtuar njeri. Edhe me jugosllavët kemi qenë korrektë kur kishim marrëdhënie të mira me ta, por kur tradhtuan, ne u hodhëm në një luftë të vendosur parimore kundër tyre. Edhe me hrushovianët kështu vepruam kur ata tradhtuan marksizëm-leninizmin.

Ne jemi të qartë dhe të vendosur në luftën kundër imperializmit dhe revizionistëve modernë. Këtë luftë do ta zhvillojmë gjer në fitoren e plotë të marksizëm-leninizmit, duke qenë të tërë marksistë-leninistë të vërtetë të bashkuar rreth tij.

Partia Komuniste Franceze nuk po mban asnjë qëndrim të qartë. Ajo nga njëra anë përkrah Dë Golin, nga ana tjetër përkrah amerikanët bashkë me hrushovianët. Këtë ajo e bën, sepse është kthyer në një avokate e antimarksizmit, në një parti burokrate që jeton me fondet e mëdha që i japin sovjetikët, me firma treg-

tare dhe me një numër të madh shoqatash që mbahen në këmbë me ndihmat e Bashkimit Sovjetik.

Është e drejtë pikëpamja juaj kur thoni se synoni të futeni në masa. Kalanë, domethënë organizatën e partisë në Francë, e kanë akoma revizionistët francezë. Ne shpresojmë, se komunistët e vërtetë marksistë-leninistë francezë do ta marrin këtë kala. Sigurisht kjo nuk bëhet brenda një kohe të shkurtër, por ama do të bëhet dhe lufta e marksistë-leninistëve do t'i katandisë revizionistët francezë të bashkohen edhe më hapur me socialistët e Gi Molesë etj., ashtu siç po bën Partia Komuniste Italiane.

Partia jonë mendon se situatat për lëvizjen komuniste ndërkombëtare janë të favorshme. Në Vietnam po luhet fati i imperializmit. Amerikanët atje kanë hyrë shumë thellë dhe tani nuk po dalin dot që andej. Sa më shumë bombardime të bëjnë imperialistët amerikanë në Vietnamin e Veriut dhe sa më tepër aventura të ndërmarrin, aq më tepër do të shpejtohet disfata e tyre. Në këtë luftë do të diskreditohen shumë edhe revizionistët sovjetikë. Edhe ata të cilët akoma i kanë të zënë me perde sytë do të shohin më qartë ç'qëndrim mbajnë hrushovianët.

Partia jonë e ka për detyrë t'i luftojë gjer në fund revizionistët modernë dhe në radhë të parë ata sovjetikë. Kjo, mendojmë ne, është rruga më e drejtë. Vija e Partisë sonë në këtë çështje është e qartë. Ne nuk flasim pa fakte, pa argumente kundër armiqve tanë. Ato që ka thënë Partia jonë kundër revizionistëve modernë janë vërtetuar të gjitha. Sot lëvizja revolucionare kudo në botë ka filluar të ngrihet. Revizionistët mo-

dernë kanë akoma një forcë të madhe propagandistike, financiare, demagogjike etj. në dorën e tyre. Kësaj force ne i kundërvëmë marksizëm-leninizmin, me të cilin jemi armatosur mirë, dhe unitetin e luftën e përbashkët të marksistë-leninistëve, të proletariatit e të popujve kudo në botë.

Për sa i përket situatës në vendin tonë, ajo është mjaft e shëndoshë. Ne kemi arritur suksese të dukshme në luftën tonë për ndërtimin e socializmit, por kemi akoma shumë për të bërë.

Kolektivizimi i bujqësisë i dha një hov të madh zhvillimit të ekonomisë sonë dhe krijoi në fshat frymën e solidaritetit socialist. Fshatarësia jonë e kuptoi rëndësinë e kësaj çështjeje, e përqafoi kolektivizimin dhe tani punon e bashkuar duke shtuar prodhimin dhe të ardhurat. Kjo ka bërë që të përmirësohet shumë mënyra e jetesës në fshatin tonë socialist. Edhe industria te ne është zhvilluar mjaft. Për këtë në fillim na ka ndihmuar Bashkimi Sovjetik në mënyrë internacionaliste. Specialistët sovjetikë që na u dërguan nga Stalini ishin shumë të mirë, por më vonë ne vumë re se Hrushovi u kishte dhënë specialistëve sovjetikë që punonin në Shqipëri direktiva për sabotim. Njerëzit tanë i shikonin punët e tyre jo të mira dhe nga viti 1956 filluan t'i dallojnë sabotimet e revizionistëve, të cilët bënë kërkime për naftë në Shqipëri, por këto kërkime i bënë në vende të atilla ku nuk kishte asnjë shenjë nafte. Ne u thoshim se në vendet ku kërkonin ata nuk kishte naftë, por na përgjigjeshin se duhej të kishim durim dhe bënë një punë boshe me shpenzime të mëdha. Këta janë shembuj konkretë të punës së tyre minuese.

Pavarësisht nga veprimet armiqësore të revizionistëve hrushovianë, gjendja në Shqipëri është e fortë. Partia jonë është e bashkuar, monolite dhe e lidhur ngushtë me popullin më tepër se çdo herë tjetër. Në këto kushte, çfarëdo pengese e vështirësie që të na paraqitet ne do ta kalojmë patjetër, sepse vija e Partisë është e drejtë. Populli ynë është modest dhe i zgjuar. Ai e kupton se i gjithë zhvillimi që është arritur te ne gjer tani është rezultat i punës, i përpjekjeve, i luftës dhe i djersës së tij. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen. Populli ynë nuk është mësuar të jetojë në luks të tepruar dhe nuk ka pretendime. Në treg ai gjen çdo gjë të domosdoshme që i duhet për jetën e tij të përditshme. Populli është i ndërgjegjshëm se në të ardhmen do të ketë edhe më shumë, por rëndësi ka fakti se te ne nuk ka mungesë prodhimesh ushqimore dhe çmimet e tyre nuk ngrihen siç ndodh në vendet ku janë në fuqi revizionistët. Kjo ndodh jo se ne jemi më të pasur, por për faktin se te ne Partia është më e fortë, vija e saj është e drejtë dhe patriotizmi i masave është më i madh.

Nga pikëpamja morale populli ynë qëndron lart. Ai ka qenë kurdoherë luftëtar, besnik ndaj atdheut, i fjalës dhe i besës ndaj mikut. Popullit tonë i është dashur të luftojë gjithnjë kundër armiqve dhe është përpjekur kurdoherë të mbrohet me të gjitha mjetet. Gjatë luftës së tij shekullore ai ka forcuar qëndrueshmërinë, patriotizmin dhe ndershmërinë. Te këto cilësi të tjera të larta të masave Partia jonë ka gjetur një thesar të madh, të cilin e ka pasuruar më tepër dhe ka bë-

rë që situata në vendin tonë të jetë gjithnjë e më e shëndoshë.

Vendi ynë është i rrethuar nga armiq të shumtë, të cilët përpiqen të na shkatërrojnë. Por populli ynë është vigjilent, ai ka qëndruar dhe qëndron i gatshëm për mbrojtjen e atdheut. Tani të gjithë armiqtë e vendit tonë e kanë të qartë se, po i trazove shqiptarët, do të kesh luftë me ta. Edhe në të ardhmen, ashtu si deri tani, populli ynë do t'u qëndrojë vazhdimisht i papërkulur armiqtve të socializmit. Ne e kemi të qartë se ata do të vazhdojnë të përpiqen të na dëmtojnë, por do të dësh-
tojnë kurdoherë dhe ne do të fitojmë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**NDIHMJA QË MARKSISTË-LENINISTËT I JAPIN
NJËRI-TJETRIT ËSHTË NDIHMË
INTERNACIONALISTE**

*Nga biseda me përfaqësues të rretheve
marksiste-leniniste të Italisë*

30 prill 1965

*Mbasi bëhen përshëndetjet e rastit, fjalën e merr
shoku Enver Hoxha:*

Ardhja juaj në Shqipëri na ka gëzuar mjaft. Me marksistë-leninistët e Italisë jemi shokë, pasi luftojmë për të njëjtën çështje: për fitoren e marksizëm-leninizmit dhe për shembjen e shkatërrimin e imperia-lizmit, kapitalizmit dhe revizionizmit modern. Lufta kundër armiqve të përbashkët na ka lidhur me nyje shumë të forta. Përfitoj nga rasti t'ju shprehim juve pikëpamjet dhe ndjenjat tona të mirënjohjes për besimin që kanë treguar komunistët e vërtetë të Italisë për Partinë tonë. Populli shqiptar ka ushqyer dhe ushqen kurdoherë një simpati të singertë për popullin italian, që është një popull i mirë, inteligjent, punëtor. Kurrë populli ynë nuk ka ngatërruar dhe nuk ngatërron popullin italian me fashistët këmishëzinj të Musolinit.

Ne, shokë, admirojmë punën që po bëjnë marksistë-leninistët në Itali. Ajo është një punë e lavdishme që zhvillohet në kushte të vështira dhe kemi besim se me doemos do të japë rezultate. S'ka dyshim se në rrugën e luftës revolucionare do të dalin edhe pengesa, por ato do të kapërcehen me sukses nga marksistë-leninistët e vendit tuaj, sepse tani ata kanë më shumë eksperiencë, se forca e komunistëve në të gjithë botën është rritur mjaft dhe lufta që bëjnë ata është një shkollë e madhe. Por marksistë-leninistët mësojnë edhe nëpërmjet kontakteve midis tyre. Ata konsultohen e bisedojnë hapur, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Ky është një parim bazë që e respektojnë marksistë-leninistët në marrëdhëniet midis tyre. Komunistët janë përgjegjës për zbatimin e drejtë të marksizëm-leninizmit në vendin e vet, sipas kushteve konkrete, por kjo nuk i pengon shokët marksistë të vendeve të tjera të bëjnë vërejtje e sugjerime kur shohin te shokët e partisë motër ndonjë gabim. Asnjë nuk është i pagabueshëm, shokë. Në punë mund të bëhen edhe gabime, por rëndësi ka që ato të shihen me sy kritik, të pranohen kritikata që i bëjnë shokët marksistë njëri-tjetrit. Si marksistë që jemi ne i presim me kënaqësi vërejtjet dhe kritikata e shokëve dhe të jeni të sigurt se nuk na mbetet qejfi. Edhe ne kur kemi ndonjë vërejtje shoqërisht ua themi partive të tjera marksiste-leniniste. Ndaj vërejtjeve konstruktive marksistë-leninistët reflektojnë, sepse ato janë një ndihmë që u jepet. Në fillim mund të ndodhë që të mos kuptohen drejt vërejtjet e shokëve, por secili ka për detyrë të reflektojë mbi to dhe jo vetëm kaq, por edhe të bëjë përpjekje që të gje-

jë vetë rrugën e zgjidhjes. Por tjetër gjë është vërejtja konstruktive dhe tjetër gjë urdhri apo diktati. Të na thonë, për shembull, që ju shqiptarët duhet të bëni kështu apo ashtu, nuk do të ishte e drejtë, ashtu sikurse nuk do të ishte e drejtë që ne t'u themi të tjerëve të bëjnë kështu ose ashtu në vendin e tyre. Askush nuk mund t'i gjykojë më mirë dhe t'i zgjidhë më drejt problemet sesa vetë marksistë-leninistët në vendet e tyre. Edhe gjendjen e popullin në Itali i njohin më mirë se ne dhe se kushdo tjetër marksistë-leninistët italianë. Ata i njohin njerëzit, grupet, aleancat, njohin idetë dhe tendencat, si rrjedhim ata mund të gjykojnë e të vlerësojnë drejt se si duhet të veprojnë për t'u bashkuar në luftë për të mirën e çështjes sonë. Ne mund të gjykojmë një ngjarje në Itali, por nuk do t'i lejonim kurrë vetes të ndërhyjmë në punët tuaja e t'ju thoshim që të veproni kështu apo ashtu në Milano ose në Torino, ashtu si nuk do të pranohim që ju të na thoshit të veprojmë kështu ose ashtu në Vlorë ose në Gjirokastrë, gjendjen e të cilave ju nuk e njihni.

Udhëheqësit revizionistë italianë akuzojnë Partinë tonë se gjoja ndërhyr në punët e marksistë-leninistëve italianë. Kjo nuk është e vërtetë dhe vetë komunistët italianë këtë e dinë fare mirë. Por akuzën revizionistët në fakt e drejtojnë kundër lëvizjes marksiste-leniniste në Itali, për ta paralizuar atë. Pavarësisht nga këto, ne, sa herë që të paraqitet rasti, do ta ndihmojmë njëri-tjetrit, duke shkëmbyer mendime për probleme të ndryshme e duke përfituar nga eksperiencia e njëri-tjetrit. Natyrisht kjo është vetëm ndihmë që marksistë-leninistët i japin njëri-tjetrit. Por dihet që përgjegjësia

për punën që bën çdo parti në vendin e vet i bie asaj vetë. Ne jemi përgjegjës përpara popujve të vendeve tona dhe pastaj, të gjithë së bashku, jemi përgjegjës përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Sigurisht, komunistët revolucionarë italianë, qysh kur u ngritën kundër udhëheqjes revizioniste, e ndienë barrën dhe përgjegjësinë e madhe që po merrnin përsipër për forcimin dhe zgjerimin e lëvizjes marksiste-leniniste në Itali. Edhe ne e kishim të qartë përgjegjësinë tonë të madhe kur filluam luftën kundër udhëheqjes revizioniste të PK të BS. Marksistë-leninistët kudo në botë janë luftëtarë të së njëjtës rrugë, të rrugës së luftës kundër rendit kapitalist e kundër revizionizmit. Duke qenë të tillë ata bisedojnë e diskutojnë së bashku, bëjnë edhe debate për çështje të ndryshme, debate këto që kanë frymë shoqërore, marksiste-leniniste, që janë të drejta, mbi baza të barabarta dhe në shërbim të çështjes sonë të madhe të përbashkët.

Ne kemi vazhdimisht kontakte me marksistë-leninistët e vendeve të tjera dhe jemi të bindur se është e dobishme që t'i forcojmë edhe më shumë këto, pasi kështu forcojmë bashkëpunimin tonë në rrugën marksiste-leniniste. Të jeni të sigurt se qëndrimet e Partisë sonë edhe ndaj komunistëve të vërtetë italianë do të jenë kurdoherë marksiste-leniniste dhe se do të jemi kurdoherë të gatshëm t'ju ndihmojmë. Vërtet populli ynë është një popull i vogël dhe Partia jonë një parti e vogël, por ata nuk ua kursejnë ndihmën e tyre shokëve dhe miqve revolucionarë të çdo vendi, që punojnë për formimin dhe forcimin e partive të tyre të vërteta marksiste-leniniste dhe luftojnë kundër armiqve tanë të për-

bashkët, imperialistëve dhe revizionistëve modernë. Kjo është një ndihmë që ne e japim pa asnjë interes. Edhe ne na ndihmonte dikur BS, por kur pamë se Hrushovi tradhtonte dhe e përdorte ndihmën për të na tërhequr në rrugën e vet nuk e mbyllëm gojën, por filluam luftën kundër tij dhe vendosëm të rronim edhe pa bukë, por luftën për të drejtën, për marksizëm-leninizmin ta vazhdonim gjer në fund. Me këto dua të them se ndihma që i japin marksistë-leninistët njëri-tjetrit është ndihmë internacionaliste dhe jo ndërhyrje në punët e brendshme të tyre.

Tani para marksistë-leninistëve italianë qëndron çështja e organizimit të partisë së re, e cila s'do të ketë asgjë të përbashkët me partinë revizioniste të Toliatit. Këtë do ta organizojnë vetë marksistë-leninistët italianë kur të vijë momenti i përshtatshëm për një gjë të tillë. Ne e kuptojmë se bashkimi i grupeve marksistë-leniniste është një gjë e domosdoshme dhe njëkohësisht një punë e vështirë, që arrihet e forcohet duke punuar edhe brenda radhëve të PK Italiane për të sqaruar dhe për të tërhequr edhe ata anëtarë të saj, të cilët nuk e kanë kuptuar akoma tradhtinë e udhëheqjes së partisë. Kjo është e domosdoshme të bëhet, sepse në parti ka mjaft elementë, që, po të sqarohen, do të vihen në pozita të shëndosha. Nuk është marksiste të thuash se të gjithë ata që janë akoma në radhët e PK Italiane janë tradhtarë. Brenda partisë së Toliatit ka njerëz të lëkundur, që, megjithëse e kuptojnë tradhtinë e udhëheqësve të partisë, nuk dalin hapur kundër tyre. Këta nuk mund t'i quajmë revolucionarë, por as nuk duhet të nxitohemi e të themi se janë tradhtarë. Midis këtyre

të dyjave ka një diferencë të madhe. Vetëm në qoftë se do të luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, kundër çështjes së proletariatit e të popullit, atëherë ata duhen shpallur kundërrevolucionarë. Pra sa më mirë ta organizojmë punën, aq më shumë komunistë dhe kuadro, që janë akoma në radhët e partisë, ndihmohen për të kaluar në radhët e revolucionarëve.

Rëndësi nuk duhet t'i vëmë vetëm shtimit të radhëve të partisë, por edhe edukimit e kalitjes së anëtarëve të saj. Në radhët e partisë hyjnë edhe njerëz që në fillim tregohen entuziastë për çështjen e saj, por ngaqë u mungojnë formimi dhe kalitja e nevojshme, nuk janë plotësisht të vendosur për të ndjekur me konsekuencë gjer në fund rrugën e nisur. Eksperiencia e Partisë sonë na ka mësuar që ndaj këtyre shokëve të jemi të kujdesshëm dhe vigjilentë, të punojmë me ta dhe, kur bindemi për rrugën e tyre të shtrembër, t'u tregojmë vendin. Çdo qëndrim tolerues në raste të tilla dëmton rëndë partinë dhe punën e saj.

Është mjaft e rëndësishme që marksistë-leninistët italianë kanë bërë një punë të madhe me gjithë vështirësitë që u kanë dalë përpara. Bashkimi i organizatave dhe i grupeve, ndjekja e një politike të drejtë me komunistët dhe kuadrot sigurojnë të ardhmen e lëvizjes, krijimin dhe forcimin e partisë marksiste-leniniste. Në këtë kuadër del një problem tjetër mjaft i rëndësishëm: lidhja e partisë me masat. Kjo është një detyrë kapitale për çdo parti. Shkëputja nga masat e fut partinë në rrugën e degjenerimit, në revizionizëm. Nga sa dimë ne, shumë nga ish-partitë komuniste të vendeve kapitaliste, në vend që të lidheshin e të punonin me

masat, nisën të filozofojnë e të bëjnë teorira dhe harruan punën revolucionare, mobilizimin dhe hedhjen e tyre në aksion. Mund të gaboj por këtë përshtypje kam unë. E kam fjalën më shumë për PK Italiane dhe PK Franceze. Kurse neve, marksistë-leninistëve, na intereson zhvillimi konkret i luftës kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern, natyrisht e ndriçuar kjo nga teoria marksiste-leniniste.

Jam i mendimit se punëtorët e mirë e të sinqertë italianë që janë gati të hidhen në aksion, preferojnë më shumë artikujt e shtypit marksist-leninist sesa teoritë e revizionistëve italianë që janë zhytur në llumin e degjenerimit. Dëgjova pardje Longon në televizion. Ai qëndronte në pozitën e të akuzuarit për vdekje përpara dy të tjerëve që mbanin pozitën e prokurorit demokristian dhe i drejtonin pyetjet. Po të dëgjonit çfarë përgjigje mizerabël u jepte atyre Longoja, do të revoltoheshit. Kur e pyetën: «Ç'mendoni ju për krijimin e një partie të re unike të proletariatit të të gjitha korentëve socialiste?», Longoja, që u paraqit tamam si një borgjez, bëri në këtë rast një diskutim të errët, por në thelb u përgjigj se kjo përpjekje qenka një gjë normale. Me një parti të tillë të vetme, ai ka parasysh jo partinë proletare, pararojën revolucionare të klasës punëtore, por një parti të çorganizuar, një organizatë amorfë, pa kufij të qartë ideologjikë, politikë dhe organizativë, ku do të konkurrojnë rrymat ideologjike e politike më të ndryshme, një organizatë pa disiplinë të shëndoshë partie, të hapur për këdo. Ndërtimin e kësaj partie, që sipas tij do të ishte një parti e «demokracisë

së vërtetë», ai e quante sukses dhe lidhur me këtë shtoi se po të krijohet, ajo do të forcohet nëpërmjet debateve që do të japin «fryte». Por këto nuk do të jenë tjetër veçse debate midis korenteve të ndryshme ideologjike që s'kanë asgjë të përbashkët me një parti të vërtetë komuniste. Kur e pyetën «a ka korente të ndryshme në partinë tuaj, mbasi dimë se një nga këto korente, ai katolik, është i fortë», Longoja e mohoi këtë, por shtoi se politika e bashkëpunimit me katolikët është një dëshirë e vjetër e komunistëve italianë. «Me këtë nuk dua të them se ne jemi dakord me drejtuesit e partisë demokristiane — përfundoi përgjigjen ai — por jemi dakord me masat demokristiane».

Ja, kështu, në debate e në filozofira humbasin Longoja me shokë dhe lënë mënjanë masat e punëtorëve e të fshatarëve, organizimin e punës me ta, udhëheqjen e tyre në rrugë revolucionare. Nga sa dimë, në organizatat-bazë të partisë revizioniste italiane nuk mësohet marksizmi. Ndërsa metoda që ndjekin marksistë-leninistët në punën me masat është mjaft e mirë. Natyrisht, teoria nuk mund të lihet pas dore, sepse pa teori partia nuk bën dot. Por të bësh teori, siç bëjnë revizionistët italianë, duke mos u kuptuar fare nga masat, kjo nuk vlen asgjë.

Në gjirin e marksistë-leninistëve italianë ka shumë shokë që dinë të trajtojnë mirë problemet teorike, të cilët mund të punojnë shumë mirë për edukimin dhe mobilizimin e masave në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit.

Në luftë për zbatimin e këtyre parimeve, Partia jonë ka ditur të mobilizojë rreth saj komunistët dhe

masat punonjëse të vendit tonë dhe bën një luftë të vendosur për mbrojtjen e tyre. Në parimet ne nuk lëshojmë. Kjo është arsyeja që kundërshtuam me aq forcë klikën e Hrushovit. Luftën kundër tij ne nuk e filluam më 1960, por qysh më përpara, megjithëse atëherë nuk ishim aq të qartë për tradhtinë e tij. Diskutime, bile mjaft të ashpra, me udhëheqësit sovjetikë kemi pasur qysh kur erdhi në fuqi Hrushovi. Disa veprime të tij gradualisht po kristalizoheshin për ne, prandaj diskutonim me sovjetikët, natyrisht me durim. Pastaj erdhi një kohë që na u bënë të qarta djallëzitë e Hrushovit, përkëdheljet, nga njëra anë, dhe thika që përgatiste të na fuste pas shpine, nga ana tjetër, dhe kur u mbush kupa, filluam luftën kundër tij. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë na akuzonin ne si kokëfortë, sepse nuk u bindeshim, prandaj u përhap legjenda se shqiptarët janë «kokëfortë». Partitë, qofshin këto të mëdha ose të vogla, janë të barabarta dhe, vetëm mbi baza barazie dhe singëriteti, diskutimet janë kurdoherë të mira. Barazinë dhe miqësinë e singërtë Hrushovi i shkeli me këmbë. Këtë e kanë bërë edhe revizionistët e tjerë, që mbajnë ndaj Shqipërisë qëndrime shoviniste të shtetit të madh e të partisë së madhe tamam sipas pikëpamjeve të Hrushovit.

Të tilla mostra ishin edhe Toliati e drejtuesit e tjerë të PK Italiane, të cilët kanë qenë tërësisht në pozitë të Hrushovit. PK Italiane duhej të bënte propagandë, sado të vogël, për Shqipërinë socialiste dhe për popullin tonë, ndaj të cilit borgjezia italiane gjatë këtij shekulli organizoi dy sulme të hapëta imperialiste. Por udhëheqësit e PK Italiane asgjë nuk bënë në këtë drej-

tim, kurrë nuk thanë një fjalë të mirë për popullin shqiptar dhe për Partinë tonë që luftuan me aq heroizëm kundër fashizmit italian. Përkundrazi, qëndrimet e udhëheqësve të PK Italiane ndaj nesh nuk kanë qenë qëndrime prej marksistësh. Tri herë na ka takuar të ndodheshim në një kohë me Toliatin në Moskë, por të tri herët ai as nuk ka ndenjur të na jepte dorën. Kur ne kemi shkuar t'u jepnim dorën Toliatit me shokë, ata sa na kanë takuar dhe janë larguar. E çfarë marksistësh mund të ishin ata?

Kuptimi, mbrojtja dhe zbatimi i vijës marksiste-leniniste të partisë nga masat është i lidhur ngushtë edhe me krijimin, edukimin dhe kalitjen e kuadrove. Partia jonë gjithmonë e ka parë këtë si një problem mjaft të rëndësishëm dhe që gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare u kujdes jo vetëm për krijimin dhe kalitjen e kuadrove të saj në zjarrin e betejave, por edhe për ngritjen teorike të tyre. Pas Çlirimit nevojat tona për kuadro ishin shumë të mëdha, sepse nga e kaluara pothuajse nuk trashëguam fare, prandaj i hymë punës menjëherë për përgatitjen e tyre. Për të forcuar mbrojtjen e vendit, gati të gjithë kuadrot ushtarakë që bënë luftën u dërguan të studiojnë në akademi ushtarake. Një punë të madhe bëmë edhe për përgatitjen e kuadrove që do t'i viheshin punës për ndërtimin e socializmit. Na duheshin kuadro për të drejtuar industrinë, bujqësinë, kulturën, arsimin. Në fillim hapëm shkolla duke marrë si mësues edhe njerëz që posa kishin mbaruar një shkollë fillore. Sa nuk kishim përgatitur akoma kuadrot tanë, shkova një herë te Stalini pas luftës dhe i parashtrova nevojat që kishim ne për dhjetëra kuadro. Ai u tre-

gua i gatshëm të na i dërgonte, dhe na i dërgoi, por njëkohësisht më këshilloi që ne të përgatitnim vetë sa më parë kuadrot tanë dhe na premtoi se do të na ndihmonte edhe në këtë drejtim. Krejt e kundërta ndodhi me Hrushovin dhe revizionistët e tjerë, të cilët e përdorën dërgimin e specialistëve si mjet presioni ndaj nesh dhe nëpërmjet tyre, në mjaft raste, u përpoqën të na sabotonin. Por të gjitha orvatjet e tyre ndaj nesh dështuan, sepse në këtë kohë kishim kuadrot tanë. Ne tani kemi një armatë të tërë arsimtarësh, mbasi kemi shkolla në të gjitha fshatrat e vendit. Arsimi tetëvjeçar te ne është i detyrueshëm. Kjo ka bërë që të kërkohen shumë kuadro për këto shkolla. Edhe shkollat e mesme janë rritur më shumë se dhjetë herë në krahasim me periudhën e paraçlirimit. Atëherë kishte vetëm disa gjimnaze në gjithë Shqipërinë, ndërsa tani ka të tilla bile edhe në disa kooperativa bujqësore.

Industria jonë e re gjithashtu tani punon e tëra me specialistët tanë, që i kemi përgatitur kryesisht në universitetin tonë, të cilin e hapëm në fillim me fare pak kuadro, ndërsa tani në të ka shumë të tillë. Kur u çliroam, ne kishim gjithsej 380 kuadro të lartë, tani kemi disa mijëra, sepse me qindra janë ata që dalin çdo vit nga shkollat tona të larta. Vetëm universiteti nxjerr çdo vit rreth 700 kuadro të lartë. Ndërsa në të gjitha format e shkollave të larta, të ditës, të mbrëmjes e me korrespondencë studiojnë 12 mijë veta. Ky është një satisfaksion i madh për ne. Megjithatë problemin nuk e kemi zgjidhur plotësisht, pasi vazhdimisht na duhen qindra e qindra kuadro, sepse tani jemi duke ndërtuar uzina e fabrika të reja, si ajo e azotikut në Fier etj. Për

veprat e reja që do të ndërtojmë, ne jemi duke përgatitur kuadro të tjerë. Njerëzit tanë bëjnë punë dhe shkollë njëkohësisht. Kudo te ne u kemi krijuar punonjësve kushte të favorshme që të mësojnë.

Në rininë tonë ka një dëshirë jashtëzakonisht të madhe për të mësuar si në shkollat e përgjithshme, edhe në shkollat teknike, industriale etj. Në Elbasan po ndërtojmë një uzinë për shkrirjen e hekurit. Ju do të shikoni atje të rinj 16-17-vjeçarë, të gjithë montatorë që nuk e kanë mbaruar shkollën teknike, por që kanë bërë e bëjnë shkollën e punës. Sipas mësimeve të Partisë, çdo montator i vjetër merr në patronazh dhjetë të rinj dhe u mëson të fshehtat e profesionit, të tërë këta të rinj po mësojnë zanatin e bile bëjnë punë të mirë. Natyrisht, këta nuk janë që tani teknikë të përsosur, por kanë pasion e vullnet, kanë dashuri për punën, për të mësuar dhe, me kalimin e kohës, do të bëhen teknikë me eksperiencë. Natyrisht, ata mund të bëjnë edhe gabime në punë, por gabime bëjnë edhe të vjetrit, mirëpo ne nuk mund të pritnim që t'i ndërtonim këto vepra sa të përgatiteshin kuadrot.

Ju falënderoj, shokë, për bisedën që bëmë dhe kemi besim se do të jemi kurdoherë në unitet në luftën tonë të përbashkët. Ju falënderojmë sidomos për konsideratën që keni për Partinë tonë. Partia jonë do të bëjë çmos ta meritojë besimin e bashkëpunimin e hapët, të sinqertë e shoqëror të marksistë-leninistëve të vërtetë.

Ju urojmë, shokë, suksese të mëdha në luftën dhe në punën tuaj, sepse sukseset e marksistë-leninistëve të çdo vendi janë njëkohësisht suksese edhe për ne. Për ne

do të ishte shumë mirë të krijohet një parti e fortë marksiste-leniniste në Itali. Ne kemi besim se kjo parti do të krijohet në saje të punës dhe të luftës që do të bëni si marksistë-leninistë të vërtetë¹.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

¹ Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) u formua më 15 tetor 1966.

MARKSIZËM-LENINIZMI KA TRIUMFUAR DHE DO TË TRIUMFOJË KURDOHERË

*Nga biseda me një delegacion të PK të Spanjës
(marksiste-leniniste)*

30 prill 1965

*Pasi miqtë u pritën ngrohtësisht dhe zunë vend,
fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Jemi shumë të gëzuar, shokë, për vizitën tuaj në Shqipëri. Komunistët dhe populli shqiptar kanë një simpati dhe respekt të veçantë për komunistët dhe popullin heroik spanjoll. Vazhdimisht na kujtohet lufta juaj e madhe kundër fashizmit dhe diktatorit Franko. Në luftën antifashiste të popullit spanjoll kanë marrë pjesë edhe shumë shokë shqiptarë. Ajo ishte një luftë e lavdishme dhe një shembull frymëzimi për të gjithë. Forcat e reaksionit ndërkombëtar i erdhën në ndihmë dhe e mbajtën në këmbë fashizmin në Spanjë, por lufta e ardhshme kundër fashizmit me siguri do të mbarojë me fitoren e popullit spanjoll, sepse tani forcat e revolucionit dhe të marksizëm-leninizmit janë vazhdimisht në rritje. Natyrisht vështirësitë akoma janë të shumta,

por komunistët me vendosmërinë që i karakterizon i kapërcejnë ato.

Ne gëzohemi së tepërmi për formimin e partisë suaj marksiste-leniniste¹ dhe i urojmë asaj suksese të mëdha në luftërat që e presin. Sukseset tuaja ne i çmojmë si sukseset tona, sepse kemi parasysh që ekzistenca dhe forcimi i partive të vërteta marksiste-leniniste në vende të tilla si Spanja, Franca, Italia përbëjnë një fitore të madhe për marksizëm-leninizmin në të gjithë botën.

Partia jonë është një parti e vogël, por pavarësisht se është e tillë, ajo do të përpiqet kurdoherë ta bëjë detyrën e vet internacionaliste, pa pasur frikë nga armiqtë e shumtë. Duke qenë një pjesëtare e lëvizjes së madhe komuniste ndërkombëtare, ajo e ndien veten të lidhur shumë ngushtë me partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste që janë formuar dhe po formohen, pra edhe me partinë tuaj marksiste-leniniste që porsa është formuar, por që nuk është pa eksperiencë, sepse komunistët në Spanjë kanë ekzistuar edhe më parë. Ata kanë luftuar kurdoherë me heroizëm, dhe, me gjithë epërsinë e armiqve, kurrë nuk janë mposhtur. Në Spanjë nuk është mposhtur as flamuri i marksizëm-leninizmit edhe pse tradhtuan krerët e partisë, të cilët i sollën dëm të madh vetë Partisë Komuniste Spanjolle dhe çështjes së proletariatit e të popullit spanjoll. Krerët tradhtuan, por nuk kanë tradhtuar marksistë-leninistët e vërtetë dhe populli heroik spanjoll. Prandaj marksizëm-leninizmi në Spanjë përsëri është në ngritje. Lë-

1 PK e Spanjës (marksiste-leniniste) u formua më 17 dhjetor 1964.

vizja komuniste ndërkombëtare edhe në raste të tjera ka parë elementë dhe grupe antimarksiste që kanë tradhtuar. Shumë prej këtyre janë përpjekur ta shkatërrojnë lëvizjen komuniste nga brenda, duke pasur ndihmën e imperializmit, por marksizmi, qëkurse lindi, asnjëherë nuk u mund, ai ka triumfuar dhe vazhdon të triumfojë dhe ecën kurdoherë përpara, kurse tradhtarët dhe tradhtia kanë dështuar dhe do të dështojnë edhe në të ardhmen.

Partia juaj marksiste-leniniste mund të mos ketë akoma shtrirje organizative në tërë Spanjën, por megjithatë atje ekziston fryma e marksizëm-leninizmit. Kjo frymë po zien dhe kemi bindjen se njerëzit e ndershëm janë dhe do të jenë me ju e jo me tradhtarët. Por ata duhen organizuar. Ky organizim do të arrihet nëpërmjet luftës. Edhe revizionistët kanë format e tyre të punës e të organizimit, kanë aparatet e burokracinë e tyre. Siç na mëson marksizëm-leninizmi, tradhtarët, revizionistët, oportunistët nuk kanë mbështetjen e masave, sepse bien në kundërshtim me interesat e këtyre të fundit. Prandaj ata do të futen në luftë me masat, do të izolohen dhe maska e tyre demagogjike do të çirret nga marksizëm-leninizmi.

Lëvizja revolucionare marksiste-leniniste, kudo qoftë ajo, nuk mund të mos krijojë pararojën e saj. Ky është ligj. Prandaj edhe partia juaj, pararoja e re e klasës punëtore spanjolle do ta pastrojë terrenin nga revizionistët spanjollë, nga çdo sëmundje tjetër antimarksiste dhe do t'i bëjë revizionistët ta humbasin betejën, të dështojnë. Tani për tani revizionistët nuk e vlerësojnë sa duhet lëvizjen marksiste-leniniste në Spanjë,

këtë rrezik të madh që po ngrihet për ta, sepse hëpërhë disponojnë akoma fonde financiare, mjete e aparate propagandistike. Ata e nënvleftësojnë luftën revolucionare, sepse janë kundër popullit dhe revolucionit, janë vetëm një bisht i borgjezisë, janë kthyer në burokratë dhe mendojnë se vetëm duke pasur forcën ekonomiko-financiare ose një aparat të fortë propagandistik mund të shtypin çdo lloj lëvizjeje revolucionare.

Por nuk është kështu. Le të marrim si shembull Shqipërinë. Revizionistët hrushovianë, si antimarksistë që janë, menduan se Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë mund të likuidoheshin brenda 5 ditëve, se ato do të gjunjëzoheshin me lëvizjen e parë të gishtit të Hrushovit dhe se, po të mos bëhej kështu, Shqipëria do të vdiste. Por në fakt ngjau e kundërta e asaj që menduan ata. Nga një vend dhe një parti e vogël, siç janë Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë, Hrushovi dhe hrushovianët hëngrën një grusht të rëndë. Ata vërtet na bënë presione të gjithanshme politike, ideologjike dhe bllokadë ekonomike, por nuk na thyen dot. Ishin ata që dështuan e jo ne. Kështu do ta pësojë me siguri edhe partia komuniste revizioniste e Dolores Ibarrurit dhe e lakeut borgjez Kariljo.

Gjithë shpresën revizionistët e kanë në aleancën me borgjezinë. Në këtë aleancë e shohin ata shpëtimin e tyre dhe të borgjezisë, së cilës i shërbejnë. Revizionistët spanjollë mendojnë se popullin dhe komunistët mund t'i tërheqin prej hundësh, se të gjithë do t'i besojnë Pasionares, që dikur ka qenë vërtet një luftëtare, por sot ka tradhtuar dhe është bërë një me revizionistët. Populli ynë, kur të pyet, nuk të thotë «si ke qenë?»,

por «si je?». Që të të ndjekë populli, duhet të jesh vazhdimisht luftëtar e konsekuent, po të tradhtosh, ai të kthen kurrizin. Edhe te ne, disa elementë, të cilët në vitin 1920 luftuan me armë në dorë kundër italianëve, kur erdhi Zogu në fuqi, u hodhën në emigracion, siç emigroi edhe Pasionarja juaj. Por ata u kthyen në Shqipëri kur hynë pushtesit italianë, u bashkuan me ta dhe u hodhën kundër popullit. Për tradhtinë që bënë ata u kapën, u nxorën në gjyq dhe morën dënimin e merituar. Populli e aprovoi plotësisht këtë masë, sepse ata u bënë tradhtarë, pavarësisht se në të kaluarën kishin mbajtur në rrethana të caktuara edhe ndonjë qëndrim disi të drejtë. Populli të ruan e të respekton vetëm në qoftë se qëndron e lufton gjer në fund të jetës për interesat e tij dhe të atdheut.

Udhëheqësit revizionistë të Partisë Komuniste Spanjolle, nga sa dimë dhe gjykojmë ne, e njollosën vetë të kaluarën e tyre. Ju gjykoni drejt kur thoni se akoma nuk e keni evituar influencën e tyre në Spanjë. Kjo do të thotë se ju e peshoni mirë armikun, forcat e tij, pa i nënvleftësuar dhe pa i mbivlerësuar ato. Kështu do të mund ta luftoni edhe më mirë atë. Po ta mbivlerësosh armikun, do të pengosh hovin revolucionar të masave dhe, po ta nënvleftësosh atë, mund të hidhesh në aventurë dhe të pësosh disfatë.

Është e qartë se armiqtë nuk flenë. Ne mund të themi tani që revizionistët modernë rrezikun më të madh e shikojnë nga partitë e vërteta marksiste-leniniste, nga marksizëm-leninizmi, prandaj aparatet e tyre, njerëzit dhe të gjitha forcat e tyre ata i kanë drejtuar kundër nesh. Që këtej del se edhe marksistë-leninistët duhet

të bashkojnë forcat kundër tyre dhe t'i godasin ata me vendosmëri, trimëri dhe urtësi.

Lufta juaj, shokë, është një luftë e lavdishme, por jo e lehtë. Atë e vështirëson sidomos fryma që kanë përhapur revizionistët me demagogjinë dhe me metodat e tyre të punës, që ne tashmë i njohim, dhe përpjekjet që bëjnë ata për të likuiduar elementët e rinj revolucionarë e bashkë me ta edhe punën e veprën e tyre. Prandaj zhvillimi me sukses i luftës suaj kërkon organizim të fortë dhe disiplinë të hekurt. Kjo nuk do të thotë të jesh sektar, por disiplina e hekurt në një vend dhe në një parti, që ka përpara armiq të rrezikshëm dhe me eksperiencë, është e domosdoshme dhe ka një qëllim të lartë. Armiqtë janë të shumtë, ata mund të kenë depërtuar edhe në radhët e marksistë-leninistëve, prandaj asnjë lëshim nuk duhet bërë ndaj cilitdo goftë, nëse ai shmanget nga lufta që bën partia. Çdo frymë lëshimi shkakton dëme të mëdha. Ju keni eksperiencën e pasur të luftës kundër fashizmit, kundër diktatorit Franko dhe klerit spanjoll. Ky është për ju një avantazh që do t'ju ndihmojë të arrini patjetër suksese në qëllimet që i keni vënë vetes.

Situatat sot në botë janë në favor të marksizëm-leninizmit, pavarësisht se tani kanë dalë sheshit revizionistët modernë. Por për lëvizjen komuniste ndërkombëtare që një gjë shumë e mirë që sëmundja e revizionizmit u zbulua, sepse kështu luftohet ajo me sukses, ndryshe, po të mos që zbuluar, ajo do t'i shkaktonte dëme kolosale lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Gjer sa kjo sëmundje ekzistonte, atëherë duhej të bëhej edhe

operacioni përkatës shpëtimtar, domethënë të ndiqej gjer në fund rruga e revolucionit.

Revizionizmi modern përbën një vështirësi të përkohshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe ne jemi të bindur se kjo vështirësi do të kapërcehet patjetër, natyrisht, me fitore dhe me humbje, por kurdoherë fitorja e fundit do të jetë jona. Ne po konstatojmë se në një kohë kaq të shkurtër grupi tradhtar i Hrushovit, që fshihej prapa autoritetit të PK të BS dhe të Bashkimit Sovjetik, u demaskua. Edhe udhëheqja revizioniste spanjolle, edhe partitë e tjera, si Partia Komuniste Franceze, Partia Komuniste Çekosllloake etj., në krye të të cilave tani janë revizionistët, jo vetëm janë diskredituar e janë në rënie, por edhe po hasin në vështirësi kolosale, si brenda vendeve të tyre, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Në të gjithë vijën e tyre ato po pësojnë vazhdimisht disfata. Nga ana tjetër, çdo ditë e më mirë vërtetohet rruga e drejtë e marksizëm-leninizmit.

Më parë kishte grupe marksiste-leniniste spanjolle në vendin tuaj dhe jashtë, në Evropë e në Amerikën Latine. Por tani në Spanjë u krijua një bërthamë, një parti e re marksiste-leniniste, e cila do të zmadhohet në luftë dhe në përpjekje të gjithanshme me armiqtë e klasës. Formimi i partisë suaj përbën një ngjarje historike, por forcimi i saj, krijimi i bazave, i lidhjeve me komunistët dhe masat e popullit spanjoll është tani një detyrë e dorës së parë. Rëndësi të veçantë ka sigurimi i lidhjeve të partisë me mijëra e dhjetëra mijëra njerëz, sepse dikush prej tyre është i paqartë, dikush i deziluzionuar, dikush shumë i entuziazmuar nga krijimi i par-

tisë, dikush trembet të futet menjëherë në aksion, dikush është më i mbyllur etj. Njerëzit me të cilët do të punojë partia janë të ndryshëm. Ka shumë që nuk i kuptojnë gjërat njëlloj, disa nuk i kuptojnë lehtë e menjëherë, disa janë dakord me disa çështje, disa të tjerë nuk janë dakord, disa i stërhollojnë çështjet për t'u larguar nga aksioni, disa tregohen të zjarhtë por kanë vetëm fjalë, disa tregohen më të thjeshtë, por janë më të vendosur, disa nuk kanë fjalë shumë dhe japin përshtypjen sikur janë të dobët, por ata janë më të thellë, më të vendosur, më të aksionit, ecin në shembullin e proletariatit etj. Çështja është që me të gjithë këta duhet punuar, duhen bërë për vete, duhen sqaruar e duhen kalitur në kudhrën e partisë. Kjo sigurisht është një punë e madhe, e vështirë, por e lavdishme dhe kemi bindjen se partia juaj do ta zhvillojë atë me sukses.

Edhe ne, para formimit të Partisë, kemi kaluar më parë nga grupet, nga lufta në mes njërës grup me tjetrin, por, kur erdhi momenti i volitshëm, të gjitha grupet u bashkuan, jo në një bashkim formal, por në një bashkim parimor luftarak të mbështetur në marksizëm-leninizmin dhe të vendosur për të realizuar detyrat e caktuara karshi atdheut dhe popullit. Që në fillim Partia jonë u armatos me një program politik të qartë, të bazuar në themele shkencore marksiste-leniniste. Në dokumentin e parë të Partisë¹ ne vinim në dukje se armiku ishte

1 Është fjala për Rezolucionin e Mbledhjes së grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë për krijimin e Partisë, në nëntor 1941.

në vatrën tona, prandaj komunistët duhet të rroknin armët dhe në udhëheqje të masave të shpartallonin pushuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre, tradhtarët vendas, të çlironim Shqipërinë dhe të vendosnim pushtetin popullor. Me këto parulla ne mobilizuam konkretisht popullin. Më vonë, pati disa që, duke studiuar materialet e Partisë, thanë përse nuk është vënë në këtë dokument që Partia do të bënte Reformën Agrare. Është e vërtetë që Reforma Agrare nuk përmendet në këtë dokument, por ama pas Çlirimit, nën udhëheqjen e Partisë, ajo u bë në Shqipëri, bile ne nuk mbetëm te Reforma, por shkuam më tej, bëmë edhe kolektivizimin e bujqësisë dhe po ndërtojmë socializmin edhe në fshat. Sipas këtyre shokëve, po të ishte shtruar qysh atëherë çështja e Reformës Agrare, Partia do ta kishte bërë më mirë me vete fshatarësinë. Por realiteti ynë tregoi se edhe pa e formuluar çështjen e Reformës Agrare në dokumentin e parë të Partisë, fshatarësia jonë e përkrahu dhe luftoi nën drejtimin e Partisë, sepse pati besim në vijën e drejtë të saj dhe e shihte që Partia ishte shpëtimtarja e gjithë popullit. Nga ana tjetër, sipas mendimit tonë, formulimi për marrjen e tokës nuk mund të vihej që në atë kohë, sepse në luftën e popullit ishin hedhur jo vetëm fshatarët pa tokë, por edhe shumë fshatarë me tokë, të cilëve, po t'u thoshim se do t'u merrnim tokën, s'do ta kuptonin të vërtetën e mund të hidheshin me armikun. Prandaj Partia shpalli se do të luftonte për zgjidhjen drejt të çështjes agrare dhe se fshatarëve të varfër do t'u jepej tokë. Kjo bëri që ata që kishin tokë dhe nuk ishin kulakë e armiq të Partisë të mos frikësoheshin, përkundrazi, ata u bashkuan me

Partinë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pra, nuk ndodhi ashtu siç mendonin ata shokë që niseshin në mënyrë të verbër nga teoria dhe nuk mbështeteshin sa duhej në praktikën revolucionare. Teoria lipset, se pa të nuk mund të ecet, por nuk mund të ecet gjithashtu edhe pa një praktikë revolucionare, pa marrë parasysh kushtet konkrete, botëkuptimin e njerëzve, të klasave e të shtresave të popullit. Të gjitha këto duhet të jenë të lidhura mirë me njëra-tjetrën.

Ashtu siç thoni ju, detyra të mëdha kanë përpara për të kryer komunistët spanjollë që të rrëzojnë me luftë diktaturën fashiste të Frankos. Prandaj me të drejtë partia juaj ka caktuar si vijë të përgjithshme të saj luftë kundër imperialistëve amerikanë, luftë kundër revizionistëve hrushovianë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste revizioniste Spanjolle. Për një vijë të tillë është i interesuar dhe populli spanjoll. Në zbatimin e kësaj vije, natyrisht, lindin pastaj shumë gjëra që duhet t'i përcaktojë e t'i sqarojë mirë Partia, si për shembull, si do të bëhet lufta, ç'është proletariati dhe si duhet organizuar ai, si do të krijohen lidhjet me masat, ç'është diktatura e proletariatit, ç'janë aksionet, aleancat, si do të zhvillohen ato etj., etj. Këto do të zgjidhen në luftë e sipër, nën udhëheqjen e partisë, e cila organizon dhe frymëzon komunistët e popullin për të shkuar në komunizëm. Për zgjidhjen drejt të këtyre çështjeve në praktikë, udhëheqja dhe tërë partia duhet të manovrojnë me kujdes dhe jo të humbasin pas diskutimeve e filozofimeve.

Ju e keni drejt kur thoni që baza e punës suaj revolucionare duhet të jetë dhe është brenda në Spanjë,

sepse jashtë, sidomos në emigracionin ekonomik, kjo është më e pakët. Sigurisht në emigracion ka edhe njerëz të mirë dhe duhet punuar me ta, por fusha kryesore është vetë Spanja. Prandaj revolucionarët duhet të shkojnë, të punojnë dhe të ndihmojnë në radhë të parë shokët brenda në Spanjë, se baza atje brenda është, t'i organizojnë njerëzit dhe t'i hedhin në aksion. Elementët e emigracionit ekonomik spanjoll që janë, për shembull, në Francë, në Itali, në Belgjikë e gjetkë janë në kushte të tjera, ata nuk e kanë kokën në rrezik si komunistët dhe revolucionarët që militojnë brenda në Spanjë. Kurse brenda në Spanjë puna e revolucionarit është me nerva të ngritur dhe, në qoftë se nuk bëhet kujdes për të zbatuar me rreptësi udhëzimet e partisë, disiplinën e saj dhe konspiracionin, një gabim i vogël mund të kostojë shumë, kokën e dhjetëra shokëve. Këtë e themi nga eksperiencia jonë, sepse edhe ne kemi kaluar nga kjo rrugë që po kaloni ju. Kemi pasur edhe ne njerëz në emigracion. Njëri ndër ta që revolucionari i shquar Ali Kelmendi. Ai ishte njeri i thjeshtë, nuk bënte shumë teori, por ishte një revolucionar i zjarrtë. Kominterni i dha atij detyrën të futej në Shqipëri. Ai erdhi këtu dhe filloi të punonte për përhapjen e ideve komuniste dhe për organizimin e komunistëve, por u zbulua, u burgos, dhe u torturua. Nuk kishte asnjë ndihmë, ai jetoi në varfëri saqë kur ishte në Gjirokastër në internim, e kisha parë që s'kishte as këpucë, por dilte me disa si pantofla, megjithatë ai bënte një punë revolucionare me komunistët dhe me masat e popullit. Ky shok orientoi drejt lëvizjen komuniste e punëtore në Shqipëri, por kishte edhe të tjerë emigrantë politikë

shqiptarë, ndonjëri bile edhe pedagog në universitetin e Moskës, të cilët merreshin më shumë me diskutime, s'qenë të lidhur me gjendjen reale në Shqipëri dhe më pas i bënë shumë dëme Partisë sonë. Prandaj ne i kuptojmë kushtet në të cilat ndodhën. Në këto kushte, ka rëndësi të madhe konspiracioni, të cilin ju duhet ta ruani e ta mbani vazhdimisht. Një punë e fortë konspirative pa lëshime është e domosdoshme për ju, sepse çdo lëshim, sado i vogël, në kushtet tuaja mund të shkaktojë dëme. Edhe puna e revolucionarëve jashtë shtetit, natyrisht, ka rëndësi të madhe, sepse dhe atje jetojnë shumë njerëz, të cilët përbëjnë një forcë të konsiderueshme. Por këtu nuk duhet të marrim shembullin e Dolores Ibarrurit, Listerit etj., që janë shkëputur krejt nga masat. Revizionizmi i korruptoi këta njerëz në emigracion. Ata kanë rënë në inaktivitet, kurse brenda në Spanjë armiku punon, prandaj ka rrezik që në këto situata edhe njerëz të tjerë brenda në Spanjë të gabohen. Sigurisht ata që janë revolucionarë të vërtetë punojnë dhe te këta njerëz duhet bazuar. Pra, puna kryesore e partisë është atje brenda, në Spanjë, ku gjendet forca më e madhe, vendimtare për fitoren e revolucionit. Prandaj partisë i bie detyrë të lidhet ngushtë me masat dhe të punojë me to.

Ne, ato që mendojmë ua themi shoqërisht, hapur, pa ndërhyrë në punët tuaja. Nga Partia jonë do të keni çdo ndihmë, por dihet që përgjegjës për punën revolucionare në Spanjë janë vetëm komunistët, marksistë-leninistë spanjollë, që vendosin atje për çdo gjë, sepse janë ata të zotët e vendit. Eksperienca dhe aftësitë nuk u mungojnë atyre, sepse kanë një kohë të gjatë që janë

komunistë. Por ne e ndiejmë për detyrë që eksperiencën tonë dhe avantazhin e madh që kemi, si një Parti në pushtet dhe që lufton e punon për ndërtimin e socializmit, t'i vëmë edhe në shërbim të vendeve të tjera, me qëllim që t'i ndihmojmë ata. Si marksistë që jemi, neve nuk mund të na lejohet që të mos i ndihmojmë marksistë-leninistët dhe revolucionarët kudo në botë. Por, gjithashtu, edhe ata, në shumë mënyra e drejtime na ndihmojnë. Kështu e kuptojmë ne ndihmën reciproke internacionaliste dhe jo siç bënte Hrushovi, i cili i shfrytëzonte «ndihmat» me qëllim që të na bënte t'i përulëshim atij. Por ne nuk mund ta pranoni një gjë të tillë. Partia dhe populli shqiptar preferuan më mirë të rrinin pa bukë sesa t'i nënshtroheshin këtij tradhtari.

Ndihma që partitë marksiste-leniniste i japin njëra-tjetrës në rrugë e me mjete të ndryshme, me mendimet e vërejtjet për çështjet që u dalin përpara dhe kërkojnë zgjidhje, është një detyrë internacionaliste. Mundet që për një çështje të mos kemi mendime të njëjta. Kjo është e natyrshme dhe mund të ndodhë, por kjo nuk duhet të cenojë aspak marrëdhëniet midis marksistë-leninistëve, sepse ata janë dakord për një çështje të madhe themelore, për çështjen e revolucionit, të socializmit dhe të komunizmit. Lufta juaj është edhe lufta jonë, prandaj të jeni të sigurt se do të na keni kurdoherë pranë. Sa më e fortë të jetë partia juaj, aq më shumë do të goditet imperializmi, do të dobësohet frankizmi, aq më shpejt do të zhvillohet revolucioni në Spanjë dhe në gjithë Evropën Perëndimore dhe atë Lindore. Ju e kuptoni ç'do të thotë për interesat e revolucionit të dalë një parti e fortë marksiste-leniniste

në Spanjë. Kjo do të krijojë një tronditje të madhe në radhët e revizionistëve. Ne kemi bindjen e plotë se marksistë-leninistët e Spanjës do ta çojnë punën përpara.

Duke e marrë fjalën kryetari i delegacionit, midis të tjerash, tha:

Këto që thoni ju, shoku Enver, përputhen në mënyrën më ekzakte me ato opinione që ne kemi për Partinë e Punës të Shqipërisë. Është shumë e drejtë të thuhet se ju keni qenë në pararojë të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Pikërisht kur revizionistët modernë ishin në kulmin e ngritjes së tyre, ishit ju që ua zbuluat atyre fytyrën, duke treguar se cilët janë ata, ju u dhatë atyre një grusht të rëndë si grushti që hëngrën nazistët në betejën e Stalingradit dhe gjatë këtyre viteve lufte nga ana juaj është krijuar një tjetër situatë për revizionistët. Ata tani janë në rënie, në shkatërrim. Natyrisht, të gjithë kemi shumë për të bërë dhe jemi të ndërgjegjshëm se rruga jonë nuk është me trëndafila.

Ne ju falënderojmë për fjalët dhe mendimet që shprehët, për solidaritetin tuaj të madh, për të cilat kurrë nuk kishim dyshim. Ne ishim të bindur se këtë përkrahje e mbështetje të sinqertë do të gjenim nga Partia, nga udhëheqja e Partisë suaj dhe nga i gjithë populli shqiptar. Nga Shqipëria do të largohemi të frymëzuar dhe me forca të reja, si njerëz që kemi mësuar shumë te ju. Këshillat që na dhatë do të na vlejnjë shumë dhe do t'i kemi kurdoherë parasysh gjatë punës dhe luftës sonë në të ardhmen.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderojmë së te-

përmi për fjalët tuaja të përzemërta shoqërore dhe marksiste-leniniste. Partia jonë do të bëjë çdo gjë që ta meritojë besimin e shokëve marksistë-leninistë të Spanjës. Të jeni të sigurt, shokë, se te Partia jonë keni dhe do të keni kurdoherë një parti besnike, që do të flasë hapur dhe sinqerisht me ju, kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste dhe që në çdo moment, qoftë i mirë ose i vështirë, do të jetë krah për krah komunistëve të vërtetë marksistë-leninistë të Spanjës dhe popullit spanjoll.

Ju urojmë edhe një herë për formimin e partisë suaj të re marksiste-leniniste, por me tradita të vjetra revolucionare!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

PER PRANIMET NË PARTI TË ECIM KURDOHERË NË MËNYRË SHKENCORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

7 maj 1965

Orientimet që kemi dhënë për forcimin e Partisë në përgjithësi mund t'i gjykojmë se janë të drejta. Për të dhënë një orientim të ri kërkohen përgatitje, studim. Nuk do të ishte mirë të merrnim një vendim që tani Partia të rritet në fshat dhe nesër, kur të shohim se u pranuan në Parti pak punëtorë, ta frenojmë pranimin nga fshati etj. Në Kongresin e ardhshëm Partia do të ketë një eksperiencë më të madhe, të cilën duhet ta shfrytëzojmë sa më mirë.

Ne duhet t'i rikthehemi kësaj çështjeje duke parë të katër kongreset. Të nxjerrim eksperiencën e periudhës përkatëse të rritjes së Partisë për çdo Kongres. Rritja e Partisë gjatë këtyre periudhave nuk mund të themi

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zbatimin e detyrave për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë.

se është bërë në mënyrë spontane, megjithatë këtu ka vend për të bërë një analizë kritike të orientimeve që kemi dhënë. Partia duhet dhe kurdoherë do të veprojë për të udhëhequr dhe për të drejtuar gjithë jetën e vendit. Ajo lufton jo vetëm për forcimin e radhëve të saj, por udhëheq zhvillimin socialist të vendit, zhvillimin dhe rritjen e industrisë, të bujqësisë, zhvillimin e arsimit e të kulturës, të ushtrisë, të tregtisë etj., etj. Pra, në përputhje me këto detyra duhet të rritet edhe Partia. Partia tani në fakt është rritur, por mendoj se në Kongresin e ardhshëm duhet të shkojmë me një orientim shkencor për rritjen e mëtejshme të saj.

Por si duhet ta bëjmë këtë? Këtë mendoj ta bëjmë bashkë me orientimin që do të japë Kongresi lidhur me zhvillimin e ekonomisë së vendit. Ne kemi thënë që pesëvjeçari i ri do të shënojë një hap përpara drejt kalimit të vendit tonë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar, kemi përcaktuar afërsisht sa do të zhvillohet çdo sektor, po me një orientim për pranimë në Parti akoma nuk kemi dalë. Në shumë fshatra akoma nuk kemi organizata-bazë partie. Kjo është një çështje e rëndësishme që kërkon studim dhe në përputhje me situatën që kemi përpara ne duhet ta bëjmë një studim të tillë. Po si ta bëjmë?

Këtë studim, së pari, them ta bëjmë me periudha, me kongrese. Për shembull, në Kongresin e 1-rë duhej të forconim ushtrinë, vigjilencën etj., se çështja e kooperativave bujqësore në atë kohë nuk shtrohej siç u shtrua më vonë. Pra në bazë të kongreseve ne duhet të bëjmë një analizë krahasuese. Rezultatet për çdo periudhë tani i kemi dhe ka mundësi të shohim si u rrit

Partia nga Kongresi në Kongres, si u rrit numri i komunistëve në sektorët e ekonomisë, në administratë etj. Këtej do të nxjerrim edhe eksperiencë, edhe proporcionet e rritjes së Partisë. Kjo është për periudhën e parë. Për periudhën tjetër Partia ka një orientim të ri. Në këtë kohë ne bëmë një hap përpara, drejt krijimit të kooperativave bujqësore; edhe industria, arsimit, tregtia u zhvilluan më tej. Tani, në periudhën e dytë, duhet të shohim gjithashtu si janë zhvilluar këto proporcione, nëse këto janë zhvilluar në rrugë të drejtë, në përshatje me zhvillimin e industrisë, të bujqësisë, të tregtisë, të artizanatit, të reparteve ushtarake etj. Kështu ne do të shohim si kanë ecur proporcionet në sektorët që thamë dhe ritmet e rritjes së klasës punëtore etj.

Çdo periudhë jo vetëm duhet ta lidhim me orientimin që ka dhënë Partia për çdo pesëvjeçar, po të shohim edhe sa elementë kanë dalë jashtë, sa kanë ardhur nga mosha e rinisë, sa kanë rekomanduar organizatat e rinisë për të hyrë në Parti. Në pesëvjeçarin e ardhshëm do të na dalin edhe gjëra të tjera. Shumë anëtarë partie do të dalin në pension, sepse janë nga 50 vjeç e lart dhe kështu del detyrë që të përgatitim zëvendësit e tyre.

Çështja e Partisë është me shumë rëndësi, prandaj t'i vihemi kësaj pune. Materiale kemi, të thirren edhe shokë që punojnë në kartotekat e komiteteve të Partisë të rretheve, ndonjë sekretar komiteti partie që merret me organizimin dhe të dalim përpara Byrosë Politike me një pasqyrë shkencore të studiuar mirë për çdo periudhë, duke arritur në konkluzione se si është rritur Partia, si kanë qenë e duhet të jenë orientimet

për këtë problem. Ky studim do të na ndihmojë të dalim me propozime në Kongres, orientimi i të cilit do të zbërthehet nga Byroja Politike e Komitetit Qendror, nga organet e Drejtorisë së Organizimit, nga organet dhe organizatat e Partisë në rrethe e në bazë, për një punë më të mirë në të ardhmen në drejtim të forcimit të Partisë, për të dalë me konkluzione më të studiuara lidhur me këto probleme shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me forcimin e Partisë. Për pranimet në Parti duhet të ecim kurdoherë në mënyrë shkencore. Në sektorin e industrisë nuk i kemi të shpërndara si duhet forcat e Partisë, në një degë të saj mund të na ndodhë të kemi komunistë më pak nga sa duhet, në arsim mund të kemi akoma më pak mësues komunistë. Prandaj këto proporcione duhet t'i shohim. Komiteti Qendror gjykon se po të mendohej që nuk duhet të pranojmë mësues në Parti, se në radhët e tyre s'ka një-rëz që ta meritojnë, atëherë një pikëpamje e tillë do t'i sillte dëm të madh Partisë, sepse problemi do të shikohej në mënyrë sektare.

Partia është një organizëm i gjallë që e ka synë kudo, ajo nuk është diçka automate, që çdo gjë mund ta caktosh me shifra dhe të thuash se në radhët e saj duhet të hyjnë kaq punëtorë e kaq fshatarë, kurse elementëve të tjerë t'u mbyllësh dyert. Në qoftë se shihet që në tregti numri i komunistëve është i vogël, ne duhet të nxjerrim konkluzione të rëndësishme, se ky është edhe një shkak që në këtë sektor përvetësohet dhe shpërdorohet pasuria e shtetit, dobësohen lidhjet e Partisë me masat.

Parimet si kudo duhet t'i ruajmë edhe në pranimet

nga klasa punëtore në radhë të parë, se kjo është kolona vertebrale e Partisë. Vendi ynë ecën kurdoherë përpara, industria kërkon gjithnjë më shumë punëtorë të thjeshtë e të kualifikuar, pra radhët e punëtorëve shtohen vazhdimisht, prandaj është e natyrshme që punëtorët më të mirë të na vijnë medoemos në Parti, në shumicë nga industria. Por në Parti ne nuk mund të pranojmë vetëm punëtorë dhe nga sektorët e tjerë të lëmë pa pranuar.

Në këtë studim duhet të sqarohen shumë gjëra që sot na preokupojnë. Për shembull, ne konstatojmë se gjendja shoqërore po pëson ndryshime, sepse disa punëtorë ose fshatarë bëhen nëpunës. Natyrisht, një gjë e tillë nuk duhet të na alarmojë, vetëm duhet të kemi një pasqyrë që ta dimë se kaq veta kanë kaluar nga klasa punëtore e janë bërë nëpunës, po ne duhet të kuptojmë se me këta nëpunës që vijnë nga radhët e punëtorëve kemi forcuar aparatën shtetërorë, kemi futur në këto aparate frymën e ndjenjën e klasës, prandaj kjo duhet konsideruar si sukses. Pastaj ai tjetri nuk do të rrijë tërë jetën punëtor i thjeshtë, ai mund të arrijë të punojë deri në aparatën e Komitetit Qendror apo të bëhet anëtar i Qeverisë, e jo të mos bëhet drejtor fabrike, prandaj kalimi nga gjendja shoqërore punëtore në gjendje shoqërore nëpunës nuk duhet të na shqetësojë. Ose të marrim çështjen e oficerëve që kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare. Ata përpara ishin punëtorë apo fshatarë, tani konsiderohen nëpunës. Po mos vallë punëtori që është pranuar në Parti tani, ka më shumë garanci nga këta shokë oficerë që bënë luftën, kaluan gjithë këto vështirësi, vetëm për faktin

se i pari është me gjendje punëtore dhe oficeri është nëpunës? Po të mendohej nga dikush kështu, do të ishte shumë gabim, problemi do të shihej formalisht. Prandaj në qoftë se një punëtor e bëjmë nëpunës, kjo aspak nuk e dobëson Partinë, përkundrazi e forcon.

Mendimet që parashtrova mund të mos jenë të plota. Ne, sekretarët e Komitetit Qendror, duhet t'i shikojmë më thellë këto çështje, prandaj mund të bëjmë edhe diskutime të veçanta. Shokët përkatës të aparatit të Komitetit Qendror duhet të reflektojnë më shumë dhe herë pas here të na i shtrojnë këto probleme më të studiuara, që kështu të japim orientimet e duhura.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PUNA E SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT ËSHTË SHUMË SERIOZE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

7 maj 1965

Shumë kritika po të bëhen ty, shoku sekretar i parë. Mua nuk do të më vinte keq po të mos mbash shënime, sepse këto vërejtje ne t'i kemi bërë shumë herë, prandaj s'ka nevojë për shënime, më mirë më shiko në sy dhe dëgjo. Ti je anëtar i Plenumit të Komitetit Qendror, ke mbaruar Shkollën e Lartë të Partisë, je në kontakte të shpeshta me ne dhe shokë të tjerë udhëheqës, je në kontakte të përditshme me shokë të Partisë, të arsimit, të kulturës etj. Megjithëkëtë, mendimi im është se puna jote si sekretar i parë i komitetit të Partisë të rrethit nuk shkëlqen jo vetëm në fushën ekonomike, sepse në këtë drejtim nuk shikojmë një

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga komitetet e Partisë të dy rretheve mbi punën e organizatave të Partisë për drejtimin e problemeve ekonomike.

ngritje të kënaqshme, por edhe në fushën e arsimit, të kulturës, të zhvillimit politik etj. Ne shikojmë vazhdimisht që në fshatrat e rrethit tuaj ka dobësi të mëdha dhe për këto një përgjegjësi të rëndë veçanërisht ke ti, që je sekretar i parë i komitetit të Partisë të rrethit. Dobësitë vërehen sidomos në drejtim të çështjeve politike, kulturore dhe arsimore. Edhe në sektorët ekonomikë, rrethi juaj, megjithëse ka bërë disa përparime, po ecën shumë ngadalë.

Përse ndodh kjo me ty, shoku sekretar i parë? Për rrethin tuaj, këtu në Sekretariat, ne kemi folur shumë herë. Mua më duhet të ta them hapur dhe besoj se nuk gabohem, që këto dobësi në rrethin tuaj vijnë në radhë të parë nga dobësitë në punë të shokëve të komitetit të Partisë të rrethit.

Të punosh me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë nuk është një gjë e lehtë, siç mund të mendohet, me ta nuk mund të punohet pa kokëçarje. Kokëçarja duhet kuptuar në përpjekjet për të reflektuar thellë për ato që do t'u thuash atyre, për ato që do t'u mësosh dhe do t'u edukosh. Me ta nuk mund të flasësh çfarë do që të dalë përpara ose çfarë të të kujtohet në atë kohë që do të flasësh. Preokupacioni i sekretarit të parë nuk duhet kuptuar vetëm nga fakti se atë mund të mos e zërë gjumi për punën. Edhe ty mund të mos të të zërë gjumi, se je një shok i mirë politikisht e ideologjikisht, po për sa i përket punës, mënyrës si mendon e vepron dhe si i konkretizon detyrat, të gjitha këto tregojnë se ti nuk i kupton sa duhet këto gjëra. Më duket nuk ke të qartë çështjen që në radhë të parë duhet të mësosh vetë. Ç'do të thotë kjo, mos vallë duhet

të vesh përsëri në shkollë? Jo, shkollë ti ke bërë, prandaj hapi një çikë librat dhe gazetat, i këndo ato më me kujdes, jo për të dhënë provim si përpara profesorit, po për të dhënë provim në jetë, për të freskuar vazhdimisht dijenitë që ke fituar. Puna e sekretarit të parë është shumë serioze, kurse ju lexoni dhe nuk lexoni. Çështja nuk është vetëm thjesht të lexosh. Edhe kur lexoni ndonjë artikull, vetëm sa shpreheni: «Oh sa bukur e ka thënë Komiteti Qendror këtë çështje», dhe mbi problemet që ngrihen nuk punoni vetë, në radhë të parë, e pastaj këtë praktikë ta çoni gjer në bazë.

Dua t'ju pyes, mbani ju shënime për ato që lexoni? Lodhen shokët e Komitetit Qendror për artikujt që botohen në shtypin e Partisë, ata bëjnë një punë shumë të madhe në këtë drejtim. Prandaj edhe ju gjatë leximit e studimit duhet të mbani shënime për mjaft gjëra për të cilat dini se ka nevojë Partia. Partisë jo vetëm duhet t'ia transmetoni ekzakt çështjet, sikurse thotë Komiteti Qendror, po edhe vetë duhet të reflektoni dhe t'i zbërtheni direktivat e Komitetit Qendror në kushtet tuaja dhe pastaj këto t'ua thoni instruktorëve dhe sekretarëve të organizatave-bazë. Pra, ti, si sekretar i parë që je, duhet të reflektosh në mënyrë serioze për të nxjerrë konkluzione nga gjithë eksperiencia e punës së Partisë të rrethit dhe këtë eksperiencë ta përpunosh çdo ditë në mendjen tënde e pastaj t'ua japësh edhe shokëve, jo të bësh vetëm punë që të dalin përpara e të zgjidhësh ç'të të thonë. Kështu nuk punohet. Nuk është vetëm kjo puna e sekretarit të parë, po diçka tjetër më e madhe. Të marrim, për shembull, punën me

komunistët analfabetë. Për këtë problem jo vetëm që ju nuk e vini fare ujët në zjarr, po nuk kujtoheni që edhe në rast se këta komunistë që janë analfabetë përpigën të mësojnë shkrim e këndim, ju nuk mendoni t'i nxitni më tej. Do të ecë Partia me njerëz të pamësuar? Jo, nuk mund të ecë, qoftë edhe sikur ata të kenë shumë dekorata.

Ne duam gjithashtu që organizatat-bazë të Partisë të udhëhiqen nga njerëz jo vetëm energjikë, luftëtarë e punëtorë, por edhe të ngritur politikisht, njerëz me shkollë. Të tjerët që kanë luftuar por më vonë nuk kanë bërë përpjekje për të kryer shkollë, t'i respektojmë, po neve na duhen njerëz që të jenë përkohësisht edhe të mësuar për të zgjidhur mirë problemet e mëdha që i dalin përpara Partisë në fushën ideologjike, politike, arsimore, kulturore, ekonomike etj., prandaj njerëz që për shumë arsye nuk ecin, le të jenë edhe anëtarë partie, le të kenë edhe eksperiencë në disa punë të thjeshta, ne duhet t'i zëvendësojmë. Ti shoku sekretar i parë duhet të reflektosh për këtë.

Të marrim çështjen e seminareve. Unë nuk mund ta konceptoj që sekretari i parë të mos interesohet për çështjen e seminareve, ose për përgatitjen e referateve që do të mbahen në to. Nuk është puna që të vesh një herë ose dy herë në seminare, mund të ketë edhe raste që s'vete, po referatet që do të mbahen nga të tjerët, duhet të kenë kaluar nga dora jote. Me këtë dua të them që ti qysh më parë ta dish problemin që do të shtrohet në seminar dhe ai që do të flasë atje jo vetëm duhet të vijë dhe të të raportojë si u zhvilluan punimet e seminarit e ç'doli prej tyre, po qysh përpara

seminarit ti duhet të kesh punuar me të për problemin që do të trajtohet atje, të kesh punuar vetë më parë, ditën dhe natën. Me një fjalë, ti të kesh bërë më parë një punë efektive që t'ia plotësosh punën atij që do të flasë, ta ndihmosh në drejtim të brendisë në radhë të parë, po edhe të formës dhe mënyrës së trajtimit të çështjeve, se edhe këto luajnë rol për të arritur sukses në punë.

Në qoftë se ti kënaqesh vetëm me faktin se në planin e seminareve të sekretarëve të organizatave-bazë është shkruar se do të bëhet një referat nga një instruktor dhe vetë nuk bën asgjë për këtë, ja ku po të them se nuk është kjo puna e një sekretari të parë. Në qoftë se ti si sekretar i parë nuk do të bësh më parë një punë me instruktorin e ngarkuar me këtë punë të rëndësishme ose me kuadrot që janë ngarkuar të flasin në seminarët e sekretarëve të organizatave-bazë, atëherë puna e Partisë nuk ka se si të ecë përpara, ajo do të qëndrojë kështu si po qëndron te ju.

Po ju, shoku sekretar i parë, përse nuk shkoni në seminar po e keni më lehtë të veni në një mbledhje fshati? Sepse mendoni që puna në fshat nuk ka shumë përgjegjësi. Duhet të ta them shqip, dhe për këtë juve ju vret ndërgjegjja, se e dini që në seminar kërkohet një punë e posaçme, e kualifikuar dhe që më parë kërkon të mendosh e të përgatitesh mirë. Dhe meqenëse këtë ti nuk e bën, i thua tjetrit ta bëjë seminarin dhe për vete shkon në fshat ku u flet njerëzve pak nga të gjitha, u kërkon edhe ndonjë statistikë dhe pastaj ikën. Jo shok, nuk mund të ecet kështu. Në qoftë se dëshiron ta nderosh Partinë që të ka edhe anëtar të Komite-

tit Qendror, edhe sekretar të parë rrethi, atëherë të punosh që të vesh t'u flasësh edhe njerëzve të mësuar, të përgatitur ideologjikisht. Mirëpo në qoftë se atje do të vesh direkt nga shtëpia pa bërë më parë përgatitje, as unë, as ti nuk do t'u themi dot atyre ato që kërkohen. Prandaj t'i mësojmë shokët të punojnë që edhe te fshatarët e thjeshtë kur venë, të mësohen të përgatiten mirë më parë dhe jo të flasin ç't'u vijë në mendje. Tani të gjithë kemi stazh të gjatë në Parti, pastaj shumë prej nesh i kanë kaluar të 40 vjetët. Të tjerët që pas Çlirimit ishin të vegjël, sot kanë mbaruar universitetin, dinë shumë gjëra, prandaj nuk u flet dot sidokudo. Ti je sekretar, mundet të mos dish shumë gjëra sa di ai në degën e tij, po kur të vesh përpara tij diçka duhet medoemos t'i thuash dhe t'i mësosh. Në këtë drejtim duhet punuar seriozisht se të gjithë kemi përgjegjësi.

Çështja është që pa menduar vetë sekretari i parë, pa reflektuar thellë ai për problemet që preokupojnë organizatën e Partisë në rreth, pa menduar për t'i ndihmuar shokët mirë dhe konkretisht, puna nuk mund të ecë përpara.

As çështja e hasmërive ose e pakënaqësive nuk zgjidhet, ashtu siç na thoni, që veni në shtëpinë e palëve, pini nga një kafe dhe kujtoni se u zgjidhën këto çështje me rrënjë kaq të thella. Këto punë nuk zgjidhen kështu, po me një veprimtari masive politike të shumëllojshme, duke përfshirë edhe vajtjen në shtëpi, gjer te ndjekja e çështjes si qëndrojnë të dy palët në çezmë, në rrugë etj. pas pajtimit, dhe të krijohet kudo për këta njerëz një atmosferë vëllazërimi që të mund të zhduken këto mbeturina të rrezikshme.

Udhëzime janë dhënë dhe kurdoherë do të jepen nga Komiteti Qendror, por në rast se këto udhëzime nuk kuptohen dhe nuk zbatohen menjëherë dhe vazhdimisht e jo në mënyrë automatike administrative, në radhë të parë nga vetë sekretari i parë, atëherë vaj halli për të tjerët. Ne kurdoherë e kemi për detyrë që ndonjë çështje sekretarit të organizatës-bazë t'ia shpjegojmë, po të jetë nevoja edhe disa herë, derisa ta kuptojë, po jo ama sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit, ndryshe do të bëheshim si papagaj duke përsëritur vazhdimisht se si duhet punuar, për shembull, me instruktorët, çështje kjo që është trajtuar gjerë nga Komiteti Qendror. Tani na kanë dalë qime të bardha, shokë, nuk jemi më të rinj e pa eksperiencë. Ç'është kështu me ju, përse nuk e vini në jetë këtë metodë pune që ju rekomandon Komiteti Qendror dhe ta përmirësoni punën konkretisht? Kjo metodë, natyrisht, nuk duhet marrë në mënyrë dogmatike, por vetëm duke pasur parasysh parimin që duhet punuar mirë me instruktorët, pa qenë nevoja të udhëzoheni më tej si duhet vepruar. Sekretari i parë ta vrasë një çikë mendjen si ta organizojë punën për këtë problem që ju ka rekomanduar Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror. Një gjë e tillë do të bëjë që me instruktorët të organizohet një punë me të vërtetë shkencore dhe jo shkel e shko. Vetë sekretari i parë, pra, duhet të gjejë forma e mënyra pune si ta zbatojë sa më mirë e me sukses këtë direktivë.

Më duket se nuk ka nevojë të na thuash se keni vështirësi për daljen e kooperativistëve në punë. Sa herë e kemi dëgjuar dhe do ta dëgjojmë këtë shprehje.

Çështja është që ju të organizoni mirë punën, politikisht dhe ideologjikisht, në mënyrë që njerëzit të dalin më shumë në punë, që ata të jenë më të rregullt. Asgjë nuk zgjidhet si duhet kur nuk organizohet mirë puna dhe kur kjo nuk mbështetet politikisht. Këtu e keni dobësinë ju, shokë të komitetit të Partisë të rrethit. Ju bëni një punë të pamjaftueshme politike, arsimore dhe kulturore. Prandaj në këto drejtime sikur ta shikonit dhe ta analizonit më mirë punën tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PROBLEMET E SHKOLLËS STUDIOHEN E ZGJIDHEN SIPAS KUSHTEVE TË REJA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

8 maj 1965

Mendoj që shkolla e mesme të mos konsiderohet masive dhe e detyruar sepse te ne e tillë tani për tani është vetëm shkolla 8-vjeçare. Në qoftë se themi që shkolla e mesme të jetë masive dhe e detyruar kjo do të thotë që atë ta mbarojnë të gjitha masat e rinisë në fshat e në qytet, që kultura e përgjithshme minimale e çdo qytetari shqiptar të jetë shkolla e mesme. Mirëpo kjo s'ka mundësi të realizohet tani, pra, kultura masive te ne merret në shkollën 8-vjeçare. Mendoj se për arsye ekonomike e shoqërore edhe për disa pesëvjeçarë shkolla 8-vjeçare te ne do të mbetet si bazë e arsimit për të gjithë. Kjo nuk do të thotë aspak se arsimit do të

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi planet, programet dhe afatin e shkollës së mesme të arsimit të përgjithshëm».

mbarojë me kryerjen e 8-vjeçares, për arsye se një pjesë e rinisë do të ndjekë shkollat e mesme të përgjithshme, të tjerë do të ndjekin shkollat e mesme profesionale. Nga këta një pjesë do të venë në universitetet me ose pa shkëputje nga puna. Të tjerë, pasi të mbarojnë 8-vjeçaren, mund të ndjekin edhe kurse të ndryshme disamujore dhe një ose dyvjeçare, që do të thotë se kultura e tyre do të vazhdojë pas asaj të 8-vjeçares. Por megjithëkëtë, shkolla e mesme edhe gjatë një periudhe të ardhshme nuk do të jetë për të gjitha masat e rinisë. Kështu ndodh edhe tani. Në këtë mënyrë në vendin tonë do të rritet vazhdimisht kultura e njerëzve.

Ne nuk duhet të mendojmë që ta suprimojmë krejtësisht shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm, domethënë gjimnazin dhe të orientohemi vetëm nga shkollat e mesme profesionale. Gjimnazi në vendin tonë është i nevojshëm të jetë edhe në të ardhmen. Nëse shkolla e mesme e përgjithshme duhet të jetë 11 apo 12 vjet, kjo është një çështje tjetër që duhet ta gjykojmë e ta vendosim. Në qoftë se sot ne nuk kemi sa duhet shkolla të mesme profesionale, mund të hapim të tjera. Kjo gjithashtu duhet të studiohet e të vendoset.

Tani të shohim çështjen e afatit të shkollës së mesme të përgjithshme, nëse duhet ta kemi 11 apo 12 vjet. Përcaktimi i këtij afati varet nga shumë faktorë që u diskutuan këtu. Ky afat varet nga programi, nga arsimtarët që i zbatojnë këto programe shkollore si dhe nga mundësia e përvetësimit të këtyre programeve prej nxënësve.

Ngarkesës së nxënësve me punë dhe çlodhjes së

tyre u duhet kushtuar rëndësi. Edhe ne të rriturit kemi nevojë të freskohemi pas një pune mendore ose mbledhjeje të gjatë. Pastaj duhen llogaritur në total, orët e mësimeve në klasë, të përgatitjes së mësimeve në shtëpi si dhe koha e lojës, punët shoqërore të rinisë, pushimi gjatë ditës ose javës etj.

Bashkë me këto një problem i rëndësishëm që duhet pasur parasysh është edhe ana ekonomike, kjo si për shtetin, ashtu edhe për nxënësin e familjen e tij. Më së fundi është edhe çështja e nevojave që ka ekonomia shtetërore për kuadro në sektorë të ndryshëm. Të gjithë këta faktorë duhet t'i kemi parasysh.

Arsimtarët, për sa i përket zgjatjes së afatit, nisen nga prirja për të pasur një kohë më të gjatë në dispozicion. Edhe këtë pikëpamje ne nuk duhet ta hedhim poshtë, po të mos e shikojmë nga pozita e arsimtarit. Unë mendoj se një arsimtar mund ta realizojë programin më mirë në qoftë se shkolla bëhet 12 vjet, ai që është më i aftë mund ta realizojë akoma më mirë, kurse i paafiti mund ta zgjatë programin dhe përmbajtjen e tij ta zhvillojë me të meta.

Çështja është, në radhë të parë, që, nëpërmjet programeve të caktuara, t'u japim nxënësve një kulturë të përgjithshme të nevojshme, të domosdoshme për t'i bërë ata të aftë të dalin në jetë.

Programet kanë rëndësi të madhe, prandaj ato duhet të përgatiten sa të jetë e mundur më mirë. Në qoftë se do të pranojmë që shkolla e mesme e përgjithshme të jetë 12 vjet, këtë shtesë në afat mendoj të mos e përdorim për të rënduar programet, por të ruajmë disa rezerva për një plotësim programi. Specialistët

e Ministrisë së Arsimit tani, për shembull, mendojnë se në qoftë se shkolla bëhet 12-vjeçare t'u japin më tepër prioritet matematikës, kimisë e fizikës, gjë që në masën e duhur mund të bëhet dhe nuk mendojnë fare për t'u krijuar mundësinë arsimitarëve që të kenë kohë të lirë për të studiuar më mirë lëndën. Pra, në kushtet tona mësuesit duhet t'i lëmë kohë ta studiojë më mirë lëndën, të perfeksionohet në zanatin e tij në forma të ndryshme. Duke e bërë shkollën 12 vjet, do t'u rezervojmë më shumë kohë që edhe ata vetë të kenë mundësi të mësojnë.

Pra, në qoftë se shkollën do ta bëjmë 12-vjeçare, ne duhet ta mbushim programin me diçka tjetër, me synimin për t'i përgatitur nxënësit për jetën, për prodhimin, por edhe për mbrojtjen; të kemi gjithashtu parasysh të ruajmë edhe disa rezerva për të ardhmen, për kohën e lirë të nxënësve, që t'u krijojmë mundësi të merren edhe me aktivitete fizikulturale për zhvillimin e tyre fizik, si dhe nxënësi të ketë mundësi të bëjë edhe punë mendore jashtë shkollës për t'u përgatitur për të nesërmen.

Tani të shikojmë edhe anën ekonomike. Në qoftë se duam që shkolla e mesme e arsimit të përgjithshëm të jetë e masave të gjera të rinisë, afati i saj 12-vjeçar mund të duket sikur nuk është ekonomik, sepse hyjnë në prodhim 1 vit më vonë. Por në rast se ato do t'i ndërtojmë në përputhje me nevojat shtetërore, këtu duhet të shohim edhe çështjen e shkollave të tjera. Fakti është se tani po hyjmë në një fazë të re, kur nga shkollat e mesme të përgjithshme po na mbetet një kontingjent që nuk e thith arsimiti i lartë. Në qoftë se

tani rregullojmë një sistem më të përshtatshëm shkollor, duke ua përshtatur më mirë nevojave që do të ketë ekonomia e kultura jonë, ne nuk do të kemi kurrë suficit, por do të ndodhë e kundërta. Pra, po ta organizojmë më mirë sistemin shkollor, sipas nevojave aktuale të shtetit dhe të perspektivës për të pasur kuadro, teknikë të mesëm dhe punëtorë të kualifikuar në degët më të ndryshme, atëherë neve do të na leverdisë që shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm ta kemi 12-vjeçare.

Ekonomikisht një shkollë me 12 vjet ne mund ta përballojmë. Së pari, në shkollat e mesme të përgjithshme nuk do të na vijë një numër i madh nxënësish, sepse do të ketë një sistem shkollash me specialitete e afate të ndryshme. Nga ana tjetër, Partia duhet të bëjë një punë të madhe me nxënësit për të rrënjosur tek ata dashurinë për punën dhe profesionin dhe të thyhet mentaliteti për të ndjekur medoemos shkollën e arsimit të përgjithshëm e për të vazhduar universitetin, për të siguruar punë drejtuese në administratë e në prodhim. Duhet kjo frymë të futet që në familje, të bëjmë që prindi t'i flasë djalit të tij në shtëpi për tornon, traktorin etj., duke i futur dashurinë për punë dhe të përpiqet që djali të mos i bëjë bisht prodhimit. Por puna e Partisë dhe e rinisë në këtë drejtim duhet të jetë edhe më e madhe, në mënyrë që njerëzit të drejtohen edhe në profesione. Mësimi dhe puna janë të pandarë për rininë tonë.

Ne kemi ngritur me dhjetëra shkolla të mesme të përgjithshme, bile gjer në ndonjë kooperativë si Krutja. Tani mendoj se duhet të studiojmë me kujdes se gjersa

do të shtrihemi me këto shkolla, si do t'i shfrytëzojmë jo vetëm për të furnizuar shkollat e larta, por ato kontingjente të tyre që nuk do të vazhdojnë studimet më lart ku do t'i kanalizojmë, në shkolla a kurse 1-2-vjeçare a disamujore, apo do t'i jepen prodhimit. Nuk ka pse të mbeten ata që mbarojnë shkollat e mesme të përgjithshme pa punë, prodhimi ka nevojë për njerëz me shkollë. Natyrisht, këtu dalin probleme, ne nuk marrim përsipër t'i gjejmë punë njërit e tjetrit aty ku ia ka qejfi, në Tiranë, pranë familjes etj., por atje ku ka nevojë atdheu, në fshatra, ferma, miniera etj. Por duhet luftuar edhe mentaliteti i disa të rinjve që mendojnë se, meqë kryen një arsim të mesëm, ata nuk mund të bëhen punëtorë e të ngjitin shkallët në punë e sipër. Sidoqoftë, sot mund të bëjnë naze, se kemi nevojë për kuadro drejtues, por nesër nuk do të jetë kështu, se kontingjentet e shkollarëve do të jenë më të mëdha e ata që do të venë në arsimin e lartë do të zgjidhen nga më të mirët.

Mendoj të shohim edhe një gjë tjetër. Më duket se te disa të rinj ka një prirje të gabuar: me të dalë nga shkolla e mesme ose nga ndonjë kurs teknik, po të mos marrin nga 500 lekë në muaj ata nuk punojnë. Ai që mbaron shkollën e mesme ose një kurs profesional në fillim mund të marrë edhe më pak, pastaj të marrë më tepër në bazë të punës dhe të aftësive të tij.

Nuk është e drejtë që një djalë ose një vajzë e re 16-17-vjeçare, porsa të dalë nga kursi të kërkojë dhe të marrë rrogë sa edhe një teknik i mesëm ose të marrë kategorinë e 5-të. Ai duhet të punojë ca kohë, të arrijë

nivelin profesional të teknikut të mesëm, pastaj të krahasohet me të. Këto gjëra duhet t'i shohim, se jo vetëm bëhen nxitje që njeriu t'i marrë shoqërisë më shumë se ç'i jep, por nxitin edhe karrierizmin. Ka të rinj që thonë: «Si teknik, pse të paguhem kaq pak, prandaj më mirë të vete në shkollën e mesme të përgjithshme dhe pastaj këtej e në universitet se ashtu do të paguhem më shumë». Ne duhet t'i edukojmë njerëzit që shkallët t'i ngjitin me përpjekje.

Për sa i përket afatit të shkollës së mesme të arsimit të përgjithshëm, pas diskutimesh që u zhvilluan, edhe unë jam i mendimit që ajo të jetë 12-vjeçare.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUR KE POPULLIN ME VETE MUND TË KALOSH ÇDO VËSHIRËSI

Nga biseda me një përfaqësuese të grave të Malit

10 maj 1965

Pasi u bënë përshëndetjet e rastit, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Jam i gëzuar që takohem me ju, zonjë, një ndër udhëheqëset dhe drejtueset e grave heroike të Malit. Megjithëse jemi larg njëri-tjetrit, ne kemi simpati e dashuri për Republikën e Malit dhe për popullin tuaj. Pavarësisht se popujt tanë janë të vegjël, ata kanë të drejtën të jetojnë e të punojnë të lirë, të thonë hapur fjalën e tyre, të përfaqësojnë vullnetin dhe të mbrojnë të drejtat e veta.

Megjithëse sistemi ynë ekonomik-shoqëror është i ndryshëm nga ai i vendit tuaj, ne mbajmë lidhje me njëri-tjetrin duke respektuar e duke zbatuar parimet e njohura të marrëdhënieve midis vendeve. Ne jemi komunistë dhe këtë e dinë të gjithë, sepse e themi hapur. Por fakti që jemi komunistë nuk na pengon, përkun-

drazi na ndihmon që të duam, të nderojmë e të respektojmë çështjen e drejtë të të gjithë popujve që luftojnë për lirinë e pavarësinë e tyre, të respektojmë e të mbështetim të gjitha ato qeveri përparimtare që janë për përparimin dhe zhvillimin e vendeve të veta dhe nuk pranojnë të bëhen vegla të imperialistëve në dëm të popujve të vet apo të popujve të tjerë, që janë të lidhur me popullin dhe e drejtojnë vendin në rrugën e përparimit. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse kur ke popullin me vete mund të bësh çdo gjë, mund të kalosh çdo vështirësi, sado të mëdha të jenë ato. Ne nuk respektojmë vetëm opinionet e atyre që veprojnë në kundërshtim me interesat e popujve, nuk respektojmë ata që, nga një anë, bëjnë demagogji, por, nga ana tjetër, ndjekin një politikë skllavëruese, presioni dhe nënshtrimi ndaj popujve, me qëllim përfitimi për vete. Ndaj të tillë njerëzve dhe grupeve ne nuk mund të rrimë indiferentë, por i demaskojmë gjer në fund.

Ashtu sikurse populli juaj edhe populli ynë ka vuajtur në të kaluarën. Por pas Çlirimit e këtij Partia dhe Qeveria jonë kanë bërë mjaft për popullin dhe tani jeta e tij është përmirësuar.

Më parë përfaqësuesit e borgjezisë kapitaliste na quanin ne, shqiptarët, njerëz të egër, nga më të prapambeturit në Evropë. Nuk ka dyshim se nga kolonizatorët është thënë kështu edhe për popullin tuaj. Por faktet dhe realiteti tregojnë të kundërtën. Pushtuesit e huaj këto ide i trillonin me qëllim që të na mbanin të skllavëruar dhe të justifikonin veprimet e tyre barbare ndaj popujve tanë. Ne jemi dy popuj të ndryshëm, por kemi pasur fat të njëjlojtë, sepse kemi qenë të

sunduar për shumë kohë nga të huajt, të cilët donin të na shtypnin. Por vullneti i popujve nuk mund të shtypej për tërë jetën. Erdhi një kohë që ky vullnet shpërtheu me furi dhe pushtuesit pësuan një tronditje të fortë. Tërmet i madh ra pas Luftës së Dytë Botërore për kolonizatorët francezë në Mali, ashtu si edhe për kolonizatorët e tjerë në Afrikë. Në saje të luftës së tyre heroike, shumë popuj afrikanë fituan pavarësinë kombëtare dhe tani po ndjekin një politikë antikolonialiste.

Duke lexuar tekstin e një historiani francez mbi Afrikën nuk mund të të shpëtojë pa vënë re se kjo është një vepër që synon të nënvleftësojë historinë e vendeve të Afrikës, kulturën e tyre. Është fakt se kolonizatorët, që u dyndën dhe sunduan për shekuj, u munduan ta shkatërrojnë këtë kulturë, kurse popujt afrikanë ata i kthyen në skllëvër dhe i shfrytëzuan gjer në palcë. Por, me gjithë përpjekjet e tyre ata jo vetëm nuk mundën ta shuanin këtë kulturë, por as të frenonin përgjithnjë zhvillimin e mëtejshëm të saj. Dhe kjo ka arsyet e veta. Kultura e shumë vendeve afrikane, në krahasim me atë të vendeve evropiane, ka qenë shumë më e lashtë. Kjo kulturë ka influencuar shumë në zhvillimin e kulturës së kontinenteve të tjera dhe të kulturës botërore. Natyrisht unë nuk mund ta njoh sa ju historinë e popujve të Afrikës, por ka dije-tarë që kanë studiuar në mënyrë objektive zhvillimin e kulturës suaj dhe flasin me admirim të madh për këtë kulturë. Tani, shumë nga popujt e Afrikës janë çli-ruar, po e marrin veten dhe sot kultura e tyre përsëri është duke u zhvilluar. Pikëpamja reaksionare që shpall

inferioritetin e të ziut ndaj të bardhit dhe të gruas ndaj burrit, sot nuk i qëndron më realitetit.

Për sa i përket rolit të gruas në shoqëri, Partia jonë kurdoherë është mbështetur në forcën dhe në zgjuarsinë e saj. Ne mendojmë se pa gruan nuk mund të ecet asnjë hap përpara. Partia jonë qysh kur u krijua kërkoi që ne të mbështeteshim fort te masa e grave, sepse ato jo vetëm përbëjnë gjysmën e popullsisë, por edhe për faktin që në qoftë se edukohen dhe udhëhiqen drejt, ato bëhen një forcë e madhe dhe e pallogaritshme për përparimin e vendit. Gratë jo vetëm përtërijnë jetën, por janë edhe edukatore të brezit të ri, janë një forcë e madhe prodhuese dhe kanë aftësi drejtuese e organizuese. Para Çlirimit gratë në vendin tonë ishin të shtypura. Shumica e tyre, sidomos ato që ishin të fesë myslimane, nuk punonin jashtë shtëpisë. Ndërsa sot, gjendja e gruas në Shqipëri ka ndryshuar rrënjësisht. Partia u kujdes shumë për gruan dhe i dha asaj mundësinë që të zërë vendin që i takon dhe të luajë aktivisht rolin e saj jo vetëm në familje, por edhe në prodhim e në jetën shoqërore. Por megjithëse kemi bërë shumë, ne akoma nuk kemi arritur të bëjmë atë që duam për gruan. Ne e dimë se edhe ju keni bërë mjaft në këtë drejtim.

Mali është një vend shumë më i madh nga Shqipëria, sidomos nga pikëpamja e sipërfaqes, por edhe në popullsi ju keni mbi 2 herë më shumë se ne. Vendi juaj është gjithashtu i pasur dhe po ecën në rrugën e përparimit. Kjo dëshmon se populli juaj, si të gjithë popujt, ka aftësi krijuese. Tani, pas disa vjet jete të lirë e të pavarur, nuk mund të thuhet se populli juaj

nuk ka eksperiencë. E vërteta është se edhe ne në fillim nuk kishim eksperiencë, por kur filluam t'u futemi punëve, u panë edhe më mirë energjitë e pashtershme dhe aftësitë krijuese të popullit. Sigurisht, çdo gjë nuk u bë menjëherë, mjaft probleme u zgjidhën me kalimin e viteve dhe tani vendi ynë është në transformim të plotë. Ja, në kohët e para pas Çlirimit, patëm trashëguar shumë pak shkolla, ndërsa tani kemi një rrjet shumë të gjerë shkollash të të gjitha kategorive, bile dhe universitetin tonë. Megjithëse me vështirësi, ne krijuam inteligjencien tonë të re dhe sot, jo vetëm në shkolla, por në të gjithë sektorët kemi kuadrat tanë, pedagogë, inxhinierë, agronomë, gjeologë e mjekë. Kështu do të ndodhë medoemos edhe në vendin tuaj. Me sa dimë, ju tani keni shumë më tepër shkolla nga sa kishim ne pas Çlirimit, sigurisht shkolla franceze dhe me pedagogë të huaj. Në vitin 1963 ju keni pasur 100 000 nxënës, të cilët mund të bëhen patriotë të mirë të atdheut të vet. Kjo është një fitore e madhe për ju. Të dy vendet tona, natyrisht, kanë akoma shumë vështirësi, por ne patjetër do t'i kalojmë ato me kurajë, vendosmëri dhe besim të madh.

Ne jemi një popull i vogël, i rrethuar nga armiq. Fashistët italianë, kur pushtuan Shqipërinë, bënë të gjitha përpjekjet për të na likuiduar. Edhe revizionistët jugosllavë, që për ne janë tradhtarë, dhe këtë e themi botërisht, synuan ta gllabëronin vendin tonë. Qysh pas Çlirimit ata u përpoqën ta mbytnin Republikën Popullore të Shqipërisë, ta bënin një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Kur kishim marrëdhënie me ta, ne i kon-

sideronim si miq dhe shokë, por ata na sabotonin në të katër anët.

Edhe monarko-fashistët grekë kanë mbajtur vazhdimisht qëndrim armiqësor ndaj Shqipërisë. 20 vjet kanë kaluar nga mbarimi i luftës dhe ata gjithnjë kanë refuzuar të lidhin marrëdhënie diplomatike me vendin tonë. Ne nuk kemi qenë kurrë në luftë me Greqinë, përkundrazi, shqiptarët janë përpjekur gjithnjë të rrojnë në miqësi me popullin vëlla grek. Luftëtarët tanë kanë marrë pjesë edhe në revolucionin grek dhe në luftërat e tjera çlirimtare të Greqisë. Ali Pashë Tepelena, për shembull, që ka ndihmuar revolucionin grek, ka qenë shqiptar. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, fashistët italianë që kishin pushtuar më parë Shqipërinë, sulmuan edhe Greqinë. Ne, që i kuptonim synimet e fashistëve italianë, bëmë gjithçka për të ndaluar këtë agresion, e sabotuam luftën e italianëve kundër Greqisë. Megjithatë monarko-fashistët grekë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e sot e kësaj dite pretendojnë se janë në «marrëdhënie lufte» me Shqipërinë, e cila ishte vetë e pushtuar nga italianët, kurse me Italinë që i sulmoi, ata mbajnë marrëdhënie diplomatike dhe lidhje të tjera në fusha të ndryshme.

Në saje të vijës dhe të qëndrimit të drejtë të Partisë dhe të Qeverisë sonë, kufijtë tanë janë të mbrojtur mirë dhe brenda tyre ka qetësi. Përpara armiqtë na bënë vazhdimisht provokacione në kufi. Tani gjëra të tilla nuk ndodhin si më parë. Kjo jo se ne u rritëm më shumë, por fqinjët e kanë kuptuar vendosmërinë e shqiptarëve, e dinë se në tokën shqiptare nuk kalohet lehtë, se populli ynë lufton me vendosmëri për mbrojt-

tjen e të drejtave të tij dhe do t'u imponohet të gjithë atyre që duan t'i bëjnë keq, që duan të përfitojnë në kurriz të tij dhe të veprojnë në rrugë jo të drejta. Gjithmonë populli ynë ka dashur dhe dëshiron që të jetojë në fqinjësi të mirë me popujt fqinjë. Ai i ka dashur dhe i do miqtë e vërtetë, ata që mbajnë qëndrime parimore të drejta ndaj tij. Kështu e ka dashur ai edhe Bashkimin Sovjetik. Por pas vdekjes së Stalinit ndryshoi puna. Revizionistët hrushovianë braktisën politikën tradicionale leniniste të ndjekur nga Stalini, prandaj ne nuk mund të rrinim pa demaskuar qëndrimet e tyre ndaj çështjes së popujve dhe vendit tonë. Ata me fjalë thoshin se ishin miq të popullit shqiptar, se ishin internacionalistë etj., por në fakt vetëm për specialistët, që na dërgonin për të na ndihmuar, na kërkonin t'u jepnim rroga 10 herë më të mëdha nga rroga ime. Atëherë, ku është këtu miqësia dhe internacionalizmi? Vështirësitë e mëdha ekonomike që kalonim ne, atyre nuk u bënin asnjë përshtypje, përkundrazi, specialistët sovjetikë, të dërguar nga Hrushovi në Shqipëri, kërkonin të jetonin në mënyrë luksoze dhe të silleshin me arrogancë ndaj njerëzve tanë. Por miqtë dhe vëllezërit nuk veprojnë kështu. Ne nuk ishim ndonjë vend i pasur, përkundrazi, kishim shumë mungesa e vështirësi, prandaj, në të tilla kushte, mënyra aq luksoze e jetesës e specialistëve sovjetikë që punonin në Shqipëri ishte një shprehje e mungesës së konsideratës së revizionistëve ndaj popullit tonë.

Edhe imperializmi amerikan, ky armik i tërbuar i popujve, përpiqet me të gjitha mënyrat të mbajë nën sundim dhe të shfrytëzojë vendet e ndryshme. Ai nuk

mund të pajtohet me qëndrimin e atyre vendeve të pavarura që kanë hyrë në rrugën e përparimit, prandaj në politikën e tij duken hapur qëllimet kolonialiste për t'i mbajtur popullin e Malit dhe popujt e tjerë të Afrikës nën një presion të vazhdueshëm ekonomik e politik. Por sfera politike dhe ekonomike e imperializmit amerikan do të vijë gjithnjë duke u ngushtuar, pasi Afrika, ky kontinent i shtypur nga kolonialistët, tani është në zgjim e sipër, po ngrihet dhe e ardhmja u takon popujve të Afrikës. Zgjimi i këtyre është një artileri e fortë kundër amerikanëve dhe të gjithë kolonizatorëve e neokolonizatorëve.

Popujt e këtij kontinenti luftojnë për t'u rimëkëmbur dhe kjo do të bëhet në radhë të parë me forcat e vetë popujve afrikanë. Ne, shqiptarët, mbasi korrëm fitoren me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, filluam nga rindërtimi i vendit dhe qysh në fillim thamë se këtë punë do ta bënim me forcat tona. Eksperienca na ka bindur se kjo është një politikë e drejtë. Dhe kur popullin e udhëheq drejt ai merr kurajë dhe përballon çdo vështirësi, forcon dashurinë e respektin për udhëheqësit dhe ecën në rrugën ku e çojnë ata.

Sot në botë, gjendja ndërkombëtare, megjithëse e ndërlikuar e me shumë probleme, po zhvillohet në favorin tonë, në favor të popujve. Por ne akoma kemi shumë për të bërë sepse armiqtë nuk i hedhin lehtë armët. Imperialistët janë armiqtë e paqes e të njerëzimit, por edhe revizionistët modernë, sidomos ata sovjetikë, janë armiq po aq të rrezikshëm sa dhe imperialistët, jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë popujt e botës. Të veshur me rroba dhe parulla «të majta» revizio-

nistët modernë janë të lidhur me të njëjtën politikë me imperialistët amerikanë, janë bërë kolona e pestë e kapitalizmit. Ata vuajnë nga megalomania e shtetit të madh, luftojnë këdo që është kundër imperializmit dhe përpiqen të marrin nëpër këmbë popujt. Revizionistët sovjetikë mendojnë se të gjithë popujt e vegjël duhet t'u nënshtrohen influencave dhe vullnetit të fuqive të mëdha.

Kryeministri sovjetik, me paturpësinë më të madhe, u tha këto ditë gazetarëve në Berlin se me armët që ekzistojnë tani, lufta është e pamundur të bëhet. Po luftërat në Vietnam, Kongo, Angola e gjetkë çfarë janë? Ai mendon kështu duke u nisur ngaqë, sipas tij, midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk mund të ndodhë luftë. Por, mos vallë vetëm kjo konsiderohet luftë nga revizionistët sovjetikë? Domethënë se, sipas revizionistëve, në qoftë se imperialistët bëjnë agresion në vendet e tjera popujt e këtyre vendeve le të vriten. Vetëm për faktin se amerikanët dhe sovjetikët kanë raketa dhe armë bërthamore dhe midis tyre tash për tash nuk bëhet luftë, ata dalin me tezën se aktualisht lufta është e pamundur të bëhet. Por si mund të jetë e drejtë kjo tezë në një kohë kur ekziston imperializmi, burimi i luftërave?

Nga ana tjetër, revizionistët hrushovianë bëjnë demagogji, flasin paturpësisht se gjoja po ndihmojnë Vietnamin, Kongon etj. Por çfarë ndihme konkrete i japin sovjetikët Vietnamit? Vetëm disa pushkë të mbetura nga Lufta e Dytë Botërore dhe nxjerrin gjithfarë pretekstesh për të mos i dërguar edhe ato. Lufta kundër amerikanëve në Vietnam ka mbi 10 vjet që ka filluar,

por gjatë kësaj kohe, ndërsa imperialistët amerikanë u kanë dhënë armë të të gjitha llojeve dhe raketa qeverisë kukull të Vietnamit të Jugut dhe gjithë aleatëve të tyre, Hrushovi, si kryeministër sovjetik, përse nuk e furnizoi edhe ai me armë, aeroplanë e me raketa RD të Vietnamit, në një kohë kur aeroplanë i jep dhe Indisë reaksionare? Kësaj pyetjeje ai nuk i përgjigjet dot. Tani që amerikanët po bombardojnë egërsisht Vietnamin e Veriut, tradhtarët revizionistë bërtasin sikur duan t'i japin ndihma Vietnamit, por nuk po i lejoka Kina. Ata po trumbetojnë sikur gjoja duan të dërgojnë edhe vullnetarë në Vietnam. Por Vietnami nuk ka nevojë për njerëz, ai ka nevojë për armatime, ka nevojë për përkrahje dhe mbështetje të vendosur nga të gjithë.

Kur e pyetën korrespondentët e huaj Kosiginin se ç'mendonte ai mbi situatën në Evropë dhe mbi bashkimin e Gjermanisë, ai pati paturpësinë të pohojë se Bashkimit Sovjetik i intereson statukuojat e tanishme në Evropë. Kjo do të thotë që jashtë Evropës amerikanët mund të bëjnë ç'të duan dhe se evropianët, duke preferuar statukuonë, u lënë atyre dorë të lirë në pjesët e tjera të botës! Ç'janë thënë më parë nga Hrushovi dhe Ulbrihti, tani udhëheqësit revizionistë sovjetikë i hedhin poshtë të tëra për të mos i penguar amerikanët në luftën e tyre për shtypjen e revolucionit botëror. Kur ne i demaskojmë për të tilla veprime tradhtarë, ata thonë se shqiptarët nuk kuptojnë nga politika, se janë kokëfortë etj. Ndaj armiqve imperialistë e revizionistë ne vërtet jemi kokëfortë e të papërkulur, kurse me miqtë merremi vesh dhe jemi të arsyeshëm.

Ndaj njerëzve të tillë siç janë revizionistët nuk ke si të mos revoltosh. Kokë për të menduar nuk kanë vetëm Kosigini, Brezhnjevi dhe shokët e tyre, por kanë edhe të tjerët. Ata mund të kenë topa, tanke dhe aeroplanë, raketa, armë atomike e shumë armë moderne, por fitorja nuk është me ta, fitorja u përket popujve. Ne jemi të sigurt, se, ashtu si Lenini dhe Stalini që, pa pasur asgjë përveç vullnetit të pathyeshëm të masave dhe të partisë, udhëhoqën popullin në revolucion dhe fituan, ashtu sikurse fituam edhe ne që, kur ia nisëm luftës çlirimtare kundër imperialistëve italianë, gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, nuk kishim asgjë veç udhëheqjes së Partisë dhe vullnetit për fitore, edhe sot popujt e botës do të fitojnë kundër imperialistëve dhe revizionistëve, pavarësisht se këta janë të armatosur dhe duken si të fuqishëm.

Ne i kushtojmë rëndësi të veçantë mbrojtjes së vendit, sepse në botë ekzistojnë imperializmi dhe revizionizmi. Për qëllime mbrojtjeje i kemi armët tona, bile edhe raketat. Ato i nxorëm edhe në paradën që u zhvillua me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Sovjetikët nuk deshën të na i jepnin, por ne insistuam, i detyruam të na i jepnin. Tani ata janë dëshpëruar shumë për këtë. Por aq na bën. Të kesh raketa është një gjë normale dhe e drejtë për çdo shtet që kërkon të mbrohet.

Duke marrë fjalën mysafirja nga Mali, midis të tjerash, tha:

Ju falënderoj shumë për bisedën. Këtu mora një mësim të madh nga ju. Për revizionistët modernë kemi

dëgjuar shumë por nuk u besojmë më atyre. Ne jemi të pakënaqur nga politika e Bashkimit Sovjetik që, nga njëra anë, furnizon me armë Indinë, kurse Vietnamin, që lufton për lirinë e vet, nuk e ndihmon. Gjerca kohë përpara politika jonë mbështetej në ndihmat e Bashkimit Sovjetik, por tashmë e kemi të qartë se nuk mund të mbështetemi më në këto ndihma. Popullsia e Bamakos është shumë e pakënaqur nga qëndrimet që mbajnë njerëzit sovjetikë që punojnë te ne dhe kërkojnë rroga të mëdha, megjithëse e shikojnë se si jeton populli ynë.

Teknikët sovjetikë në Mali kërkojnë që veç rrogave të larta, t'u sigurojmë edhe vetura, frigoriferë e komoditete të tjera. Por një qëndrim i tillë bën përshtypje të keqe në punëtorët tanë, që nuk i kuptojnë këto gjëra. Personeli i ambasadës sovjetike në Bamako përbëhet nga më shumë se 300 veta. Këta nuk lënë gjë pa blerë nëpër dyqanet tona. Bile shumë gjëra ata i blejnë në sasi të mëdha dhe i nisin me aeroplan për në Moskë. Gruaja e ambasadorit, për shembull, sa herë që del në treg blen nga 20 kg gjalpë, por populli, që sheh se ç'bëhet, pyet: «Ç'janë këto gjëra që bëjnë këta? Le të blejnë më pak gjalpë që të mbetet edhe për fëmijët tanë diçka e jo nga 20 kg gjalpë menjëherë». Ngaqë blejnë mallra në sasira të mëdha në tregun tonë, u detyruam të marrim masa në dyqanet që çdo blerësi të mos i jepet, për shembull, më shumë se një kilogram gjalpë. Vetë populli na bënte presion e na thoshte: «Sovjetikët sikur kanë ardhur të na ndihmojnë, kurse këta po na rrjepin lëkurën».

SHOKU ENVER HOXHA: Po përse e marrin ata

gjarpin tuaj? Hrushovi 10 vjet përpara thoshte se BS do t'ua kalonte edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në qumësht, mish etj. Por ai dhe të gjithë revizionistët e tjerë, janë jo vetëm gënjeshtarë, por edhe hajdutë të mëdhenj. Kështu i kanë mësuar të jenë edhe specialistët që i dërgojnë në vendet e tjera. Krejt ndryshe ishte Stalini. Pas kërkesës që i bëmë ne, ai na dërgoi specialistë sovjetikë në Shqipëri. Një herë m'u drejtua me këto fjalë: «Nuk mund t'ju lejoj, shoku Enver Hoxha, t'u paguani specialistëve sovjetikë që ju kemi dërguar në Shqipëri më shumë nga sa marrin specialistët shqiptarë». Kurse Hrushovi, kur erdhi në fuqi, bëri të kundërtën, pikërisht atë që thoni tani ju në lidhje me vendin tuaj, duke na kërkuar që specialistëve sovjetikë t'u jepnim rroga shumë të mëdha.

Eksperienca tregon se popujt, si në luftën për çlirim shoqëror e kombëtar ashtu edhe në ndërtimin e vendit, duhet të mbështeten në radhë të parë në forcat e veta. Ndihma që të japin miqtë është vetëm ndihmë. Por edhe kjo do parë mirë, sepse mund të jetë ndihmë internacionaliste si ajo e Stalinit, por mund të jetë dhe e ashtuquajtur ndihmë e spekulatorëve revizionistë, të cilën nuk ke ç'ta duash. Ndaj atyre që të ofrojnë një «ndihmë» të tillë për interesa politike dhe ekonomike nuk ke se si të mos revoltohesh. Le të marrim revizionistët jugosllavë, të cilët gjithashtu spekulojnë. Ata kudo përpiqen të shfrytëzojnë deri edhe besimet fetare, duke dërguar në vendet me popullsi myslimane ambasadorë që vetëm emrin kanë myslimanë. Ne e dimë çfarë bëjnë këta ambasadorë në vendet ku janë akre-

dituar. Duke qenë hipokritë, ata ndryshe flasin, ndryshe veprojnë.

Në Jugosllavi, në krahinën e Kosovës, jetojnë rreth 1 milion shqiptarë. Shqiptarët janë njerëz të fortë, të qëndrueshëm, dhe titistët nuk kanë mundur t'i asimulojnë. Këtë, jugosllavët e dinë, prandaj vazhdimisht kanë zhvilluar një terror të madh kundër shqiptarëve, qysh në kohën e kralëve. Një politikë të tillë kundër shqiptarëve vazhdoi edhe klika e Titos. Me anën e fesë dhe nën maskën se shumica e shqiptarëve kosovarë janë myslimanë, titistët ose i konsiderojnë ata turq, prandaj i dërgojnë me shumicë në Turqi, ose i detyrojnë t'i nënshtrohen ligjit të tyre që nuk është ligj socialist. Territoret ku banojnë shqiptarët në Jugosllavi janë më të prapambeturat ekonomikisht. Besoj se ju keni dëgjuar se si çmimet në Jugosllavi ngjiten përpjetë jo me shkallë, por me ashensor. Këtë e thonë vetë Titoja dhe udhëheqësit e tjerë jugosllavë. Një politikë të egër shfrytëzimi ndjek shteti jugosllav ndaj shqiptarëve, për t'i mbajtur të shtypur dhe për t'i shfrytëzuar sa më shumë.

Sot popujt po sqarohen gjithnjë e më shumë edhe për sa u përket revizionistëve jugosllavë, prandaj këta po pësojnë vazhdimisht disfata. Në situatat e sotme ndërkombëtare që po ndryshojnë, popujt e Jugosllavisë e kuptojnë se ku po i çon klika revizioniste e Titos.

Qeveria juaj për shumë probleme është treguar vazhdimisht dakord me tonën. Ne kemi nënshkruar bashkërisht edhe një marrëveshje tregtare, kulturore dhe shkencore. Të dy palët e kemi të qartë, nuk duam t'i

japim mësime njëri-tjetrit, por eksperiencë mund t'i japim.

Na vjen keq që do të largoheni shpejt nga Shqipëria, por dëshirojmë që të vini edhe herë të tjera.

Me këtë rast ju lutemi t'i transmetoni ndjenjat tona më të nxehta revolucionare dhe urimet më të mira popullit të Malit, të cilin e duam si vëllain tonë dhe i urojmë atij suksese gjithnjë e më të mëdha. Edhe në të ardhmen do të përpiqemi ta zhvillojmë gjithnjë më shumë miqësinë midis dy popujve tanë. Shqipëria është atdheu i një populli të vogël, por të jeni të sigurt se te ne ju keni e do të keni një mik të vërtetë të popullit tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

MBROJTJA DHE ZBATIMI I LIGJEVE — DETYRË E SHENJTË E POLICISË POPULLORE

Përshëndetje drejtuar efektivit të Policisë Popullore

14 maj 1965

Të dashur shokë të Policisë Popullore!

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të gjithë komunistëve, të popullit tonë dhe në emrin tim personal, ju përshëndes nga zemra me rastin e festës suaj jubilare, 20-vjetorit të krijimit të Armës së Policisë Popullore dhe ju përgëzoj për sukseset që keni arritur në punë, si edhe për kontributin që keni dhënë në forcimin dhe në konsolidimin e rendit tonë socialist.

Policia jonë Popullore, pjesë e forcave tona të lavdishme të armatosura, e krijuar nga Partia dhe Qeveria për t'u shërbyer interesave të popullit, i ka kryer dhe po i kryen me nder dhe me devotshmëri detyrat shumë të rëndësishme që i janë ngarkuar. Shumë nga kuadrot e Policisë Popullore janë vënë në shërbim të atdheut dhe të popullit qysh gjatë Luftës heroike Nacionalçlirimtare, duke luftuar me armë në dorë kundër pushuesve dhe tradhtarëve të vendit. Të tjerë më të rinj, së bashku me shokët e tyre të luftës, kanë kryer dhe po

e kryejnë me nder detyrën që u është ngarkuar gjatë këtyre 20 vjetëve.

Efektivi i Policisë sonë Popullore përbëhet, pra, nga bij besnikë të popullit shqiptar, patriotë të flaktë, tri- ma, të ndërgegjegjshëm, të ndershëm, të thjeshtë e të dashur, të lidhur ngushtë me masat, me zemër e shpirt të pastër e që janë të gatshëm në çdo moment të japin edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre, për interesat e popullit dhe të atdheut. Ja përse efektivi i Policisë sonë Popullore gëzon dashurinë dhe besimin e gjithë masave tona punonjëse. Qëndrimi dhe puna juaj e përditshme, të mbështetura në ligjet e Republikës, në porositë dhe në vendimet e Partisë dhe të Qeverisë, çmohen nga i madh e i vogël, nga gjithë qytetarët në vendin tonë, të cilët shikojnë te ju shokun, birin e vëllanë e tyre.

Mbrojtja dhe zbatimi i ligjeve ka qenë dhe është detyrë e shenjtë kryesore e Policisë sonë Popullore qysh nga dita e krijimit të saj. Ju kurdoherë keni qenë në nivelin e detyrës për ruajtjen e rendit tonë juridik nga kushdo që kërkon ta cenojë sadopak atë.

Në kushtet e rrethimit kapitalist dhe revizionist, populli ynë, i udhëhequr me urtësi nga Partia jonë heroike e Punës, me vrull dhe entuziazëm po ndërton me sukses socializmin. Vendi ynë po zbukurohet e po forcohet çdo ditë e më tepër. Në arritjen e sukseseve të mëdha historike të popullit shqiptar në përgjithësi e veçanërisht në forcimin e pushtetit tonë popullor dhe në zbatimin e ligjshmërisë sonë socialiste, policia jonë ka dhënë kontributin e saj të vlefshëm. Duke bërë sot bilancin e veprimtarisë suaj 20-vjeçare, ju, shokë, keni

përse të krenoheni, sepse së bashku me gjithë popullin edhe ju keni kontribuar në ndërtimin e Shqipërisë sonë të shtrenjtë socialiste, që qëndron e do të qëndrojë e pamposhtur në shekuj.

Populli ynë e ka të qartë perspektivën. Duke ndjekur me vendosmëri mësimet e Partisë së Punës dhe në unitet të pathyeshëm me të, ai do të realizojë suksese të reja edhe më të mëdha në të ardhmen. Po ne jemi të ndërgjegjshëm se ngjitja jonë e pandërprerë, shokë, drejt objektivave më të lartë nuk do të jetë e lehtë, pa pengesa e pa vështirësi, përderisa në botë do të ekzistojnë imperializmi, revizionizmi dhe armiqtë e tjerë.

Imperialistët amerikanë, satelitët e tyre, ashtu si dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit, revizionistët modernë hrushovianë dhe titistë, ushqejnë një armiqtësi të madhe ndaj Partisë së Punës, Republikës sonë Popullore, popullit dhe atdheut tonë. Ata, ashtu si deri tani, do të përpiqen të shfrytëzojnë çdo rast e mundësi për qëllime armiqësore dhe do të aktivizojnë çdo mbeturinë të shoqërisë sonë për të realizuar qëllimet e tyre djallëzore.

Ju takon edhe juve, shokë të policisë, që planeve kriminale të armiqve të popullit, kur është rasti, në bashkëpunim të ngushtë me popullin dhe me organet e tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme t'u prisni, ashtu si gjithmonë, rrugën, t'i zbuloni me kohë e t'i godisni me ashpërsinë e duhur, duke bërë drejt diferencimin midis elementëve të ndërgjegjshëm dhe atyre që kanë gabuar. Puna edukative që ju duhet të bëni me njerëzit duhet të jetë e vazhdueshme. Rëndësi të madhe dhe kryesore ka gjithashtu që puna juaj të arrijë që çdo

krim eventual ta zbuloni në tentativë, pa u kryer akoma, sepse në këtë mënyrë do të evitonit çdo dëm që mund t'u bëhej interesave të atdheut dhe do t'i sillni kështu një shërbim akoma më të vyer çështjes për të cilën ju kanë ngarkuar Partia dhe Qeveria.

Shërbimet tuaja janë shumë të gjera e komplekse, të lidhura ngushtë me tërë jetën e popullit e zhvillimin e pandërprerë të atdheut tonë socialist. Prandaj, ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen prej jush kërkohen njohuri të përgjithshme e kulturë profesionale në nivel të lartë, për të cilat jo vetëm që duhet të bëni të gjitha përpjekjet t'i përvetësoni, por edhe t'i vini në zbatim. Kërkohet që ju t'i forconi gjithnjë e më shumë lidhjet me masat punonjëse, të përmirësoni vazhdimisht e më shumë qëndrimet dhe sjelljen me to, si gjatë shërbimit, ashtu dhe jashtë tij.

Komiteti Qendror i Partisë dhe unë personalisht kemi besim të plotë se organet e repartet e Policisë sonë Popullore, të udhëhequra si kurdoherë nga Partia, ashtu si deri tani edhe në të ardhmen do të punojnë me të gjitha forcat që shërbimi dhe niveli i kryerjes së detyrave nga ana juaj të ngrihen në një shkallë edhe më të lartë.

Duke shfrytëzuar këtë rast, ju uroj, të dashur shoqë, gëzuar 20-vjetorin e festës suaj dhe suksese kurdoherë më të mëdha në realizimin e detyrave shumë të rëndësishme që ju janë ngarkuar!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 115 (5211), 14 maj 1965

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

IMPERIALIZMI NUK E KA NDRYSHUAR DHE NUK E NDRYSHON KURRË NATYRËN E TIJ AGRESIVE

*Nga biseda me delegacionet e Federatës Pankineze
të Bashkimeve Profesionale, të rinisë dhe
të gazetarëve kinezë*

17 maj 1965

Pasi mysafirët u pritën ngrohtësisht dhe zunë vendet, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Jemi shumë të gëzuar që kemi në mes nesh, shokë kinezë të bashkimeve profesionale, të rinisë dhe të gazetarëve. Për ne, ju shokë kinezë, jeni vëllezër dhe miq të dashur. Populli ynë është një popull i vogël në krahasim me popullin tuaj të madh, por që të dy janë të lidhur midis tyre me një miqësi të ngushtë. Marksizmi na mëson se nuk ka popull të madh dhe të vogël në kuptimin marksist-leninist, ndërsa në kuptimin material, natyrisht ka.

I udhëhequr nga Partia, populli i vogël shqiptar u qëndron përballë imperializmit, revizionizmit modern dhe reaksionarëve të të gjitha vendeve. Por ne nuk jemi vetëm. Proletariati dhe popujt e botës, partitë e

reja komuniste marksiste-leniniste që janë krijuar e po krijohen, gjithë njerëzit përparimtarë e revolucionarë janë me ne. Bile edhe në vetë BS e në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës njerëzit, proletarët, masat e shtypura dhe gjithë komunistët e vërtetë janë me ne. Të gjithë ne na bashkon një forcë e madhe, e kështu të bashkuar përbëjmë armatën kolosale të marksizëm-leninizmit, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin si mishi me thoin.

Popujt që luftojnë për të drejtat e tyre, për liri dhe socializëm jo vetëm nuk kanë frikë nga imperializmi dhe agjentët e tij revizionistët modernë, përkundrazi, i kanë shumëfishuar forcat e tyre në luftën për jetë a vdekje kundër këtyre armiqtve të egër. Kur rronin Lenini dhe Stalini, kur Partia Komuniste e BS ishte në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, njerëzimit i kishin lindur shpresa dhe i ishin hapur perspektiva të mëdha. Por me ardhjen në fuqi të Hrushovit këto shpresa dhe perspektiva u errësuan. Periudha e re në historinë e njerëzimit pas tradhtisë së udhëheqjes sovjetike ngriti në shkëlqimin e vet drejtësinë e marksizëm-leninizmit, tek i cili edhe vetë komunistët e vërtetë marksistë-leninistë sovjetikë kanë besim, shpresë dhe një mbështetje për rregullimin e situatës brenda në Bashkimin Sovjetik, për likuidimin atje të revizionizmit modern dhe të tradhtisë. Këtë të vërtetë ne shqiptarët e themi hapur dhe të gjithë komunistët dhe popujt e tjerë duhet ta thonë me zë të lartë dhe haptazi.

Ne ndjekim dhe studiojmë me kujdes situatën që po zhvillohet aktualisht dhe, si marksistë e patriotë që jemi, zbatojmë gjer në fund vijën e Partisë sonë dhe

jemi optimistë. Frikë nga imperializmi as nuk kemi pasur dhe as nuk kemi. Kur themi që nuk kemi frikë, nuk gjykojmë si aventurierë, por duke analizuar realisht situatat. Rruga në të cilën ka ecur Partia jonë në bazë të një analize marksiste të forcave në arenën ndërkom-bëtare të socializmit, nga një anë, dhe të kapitalizmit së bashku me ato të revizionizmit modern, nga ana tjetër, është e drejtë. Duke e bërë drejt këtë analizë, Partia dhe populli ynë veprojnë në mënyrë që situatat konkrete, morale dhe materiale të zhvillohen e të forcohen në mënyrë të tillë që jo vetëm të shkaktojnë dobësimin, por edhe shkatërrimin e armiqve imperialisto-revizionistë. Mbi këtë bazë Partia jonë e udhëheq drejt popullin që të jetojë me situatat dhe të punojë për ta zhvilluar vendin me një ritëm të pandalshëm si nga ana materiale, ashtu edhe politiko-morale, pa marrë parasysh pengesat e mëdha që na shkaktojnë imperialistët dhe revizionistët. Këto pengesa tregojnë edhe një herë se imperializmi nuk ka ndryshuar dhe kurrë nuk do ta ndryshojë natyrën e tij agresive e luftënxitëse. Dhe në fakt ai po përgatitet për luftë. Duke pasur parasysh natyrën e tij agresive dhe përgatitjet për luftë, ne nuk mund të kemi asnjë iluzion se imperializmi do të bëhet qengj, prandaj vazhdimisht i duhet rënë në kokë për vdekje. Këtë Partia dhe populli ynë e kanë kuptuar drejt në rrugë marksiste-leniniste.

Imperialistët ndihmohen në planet e tyre edhe nga revizionistët modernë hrushovianë, titistë etj., të cilët u shërbejnë atyre nën maskën e marksizëm-leninizmit.

Në fakt, revizionistët punojnë për të demoralizuar komunistët e patriotët kudo në botë, për t'i frikësuar dhe për t'i larguar ata nga lufta revolucionare kundër imperializmit, për t'i tmerruar me shantazhin atomik, për t'i degjeneruar shpirtërisht, për të shkatërruar partitë marksiste-leniniste dhe për të përgatitur kështu terrenin moralo-psikologjik, ekonomik dhe ushtarak që imperializmi të dominojë, domethënë të vendosë kudo në botë hegjemoninë e tij. Por në situatat aktuale imperializmi në përgjithësi po dobësohet dhe imperializmi amerikan veçanërisht po pëson disfata të njëpasnjëshme. Sidomos në Vietnam ai ndodhet në pozita jashtëzakonisht të vështira, gjë që i bën imperialistët amerikanë, dhe bashkë me ta edhe revizionistët modernë sovjetikë, agjentë të imperialistëve, të demaskohen çdo ditë e më shumë e të dobësohen. Kjo është një analizë e drejtë e situatës ndërkombëtare. Kësaj analize i përshtaten të gjitha orientimet dhe veprimet tona.

Ne gjykojmë se revizionistët modernë janë të destinuar të shkatërrohen. Natyrisht ne nuk mund ta përcaktojmë afatin e këtij shkatërrimi për dy, tre ose më shumë vjet, por ata do të shkatërrohen. Këtë e shohin edhe imperialistët e vetë revizionistët modernë, të cilët e ndiejnë forcën e madhe të marksizëm-leninizmit, që rritet çdo ditë e më shumë. Shantazhi dhe mburrjet e tyre, në brendinë e vet, përmbajnë frikën e tmerrshme që kanë, disfatën që i pret. Ne e shohim këtë, se i mbajmë sytë hapur dhe kemi besim në forcat tona, në mundësitë tona krijuese, në forcën morale të komunistëve dhe të popujve, në unitetin e popullit me Partinë dhe në zhvillimin material të shoqërisë sonë socialiste, kurse

armiqtë tani kanë frikë nga kjo. Arma më e fuqishme kundër imperializmit janë popujt. Ja, amerikanët kanë mbi 10 vjet që po luftojnë në Vietnam dhe me gjithë mjetet moderne që po përdorin, vetëm disfata kanë korrur, ndërsa luftëtarët heroikë vietnamezë kanë arritur të çlirojnë katër të pestat e territorit, hedhin në erë aerodrome, trena, gjer ambasadën amerikane në Sajgon. Imperialistët amerikanë tani janë detyruar të sjellin forca të reja në Vietnam, ku kanë humbur ushtarakisht dhe politikisht. Prandaj, në qoftë se do të bëjnë «shaka» të fillojnë luftë edhe me vende të tjera, vdekja e tyre do të jetë e sigurt. Një gjë të tillë ata e llogaritin. Dhe sa më shumë kohë që kalon, aq më e vështirë bëhet gjendja për ta. Edhe Kosiginit e hrushovianëve të tjerë u ka hyrë frika në palcë nga zgjerimi i luftës klasore kudo në botë, nga zgjerimi i lëvizjes marksiste-leniniste. Ndjenjat shoviniste imperialiste të shtetit të madh të hrushovianëve nuk do të kenë sukses, sepse fronti ynë antiimperialist e antirevizionist është i pathyeshëm. Përveç kësaj, edhe pozitat e tyre brenda në BS po dobësohen jashtëzakonisht, ashtu siç po dobësohen edhe ekonomikisht.

Në këto situata, për ne, natyrisht, lindin detyra të mëdha. Ne shqiptarët jemi të ndërgjegjshëm për to dhe luftojmë në këtë drejtim bashkë me popujt e tjerë dhe me të gjitha partitë marksiste-leniniste që të dështojnë imperializmi dhe revizionizmi në veprën e tyre armiqësore shkatërruese. Natyrisht, lufta jonë e përbashkët ka bërë që revizionistët të demaskohen. Megjithatë, ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi akoma më shumë për të bërë e për të vepruar kundër tyre ideologjikisht, poli-

tikisht dhe organizativisht, me qëllim që revizionizmi modern të marrë edhe më shumë të tatëpjetën.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që imperialistët amerikanë të dërrmohen në Vietnam. Në vendin tonë ka kohë që po zhvillohet një fushatë e madhe në mbrojtje dhe në solidaritet të plotë vëllazëror me popullin vietnamez. Vietnami është një nga pikat më nevralgjike të luftës sonë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Populli vietnamez, i mbështetur fuqimisht nga popujt tanë dhe nga të gjitha forcat anti-imperialiste, do të fitojë. Ne jemi plotësisht të bindur se amerikanët do të pësojnë atje disfatën më të madhe, prandaj ne do ta forcojmë edhe më shumë luftën tonë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Lidhur me këto detyra të mëdha, në fushën ideologjike e politike, kemi përpara edhe detyra ekonomike, ngritjen dhe forcimin e potencialit ekonomik të vendit tonë. Populli ynë i është përveshur punës që të arrijë çdo vit e më shumë përparime ekonomike, që ekonomia jonë të zhvillohet me ritme të shpejta, në përputhje me situatat, me nevojat, duke u dhënë prioritet problemeve më të domosdoshme, në radhë të parë, problemit të mbrojtjes. Në këtë drejtim ne shqiptarët kemi arritur suksese dhe do të vazhdojmë të bëjmë përpjekje edhe më të mëdha në rrugën tonë për ndërtimin e socializmit, që është njëkohësisht edhe rruga e forcimit dhe e përgatitjes kundër rrezikut që na kërcënon me luftë, imperializmit e revizionizmit.

Që të arrihen këta objektiva është e domosdoshme që të punohet për kalitjen e ndërgjegjes së njerëzve tanë, për t'i bërë të aftë të përballojnë problemet kon-

krete aktuale dhe të ardhshme që i vihen vendit tonë. Ne po punojmë që këto probleme të shikohen jo vetëm në lëmin e brendshëm kombëtar, por edhe në atë ndër-kombëtar. Prandaj në punën e saj Partia jonë po bën të gjitha përpjekjet për të kalitur dhe për të farkëtuar të tillë njerëz që të ndërtojnë socializmin, të ngrenë ekonominë, të forcojnë mbrojtjen e vendit, të jenë të fortë dhe të përgatitur për çdo eventualitet, që çdo rrezik të mos e gjejë popullin tonë në gjumë. Partia jonë synon në radhë të parë të arrijë kalitjen politike dhe ideologjike të klasës punëtore, të rinisë dhe të të gjitha masave punonjëse të vendit. Në këtë drejtim shërben në shkallë të gjerë edhe shtypi me artikujt e tij teorikë dhe politikë. Partia jonë e ka bërë atë ushqim për të gjithë punonjësit. Orientimi i drejtë i Partisë sonë për edukimin e masave nuk është diçka e rastit. Ai mbështetet në marksizëm-leninizmin dhe në eksperiencën e praktikën tonë revolucionare. Imperialistët dhe revizionistët modernë ne na quajnë si gramafoni i Kinës. Por ne kurrë nuk kemi qenë dhe as bëhemi gramafon i të tjerëve. Këtë e kanë të qartë të gjithë. Busull për ne është marksizëm-leninizmi, mbi bazën e të cilit ne kemi pozitë tona të drejta që i mbrojmë me çdo mënyrë.

Ardhja e delegacioneve tuaja në Shqipëri është një gjë e frytshme. Takimet me rininë, me punëtorët tanë, me kooperativistët, gazetarët dhe masat e tjera punonjëse të vendit tonë, bisedimet që do të bëni me ta do të jenë një kontribut i vlefshëm për forcimin e miqësisë midis dy popujve tanë. Kina dhe Shqipëria janë larg njëra-tjetrës, por kur përfaqësues nga populli juaj

vijnë në Shqipëri, populli shqiptar i pret dhe i trajton ata si miq, si luftëtarë të çështjes sonë të përbashkët. Ne e dimë se ju kur të ktheheni në Kinë do t'i flisni popullit tuaj për vendin tonë, për luftën e popullit shqiptar, për vështirësitë dhe sukseset tona dhe kësisoj do të kalitet edhe më tej miqësia e madhe që është duke u farkëtuar midis dy vendeve.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 29-të V—X

1965

NATYRA KAPITALISTE E «VETADMINISTRIMIT
PUNËTOR» JUGOSLLAV NË DRITËN E KONGRE-
SIT TË 8-TË TË LKJ — Artikull i botuar në gazetën
«Zëri i popullit» (7 shkurt 1965) 1—51

METODA DHE PROGRAMI I PUNËS SË ORGANIZA-
TAVE-BAZË TË PARTISË TË JENË MODEL PËR TË
GJITHË PUNONJËSIT — Fjala në mbledhjen e ple-
numit të Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës
(8 shkurt 1965) 52—90

FORCIMI I PARTISË ËSHTË HALLKA KRYESORE
— Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të
PPSH (13 shkurt 1965) 91—99

Ç'FSHIHET PRAPA MBLEDHJES FRAKSIONISTE
TË 1 MARSIT QË PO PËRGATITIN REVIZIONISTËT
HRUSHOVIANË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri
i popullit» (16 shkurt 1965) 100—118

REALIZIMI I PLANIT KËRKON DITURI, ORGANI-
ZIM, PUNË SISTEMATIKE — Fjala në Plenumin e
14-të të KQ të PPSH (18 shkurt 1965) 119—148

- TROJKA HRUSHOVIANE BREZHNJEV-KOSIGIN-
-MIKOJAN NË RRUGËN E MOHIMIT DHE TË SA-
BOTIMIT TË LUFTËRAVE ÇLIRIMTARE TË PO-
PUJVE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popu-
llit» (3 mars 1965) 149—164
- SHKOLLA JONË ËSHTË POLITIKE DHE IDEOLO-
GJIKE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të
KQ të PPSH (9 mars 1965) 165—179
- KUR NJË POPULL QË LUFTON KA NË KRYE
QEVERINË E TIJ, U THOTË TË TJERËVE SE AI
ËSHTË ZOT NË VENDIN E VET — Nga biseda me
ambasadorin e RP të Kinës, Shy Gjian Guo
(16 mars 1965) 180—191
- MBLEDHJA PËRÇARËSE, REVIZIONISTE E 1 MAR-
SIT — NJË KOMPLOT I MADH KUNDËR MARK-
SIZËM-LENINIZMIT DHE KOMUNIZMIT NDËR-
KOMBËTAR — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i
popullit» (18 mars 1965) 192—234
- TË MBROSH ME GJAK LIRINË E PAVARËSINË E
VENDIT TËND ËSHTË PATRIOTIZËM I MADH,
VIRTYT I MADH — Nga biseda me një delegacion të
PK të Kolombisë (marksiste-leniniste) i kryesuar nga
shoku Pedro Vaskues (20 mars 1965) 235—253
- SHQIPËRIA SOCIALISTË I KA KRYER DHE DO T'I
KRYEJË DERI NË FUND DETYRAT E SAJ PËR TRI-
UMFIN E MARKSIZËM-LENINIZMIT — Nga biseda
me delegacionin e partisë e të qeverisë së Kinës, të
kryesuar nga Çu En Lai (27-28 mars 1965) 254—295
- RINIA — FORCË E MADHE PËR NDËRTIMIN E
SOCIALIZMIT — Nga fjala në konferencën e Bash-

kimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë të rrethit të Elbasanit (4 prill 1965)	296—323
TË NGRIHEMI NË KËMBË PËR NDËRTIMIN E VEPRËS SË MADHE TË METALURGJISË SË ZEZË NË ELBASAN — Nga fjala para kuadrove të Partisë të rrethit të Elbasanit (5 prill 1965)	324—351
·INVESTIMET T'I MATIM ME REZULTATET QË ARRIJMË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 prill 1965)	352—361
PUNA SHKENCORE KËRKON PASION, DISIPLINË, METODË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 prill 1965)	362—370
GRUPI TRADHTAR I REVIZIONISTËVE SOVJETIKË PËRKRAH IMPERIALISTËT AMERIKANË NË AGRESIONIN KUNDËR VIETNAMIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (20 prill 1965)	371—391
KUFITARËT TRIMA JANË KURDOHERË NË MBROJTJE TË ATDHEUT TONË SOCIALIST — Përshëndetje drejtuar forcave të kufirit (25 prill 1965)	392—395
REVIZIONISTËT MODERNË — LIKUIDATORËT MË TË MËDHENJ NË HISTORINË E LËVIZJES KOMUNISTE NDËRKOMBËTARE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (25-26 prill 1965)	396—472
LUFTA E POPULLIT TË VIETNAMIT TË JUGUT VËRTETON PARIMIN SE LIRIA NUK DHUROHET, POR FITOHET — Nga biseda me një delegacion të Shoqatës së Punonjësve për çlirimin e Vietnamit të Jugut (30 prill 1965)	473—484
LUFTËN KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT DO TA ZHVILLOJMË DERI NË FITO-	

- REN E PLOTË TË MARKSIZËM-LENINIZMIT — Nga biseda me përfaqësues të komunistëve marksistë-leninistë të Francës (30 prill 1965) 485—496
- NDIHMA QË MARKSISTË-LENINISTËT I JAPIN NJËRI-TJETRIT ËSHTË NDIHMË INTERNACIONALISTE — Nga biseda me përfaqësues të rretheve marksiste-leniniste të Italisë (30 prill 1965) 497—509
- MARKSIZËM-LENINIZMI KA TRIUMFUAR DHE DO TË TRIUMFOJË KURDOHERË — Nga biseda me një delegacion të PK të Spanjës (marksiste-leniniste) (30 prill 1965) 510—524
- PËR PRANIMET NË PARTI TË ECIM KURDOHERË NË MËNYRË SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (7 maj 1965) 525—530
- PUNA E SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT ËSHTË SHUMË SERIOZE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (7 maj 1965) 531—538
- PROBLEMET E SHKOLLËS STUDIOHEN E ZGJIDHEN SIPAS KUSHTEVE TË REJA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 maj 1965) 539—545
- KUR KE POPULLIN ME VETE MUND TË KALOSH ÇDO VËSHTIRËSI — Nga biseda me një përfaqësues të grave të Malit (10 maj 1965) 546—560
- MBROJTJA DHE ZBATIMI I LIGJEVE — DETYRË E SHENJTË E POLICISË POPULLORE — Përshëndetje drejtuar efektivit të Policisë Popullore (14 maj 1965) 561—564

**IMPERIALIZMI NUK E KA NDRYSHUAR DHE NUK
E NDRYSHON KURRË NATYRËN E TIJ AGRESIVE**

— Nga biseda me delegacionet e Federatës Pankineze
të Bashkimeve Profesionale, të rinisë dhe të gazetarëve
kinezë (17 maj 1965)

565—572

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1969